
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i tridhjetë)

Nga fillimi i sures "Nebe" deri në fund të sures "Nas"

TIRANË, 2021

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzetenëntë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga persishtja: ***Rajmonda FEZA***

E redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Sure "En Nebe"

Zbritur në Mekë

Ajete 40

Përmbajtja e sures "En Nebe"

Në parim, shumica e sureve të xhuzit të fundit të Kur'anit kanë zbritur në Mekë dhe më shumë se për çdo gjë ato flasin për çështjen e *"Krijimit" - "El Mebde'u"*, *"Ringjalljes" - "El Meadu"*, paralajmërimit e përgëzimit. Në përgjithësi, toni i ajeteve është i vrullshëm dhe tronditës. Të gjitha ajetet, përveç disa rasteve, janë të shkurtra, si dhe të mbushura me referenca, ndaj dhe kanë një ndikim shumë të thellë te çdo njeri i vetëdijshëm. Po ashtu, të pavetëdijshmit i zgjon dhe trupave të pajetë u jep jetë. Personave indiferentë u jep ndjesinë e përgjegjësisë. Ajetet kanë një botë të saj, e cila është plot reagime e lëvizshmëri.

Surja "En Nebe" nuk është e ndryshme nga suret mekase për nga natyra e tyre e përmbajtjes. Përmbajtja e sures "En Nebe" mund të përmblidhet në disa pjesë:

1- Pyetja që bëhet në fillim të sures, për ngjarjen e madhe, *"Ditën e Kiametit"- "Nebeul Adhijm"*, e cila është një ndodhi mjaft e frikshme.

2- Argumentimi i Ringjalljes nëpërmjet dukurive të fuqisë së All'llahut të Madhëruar, në qiej, në tokë, në jetën e njerëzve dhe në mirësitë e Tij.

3- Në një tjetër pjesë të sures flitet për shenjat e fillimit të Ringjalljes.

4- Në pjesën e katër të saj flitet për një pjesë të dënimit të dhimbshëm, që kanë për të pasur mëkatarët.

5- Pjesa e pestë flet për një pjesë të mirësive dhe dhuratave të jashtëzakonshme të Xhennetit.

6- Në përfundim, në pjesën e gjashtë, flitet për dënimin e madh, që është shumë afër, si dhe për të ardhmen e dhimbshme të jobesimtarëve, *"kafirun"*.

Emërtimi i kësaj sureje është bërë për shkak të interpretimit të dhënë në ajetin e dytë të saj, por ndonjëherë interpretohet si surja "A'mme" në përputhje me ajetin e parë.

Mirësitë e leximit të sures "En Nebe"

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Ai që lexon suren "En Nebe", All'llahu i Madhëruar do t'i heqë etjen në Ditën e Kiametit."*[1]

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Një person që lexon çdo ditë suren "En Nebe", do të shkojë në Haxh pa u mbushur një vit (nga momenti që ka nisur të lexojë suren."*[2]

Po ashtu, në një hadith tjetër të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush e lexon dhe e mëson përmendësh suren "En Nebe", koha e llogarisë së tij në Ditën e Kiametit do të jetë sa koha e faljes së një namazi."*[3]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 1 f. 42.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 1 f. 42.
[3] Tefsiri "El Burhan", vëll. 4, f. 419.

Ajetet 1 – 5

﴿بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ﴾

﴿عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ١ عَنِ النَّبَإِ الْعَظِيمِ٢ الَّذِى هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ٣ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ٤ ثُمَّ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ٥﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin?"

"Për Lajmin e madh."

"Rreth të cilit ata kanë kundërshtime."

"Ani, shpejt do ta marrin vesh!"

"Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!"

Komentimi

Lajm i rëndësishëm!

Ajeti i parë i kësaj sureje, me një pyetje të përzier me çudi, thotë: **"Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin?"**.[1]

Pas asaj, duke mos e pritur përgjigjen, vetë ata përgjigjen: **"Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime."**.

Cili është lajmi i madh që përmendet në ajet?

Në lidhje me këtë, komentuesit kanë dhënë shpjegime të ndryshme.

Një grup prej komentuesve, thonë se tregon për Ditën e Kiametit. Disa të tjerë thonë se tregon për zbritjen e Kur'anit. Dhe disa të tjerë thonë se ai lajm i madh tregon për parimet e fesë, duke u nisur nga Njësimi (Teuhidi) e deri te Ringjallja.

Disa transmetime e komentojnë për çështjen e vilajetit dhe të imametit (udhëheqësisë), të cilën do ta përmendim në hulumtimet që do të vijnë.

Me një vështirm të thelluar në ajetet e kësaj sureje, sidomos në sqarimin që vjen pas ajetit *"Ine jeumel fasli kane mijkata"* ku përmenden shenjat e fuqisë së All'llahut në tokë dhe në qiell, si dhe vëmendja ndaj të vërtetës së Ringjalljes *(El Mead)*, të cilën e

[1] Fjala *"a'mma -* عمَّ*"* është shkurtimi i fjalës *"a'mma -* عمّا *"* dhe është përbërë nga *"an -* عن *"* dhe *"ma -* ما *"* pyetëse.

kundërshtojnë jobesimtarët, të gjitha këto forcojnë komentimin e parë që thotë se lajmi i madh është Dita e Kiametit.

Fjala *"en nebe'u"*, sipas Ragibit, në librin "Mufredat", ka kuptimin e lajmit me dobi të madhe, pra lajm *"i rëndësishëm"* dhe *"me vlerë"* me anën e të cilit arrihet dija.

Kështu, përshkrimi i fjalës *"en nebe'u"* me fjalën *"el adhijmu"* është bërë për të përforcuar rëndësinë e atij lajmi dhe për ta bërë të prerë se ajo që disa dyshojnë në të është reale, e vërtetë dhe shumë i rëndësishëm e i rrezikshëm. Sikurse e thamë edhe më lart, ky tefsir është në përshtatje më shumë me të qenit e atij lajmi Dita e Kiametit.

Fjala *"jetesaelun"* - **"Ata pyesin njëri-tjetrin"** mund të tregojë vetëm jobesimtarët, sepse ata gjithmonë pyesin njëri-tjetrin për Ringjalljen. Pyetjet e tyre nuk ishin për të kërkuar dhe për të kuptuar të vërtetën, por ishin për qëllim dyshimi.

Ka një supozim tjetër se: Pyetja e tyre i drejtohej besimtarëve në përgjithësi dhe Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në veçanti.

Këtu është ngritur një pyetje: Nëse qëllimi i përdorimit të fjalës *"Nebeul Adhijm"* është Ringjallja, ky veprim, me sa duket, mohohej nga të gjithë jobesimtarët, atëherë përse thotë: **"Ata kanë kundërshtime"**?

Në përgjigje të saj themi: Mohimi i Ringjalljes, edhe në mesin e jobesimtarëve, nuk është i prerë në mënyrë absolute. Shumë nga ata e pranojnë qëndrimin e shpirtit pas trupit, me fjalë të tjera, në përgjithësi, e pranojnë ringjalljen e shpirtit.

Por, përsa i përket ringjalljes së trupit, disa kanë shprehur dyshimet e tyre, e kanë kundërshtuar, e kanë mohuar me forcë, sepse gjuha e ajeteve të Kur'anit atë e ka reflektuar.

"Vallë, a dinë ndopak ata për Jetën Tjetër!? Përkundrazi! Ata dyshojnë në të, ata janë të verbër ndaj saj."[1]

Po ashtu, ata, duke pretenduar të kundërtën e asaj që thoshte Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për Ringjalljen, edhe Profetin e kanë konsideruar të çmendur, si dhe e konsideruan përgojues të All'llahut. *(Zot na ruaj e na fal!)*

"Ata, të cilëve u është dhënë dituria, e shohin se ajo, që të është zbritur ty nga Zoti yt, është e vërteta, e cila të udhëzon në Rrugën e të Plotfuqishmit dhe të Denjit për çdo lavd." "Ndërsa jobesimtarët thonë: 'A doni t'ju tregojmë një njeri[2] **që pretendon se, kur të shpërbëheni plotësisht e të bëheni pluhur, ju, me siguri do të rikrijoheni nga e para?'"**[3]

Në këtë mënyrë, konflikti i tyre në çështjen e Ringjalljes nuk mund të mohohet.

Më pas shton: **"Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij, para se t'ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t'ju ndihmojë kush."**.

---

[1] Sure "Neml", ajeti 66.
[2] D.m.th. Muhamedin *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.
[3] Sure "Sebe", ajetet 7-8.

Përsëri nuk është ashtu sikurse ata mendojnë, shumë shpejt ata do të jenë të vetëdijshëm.

Atë Ditë ata do të njoftohen, zërat dhe keqardhja e tyre do të jetë e madhe. Ata do të pendohen shumë për humbjen dhe mos vëmendjen e tyre.[1]

Atë ditë, kur valët e dënimit janë përreth tyre, do të bëjnë kërkesë për t'u kthyer në këtë botë: **"Për atë që All'llahu e shpie në humbje, nuk ka mbrojtës tjetër përveç Tij. Ti do të shohësh se si keqbërësit, kur ta shohin dënimin, do të thonë: 'A ka ndonjë rrugë për t'u kthyer?'"**.[2]

Po ashtu, edhe në momentet e fundit të jetës, kur perdja largohet nga sytë e njeriut dhe, për njeriun shfaqet e vërteta e Botës Tjetër, bindet se ka Xhehennem dhe Ringjallje, atëherë në ato çaste ngrihet zëri i tij: **"O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!"**.

"Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve)**, ai thotë: 'O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!' Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai** (kot) **e thotë! Prapa** (vdekjes së) **tyre do të ketë një** (kohë) **ndarëse, deri në Ditën kur do të ringjallen."**.[3]

Fjala *"se ja'lemun"*, e cila nis me germën *"sin"*, zakonisht përdoret për një të ardhme të afërm dhe tregon: Kiameti është një

[1] Sure "Ez Zumer", ajeti 54.
[2] Sure "Esh Shura", ajeti 44.
[3] Sure "El Mu'minun", ajetet 99-100.

urdhër i afërm. E gjithë jeta jonë në këtë botë, përballë atij çasti, nuk është asgjë.

Dy ajetet e lartpërmendura, të cilat kanë ardhur në mënyrë të përsëritur, kanë për qëllim theksimin e një të vërtete: I njeh ata me një të ardhme të afërt, me Kiametin dhe Ringjalljen, ose tregon dy çështje të ndryshme, të ndara nga njëra-tjetra.

E para tregon se në një të ardhme të afërt do të shikojnë dënimin e All'llahut; e dyta tregon se dënimin e Botës së Përtejme, të Ahiretit, do ta shikojnë pas kësaj bote (pra, dynjasë). Komentuesit kanë dhënë dy mendime, por komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Po ashtu, është dhënë edhe kjo mundësi: Qëllimi i saj është se, duke pasur parasysh zhvillimin e dijes dhe të njeriut, bëhen më të shumta dëshmitë dhe argumentet për ekzistencën e Ringjalljes, saqë edhe ata që e mohojnë, nuk kanë rrugë tjetër, duhet ta pranojnë atë.

Por, problemi i këtij tefsiri është: Njohuri të tilla për brezat e ardhshëm do të jenë nga vetë njeriu dhe jo për atë grup që ka jetuar në kohën e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilët kanë pasur kundërshtime, përsa i përket çështjes së Kiametit. Ndërkohë që ajeti flet për ta.

Hulumtim

1- Çështja e *"udhëheqësisë"- "vilajet"* dhe e *"lajmit të rëndësishëm" - "Nebeul Adhijm"*

Sikurse e thamë edhe më parë, *"lajmi i rëndësishëm" - "Nebeul Adhijm"* është komentuar në disa kuptime: Kiamet, Kur'an, të gjitha parimet e besimit fetar, duke nisur që nga origjina e deri te Ringjallja. Por shenjat ekzistuese, në të gjitha ajetet e kësaj sureje, tregojnë se komentimi më i mirë është për çështjen e Ringjalljes *(El Mead)*.

Në shumë transmetime dhe hadithe, të cilat i kemi marrë si nga Ehli Bejti *(Paqja qoftë mbi ta!)*, ashtu edhe nga Ehli Syneti, tregohet se *"lajmi i rëndësishëm" - "Nebeul Adhijm"* ka të bëjë me çështjen e udhëheqjes së Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Kjo çështje ka pasur mospajtime dhe diskutime nga ana e një grupi, ose kanë patur mospajtim me çështjen e udhëheqësisë në mënyrë të përgjithshme.

Këto transmetime ndonjëherë janë transmetuar nga vetë Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe ndonjëherë nga Imamët e tjerë *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Ne do i sjellim si shembull.

1- Në një transmetim që vjen nga Hafizi, Muhammed bin Mumin Shirazi, i cili ka qenë ndër dijetarët e Ehli Synetit thuhet: "I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për komentimin e sures "En Nebe", pra, për ajetin, thotë:

Ka për qëllim *"udhëheqjen" - "vilajetin"* e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Njeriu do të pyetet në varr për të. Nuk do të largohet nga kjo botë asnjë njeri, që nuk do të pyetet pas vdekjes, për udhëheqjen e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, qofshin në Lindje apo në Perëndim të botës. Të gjithë njerëzit do të pyeten: "Cila është feja juaj? Kush është Profeti? Kush është Imami juaj?"[1]

2- Në një tjetër hadith thuhet: "Një ditë, gjatë Luftës së Sifijnit, një nga luftëtarët e Shamit u fut në fushën e betejës. Ishte i armatosur dhe Kur'anin e mbante me vete. Nisi të citojë ajetet e para të sures "En Nebe".

Imam Aliu u fut në fushën e betejës dhe i tha: *"A e di ti lajmin e rëndësishëm, që shumë udhëheqës kanë kundërshtime se kush është?!"*

Burri u përgjigj: "Jo, nuk e di!"

Imami i tha: "Unë jam ai 'lajmi i rëndësishëm', që keni kundërshtuar! Gjatë udhëheqjes sime u ngritët kundër, duke u grindur. Ju i kthyet krahët udhëheqjes sime, pasi e pranuat atë më parë. Në Ditën e Kiametit do të mësoni se çfarë veprimi keni kryer!"[2]

3- Në një tjetër transmetim të Imam Sadikut thuhet: "Lajmi i rëndësishëm është çështja e *"udhëheqjes" - "vilajetit"*."[3]

---

[1] Ebu Bekër Muhamed ibn Mu'min Esh Shirazij, "Risaletul E'tikad", sipas transmetimit "Ihkakul Hakk", vëll. 3, f. 484.
[2] Tefsiri "Burhan", vëll. 3, f. 42, Hadithi 9; "Biharul Enuar", vëll. 36, f. 2. (me pak ndryshim)
[3] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 419, Hadithi 3.

E përbashkëta midis përmbajtjes së këtij transmetimi dhe asaj që u përmend, përsa i përket çështjes së *"Ringjalljes" - "Meadit"* është:

Së pari: *"Lajmi i rëndësishëm" - "Nebe adhim"* ka një kuptim të gjerë dhe i përfshin të gjitha këto që thamë më lart, edhe pse në momentin e zbritjes së këtij ajeti theksi i Kur'anit është përqendruar te çështja e *"Ringjalljes" - "Meadit"*. Por kjo gjë nuk është pengesë për të treguar se ajeti ka edhe shpjegime të tjera.

Së dyti: Dimë dhe e kemi thënë shumë herë, se Kur'ani trajton çështje dhe kontekste të ndryshme, që do të thotë, se një ajet kur'anor mund të ketë kuptime të ndryshme dhe ndërmjet të gjithave kuptimeve, ka edhe një kuptim të brendshëm, dhe të jashtëm. Kuptimi ezoterik i Kur'anit arrihet me ndihmën e shenjave të ndryshme, ose, me fjalë të tjera, është një lloj kuptimi i nënkuptuar, të cilin nuk e kanë të gjithë personat, vetëm disa të veçantë.

Nuk është vetëm ky ajet që ka kuptime të jashtme dhe të brendshme, sepse ka plot ajete të tjera kur'anore që kanë kuptime të jashtme dhe të rendshme. Edhe transmetime islame i komentojnë shumë ajete me kuptime të ndryshme. Disa prej tefsireve janë në përputhje me të jashtmen e ajetit dhe disa tefsire të tjerë janë në përputhje me të brendshmen e ajetit.

Këtu duhet thënë se nuk lejohet rreptësisht që Kur'anit t'i vendosim kuptim të brendshëm sipas mendimit tonë, pa ekzistencën e shenjave të qarta, apo pa u bazuar në komentimin e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe të Imamëve të pastër *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Kjo, me qëllim që ekzistenca e komentimit të brendshëm të Kur'anit nuk duhet të jetë justifikim për të devijuarit, që të mund t'i komentojnë ajetet e Kur'anit si të duan ata, pra, sipas shijes së tyre.

2- Sekreti i këmbënguljes për *"Meadin" - "Ringjalljen"*

Thamë më parë se një ndër çështjet e rëndësishme që trajtohet në xhuzin e tridhjetë të Kur'anit të Shenjtë, ku shumica e sureve të këtij xhuzi kanë zbritur në Mekë, është se këto sure janë mbështetur më tepër në çështjen e *"Meadit" - "Ringjalljes"*, duke komentuar gjendjen e njerëzve në Ditën e Ringjalljes.

Ndaj njeriu duhet të dijë se, nëse dëshiron të korrigjohet, hapi i parë është të dijë se për të ka një llogaridhënie.

Ekziston një gjykatë, ku Gjykuesit nuk i fshihet asgjë.

Ekziston një gjykatë, ku në të nuk ka as dhunë e as shtypje dhe nuk bëhet asnjë gabim.

Në atë gjykatë nuk ka vlerë as rekomandimi e as ryshfeti, nuk ka mundësi as të gënjesh dhe as të mohosh. Përfundimisht, nuk ka asnjë rrugë për t'u shmangur apo për t'u larguar nga grepat e dënimit. E vetmja rrugë është që në këtë botë të hiqet dorë nga kryerja e mëkateve.

Besimi në ekzistencën gjykatës së drejtë hyjnore e nxit njeriun të vërë në lëvizje ndërgjegjen e tij, ta zgjojë atë nga shkujdesja dhe të ringjalli shpirtin e devotshmërisë dhe të ndjenjës

së përgjegjësisë. Në këtë mënyrë i fton ata të kryejnë detyrat që u janë ngarkuar.

Në parim, në çdo mjedis ku ka depërtuar korrupsioni, situata është një prej këtyre dy gjendjeve: Dobësimi i kujdesit, ose dobësimi i organizatës së drejtësisë. Nëse kujdestarët, të cilët janë vrojtues të mirë, e marrin në konsideratë veprimin e njeriut dhe gjykata merr vendimin e duhur për shkelësit e ligjit, si dhe asnjë krim të mos mbetet pa u dënuar, patjetër që në një mjedis të tillë, korrupsioni, mëkati, dhuna, shkeljet dhe abuzimi do të jenë shumë të pakta. Në vendet ku jeta materiale është e mbuluar nga kujdestarët dhe gjykatat të tilla, jeta spirituale e njeriut është e qetë.

Besimi në ekzistencën e origjinës që çdo gjë nis me të, dhe se nuk i fshihet asgjë Krijuesit edhe në qoftëse ajo është më e vogël se sa grimca: **"Jo besimtarët thonë: 'Nuk do të na vijë Ora** (e Kiametit)**!'. Thuaju: 'Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t'ju vijë!'. Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë, as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë."**[1] Dhe besimi për ekzistencën e Ringjalljes, që e vërteta nuk humbet: **"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."**[2], pra ky besim krijon te njeriu një devotshmëri të tillë, saqë gjatë gjithë jetës mund të jetë shembull udhëzimi në Rrugën e Drejtë.

[1] Sure "Sebe", ajeti 3.
[2] Sure "Ez Zelzele", ajetet 7-8.

Ajetet 6 – 16

﴿أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا٦ وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا٧ وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا٨ وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا٩ وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا١٠ وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا١١ وَبَنَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا١٢ وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا١٣ وَأَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا١٤ لِنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا١٥ وَجَنَّاتٍ أَلْفَافًا١٦﴾

“A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat.”

“E malet si shtylla?!”

“Ne ju kemi krijuar në çifte.”

“Dhe gjumin jua kemi bërë për prehje.”

“Natën jua kemi bërë mbulesë.”

“ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar.”

“Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë.”

“Dhe kemi vënë kandil (diell) **të shndritshëm!”**

“Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme”

“Për rritjen e drithërave, bimëve.”

“Dhe të kopshteve të dendura.”

Komentimi

Çdo gjë është me urdhërin Tënd o Zot

Këto ajete janë përgjigje për pyetjet e mohueseve të Ringjalljes, si dhe të kundërshtarëve për *"lajmin e rëndësishëm"* - *"nebeul adhijm"*, për shkak se janë një pjesë e vogël e sistemit të urtësisë së universit. Ato janë konsideruar si dhuratë dhe kanë një rol shumë të rëndësishëm dhe me shumë ndikim në jetën e njerëzve. Nga ana tjetër, këto ajete janë një argument i qartë, përsa i përket fuqisë së All'llahut të Madhëruar, mbi gjithçka, edhe për ringjalljen e të vdekurve.

Nga ana tjetër, i referohet këtij sistemi të urtë, i cili nuk mund të jetë i kotë. Nëse jeta do të mbaronte me këtë botë materiale, atëherë sigurisht që çdo gjë do të ishte e kotë e pa vlerë.

Në këtë mënyrë kemi sjellë dy argumente, përsa i përket çështjes së Ringjalljes, që është argumenti i Fuqisë dhe argumenti i Urtësisë.

Në këto njëmbëdhjetë ajete është folur për dymbëdhjetë mirësi të rëndësishme. Të gjitha ato janë përmendur nëpërmjet interpretimeve të përziera me argument, duke nxitur emocionet, sepse, nëse pranë argumenteve racionale nuk ekziston ndjenja, fryma e vitalitetit dhe e efikasitetit të tij është i ulët.

Në fillim nis nga toka:

"A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat?!"

Fjala *"el mihadu"*, sipas Raghibit, në librin "Mufredat", ka kuptimin e një vendndodhjeje të butë dhe të rregullt. Fjala

"mehdun" - "djep" ka kuptimin e vendit, ku çlodhet fëmija. (Në përgjithësi flitet për djepin ose për shtratin). Ndërsa disa nga gjuhëtarët dhe komentuesit e kanë komentuar si *"firash" - "shtrat"*, për shkak të butësisë së tij dhe të qënit shumë i rehatshëm.

Përzgjedhja e këtij termi për tokën është me shumë kuptim, sepse, nga një anë, një pjesë e mirë e tokës është shumë e butë dhe e rregullt, ku njeriu shumë mirë mund të ndërtojë shtëpi, ta punojë atë për bujqësi, si dhe të krijojë kopshte.

Nga ana tjetër, të gjitha nevojat e njeriut janë mbi tokë ose në tokë, ku në thellësinë e saj, nga gërmimet që bëhen, merret lënda e parë, si dhe mineralet e çmuara.

Po ashtu, lënda e shtuar bën që të jetë tërheqëse, trupat e vdekur që varrosen në tokë, shumë shpejt shpërbëhen. Gjithashtu, lloje të ndryshme të mikrobeve, shkatërrohen ose zhduken nëpërmjet ndikimit të një efektit misterioz e cila është e vendosur në tokë nga dora e Krijuesit.

Toka, me lëvizjen e saj të ngadaltë dhe të shpejtë rreth Diellit dhe rreth vetes së saj, shëtit dhe sjell për njerëzit jo vetëm ditën e natën, por edhe stinët, të cilat luajnë një rol shumë të madh në jetën e njeriut.

Një tjetër rol që toka luan, është se, kur bie shi, ajo e grumbullon dhe e ruan ujin. Më pas ne e shfrytëzojmë atë si burim për nevojat që kemi.

Përfundimisht, në këtë shtrat të qetë dhe çlodhës janë vendosur të gjitha mjetet e nevojshme për qetësinë dhe rehatinë e

të gjithë fëmijëve të kësaj toke. Kur rëndësia e gjithë këtyre mirësive bëhet më e qartë, atëherë mund të ketë ndryshim.

Përballë butësisë së tokës së sheshtë flitet për rëndësinë e maleve dhe për rolin që kanë në jetë, e që janë harruar nga njerëzit. Në ajetin tjetër shton:

"E malet si shtylla?!"

Malet, përveçse kanë "rrënjë" të mëdha në thellësinë e tokës, janë të bashkangjitura sikurse është korja e tokës, e cila qëndron e fortë përballë presioneve që shkaktohen nga llava e brendshme. Efekti i gravitetit të baticës që shkaktohet nga Hëna, e mbron Tokën nga jashtë. Muret e larta, përballë tufaneve të rënda, llogariten si vendmbrojtja e sigurt për djepin e njerëzve. Nëse ato nuk do të ekzistonin, pra, nëse nuk do të ekzistonte vendmbrojtja, jeta e njeriut do të ishte gjithmonë nën goditjet e tufaneve dhe njerëzit nuk do të kishin qetësi.

Për më tepër ekziston një ligj për rezervat e ujërave, si dhe të llojeve të ndryshme të mineraleve të çmuara. Përveç kësaj, përreth Tokës ekziston një mbulesë shumë e madhe prej ajri. Malet qëndrojnë në formën e ingranazheve të një rrote, duke hedhur kthetrat e tyre të mëdha në tokë. Ato lëvizin së bashku me tokën.

Dijetarët thonë: Nëse sipërfaqja e Tokës do të ishte e sheshtë, shtresa e ajrit, në kohën që lëviz Toka, do të rrëshqiste nën të, duke shkaktuar tufane të mëdha. Po ashtu, mund të ishte e mundur që ky fërkim i vazhdueshëm do ta ngrohte shumë sipërfaqen e Tokës, saqë ajo do të bëhej vend i pabanueshëm.

Pas shpjegimit të këtyre dy shembujve nga mirësitë e Allahut dhe shenjat në horizont, Kur'ani përmend mirësitë që Allahu e ka begatuar njeriun dhe thotë: **"Ne ju kemi krijuar në çifte."**

Fjala *"ezuaxha"* është shumësi i fjalës *"zeuxh"*, që ka kuptimin *"çift"*, si dhe tregon gjininë "mashkullore dhe femërore". Krijimi i njeriut në këto dy gjini, përveçse është siguri për mbijetesën e racës njerëzore, është edhe shkaku i qetësisë së trupit dhe shpirtit të tij.

Në ajetin 21 të sures "Er Rrum" thuhet: **"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."**

Sipas një interpretimi tjetër, mashkulli dhe femra janë plotësues dhe eliminues i mangësive të njëri-tjetrit.

Sipas fjalorit, fjala *"ezuaxha"* ka kuptimin *"varietete dhe lloje"*. Disa, këtë ajet e kanë interpretuar si varietet i ndryshëm i njeriut, që vjen si pasojë e racave, ngjyrave, emocioneve dhe fuqive të ndryshme që janë te njerëzit. Të gjitha këto shenja janë tregues i madhështisë së All'llahut dhe burim i përsosmërisë së shoqërisë njerëzore.

Pas shpjegimit të krijimit në çift flet për një tjetër krijim dhe dhuratë që i bëhet njeriut, për gjumin. Pra, gjumi është një tjetër mirësi nga All'llahu i Madhëruar.

"dhe gjumin jua kemi bërë për prehje."

Fjala *"suba'ta"* vjen nga rrënja *"sebt"* me kuptimin *"el kat'u"*, *"prerje"*. Pastaj është përdorur me kuptimin e *"ndërprerjes së punës"*, pra, me kuptimin e pushimit që bëhet pas pune. Në fjalorin arab - *"dita e shtunë"* është quajtur *"jeumul sebt"*sepse jahudijtë e ndërprisnin punën në ditën e shtunë dhe e konsideronin ditë pushimi.

Interpretimi i termit *"suba'ta"*, në këtë rast, tregon butësinë me pushimin e pjesëve të mëparshme, të cilat janë të justifikuara nga aktiviteti i trupit dhe i shpirtit të njeriut në kohën kur ai fle. Ky pushim i shkurtër është shkak i qetësisë dhe i pushimit të gjymtyrëve të vjetruara, forcimit të shpirtit dhe të trupit, bën që të përtëritet fuqia e njeriut, si dhe largon çdo lodhje dhe shqetësim. Kështu, si përfundim, gjumi bën që njeriu të përtërijë aktivitetin e tij.

Megjithëse njeriu e kalon një të tretën e jetës së tij në gjumë dhe gjithmonë ka qenë përballë kësaj çështjeje, nuk e ka njohur shumë mirë sekretin e gjumit. Po ashtu, njeriu nuk e di se cilat janë shkaqet e pushimit të aktivitetit të trurit, arsyeja pse mbyllen qepallat dhe pse gjithë gjymtyrët e trupit bien në qetësi. E gjitha kjo nuk është qartësuar akoma.

Por ajo që është e kuptueshme, është se gjumi luan një rol të madh për shëndetin e njeriut. Mjekët psikiatër përpiqen që gjumin e pacientëve të tyre ta sistemojnë në mënyrë të natyrshme, sepse pa gjumin, ata nuk mund të kenë ekuilibër mendor.

Njerëzit që nuk mund të flenë në mënyrë natyrale, janë të venitur, nervozë, të dëshpëruar, të hidhëruar dhe të zemëruar.

Ndryshe janë personat që bëjnë gjumë mesatar. Ata janë të gëzuar. Kur zgjohen nga gjumi, kanë fuqi të jashtëzakonshme.

Pas një gjumi të qetë, studimi sjell efekt shumë pozitiv, po ashtu edhe aktivitetet mendore dhe fizike kanë më tepër sukses kur bëjmë një gjumë të qetë. Të gjitha këto tregojnë rolin e rëndësishëm që luan gjumi në jetën e njeriut.

Tortura më e pakët për njeriun do të ishte nëse do të kishte pagjumësi të detyruar dhe urgjente. Kjo gjë do të ishte një dhimbje e madhe. Përvoja ka treguar se durimi i njeriut përballë pagjumësisë është shumë i pakët dhe pas një periudhe kohore ai nuk do të gëzojë shëndet të mirë, pra, do të sëmuret, nëse nuk do të flejë. Në të vërtetë, ajo ç'ka u tha për rëndësinë e gjumit, nënkupton një gjumë të ekuilibruar dhe të përshtatshëm.

Përndryshe, të flesh shumë, pa pasur një ekuilibër, është një cilësi e keqe, e cila bëhet shkak i sëmundjeve të ndryshme.

Është e çuditshme se sasia e gjumit natyral për njerëzit nuk është e njëjtë. Për këtë arsye nuk ka një masë të caktuar apo të përcaktuar se sa duhet fjetur. Ndaj çdo njeri duhet të përcaktojë nevojën e tij për gjumë, sigurisht duke e bazuar këtë në aktivitetin e tij fizik dhe mendor.

Është e çuditshme se, kur ndodhin ngjarje të vështira dhe njeriu duhet të qëndrojë detyrimisht i zgjuar, rezistenca e tij përballë pagjumësisë rritet përkohësisht dhe gjumi largohet. Ndonjëherë në masën e nevojshme, pra, pagjumësia mund të përballohet dy apo tre orë. Është parë se kjo pagjumësi, ose mangësi e gjumit plotësohet kur gjendja qetësohet. Fiziku i njeriut dhe mendja e tij e rikuperon atë me qëndrim. Në të vërtetë, gjenden

pak njerëz që mund të qëndrojnë zgjuar për muaj të tërë pa vënë gjumë në sy.

E kundërta ndodh me disa persona, që, edhe kur janë duke ecur në rrugë e rrugica, apo edhe kur janë duke biseduar me dikë, flenë. Kjo gjë është e rrezikshme, nëse nuk rri dikush me ta. Sigurisht, persona të tillë nuk janë të shëndetshëm dhe, duan apo nuk duan ata, janë të përfshirë në këtë gjendje të dobët fizike dhe mendore.

Përfundimisht, ky ndryshim dhe transformim i çuditshëm "gjumi" e që gjendet te njeriu, ka çudira të shumta, që e bëjnë atë (gjumin) një "mrekulli".[1]

Ajeti i mësipërm flet për gjumin si një mirësi hyjnore. Por, meqë gjumi është i ngjashëm me vdekjen dhe zgjimi na tregon ngjashmërinë me Ringjalljen, kjo mund të jetë një shenjë, ose të tregojë diçka nga ky subjekt, pra, nga vdekja dhe nga Ringjallja.

Pas shpjegimit që i bëhet gjumit dhe mirësitë që sjell për njeriun, menjëherë flitet për dhuratën tjetër, për natën. All'llahu i Madhëruar në këtë ajet të Kur'anit thotë: **"Natën jua kemi bërë mbulesë."**

Më poshtë shton: **"Ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar."**[2]

---

[1] Përsa u përket çudirave të botës së gjumit, kemi trajtuar një tjetër diskutim në suren "Er Rrum", në ajetin 24.
Po ashtu, kemi folur edhe për skena që njeriu i shikon në ëndërr, si dhe për çuditë e gjumit në komentimin e ajetit 3 të sures "Jusuf".

[2] Termi *"measha"* mund të jetë emër që tregon kohën ose vendin. Po ashtu, mund të jetë edhe paskajore e shkronjës *"mim"*, që në këtë rast ka një eliminim dhe vlerësim në "sebben li measHikum".

Ajetet hedhin poshtë injorancën e idhujtarë rreth sekreteve të krijimit. Ata thonin se dita dhe ndriçimi i saj janë mirësi, ndërsa natën e konsideronin shkakun e të keqes, të dhunës dhe të fatkeqësive. Ata mendonin se dita dhe nata kanë krijues më vete. Pra, njërën e konsideronin "Zot" dhe tjetrën e konsideronin "Demon". Po të jemi pak më tepër të vëmendshëm, do të shikojmë se secila prej tyre jo vetëm që është një mirësi e madhe, por edhe burim i mirësive të tjera.

Sipas ajeteve të mësipërme, nata është perdja dhe rroba jo vetëm për tokën, por edhe për të gjitha krijesat që jetojnë në tokë. Me mbarimin e ditës, aktiviteti i lodhshëm i jetës së njeriut pushon me një urdhër të detyruar. Errësira bëhet shkak dhe burim i qetësisë dhe i pushimit. Ajo mbizotëron mbi të gjitha gjërat. Në këtë mënyrë, trupat dhe shpirtrat e lodhur përtërijnë fuqinë e tyre, sepse gjumi bëhet në qetësi vetëm natën, në errësirë.

Veç kësaj, me ardhjen e natës shkëlqimi i diellit shpërbëhet. Nëse dielli do të qëndronte në mënyrë të vazhdueshme, të gjitha bimët, kafshët do t'i digjte dhe toka nuk do të ishte vend i përshtatshëm për të jetuar.

Për këtë arsye, Kur'ani i Shenjtë shpesh e citon këtë çështje. Në një nga ajetet e Kur'anit thuhet: **"Thuaju** (o Muhammed)**: 'Pa mendoni, nëse All'llahu jua bën ditën të përhershme deri në Ditën e Kiametit, cili zot, përveç Tij, do t'jua sillte natën, në të cilën qetësoheni? Vallë, a nuk shihni?'"**[1]

Fjala *"measH"* vjen nga rrënja *"'ishun"*, që ka kuptimin *"jetë"*. Ndryshimi që ka me jetën është se, për All'llahun dhe engjëjt, jeta është pakufizushme, por termi *"'ishun"* është posaçërisht për jetën e njerëzve dhe të kafshëve.

[1] Sure "El Kasas", ajeti 72.

Pas këtij ajeti, përsëri All'llahu i Madhëruar thotë: **"Prej mëshirës së Vet, Ai ka bërë për ju natën dhe ditën, që të qetësoheni, të kërkoni nga mirësia e Tij dhe të jeni mirënjohës."**[1]

Është domethënëse se në Kur'anin e Shenjtë, për shumë çështje të rëndësishme betimi është bërë vetëm një herë, ndërsa për "natën" është betuar shtatë herë. Sikurse e dini, betimi bëhet për çështje të rëndësishme dhe kjo është një shenjë e rëndësishme e perdes së territ të natës.

Ata që natën e ndriçojnë me dritë artificiale dhe rrinë zgjuar gjithë natën, ndërsa ditën flenë, janë persona të sëmurë, të mangët dhe nuk janë të gëzuar.

Në fshatra, ku njerëzit bëjnë një jetë ndryshe nga njerëzit në qytet, si për shembull, flenë dhe zgjohen më herët se të tjerët, janë më të shëndetshëm dhe jetojnë më mirë e më të qetë se sa njerëzit e qyteteve.

Nata, po ashtu, ka përfitime dhe mirësi, sepse ata që ngrihen herët në mëngjes, përzgjedhin kohën më të mirë për t'i shprehur nevojat dhe sekretet e tyre Krijuesit të Madhëruar. Adhurimi dhe edukimi i vetvetes është edukimi i nefsit (egos).

Këtë na e këshillon All'llahu në Kur'anin e Shenjtë: **"Ndërsa në agim kërkonin falje** (nga All'llahu)**."** [2]

Ndriçimi i ditës është vetë një mirësi e pashembullt. Ajo sjell gjallëri dhe kumbim. E ndihmon njeriun dhe e përgatit për punë

[1] Sure "El Kasas", ajeti 73.
[2] Sure "Edh Dhariat", ajeti 18.

dhe aktivitet. Bimët mbijnë nga ndriçimi i ditës, kafshët rriten me ndriçimin e ditës.

Në ajetin e mesipërm thotë: **"Ditën e bëra për ju mjet jetese për jetën tuaj."**[1]

Ky interpretim, po të shikohet nga të gjitha këndvështrimet, është shprehës dhe nuk ka nevojë për përshkrim.

Fjala e fundit, përsa i përket çështjes së ardhjes dhe ikjes së natës dhe ditës, konsiderohet si një sistem i saktë, që bën ndryshimet graduale të tyre, tregon një nga shenjat e krijimit të All'llahut, si dhe burimin e gjetjes së një kalendari natyral për sistemin e klasifikimit të kohës dhe jetës së njerëzve.

Më tej flitet për "tokën" dhe "qiellin": **"Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë."**

Numri shtatë, në këtë rast, mund të tregojë: numrin e "shumicës", dhe tregon për numrin e shumtë të planeteve qiellore dhe të sistemeve diellore. Po ashtu, mund të jenë galaktikat dhe shkaqet e ndryshme të kozmosit, të cilat kanë krijesa të forta, ndërtesa të mëdha dhe të forta. Një mundësi tjetër interpretimi është: Atë çka shikojmë ne nga yjet është se gjithçka lëviz sipas një urdhri. Në suren "Es Saffat", në ajetin 6, lexojmë: **"Ne e kemi stolisur qiellin e kësaj bote me shkëlqimin e yjeve."**

Ky ajet tregon se (numri) i përket qiellit të parë dhe atyre gjashtë botëve dhe qiejve të tjerë, ku njohuritë e njeriut nuk arrijnë te ata.

---

[1] Sures " El Kasas", ajeti 72.

Po ashtu, ekziston edhe kjo mundësi, që qëllimi i kateve të shumta qiellore mund të jenë përreth tokës. Në të njëjtën kohë, edhe pse paraqitja e saj e jashtme është e hollë, forca dhe qëndresa është aq e madhe, saqë ky planet e ruan atë nga sulmi i gurëve qiellorë. Në çastin kur njëri prej tyre thithet nga planeti Tokë, nga ndikimi i përplasjes së madhe, shtresa e ajrit do të bëhej aq e nxehtë, saqë do të merrte zjarr. Kështu tymi dhe hiri i saj mund të bjerë në tokë në mënyrë të butë. Nëse kjo shtresë (lëvore) nuk do të ekzistonte, qytetet dhe plantacionet tona do të ishin vazhdimisht, ditë dhe natë, nën sulmin e gurëve.

Disa dijetarë dhe shkencëtarë kanë bërë një përllogaritje: Forca dhe qëndresa e shtresës së ajrit përreth Tokës është përafërsisht njëqind kilometër e trashë, në masën e një çatie çeliku. Kjo është një nga komentimet e **"seb'an shidada"**.[1]

Pas një referimi të shkurtër që u bë për krijimin e qiejve, do të flasim për një tjetër mirësi të madhe, që është dielli. Ajeti kur'anor thotë: **"Kemi vënë kandil** (diell) **të shndritshëm."**.[2]

Fjala *"ue'haxha"* vjen nga rrënja *"uehexhe"*, e cila ka kuptimin *"dritë"* dhe *"nxehtësi, që lëshohet nga zjarri"*.[3] Ndaj edhe përshkrimi i diellit me këtë fjalë tregon për dy mirësi të mëdhaja që janë drita dhe nxehtësia, që janë burimi i të gjithë mirësive dhe dhuratave materiale të kësaj bote.

---

[1] Përsa u përket shtatë qiejve dhe komentimit të tyre, kemi folur në vëllimin e parë, poshtë ajetit 29 të sures "El Bekare".

[2] Fjala *"xhealna"* këtu ka kuptimin *"khalekna", krijuam*.

[3] Në librin "Mufredat" të Raghibit, jepet shpjegimi i rrënjës së fjalës *"uehexhe"*, sipas rregullave të gjuhës arabe: Nxehtësia e Diellit dhe e zjarrit kanë një ndasi të largët.

Drita e diellit jo vetëm që ndriçon të gjithë skenën e jetës së njeriut dhe të gjithë Sistemin Diellor, por ka një ndikim të thellë në zhvillimin dhe rritjen e krijesave të gjalla.

Nxehtësia e tij, ndikon jo vetëm në jetën e njerëzve, por edhe te kafshët dhe te bimët. Burimi kryesor i ekzistencës së reve, erërave, rënia e shiut janë ujitësit e tokave të thara.

Dielli ka një rol shumë të madh në vrasjen e mikrobeve, për shkak të rrezeve të tij të veçanta ultravioletë. Nëse këto rreze nuk do të ekzistonin, Toka do të shndërrohej në një spital të madh. Ndoshta për një kohë shumë të shkurtër brezat e krijesave të gjalla do të zhdukeshin.

Në realitet rrezet e diellit janë dritë e shëndetshme, falas, të përhershme dhe qëndrojnë në një largësi të përshtatshme, nuk janë shumë të nxehtë dhe përvëluese, dhe nuk janë as të ftohta. Është një mirësi që është vendosur në shërbimin tonë.

Nëse çmimi i energjisë që vjen nga Dielli, do të krahasohej me çmimin e ndonjë burimi tjetër, do të formonte një numër shumë të madh. Nëse do të supozojmë se një pemë molle do ta rrisnim me dritë dhe energji artificiale, çmimi i një kokrre molle do të ishte tronditës. Të gjitha këto shërbime dhe mirësi, që vijnë nga *"siraxhen uehaxha" - "dielli i shndritshëm"* dhe *"i ngrohtë"*, Krijuesi i universit i ka vendosur në shërbimin tonë falas.[1]

[1] Në librin "Dunjaje Setaregan", shkrimtari Enteri Vait ka bërë një përllogaritje për dritën dhe nxehtësinë që Dielli u jep krijesave të tokës. Ai thotë: "Nëse do të paguanim energjinë dhe ngrohjen që marrim nga Dielli, sikurse paguajmë energjinë elektrike, një person do të paguante për një orë një miliard e shtatëqind

Masa e Diellit është rreth një milion e treqind mijë, herë më shumë se planetin Tokë dhe largësia e tij është përafërsisht njëqind e pesëdhjetë milionë kilometër. Nxehtësia e jashtme e sipërfaqes së Diellit është vlerësuar gjashtë mijë gradë celsius, kurse nxehtësia e brendshme e tij është vlerësuar përafërsisht njëzet milionë gradë.

Nëse largësia apo nxehtësia do të ishte më pak apo më shumë, zona e jetesës në planetin Tokë do të ngushtohej dhe vazhdimësia e jetesës do të ishte e pamundur. Përshkrimi i saj në këtë rast, ku flitet vetëm për një përmbledhje, nuk është qëllimi ynë.

Pas mirësisë së dritës dhe nxehtësisë, të cilat janë një ndër burimet e rëndësishme të jetës e që kanë një lidhje tjetër të rëndësishme me lindjen e Diellit, janë retë. Ajeti tjetër kur'anor thotë: **"Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme."**

Fjala *"el mu'siratu"* është shumësi i fjalës *"mu'serun"*, që vjen nga rrënja *"usrun"*, që do të thotë *"presion"*. Në rastin tonë tregon presionin e "reve që sjellin shi", duket sikur ato shtrëngohen, që nga brendësia e tyre të dalë ujë.[1]

milionë dollarë, që për një vit do të ishte një shumë marramendëse. Kjo tregon se sa ndihmë dhe pasuri të madhe na është dhuruar falas nga ky Diell kalimtar." Po ashtu, sipas mendimit të shkrimtarit të librit "Az Xhehan'hai Dur", nëse njerëzit e tokës, do të donin që dritën, që e marrin nga Dielli, ta merrnin nëpërmjet llambave, do t'u duheshim më tepër se qindra miliardë llamba të ndezura.

[1] Sipas mendimit të disa shkencëtarëve, kur mbi retë mbizotëron sistemi i dendësisë dhe ato vihen në presion, si pasojë e këtij presioni prej tyre bie shi. Kjo dukuri konsiderohet si një ndër mrekullitë e Kur'anit të Shenjtë. (Për këtë çështje të shikohet libri "Bad ve Baran", faqe 126.)

Po ashtu, disa kanë mendimin se fjala *"mu'sirat"* ka kuptimin e reve, të cilat përgatiten për të rënë shi.

Disa komentues të tjerë, përsa i përket fjalës *"mu'siratun"* janë shprehur se kjo fjalë nuk është mbiemër apo përshkrues i reve, por është përshkrues i erërave, sepse erërat janë ato që i venë në presion retë, që të bjerë shiu.

Fjala *"eth thexhaxhu"* vjen nga rrënja *"eth thexhu"* me kuptimin e rënies së ujit të shumtë në fytyrë në mënyrë të njëpasnjëshme. Duhet të kemi parasysh se fjala *"thexhaxhun"* është formulë ekzagjerimi që tregon frekuencë dhe intensitet më të shumtë.

Si përfundim, kuptimi i ajetit është: Ne nga retë lëshuam shi të bollshëm dhe të njëpasnjëshëm.

Edhe pse zbritja e shiut, në vetvete, është burim mirësie dhe bereqeti, shiu bën që ajri të jetë i mirë dhe i pastër, të gjitha papastërtitë i lan. Me rënien e shiut, të gjitha papastërtitë largohen, nxehtësia e ajrit normalizohet dhe freskohet. Po ashtu, shiu bën që, edhe kur është dimër dhe ftohtë, ajri të normalizohet dhe të mos jetë shumë ftohtë dhe në këtë mënyrë zvogëlohen shkaqet e ardhjeve të sëmundjeve. Të gjitha këto shërbime që shiu bën për ne, njerëzit, shpirti ynë është i gëzuar dhe i qeshur.

Por me të gjitha këto të mira dhe begati, në ajetet e ardhshme do të flasim për tre dobi të rëndësishme që sjell rënia e shiut.

Qëllimi i rënies së shiut është se farërat ushqyese dhe bimët mbijnë nga toka nëpërmjet shiut: **"...për rritjen e drithërave, bimëve..." "dhe të kopshteve të dendura."**

Fjala *"el fafa"*, sipas shpjegimit të Raghib, në librin "Mufredat", tregon për pemët e këtij kopshti, të cilat janë aq shumë, saqë bëhet një kompleks midis tyre. Në të vërtetë, këto dy ajete flasin për të gjitha ushqimet e bimët që njerëzit dhe kafshët hanë, ose i përdorin ato. Të gjitha ato mbijnë nga toka. Një pjesë e madhe prej tyre është e përbërë nga farërat ushqyese, që është *"habben"*. Pjesa tjetër është për perimet *"ue nebata"*, ndërsa pjesa tjetër flet për frutat - *"ue xhennat"*).

Në këto dy ajete është folur vetëm për këto tre mirësi të mëdha, që vijnë si rezultat i rënies së shiut. Por pa dyshim, përfitimet e shiut nuk janë të kufizuara me këto që përmendëm. Në parim, pothuajse shtatëdhjetë për qind e trupit të njeriut është i përbërë nga uji dhe burimi i shfaqjes së gjithë krijesave të gjalla, sipas Kur'anit, është uji.[1]

Kështu që uji, ka një rol shumë të veçantë jo vetëm në jetën e krijesave të gjalla, por edhe te njerëzit.

Jo vetëm trupi i njeriut, i cili është një fabrikë që nuk punon pa ujë dhe mund të paralizohet, po ashtu edhe sistemi i industrisë bie.

Bukuria e natyrës dhe veprimtaria e saj është e përbërë nga uji. Po ashtu, edhe rruga tregtare dhe ekonomike e botës rrjedh dhe përbëhet nga uji.

[1] Sure "Enbija", ajeti 30.

Hulumtim

Lidhja e këtyre ajeteve me çështjen e "Ringjalljes" - "Meadit"

Në njëmbëdhjetë ajetet e lartpërmendura flitet për dhurata dhe për mirësitë më të rëndësishme hyjnore, si dhe për shtyllat themelore të jetës së njeriut, që janë drita, terri, nxehtësia, uji, toka dhe bimët.

Shpjegimi i këtij sistemi të saktë, nga një anë, është argument i qartë për fuqinë e All'llahut mbi të gjitha gjërat. Si rrjedhim, nuk ka vend për fjalë, për të treguar fuqinë e All'llahut në ringjalljen e të vdekurve.

Në ajetet e fundit të sures "Jasin" mohuesve të ringjalljes u është dhënë shumë qartë përgjigjja: **"Vallë, a nuk është i zoti Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, t'i rikrijojë ato? Po! Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshmi!"**[1]

Nga ana tjetër, të gjitha këto struktura masive, patjetër që kanë një qëllim. Ky qëllim, sigurisht nuk mund të jetë jeta disaditore e kësaj bote. Edhe këto ushqime dhe lëngje, gjumi dhe zgjimi do të mjaftojnë, mirëpo urtësia e All'llahut ka një qëllim më të madh se kaq.

[1] Sure "Ja Sijn", ajeti 81.

Ky përshkrim është dhënë në ajetin 115 të sures "El Mu'minun": **"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne** (për t'ju gjykuar)**?!"**

Nga ana tjetër, çështja e gjumit dhe e zgjimit në vetvete është një shembull nga vdekja dhe jeta e dytë. Po ashtu, sikurse toka e vdekur ringjallet pas rënies së shiut, skenë, të cilën njerëzit e kanë çdo vit para syve të tyre, është një tregues plot kuptim, përsa i përket çështjes së Ringjalljes dhe jetës pas vdekjes.

Në ajetin 9 të sures "Fatir" flitet për përtëritjen e jetës, të tokës së vdekur nga rënia e shiut: **"All'llahu është ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë. Ne i drejtojmë ato në viset e vdekura e, nëpërmjet tyre gjallërojmë tokën, pasi ka qenë e shkretë. Kështu do të jetë edhe Ringjallja."**

Ajetet 17 – 20

﴿إِنَّ يَوْمَ الْفَصْلِ كَانَ مِيقَاتًا١٧ يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَتَأْتُونَ أَفْوَاجًا١٨ وَفُتِحَتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ أَبْوَابًا١٩ وَسُيِّرَتِ الْجِبَالُ فَكَانَتْ سَرَابًا٢٠﴾

"Sigurisht, Dita e Ndarjes vendimtare është caktuar."

"Atë Ditë do të fryhet në Sur dhe ju do të vini grupe-grupe."

"Dyert e qiellit do të hapen."

"Dhe malet do të shtyhen tutje e do të bëhen si mirazh."

Komentimi

Do të vijë Dita e premtuar

Në ajetet e mëparshme janë përmendur argumente të ndryshme, përsa i përket Ringjalljes. Në ajetin 17 është diskutuar se Dita e Ndarjes, Dita e Ringjalljes, është ditë e premtuar për të gjithë.

"Sigurisht, Dita e Ndarjes vendimtare është caktuar."

Interpretimi i fjalës *"jeumul fasl"* është një interpretim kuptimplotë, që tregon dhe shpjegon ndarjet në atë ditë të madhe, ndarjen e të drejtës nga e pavlefshmja, ndarjen e rreshtave të besimtarëve të mirë nga ata kriminelë dhe punëkëqij, ndarjen e babait dhe të nënës nga fëmija dhe e vëllait nga vëllai.

Fjala *"el mikatu"* vjen prej *"el uaktu"* sikurse *"el miad"* vjen prej *"el uadu"* që do të thotë kohë e përcakruar. Po ashtu edhe vendeve ku janë përcaktuar për t'u grumbulluar apo për të qëndruar personat pelegrinë të Shtëpisë së All'llahut, quhen *"el meuakijt"*, sepse ata grumbullohen në një vend të caktuar.

Më pas flitet për disa nga cilësitë dhe ngjarjet e asaj Dite të madhe: **"Atë Ditë do të fryhet në Sur dhe ju do të vini grupe-grupe."**.

Nga ajetet kur'anore mund të kuptohet shumë mirë se do të ndodhin dy Fryrje të mëdhaja që Kur'ani i quan *"nefekhu sur"*. Në fryerjen e parë sistemi i botës do të bjerë dhe të gjithë njerëzit, ata që janë në tokë e ata që janë në qiej, do të vdesin. Në fryerjen e dytë, bota do të rikrijohet dhe të gjithë ata që kanë vdekur, do të kthehen në jetë. Kështu do të ndodhë Ringjallja e madhe.

Fjala *"nufikha"* ka kuptimin *"goditje"*, ndërsa fjala *"es suru"* ka kuptimin *"bri"*. Zakonisht bririn e përdornin për ndalimin e një karvani apo të ushtrisë. Nga melodia që briri lëshon, njerëzit kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë, të ndalojnë apo të lëvizin.

Ky interpretim është një aluzion i pëlqyeshëm dhe i bukur prej dy ngjarjeve të mëdha. Ajo çka është përmendur në ajetin e

mësipërm ka të bëjë me *"nufikha"* "fryrjen e bririt (Surit) të dytë", sepse *"nufikha"* është jeta e dytë dhe Ringjallja.[1]

Ajeti që po diskutojmë thotë se atë ditë ju do të futeni grupe-grupe në Ditën e dhënies së Llogaris, ndërkohë që në suren "Merjem", në ajetin 95 thuhet: **"Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij."**.

Po ashtu, ajeti 71 i sures "El Isra" thotë: **"Ditën, kur Ne do t'i thërrasim të gjithë popujt me prijësin e vet, ata, që do t'u jepet libri në anën e djathtë, do ta lexojnë librin e vet dhe nuk do të pësojnë as padrejtësinë më të vogël."**.

Bashkësia dhe mbledhja midis këtyre dy ajeteve, është e tillë: Të qenit grumbuj-grumbuj, nuk ka asnjë papajtueshmëri me këtë. Çdo grup do të paraqitet në Ditën e Gjykimit me Imamin e tij, ndërsa përsa i përket të qenit vetëm, "tek", tregon se Kiameti ka vendqëndresa të shumta. Mund të jetë e mundur që njerëzit, në pozitën e parë, do të futen në llogari me udhëheqësit e tyre. Por në kohën kur vendosen në gjykatën bazë të drejtësisë së Zotit, do të jenë vetëm, tek.

Kjo gjë thuhet edhe në ajetin 21 të sures "Kaf": **"Çdo shpirt do të vijë i shoqëruar me një** (engjëll) **grahës dhe një** (engjëll) **dëshmitar."**.

Ekziston edhe kjo mundësi interpretimit: Të qenit "tek", i ndarë nga shokët, mbështetësit, miku dhe ndihmësit, ka si qëllim

[1] Përsa i përket interpretimit të grupit emëror *"nufikhe sur"*, pra, fryrjes së bririt dhe çështjeve të tjera, që janë të lidhura me të, është përmendur në mënyrë më të gjerë, në suren "Ez Zumer", në ajetin 67.

njeriun, që në ato momente është i vetëm, pra, është njeriu me veprimet e tij.

Më tej shton: **"Dyert e qiellit do të hapen."**.

Cili është qëllimi i përdorimit të fjalës "dyer"? Ç'kuptim ka hapja e dyerve?

Disa nga dijetarët thonë: Në këtë rast, fjala *"dyert"* tregon *"botën e fshehtë"* - *"Gajb"* dhe botën vizuale, atë të dukshmen, sepse perdet do të largohen dhe bota e engjëjve bëhet e njohur për botën e njerëzve.[1]

Por një grup tjetër, këtë ajet e konsideron si shenjë për diçka, që në ajetet e tjera të Kur'anit thuhet: **"Në prag të Kiametit qiejt çahen."**.[2]

Në një vend tjetër, po këtë kuptim, e ka interpretuar në një mënyrë tjetër:

"Kur qielli të çahet." [3]

Në të vërtetë, aq shumë të çara do të shikohen në qiej, saqë do të duket sikur qielli është i hapur tej e tej dhe i shndërruar në dyer. Ky supozim, edhe pse është i mundur për shndërrimin e qiejve, për njeriun është e pamundur, sepse njeriu, në kushtet ekzistuese në këtë botë, është i pafuqishëm të lëvizë në qiej. Nëse do të krijohej mundësia që njeriu të lëvizte nëpër qiej, ajo mundësi do të ishte shumë e kufizuar. Kushtet ekzistuese tregojnë se të

[1] Tefsiri "El Mizan", vëll. 20, f. 265.
[2] Sure "El Inshikak", ajeti 1.
[3] Sure "El Infitar", ajeti 1.

gjitha dyert e qiejve për të janë të mbyllura. Por në Ditën e Kiametit njeriu do të jetë i lirë nga planeti Tokë, e dyert e udhëtimit, te të gjithë qiejt, do të jenë të hapura për të. Gjithashtu, do t'i ketë të gjitha kushtet e plotësuara.

Sipas një interpretimi tjetër: Atë ditë, në fillim do të dekompozohen qiejt dhe pas tyre, sipas ajetit 48, të sures "Ibrahim", qiejt e rinj dhe toka e re do ta zërë vendin e tij: **"Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjyesit All'llah."**.

Dhe: **"Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhennet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: 'Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!'"**[1]

Dhe: **"Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë** (e Xhennetit)**."**.[2]

Dhe: **"Jobesimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehennem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij dhe rojtarët do t'u thonë atyre: 'A nuk ju kanë ardhur të Dërguar midis jush, të cilët ju lexonin Shpalljen e Zotit tuaj e ju tërhiqnin vërejtjen për takimin e kësaj Dite?!'. Mohuesit do të thonë: 'Po, është e vërtetë!'. E kështu përmbushet Fjala e All'llahut për dënimin e mohuesve."**[3]

[1] Sure "Ez Zumer ajeti 73.
[2] Sure "Er Rra'd", ajeti 23.
[3] Sure "Ez Zumer", ajeti 71.

Dhe: **"Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhennetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit."**[1]

Së fundi, në ajetin 20 diskutohet gjendja e maleve në Ditën e Kiametit: **"Malet do të shtyhen tutje e do të bëhen si mirazh."**.[2]

Në përmbledhjen e ajeteve të ndryshme të Kur'anit të Shenjtë, që është bërë për fatin e maleve në Ditën e Kiametit kuptojmë që, malet do të kalojnë disa faza. Faza e parë e tyre është lëvizja. Në fazën tjetër, mali shkulet nga vendi ku qëndron dhe përplaset me malin tjetër: **"Kur toka dhe malet të ngrihen lart e të thërrmohen me një goditje shkatërrimtare."** [3]

Më pas malet do të shndërrohen në masa rëre të dendura: **"Në Ditën, kur Toka dhe malet dridhen e bëhen si pirgje rëre të lëvizshme."**.[4]

Pasi malet shndërrohen në rërë të dendur, vjen faza tjetër, malet shndërrohen në lesh e lëvizin me erën e fortë. **"Kurse malet si leshi i shprishur."**.[5]

Në një tjetër fazë, malet shndërrohen në "pluhur" që shpërndahet në hapësirë: **"Malet të thërrmohen copë-copë e të shndërrohen në pluhur të shpërndarë."**.[6]

---

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 133.
[2] Sure "Et Tur", ajeti 10.
[3] Sure "El Hakka", ajeti 14.
[4] Sure "El Muzemil", ajeti 14.
[5] Sure "El Karia", ajeti 5.
[6] Sure "El Uakiah", ajetet 5-6.

Sikurse është cekur edhe në ajetin që po trajtojmë, i vetmi ndikim që mbetet nga malet, është vegimi (mirazhi).

Në këtë mënyrë shpërbëhen dhe përfundojnë malet nga terreni i tokës dhe toka bëhet e sheshtë: **"Kur të të pyesin ty** (o Muhammed) **për malet, thuaj: 'Ato do t'i bëjë hi e pluhur Zoti im, ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë."'**.[1]

Fjala *"es serabu"* - *"mirazh"* vjen nga rrënja *"es serbu"* që ka kuptimin të ecësh në tatëpjetë. Në shkretëtirë është shumë nxehtë dhe njeriut i duhet të ecë e të lëvizë në tatëpjetë. Nga larg atij i krijohet mirazhi (vegimi) dhe i duket sikur po shikon ujë, ndërkohë që aty nuk ndodhet asgjë, vetëm drita thyhet.

Çdo gjë që ka një pamje të jashtme (në dukje), por që në të nuk ka asnjë të vërtetë, quhet mirazh (vegim).

Në këtë mënyrë, ajeti i mësipërm shpjegon fillimin dhe përfundimin. Ajetet e tjera shpjegojnë stadet e tjera të lëvizjes.

Në të vërtetë, malet do të shndërrohen në pluhur dhe do të duken si mirazh (vegim). Mali, me gjithë madhështinë dhe forcën e tij, ka këtë fat. Është e dukshme se çfarë ndryshimesh do të ndodhin në botë. Po ashtu, persona apo fuqi të mëdha të cilët në jetën e kësaj bote kanë patur pushtet apo madhështinë, e janë dukur si malet, në atë Ditë nuk do ju duket tjetër vetëm se një mirazh.

Këtu lind pyetja: A mos vallë këto ngjarje kur do të fryhet në "Sur"të kenë lidhje me përfundimin e botës? Apo ka lidhje me

[1] Sure "Ta Ha", ajetet 105-106.

momentin kur ti fryhet "Surit" herën e dytë që është fillimi i Ringjalljes?

Duke pasur parasysh se ajeti **"Atë Ditë do të fryhet në Sur dhe ju do të vini grupe-grupe "** lidhet me fryrjen e parë të "Surit" kur njerëzit ringjallen, dhe grupe-grupe futen në llogari, po ashtu edhe ky ajet si rregull duhet të ketë lidhje me fryrjen e parë të "Surit" (bririt), por ekziston edhe mundësia, që fillimi i lëvizjes së maleve të jetë në fryrjen e parë të "Surit" (bririt) dhe tronditja e madhe të ndodhë në fryrjen e dytë të "Surit" (bririt).

Është i mundur edhe një tjetër interpretimi: Të gjitha stadet e prishjes dhe të shkërrmoqjes së maleve, është e lidhur me fryrjen e parë të "surit" (bririt). Sepse koha e fryrjes së parë të "Surit" me atë të fryrjes së dytë nuk është e largët. Këto ngjarje janë trajtuar në disa nga ajetet e tjera të Kur'anit të Shenjtë, p.sh: në suren "Et Tekuir" dhe suren "El Infitar". Është domethënës fakti se në ajetet e mëparshme kur'anore, malet u paraqitën si shtylla dhe toka si djep. Ndërsa ajeti që po diskutojmë, thotë: Atë Ditë që të jepet urdhri i shuarjes së botës, ai djep do të thyhet dhe këto shtylla të mëdha do të shkulen nga vendi i tyre. Është e qartë se në kohën që shtyllat do të tërheqin diçka, ajo do të thërrmohet dhe do të dekompozohet.

Ajetet 21 – 30

﴿إِنَّ جَهَنَّمَ كَانَتْ مِرْصَادًا٢١ لِلطَّاغِينَ مَآبًا٢٢ لَابِثِينَ فِيهَا أَحْقَابًا٢٣ لَا يَذُوقُونَ فِيهَا بَرْدًا وَلَا شَرَابًا٢٤ إِلَّا حَمِيمًا وَغَسَّاقًا٢٥ جَزَاءً وِفَاقًا٢٦ إِنَّهُمْ كَانُوا لَا يَرْجُونَ حِسَابًا٢٧ وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كِذَّابًا٢٨ وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ كِتَابًا٢٩ فَذُوقُوا فَلَنْ نَزِيدَكُمْ إِلَّا عَذَابًا٣٠﴾

“Me të vërtetë, Xhehennemi do të bëhet pusi.”

“Vendbanim i caktuar për keqbërësit.”

“Që aty të mbeten përgjithmonë.”

“Aty nuk do të shijojnë as freski, as pije.”

“Përpos ujit të valuar dhe qelbësirave.”

“Si shpërblim përkatës (të veprave të tyre)**.”**

“Në të vërtetë, ata as që e çonin nëpër mend se do të jepnin llogari.”

“Dhe Shpalljet Tona i mohonin prerazi.”

“Por Ne çdo gjë e kemi shënuar në një libër.”

“Prandaj do t’u themi: ‘Shijojeni këtë! Ne nuk do t’ju shtojmë gjë tjetër përveçse dënim!’”

Komentimi

Xhehennemi pritë tmerruese

Pasi shpjeguam disa argumente të Ringjalljes dhe një pjesë të ngjarjeve nga Ringjallja, do të flasim për fatin e personave që do të shkojnë në Xhehennem dhe në Xhennet.

Në fillim do ta nisim nga personat që do të shkojnë në Xhehennem. Ajetet 21-23 thonë: **"Me të vërtetë, Xhehennemi do të bëhet pusi, vendbanim i caktuar për keqbërësit, që aty të mbeten përgjithmonë."**.

Fjala *"el mirsadu"* është emër vendi, që ka kuptimin e një vendi që rrihet. Raghibi, në librin e tij "Mufredat", thotë: Fjalët *"mursed"* dhe *"mirsada"* kanë të njëjtin kuptim, por me një ndryshim. Fjala *"mirsada"* përdoret për një vend që është pikërisht për pritë.

Po ashtu, disa komentues të Kur'anit të Shenjtë kanë thënë se është me kuptimin e zënies pritë (një person që zë pritë). Në të njëjtin kuptim përdoret edhe për arkitektin, një person që ndërton shumë ndërtesa.

Në të vërtetë, kuptimi i parë është më i njohur dhe është më i përshtatshëm, sepse kush është ai person që në Xhehennem do t'u zërë pritë rebelëve? Përgjigjja e kësaj pyetjeje, është: Janë engjëjt e ndëshkimit. Sipas ajetit 71, të sures "Merjem", të gjithë njerëzit, si të mirët, ashtu edhe të këqijtë, do të kalojnë pranë Xhehennemit ose

sipër tij: **“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai** (Xhehennemi)**. Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt.”**.

Në këtë vendkalim, të gjithë engjëjt e ndëshkimit janë vënë në pritë dhe rrëmbejnë të gjithë Xhehennemlinjtë!

Nëse do të themi në komentimin e këtij ajeti se ky vend kalim është në formën metaforike, atëherë Xhehennemi do të jetë prita e tyre dhe çdo rebel që i afrohen atij, ai i tërheq drejt vetes së tij dhe i merr me vete. Sido që të jetë, nga ky vendkalim i përgjithshëm nuk mund të kalojë asnjë prej rebelëve, ose ata i rrëmbejnë engjëjt e dënimit, ose ata i tërheq vetë Xhehennemi.

Fjala *“el me’abu”* ka kuptim *“referim”* dhe *“vendkthim”*. Ndonjëherë ka kuptimin *“vendbanim”* dhe *“kamp”*. Këtu ka po këtë kuptim, *“vendbanim”*.

Fjala *“el ehkabu”* është shumësi i fjalës *“hukbun”* me kuptimin *“kohë e papërcaktuar”*, pra, tregon kohën. Disa atë e kanë komentuar me tetëdhjetë vite, ndërsa disa me shtatëdhjetë vite e disa të tjerë me dyzet vite. Nga ky shpjegim kuptohet se Xhehennemlinjtë do të qëndrojnë për një kohë të gjatë në Xhehennem dhe do të kenë një përfundim. Ky fakt gjithmonë ka hapur diskutime midis komentuesve, ku secili komentues, në tefsirin e tij ka gjetur një mënyrë për ta racionalizuae mendimin e tij.

Më mesin e komentuesve fjala *“ehkaba”* është e njohur se tregon kohën e gjatë dhe vitet e gjata që kalojnë njëri pas tjetrit, pa ardhur fundi dhe çdo kohë që kalon në vendin e saj vjen dhe zëvendësohet me një tjetër kohë.

Në disa nga transmetimet është cekur se ky ajet u përket mëkatarëve, që si përfundim do të pastrohen dhe do të lirohen nga Xhehennemi, kurse qafirët do të jenë përjetësisht në zjarr.[1]

Më tej flitet për një pjesë të vogël nga dënimet e mëdha të Xhehennemit. Ata atje nuk do pinë e as nuk do provojnë asgjë të freskët për të shuar etjen dhe nxehtësinë e tmerrshme të Xhehennemit. Gjithashtu, nuk kanë pije që të zvogëlojë e të lehtësojë vuajtjet në zjarrin e Xhehennemit.

"Aty nuk do të shijojnë as freski, as pije." "Përpos ujit të valuar dhe qelbësirave."

Atje nuk ka hije përveç hijes që lëshon tymi, i cili është gaz i nxehtë dhe sjell vetëm zjarr.

Në ajetin 43 të sures "El Uaki'a" thuhet: **"Nën hijen e një tymi të zi, e cila nuk do të jetë as e freskët e as e këndshme."**.

Fjala *"el hamijm"* ka kuptimin *"ujë shumë i nxehtë"*, ndërsa fjala *"el gassaku"* ka kuptimin *"qelb dhe gjak që rrjedh nga një plagë"*. Disa komentues të tjerë ato i kanë komentuar si lëngje me erë të keqe.

Ndërkohë që xhennetlinjtë All'llahu i Madhëruar do t'u japë të pinë nga burimi që ka pije të pastër e të freskët, siç thuhet në ajetin 21 të sures Insan (Dehr): **"...Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër."**.[2] Madje edhe enët me të cilat do të pijnë do të jenë

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 494, dhe Hadithi 23, f 495.
[2] Sure "Insan", ajeti 21.

me *"misk"*, siç thotë ajeti 26 i sures Mutaffijn: **"...fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen."**.[1]

Në mendimin e disave ndoshta ekzistenca e këtyre dënimeve të vështira dhe të tmerrshme, të duken të çuditshme, por në ajetin tjetër thuhet se këto dënime janë të përshtatshme me veprimet e tyre: **"...si shpërblim përkatës** (të veprave të tyre)**."**

Përse të mos jetë një shpërblim i tillë? Ata në këtë botë kanë djegur zemrat e të shtypurve. Shpirtin dhe zemrën e tyre e kanë djegur në zjarr. Me shtypjen, me dhunën dhe me arrogancën e tyre kanë shkaktuar shumë tragjedi, nuk kanë pasur mëshirë për asnjë dhe për asgjë. Është mirë që atje dënimi i tyre të jetë i tillë dhe pijet e tyre të jenë po ashtu të tilla.

Sikurse e kemi thënë dhe e kemi theksuar shumë herë, kur nga ajetet e Kur'anit tregon për dënimet në Ditën e Kiametit, i sqaron se këto dënime janë si rezultat i veprave të njeriut që ka kryer në këtë botë. Kjo gjë është përmendur edhe në suren "Et Tahrim", ajeti 7: **"O ju, që nuk keni besuar! Mos u shfajësoni sot** (në Ditën e Gjykimit)**, sepse, me të vërtetë, dënoheni vetëm për veprat që keni bërë."**

Më tej, pas shpjegimit të shkakut të dënimit thotë: **"Në të vërtetë, ata as që e çonin nëpër mend se do të jepnin llogari."**.

Po ky mosvlerësim ndaj Ditës së Llogarisë është bërë shkak dhe burim i arrogancës, i rebelimit, i kokëfortësisë, i dhunës dhe i

[1] Sure "El Mutafifin", ajeti 26.

shtypjes. Ajo dhunë dhe korrupsion ka bërë që të kenë këtë të ardhme të dhimbshme.

Në të vërtetë, mosbesimi në Ditën e Llogarisë është shkak për arrogancën dhe vetë arroganca është shkak për ato dënime të vështira.

Fjala *"la jerxhune"* vjen nga rrënja *"err rrexhau"*, e cila ka kuptimin e *"shpresës"*. Po ashtu ka kuptimin *"të kesh frikë dhe tmerr"*.

Në parim, kur njeriu ka shpresë dhe është në pritje të dënimit, natyrisht që ka frikë e, nëse nuk ka frikë, nuk frikësohet. Të dyja këto janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ndërsa ata që nuk kanë shpresë e nuk besojnë te Dita e Llogarisë, nuk kanë as frikë.

Fjala *"inne"*, në këtë rast është për *theksim*, ndërsa fjala *"kanu"* tregon vazhdimësinë e së kaluarës, kurse fjala *"hisaben"*, që vjen në mënyrë të pacaktuar dhe është përmendur pas refuzimit, ka një kuptim të përgjithshëm.

Të gjitha këto janë tregues i një të vërtete, se ata nuk kanë asnjë frikë nga ndëshkimi dhe Dita e Llogarisë. Ose me fjalë të tjera, llogaria në Ditën e Kiametit është harruar nga ata dhe është hequr e gjitha nga programi i jetës së tyre. Kështu që është e natyrshme që të tillë njerëz janë të përfshirë dhe janë zhytur në gjynahe të mëdha.

Si përfundim, ata që janë të përfshirë në të tilla gjynahe, dënimi i tyre do të jetë i vështirë dhe i dhimbshëm.

Ndaj, për këtë arsye, ajeti që vjen, thotë: **"Shpalljet Tona i mohonin prerazi."**.

Te ata mbizotëronte egoja e sëmurë, saqë ata i mohuan të gjitha ajetet kur'anore, të cilat e zgjojnë njeriun. Ata vazhduan me kokëfortësi rrugën e tyre. Dëshirat jo të ligjshme u bënë rrobë e veprave të tyre.

Fraza *"ajatuna", shenjat tona,* ka kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha ajetet e "Njëshmërisë" - "Teuhidit", "të profetësisë" - "Nubuvetit", krijimin, legjislacionin, mrekullitë e Profetëve dhe dispozitat. Mohimit i këtyre shenjave hyjnore sigurisht që meriton dënim të ashpër, për të cilin lajmëron Kur'ani.

Kur'ani i paralajmëron arrogantët, se ka ekuilibër midis krimit dhe ndëshkimit në drejtësinë hyjnore. Kur'ani thotë: **"Por Ne çdo gjë e kemi shënuar në një libër."**.

Mos mendoni se veprat tuaja do të mbeten pa u llogaritur, pa u gjykuar. Po ashtu, asnjëherë mos mendoni se këto dënime dhe ndëshkime janë jo të drejta.

Kjo e vërtetë, që të gjitha veprat dhe punët e njeriut, qofshin të vogla apo të mëdha, të fshehura apo të kryera hapur, nijeti dhe besimi i njeriut shënohet dhe ruhet. Të gjitha këto janë të shkruara dhe të pasqyruara në ajetet e Kur'anit të Shenjtë.

Në një ajet tjetër kur'anor thotë: **"Çdo bëmë e tyre është shënuar në librat** (e engjëjve që regjistrojnë veprat)**. Çdo gjë, e madhe a e vogël qoftë, është shënuar** (në Leuhi Mahfudh)**."**.[1]

[1] Sure "Kamer", ajetet 52-53.

Në një tjetër ajet thuhet: **"Me të vërtetë, të dërguarit Tanë** (engjëjt) **shënojnë intrigat tuaja."**[1]

Në një ajet tjetër lexojmë: **"Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë."**[2]

Në çastin kur punëkëqijtë do të marrin në duart e tyre letrën e veprave të tyre, zëri i tyre do të ngrihet lart dhe do të thonë: **"Dhe Libri** (i veprave të tyre) **do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: 'Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë?'. Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt."**[3]

Padyshim, një person që e beson me gjithë zemër këtë të vërtetë, në kryerjen e punëve, është shumë i saktë dhe llogaridhënës. Ky besim krijon një pengesë të madhe midis njeriut dhe mëkatit. Kjo gjë konsiderohet si një nga shkaqet e rëndësishme të edukimit.

Në ajetin 30, mënyra e të folurit ka ndryshuar, fjalia u adresohet atyre. Në vend të fjalisë kërcënuese e të zemërimit apo të një fjale tronditëse thotë: "**Prandaj do t'u themi: 'Shijojeni këtë! Ne nuk do t'ju shtojmë gjë tjetër përveçse dënim!'"**. Sado që të ulërini dhe të thoni e të bëni lutje për kthim, që të shlyeni ato që keni bërë në këtë botë, nuk do t'ju pranohet asnjë lutje dhe kërkesë

[1] Sure "Junus", ajeti 21.
[2] Sure "Ja Sin", ajeti 12.
[3] Sure "Kehf", ajeti 49.

që do bëni. Përveç zjarrit dhe dënimit nuk do t'ju shtohet asgjë tjetër.

Ky dënim është për ata persona që, kur ishin përballë ftesës së Profetëve, e cila ishte një ftesë plot me mirësi dhe dashuri për të besuar dhe për të qenë të devotshëm, thoshin:**"Ata thanë: 'Për ne është njëlloj: na këshillove ose nuk na këshillove ti.'"**[1]

Dhe, dënimi i atyre që, kur u zbresin ajetet hyjnore "përveç përbuzjes, nuk shtonin tjetër gjë".

"Në të vërtetë, Ne kemi paraqitur me hollësi në këtë Kur'an Shpalljet Tona, që ata (jobesimtarët) **t'ua vënë veshin, por kjo vetëm ua ka shtuar atyre largimin** (nga e vërteta)**."** [2]

Së fundi, ky është dënimi i atyre që nuk kthehen prapa për mëkatet dhe gjynahet e tyre dhe nuk patën asnjë dëshirë që të bëjnë punë të mira.

Në një hadith të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Ky ajet është ajeti më i fortë që ka ardhur për banorët e Xhehennemit!"*[3]

Si të mos jetë kështu, ndërkohë që All'llahu i Madhëruar, Falës dhe Mëshirëplotë, është zemëruar aq shumë, saqë u mbyll atyre të gjitha dyert e shpresës dhe nuk u lë asnjë premtim përveç premtimit të dënimit.

---

[1] Sure "Esh Shu'ara", ajeti 136.
[2] Sure "El Isra", ajeti 41.
[3] Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 69. Ky hadith ka ardhur edhe në tefsirin "Safij", poshtë ajetit për të cilin po diskutojmë, si dhe në tefsirin "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 307.

Ajetet 31 – 37

﴿إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا٣١ حَدَائِقَ وَأَعْنَابًا٣٢ وَكَوَاعِبَ أَتْرَابًا٣٣ وَكَأْسًا دِهَاقًا٣٤ لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا وَلَا كِذَّابًا٣٥ جَزَاءً مِنْ رَبِّكَ عَطَاءً حِسَابًا٣٦ رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الرَّحْمَنِ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا٣٧﴾

"Vërtet, për punëdrejtët është përgatitur e mira (Xhenneti)**."**

"Kopshte dhe vreshta."

"Vajza të reja, të së njëjtës moshë."

"Dhe kupa të plota."

"Atje nuk do të dëgjojnë biseda të kota e as gënjeshtra."

"Kështu është shpërblimi nga Zoti yt - dhuratë sipas meritës –"

"Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, i Gjithëmëshirshmi, të Cilit askush nuk do të mund t'i flasë (nga frika)**."**

Komentimi

Premtimi i Allahut për të devotëshmit

Në ajetet e mësipërme u fol për fatin e arrogantëve dhe të rebelëve. Në një pjesë tjetër u fol për dënimet e dhimbshme dhe shkakun e kësaj fatkeqësie. Në ajetet e diskutuara u fol dhe u përshkruan pikat e kundërta të tyre. Më pas u fol për besimtarët e drejtë dhe punëmirë. Gjithashtu, u fol edhe për një pjesë të dhuratave të tyre në Ditën e Kiametit.

Në një krahasim ballë për ballë midis këtyre të dyjave, e vërteta bëhet edhe më e qartë. Edhe në tregimet e sureve të tjera të Kur'anit të Shenjtë paradoksi është vendosur përballë tyre dhe shpjegon gjendjen e tyre në këtë përballje.

Në fillim thotë: **"Vërtet, për punëdrejtët është përgatitur e mira** (Xhenneti)**."**.

Fjala *"el mefazu"* është emër vendi, dhe vjen nga rrënja *"el feuzu"*, që ka kuptimin "*të arrish të mirën dhe mirësinë e përbashkët me shëndet"*. Po ashtu ka kuptimin e shpëtimit dhe të fitores, e cila është e nevojshme për këtë kuptim. Fjala *"mefaza"* është cituar si term që tregon një fitore të madhe, arritjen e mirësisë dhe të lumturisë.

Pas saj do të shpjegojmë këtë fitore dhe lumturi. Në ajetin kur'anor thuhet se ata do të kenë kopshte të gjelbëruara dhe lloje të ndryshme rrushi: **"kopshte dhe vreshta..."**.

Fjala *"el hadaik"* është shumësi i fjalës *"hadijkatun"*, që ka kuptimin "*kopsht i gjelbëruar dhe me plot pemë, i cili është i rrethuar dhe i mbrojtur nga çdo gjë*". Ragibi, në librin e tij "Mufredat", thotë se fjala *"hedaik"* tregon një tokë që ka ujë. Por mund t'i thuhet edhe syrit, që është gjithmonë i lotuar.

Është për t'u habitur se nga të gjitha frutat që gjenden në tokë, në këtë ajet theksi i është vendosur *rrushit*, ndoshta për shkak të shijes shumë të mirë që ka ky frut. Sipas njohësve të ushqimit, rrushi, përveçse konsiderohet si një frut i plotë, përbërësit ushqyes i ka të përafërta me qumështin e nënës. Po ashtu, rrushi bën që trupi ynë të krijojë nxehtësi. Veç kësaj, rrushi ka shumë vlera ushqyese, saqë mund të konsiderohet si një farmaci natyrore.

Rrushi ka, po ashtu, veçorinë e antihelmit, është i dobishëm për filtrimin e gjakut, largimin e reumatizmës, sëmundjes së tokës, si dhe lufton rritjen e uresë në gjak.

Përveç këtyre, rrushi kuron nervat dhe rrit gjendjen e hareshme dhe gjallërimin te njeriu. Vitaminat e rrushit bëjnë që njeriu të jetë tepër i fuqishëm.

Të gjitha këto ishin një pjesë e vogël nga të mirat që sjell ngrënia e rrushit. Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Fruti më i mirë për ju, është rrushi!*".[1]

[1] "Mustedrek El Uesail", vëll. 16, f. 393, Hadithi 20292-5 (Botim i "Ehli Bejtit"); "Biharul Enuar", vëll. 59, f. 292 dhe vëll. 63, f. 149.

Më tej, All'llahu i Madhëruar na vë në dijeni për një tjetër dhuratë që do t'u jepet banorëve të Xhennetit, gratë e Xhennetit. Ajeti thotë: **"Vajza të reja, të së njëjtës moshë."**.

Fjala *"el keuaibu"* është shumësi i fjalës *"ka'ibun"*, që ka kuptimin e vajzaës që sapo ka filluar t'i rritet gjoksi. Kjo tregon për rininë e bashkëshorteve të devotëshmëve në Xhennet.

Ndërsa fjala *"el etrabu"* është shumësi i fjalës *"terbun"*, që ka kuptimin e *"personave të së njëjtës moshë"*. Kjo fjalë është përdorur më tepër për gjininë femërore. Sipas mendimit të disa dijetarëve, në realitet është *"teraib"*, që ka kuptimin e kafazit të kraharorit, e cila ka një ngjashmëri me të.

Përsa i përket moshës së njëjtë, mund të jetë e mundur që gratë e Xhennetit të jenë në moshë e re dhe në bukuri të jenë të njëjta. Po ashtu, edhe karakteri, drejtësia e moderimi midis tyre dhe bashkëshorteve është shumë i përshtatshëm, sepse mosha përafërsisht e njëjtë midis dy bashkëshortëve bëhet shkak që të kuptojnë më mirë ndjenjat e njëri-tjetrit.

Komentimi i parë është më i përshtatshëm për ajetin. Në ajetin tjetër flet për dhuratën e katërt, që është në pritje të atyre që largohen nga punët e këqija: **"dhe kupa të plota..."**.

Por këto kupa nuk janë të mbushura me pije, e cila në këtë botë është e prishur dhe e deh mendjen e njeriut, saqë njeriu duket si një kafshë. Ndërsa pija e Xhennetit e gëzon dhe e bën të lumtur njeriun, edukon shpirtin dhe e rrit atë.

Fjala *"el ke'su"* ka kuptimin "kupë plot me pije". Ndonjëherë i referohet vetë kupës ose përmbajtjes së saj.

Shumë komentues dhe gjuhëtarë, fjalën *"dihakan"* e kanë komentuar me kuptimin *"plot"*. Ibn Mendhur, në veprën "Lisanul Arabi", ka transmetuar edhe dy kuptime të tjera për këtë fjalë: *"e njëpasnjëshme"*, *"i butë"*.

Nëse do të marrim në konsideratë të përgjithshmen e këtij kuptimi, atëherë kuptimi i ajetit do të jetë: Për banorët e Xhennetit do të ketë kupa të mbushura plot më pije të pastër, të qartë, që do të sillen njëra pas tjetrës.

Në ajetin tjetër thuhet: **"Atje nuk do të dëgjojnë biseda të kota e as gënjeshtra."**.

Pija që prodhohet në këtë botë (pija alkoolike, si: vera, rakia, uzo, etj), e deh mendjen e njeriut, zgjuarsinë e njeriut e largon nga truri, kështu që njeriu nis të flasë përçart dhe pa pasur mendjen. Ndërsa pija që do të pihet në Xhennet, do t'i japë njeriut fuqi, mendje të shëndoshë dhe dritë të qartë.

Përsa i përket kuptimit të fjalës *"fijha"* janë dhënë dy mundësi: mundësia e parë është *"Xhenneti"* ndërsa e dyta është *"kupa"*.

Sipas komentimit të parë, kuptimi i ajetit do të ishte: Në Xhennet nuk fliten fjalë të kota dhe gënjeshtra, pra, nuk do të dëgjoni fjalë të kota dhe gënjeshtra.

E njëjta gjë thuhet edhe në suren "Gashieh", në ajetet 10-11: **"Ata do të jenë në kopshtin e lartë, në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe."**

Sipas komentimit të dytë, kuptimi i ajetit është: Nga pirja në kupë nuk flasin kot e nuk thonë gënjeshtra. Kjo përforcohet edhe në ajetin 23 të sures "Et Tur": **"Atje do t'ia kalojnë njëri-tjetrit gotat e mbushura e nuk do të ketë biseda të kota e as gjynahe."**

Sido që të jetë, një nga dhuratat e mëdha dhe shpirtërore të Xhennetit është se në Xhennet nuk ekzistojnë gënjeshtrat, fjalët e kota, thashethemet, shpifjet, nuk mohohet e drejta, nuk justifikohet e kota, nuk flitet keq, me fjalë ofenduese. Të gjitha këto bëjnë që zemrat e atyre që largohen nga punët e këqija, të jenë gjithmonë të shqetësuara.

Sa bukur është kur njeriu qëndron në një vend të tillë, ku nuk flitet kot dhe nuk vuan nga kotësia. Ajeti 62 i sures "Merjem" thotë: **"Aty nuk do të dëgjojnë llomotitje, por vetëm fjalë përshëndetjeje për paqe dhe do të ushqehen në mëngjes dhe në mbrëmje."**.

Në përfundim, përmendja e këtyre bekimeve shpirtërore tregon se All'llahu është më i Madhëruari e më Zemërgjeri se gjithçka tjetër. Më tej shton: **"Kështu është shpërblimi nga Zoti yt - dhuratë sipas meritës."**.

Çfarë bekimi dhe mirësie më të mirë se kaq mund të ketë robi i vogël dhe i dobët, që të marrë të gjitha përkëdheljet, mirësitë dhe dashurinë e Krijuesit të Madhëruar. Në këtë mënyrë, All'llahu i jep njeriut respekt të madh, ngritje, përkujdesje dhe falënderim. I gjithë ky respekt dhe dashuri u jep aq shumë kënaqësi besimtarëve, saqë nuk mund të krahasohet me asnjë bekim tjetër.

Fjala *"Rabbu"* – *"Zot"* ka ardhur së bashku me përemrin e vetës së dytë njëjës dhe me fjalën *"ata'un"*. Të gjitha këto shpjegojnë

mirësinë e jashtëzakonshme të të gjitha shpërblimeve që janë fshehur.

Fjala *"hisaben"*, sipas mendimit të shumë komentuesve, këtu ka kuptimin *"kafijen"*. Ndonjëherë thuhet *"ehsebtu"*, që do të thotë, aq shumë i falëm atij, saqë tha: *"Hesbi!"* - "Është e mjaftueshme!".[1]

Në një hadith të Prijësit të besimtarëveAli ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Në Ditën e Kiametit, All'llahu i Madhëruar i llogarit mirësitë e besimtarëve. Çdo mirësi e shpërblen nga dhjetëfishi deri në shtatëqindfish."*. All'llahu në Kur'an thotë: **"Kështu është shpërblimi nga Zoti yt - dhuratë sipas meritës."**.

Nga ky ajet mund të mësojmë se dhuratat hyjnore, edhe pse kanë aspekt mirësie, në të njëjtën kohë është në llogari të veprave, që do të thotë se preferencat dhe mirësitë e All'llahut janë në përputhje me punët e mira të njeriut. Në këtë mënyrë mund të themi se fjala *"hisaba"* mund të komentohet me ajetin e mësipërm me po atë kuptim të njohur *"mehasebeh"*. Ajo që është e përbashkët midis këtij kuptimi dhe kuptimit të kaluar, nuk përbën ndonjë pengesë.[2]

Më pas, në ajetin 37, shton se këtë mirësi të madhe e fal Ai që është Zot i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre, All'llahu është Mëshirëbërës dhe Falës: **"Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, i Gjithëmëshirshmi."**

All'llahu është Pronar i kësaj bote, Ai është Kujdestari dhe Admistruesi i saj dhe mëshira e Tij është gjithkund dhe përfshin

[1] Tefsiri "Bejdhavi", poshtë ajetit për të cilën po diskutojmë.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 495, Hadithi 29.

çdo njeri. Ai është Mëshiruesi dhe Falësi i gjithë atyre mirësive në Kiamet. Të gjitha këto janë për të mirët dhe të pastrit nga mëkatet.

Në të vërtetë, ajeti i mësipërm tregon këtë të vërtetë: Nëse All'llahu ka premtuar, këtë gjë e ka bërë për të kujdesshmit dhe të devotshmit. Po ashtu, një pjesë të saj (mirësive) në këtë botë All'llahu e ka treguar në mënyrë të mëshirshme për të gjithë ata që janë në qiej dhe në Tokë.

Në fund të ajetit thotë se asnjë nuk ka të drejtë të flasë pa lejen e Tij apo të urdhërojë dikë: **"Askush nuk do të mund t'i flasë** (nga frika)**."**

Përemri te fjala *"la jemlikune"* mund të përfshijë të gjithë ata që janë në qiej dhe në Tokë, ose te të gjithë të devotshmit dhe që mblidhen në Ditën e Kiametit për të dhënë llogari. Sido që të jetë, ky ajet tregon se në atë ditë, asnjë person nuk ka të drejtë të kundërshtojë apo të thotë se përse kështu e përse ashtu. Në atë ditë, Llogaria Hyjnore do të jetë aq e drejtë dhe e saktë, saqë nuk do të mbetet vend për të pyetur "Si?" dhe "Përse?".

Përveç kësaj, askush nuk ka të drejtën e *shefaatit*, përveçse me lejen e All'llahut: **"...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?..."**[1]

[1] Sure "El Bekare", ajeti 255.

Hulumtim

1- Shpërblimi i të devotëshmve dhe dënimi i mëkatarëve

Në ajetet e mësipërme u fol për dhuratat dhe bekimet që All'llahu ka vendosur në dispozicion për njerëzit e devotshëm, duke i krahasuar me ajetet e kaluara, që flisnin për dënimin e punëkëqijve dhe të jobesimtarëve. Midis këtyre ajeteve është bërë një krahasim interesant.

U fol për vendin e shpëtimit *"el mefazu"*, për vendin e dënimit *"el mirsadu"*. Më tej u fol për kopshtet plot me fruta *"hadaike ue e'naba"*, si dhe për zjarrin e Xhehennemit dhe për ata që do qëndrojnë aty për një kohë të paparashikuar *"ehkaben"*.

Më pas u fol për kupa të mbushura me pije plot e përplot *"esh sherabu et tahur"*, ndërsa më lart u fol për pijen e nxehtë *"hamijmen ue gesakan"*.

Këtu u fol për dhuratën e madhe që All'llahu i Mëshirshëm na ka bërë *"Rrahman"*. Ndërsa më lart u fol për dënimin e drejtë, pra, *"xhezaen uifakan"*.

Më tej u fol për shtimin e mirësive të All'llahut *"en nimetu"*, si dhe për rritjen dhe shtimin e dënimit *"el adhabu"*.

Në një përmbledhje të shkurtër, nëse i krahasojmë këto dy grupe nga çdo mendim, ata janë vendosur në dy kënde të ndryshme, sepse edhe ana e besimit dhe e veprave të tyre janë në kënde të ndryshme.

2- Pijet e Xhennetit

Në ajetet e ndryshme të Kur'anit të Shenjtë këshillohet dhe është folur shumë për pijet e shumta të Xhennetit. Ata që do t'i pinë këto pije, do të kenë një kënaqësi shpirtërore, që nuk mund të shpjegohet në asnjë lloj mënyre. Më tej, kur flitet për pijen, atë e krahason me *"esh sherabu et tahur"*, pijen e pastër: **"... Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër."** [1]

Ndërsa në një ajet tjetër thekson se kjo pije është e pastër dhe e qartë, nuk dëmton dhe sjell gëzim. Ajo nuk sjell dhembje koke dhe as nuk deh, si dhe nuk sjell prishjen e mendjes: **"Aty do t'u shërbehet një gotë e mbushur nga një burimi i rrjedhshëm,** (me pije) **të bardhë e të shijshme për ata që do ta pinë. Prej saj as nuk do të trullosen dhe as nuk do të dehen."**[2]

Në një tjetër ajet theksohet se ata pinë nga kupa, të cilat janë me *"Kafur"*, të freskëta dhe qetësuese: **"Sigurisht, të ndershmit besimtarë do të pinë** (në Xhennet) **kupa me pije të përzier me Kafur.".**[3]

Më tej shton se ata pinë në kupa, të cilat janë prej xhenxhefili (ngrohëse që të sjell lumturinë): **"Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil."**. [4]

Në ajetet e mësipërm, lexuam se kupat janë të mbushura plot e përplot dhe të qarta. Është e rëndësishme të theksojmë se *"es sakij"* është All'llahu, i cili nëpërmjet fuqisë, zemërgjerësisë dhe

[1] Sure "Insan", ajeti 21.
[2] Sure "Es Saffat", ajeti 45-47.
[3] Sure "Insan", ajeti 5.
[4] Sure "Insan", ajeti 17.

mëshirës së Tij, siç thotë ajeti 21 i sures "Insan" (Dehr): **"Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër."**[1]

O Zot! Na bëj edhe ne prej atyre që do të pinë nga kjo pije!

[1] Sure "Insan", ajeti 21.

Ajetet 38 – 40

﴿يَوْمَ يَقُومُ الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا لَا يَتَكَلَّمُونَ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَقَالَ صَوَابًا٣٨ ذَلِكَ الْيَوْمُ الْحَقُّ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَى رَبِّهِ مَآبًا٣٩ إِنَّا أَنْذَرْنَاكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا يَوْمَ يَنْظُرُ الْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ وَيَقُولُ الْكَافِرُ يَا لَيْتَنِي كُنْتُ تُرَابًا٤٠﴾

"Në ditën, kur Shpirti (Xhebraili) **dhe engjëjt do të jenë të rreshtuar, nuk do të flasë askush, përveç atij që do t'i japë lejë i Gjithëmëshirshmi e që do të thotë të vërtetën."**

"Ajo është Dita e Vërtetë, prandaj kush të dojë, le të kthehet te Zoti i vet (që në këtë jetë)**."**

"Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: 'Ah, sikur të isha pluhur!'"

Komentimi

Pendimi i madh

Në ajetet e kaluara u fol për një pjesë të dënimeve të punëkëqijve dhe të jobesimtarëve. Gjithashtu, u fol edhe për dhuratat dhe shpërblimet që All'llahu i Madhëruar shpërblen punëmirët dhe njerëzit e devotshëm në Ditën e Ringjalljes.

Ajetet që do të diskutojmë, shpjegojnë dhe prezantojnë atë Ditë të madhe, si dhe një pjesë të cilësive të saj. Ngjarjet e kësaj Dite të madhe i komenton duke thënë: Të gjithë këto do të ndodhin në Ditën e Kiametit. Në këtë Ditë shpirti dhe engjëjt do të qëndrojnë në një rresht (saf). Askush nuk do të flasë, përveçse me lejen e All'llahut të Mëshirshëm. Ai që flet, nuk flet tjetër përveçse sevapet dhe të drejtën.

Padyshim që "shpirti" dhe "engjujt" në atë ditë do të qëndrojnë në një rresht (saf). Në atë Ditë flitet vetëm me lejen e All'llahut të Mëshirshëm. Gjithçka është vetëm për të zbatuar urdhrin e Tij. Ata edhe në këtë botë janë udhëheqësit e urdhrit, si dhe ekzekutivi i urdhrave të Tij. Në Botën Tjetër (Ahiret) kjo gjë është edhe më e qartë dhe më e zgjeruar.

Për kuptimin e fjalës *"er ruhu"* midis komentuesve të Kur'anit të Shenjtë ka pasur diskutime. Komentuesit e tefsireve kanë përmendur disa komentime. Disa nga tefsiret flasin për tetë mundësi.[1] Po përmendim mundësitë më të rëndësishme:

[1] Tefsiri "Kurtubi", vëll. 10, f. 6977.

1- *"Ruh"* është një krijesë, e cila nuk është prej engjëjve, por është më e mirë se engjëjt.

2- *"Ruh"* është (Xhebraili), i besuar, i cili është ndërmjetësi dhe dërguesi i Shpalljes midis All'llahut dhe Profetëve. Xhebraili është edhe më i madhi i të gjithë engjëjve.

3- *"Ruh"* janë "shpirtrat e njerëzve", që çohen së bashku me engjëjt.

4- Është një engjëll më lart nga të gjithë engjëjt dhe më i mirë se Xhebraili. Ai ka qenë dhe është bashkë me Profetët dhe Imamët e sinqertë.

Është e rëndësishme të theksojmë se fjala *"er ruh"* në Kur'anin e Shenjtë ndonjëherë vjen i vetme dhe pa asnjë shoqërim. Shpeshherë vjen e shoqëruar me fjalën melaike. Këtë e thotë edhe ajeti kur'anor: **"Tek Ai ngjiten engjëjt dhe Shpirti** (Xhebraili)**, në një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet."**.[1]

Po ashtu, në një tjetër ajet, të sures "Kadr", thuhet: **"Engjëjt dhe Shpirti** (Xhebraili)**, me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet."**.[2]

Në këto dy ajete fjala *"er ruhu"* është përmendur pas engjëjve, kurse në ajetin që po diskutojmë, është përmendur përpara engjëjve. Në të vërtetë, mund të jetë e mundur që kjo ndarje t'i përkasë një individi të përcaktuar dhe të madh. Sipas fjalës së përmendur *"ammun"* - *"e përgjithshmja"* është pas fjalës *"khasun"* – *"e veçanta"*, ose përmendja e të veçantës është pas përmendjes së të përgjithshmes.

---

[1] Sure "El Me'arixh", ajeti 4.

[2] Sure "Kadr", ajeti 4.

Por në shumë ajete, fjala *"er ruhu"* vjen bashkë me një shtesë apo një ndajfolje, p.sh. *"Ruhul Kudus"* - *"Shpirti i Shenjtë"*. Këtë gjë e shikojmë në suren "Nahl", ajeti 102, ku thotë: **"Thuaj: 'Atë** (Kur'anin) **e ka zbritur Shpirti i Shenjtërisë nga Zoti yt me të vërtetën...'"**.[1]

Në një ajet tjetër kur'anor thuhet: **"Atë e zbriti Shpirti i besueshëm** (Xhebraili)**."**.[2]

Në disa nga ajetet, All'llahu i Madhëruar, fjalën *"er ruh"* ia ka vendos vetes së Tij, duke thënë: **"Kur t'i jap formën dhe t'i fryj prej shpirtit Tim..."**[3]

Në një tjetër ajet thotë: **"Ne dërguam te Merjemja shpirtin Tonë."**[4].

Në këto ajete duket që fjala *"er ruhu"* që ka ardhur me kuptime të ndryshme dhe ne kemi folur për secilin kuptim të saj.

Por ajo çka është më e përshtatshme midis të gjithë komentuesve, përsa i përket ajetit për të cilin po diskutojmë, mendohet se qëllimi i përdorimit të fjalës *"ruh"* këtu, është njëri prej engjëjve të mëdhenj hyjnorë, që sipas disa prej ajeteve, është edhe më i mirë se Xhebraili.

[1] Sure "Nahl", ajeti 102.
[2] Sure "Shuara", ajeti 193.
[3] Sure "Hixhr", ajeti 29.
[4] Sure "Merjem", ajeti 17.

Në një prej haditheve të Imam Sadikut lexojmë: "Huve melekul a'dhamu min xhibraili ve mikaili." - *"Ai është engjëlli më i madh se Xhebraili dhe Mikaili."*[1]

Po ashtu, në tefsirin "Ali ibnn Ibrahim" thuhet: "Shpirti është engjëlli më i mirë nga Xhebraili dhe Mikaili. Ai ka qëndruar me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Gjithashtu, ai është bashkë me Imamët *(Paqja qoftë mbi ta!)*."[2]

Në disa nga transmetimet në komentimet e Ehli Synetit, nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është transmetuar se: Shpirti është ushtri prej ushtarve të Zotit. Ato nuk janë engjuj, kanë duar, këmbë dhe kokë. Më pas Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* recitoi këtë ajet: **"Ata thonë: 'Kur do të bëhet ky premtim, nëse flisni të vërtetën?'"**.[3] Më tej shtoi se këto janë një ushtri dhe ata një ushtri tjetër.[4]

Gjithsesi, sikurse është përmendur edhe më parë, kjo krijesë e madhe hyjnore si të jetë prej engjëjve, apo prej ndonjë krijese tjetër, në Ditën e Kiametit, së bashku me engjëjt do të jenë të gatshëm që t'i binden urdhrit të All'llahut. Po në atë Ditë të Madhe, askush nuk mund të flasë pa lejen e All'llahut. Të gjithë do t'i zërë ankthi dhe tronditja. Në momentin që ndokush dëshiron të flasë apo t'i bëjë ndokujt "*shefaat*", mund ta bëjë këtë vetëm me urdhrin

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 427; "Biharul Enuar", vëll. 25, f. 47.
[2] Tefsiri "Ali ibn Ibrahim", vëll. 2, f. 402.
[3] Sure " Enbija", ajeti 38.
[4] Tefsiri "Durrul Menthur", vëll. 6, f. 309; Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 176; Tefsiri "Fet'hul Kadijr", vëll. 5, f. 371.

e All'llahut. Ata falënderojnë dhe adhurojnë All'llahun dhe u bëjnë "*shefaat*" atyre që e meritojnë atë. Në një hadith është transmetuar se, kur e pyetën Imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)* për këtë ajet, tha: "*Betohem në All'llah, se në atë ditë (në Ditën e Kiametit) ne do të na jepet leje për të folur dhe do të flasim.*".

Transmetuesi e pyet: "Çfarë do të thoni ju në atë ditë?"

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "*E falënderojmë dhe e adhurojmë All'llahun, u dërgojmë salavate dhe selame Profetëve, ndjekësve tanë u bëjmë "shefaat" dhe All'llahu nuk e mohon "shefaatin" tonë.*".[1]

Nga ky transmetim mund të mësojmë se edhe Profetët, edhe Imamët e pagabuar, qëndrojnë në rresht (Saf) së bashku me engjëjt dhe "*ruhun*". Ndërsa janë pikërisht këta që u jepet leje për të folur, për të falënderuar, për të adhuruar All'llahun e për të bërë shefaat.[2]

Interpretimi i fjalës "*seuaben*" është argument se nëse: engjëjt dhe "*err rruh*" ose Profetët dhe evlijatë do të bëjnë shefaat për disa persona , kjo gjë është e llogaritur dhe nuk është pa shkas.

Pasi flitet për këtë Ditë të Madhe, e cila konsiderohet edhe si dita e kryengritjes së njerëzve dhe e engjëjve, si dita e kapitullit të dënimit dhe e shpërblimit të njerëzve të devotshëm, më tej shton: **"Ajo ditë është e drejtë."**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 427; "Biharul Enuar", vëll. 24, f.262.
[2] Përsa i përket "shefaatit", janë cituar kushtet e veçanta dhe filozofike të tyre. Përgjigjja dhe kritikat, në lidhje me të, janë diskutuar në vëllimin e parë, në ajetin 48 të sures "El Bekare".

Fjala *"el hakku"* ka kuptimin e një gjëje të qëndrueshme, të vërtetë dhe që realizohet. Ky interpretim për Ditën e Kiametit është plotësisht i vërtetë. Në këtë Ditë *"e drejta" - "el hakku"* e secilit do të jepet, të drejtat e të shtypurve do të merren nga shtypësit, e vërteta dhe sekretet e brendshme do të shfaqen, ndaj dhe konsiderohet me gjithë kuptimin si Dita e Hakut.

Duke u bazuar në këtë të vërtetë, kjo gjë mund të jetë motivimi më i efektshëm i njeriut drejt All'llahut dhe bindja të jetë në urdhrat e Tij. Më tej, All'llahu thotë: **"Prandaj kush të dojë, le të kthehet te Zoti i vet** (që në këtë jetë)**."**.

Ky ajet ka këtë kuptim: Të gjitha mjetet e kësaj lëvizjeje janë siguruar, pra, rruga dhe pusi është prezantuar. Profetët kanë propaganduar shumë urdhrin e drejtë. Po ashtu, edhe mendja e njeriut është një profet i brendshëm i tij. Fati i punëkëqijve dhe i punëmirëve është shpjeguar në mënyrë të qartë. Gjithashtu, është përcaktuar "gjykata" , "gjykatësi" dhe "ankuesi". Ajo çka mbetet është vendimi i prerë i njeriut, i cili, duke përdorur lirinë dhe mundësinë që All'llahu i ka dhuruar, mund të përzgjedhë rrugën e të ecë përpara.

Fjala *"el meab"* ka kuptimin e rrugës dhe të vendit të kthimit.

Më poshtë trajtohet çështja e ndëshkimit të kriminelëve, si dhe shpjegohet afrimi i asaj Dite të Madhe përballë personave që pandehnin se ajo ditë është shumë e largët. Ajeti thotë: **"Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi."**.

Jeta në këtë tokë, sado e gjatë që të duket, në krahasim me jetën e Ahiretit, nuk është më shumë se një orë. Gjithashtu, për të

përforcuar më shumë këtë mendim, përmendim një fjalë të urtë arabe: "Çdo gjë që vjen e sigurt, është shumë afër.".

Në ajetet 5-7 të sures "Mearixh" All'llahu i drejtohet Profetit, duke i thënë: **"Prandaj, duro, me durim të hijshëm. Ata e mendojnë atë** (dënim) **të largët, kurse Ne e shohim të afërt."**.

Prijësit të besimtarëve Ali ibn Ebu Talib, po ashtu, në një hadith thotë: *"Çdo gjë do vjen, qoftë e largët dhe e afërt."*[1]

Përse të mos jetë e afërt, ndërkohë që burimi kryesor i dënimit hyjnor, janë veprat e njerëzve, që gjithmonë qëndrojnë me ta? **"Ata kërkojnë prej teje shpejtimin e dënimit, por, në të vërtetë, Xhehennemi do t'i përfshijë të gjithë mohuesit."**[2]

Në atë ditë, një grup i madh do të jetë shumë i hidhëruar dhe do të ndjejë keqardhje. Ata pendohen dhe bëhen pishman. Por as keqardhja e as hidhërimi nuk do të ketë ndonjë ndikim apo rezultat te gjendja e tyre. Pas këtij paralajmërimi, shton: **"Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: 'Ah, sikur të isha pluhur!'"**.

Një grup prej komentuesve të Kur'anit të Shenjtë, fjalën *"jendhuru"*, në këtë ajet e ka komentuar me kuptimin *"jentedhiru"*. Sipas tij, qëllimi i përdorimit të kësaj fjale është të tregojë pritjen e dënimit të veprave të njeriut.

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbja 103.
[2] Sure "El Ankebut", ajeti 54.

Disa të tjerë kësaj fjale i kanë dhënë kuptimin e shikimit të librit (librit ku mbahen shënim të gjitha veprat e njeriut) të veprave dhe marrjes në konsideratë të veprave të mira dhe të kapërcyera.

Po ashtu, mendohet se qëllimi i shikimit të shpërblimit dhe të dënimit, është vepra.

Të gjitha këto komentime lindin, sepse ata, në atë Ditë do të kenë më pak vëmendje ndaj çështjes së pranisë dhe shikimit të veprimeve të njeriut. Duke u ndeshur me këtë të vërtetë, kuptimi i ajetit kur'anor është i qartë dhe nuk ka nevojë për asnjë vlerësim dhe interpretim.

Nga ajete të ndryshme të Kur'anit dhe nga transmetimet islame mësojmë se veprat e njeriut në atë Ditë vijnë në mënyrë të përshtatshme dhe të mëshiruara. Më pas shfaqen përballë tij. Njeriu i shikon veprat e tij dhe, kur i shikon ato vepra, trupi i tij trembet dhe e zë frika e keqardhja. Kur shikon veprat e mira, gëzohet dhe lumturohet. Në parim, shikohet se një ndër shpërblimet më të mira të punëmirëve janë po këto vepra, të cilat mëshirohen me ta. Po ashtu, për punëkëqijtë dhe veprat e tyre është dënimi më i keq, kur veprat e tyre trupëzohen, mëshirohen te ata vetë e do të jenë bashkë me ta.

Në ajetin 49 të sures "El Kehf" lexojmë: **"... Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar..."**.

Po ashtu, në ajetet e fundit të sures "Ez Zelzele" lexojmë: **"Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."**.

E gjithë kjo është prej çudirave të Ditës së Kiametit. Veprat e njeriut atje do të mëshirohen, do të trupëzohen dhe energjitë do të shndërrohen në material e do të marrin shpirt.

Fjalia *"kademet jedah"*, **"ç'kanë bërë duart e tij"** tregon kryerjen e punëve prej njeriut. Njeriu, shpeshherë, i kryen punët me duart e tij, por sigurisht pa u kufizuar te veprat e duarve. Por ajo çka thuhet me gojë, sy, veshë, etj, të gjitha këto përfshihen në këtë ligj.

Kur'ani i Shenjtë, para se të vijë ajo ditë, na ka paralajmëruar dhe na ka njoftuar duke na thënë: **"...çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen..."**.[1]

"...Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij." (Çfarë ka mbjellë për atë Ditë, atë do të korrë.)

Në çdo rast, kur jobesimtari dhe punëkeqi do të shikojë të gjitha veprat që ka kryer përgjatë gjithë jetës së tij, aq shumë do të bëhet pishman dhe do t'i vijë keq, saqë, nga hidhërimi, do të thotë: **"Ah, sikur të isha pluhur!"**.

Ah sikur! Që në fillim, që në stadin e parë të mos binim më poshtë se sa dheu, e se kafshët.

Ah sikur! Pasi u bëmë njerëz dhe u larguam nga kjo botë, të mos kishim një jetë të re, të mos kish Ringjallje!

Në të vërtetë, ata e dinë se edhe dheu është më i mirë se ata, sepse dheu merr një farë dhe pas saj nxjerr me qindra fara. Dheu është burimi i llojeve të ndryshme të ushqimeve dhe i minierave, si

[1] Sure "Hashr", ajeti 18.

dhe ka plot bereqete të tjera. Dheu është shtrati i njeriut dhe djepi i jetës së tij. Dheu nuk sjell asnjë dëm, përveçse të mira. E kundërta e atyre jobesimtarëve, të cilët nuk kishin asnjë dobi në jetën e tyre. Ata dinin veçse të lëndonin e të dëmtonin.

Po, puna e njeriut është më e mira, sepse njeriu është më i miri ndër krijesat e tjera. Por ky njeri, ndonjëherë, i ndikuar nga "kufri" dhe mëkati, arrin deri aty sa dëshiron të jetë në radhët e një tjetër krijese, e cila është e ulët dhe pashpirt.

Në ajetet kur'anore lexojmë se: jobesimtari dhe krimineli në kohën që shikon skenën e Kiametit dhe gjyqin e All'llahut e kur vjen momenti i marrjes së dënimit për veprat që ka kryer, vepron në mënyra të ndryshme. E gjithë kjo ndodh, sepse ai ka një presion shumë të madh dhe një keqardhje për atë që ka vepruar.

Disa prej tyre thonë: **"Mjerë për mua që nuk i kam kryer detyrimet ndaj All'llahut, madje, edhe jam tallur!"**.[1]

E ndonjëherë ata njerëz thonë: **"O All'llah, na kthe përsëri në tokë që të kryejmë punë të mira."**.[2]

E ndonjëherë ata lusin: **"O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj, kthena** (në atë botë) **që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!"**.

[1] Sure "Ez Zumer", ajeti 56.
[2] Sure "Es Sexhde", ajeti 12.

Hulumtim

Vështrim i shpejtë rreth çështjes së *"el xhebru uel ikhtijar" - "detyrimi dhe zgjedhja"*

Kjo çështje është ndër çështjet më të vjetra, e cila diskutohet ndërmjet dijetarëve. Një grup dijetarësh janë të mendimit se njeriu është i lirë në zgjedhje, ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se njeriu është i detyruar në veprimet e tij. Secili grup ka argumentet e tij për të vërtetuar atë që mendojnë. Por është i çuditshëm fakti se të dy grupet e pranojnë praktikisht se njeriu është zgjedhës në veprimet e tij.

Thënë ndryshe: Të gjitha hulumtimet dhe diskutimet në mesin e dijetarëve nuk e kalon rrethin e hulumtimit shkencor (teorik). Kurse në procesin praktik ata kanë mendim të përbashkët se njeriu është zgjedhës në veprimet e tij. Kjo gjë tregon shumë mirë dhe qartë se parimi kryesor i lirisë së vullnetit dhe zgjedhjes është prej parimeve të natyrsëm (fitretu) së njerëzve. Nëse nuk do të ekzistonte dyshimi, të gjithë do të ishin mbështetës të parimit të lirisë së zgjedhjes së njeriut.

Kjo ndërgjegje e përgjithshme dhe natyra e njeriut (el fitratu), janë prej argumenteve më të qarta të zgjedhjes *(el ikthijaru)*, dhe shfaqet qartë në forma të ndryshme në jetën e njeriut. Ndaj, nëse njeriu do e konsideronte veten e tij të detyruar në kryerjen e veprave dhe jo zgjedhës, atëherë:

1- Ndonjëherë ai pendohet për veprat dhe veprimet që kryen. Ndonjëherë nuk pendohet për to dhe kështu merr vendimin

që në të ardhmen të përdorë përvojën që ka kaluar më parë. Kjo gjendje që vjen me keqardhje për ata që janë mbështetës të detyrimit, është e shumtë. Nëse nuk do të ishte zgjedhës në veprime, përse atëherë do të ishte keqardhja?!

2- Të gjithë punëkëqijtë qortohen dhe kritikohen. Nëse janë të detyruar, atëherë përse të kritikohen?

3- Përse punëmirët lavdërohen dhe falënderohen nëse do ishin të detyrua në veprime?!

4- Përsa i përket edukimit dhe mësimit të fëmijës, njeriu përpiqet që t'i sigurojë fëmijës një të ardhme të lulëzuar. Nëse veprat janë të detyruara, atëherë çfarë kuptimi do të kishte mësimi dhe edukimi?

5- Përse dijetarët përpiqen që niveli i moralit në shoqëri të jetë në shkallën më të lartë?!

6- Njeriu pendohet për gjynahet që bë. Nëse ai do t ishte i detyrua në veprime, çfarë dobie do kishte pendimi?!

7- Për njeriu ndien keqardhje për mangësitë dhe dështimet që ka bërë gjatë jetës së tij kur ai është i detyruar në veprime?!

8- Përse në të gjithë botën, punëkëqijtë dhe kriminelët gjykohen dhe hetohen sipas ligjeve kur ata janë të detyruar në veprime?!

9- Përse popujt (besimtarë dhe jo besimtarë) kane vemdosur ndëshkime për kriminelët kur ata janë të detyruar në veprimet e tyre?!

10- Përse përkrahësit e shkollës së "*xhebrit*", fatalizmit, detyrimit, ngrejnë zërin e tyre përpara gjykatësit kundër atyre që u kanë bërë padrejtësi kur ata janë të detyruar në veprimet e tyre?!

Si përfundim, nëse në të vërtetë njeriu nuk do të ishte zgjedhës në veprime, çfarë kuptimi do të kishte pendimi?! Po dënimi dhe qortimi, përse do të nevojiteshin?! A është e mundur që të dënohet dikush që nuk është zgjedhës në kryerjen e veprimeve?!

Përse lavdërohen dhe nxiten punëmirët? Nëse ajo që vepruan ishte jashtë zgjedhjes së tyre, atëherë përse duhet nxitja dhe inkurajimi?!

Në parim, me pranimin e ndikimit të të mësuarit dhe të edukuarit, detyrimi do ta humbasë kuptimin e tij. Duke e lënë këtë pas, çështja e moralit nuk do të kishte kuptim, nëse nuk do të pranohej vullneti i lirë.

Nëse ne jemi të detyruar në ndonjë punë, ç'do të thotë kujdes? Përse të na vijë keq? Gjykimi i një personi të detyruar do të ishte ndër punët më të dhunshme, dënimi i tij do të ishte më i keq se sa gjykimi i tij.

Të gjitha këto tregojnë se liria e zgjedhjes dhe mosdetyrimi është parim për të cilin gjykon edhe natyra e njeriut. Kjo gjë është në përputhje të plotë me ndërgjegjen e njerëzve. Të gjithë pa dallim punojnë sipas këtij parimi qofshin masa e përgjithshme e njerëzve apo edhe dijetarët dhe filozofët. Askush nuk përjashtohet nga ky parim, madje as vetë ata që thonë se njeriu është i detyruar në veprimet e tij. Edhe ata janë zgjedhës por nuk e kuptojnë.

Kur'ani i Shenjtë shpesh vë theksin mbi këtë çështje. Mqenëse ajetet kur'anore që vërtetojnë se njeriu është zgjedhës, do të mjaftohemi me përmendjen e tre ajeteve:

1- "Natyrisht që Ne i udhëzuam atij Rrugën (e Drejtë)**, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës."**[1]

2- Në ajetin 29 të sures "El Kehf" thotë: **"...Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë'..."**.

3- Po ashtu, në suren "El Insan", në ajetin 29, lexojmë: **"Në të vërtetë, kjo është këshillë, prandaj, kush të dojë, le të ndjekë Rrugën që e shpie te Zoti i tij."**.

Të flasësh për çështjen e *"xhebrit" - "detyrimit, fatalizmit* dhe *"ikhtiarit" - "zgjedhjes, vullnetit"* kërkon shumë kohë, sepse vetë çështja është shumë e gjatë. Për këtë fushë është shkruar dhe është folur shumë. Ajo që u tha më lart, është vetëm një pjesë e shkurtër dhe një këndvështrim sipas Kur'anit dhe ekzistencës së ndërgjegjes. Këtë diskutim do ta përfundojmë me rikujtimin e një çështjeje të rëndësishme.

Mbështetësit e grupit të çështjes së *"xhebrit" - "detyrimit, fatalizmit"* kanë ndërhyrë në këtë çështje vetëm për hir të një pjesë të vogël të problemeve që ka filozofia dhe si pasojë e mospasjes së një argumenti. Por edhe faktorët e tjerë të rëndësishëm, sikurse janë ata, psiqik dhe shoqërorë, padyshim që kanë ndikuar në gjetjen dhe në vazhdimësinë e këtij besimi.

[1] Sure "El Insan", ajeti 3.

Shumë persona kanë pikpamje *"xhebri"* ose tek "fati i detyruar", ose në "Kadha" dhe "Kader", me kuptimin e detyrimit, që të gjitha kanë rrënjë të përbashkët. Shkaku i pranimit të *"xhebrit"* është për t'ju larguar përgjegjësisë. Me këtë besim ata kanë mbuluar humbjet dhe dështimet e tyre, të cilat vijnë për shkak të neglizhencës.

Por mund të jetë një mbulim i epsheve të tyre rebele ...

Ndonjëherë kolonialistët, për të shtypur qëndresën e njerëzve dhe për të shuar zjarrin e zemërimit të popujve, si dhe duke kërkuar ndërmjetësimin në këtë besim, u imponojnë njerëzve mendimin se fati i tyre ishte i tillë që në fillim, kështu që nuk kanë rrugë tjetër veçse të binden.

Nëse do të pranonim këtë shkollë, të gjitha veprimet e kriminelëve bëhen shkak që mëkatet e të gjithë mëkatarëve të kenë një justifikim logjik dhe midis të bindurit dhe fajtorit nuk do të ketë asnjë dallim.

O All'llah! Na ruaj nga ky besim jo i drejtë!

O All'llah! Atë Ditë kur Xhehennemi të jetë në pritje të rebelëve dhe Xhenneti në pritje të njerëzve të devotshëm, sytë tanë dhe shpresa jonë të jetë e drejtuar nga mirësia Jote!

O All'llah, atë Ditë, kur të gjitha veprat tona do t'i shikojmë me sytë tanë, të lutem mos na turpëro!

Amin Ja Rab'bel Alemin

Fundi i sures "En Nebe"

Sure "En Naziat"

Zbritur në Mekë

Ajete 46

Përmbajtja e sures "En Naziat"

Kjo sure, sikurse edhe surja "En Nebe" flet rreth çështjeve të *"Meadit" - "Ringjalljes"*. Kjo sure është përmbledhur në gjashtë pjesë.

1- Nis me disa pjesë përmbledhëse, që lidhen me çështjen e *"Meadit" - "Ringjalljes"* dhe e vendos theksin në këtë Ditë të Madhe.

2- Në stadin tjetër flet për peizazhet e frikshme dhe të tmerrshme të asaj Dite.

3- Në pjesën tjetër flet shkurtimisht për historinë e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe fatin e Faraonit rebel, gjë e cila bëhet burim dhe shkak rehatie për Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për besimtarët. Po ashtu, zgjon idhujtarët dhe rebelët, të cilët mohojnë Ringjalljen dhe bien në mëkat të pisët.

4- Në pjesën tjetër sjell shembuj nga peizazhi i fuqisë së All'llahut në qiell dhe në Tokë, e cila është argument për mundësinë e Ringjalljes dhe të jetës pas vdekjes.

5- Edhe një herë tjetër përshkruan jo vetëm një pjesë nga ngjarjet e tmerrshme të asaj Dite të Madhe, por edhe fatin e rebelëve dhe shpërblimin e punëmirëve.

6- Si përfundim, në fund të sures theksohet fakti se asnjë person nuk ka dijeni për historinë e asaj Dite. Vetëm një gjë dihet, Ringjallja është e sigurt.

Kësaj sureje i është vënë ky emër, "En Naziat", për shkak të ajetit të saj të parë.

Mirësitë e leximit të sures "En Naziat"

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Ai që do të lexojë suren 'En Naziat' ndalimi dhe llogaria e tij në Ditën e Kiametit do të jetë sa koha e faljes së një namazi. Më pas do të futet në Xhennet.*".[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "*Ai që lexon këtë sure, ikën nga kjo botë i ngopur me ujë. All'llahu do ta paraqesë atë Ditë të ngopur me ujë. Edhe në Xhennet do të jetë i ngopur me ujë.*" (Do të jetë i ngopur nga mëshira e pafundme e All'llahut).[2]

Nuk është e habitshme që njeriu të marrë te Zoti i tij të gjitha ato shpërbleme që u përmendën kur ai thellohet në leximin e sures dhe në përmbajtjen e saj, e zgjon shpirtërat e përgjumur e të shkujdesur, duke i bërë që të jenë të kujdesshëm për detyrat e tyre. Po ashtu, ato detyra duhet t'i vendosë në veprim, kështu që ata do të kenë shpërblim.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 428.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 428.

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالنَّازِعَاتِ غَرْقًا، وَالنَّاشِطَاتِ نَشْطًا، وَالسَّابِحَاتِ سَبْحًا، فَالسَّابِقَاتِ سَبْقًا، فَالْمُدَبِّرَاتِ أَمْرًا﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Për ata (engjëj) **që marrin me forcë."**

"Për ata që marrin butësisht."

"Për ata që notojnë në hapësirë."

"Për ata që nxitojnë."

"Dhe për ata që i rregullojnë punët!"

Komentimi

Betimi në engjëjt

Në këto pesë ajetet e para të sures "En Naziat" flitet për pesë çështje të rëndësishme, ku dhe All'llahu betohet në këto pesë çështje të rëndësishme. Qëllimi i këtij betimi është sqarimi e së

vërtetës dhe realizimi i çështjes së *"Meadit" - "Ringjalljes"*. All'llahu thotë:

"Për ata (engjëj) **që marrin me forcë."**

"Për ata që marrin butësisht."

"Për ata që notojnë në hapësirë."

"Për ata që nxitojnë."

"Dhe për ata që i rregullojnë punët!"

Përpara se të merremi me komentimin e këtyre ajeteve, është mirë që fillimisht të merremi me kuptimin e fjalës që është përdorur te këto ajete, për t'i qartësuar edhe më mirë ato.

Fjala *"en naziat"* vjen nga rrënja *"en nez'u"*, me kuptimin, *"shkuljen e diçkaje nga vendi ose tërheqjen e diçkaje nga vendi i saj"*. Sikurse tërheqim harkun, kur duam të hedhim shigjetën. Ndonjëherë kjo fjalë është përdorur edhe për çështjet shpirtërore, si për shembull: "neze'u" armiqësi apo dashuri nga zemra, me kuptimin shkuljen e saj.[1]

Fjala *"el garku"*(me zanoren "*e*") sipas shumë gjuhëtarëve, në origjinë, ka kuptimin e "*zhytjes në ujë"*. Ndonjëherë ka kuptimin e një problemi të madh në një ngjarje apo bela. *"El gark"* (pa zanoren "*e"*), sipas Ibn Mandhurit, në gjuhën arabe, është emër i cili është vendosur në vend të paskajores e që ka kuptimin *"el ighrak"*. "*el igrak"*, ka kuptimin e tërheqjes së shigjetës së harkut deri

[1] Libri "Mufredat"i Raghibit, Made "Neze".

në pikën më të mundshme. Më pas është përdorur si hiperbolë në çdo punë që kryhet.

Këtu bëhet shumë e qartë se ajo që përmendet në ajetin e mësipërm, nuk ka kuptimin e mbytjes apo zhytjes në ujë, por ka kuptimin e kryerjes së një pune në masën më të mundshme.[1]

"Për ata që marrin butësisht."

Fjala *"en nashitatu"* vjen nga rrënja *"en neshtu"*, ka kuptimin e zgjidhjes së nyjeve, të cilat hapen kollaj, po ashtu puset që kanë thellësi të pakët dhe kova e pusit nxirret kollaj atëhere thuhet *"enshat"*. Po ashtu, edhe devetë, të cilat lëvizin apo ecin shpejt me pak shtysë, u thuhen *"en neshijtetu"*. Në përgjithësi, kjo fjalë është e përdorshme në çdo rast të lëvizjes që kryhet me lehtësi.

"Për ata që notojnë në hapësirë."

"Es Sabihatu" është fjala tjetër që vjen nga rrënja *"es sebhu"*, e cila ka kuptimin e lëvizjes së shpejtë në ujë apo në ajër. Ndaj ky term përdoret për notim në ujë, ose për lëvizjen dhe ecjen e shpejtë të kalit. Mund të përdoret edhe kur dikush kryen një punë me shumë nxitim dhe shpejtësi.

Fjala *"et tesbijhu"* është përdorur me kuptimin e pastrimit të All'llahut të Pastër nga çdo e metë dhe nga çdo mangësi. Po ashtu, ata që thonë *"et tesbijh"*, pra, falënderojnë All'llahun dhe lëvizje me nxitim në adhurimin e All'llahut.

[1] Është parë libri "Lisanul Arab", tefsiri "Mexhmaul Bejan", tefsiri "Keshshaf" dhe libri "Mexhmaul Bahrejn".

“Për ata që nxitojnë.”

Fjala *“es sabikatu”* vjen nga fjala *“es sebeku”* dhe ka kuptimin *“paraprirjes në ecje”*. Meqenëse paraprirja në ecje nuk arrihet veçse me lëvizje të shpejtë, kjo fjalë, gjithashtu, përmban edhe kuptimin e shpejtësisë.

“Dhe për ata që i rregullojnë punët!”

Fjala *“el mudebiratu”* vjen nga rrënja *“tedbijr”*, e cila ka kuptimin e të menduarit për fundin e ndonjë gjëje. Të menduarit për të ardhmen ndihmon që një punë të përfundojë në mënyrën më të mirë. Ndaj edhe fjala *“tedbir”* është përdorur për këtë kuptim.

Pas këtij përshkrimi të shkurtër le të nisim komentimin e tyre:

Këto pesë betime, që fillimisht paraqiten të paqarta, nxisin mendjen, duke u bërë shkak i ekspozimit të mendjes si dhe të pasurit kujdes. Të gjitha këto betime, për kë bëjnë fjalë, apo çfarë gjërash janë?

Komentuesit kanë folur shumë për to, si dhe kanë komentuar shumë se në përgjithësi ato mbështeten në tre boshte:

1- Qëllimi i këtij betimi te “engjëjt” është se ata (engjëjt) janë të deleguar për të marrë shpirtrat e qafirëve dhe të kriminelëve. Ata e ndajnë me rrëmbim shpirtin nga trupi i tyre. Të tillë shpirtra të pabindur, kurrë nuk kanë qenë gati t’i binden All’llahut.

Ky betim lidhet edhe me engjëjt që janë deleguar për të marrë shpirtrat e besimtarëve, e kryejnë detyrën e tyre me shumë

butësi dhe me shumë qetësi, pra, engjëjt ndajnë me shumë kujdes shpirtin e besimtarëve nga trupi i tyre.

Më tej flitet për engjëjt që e zbatojnë me përpikëri dhe me shumë nxitim urdhrin e All'llahut. E më pas ata garojnë për përparësi midis tyre. Në fund, janë engjëjt që e kryejnë detyrën e tyre duke rregulluar punët e botës.

2- Betimi, ka lidhje me yjet e qiellit, të cilët vazhdimisht bien nga horizonti dhe më pas spostohen në një tjetër horizont.

Një grup lëviz me ngadalë, kurse grupi tjetër e nis rrugën e tij me nxitim. Në oqeanin e botës së sipërme notojnë. Garojnë me njëri-tjetrin. Si përfundim, me ndikimet që kanë këto planete (ndikime si, drita e diellit, e hënës në planetin e Tokës) bëjnë që punët e kësaj bote t'i rregullojnë me urdhër të All'llahut.

3- Betimi ka lidhje me *"luftëtarët"* në Rrugën e All'llhut apo me *"kuajt"* e tyre, të cilët largohen nga shtëpitë dhe nga atdheu i tyre.

Më tej, ata me gëzim dhe qetësi nisin rrugën për në fushën e betejës dhe garojnë me njëri-tjetrin. Çështjet e luftës i menaxhojnë dhe i drejtojnë.

Disa nga komentuesit këto komentime i kanë përzier. Një pjesë prej pesë betimesh i kanë marrë nga një tefsir dhe disa të tjera nga një tjetër. Duhet të theksojmë se parimi është te ato tre komentime që u përmendën më lart.

Në të vërtetë, midis këtyre tre komentimeve nuk ekziston kundërshti. Ka mundësi që ajetet të simbolizojnë të gjitha këto

kuptimet. Në përgjithësi duket se tefsiri i parë është më i përshtatshëm, përshka se:

Së pari: Është përshtatshmëria me Ditën e Kiametit e që surja në total është mbikëqyrëse e saj.

Së dyti: Një tjetër përshtatshmëri është me fillimin e ajeteve të sures "Murselat".

Së treti: Fjala *"uel mudeb 'birati emra"* është më e përshtatshme për *"engjëjt"*, të cilët, me urdhër të All'llahut, kryejnë dhe rregullojnë çështjet e botës. Ata nuk reshtin së kryeri detyrën e tyre as edhe për një çast: **"Ata nuk flasin para** (Fjalës së) **Tij dhe veprojnë me Urdhrin e Tij."**.[1]

Veçanërisht, çështja e rregullimit dhe e sistemimit të çështjeve të botës këtu është përmendur në mënyrë absolute dhe në të nuk ka asnjë kusht.

Pas mendimeve që u thanë më lart, kemi transmetime nga Imamët *(Paqja qoftë mbi ta!)* për komentimin e këtyre ajeteve. Në një transmetim nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, për komentin e këtij ajeti, lexojmë: ***"ue naziati garka"*** - *"Qëllimi i këtij ajeti është për engjëjt që marrin shpirtrat e qafirëve nga trupat e tyre. Këta engjëj e marrin me rrëmbim shpirtin e tyre. Tërheqja është në atë mënyrë, sikur tërhiqet harku gjer në stadin më të fundit të tij"*.[2]

[1] Sure "Enbija", ajeti 27.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 497, Hadithi 4.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ngjashëm me këtë kuptim, ka komentuar ajetin 2-5 të sures "Naziat".[1]

Sigurisht që këtë komentim mund ta shprehim në mënyrë më të përgjithshme, duke thënë se çështja e marrjes së shpirtrave të besimtarëve dhe të qafirëve mund të jetë një prej shembujve të saj dhe jo i gjithë kuptimi i saj. Kështu që qëllimi për këto betime është për shumicën e engjëjve, në lidhje me zbatimin e përgjithshëm të Urdhrit Hyjnor. Zbatimi i këtyre urdhrave realizohet në pesë stade.

Së pari, lëvizja e parë është në kërkim të vendimit të prerë. Më tej është stadi i ecjes me qetësi. Në stadin tjetër është nxitimi dhe përparësia. Në përfundim, është rregullimi i çështjes dhe organizimi i punëve. Por sido që të jetë programi i engjëjve në fushën e marrjes së shpirtrave të qafirëve dhe të besimtarëve, është një nga shembujt e këtij kuptimi të përgjithshëm. Po ashtu, ky diskutim hap një tjetër terren për diskutimet e ardhshme të kësaj sureje për *"Meadin" - "Ringjalljen"*.

Përgjigje për dy pyetje

Nga sa thamë më lart, shtrohen dy pyetje për diskutim:

Pyetja e parë: Fjala *"en naziat"* dhe *"en nashitat"* janë shumësa të emrit femëror, atëhere kush është qëllimi i përdorimit të tyre në këtë rast?

Pyetja e dytë: Tre betimet e para nisin me *"uau"-in* e betimit, ndërsa dy betimet e tjera, pra, betimi i katërt dhe i pestë nisin me

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 497, Hadithet 7-8 dhe 12.

shkronjën *"f"*, e cila është pasardhëse e shkronjës *"uau"*. Cila është arsyeja e përdorimit të këtyre shkronjave?

Në përgjigje të pyetjes së parë duhet të kemi vëmendjen te kjo pikë: Fjala *"en naziat"* është shumësi i fjalës *"naziatun"*, me kuptimin e një grupi nga engjëjt që kryejnë atë që janë urdhëruar. Po ashtu fjala *"en nashitat"* dhe të tjerë shumësa që vijnë nga fonetika femërore, shumësi i tyre, është lidhur me po të njëjtën mënyrë.

Në përgjigje të pyetjes së dytë, mund të thuhet se të konkurosh e të kërkosh përparësi, është konkluzioni i një lëvizjeje të shpejtë, e cila përdoret nga *"es sabihat"*. Po ashtu, sistemimi dhe rregullimi i çështjeve është një konkluzion për totalin e kësaj lëvizjeje. Po për këtë arsye ajo nis me shkronjën *"f"*.

Fjala e fundit që duhet të thuhet këtu, është se këto betime që janë përmendur në pesë ajetet e para të kësaj sureje, janë betime për diçka që nuk përmendet qëq është përgjigja e betimit. Por nga pozicioni simetrik dhe po ashtu nga ajetet e mëposhtme, qartësohet shumë mirë se për çfarë bëhet fjalë. Qëllimi i përdorimit të këtyre betimeve është se të gjithë ju, përfundimisht, do të dërgoheni dhe do të shfaqeni. Kiameti dhe Ringjallja janë të vërteta.

Ajetet 6 – 14

﴿يَوْمَ تَرْجُفُ الرَّاجِفَةُ٦ تَتْبَعُهَا الرَّادِفَةُ٧ قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ٨ أَبْصَارُهَا خَاشِعَةٌ٩ يَقُولُونَ أَإِنَّا لَمَرْدُودُونَ فِي الْحَافِرَةِ١٠ أَإِذَا كُنَّا عِظَامًا نَخِرَةً١١ قَالُوا تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ١٢ فَإِنَّمَا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ١٣ فَإِذَا هُمْ بِالسَّاهِرَةِ١٤﴾

"Ditën kur do të dridhet gjithçka nga ushtima (që lajmëron Kiametin)**."**

"E cila do ta ndiqet nga një e dytë."

"Disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr."

"E shikimet e tyre do të bien përdhe."

"Ata thonë: 'Vallë, vërtet do të rikthehemi në jetë?!'"

"A thua, edhe kur të bëhemi eshtra të thërrmuara?!"

"Dhe thonë: 'Po qe kështu, atëherë ky kthim do të jetë humbje (për ne)**!'"**

"Por, ajo do të jetë veç një fryrje e vetme (e Surit)**."**

"Dhe ata përnjëherësh do të brofin (të ringjallur)**."**

Komentimi

Britma tmerruese e vdekjes

Më lart u fol se Kiameti është një e vërtetë e padiskutueshme. Ajetet në fjalë paraqesin disa ndodhi e shenja që do të shoqërojnë Ditën e Kiametit. Ajeti i parë në fjalë thotë: **"Ditën kur do të dridhet gjithçka nga ushtima** (që lajmëron Kiametin)**."** Pra, kur do të ndodhë një tërmet i tmerrshëm, që do të tronditë gjithçka. Ajeti në vijim thotë: **"E cila do ta ndiqet nga një e dytë."**

Fjala *"er raxhifetu"* vjen nga rrënja *"er rexhfu"*, që ka kuptimin e shqetësimit dhe të lëkundjes së madhe. Po ashtu kjo fjalë përdoret edhe për lajmet që shkatojnë shqetësim në mesin e njerëzve.

Fjala *"er radifetu"* vjen nga rrënja *"er redfu"* dhe ka kuptimin e një personi apo të një diçkaje, e cila vjen pas dikujt tjetër. Personi që ka hipur mbi një kafshë apo diçka tjetër dhe pas tij hipën dikush tjetër, i thuhet *"redif"* - i rreshtuar pas dikujt tjetër.

Shumë prej komentuesve janë të mendimit se qëllimi i përdorimit të fjalës *"raxhife"* ka të bëjë me britmën e parë, ose me fryrjen e *"Surit"* të parë i cili është briri që fryhet për të paralajmëruar zhdukjen e botës dhe tërmetin shkatërrues. Ndërsa fjala *"radife"* flet për britmën e dytë dhe fryrjen e *Surit* të dytë, e cila konsiderohet si fryrja e jetës, e ringjalljes dhe e kthimit në një jetë të re.

Për këtë arsye, këto dy ajete tregojnë të njëjtën gjë që tregon ajeti 68 i sures "Ez Zumer":**"Kur do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do**

All'llahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin."

Disa komentues kanë thënë: Fjala *"er raxhifetu"* tregon tërmetin që do të shpërbëjë tokën, ndërsa fjala *"er radifetu"* është tërmeti që do të shpërbëjë qiejt. Komentimi i parë duket se është më i drejtë.

Ajeti vijues thotë: **"...disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr."**.

Zemrat e kriminelëve, të mëkatarëve dhe të dhunuesve do të dridhen shumë dhe do të jenë të shqetësuar jo vetëm për llogarinë që do t'u kërkohet, por edhe për dënimin që do të marrin.

Fjala *"ek uaxhifetu"* vjen nga rrënja e fjalës *"el uexhfu"* që ka kuptimin *"shpejtësi e lëvizjes"*. Në një tjetër vend thuhet *"ue euxhefetul beir"*, *"njeriu e lëviz me nxitim devenë"*. Në vendet ku shpejtësia dhe nxitimi ekzistojnë, bëhet shkak që edhe dridhja (tërmeti) dhe shqetësimi të jetë i pranishëm. Ky term, po ashtu, përdoret edhe për kuptimin e forcës së shqetësimit.

Ky shqetësim i brendshëm është aq i madh, saqë ndikimet e tij janë të pranishme te e gjithë qenia e mëkatarëve. Ndaj në ajetin tjetër thotë: **"Shikimet e tyre do të bien përdhe."**.

Në atë Ditë sytë ulen me forcë, mbeten mbrapa, nuk lëvizin, bëhen kokëfortë. Ata duken sikur e kanë humbur shikimin nga frika e madhe që kanë.

Në ajetin vijues flitet për hetën e dynjasë: **"Ata thonë: 'Vallë, vërtet do të rikthehemi në jetë?!'"**.

Fjala *"el hafiretu"* vjen nga rrënja *"el hafru"*, e cila në origjinal ka kuptimin *"gërmim i tokës"*. Ndikimi që mbetet nga ajo, quhet *"hefer"*. Po ashtu, thundrës së kalit i thuhet *"hafer"*, sepse trondit tokën me thundrën e tij. Më pas fjala *"hafere"* është në rolin e metaforës në citimin e parë që i është bërë. Sepse njeriu kur ecën e gërmon, e ngjesh tokën me këmbët e tij dhe në atë vend mbetën gjurmët e këmbës së tij. Po ashtu, në kohën që ai kthehet, para i vendos këmbët në gjurmët e tij. Ndaj ky term ka ardhur me kuptimin e parë.

Ajeti tjetër tregon vazhdimësinë e fjalimit të tyre: **"A thua, edhe kur të bëhemi eshtra të thërrmuara?!"**.

Kjo është pyetja që mohuesit e Ringjalljes i kanë drejtuar gjithmonë jo vetëm vetes, por edhe të tjerëve. Ata nuk besonin se kockat e bëra copë-copë "veshin" edhe një herë rrobat e jetës, ndërkohë që largësinë midis tyre dhe një krijese të gjallë e shikonin shumë të madhe. Fatkeqësisht, ata kishin harruar që edhe në fillim ata u krijuan po nga ajo baltë.

Fjala *"nakhirtun"* është mbiemër dhe vjen nga rrënja *"en nukhru"* që në origjinë ka kuptimin e *"pemë e zhveshur, e cila është bosh brenda"*. Kur era fryn, kjo pemë lëshon zë, bën zhurmë. Po ashtu edhe zëri që rrotullohet në hundë i thuhet *"en nekhijr"*. Pra, kjo fjalë është përdorur për çdo krijesë që është bërë dhe shpërbëhet nga gjendja e parë.

Mohuesit e Ringjalljes nuk mjaftohen me kaq, por merren me talljen e *"Meadit" - "Ringjalljes"*. Ata thonë se, nëse do të kishte apo do të ekzistonte Kiameti apo kthimi, do të ishte me humbje, atëherë gjendja e tyre në atë Ditë do të jetë shumë e dhimbshme.

"Dhe thonë: 'Po qe kështu, atëherë ky kthim do të jetë humbje (për ne)**!'"**.

Një tjetër mundësi për komentimin e këtij ajeti është ajo që ata thonë, duke u bazuar te fjalët e stërgjyshërve të tyre dhe jo për t'u tallur. Ata thonë se, nëse do të ketë kthim, atëherë ky kthim i përsëritur do të jetë i kotë dhe me humbje. Nëse jeta do të ishte e mirë, sa mirë do të ishte sikur All'llahu të vazhdonte me po këtë jetë. Nëse kjo jetë është e keqe, përse të jetë kthimi?

Fjalia *"Inna lemerdudune fil khafire"*, duke pasur parasysh se *"khafire"* ka kuptimin e *"gropës dhe të zgavrës"*, mund të jetë simetri për këtë komentim. Por ajo çka është e njohur midis komentuesve, është komentimi i parë.

Duhet pasur parasysh se në ajetin e kaluar interpretimi ishte për fjalën *"jekulun"*, e cila është shenjë e vazhdimësisë dhe përsëritja e tyre është fjalë nga ana e tyre. Por interpretimi me *"kalu"* - *"thanë"*, në ajetin për të cilin po diskutojmë, është argument se ky fjalim nuk është i përsëritur gjithmonë, vetëm ndonjëherë janë përmendur. Kjo është pika e ndryshimit të këtij interpretimi.

Në fundin e këtyre ajeteve, do të kthehemi edhe një herë te çështja e Kiametit dhe e Ringjalljes. All'llahu, me një zë të prerë, thotë se ky kthim do të bëhet vetëm me një britmë, me zë të madh: **"Por, ajo do të jetë veç një fryrje e vetme** (e Surit)**." "Ata përnjëherësh do të brofin** (të ringjallur)**."**

Kjo punë nuk është e komplikuar dhe me probleme, sepse me urdhrin e All'llahut do të lulëzojë edhe era e dytë e në këtë mënyrë do të ngrihet jeta. Të gjithë këto dhera dhe kocka të

copëtuara do të mblidhen edhe një herë dhe do të marrin shpirt, duke u ngritur nga varret.

Fjala *"ez zexhretu"* ka kuptimin e britmës, e cila përdoret për shtysë, ndërsa në këtë rast është përdorur me kuptimin e dytë të erës.

Për të interpretuar këtë grup emëror *"zexhretun uahidetun"* duhet pasur parasysh përmbajtja e këtyre dy fjalëve, të cilat tregojnë shpejtësinë dhe të papriturën e Ringjalljes, si dhe lehtësinë që All'llahu ka për ta bërë atë. Pra, me një britmë nga ana e engjëllit të Ringjalljes apo nga ana e Surit të Israfilit, të gjithë të vdekurit do të veshin rrobat e jetës dhe do të paraqiten në Fushën e Kiametit.

Fjala *"es sahiretu"* vjen nga rrënja *"es sehru"*, që ka kuptimin *"të qëndrosh zgjuar natën"*, për vetë faktin se, kur shikojmë në gjumë ngjarje të tmerrshme, gjumi largohet nga sytë. Fusha e Kiametit, po ashtu, është shumë e frikshme. Fjala *"es sahiretu"* është përcaktuar për Fushën e Kiametit.

Disa komentues të Kur'anit të Shenjtë thonë se fjala *"es sahiretu"* është përdorur për çdo shkretëtirë, sepse, në parim, të gjitha shkretëtirat janë të tmerrshme dhe nga tmerri që ato ofrojnë, duket që edhe gjumin e natës ta marrin nga sytë.[1]

[1] "Lisanul Arabi", rrënja *"sahr"* dhe në tefsirin "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 429 dhe tefsirin "Kurtubi", vëll. 10, f. 6990.

Ajetet 15 – 26

﴿هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى١٥ إِذْ نَادَاهُ رَبُّهُ بِالْوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى١٦ اذْهَبْ إِلَى فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى١٧ فَقُلْ هَلْ لَكَ إِلَى أَنْ تَزَكَّى١٨ وَأَهْدِيَكَ إِلَى رَبِّكَ فَتَخْشَى١٩ فَأَرَاهُ الْآيَةَ الْكُبْرَى٢٠ فَكَذَّبَ وَعَصَى٢١ ثُمَّ أَدْبَرَ يَسْعَى٢٢ فَحَشَرَ فَنَادَى٢٣ فَقَالَ أَنَا رَبُّكُمُ الْأَعْلَى٢٤ فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ الْآخِرَةِ وَالْأُولَى٢٥ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِمَنْ يَخْشَى٢٦﴾

"A e ke dëgjuar (o Muhammed) **historinë e Musait?"**

"Zoti i tij e thirri në luginën e shenjtë të Tuvas dhe i tha."

"Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar çdo kufi."

"Dhe thuaji: 'A do ta pastrosh veten."

"Dhe të të udhëzoj te Zoti yt, që t'i frikësohesh?"

"Musai ia tregoi mrekullinë më të madhe."

"Por ai (Faraoni) **e mohoi dhe e kundërshtoi."**

"Pastaj i ktheu shpinën, duke u përpjekur (kundër së vërtetës)**."**

"Dhe tuboi njerëzit e u deklaroi."

“Unë jam zoti juaj më i lartë!”

“Prandaj All’llahu e goditi atë me dënim në Jetën Tjetër dhe në këtë jetë.”

“Kjo është këshillë për ata që i frikësohen All’llahut.”

Komentimi

Shpifja e Faraonit

Pas sqarimeve të detajuara që u bënë në ajetet e mësipërme, përsa i përket çështjes së Ringjalljes dhe të mohimit të saj nga kundërshtarët dhe idhujtarët, më tej do të diskutojmë për ajetet që flasin për njërin prej rebelëve më të mëdhenj të historisë, për Faraonin dhe fatin e tij të dhimbshëm. Historia me Faraonin tregon se personat e fuqishëm nuk mund t’i rezistojnë zemërimit dhe dënimit të All’llahut. Po ashtu, zemrat e besimtarëve i gëzon, duke u thënë të mos kenë frikë nga fuqia e jashtme e armikut. Për All’llahun është shumë e lehtë t’i dënojë ata.

Ky grup ajetesh fillon me ajetin që flet për Musain *(Paqja qoftë mbi të!)*: **“A e ke dëgjuar** (o Muhammed) **historinë e Musait?”**.

Interesant është fakti se ajeti është ndërtuar në formën e pyetjes, duke iu drejtuar Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo mënyrë e ndërtimit

të ajetit zgjon kureshtjen e dëgjuesit dhe bën që ai të jetë i gatshëm ta dëgjojë këtë tregim paralajmërues.

Më tej shton: **"Zoti i tij e thirri në luginën e shenjtë të Tuvas."**.

Tuva mund të jetë emri i një toke të shenjtë, e cila është midis Shamit, Medines dhe Egjiptit. Shkëndija e parë e zbulesës është shfaqur në zemrën e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* në atë shkretëtirë. Ky interpretim është përmendur edhe në suren "Ta Ha", në ajetin 12, kur Musai dëgjon një zë: **"Në të vërtetë, Unë jam Zoti yt! Prandaj, hiqi nallanet, sepse ndodhesh në luginën e shenjtë të Tuvasë."**.

Është edhe një mendim tjetër, që fjala *"tuva"* ka funksionin e ndajfoljes dhe vjen nga rrënja *"tej"* që ka kuptimin *"mbështjell"*. A thua ajo tokë është e shenjtë dhe bereqeti ishte i mbështjellë? Sipas Ragibit, Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* duhet të bënte rrugë të gjatë, derisa të bëhej gati për t'iu shpallur zbulesa, por All'llahu këtë rrugë e mbështolli, që Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* të arrijë sa më parë afër qëllimit.

Kur All'llahu i dha mesazhin Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*, ia dha në tokën e shenjtë, mesazhi ishte në dy fjali të shkurtra, por shumë kuptimplota. All'llahu i tha: **"Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar çdo kufi". "Thuaji: 'A do ta pastrosh veten?'"**.

E nëse do të pastrohesh dhe të jesh i aftë për këtë takim e të bëhesh i dashur: "Unë ty do të të udhëzoj drejt All'llahut, që të kesh frikë All'llahun dhe të mos kryesh vepra që janë në kundërshtim me Të: **"Të të udhëzoj te Zoti yt, që t'i frikësohesh."**.

Në këtë ajet thirrja dhe ftesa është e përzier me argument. Ajeti tjetër thotë se Musai, pasi bëri këtë bisedë, i tregoi një mrekulli të madhe: **"Musai ia tregoi mrekullinë më të madhe."**.[1]

Cila është mrekullia e madhe? A është shndërrimi i shkopit në gjarpër të madh, apo është dorabardhë, apo janë të dyja bashkë (sepse *"elifi"* dhe *"lami"* në *"el ajetul kubra"* të jetë tregues i një gjinie), ose çdo veprim tjetër, ishte mrekulli e madhe e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ai, që në fillimin e ftesës së tij, u mbështet te ajo mrekulli.

Në këto ajete ndodhen disa shënime tërheqëse, që është e nevojshme t'u kushtohet vëmendje:

1- Arsyeja e ikjes drejt Faraonit tregon jo vetëm rebelimin e Faraonit, por edhe një ndër qëllimet e mëdha të Profetëve, udhëzimin e rebelëve, ose luftën me ta.

2- Ftesa që i bëhet Faraonit i bëhet butësisht dhe me shumë bamirësi. Interpretimi i urdhrit është bërë në këtë mënyrë: **"Thuaji: 'A do ta pastrosh veten?'"**.

(Në të vërtetë, pastërtia absolute përfshin pastërtinë nga dyshimi dhe kufri, si dhe nga dhuna e korrupsioni). Ky interpretim është i ngjashëm me interpretimin që është bërë në ajetin 44 të sures "Ta Ha": **"Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!"**.

[1] Është e qartë se midis tyre është thirrja hyjnore në atë fushë të shenjtë si dhe paraqitja e një mrekullie krijonte një distancë të madhe, ku Kur'ani e ka ruajtur shkurtimin e përmbajtjes.

3- Ky interpretim është një shenjë delikate që i bëhet kësaj të vërtete, që thotë se profetësia e Profetëve në fillim është për të pastruar njeriun dhe të kthejë te ai pastërtinë natyrale. Profetët nuk thoshin: "Unë do të të pastroj ty!", por ajeti thotë: **"A do ta pastrosh veten?"**. Kjo tregon se pastrimi duhet të jetë me pëlqim dhe dëshirën e vetë njeriut dhe të mos i imponohet atij nga jashtë.

4- Përmendja e "udhëzimit", pasi të pastrohet është argument se në fillim njeriu duhet të pastrohet, pastaj të hedhë hapat për të kryer urdhrat.

5- Duke interpretuar fjalën *"Rabbike" - "Zotit"* i vihet theksi kësaj pike: Ty do të të dërgoj drejt një personi, që është pronari, kujdestari dhe trajnuesi yt, atëherë përse largohesh nga rruga e lumturisë?!

6- *"el khashjetu" - "të pasurit frikë All'llahun"* është rezultat i udhëzimit drejt Zotit. Fryti i pemës së udhëzimit dhe i Njëshmërisë është po ajo ndjesi e përgjegjësisë përballë All'llahut të Madhëruar. Të pasurit frikë, kurrë nuk arrihet pa pasur njohuri. Ndaj dhe në suren "Fatir", në ajetin 28 lexojmë: **"Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robtë e Tij, All'llahut i frikësohen vetëm dijetarët,** (që e dinë se) **All'llahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës."**.

7- Profeti Musa *(Paqja qoftë mbi të!)*, në fillim, udhëzimin e nis në mënyrë emocionale. Më pas, nëpërmjet shenjave dhe mrekullive të mëdha, shkon te udhëzimi racional dhe logjik. Kjo është propaganda më me ndikim, e cila si fillim nis nëpërmjet mirësisë dhe dashurisë ndaj ndjenjave dhe emocioneve të krahut tjetër, më tej shkohet drejt argumentit dhe shprehjes së urdhrit.

Tani le të shohim reagimin e Faraonit përballë gjithë këtyre të mirave, mirësive, shenjave të mëdha që iu thanë nga Profeti Musa *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Ky rebel kokëfortë nuk zbriti kurrë nga kryelartësia, sikurse tregohet edhe në ajetin e mëposhtëm. Ai e mohoi ftesën e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe u rebelua me All'llahun. Kjo tregon se mohimi është fillesa e rebelimit, sikurse edhe verifikimi dhe besimi është fillesë e bindjes ndaj Krijuesit.

Ai nuk u mjaftua me këto veprime të tij, por përballë ftesës së Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* u kthye prapa dhe nisi luftën e pandërprerë me të dhe u përpoq që të zhdukte besimin.[1]

Meqë mrekullia e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* vinte në rrezik të gjithë qenien e tij rebele, urdhëroi shërbyesit e tij që të mbledhin të gjithë magjistarët në qytete të ndryshme. Po ashtu urdhëroi që të mblidhen të gjithë njerëzit që të shikojnë magjistarët, të cilët do garojnë me Musain *(Paqja qoftë mbi të!)*: **"... tuboi njerëzit..."**.

Edhe pse fjala *"heshere"*, në këtë rast, e ka përmendur në mënyrë absolute, por detajimin e çështjes e kuptojnë nëpërmjet aheteve të tera, siç janë ajetet 111 dhe 112 të sures "El Araf", që thonë: **"...dhe dërgoni nëpër qytete lajmëtarë që të tubojnë e të të sjellin ty** (Faraon) **çdo magjistar të shkathët.'"**.

E njëjat situatë është edhe për fjalën *"nada"*, kuptimin e së cilës e arrijmë kur lexojmë ajetin 39, të sures "Esh Shuara", i cili flet

[1] Interpretimi me fjalën *"thumme"* zakonisht vjen për të distancuar dy ngjarje. Është e mundur që interpretimi me këtë fjalë të jetë për këtë shkak: Faraoni dha një interval kohor, që plani i tij i luftës me Profetin Musa të ishte plotësisht i pjekur dhe i suksesshëm.

për të njëjtën çështje dhe thotë: **"E popullit iu tha: 'A jeni mbledhur të gjithë?'"**.

Përsëri faraoni nuk mjaftohet me këto komplote, por shpreh pretendimin e tij më të madh, duke thënë: **"Unë jam zoti juaj më i lartë!"**.

Në të vërtetë, është shumë e çuditshme që ky rebel kokëfortë, në kulmin e mendjemadhësisë dhe të egoizmit nuk njeh asnjë masë, kufi apo formalitet. Gjithashtu, nuk mjaftohet me pretendimin e tij për të qenë zot, por dëshiron të jetë zot i zotave.

Fjala e tij është se, nëse ju adhuroni idhujt, ata janë të respektuar në pozitën e tyre, por unë jam idhulli që ju duhet të adhuroni.

Por ajo çka është e habitshme në këtë rast është se vetë Faraoni, sipas ajetit 127 të sures "El Araf" ishte vetë një nga adhuruesit e idhujve: **"...A mos vallë do ta lësh Musain dhe popullin e tij që të bëjnë ngatërresa në tokë dhe që të braktisin ty dhe zotat e tu?..."**.

Pra, pretendimi i Faraonit se ishte zoti më i lartë ishte edhe për zotat e tij që edhe ata isjun robër të tij! Kjo është sjellja e kotë e faraonëve dhe e rebelëve.

Më e çuditshme se kaq është fakti se në një vend tjetër ai pretendon se është hyjni, duke thënë: **"Dhe Faraoni tha: 'O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje!..."**[1]

[1] Sure "El Kasas", ajeti 38.

Por sipas ajetit që ne po diskutojmë, ai e ka hedhur këmbën më tej, sa pretendon se është zot: **"Unë jam zoti juaj më i lartë!"**. Ky pra është programi i mendjemëdhenjve dhe kokëfortëve.

Për çdo rast, Faraoni, rebelimin dhe kokëfortësinë e tij e shtyn drejt stadit të fundit dhe bën që të meritojë dënimin më të dhimbshëm. Urdhri Hyjnor do të arrijë dhe dhuna e korrupsioni që ai ka organizuar, do të shtypet. Ndaj edhe në ajetin e mëposhtëm thuhet: **"Prandaj All'llahu e goditi atë me dënim në Jetën Tjetër dhe në këtë jetë."**.

Fjala *"en nekalun"* ka kuptimin *"dobësi, pamundësi dhe paaftësi"*. Ndaj dhe kur një person heq dorë nga atributet, i thonë se ka bërë një gjë të turpshme.

Ndërsa në ajet fjala *"nekalu"* ka kuptimin e një zinxhiri të rëndë, që njeriun e bën të dobët dhe të pafuqishëm. Po ashtu, bën që njeriu të mos ketë mundësi të lëvizë. Edhe dënimi i All'llahut, po ashtu, është burim i paaftësisë dhe personat e tjerë i ndalon të kryejnë mëkate. Kësaj gjendjeje i thuhet *"nekal"*.

Grupi emëror *"nekalul akhire"* tregon dënimet e Kiametit që do të zënë qafën e Faraonit dhe të të tjerëve. Meqë në nivelin e parë ka të bëjë rëndësia, u pa e arsyeshme se qëllimi i përdorimit të fjalës *"el ula"* është theksimi i dënimit të kësaj bote, që ka zënë qafën e Faraonit dhe të gjithë shokëve të tij, të cilët u zhytën në lumin Nil.

Këtu është përmendur një tjetër komentim për ajetin. Qëllimi i përdorimit të fjalës *"el ula"* është fjala e parë, të cilën e tha Faraoni, në rrugën e rebelimit, duke pretenduar se është zot.[1]

[1] Sure "El Kasas", ajeti 38.

Ndërsa fjala *"el akhiretu"* tregon fjalën e fundit të Faraonit, të pretendentit për zotin e madh. Ndaj dhe All'llahu e dënoi Faraonin në këtë botë për këto pretendime që pati.

Në një hadith të Imam Bakir *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar se fjalia e dytë është thënë 40 vjet pas fjalisë së parë. (All'llahu, për të përmbushur maksimumin e argumentit, nuk e dënon atë gjatë kësaj periudhe.)[1]

Fjala *"ekhedhe"* është folje e kohës së shkuar dhe tregon në mënyrë të plotë dënimet që kanë ngjarë në këtë botë. Ajeti tjetër këtë ngjarje e konsideron si mësimin dhe shembullin më të suksesshëm.

Si përfundim, pasi është folur për të gjithë ngjarjen, ajeti 26 bën një përmbledhje, duke kuptuar që historia e Profetit Musa *(Paqja qoftë mbi të!)* me Faraonin është një mësim i madh për ata që i tremben All'llahut, duke dhënë një këshillë: **"Kjo është këshillë për ata që i frikësohen All'llahut."**.

Ky ajet tregon më së miri se nga kjo ngjarje marrin mësim vetëm personat që përfitojnë nga frika, përgjegjësia dhe në zemrën e tyre është ndjenja e përgjegjësisë apo, me fjalë të tjera, ata kanë syrin e nxënies.

Ky ishte dhe fati i Faraonit rebel. Le të marrin mësim të gjithë ata faraonë dhe rebelë të pafe, sepse në çdo kohë dhe epokë

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 432. Edhe një tjetër transmetim ka po këtë përmbajtje, që është transmetuar nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky transmetim është shpjeguar më me shumë hollësi. (Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 500).

do të arrijë edhe llogaria e tyre dhe ta dinë që ky urdhër është i prerë dhe se as historia dhe as tradita, nuk e ndryshon dot atë.

Hulumtim

Dymbëdhjetë ajetet e shkurtra që u komentuan më lart, tregojnë elokuencën dhe retorikën e Kur'anit të Shenjtë. Në këto rreshta të shkurtra është folur në mënyrë të përmbledhur për të gjithë ngjarjen e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe të Faraonit: misioni i motivimit, qëllimi i profetësisë, mjetet e pastrimit, si bëhet ftesa, mënyra dhe cilësia e reagimit, mënyrat e komplotit të Faraonit.

Si përfundim, flet për dënimet e dhimbshme të këtij njeriu mendjelehtë dhe për mësimin që duhet të marrin njerëzit, duke reflektuar rreth këtyre ajeteve.

Ajetet 27 – 33

﴿أَأَنْتُمْ أَشَدُّ خَلْقًا أَمِ السَّمَاءُ بَنَاهَا٢٧ رَفَعَ سَمْكَهَا فَسَوَّاهَا٢٨ وَأَغْطَشَ لَيْلَهَا وَأَخْرَجَ ضُحَاهَا٢٩ وَالْأَرْضَ بَعْدَ ذَلِكَ دَحَاهَا٣٠ أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَاهَا٣١ وَالْجِبَالَ أَرْسَاهَا٣٢ مَتَاعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ٣٣﴾

"Cili është më i vështirë: krijimi i juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi."

"Ia ngriti lart kupën dhe e përsosi."

"Netët i bëri të errëta, kurse ditët të ndritshme."

"Pastaj e shtriu rrafsh Tokën."

"Dhe, nga ajo nxori ujërat dhe bëri kullotat."

"Kurse malet i bëri të patundshme."

"Që t'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja."

Komentimi

Shenjat e hyjnore në sistemin e gjithësisë

Një tjetër argument për Ringjalljen është ky ajet: **"Cili është më i vështirë: krijimi i juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi?"**.

Pas përmendjes së jetës së Profetit Musa dhe Faraonit, që u paraqit si mësim për të gjithë rebelët dhe mohuesit, i rikthehet edhe një herë tjetër çështjes së Ringjalljes, ku do të sjellë shembuj nga fuqia e pafundme e All'llahut në botën e ekzistencës, si një argument për mundësinë e Ringjalljes. Po ashtu, në një pjesë të tij flet për mirësinë e pafundme të All'llahut ndaj njeriut, që te njeriu të zgjohet ndjesia e falënderimit, e cila është burimi i mirënjohjes.

Së pari, mohuesit e Ringjalljes i ka vendosur si adresues dhe më pas All'llahu thotë: "A mos vallë krijimi juaj (dhe kthimi në jetë, ringjallja juaj pas vdekjes) është më i vështirë? A mos vallë krijimi i këtyre qiejve me këtë madhështi që All'llahu ka ndërtuar është më i vështirë?

Ky fjalim, në të vërtetë, është përgjigje për fjalën e tyre, që u përmend në ajetet e mëparshme: **"A do të kthehemi ne në gjendjen e mëparshme?"**.

Ky ajet thotë se çdo njeri, në çdo fazë të perceptimit dhe të vetëdijes, e di që krijimi i këtyre qiejve të lartë dhe i të gjithë këtyre mirësive, si dhe i galaktikave të pafundme, nuk mund të krahasohet me krijimin e njeriut. Ai që ka këtë fuqi, si mund të jetë i pafuqishëm t'ju kthejë ju përsëri në jetë?!

Pas kësaj do të përshkruajmë edhe më tepër këtë krijim të madh: **"Ia ngriti lart kupën dhe e përsosi."**.

Fjala *"semkun"* ka kuptimin *"lartësi"* dhe *"gjatësi"*. Gjithashtu, ka ardhur edhe për kuptimin e *çatisë*.

Në tefsirin "El Kebijr" të Fakhru Razit thuhet se, kur gjatësia e një gjëje matet nga lart poshtë, quhet thellësi dhe, nëse matja bëhet nga poshtë lart, quhet lartësi.[1]

Fjala *"seua'ha"* vjen nga rrënja *"et tesuijetu"*, që ka kuptimin *"rregullues" dhe "vendosjen në harmoni të një diçkaje"*. Gjithashtu tregon sistemin e saktë të të gjithë galaktikave qiellore, ku All'llahu është urdhëruesi i tyre. Por nëse qëllimi për gjatësinë është çatia, atëherë bëhet fjalë për lëvozhgën e madhe që vjen nga ajri, e cila qëndron si mbrojtëse, njëjtë si qëndron çatia si mbrojtëse e Tokës. Ajo mbron vërsuljen e gurëve të përçarë të qiellit dhe të rrezeve vdekjeprurëse kozmike.

Disa, interpretimin e mësipërm e kanë treguar sikur qielli është sferik, që ka rrethuar Tokën, sepse vendbanimi tregon largësinë e barabartë të elementeve të kësaj çatie, e cila, në lidhje me qendrën kryesore, pra, Tokën, nuk është e mundur pa galaktikat.

Është edhe një mundësi interpretimi për ajetin: Ajeti tregon lagësinë qiellore, largësinë shumë të madhe të planeteve dhe vënies në skenë të tyre. Gjithashtu, tregon edhe çatinë, e cila ruan tokën.

[1] Tefsiri "Fakhru Razij", vëll. 31, f. 46.

Megjithatë, ky ajet është i ngjashëm me ajetin 57 të sures "El Gafir" **"Krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e di."**.

Më tej flet për sistemin më të rëndësishëm të kësaj bote, sistemin e dritës dhe të errësirës: **"Netët i bëri të errëta, kurse ditët të ndritshme."**.

Të dyja këto në jetën e njeriut dhe të krijesave të tjera, si të kafshëve, si të bimëve, kanë një rol shumë të rëndësishëm.

Njeriu nuk mund të jetojë pa dritë, sepse të gjitha bereqetet dhe mirësitë janë të lidhura me ditët, ndjesitë dhe lëvizjet e tij. Po ashtu, njeriu nuk mund të jetojë pa errësirën, sepse ajo është sekreti i qetësisë së njeriut.

Fjala *"egtashe"* vjen nga rrënja *"el gatshu"* që ka kuptimin *"errësirë"*. Ragibi, në librin "Mufredat", thotë se origjina e fjalës *"eghtesh"* ka kuptimin e një personi, sytë e të cilit nuk janë shumë të shkëlqyeshëm.

Fjala *"dhuha"* ka kuptimin kur drita e diellit shtrihet në qielli dhe tokë.

Pas qiellit vjen te Toka: **"Pastaj e shtriu rrafsh Tokën."**.

Fjala *"deha"* vjen nga rrënja *"ed dehvu"*, që ka kuptimin *"zgjerim"*. Disa komentues thonë se kjo fjalë ka kuptimin e shkundjes së një gjëje nga vendi origjinal. Këto dy kuptime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe kthehen te një rrënjë.

Kuptimi i grupit emëror *"dehvul erdhi"* është: Në fillim, e gjithë toka ishte e mbushur me ujë, nga shirat dhe nga përmbytjet. Këto ujëra në mënyrë graduale kanë zënë vend në gropat dhe vendet e thata të tokës. Kështu, ditë pas dite, ujërat janë përhapur dhe janë shtuar sa kanë arritur në gjendjen aktuale. (Kjo gjendje është krijuar pas krijimit të tokës dhe të qiejve).

Pas zgjerimit të tokës dhe përgatitjes së saj për jetën, flitet për ujin dhe bimët: **"...dhe, nga ajo nxori ujërat dhe bëri kullotat."**.

Ky interpretim tregon se uji, në mesin e shtresës së depërtueshmërisë së Tokës, ka qenë i fshehur, më pas ai ujë ka rrjedhur në burime dhe në përrenj, më pas janë formuar dete dhe liqene.

Fjala *"el mer'a"* është emër vendi, që ka kuptimin *"kullotë"*. Rrënja e kësaj fjale është *"er re'ji"*, me kuptimin e ruajtjes dhe kujdesit për kafshët, si nga ana e të ushqyerit apo nga ana e shkaqeve të tjera. Kështu fjala *"mera'at"* ka kuptimin e kujdesit, si dhe të rregullimit të çështjeve. Po ashtu, hadithi i njohur, tregon vlerën e madhe të kujdesit të njerëzve për njëri-tjetri.[1]

Për shkaqe të ndryshme mund të prishet "qetësia" e tokës, si për shembull, tufanet e mëdha dhe të përhershme, të cilat qëndrojnë në lëkurën e tokës dhe për shkak të ndikimit të Hënës dhe të Diellit, këto dukuri shfaqen; tërmetet, të cilët shkaktohen për shkak të presonit të materialeve shkrirëse që ndodhen në tokë.

[1] Në librin "Mufredat" të Ragibit rrënja *"re'aa"* – po ashtu edhe në "Biharul Eniar", vëll. 72, f. 38.

Të gjitha këto janë qetësuar nëpërmjet rrjetit të fuqishëm të maleve, të cilët qëndrojnë si udhëheqës mbi tokë. Ndaj dhe thotë: **"Malet i bëri të patundshme."**.[1]

Për rolin e madh që luajnë malet në jetën e njerëzve, si dhe për qetësimin e tokës, kemi pasur një diskutim shumë të zgjeruar në suren "Er Rra'd", në fund të ajetit 3.

Ajeti 23 thotë: **"T'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja."**.

Po, qiellin e përsosi, sistemin e dritës dhe të territ e ndërtoi, tokën e zgjeroi, nga ajo nxori ujin dhe bimët, malet i bëri kujdestar të ruajtjes së tokës, të gjitha mjetet e jetesës së njeriut i plotësoi, që njeriu nga dhuratat e jetës të jetë përfitues dhe të mos i shpërfillë të gjitha këto begati, por të jetë falënderues, të zbatojë urdhrat Hyjnorë që janë krijuar për të.

Këto, nga një anë, janë tregues i fuqisë së All'llahut, përsa i përket çështjes së Ringjalljes, dhe, nga ana tjetër, janë argumente të mëdha dhe shenja të ekzistencës së All'llahut në rrugën e njëshmërisë dhe të dijes.

[1] Fjala *"ersaha"* vjen nga rrënja *"resua"*, që ka kuptimin *"qëndrushmëri"*. Fjala *"ersa"* ka kuptime të ndryshme: një ndër to është: Malet i ndërtoi të qëndrueshme.

Ajetet 34 – 41

﴿فَإِذَا جَاءَتِ الطَّامَّةُ الْكُبْرَى٣٤ يَوْمَ يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ مَا سَعَى٣٥ وَبُرِّزَتِ الْجَحِيمُ لِمَنْ يَرَى٣٦ فَأَمَّا مَنْ طَغَى٣٧ وَآثَرَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا٣٨ فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَى٣٩ وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَى٤٠ فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَى٤١﴾

"Kur të arrijë gjëma më e madhe."

"Atë Ditë njeriu do të kujtojë gjithçka që ka bërë."

"Dhe Zjarri flakërues do t'i tregohet çdokujt që sheh."

"Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka."

"Dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote."

"Sigurisht që do të ketë për strehë Xhehennemin."

"Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat."

"Pa dyshim që do të ketë për strehë Xhennetin."

Komentimi

Pastrimi nga egoizmi

Në ajetet e mësipërme u përmendën disa nga argumentet e Ringjalljes. Në këto ajete do të cekim edhe një herë tjetër çështjen e Ringjalljes dhe fatin e atyre që i frikësohen All'llahut, të cilët do të kthehen në atë ditë. Në kohën që do të ndodhë Ngjarja e Madhe, punëmirët dhe punëkëqijtë, secili prej tyre, do të arrijnë shpërblimin e veprave të bëra.

Fjala *"et tammetu"* vjen nga rrënja *"et temmu"*, që ka kuptimin *"mbushje plot"*. Çdo gjëje që arrin kufirin më të lartë, i thonë *"tameten"*. Po ashtu i thonë edhe ngjarjeve të vështira dhe pasioneve të mëdha. Ndërsa kështillimi për gjëmën më të madhe *"el kubra"* – *"e madhe"* e vë theksin më tepër te rëndësia dhe madhështa e kësaj ngjarjeje të pashembullt.

Më pas shton se në kohën që kjo Ngjarje e Madhe do të ndodhë, të gjithë do të zgjohen nga gjumi i neglizhencës dhe njeriu do të kujtohet për përpjekjet dhe veprat e tij, qofshin ato të mira apo të këqija: **"atë Ditë njeriu do të kujtojë gjithçka që ka bërë."**. Çfarë vlere dhe përfitimi do të kishte për të kjo rikujtesë!?

Nëse kërkesa e rikthimit në këtë botë dhe shlyerja e së kaluarës nuk pranohet, All'llahu, në përgjigje të kësaj kërkese i thotë *"kela"*.

Edhe nëse pendohet dhe kërkon falje për veprat e tij, nuk ka asnjë vlerë, sepse dyert e pendimit tashmë janë mbyllur. Për këtë

arsye, nuk ka asnjë rrugë tjetër. Ata ndiejnë keqardhje dhe mjerisht psherëtijnë. Sipas Kur'anit: **"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: 'Ah, sikur ta kisha marrë Rrugën** (e Drejtë) **me të Dërguarin!"**.[1]

Duhet pasur kujdes se fjala *"jetedhekkeru"* është folje e kohës së tashme dhe zakonisht nënkupton *"vazhdimësinë"*, që do të thotë se, në atë ditë, njeriu vazhdimisht do të kujtohet për të gjitha veprat e tij, sepse në atë ditë, perdet do të largohen nga zemra dhe shpirti i njeriut dhe të gjithë të vërtetat e fshehura do të shfaqen.

Ndaj dhe në ajetin tjetër shton: **"Zjarri flakërues do t'i tregohet çdokujt që sheh."**.

Xhehennemi është i pranishëm edhe tani. Sipas ajetit 54 të sures "El Ankebut": **"...në të vërtetë, Xhehennemi do t'i përfshijë të gjithë mohuesit."**.

Perdet e botës janë pengesë e të parit të tyre dhe në ditën kur të jetë dita e shfaqjes dhe e freskimit të çdo gjëje, Xhehennemi do të shfaqet qartë.

Fjala *"limen jera"* tregon se Xhehennemi, në atë Ditë, është aq i qartë, saqë mund ta shikojë çdokush që shikon, pa asnjë përjashtim dhe për askënd nuk është i fshehur, as për punëmirët e as për punëkëqijtë.

Është dhënë edhe kjo mundësi interpretimi i ajetit: Fjalia tregon personat që në atë ditë do të shikojnë, pasi disa, në atë ditë

[1] Sure "El Furkan", ajeti 27.

do të jenë të verbuar. Këtë e miraton ajeti 124 i sures "Ta Ha": **"... në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër."**.

Kuptimi i parë, që zakonisht komentuesit e kanë pranuar, është më i përshtatshëm, sepse pamja e Xhehennemit për punëkëqijtë është vetë dënimi dhe verbëria për grupin tjetër në Ditën e Ringjalljes mund të jetë në disa raste dhe jo në të gjitha rastet.[1]

Në tre ajetet vijues flitet për gjendjen e kriminelëve dhe të jobesimtarëve në skenën e Kiametit. Me fjalë të shkurtra, por kuptimplota, flitet për të ardhmen, për fatin e tyre dhe për pasojat që do të kenë veprimet e bëra në jetën tokësore: **"Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka." "Ka parapëlqyer jetën e kësaj bote." "Sigurisht që do të ketë për strehë Xhehennemin."**.

Në fjalinë e parë flitet për doktrriën shkatërruese të të padrejtëve, sepse padrejtësia lind nga mendjemadhësia dhe mendjemadhësia vjen si pasojë e mosnjohjes së All'llahut.

Një person që e njeh All'llahun me të gjithë madhështinë e Tij, veten e tij e konsideron shumë të vogël dhe të dobët dhe kurrë nuk e largon këmbën e tij nga rruga e adhurimit.

Fjalia e dytë flet për korrupsionin, që ishte praktikë e tyre, sepse rebelimi bëhet shkak që njeriu të konsiderojë si gjërat më të vlefshme se gjithçka tjetër, kënaqësitë e kësaj bote, të cilat kalojnë shumë shpejt në këtë botë. Ai është i gatshëm të rrezikojë për të

[1] Shpjegim më i shumtë për këtë fushë është dhënë në vëllimin 13, faqe 330, në vazhdim të ajetit 124 të sures "Ta Ha".

kaluar një kënaqësi, e cila përfundon shumë shpejt dhe atë e konsideron si parësore nga çdo gjë tjetër.

Të dyja këto, në të vërtetë, janë shkak dhe pasojë e njëra-tjetrës. Rebelimi dhe korrupsioni në besim është burim për korrupsionin praktik, duke i kushtuar më shumë rëndësi jetës së kësaj bote. Si përfundim, të dyja këto janë zjarri i Xhehennemit.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në një prej hadithe, thotë: "*Ai që bën padrejtësi, bëhet i paudhë dhe vë dorë në veprime për të cilat nuk ka asnjë argument dhe arsyetim.*".[1]

Kjo vjen si pasojë e vetë mendjemadhësisë, që e çon njeriun në dëshira të cilat nuk kanë asnjë lloj arsyetimi logjik. Kjo gjë, për të tillë njerëz, konsiderohet si vlerë.

Më poshtë, në dy fjali të shkurtra, por që janë me shumë kuptim, flitet për cilësitë e banorëve të Xhennetit: **"Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhennetin."**.

Po, kushti i parë që të jesh banor i Xhennetit është frika, e cila vjen si rezultat i njohurive, pra, i njohjes së pozitës së Krijuesit dhe të pasurit frikë nga kundërshtimi i urdhrit të Tij.

Ndërsa kushti i dytë, është rezultati i kushtit të parë dhe fryti i pemës së njohurisë. T'i shmangesh ndikimit të egos dhe të frenosh kokëfortësinë dhe mendjemadhësinë është rezultat mjaft i mirë, sepse të gjitha mëkatet dhe fatkeqësitë e korrupsionet vijnë dhe kanë si burim egon. Egoja është idhulli më i keq, fatkeqësisht

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 506, Hadithi 43.

është bërë idhulli i vërtetë: *"Zoti më i urrer që adhurohet në sipërfaqen e tokës është egoja. "*[1]

Po ashtu, edhe mjeti i ndikimit të shejtanit te njeriu është vetë egoja e tij. Nëse ky shejtan i brendshëm, nuk do të korrespondonte më shejtanin e jashtëm dhe t'ia mbyllë dyert atij, hyrja e shejtanit te njeriu nuk është e mundur. Këtë e thotë Kur'ani i Shenjtë: **"Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robtë e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty."**.[2]

Hulumtime

1- Ç'është pozita e All'llahut?

Duhet patur vëmendje se në ajetin për të cilin po diskutonim, All'llahu thotë: **"Ai që ka frikë nga pozita e All'llahut..."**[3] e nuk thotë "Ai që i frikësohet All'llahut...". Në këtë rast, cili është qëllimi i përdorimit të fjalës *"pozitë"*?

Në këtë rast janë përmendur komentime të ndryshme:

1- Së pari, është thënë se qëllimi i përdorimit të fjalës "pozitë", është për të treguar "pozitën e gjykimit", kur njeriu do të qëndrojë përballë Krijuesit për të dhënë llogari (ndaj dhe

[1] "Sherhul Esmaul Husna Mul'la Hadij Sebzevarij", vëll. 1, f. 27 dhe vëll. 2, f. 61.
[2] Sure "Hixhr", ajeti 42.
[3] Sure "Naziat", ajeti40.

komentimi *"mekam rab'bihi"* ka kuptimin *"mekamehu inde rab'bihi"*, që do të thotë qëndrimi i njeriut pranë All'llahut).

2- Shprehja: "Dijen e All'llahut dhe pozita e kujdesit të tij" përfshin të gjithë njerëzit.

Ajeti 33 i sures "Er Rra'd" e thekson këtë fakt: **"Vallë, Ai që është mbikëqyrës për çdokënd se çfarë punon..."**.

Një tjetër dëshmi për këtë komentim është hadithi që është transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ai që e di se e shikon All'llahu dhe atë që e thotë, e dëgjon All'llahu, si dhe atë që vepron, qoftë e mirë apo e keqe, All'llahu është në dijeni, ai është një njëri që e ka njohur pozitën e All'llahut dhe veten e tij e ka ndaluar nga egoja. Kjo dijeni dhe ky kujdes i tij e mban larg nga veprimet e këqija."*.[1]

3- Qëllimi i përdorimit të grupit emëror *"pozita e drejtësisë"* është për All'llahun, sepse Qenia e Tij e Pastër nuk është burim frike. Frika vjen për shkak të drejtësisë së Tij.

Në të vërtetë, kjo frikë është nga krahasimi i veprave të vetë njeriut me drejtësinë e All'llahut, sikurse kriminelët, kur shikojnë një gjykatës të drejtë, dridhen dhe, kur dëgjojnë emrin e gjykuesit dhe gjykatës, tmerrohen. Ndërkohë që një person që nuk ka bërë mëkat, nuk ka frikë nga ai dhe as nga ky tmerr.

Midis këtyre tefsireve që përmendëm, nuk ka asnjë konflikt dhe mund të jetë e mundur që të gjithë ata, në kuptimin e ajetit, të kenë të njëjtin mendim.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 197; Tefsiri "El Kafij", vëll. 2 , f. 70.

2- Marrëdhënia e tiranisë me adhurimin e kësaj bote

Ajetet e mësipërme, në mënyrë shumë të bukur dhe të denjë, flasin për parimet e lumturisë dhe mizoritë e njeriut. Mizoritë e njeriut numërohen: rebelim, tirani dhe adhurim i kësaj bote. Ndërsa lumturinë e njeriut e paraqet te "frika nga All'llahu", braktisja e egos, mësimi i të gjithave udhëzimeve të Profetëve.

Në një hadith, të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Dy gjëra janë më të tmerrshme për ata në atë Ditë: ndjekja e egos dhe dëshirat e gjata. Ndjekja e egos ju bën të jeni larg të vërtetës, ndërsa dëshirat e gjata, ju bëjnë të harroni Ahiretin."*.[1]

Adhurimi i vetes, pra, egos, bën që te arsyeja e njeriut të vihet një perde dhe kjo perde bën që mendimet e tij të zbukurohen dhe nuk kanë më ndjesinë e perceptimit, e cila është ndër mirësitë më të mëdha që All'llahu na ka dhuruar. Pra, dominimi i njeriut nga kafshët shikohet te perceptimi dhe atë e bën që të jetë i angazhuar. Profeti Jakub *(Paqja qoftë mbi të!)* u tha bijve që janë punëkëqij: **"...por ju keni sajuar diçka** (tjetër nga sa thoni)**..."**.[2]

Në këtë rast mund të flitet shumë, por dhe më i miri prej tyre mund të shikohet te këto dy hadithe nga hadithet e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"Në mesin e mërzisë, durimi dhe qëndresa është e mbuluar. Çdokush që në këtë botë është i duruar përball mërzisë, shqetësimit dhe braktisjes së epsheve, do të futet në Xhennet. Xhehennemi është në mesin e kënaqësive të pandershme*

[1] "Nahxhul Belagha", Khutbe, 42.
[2] Sure "Jusuf", ajeti 18.

dhe jo të ligjshme, si dhe kur epshet që janë të ngatërruara. Çdokush që e vendos egon e tij përballë këtyre kënaqësive, do të jetë në zjarr.".[1]

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: "*Mos e braktis egon tënde me epshet dhe dëshirat, sepse epshet dhe dëshirat bëhen shkak i vdekjes së shpirtit. Nëse e lëmë të lirë egon përballë epsheve, është dhimbje për të e, nëse e mbajmë të lidhur atë nga egot dhe dëshirat, do të jetë shërimi i tij.*".[2]

Jo vetëm Xhehennemi i Botës së Përtejme është vendbanim i adhuruesve të egos, por Xhehennem djegës i kësaj bote është pasiguria, çrregullimet, luftërat, gjakderdhja, mosmarrëveshjet dhe xhelozitë. Të gjitha këto burojnë nga egoja.

Në ajetet e lartpërmendura është folur vetëm për dy grupe, rebelët adhurues të kësaj bote dhe ata që kanë frikë All'llahun e që janë të devotshëm. Vendi i përhershëm i grupit të parë është zjarri, Xhehennemi, ndërsa vendbanimi i përhershëm i grupit të dytë është Xhenneti.

Në të vërtetë, në këtë rast ekziston edhe grupi i tretë. Ata janë besimtarët, që veprat e tyre janë përzier edhe me punë të këqija. Nëse do të përfshihen te falja e All'llahut dhe atë ta meritojnë, do të bashkohen me grupin e Xhennetit. E nëse nuk i përfshin falja Hyjnore, do të shkojnë në Xhehennem, por vendbanimi i tyre i përjetshëm nuk do të jetë Xhehennemi. Në ajetet e mësipërme nuk u fol për ta.

---

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 507, Hadithi 46; Tefsiri "El Kafij", vëll. 2, f. 89.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 507, Hadithi 45; Tefsiri "El Kafij", vëll. 2, f. 336.

Ajetet 42 – 46

﴿يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَاهَا، فِيمَ أَنْتَ مِنْ ذِكْرَاهَا، إِلَى رَبِّكَ مُنْتَهَاهَا، إِنَّمَا أَنْتَ مُنْذِرُ مَنْ يَخْشَاهَا، كَأَنَّهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَهَا لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا عَشِيَّةً أَوْ ضُحَاهَا﴾

"Të pyesin ty për Orën (e Kiametit) **se kur do të ndodhë."**

"Çfarë rëndësie ka për ty që ta përmendësh atë?"

"Tek Zoti yt është fundi i (dijenisë rreth) **saj."**

"Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i frikësohen asaj."

"Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) **do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **veç një mbrëmje apo një mëngjes."**

Komentimi

Ditën kur do të ndodhë Kiametit, e di vetëm All'llahu i Madhëruar

Në këto ajete do të shikohet pyetja e përhershme e mushrikëve dhe e mohuesve të Ringjalljes: "**Të pyesin ty për Orën** (e Kiametit) **se kur do të ndodhë."**.

Kur'ani i Shenjtë, në përgjigje të kësaj pyetjeje, për t'i bërë ata që të kuptojnë, thotë se asnjë nuk e di çastin e ndodhjes së Kiametit. Më pas, fjalimin e Tij e kthen nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Çfarë rëndësie ka për ty që ta përmendësh atë?"**.

Dita kur do të ndodhë Kiameti është e fshehur edhe për ty që je Profet e jo më për njerëzit e thjeshtë. Kjo ngjarje është prej dijes së fshehtë dhe koordinimeve të brendshme të All'llahut. Askush nuk ka dije për të.

Shumë herë kemi thënë se një ndër gjërat e fshehura, është koha e Kiametit, sepse ndikimet mësimore të tij nuk janë të mundura pa rezervim. Nëse do të ishte e qartë dhe koha të ishte e largët, të gjithë do t'i zinte mospërfillja. Nëse koha do të ishte afër, largimi nga punët e këqija do të ishte në mënyrë të detyruar dhe larg lirisë dhe zgjedhjes. Të dyja këto do të bënin që vlerat e të mësuarit të ishin të mangëta.

Janë dhënë interpretime të tjera, përsa i përket komentimit të këtij ajeti. Ndër to është komentuar se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është dërguar për të shpjeguar kohën dhe çastin e ardhjes së Kiametit, por është dërguar që të lajmërojë se kjo ngjarje do të ndodhë, por jo momentin se kur do të ndodhë.

Po ashtu, një tjetër shpjegim është se ardhja e vetë Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është një prej shenjave të afrimit të Ditës së Kiametit.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* transmetohet: Profeti

Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* afroi dy gishtat e tij pranë njëri-tjetrit dhe tha*: "Ardhja ime dhe e Kiametit është sikurse këto dy gishtërinj."*.[1]

Interpretimi i parë është më i përshtatshëm se të tjerët.

Më pas shton: **"Tek Zoti yt është fundi i** (dijenisë rreth) **saj."**. Vetëm All'llahu e di se kur do të ndodhë Kiameti, askush tjetër nuk ka dijeni për këtë ngjarje, çdo përpjekje për të pasur njohuri për kohën e ardhjes së Kiametit është e pavlerë.

Kjo çështje trajtohet edhe në ajetin 34 të sures "Lukman": **"Pa dyshim, vetëm All'llahu e di Orën e caktuar..."**.

Ndërsa në ajetin 187 të sures "El Araf" thuhet: **"Ata të pyesin ty** (Muhammed) **rreth Orës** (së Kiametit)**. Thuaju: 'Atë e di vetëm Zoti im..."**.

Disa nga komentuesit e Kur'anit të Shenjtë kanë thënë se qëllimi i fjalisë që u citua më lart, është se "realizimi dhe ardhja e Kiametit është në dorën e All'llahut. Kjo fjali është thënë për të shprehur shkakun e ardhjes. Bashkimi midis këtyre dy interpretimeve nuk ka asnjë pengesë.

Përsëri, për të shpjeguar më shumë këtë gjë, shton se detyra jote është vetëm që t'i frikësosh personat që i frikësohen kësaj Dite: **"Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i frikësohen asaj."**.

[1] Tefsiri "Fakhru Razij", vëll. 29, f. 29. Ky informacon është edhe në tefsrin "Mexhmaul Bejan", "Kurtubi", si dhe "Fi Dhilalil Kur'ani" e në tefsire të tjera, në vazhdim të ajetit 18 të sures "Muhammed".

Detyra jote është vetëm që t'i zgjosh ata, t'i bësh të reagojnë e t'i trembësh. Ndërsa përsa i përket kohës, është jashtë detyrave, kompetencave dhe njohurive të tua.

Duhet të tërheqim vëmendjen se paralajmërimi është për personat që kanë frikë nga ajo Ditë. Kjo është e ngjashme me atë çështje që ka ardhur në ajetin 2 të sures "El Bekare": **"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."**.

Të tilla interpretime tregojnë këtë të vërtetë: Shpirti që nuk kërkon Rrugën e Drejtë dhe nuk ndien përgjegjësi përballë All'llahut, nuk shkon të kërkojë e të bëjë kërkime për librat qiellorë dhe nuk pyet as për Ringjalljen dhe as për paralajmërimet e Profetëve *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Si përfundim, në ajetin e fundit të kësaj sureje, për të shprehur këtë të vërtetë, që nuk është kohë e gjatë gjer në Ditën e Kiametit thotë: **"Ditën kur do ta shohin atë,** (njerëzve) **do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **veç një mbrëmje apo një mëngjes."**.

Jeta në këtë botë kalon shpejt, po ashtu edhe periudha e botës së ndërmjetme[1] kalon shumë shpejt dhe në kohën e ardhjes së Kiametit ata mendojnë se ajo periudhë nuk ka qenë më tepër se disa orë.

Në thelb, ky urdhër është i drejtë, sepse jeta në këtë botë është shumë e shkurtër dhe kalimtare, në krahasim me Kiametin. E gjithë jeta e kësaj bote nuk është më tepër se një çast, nëse e krahasojmë me Kiametin.

[1] "Barzakh" bota e pamjesishme (*viz*. ka formë, por jo lëndë).

Fjala *"ashijeten"* ka kuptimin e *"el asr"*, pasdites dhe *"dhuha"* ka kuptimin kur dielli ka arritur lart dhe rrezet e tij janë përhapur (zenitit).

Në disa nga ajetet e Kur'anit thuhet se në Kiamet, kriminelët, gjatë kohës që do të flasin për qëndrimin e tyre në Botën e Ndërmjetme, do t'i thonë njëri-tjetrit: **"Duke i pështëritur njëri-tjetrit: 'Ju keni qëndruar** (në dynja) **vetëm dhjetë ditë.'"**.[1]

Por ata që mendojnë më mirë, thonë: **"Ne e dimë më mirë se ç'do të thonë ata** (në Ditën e Kiametit)**, kur më i mençuri prej tyre do të thotë: 'Ju keni qëndruar vetëm një ditë.'"**.[2]

Po ashtu, edhe në ajete të tjera, që flasin për kriminelët, lexojmë se në kohën që do të bëhet Kiameti, kriminelët do të thonë e do të betohen se nuk kanë qëndruar më tepër se një orë në (dynja): **"Ditën, kur të vijë Ora** (e Kiametit)**, keqbërësit do të betohen se kanë qëndruar** (në tokë) **veçse për një kohë të shkurtër. Kështu ata shmangen nga e Vërteta."**. [3]

Këto interpretime ndryshojnë për afatin e shkurtër të kohës Kiametit. Ata duan që afatin e shkurtër të kësaj kohe ta shpjegojnë dhe të reflektojnë me një shpjegim të përafërt. Secili, ndjenjat e tij i shpreh me një interpretim. Por të gjithë janë në një mendje, përsa i përket kohës së shkurtër të jetës në këtë botë, në krahasim me jetën e Kiametit. Kjo kohë e shkurtër bën që njeriu të tronditet dhe të zgjohet nga gjumi i mospërfilljes.

[1] Sure "Ta Ha", ajeti 103.
[2] Sure "Ta Ha", ajeti 104.
[3] Sure "Er Rrum", ajeti 55.

Sure "Abese"

Zbritur në Mekë

Ajete 42

Përmbajtja e sures "Abese"

Surja "Abese", edhe pse është e shkurtër, flet për çështje të ndryshme dhe të rëndësishme. Rëndësi të veçantë i kushton çështjes së *"Meadit" - "Ringjalljes"*. Përmbajtja e saj është përmbledhur në pesë tema:

1- All'llahu qorton rëndë personin që nuk pati sjellje të mirë ndaj burrit të verbër, i cili ishte në kërkim të vërtetës.

2- Vlera dhe rëndësia e Kur'anit të Shenjtë.

3- Kufri dhe mos falënderimi i njeriut përballë begative dhe mirësive të All'llahut.

4- Sqarimi i një pjese të mirësive të All'llahut në fushën e ushqimit të njeriut dhe i kafshëve, për të nxitur ndjenjën e falënderimit te njeriu.

5- Përmendja e një pjese shumë tronditëse të ngjarjeve të Kiametit, si dhe e fatit të besimtarëve dhe jobesimtarëve në atë Ditë të Madhe.

Emërtimi i sures është për shkak të ajetit të parë të saj.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Ai që lexon suren "Abese", në Ditën e Kiametit do të vijë me fytyrë të qeshur dhe të gëzuar."*.[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 435.

Ajetet 1 – 10

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿عَبَسَ وَتَوَلَّىٰ أَنْ جَاءَهُ الْأَعْمَىٰ وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَّكَّىٰ أَوْ يَذَّكَّرُ فَتَنْفَعَهُ الذِّكْرَىٰ أَمَّا مَنِ اسْتَغْنَىٰ فَأَنْتَ لَهُ تَصَدَّىٰ وَمَا عَلَيْكَ أَلَّا يَزَّكَّىٰ وَأَمَّا مَنْ جَاءَكَ يَسْعَىٰ وَهُوَ يَخْشَىٰ فَأَنْتَ عَنْهُ تَلَهَّىٰ﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin."

"Kur i erdhi pranë i verbri."

"E ku e di ti, ndoshta ai dëshironte të pastrohej (nga gjynahet)**."**

"Ose të merrte këshillë, e këshilla t'i sillte dobi atij?!"

"Sa për atë që është i pasur."

"Ti atij po i kushton vëmendje."

"Megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet."

"Sa për atë që të vjen duke nxituar."

"Dhe ndien frikë (nga All'llahu)**."**

"Ti atij nuk po ia vë veshin."

Shkaku i zbritjes

Këto ajete tregojnë qortimin e përgjithshëm të All'llahut për një njeri të pasur, në krahasim me një njeri të verbër, i cili ishte në kërkim të së drejtës.

Kush është personi që qortohet? Për këtë janë dhënë mendime të ndryshme. Por midis komentuesve të njohur të Kur'anit të Shenjtë, tregohet se ky ajet ka zbritur për Abdullah ibn Mektum, i cili shkoi te Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i cili i bënte thirrje Utbetu ibn Rebiatu, Ebu Xhehlit ibn Hisham, Abas ibn Abdul Mutalib, Ubejj dhe Ummejetu ibn Khalef që të përqafonin Islamin dhe të hiqnin dorë nga luftimi i muslimanëve.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shpresonte se, nëse fjalët e tij do të kishin pak ndikim te këta kryetarë, gjendja do të ishte ndryshe dhe sabotimet e tyre ndaj Islamit do të pakësoheshin. Kjo gjë ishte në të mirë të fesë islame. Gjatë kësaj bisede që po bënte Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, vjen një person i verbër, me emrin Abdullah bin umi

Mektum. Ai u fut brenda dhe i ndërpreu bisedën Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke iu lutur që t'i lexonte disa ajete kur'anore, si dhe t'i mësojë diçka prej Kur'anit dhe fesë islame. Ai e përsëriste vazhdimisht fjalën e tij dhe nuk po qetësohej. Ndoshta ai nuk e dinte me saktësi se me kë po bisedonte e çfarë po bënte Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai e ndërpreu aq shumë herë bisedën e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, saqë i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u mërzit. Kjo mërzitje u shfaq në fytyrën e tij të bekuar dhe me vete tha se këta kryetarë arabë do të mendojnë se ndjekësit e Muhammedit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë të verbrit dhe të varfrit. Për këtë arsye, ai i ktheu shpinën Abdullahut dhe nisi bisedën e tij me grupin që kishte aty. Në këtë gjendje zbresin ajetet e mësipërme, që kritikojnë veprimin e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas kësaj ngjarjeje, e respektonte vazhdimisht Abdullahun e, kur e takonte atë thoshte: *"Tungjatjeta o (Abdullah), që për hirin tënd All'llahu më tërhoqi vërejtje!"*. Pasi e përshëndeste, Profeti i nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thoshte: *"A ke ndonjë hall që të ta zgjidh?"*.

Profeti i nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e vendosi zëvendësin e tij dy herë në Medine.[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 437.

Mendimi i dytë, përsa i përket shkakut të zbritjes së ajeteve të mësipërme, është: Këto ajete kanë zbritur për një burrë nga Beni Umeje, i cili ishte ulur pranë Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në atë moment, Abdullah bin umi Maktum erdhi brenda. Kur ai pa Abdullahun, u mblodh dhe dukej sikur kishte frikë se mos bëhej pis. Ai u vrenjt dhe i ktheu shpinën. All'llahu, në ajetet e mësipërme, transmetoi veprimin e tij, duke e kritikuar atë.

Ky mendim i dytë është transmetuar në një nga hadithet e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*.[1]

Kërkuesi i shquar shi'it, i ndjeri Sherijf Murteda, ka pranuar variantin e dytë të shkakut të zbritjes së ajetit dhe thotë se ajeti nuk nënkupton dhe nuk ka për qëllim Profetin *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. E vetmja gjë që mund të jetë një supozim për këtë kuptim është se ajetet 8-10 të kësaj sureje thonë: **"Sa për atë që të vjen duke nxituar dhe ndien frikë** (nga All'llahu)**, ti atij nuk po ia vë veshin."**. Kjo është më e mira nga çdo gjë tjetër që mund të thuhet e mund të jetë e vërtetë për personalitetin e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Por sipas mendimit të të ndjerit Sherijf Murteda, mendohet se nuk bëhet fjalë për personalitetin e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)*, sepse, sipas tij, ashpërsia nuk është cilësi e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)*. Ai, edhe me armiqtë

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 437.

e tij, fliste me fytyrë të gëzuar dhe jo më me besimtarët, të cilët janë në kërkim të së vërtetës.

Po ashtu nuk përputhet me moralin e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahu qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të merrej me të pasurit e të linte mënjanë të varfrit. Në suren "El Kalem", në ajetin 4 është cituar morali i Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Ti je me virtyte madhore."**[1].

Pra, ajo sjellje kurrë nuk i përafrohet moralit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* (Dihet se surja "El Kalem" ka zbritur më parë se surja "Abese").[2]

Nëse do të marrim si supozim që ato ajete janë për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kjo çështje nuk është në kundërshtim dhe në papajtueshmëri me pozitën dhe pastërtinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse:

Së pari, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kishte qëllim të zgjeronte fenë islame nëpërmjet ftesës dhe fjalëve të tij, duke ndikuar te paria e kurejshëve.

Së dyti, të vrenjtësh fytyrën përballë një burri të verbër nuk krijon asnjë problem, sepse ai nuk të shikon. Përveç kësaj, Abdullah bin umi Maktum nuk e ka ruajtur respektin e takimit më Profetin

[1] I njëjti burim
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 437.

Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur dikush dëgjonte se Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte duke folur me një grup njerëzish, nuk duhet t'ia ndërpriste fjalën.

Por All'llahu i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe sjelljes me besimtarët e varfër e kërkues të së vërtetës dhe nuk e lejon që këtij personi besimtar, të mos i kushtohet vëmendje nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Nga ana tjetër, nëse këto ajete i shikojmë nga këndi i vërtetësisë dhe i madhështisë së Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shikojmë se ato janë një mrekulli, sepse udhëheqësi i madh islam, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në Librin Qiellor përmend aq shumë përgjegjësi për veten e tij, saqë edhe pavëmendjen më të voglën, në lidhje me një burrë të verbër dhe kërkues të së vërtetës, e shikon si kritikë të All'llahut. Ky është një argument i gjallë që tregon se Kur'ani është Libri Qiellor i All'llahut dhe i Dërguari, Muhammedi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i drejtë dhe i vërtetë. Është e çuditshme se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sipas transmetimit që cituam më lart, sa herë që shikonte Abdullah bin umi Maktumin, kujtonte këtë ngjarje dhe e respektonte shumë atë.

Nga ana tjetër, këto ajete mund të tregojnë kulturën islame të komunikimit me njerëzit nevojtarë. Po ashtu, ajetet tregojnë se sa shumë respektohet ky njeri i verbër e i varfër në krahasim me njerëzit e pasur dhe të fuqishëm, si dhe jobesimtarë. Kjo tregon më

së miri se feja islame është nismëtare e ndihmës së nevojtarëve dhe armike e arrogantëve.

Në përfundim, këtë fjalim do e përsërisim edhe një herë: Në mesin e komentuesve është i njohur mendimi i parë, por duhet të pranojmë se nuk ka ardhur ndonjë gjë që të jetë argument se ajeti flet për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë arsye preferohet mendimi i dytë.

Komentimi

Qortimi Hyjnor!

Duke u bazuar në mendimin e zbritjes së ajeteve që përmendëm, do të nisim komentimin e ajeteve të lartpërmendura:

Në fillim All'llahu thotë: **"Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin."**

Përse?: **"Kur i erdhi pranë i verbri."**

"E ku e di ti, ndoshta ai dëshironte të pastrohej (nga gjynahet)**"**, pra, do kërkonte besimin, devotshëmrinë dhe pastrimin.

"ose të merrte këshillë, e këshilla t'i sillte dobi atij?!". Nëse ai nuk do të bëhet i devotshëm njëqind për qind, të paktën do të

këshillohet e do të marrë mësim. Në këtë mënyrë, do të zgjohet dhe ky zgjim do të ketë ndikim për të.[1]

Qortimi vazhdon: **"Sa për atë që është i pasur, ti atij po i kushton vëmendje."**, dhe këmbëngul për ta udhëzuar atë, ndërkohë që ai është i përfshirë në mendjemadhësinë e pasurisë dhe të egoizmit, mendjemadhësi e cila është burim i rebelimit dhe i arrogancës. Kjo gjë ka ardhur edhe në ajetet 6-7 të sures "Alak":

"Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm." [2]

"Megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet.".

Detyra jote është vetëm të përcjellësh atë çka All'llahu të ka Shpallur. Ata, nëse duan, le të këshillohen, ose le të mërziten. Ndaj për persona të tillë nuk duhet të lini pas dore një njeri të verbër, i cili është në kërkim të së vërtetës, ose ta lëndoni atë, edhe pse qëllimi juaj është që të udhëzoni këto njerëz të pabindur.

---

[1] Ndryshimi i këtij ajeti me ajetin e mësipërm është: Ajeti i mësipërm flet për pastërti dhe devotshmëri të plotë. Ndërsa këtu flet për ndikimin përmbledhës të këshillimit, edhe pse nuk mund të arrijë në pozitën e plotë të devotshmërisë. Si përfundim, ai burrë i verbër dhe kërkues i së vërtetës përfiton nga këshillimi, si të jetë e plotë, si të jetë në mënyrë përmbledhëse këshilla. Nga disa komentues mund të përfitohet se ndryshimi midis këtyre dy ajeteve është se ajeti i parë tregon pastërtinë, pra, bën fjalë për pastërtinë e mëkateve. Ndërsa ajeti i dytë bën fjalë për bindjen ndaj urdhrit të All'llahut. Komentimi i parë duket më i saktë.

[2] Ragibi, në librin "Mufredat", thotë: "Fjala "*ganije*", "*istegna*", "*tegna*" dhe "*tegana*", ka po të njëjtin kuptim, "*i pasur*". Përsëri sipas tij, fjala "*tesadda*" vjen nga rrënja "*es sada*", e cila ka kuptimim gjë që vjen nga mali, ndërsa fjala "*tesadda*" ka kuptimin e vendosjes përballë një gjëje, si dhe t'i kushtosh vëmendje të plotë diçkaje.

Edhe një herë tjetër theksi vihet te kritika dhe në mënyrë të adresuar thotë: **"Sa për atë që të vjen duke nxituar."**

"Dhe ndien frikë (nga All'llahu)**."**.

Po ashtu, motivimin e frikës nga All'llahu ai e ka dërguar pas teje, që të dëgjojë më tepër përsa i përket pastrimit. Në këtë mënyrë pastron veten e tij.

"Ti atij nuk po ia vë veshin." [1]

Përsa i përket interpretimit me *"ente"* - *"ti"*, nëse zbritja është për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, atëherë ajo tregon këtë: Një njeri si ti nuk duhet të jetë i pavëmendshëm ndaj një njeriu të tillë, i cili është në kërkim të së vërtetës. Pra, mos u merr me të tjerë, edhe pse qëllimi për t'u marrë me të tjerët është udhëzimi yt. Nëse bëjmë llogarinë e përparësive midis këtyre dy grupeve, nevojtarët janë më të sinqertë dhe me zemër të pastër.

Ky qortim, si të jetë, si të mos jetë për personalitetin e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, tregon të vërtetën e rëndësishme, se feja islame dhe Kur'ani i Shenjtë ka një respekt të madh për ata që i bashkëngjiten Rrugës së Drejtë e sidomos njerëzve nga shtresat e varfra e me zemër të pastër.

E nëse përballë tyre pozicionohesh në mënyrë të ashpër, për shkak të mirësisë dhe bollëkut që All'llahu u ka falur e ata janë

[1] Fjala *"teleha"* vjen nga rrënja *"el lehv"* dhe ka kuptimin *"punë argëtuese"*. Në këtë rast ka kuptimin *"i pavetëdijshëm"* e të merresh me dikë tjetër. Në të vërtetë, është pika homologe e fjalës *"tesadda"*.

dehur e janë bërë mendjemëdhenj si pasojë e mirësive, atëherë, nëse All'llahu nuk është i kënaqur që të merresh me ta, mos u merr, sepse do të jesh më pak i prekur te njerëzit e privuar dhe kërkues të së vërtetës.

Argumenti është i qartë, sepse gjithmonë ky grup ka qenë mbështetës i sinqertë i fesë islame, si dhe kanë ndihmuar udhëheqësit e mëdhenj të fesë në problemet e tyre. Ata kanë sakrifikuar në fushat e luftërave, duke dhënë jetën për fenë. Le të përmendim urdhrin e njohur që Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë më të!)* i jep Malik Eshterit: "*Shtylla e fesë është kapitali social i myslimanëve dhe forcat e ruajtura përballë armiqve, ndaj duhet t'i dëgjosh fjalët e tyre dhe dëshirën tënde përqendroje te ata.*".[1]

Ajetet 11 – 23

[1] "Nahxhul Belaga", Letra 53.

﴿كَلَّا إِنَّهَا تَذْكِرَةٌ ١١ فَمَنْ شَاءَ ذَكَرَهُ ١٢ فِي صُحُفٍ مُكَرَّمَةٍ ١٣ مَرْفُوعَةٍ
مُطَهَّرَةٍ ١٤ بِأَيْدِي سَفَرَةٍ ١٥ كِرَامٍ بَرَرَةٍ ١٦ قُتِلَ الْإِنْسَانُ مَا أَكْفَرَهُ ١٧ مِنْ
أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ ١٨ مِنْ نُطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَّرَهُ ١٩ ثُمَّ السَّبِيلَ يَسَّرَهُ ٢٠ ثُمَّ أَمَاتَهُ
فَأَقْبَرَهُ ٢١ ثُمَّ إِذَا شَاءَ أَنْشَرَهُ ٢٢ كَلَّا لَمَّا يَقْضِ مَا أَمَرَهُ ٢٣﴾

"Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kur'an) **është këshillë."**

"Pra, kush të dojë, le të marrë këshillë!"

"Ai ndodhet në Faqe të nderuara."

"Të lartësuara, të pastra."

"Në duart e shkruesve (engjëj)**."**

"Të ndershëm dhe të drejtë."

"Mallkuar qoftë njeriu! Sa mosmirënjohës që është ai!"

"Prej çfarë gjëje e krijon All'llahu atë?"

"Prej pikës së farës e krijon dhe i jep përmasa të rregullta."

"Më pas ia lehtëson rrugën (e lindjes)**."**

"E pastaj e vdes dhe i cakton një varr."

"Dhe, kur të dojë, Ai e ringjall."

“E megjithatë, njeriu ende nuk i ka plotësuar ato që i ka urdhëruar Ai!”

Komentimi

Në ajetet e mësipërme u fol për qortimin e një personi, i cili i kushtoi pak vëmendje një burri të verbër dhe kërkues i së vërtetës. Në këto ajete do të flitet për rëndësinë e Kur’anit të Shenjtë, për origjinën e pastër të tij, si dhe për ndikimin që ka te shpirtrat e njerëzve: “Kurrë mos e përsërit këtë punë. Atë harroje përgjithmonë, sepse këto ajete janë këshillë dhe rikujtim për All’llahun”.

Nuk është e nevojshme të jemi të pavëmendshëm me nevojtarët, të cilët kanë zemër të pastër dhe t’u kushtojmë vëmendje mendjemëdhenjve.

Është edhe një mundësi tjetër që fjalia: **“Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky** (Kur’an) **është këshillë.”**, të jetë përgjigje për të gjitha thashethemet e mushrikëve dhe armiqve të fesë islame për Kur’anin.

Ata, ndonjëherë, Kur’anin e lexonin si poezi, si magji etj... Ndërsa Kur’ani thotë se asnjë prej këtyre treguesve nuk është i vërtetë. Këto ajete janë mjet për t’u zgjuar, për të rikujtuar vlerën dhe bukurinë e besimit. Në të është fshehur njohuria, besimi dhe

argumentimi, sepse çdokush që i afrohet afër atij, përveç armiqve dhe kokëfortëve, nuk i ndienin te vetja këto ndikime.

Më pas shton: **"Pra, kush të dojë, le të marrë këshillë."**.[1]

Ky interpretim tregon se nuk ka ngurrim dhe detyrim, si dhe është një tregues për lirinë e vullnetit të njeriut. Nëse njeriu nuk dëshiron dhe nuk merr vendim për të pranuar udhëzimin, nuk mund të përfitojë nga ajetet kur'anore.

Më tej shton: **"Ai ndodhet në Faqe të nderuara."**.

Fjala *"es suhufu"* është shumësi i fjalës *"sahijfetun"*, që ka kuptimin *"leuh"* - *"fletë"*, ose një gjë tjetër ku shkruhet ndonjë çështje. Ky interpretim tregon: Ajetet e Kur'anit, para se të zbresin për Profetin e nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë shkruar në *"leuh"* - *"fletë"* dhe engjëjt e zbulesës e sjellin atë me vete dhe ato janë fletë plot me vlerë.

Disa thonë se përdorimi i fjalës *"suhuf"* tregon për librin e tëdërguarëve të mëparshëm por me sa duket nuk kanë pajtueshmëri me ajetet që erdhën para dhe pas.

Më tej shton se është pllakë e pastër dhe me vlerë shumë të lartë. Është më lart nga ç'mendohet prej dashakeqësve apo ata të cilët janë të aftë për të ndryshuar. Është më e pastër nga ç'mendojnë ata që duan ta ndyejnë, është shumë e pastër nga çfarëdolloj mangësie, kundërshtimi dhe dyshimi.

[1] Përemri në fjalinë *"dhekere"* kthehet te përemri *"ineha"*. Por atje bëhet fjalë për ajetet dhe ndaj ka ardhur në gjininë femërore, ndërsa këtu flet për vetë Kur'anin, i cili është emër në gjininë mashkullore.

Këto ajete hyjnore janë: **"Në duart e shkruesve** (engjëj)**."**.

Ambasadorë me pozitë, të bindur, e punë mirë: **"...të ndershëm dhe të drejtë."**.

Disa komentues janë të mendimit se fjala *"esfere"*, në këtë rast, është për hafizat, shkruesit dhe lexuesit e Kur'anit të Shenjtë, dijetarët dhe shkencëtarët të cilët këto ajete i ruajnë në çdo kohë dhe periudhë nga duart e dashakeqësve dhe djajtë. Por ky komentim duket shumë i largët, sepse në këto ajete flitet për kohën e zbritjes së zbulesës, në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nuk flitet për të ardhmen. Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ai që është hafiz Kur'ani dhe e zbaton atë, do të jetë në radhët e shkruesve të ndershëm e të drejtë, të cilët zbatojnë urdhrat hyjnore."*.[1]

Ky interpretim tregon më së miri se hafizët (ruajtësit) e Kur'anit, komentuesit dhe zbatuesit e tij janë dhe do të jenë përherë në radhët e kësaj sofre. Kur këta dijetarë dhe hafiza do të bëjnë një punë, që është e ngjashme me engjëjt dhe mbajtësit e zbulesës, do të vendosen në radhët e tyre.

Nga e gjithë kjo bisedë kuptojmë se të gjithë personat që përpiqen për ruajtjen dhe përhapjen e fjalës së Kur'anit të Shenjtë, do të kenë një pozitë të lartë, sikurse është pozita e engjëjve.

Fjala *"kiramun"* është shumësi i fjalës *"kerijmun"*, që ka kuptimin *"i dashur"* dhe *"i respektuar, fisnik"*, *"njeri i madh"* dhe tregon madhështinë e engjëjve të zbulesës dhe pozitën që kanë engjëjt te All'llahu i Madhëruar. Po ashtu, ndonjëherë është thënë

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 438; Tefsiri "Kafij", vëll. 2, f. 603.

se ky interpretim tregon dhe flet për pastërtinë e tyre nga çfarëdolloj mëkati.

Kjo është cituar edhe në ajetet 26-27 të sures "El Enbija", duke përshkruar engjëjt: **"...Jo, ata** (engjëjt) **janë robër të nderuar. Ata nuk flasin para** (Fjalës së) **Tij dhe veprojnë me Urdhrin e Tij."**.

Fjala *"bereretun"* është shumësi i fjalës *"bar"* (si Taleb dhe Talebeh), që vjen nga rrënja e fjalës *"el berr'rri"*, që në origjinë ka kuptimin *"gjerësi"* dhe *"zgjerim"*. Ndaj dhe shkretëtirave të mëdha dhe të gjera u thuhet *"el berr'rr"*. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për njerëzit punëmirë, që kanë zemër të madhe, duke bërë të mundur që bereqetet e tyre të arrijnë edhe te të tjerët. Në fakt, qëllimi për punëmirët, në ajetin për të cilin po diskutojmë, është bindja ndaj urdhrit hyjnor dhe pastërtia nga mëkatet.

Në këtë mënyrë, All'llahu i Madhëruar, engjëjve u ka dhënë tre cilësi:

E para, All'llahu i ka konsideruar engjëjt si ambasadorë dhe mbajtës të zbulesës së Tij.

E dyta, ata i ka konsideruar të dashur dhe të vlefshëm.

E treta, pastërtia e veprave të tyre është bindje, dorëzim dhe mirësi.

Më tej shton: Ekzistojnë gjithë këto mjete të udhëzimit hyjnor, të cilat janë dhënë nëpërmjet engjëjve të All'llahut dhe kanë zbritur së bashku me llojet e ndryshme të këshillave. Por përsëri ky

njeri kokëfortë dhe mosfalënderues nuk dorëzohet përpara së vërtetës. **"Mallkuar qoftë njeriu! Sa mosmirënjohës që është ai!"**.

Në këtë rast, fjala *"el kufru"* mund të ketë kuptimin *"i pafe*, ose *"mosfalënderues"*, ose ka kuptimin e mbulimit të çfarëdolloj të vërtete.

Në ajetet e tjera flitet për llojet e mirësive të All'llahut. Në çdo rast qëllimi i këtij interpretimi: **"Mallkuar qoftë njeriu!"** ka kuptim aluzion që do të thotë shprehje e zemërimit dhe e mbajtjes mëri ndaj personave qafirë dhe mosfalënderues.

Burimi i kokëfortësisë dhe i mosfalënderimit është mendjemadhësia. Për ta thyer këtë mendjemadhësi, në ajetin tjetër thotë: **"Prej çfarë gjëje e krijon All'llahu atë?"**

"Prej pikës së farës e krijon dhe i jep përmasa të rregullta.".

Përse ky njeri nuk mendon për origjinën e krijimit të tij, por e harron atë? Përse ky njeri papritur harron fuqinë e All'llahut? Përse kjo krijesë nuk mendon ndonjëherë për atë lëng të pavlerë? Argumenti më i mirë për të njohur All'llahun është vëmendja ndaj krijimit të njeriut dhe matja e të gjithë pjesëve të qenies së tij, gjymtyrët e trupit, fuqia dhe nevojat që ka njeriu etj.

Fjala *"kaddere"* vjen nga rrënja *"et tekdijr"*, që ka kuptimin *"matje"dhe akordim*; ne e dimë se për krijimin e qenies së njeriut janë dashur më shumë se njëzet lloje mineralesh. Që secila prej tyre, nga ana e sasisë dhe cilësisë, ka një masë të caktuar. Nëse kjo masë do të shtohet, ose do të pakësohet, në qenien e njeriut dhe në sistemin e tij do të ndodhin ndryshime të padëshiruara. Çdo gjë duhet të jetë

e llogaritur, sipas një përllogaritjeje të saktë, që të sigurojë lumturinë e njeriut.

All'llahu i Madhëruar këto matje i ka vendosur në këtë lëng të pavlerë. Ky lëng është në masë shumë të vogël. Te kjo qenie e ulët dhe e vogël janë vizatuar të gjitha në masë. Disa fjalën "*tekdijr*" e kanë shpjeguar me kuptimin "*të bësh gati*". Ekziston edhe një tjetër mundësi për interpretimin e fjalës "*tekdijr":* Në këtë lëng të pavlerë krijohet fuqia e njeriut. Sa i Madhërishëm është All'llahu, që kësaj qenieje të dobët i ka vendosur gjithë këtë fuqi! Saqë është zotëruesi i tokës, qiellit dhe thellësive të deteve. Të gjitha fuqitë e mjedisit të tij t'i vendosë nën urdhrat e tij.[1]

Po ashtu, është i mundur edhe bashkimi i këtyre tre tefsireve.

Në vazhdim të këtij fjalimi, shton: **"Më pas ia lehtëson rrugën** (e lindjes)**."**, rrugën e përsosmërisë, të rritjes dhe të edukimit të fetusit në barkun e nënës, duke ia lehtësuar rrugën e transferimit të tij në këtë botë.

Një nga çuditë e lindjes së njeriut është vendosja e fetusit në mitrën e nënës. Para pak çasteve që të lindë, ai vendoset në këtë mënyrë te barku i nënës: Koka e tij qëndron lart, fytyra nga kurrizi i nënës dhe këmbët e tij qëndrojnë në pjesën e poshtme të mitrës. Por në kohën që jepet urdhri i lindjes së tij, papritur ai ndryshon, koka kthehet poshtë. Kjo gjë bën që lindja të jetë e lehtë, si për nënën, ashtu edhe për fëmijën. Por ka edhe fëmijë që lindin në të kundërtën, pra, me këmbë poshtë, të cilët i sjellin shumë probleme nënës. Pasi fëmija lind, merr dy rrugë: rritjen e trupit nga mosha e

[1] Ragibi në veprën "Mufredat" thotë: "Kadderehu ka kuptimin e dhënies së fuqisë.

vogëlisë deri te rritja dhe zhvillimi i shqisave. Rruga e dytë, zhvillmi dhe rritja gjatë rrugës së udhëzimit shpirtëror dhe besimit. Të gjitha këto, nga ana e intelektit, bëjnë që njeriu ta ketë më të lehtë ta përthithë ftesën e Profetëve *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Sa fjali e përmbledhur dhe interesante është kjo, që edhe gjatë kohës së ngushtimit cek këto çështje!

Po ashtu, është për t'u pasur në kujtesë edhe kjo pikë: "Rrugën për njeriun e bëri të heshtë" dhe nuk thotë: "Atë e detyroi të vazhdojë këtë rrugë.". Kjo gjë, në vetvete, tregon dhe thekson faktin se njeriu është i lirë dhe ka vullnetin e tij për të ecur përpara.

Përsa i përket fazës së fundit të jetës së njeriut, pasi kalon këtë rrugë dhe stade të gjata, thotë: **"Pastaj e vdes dhe i cakton një varr."**.

Sigurisht që fjala *"el imatetu"* është punë e All'llahut, por çështja e fshehjes në varr, në pamje të jashtme, është punë e njeriut. Por, meqë për ta kryer këtë punë është e nevojshme arsyeja dhe inteligjenca, si dhe mjete të tjera, të cilat All'llahu i ka mundësuar, andaj dhe kjo punë i është atribuar atij.

Disa thonë se qëllimi për t'ia atribuuar këtë punë All'llahut, është se All'llahu ka përcaktuar dhe ka krijuar varrin dhe ajo është zemra e dheut.

Disa të tjerë janë të mendimit se kjo fjali ka kuptimin e urdhrit ligjvënës dhe është urdhër hyjnor për të varrosur trupat e vdekur.

Një nga respektet që All'llahu i ka bërë njeriut, është varrimi i tij, pra, programi i varrosjes së trupit (xhenazes). Nëse nuk do të kishte mënyrë për t'u varrosur, ose nëse nuk do të kishte urdhër dhe rregull për këtë gjë, trupat e njerëzve do të qëndronin mbi tokë dhe do të qelbeshin. Trupat e tyre do të ishin ushqim për kafshët e egra dhe për shpendët mishngrënës. Kjo gjë do të ishte poshtërim dhe ulje e madhe për njeriun. Mirësia dhe përkëdhelja hyjnore jo vetëm që përputhet me gjendjen dhe me jetën e njeriut në këtë botë, por ajo mirësi vazhdon të jetë edhe pas vdekjes së tij.

Urdhri për të varrosur trupat e të vdekurve (pasi të jenë larë, të jenë veshur me qefin dhe t'u jetë falur namazi) është urdhër frymëzues, që njerëzit e vdekur duhet të jenë të pastër nga çdo anë. Si të mos jetë kështu për njerëzit e gjallë?!

Është mirë t'i kushtohet vëmendje edhe kësaj pike: Çështja e vdekjes në këtë ajet është konsideruar ndër bekimet hyjnore. Nëse do të kihet pak vëmendje, çështja është kështu: Në radhë të parë, vdekja është parathënie për lehtësimin e vuajtjeve të kësaj bote, si dhe transferimi në një tjetër vend, e cila është një botë shumë më e zgjeruar.

Së dyti, vdekja e brezave ekzistues, bëhet shkak që të hapet vend për brezat e rinj e kështu lloji i njeriut të zhvillohet. Në të kundërt, aq shumë do të ngushtohej arena e njeriut, saqë do të ishte e pamundur jetesa mbi tokë.

Është e habitshme, që po i njëjti kuptim, është një shenjë e butë në suren "Er Rrahman", ajeti 26-28: **"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra** (Qenia) **e Zotit**

Tënd, plot Madhëri dhe Nderim. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!".

Në përputhje me këto ajete, vdekja është një ndër mirësitë e mëdha të All'llahut.

Por, bota, me të gjitha mirësitë, është një burg për besimtarët, që të dalësh nga ky burg, duhet të lirohesh nga kjo botë. Dhe më tej, mirësitë e shumta hyjnore, ndonjëherë, për ndonjë grup është burim mospërfilljeje dhe këta persona bëhen të painformuar. Por mund të ndodhë që vdekja largon perdet e mospërfilljes. Kjo gjë është mirësi dhe zgjim. Nëse jeta e kësaj bote do të kishte vazhdimësi, padyshim që do të ishte shumë e mërzitshme dhe e lodhshme, nuk do të ishte si jeta në Botën Tjetër, e cila është e gëzueshme dhe e hareshme.[1]

Më tej flet për ringjalljen e njeriut. All'llahu e ringjall në çdo kohë që dëshiron dhe e paraqet atë njeri për të dhënë llogari.

"Kur të dojë, Ai e ringjall."

Fjala *"ensherehu"* vjen nga rrënja *"en neshr"*, që ka kuptimin *"përhapje"*, pasi të jenë grumbulluar. Ky interpretim është interesant se tregon se jeta e njeriut përmblidhet në mënyrë të përgjithshme me vdekjen e tij. Po ashtu, në kohën e Ringjalljes do të përhapen në një vend më të madh dhe më të mirë.

Është domethënës fakti se për çështjen e vdekjes dhe të fshehjes në varr është bërë një interpretim për "Vullnetin e Zotit". Në këtë rast thotë: **"Kur të dojë, Ai e ringjall."**. Ky ndryshim

[1] Një poet thotë: "Më erdhi në majë të hundës vetëm për dy ditë jetë. O Hidër! Ti ç'bën që ke një jetë të përhershme?!"

interpretimi mund të jetë, sepse asnjë njeri nuk ka informacion për Ditën e Ngjarjes dhe të ardhjes së Kiametit. I vetmi që ka dije për të është All'llahu. Por, përsa i përket çështjes së vdekjes, në mënyrë të përgjithshme, është e qartë, sepse njeriu, pasi të kalojë një farë moshe, normale, do apo nuk do, do të vdesë.

Në ajetin 23 thuhet se njeriu, që nga momenti që është në formën e lëngut të pavlerë, kur fillon të hedhë hapat në këtë botë dhe do të ecë rrugën e tij drejt përsosmërisë e më pas do të largohet nga kjo botë e të vendoset në varr, përsëri nuk e gjen Rrugën e Drejtë.

"E megjithatë, njeriu ende nuk i ka plotësuar ato që i ka urdhëruar Ai!" [1]

Interpretimi me *"lemma"*, që zakonisht vjen në pritje të mohimit, tregon se me të gjitha këto mirësi hyjnore dhe me të gjitha këto mjete për t'u zgjuar, të cilat janë vendosur në dispozicion të njeriut, pritet që njeriu ta marrë seriozisht rrugën e përputhjes së tij me urdhrin hyjnor. Por është për t'u habitur që akoma ai nuk e ka kryer këtë detyrë.

Përsa i përket çështjes se kush janë këta njerëz, të cilët nuk e kanë kryer detyrën, ekzistojnë dy komentime:

[1] Disa, fjalën *"kel'la"*, e kanë komentuar me kuptimin *"hakkan"*. Në pamje të jashtme kjo fjalë ka po atë kuptim të njohur të saj, ka kuptimin *"er rede'u"*, sepse shumë persona, edhe pse pretendojnë shumë, shikojnë dhe mendojnë shkurt. Ata mendojnë se i kanë kryer detyrat e tyre karshi All'llahut. Ajeti thotë: **"Njeriu ende nuk i ka plotësuar ato që i ka urdhëruar Ai!"**.

Së pari, mendohet se bëhet fjalë për njerëzit që kanë marrë rrugën e kufrit, hipokrizisë, mohues të së vërtetës, si dhe kanë dhunuar dhe kanë ecur në rrugën e gabuar.

Sipas simetrikës së ajetit 34 të sures "Ibrahim" thotë: **"...Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës."**.

Së dyti, të gjithë njerëzit janë të përfshirë, sepse asnjë njeri (qoftë besimtar, qoftë jobesimtar) nuk e ka kryer adhurimin dhe bindjen ndaj All'llahut, ashtu si e meriton All'llahu i Madhëruar.

Ajetet 24 - 32

﴿فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ٢٤ أَنَّا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا٢٥ ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا٢٦ فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا٢٧ وَعِنَبًا وَقَضْبًا٢٨ وَزَيْتُونًا وَنَخْلًا٢٩ وَحَدَائِقَ غُلْبًا٣٠ وَفَاكِهَةً وَأَبًّا٣١ مَتَاعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ٣٢﴾

"Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet."

"Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk."

"Pastaj e çajmë tokën në thellësi."

"Dhe nxjerrim prej saj drithërat."

"Rrushin e perimet."

"Ullirin e palmat."

"Kopshtet e dendura."

"Pemët dhe gjithë barërat."

"Që t'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja."

Komentimi

Njeriu duhet të mendojë për ushqimin e tij

Ajetet e kaluara flisnin për çështjen e Ringjalljes. Edhe ajetet që do të studiojmë tani, flasin në mënyrë të qartë për këtë çështje. Këto ajete janë shkak argumentimi për çështjen e Ringjalljes, e cila mbi gjithçka vërteton dhe tregon fuqinë e All'llahut të Madhërishëm ndaj gjithçkaje. Një tjetër shenjë është ringjallja e tokës së vdekur pas shiut, e cila, në vetvete, është një lloj ringjalljeje në botën e bimëve dhe që vërteton edhe një herë mundësinë e Ringjalljes.

Meqë këto ajete flasin për llojin e ushqimeve që All'llahu ka vendosur në dispozicion të njeriut dhe të kafshëve, bën që ndjesia e falënderimit te njeriu të rizgjohet, duke e ftuar njeriun të njohë mëshirën dhe dijen e All'llahut.

Ajeti 24 thotë: **"Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet."**.

Në ç'mënyrë e ka krijuar All'llahu atë?

Një ndër gjërat e jashtme, më e domosdoshmja për njeriun, është ushqimi i tij, që, duke u transformuar në organizëm, sjell mbajtjen gjallë dhe rritjen e organizmit. Nëse ndodh e kundërta, njeriu shumë shpejt merr rrugën e vdekjes. Ndaj për këtë arsye Kur'ani, nga mesi i të gjithë krijesave, ka vendosur theksin mbi materialet ushqimore, ushqim që merret nëpërmjet bimëve, pemëve, etj.

Është e qartë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"vështroj"* nuk është thjesht një vështrim i jashtëm, por për të ndërtuar një kuptim dhe mendim të saktë. Këto materiale ushqimore konsiderohen si pjesë e dhënies së jetës dhe ndikojnë në arritjen e përsosmërisë së njeriut.

Disa kanë dhënë mendimin se kuptimi i fjalës *"vështrim"*, këtu është për vështrimin e jashtëm, vështrim që bëhet shkak i nxitjes së gjëndrave të pështymës së gojës, që ndihmon në tretjen e ushqimit. Ky mendim nuk është shumë i saktë, sepse ajeti i mësipërm dhe ai i mëposhtëm nuk kanë pozitën e shpjegimit të këtyre çështjeve.

Disa dijetarë, të cilët janë njohës të ushqimeve (merceologë) e që Kur'anin e njohin nga një këndvështrim shumë i kufizuar, çështjet e tyre personale i mendojnë kështu, si dhe kanë po këtë mendim edhe për ajetin e mësipërm.

Disa të tjerë, janë të mendimit se qëllimi për vështrimin e përbërësve ushqimorë është se njeriu, kur ulet në tavolinë, le të mendojë se në ç'rrugë i ka siguruar ato, hallall apo haram, në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme. Kështu aspektet e etikës dhe të ligjit do t'i marrë në konsideratë.

Në disa nga transmetimet e bëra nga Imamët e pastër (masumët) thuhet se fjala *"ushqim"*, në këtë rast, nënkupton *"dijen"*, e cila është ushqimi i shpirtit të njeriut. Njeriu duhet të mendojë se nga kush e ka marrë atë.

Po ashtu në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* për komentin e këtij ajeti thuhet: *"Ia ka mësuar atij (dijen) ai që e ka marrë atë (dijen) prej tij"*[1]

I ngjashëm me këtë transmetim të Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* është edhe transmetimi i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*.[2]

Kuptimi i jashtëm i ajetit ka të bëjë me ushqimin trupor, që në ajetet e mëposhtme janë cituar në mënyrë të detajuar. Por ushqimi i shpirtit mund të merret si parësor nëpërmjet analogjisë, sepse njeriu është i përbërë nga shpirti dhe trupi. Ashtu si trupi i tij ka nevojë për ushqim, edhe shpirti i tij ka nevojë për ushqim shpirtëror.

Vendin, ku njeriu duhet të jetë i saktë në ushqimin e trupit, e shikojmë në ajetet e mëposhtme, ku tregohet se ushqimi është burim i jetës dhe, se duhet pasur shumë kujdes në ushqimin e shpirtit, i cili vjen nëpërmjet shiut të mëshirës së zbulesës në tokën e pastër, e cila është zemra e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Më pas ajo mëshirë kalon në gjokset e Imamëve të pastër *(Paqja qoftë mbi ta!)*, ku ruhet aty e më tej rrjedh si burim në zemrat e njerëzve. Llojet e frutave të tij janë besimi, devotshmëria dhe cilësitë morale, të cilat zhvillohen.

Njeriu duhet të mendojë më së miri, se ku është burimi kryesor i dijes, i cili është edhe ushqimi shpirtëror i tij. A mos vallë ai ushqehet nga një burim i pisët, që ia sëmur, ia dënon e ia shkatërron shpirtin?

---

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 429; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 2, f. 96.
[2] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 429; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 2, f. 96.

Po ashtu, nëpërmjet rrugës së analogjisë, çështja e *"hallallit dhe haramit"* - *"e ligjshme dhe e paligjshme"* mund të njihet nëpërmjet "nënkuptimit" të ajetit.

Ekziston edhe një tjetër mundësi interpretimi: Fjala *"ta'amun"* - *"ushqim"* edhe fjala *"vështrim"*, në këtë ajet kanë kuptim shumë të gjerë. Për këtë arsye janë mbledhur tre llojet e komentimeve.

Përsa i përket faktit se për kë bëhet fjalë dhe cili është qëllimi i përdorimit të fjalës *"njeri"*, mund të themi se është shumë e qartë. Përfshin të gjithë njerëzit, si besimtarët, ashtu edhe jobesimtarët, të gjithë duhet të mendojnë për këta përbërës ushqimorë dhe për sekretet e fshehura në to. Në këtë mënyrë, personat pa besim do të gjejnë rrugën e vërtetë, ndërsa personat besimtarë do t'u shtohet më tepër besimi.

Në të vërtetë, secili nga përbërësit ushqimorë, si: frutat, farat e ndryshme dhe perimet, kanë një botë më vete dhe duhet një kohë jo vetëm për t'i studiuar ato, por edhe për të marrë mësim prej tyre, sepse gjatë gjithë jetës sonë do të na shoqërojnë me dritë.

Më tej flitet për komentimin e detajuar të përbërësve ushqimorë dhe të burimit të tyre: **"Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk."**.

Fjala *"es sabbu"* ka kuptimin *"e rënies së ujit nga lart"*. Në këtë rast, qëllimi i përdorimit të fjalës *"zbritje"*, nënkupton *"shiun"*.

Ndërsa interpretimi me fjalën *"sabban"*, në fund të ajetit, thekson ujin e bollshëm që bie nga lart. Uji, i cili është burimi më i rëndësishëm i jetës, me mirësinë e All'llahut, gjithmonë bie në masë

të bollshme nga qielli. Të gjitha burimet, lumenjtë, kanalet dhe puset janë ruajtës të ujërave, që vijnë si pasojë e rënies së shiut. Pra, burimi kryesor i tyre është shiu. Kështu që njeriu, para se të studiojë "përbërësit ushqimorë", mendon për sistemin e rënies së shiut, se si dielli shndrit mbi det, duke u formuar retë.

Kur uji në natyrë (në dete, oqeane, liqene e lumenj) ngrohet, ai fillon të avullojë. Kjo ndodh, sepse uji përbëhet nga grimca të vogla, të cilat quhen molekula. Kur uji është i lëngët, ato lëvizin, por njëkohësisht janë të lidhura me njëra-tjetrën. Kur uji ngrohet, molekulat fillojnë të lëvizin më shpejt dhe të largohen nga njëra-tjetra dhe, për pasojë, uji kthehet në avull. Avulli është i lehtë dhe ngrihet lart në qiell. Kur ngrihet atje, takohet me ajrin e ftohtë, sepse, sa më lart drejt qiellit të shkosh, aq më i ftohtë është edhe ajri. Kur arrin te ajri i ftohtë, avulli fillon të ftohet dhe molekulat e tij fillojnë t'i afrohen njëra-tjetrës, njëlloj si gjallesat kur kanë ftohtë. Ky proces quhet kondensim. Pasi molekulat afrohen dhe formojnë pika të vogla uji, neve na duken si një masë e bardhë. Kjo është pak a shumë njëlloj si tymi që na duket si një masë e hirtë. Gjatë kësaj kohe reja lëviz e udhëton, e bartur nga rrymat e ajrit dhe era. Në re, pikat e vogla të ujit takohen me njëra-tjetrën, bashkohen dhe krijojnë pika më të mëdha. Këto pika janë shumë të rënda për të qëndruar në qiell dhe për këtë arsye bien në tokë. Rënia e këtyre pikave quhet shi.

Pasi përmendet çështja e ujit, e cila është një ndër shtyllat e rëndësishme për mbirjen e pemëve, në ajetin tjetër kur'anor përmend tokën: **"Pastaj e çajmë tokën në thellësi."**.

Shumë nga komentuesit thonë se ndarja e tokës apo çarja e saj bëhet për shkak të sythave të bimëve. Në të vërtetë, kjo është një

nga çudirat e krijimit, që një syth aq i butë, çan tokën e fortë. Ndonjëherë ato dalin nëpër male dhe shkëmbinj. Sa i Madhëruar dhe Krijues i madh është All'llahu, që ka krijuar një syth kaq të ndjeshëm dhe të butë, i cili ka një fuqi të tillë!

Disa komentues të tjerë mendojnë se qëllimi i përdorimit të fjalës **"çarje e tokës"** nënkupton punimin e tokës nëpërmjet plugut, ose nëpërmjet krimbave, që është një lloj tjetër veprimi i përbashkët, që lidhet me tokën. Është e vërtetë që plugimi është punë e njeriut, por, meqë të gjitha mjetet i ka vendosur All'llahu në dispozicion të njeriut, ky veprim i është atribuar Atij.

Ndërsa komentimi i tretë, që i është bërë këtij ajeti, thotë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"çarje e tokës"*, nënkupton gurët e thërrmuar në sipërfaqen e saj.

Një formë shpjegimi e çarjes së tokës është: Në fillim, sipërfaqja e tokës ishte e mbuluar nga një "lëkurë" e madhe prej guri. Shirat që kanë rënë vazhdimisht, kanë bërë që gurët të çahen dhe pjesët e tyre të përhapen në sipërfaqen e tokës, duke e mbuluar atë. Kështu, në këtë mënyrë, masat e dheut janë përgatitur për t'u mbjellë. Një pjesë e tyre është tretur në det, por përsëri dherat e tjera, të cilat grumbullohen si pasojë e rënies së shiut dhe të dëborës, zënë përsëri vendin e tyre. Nëse kjo gjë nuk do të ndodhte, njeriu do të kishte probleme me ushqimin, pasi do të pakësohej sipërfaqja e tokës pjellore.

Në këtë mënyrë, ajeti kur'anor shpjegon një ndër mrekullitë shkencore të Kur'anit: Në fillim bien shirat, më pas toka çahet dhe bëhet gati për t'u mbjellë. Kjo gjë nuk ka ndodhur vetëm në ditët e para, por vazhdon të ndodhë.

Ky komentim duket më i përshtatëshëm, për vetë faktin se flet për çështjen e mbirjes së bimëve, gjë e cila do të citohet në ajetin e ardhshëm.

Por mbledhja e tre komentimeve nuk është i pamundur.

Pas citimit të këtyre shtyllave të rëndësishme, si uji dhe toka, janë cituar tetë pjesë të bimëve, të cilat ndihmojnë në mbirjen e bimëve. Këto bimë janë elementet kryesore të ushqimit të njeriut dhe të kafshëve. Më tej shton: **"Nxjerrim prej saj drithërat."**.

Farërat, të cilat përdoren si burim kryesor i ushqimit për njerëzit dhe kafshët, nëse, nuk do të mbinin një vit, për shkak të thatësirës, e gjithë bota do të kishte zi dhe njeriu do të haste shumë probleme për sigurimin e ushqimit.

Interpretimi me fjalën *"habben"* ka ardhur në formën e *"nekeres"* - *"e pashquar"*, që në këtë rast shpjegon argumentin e madhështisë ose ndryshueshmërinë e llojeve të këtyre bimëve. Disa komentues kanë cituar veçanërisht *"grurin"* dhe *"thekrën"*. Ky citim nuk mund të jetë argument, sepse këtu përfshihen të gjitha drithërat.

Në ajetin 28 shton: **"Rrushin e perimet."**.

Citimi i *"rrushit"* - *"inebun"* nga mesi i të gjithë frutave, është për shkak të përbërësve ushqimorë dhe jetikë që ka ky fryt. Atë e kanë sjellë në formën e një ushqimi të plotë. Duhet të dini se fjala *"einebun"* përdoret edhe për *"rrushin"*, edhe për *"hardhinë"*. Në ajetet kur'anore janë cituar të dyja, por, në këtë rast, më e përshtatshmja është për rrushin.

Fjala *"kadaben"* ka kuptimin *"perime"*, të cilat këputen në radhë dhe stinë të ndryshme. Në këtë rast bëhet fjalë për lloje të ndryshme perimesh që hahen. Citimi i tyre pas rrushit, është argument për rëndësinë që ka kanë perimet në ushqyerjen e njeriut.

Ndonjëherë fjala *"kadaben"* ka kuptimin *"prerje"* ose *"këputje"*, ndërsa fjala *"el kadijbu"* ka kuptimin *"njohja e pemëve"*, ndërsa fjala *"seif kadhib"* ka kuptimin *"shpatë vendimtare"*.

Është transmetuar nga Ibn Abasi se qëllimi i përdorimit të fjalës *"el kadbu"*, në këtë rast, është për hurmat *"er rutebu"*, të cilën e këpusin nga pemët. Ky komentim është tepër i largët, sepse në ajetin pasardhës është folur në mënyrë të qartë për çështjen *"er rutebu"*.

Po ashtu, shumë të tjerë mendojnë se fjala *"el kadbu"* ka kuptimin e bimëve zvarritëse, si kastraveci dhe shalqiri apo diçka tjetër, si rrënjët e karotës, qepës dhe lakrës.

Por nuk është e pamundur që në këtë rast fjala *"el kadbu"* të ketë kuptim të gjerë, që të përfshijë perimet, frutat dhe drithërat, që kanë rrënjë ushqimore.

Më tej shton: **"Ullirin e palmat."**. Mbështetja te këto dy fruta është e qartë, sepse në ditët e sotme është vërtetuar se *"ulliri"* dhe *"hurma"* janë ndër përbërësit më të rëndësishëm për shëndetin e njeriut.

Në ajetin 30 shton **"Kopshtet e dendura."** (Plot me pemë me lloje të ndryshme, ngjyra-ngjyra).

Fjala *"el hadaik"* është shumësi i fjalës *"hadijkatun"*, që ka kuptimin e bahçes, e cila është e rrethuar me mur. Në të vërtetë, ka kuptimin e një pjese toke, e cila ka ujë. Kjo fjalë rrjedh nga fjala *"hadeka"*, vend që ka gjithmonë ujë.

Të tilla kopshte zakonisht janë me fruta. Mund të bëhet fjalë për kopshtet e ndryshme të Xhennetit.

Fjala *"gulb"* është shumësi i fjalës *"egleb"* dhe *"gulabau"*, me kuptimin forcë dhe fuqi. Kjo fjalë vjen nga rrënja *"galebe"*, që në këtë rast ka kuptimin *"pemë të mëdha dhe të fuqishme"*.

Pasi flet për pemët, shton: **"Pemët dhe gjithë barërat."**.

Fjala *"el ebbu"* kur vjen me texhdid ka kuptimin *"pemë të mëdha dhe kullota"*, të cilat janë përgatitur për të kullotur kafshët, ose për të mbledhur bimët. Në origjinal ka kuptimin e *"përgatitjes"*. Meqë të tilla kullota janë të gatshme për t'u përdorur, ato i quajnë *"el ebbu"*.

Disa thonë se fjala *"el ebbu"* nënkupton frutat që mund të thahen dhe mund të ruhen për dimër, për të përfituar prej tyre edhe në këtë periudhë të ftohtë.

Shumë nga komentuesit e Ehli Synetit dhe Shi'iat, në vazhdim të këtij ajeti kanë transmetuar: Një ditë, Omeri po mbante hytbe dhe po këndonte këto ajete kur'anore. Në një moment tha: Të gjitha këto ne i njohim. Por fjala *"el ebbu"* ç'është? Nuk e dimë."

Më pas, shkopin që kishte në dorë, e lëshoi dhe tha: "Betohem në All'llah! Kjo është një lloj hileje. Ç'të keqe ka, nëse nuk e dimë kuptimin e fjalës "ab"?! Ju jeni ndjekës të Librit të All'llahut,

pra, është përcaktuar për ju që të jeni ndjekës të Tij, ndaj dhe zbatojeni atë (librin). Aty ku nuk kuptoni diçka nga Libri i All'llahut, vendoseni atë para All'llahut."[1]

Kjo gjë tregon se kuptimi i fjalës *"el ebbu"* është i ndërlikuar. Nëse do të kthehemi te tekstet e fjalorëve, kjo fjalë bëhet e qartë dhe çështja bëhet e thjeshtë.

Është për t'u habitur se edhe në "Durr'rrul Menthur" po këtë pyetje, ia kanë bërë edhe Ebu Bekrit. Ai është përgjigjur: "Nuk mund të përgjigjem për diçka që nuk e di nga ajetet e Kur'anit dhe nuk mund t'ia atribuoj atë All'llahut. Kush nga qiejt do të më bëjë hije mua mbi kokë? Cila tokë do jetë gati që të më pranojë mua? Kush do të më mbështesë mua?"

Është e vërtetë që shumë prej dijetarëve të Ehli Synetit kanë nxjerrë një përfundim nga këto dy hadithe: Askush nuk duhet të flasë për çështje që nuk ka dijeni, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të Librit të All'llahut.

Por gjithsesi, pyetja mbetet: Si është e mundur që një udhëheqës i myslimanëve të mos ketë dijeni për kuptimet e fjalëve që kanë ardhur në tekstin e Kur'anit të Shenjtë, që nuk janë dhe aq të vështira? Të gjitha këto janë argumente dhe arsyetime që udhëheqësi hyjnor duhet të ketë dijeni për çdo gjë dhe të jetë i pastër nga çdo gabim.

Ndaj dhe në vazhdim të hadithit, që i ndjeri, eruditi Mufid, ka transmetuar në librin "Ershad", lexojmë: "Kur Prijësit të

[1] Shih tefsiret: "Ruhul Meanij", "Kurtubij", "Fi Dhilal Kur'an", "Durr'rrul Menthur" dhe "El Mijzan, në vazhdim të ajetit që po diskutojmë.

besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* dëgjoi për këtë ngjarje, tha: *"Është për t'u habitur. A nuk e dinte ai se kuptimi i fjalës "el ebbu" është: bimët që mbijnë vetë dhe bëhen kullota?! Dhe se fjalia:* **"Ue fakiheten ve ebba"** *është mirësi e All'llahut të Madhëruar në lidhje me krijesat e Tij, në atë çka u ka falur atyre te prodhimet ushqimore, pra, si për njerëzit, ashtu edhe për kafshët. Të gjitha këto janë burim i jetës dhe fuqia e trupit të tyre."*.[1]

Në këtë rast lind pyetja: Në ajetet e kaluara, disa prej frutave janë cituar në mënyrë të veçuar, ndërsa në këtë rast janë cituar në mënyrë të përgjithshme. Po ashtu, edhe në ajetin e mësipërm, që fliste për kopshtet, me sa duket, mendimin dhe qëllimin e kishte për frutat e tyre. Me këtë përshkrim, si mund të citohen edhe një herë frutat? Në përgjigje të saj themi se citimi i frutave në mënyrë të veçuar, si: rrushi, ulliri dhe hurma, bëhet për rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë këto fruta ndaj frutave të tjera.[2]

Ndërsa përsa i përket citimit të fjalës *"fakiheten" - "frut"*, e cila është e ndarë nga fjala *"hadaik" - "kopsht"*, mund të jetë se kopshtet, përveç prodhimit të frutave, kanë edhe përfitime të tjera, si pamjen e bukur, ajrin e pastër e shumë e shumë përfitime të tjera si këto.

Po ashtu, disa gjethe dhe lëkurë pemësh përdoren për t'u ngrënë ose për pije, si çaji, etj. Përveç gjetheve, shumë pemë janë ushqim për kafshët. Por ajo që thuhet në ajetet e mësipërme, përfshin si kafshët, ashtu edhe njerëzit, ndaj dhe në ajetin 32, i cili

---

[1] "Irshad Mufid", në përputhje me transmetimin "El Mijzan", vëll. 20, f. 319.

[2] Për rëndësinë e prodhimeve frutore, si: ulliri, hurma dhe rrushi, është bërë një diskutim i gjerë në vazhdim të ajetit 11, të sures "En Nahl".

është ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh që po diskutojmë, shton: **"Që t'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja."**.

Fjala *"meta'an"* përfshin çdo gjë që njeriu mund të përfitojë prej saj.

Hulumtim

Përbërësit e shëndetshëm ushqimorë

Në ajetet e mësipërme përmenden tetë lloj përbërësish ushqimorë për njerëzit dhe kafshët. Të gjitha këto ushqime dhe prodhime bimore, kanë bazë bimët dhe frutat. Arsyeja e përmendjes së tyre është rëndësia e këtyre produkteve në organizmin e njeriut dhe se ushqimi më i vlefshëm i njeriut janë këto produkte. Ndërsa ushqimin e kafshëve e ka vendosur në një tjetër stad dhe me sasi më të pakët.

Ajo çka bie në sy në këtë përshkrim është se shkenca e merceologjisë, në ditët e sotme, është zhvilluar shumë dhe konsiderohet shumë e rëndësishme. Në të vërtetë, shpjegimi dhe komentimi i saj është cituar në këto ajete, ku shpjegohet vlerësimi që ka Kur'ani, në veçanti për përbërësit që u cituan në mënyrë të veçuar dhe që u theksuan më shumë. Të gjithë përbërësit që u cituan, në shkencën e merceologjisë kanë një rëndësi dhe vlerë shumë të madhe.

Megjithatë, kujdesi në të tilla çështje bën që njeri të njihet më mirë me Madhështinë dhe me mirësitë e Krijuesit në lidhje me krijesat e Tij.

Të kujdesesh për ushqimin e trupit, si dhe të shpirtit, bën që njeriu të edukojë nefsin e tij dhe të marrë më tepër njohuri për Krijuesin e tij. **"Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet."** Kjo fjali e shkurtër është shumë kuptimplote.

Ajetet 33 – 42

﴿فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاخَّةُ٣٣ يَوْمَ يَفِرُّ الْمَرْءُ مِنْ أَخِيهِ٣٤ وَأُمِّهِ وَأَبِيهِ٣٥ وَصَاحِبَتِهِ وَبَنِيهِ٣٦ لِكُلِّ امْرِئٍ مِنْهُمْ يَوْمَئِذٍ شَأْنٌ يُغْنِيهِ٣٧ وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ مُسْفِرَةٌ٣٨ ضَاحِكَةٌ مُسْتَبْشِرَةٌ٣٩ وَوُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ عَلَيْهَا غَبَرَةٌ٤٠ تَرْهَقُهَا قَتَرَةٌ٤١ أُولَئِكَ هُمُ الْكَفَرَةُ الْفَجَرَةُ٤٢﴾

"Por, kur të vijë Ushtima."

"Atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai."

"Nga e ëma dhe nga i ati."

"Nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet."

"Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë."

"Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore."

"Të qeshura e të gëzuara."

"Atë Ditë do të ketë (edhe) **fytyra të pluhurosura."**

"Që do t'i mbulojë errësira."

"Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët."

Komentimi

Britma e ringjalljes

Pasi u citua një pjesë nga mirësitë Hyjnore dhe bollëku i kësaj bote, do të merremi me shpjegimin e një pjese tjetër, e cila është ngjarja e Ringjalljes, si dhe fati i besimtarëve dhe i jobesimtarëve, për të lajmëruar se, nga një anë, këto mirësi dhe begati, çfarëdo të jenë, janë kalimtare dhe kanë një përfundim. Nga ana tjetër, ekzistenca e tyre është argument për fuqinë e All'llahut mbi gjithçka dhe mbi çështjen e Ringjalljes.

All'llahu në Kur'an thotë se kur ai zë i tmerrshëm do të dëgjohet, britma e Ringjalljes, jobesimtarët dhe kriminelët, do të futen në trishtim të thellë.

"Por, kur të vijë Ushtima."

Fjala *"es sakhattu"* vjen nga rrënja *"sekhun"*, që ka kuptimin *"zë i tmerrshëm"*, saqë duket sikur po ia pëlcet daullet e veshëve njeriut. Në të vërtetë, ai zë dhe britmë të shurdhon. Në këtë rast, bëhet fjalë për britmën e dytë, pra, bëhet fjalë për fryrjen e dytë të Surit. Ajo britmë e madhe do të jetë edhe britma e zgjimit dhe e jetës, që do t'i ftojë të gjithë, pasi të Ringjallen në sheshin e Kiametit.

Po, është e vërtetë që ajo britmë do të jetë aq e madhe dhe tronditëse, saqë njeriun do ta bëjë të pavëmendshëm ndaj çdo gjëje tjetër, përveç veprave të tij.

Ndaj dhe ajeti tjetër thotë: **"Atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai."**.

Është po ai vëlla që ishte i barabartë me shpirtin e çdo gjë bëhej në kujtim të tij dhe sot largohet prej tij.

Largohet edhe nga prindërit: **"Nga e ëma dhe nga i ati."**

"Nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.".

Në këtë mënyrë, njeriu, i cili është i shoqërueshëm dhe dashamirës i madh ndaj të afërmve të tij, sikurse është vëllai, nëna, babai, bashkëshortja dhe fëmija, jo vetëm që i harron, por ikën prej tyre. Kjo tregon se tmerri i asaj Dite është aq i madh, saqë e ndan njeriun nga të gjitha lidhjet farefisnore. E ndan nga nëna, të cilën e adhuron aq shumë; e ndan nga babai, të cilin e respekton shumë; e ndan nga bashkëshortja, dashuria ndaj së cilës ishte e madhe; e ndan nga fëmijët, të cilët janë fryti i zemrës dhe drita e syve të tij.

Disa thonë se qëllimi i përdorimit të fjalëve: **"largimin nga vëllai, babai dhe nëna, bashkëshortja dhe fëmija"**, bëhet për të treguar mosbindjen, mungesën e devotshmërisë ndaj All'llahut. Të gjitha këto bëjnë që njeriu të largohet, sepse nuk dëshiron t'i lidhë me të afërmit e tij, duke menduar se mos po mban mbi vete edhe fatin e tyre. Komentues të tjerë të Kur'anit të Shenjtë thonë: Ky largim ndodh se ndoshta ndonjëri prej tyre është borxhli dhe nga frika e pamundësisë së shlyrjes së borxhit friksohet dhe largohet.

Nga mesi i këtyre tre komentimeve, më i saktë duket komentimi i parë, edhe pse kombinimi dhe përmbledhja e tyre është e pa kuptim.

Ndërsa përsa i përket faktit se përse në fillim është folur për vëllain e më pas për prindërit, bashkëshorten dhe në fund për fëmijët, disa janë të mendimit se kjo renditje është bërë në bazë të rëndësisë së lidhjeve, duke filluar nga niveli më i ulët deri në nivelin më të lartë.

Retorika më e përshtatshme është kjo: Në fillim njeriu largohet nga vëllai, më pas nga nëna dhe babai e në fund largohet nga bashkëshortja dhe fëmijët. Por, duke u bazuar në faktin se të gjithë njerëzit, përsa i përket kësaj dashurie dhe afrimiteti, me këto pesë grupe, nuk janë njësoj, ndodh që ndonjëherë vëllai ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe është më i dashur për të, ndonjëherë është bashkëshortja e ndonjëherë është fëmija. Ndaj edhe në këtë rast nuk mund të kemi një formulë të përgjithshme.

Në të vërtetë, përsa i përket rëndësisë së lidhjes së njeriut me secilin nga këto pesë grupe, mund të flitet shumë, por nuk është kështu, sepse në mënyrë të përgjithshme dhe absolute nuk mund t'i japim përparësi njërit apo tjetrit, veçanërisht sipas mënyrës që ka ardhur në ajetin kur'anor. Për këtë arsye, radhitja e mësipërme nuk është e llogaritur sipas rëndësisë së secilit person.

Në ajetin tjetër shpjegohet arsyeja e largimit: **"Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë."**.

Interpretimi me *"jugnihi"* (Atë e bën të panevojshëm) është një aludim i kujdesshëm nga kjo e vërtetë, që në atë Ditë njeriu është aq i zënë me veten e tij, saqë nuk mendon apo t'i hedhë sytë te tjetri. Ajo ngjarje është aq e madhe dhe e tmerrshme, saqë njeriu është i mjaftuar me veten dhe me mendjen e tij.

Në një hadith thuhet: "Disa nga familjarët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pyetën atë: 'Në Ditën e Kiametit a i bie mendja njeriut për shokun e tij të ngushtë?'

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: Janë tre ndalesa, ku asnjë njeri nuk do të mendojë për askënd: Ndalesa e parë është te peshorja e veprave, aty ku njeriu do të shikojë që veprat e tij janë të rënda apo të lehta. Më tej vjen Ura e Siratit, aty njeriu shikon, nëse mund ta kalojë apo jo atë urë. Më tej, kur të marrë në dorë letrën e veprave e të shikojë se nga cila anë do e marrë, nga e djathta apo nga e majta. Këto janë tre ndalesa, ku asnjë njeri nuk mendon për njeri: as për shokun e ngushtë e as për mikun e mirë; as për të afërmit e as për miqtë e sinqertë e të mirë; as për fëmijën e as për babain dhe nënën. Kjo është ajo që All'llahu i Madhëruar thotë: **'Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë.**'".[1]

Më tej flitet për gjendjen e besimtarit dhe të jobesimtarit në atë Ditë të tmerrshme: "**Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara."**

"Atë Ditë do të ketë (edhe) **fytyra të pluhurosura."**

"Që do t'i mbulojë errësira."

"Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët.".

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 429.

Fjala *"musifreten"* vjen nga rrënja *"esfarun"*. E kemi thënë edhe më parë, ka kuptimin shfaqet, shkëlqyeshme, sikurse është zbardhja e parë e mëngjesit në përfundim të natës së errët.

Fjala *"gabere"* vjen nga rrënja *"el gubar"*, me kuptimin *"mbetje e dheut"*, e cila ngrihet nga toka dhe mbetet në një gjë (pluhurit).

Fjala *"katere"* vjen nga rrënja *"el katar"*, që ka kuptimin e tymit që ngrihet nga druri apo diçka tjetër. Disa specialistë të gjuhës atë e kanë komentuar me kuptimin *"gubar"*.

Bashkimi i këtyre dy interpretimeve në ajetet e mësipërme tregon se këto dy fjali kanë kuptime të ndryshme.

Fjala *"kefere"* dhe *"fexhere"* është shumësi i *"kafir"* dhe *"faxhir"*. Fjala e parë tregon për personat që kanë besim dhe mendim të korruptuar, ndërsa fjala e dytë tregon për personat që janë të korruptuar në veprat e tyre.

Nga këto ajete mund të kuptohet shumë mirë se në skenën e Kiametit janë edhe ndikimet e besimit dhe të veprave, të cilat janë shumë të dukshme në fytyrat e njerëzve. Po ashtu, interpretimi me *"vuxhuhun"* është për shkak se ngjyra e fytyrës është treguesi më i mirë i gjendjes së brendshme dhe të jashtme të njeriut. Fytyra tregon edhe shqetësimin mendor, edhe shqetësimin shpirtëror. Po ashtu tregon edhe lodhjen e trupit.

Megjithatë aty gjendet edhe një grup, i cili është i qeshur dhe i gëzuar. Fytyrat e tyre janë të shndritshme dhe plot dritë. Qartësia e besimit dhe pastërtia e veprimeve të tyre tregohet nga shkëlqimi

i fytyrës së tyre. Ngjyra e fytyrës së tyre tregon se sa të lumtur dhe të gëzuar janë.

E kundërta ndodh me grupin tjetër, që është në errësirë dhe është duke vepruar keq. Të gjitha këto janë të dukshme në fytyrat e tyre. Ata duken sikur në fytyrat e tyre ka vetëm dhè e pluhur. Tymi i ka mbuluar, ndikimi i hidhërimit, i trishtimit dhe i dhimbjes ndihet dhe shikohet në fytyrat e tyre. Kjo është përshkruar në ajetin 41 të sures "Er Rrahman": **"Keqbërësit do të njihen sipas shenjave dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh."**.

Në atë ditë ngjyra e fytyrave të tyre janë më se të mjaftueshme për të njohur njerëzit.

Hulumtim

Bazat e ndërtimit të vetvetes

Interpretimet e ajeteve të shkurtra dhe me plot lëvizje të kësaj sureje flasin për një program të përmbledhur për edukim.

1- Nga një anë, njeriut i jepet urdhër që, nëse dëshiron të thyejë mendjemadhësinë dhe arrogancën, le të mendojë për fillimin e krijimit të tij dhe të shikojë se nga se është krijuar, nga një lëng i pavlerë.

Dimë se një nga pengesat më të mëdha për t'u edukuar është arroganca dhe mendjemadhësia.

2- Nga ana tjetër, udhëzimi hyjnor merret si lindja dhe veshja më e mirë e udhëzimit, si udhëzimi që vjen për shkak të zbulesës, si udhëzimet që vijnë për shkak të udhëheqjes së Profetëve *(Paqja qoftë mbi ta!)*, si dhe udhëzimet që vijnë nëpërmjet arsyes, ligjeve dhe sistemit të botës.

3- Më pas njeriut i urdhërohet të vështrojë dhe të reflektojë për ushqimin trupor, të hapë sytë dhe të shikojë që ky Krijues i Mëshirshëm ka krijuar një pafundësi frutash, perimesh, drithërash dhe ushqimesh për t'u ushqyer.

Njeriu jo vetëm duhet të meditojë për ndërtimin e tyre, por duhet të mendojë edhe për t'i mësuar ato, sepse ushqimi i pastër dhe hallall është një ndër bazat e rëndësishme të edukimit të njeriut.

4- Sipas mënyrës së parë, duhet të mendohet për ushqimin shpirtëror, se nga cili burim rrjedh, nga burimi i pastër apo nga burimi i papastër, sepse mësimet dhe studimet jo të drejta, si dhe propaganda që të bën të humbasësh Rrugën e Drejtë, është si ushqimi i helmuar, që e vë në rrezik jetën shpirtërore të njeriut.

Është për t'u habitur se disa njerëz janë shumë të dhënë pas ushqimit të trupit të tyre, si dhe janë shumë të vështirë në përzgjedhje, sepse i kushtojnë shumë rëndësi. Ndërsa përsa i përket ushqimit të shpirtit të tyre, janë të pavëmendshëm, lexojnë çfarëdolloj libri, dëgjojnë çfarëdolloj lajmi, duke i çuar drejt humbjes. Ata nuk kanë asnjë kusht për ushqimin e shpirtit të tyre.

Në një hadith të Prijësit të besimtarëve Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Shikoj njerëz, që, kur u shtrohet ushqimi në kohën e darkës, hapin llambat për të parë se çfarë ushqimi do të hanë. Pra, ata shikojnë se me se po ushqehen, tregojnë kujdes për ushqimin që marrin. Ndërsa ushqimit të shpirtit të tyre, nuk i japin asnjë rëndësi. Ata nuk e ndezin llambën e arsyes nëpërmjet dijes, që të mbeten të shëndetshëm në veprime dhe në besim.*".[1]

Hahdith të ngjashëm me këtë hadith transmeton edhe Imam Hasani *(Paqja qoftë mbi të!)*: *Çuditem me ata që mendojnë vetëm për ushqimin e trupit të tyre. Ndërsa për ushqimin e shpirtit të tyre, nuk kujdesen. Ata largojnë ushqimet që sjellin dëm për barkun e tyre, por zemrën e tyre e mbushin me material të pavlefshëm.*".[2]

5- Pas kësaj rikujtohet britma dhe ushtima e madhe, që do t'i zgjojë njerëzit nga gjumi i vdekjes.

Njeriu do të qëndrojë përballë veprave të tij. Ajo ngjarje do të jetë shumë tronditëse, saqë njeriu do të braktisë dhe do të largohet nga njerëzit e tij më të dashur. Njeriu duhet të mendojë se a mund të bëjë ndonjë punë, që në atë ditë të ketë një fytyrë të qeshur, të gëzuar e plot dritë, apo fytyra e tij do të jetë e ngrysur dhe e shëmtuar në errësirë.

6- Si përfundim, njeriu duhet të mendojë dhe ta përgatisë veten e tij për atë ditë tronditëse.

[1] Tefsiri "Sefinetul Bihar", vëll. 2, f. 84, Burimi "Ushqimi".
[2] Tefsiri "Sefinetul Bihar", vëll. 2, f. 84, Burimi "Ushqimi; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 268.

O All'llah! Na mundëso edukimin e vetvetes!

O All'llah! Mos na privo edukimin e shpirtit!

O All'llah! Mos na zgjo përpara britmës dhe ushtimës së Ditës së Kiametit nga gjumi i shenjtë!

Amin Ja Rabil Alemin!

Fundi i sures "Abese"

Surja "Et Tekuijr"

Zbritur në Mekë

Ajete 29

Përmbajtja e sures "Et Tekuijr"

Kjo sure është nga suret që kanë zbritur në Mekë. Janë regjistruar interpretime të ndryshme, përsa i përket kuptimit të saj. Ndër interpretimet e bëra përmendet deklarimi që kanë bërë disa armiq për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata e kanë konsideruar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si të çmendur. Kjo gjë zakonisht ndodhte në Mekë dhe ishte më e dukshme në fillimet e ftesës që i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u bënte njerëzve për t'i afruar drejt Rrugës së Drejtë. Shumë armiq, për ta ofenduar dhe për ta konsideruar si të pavlerë ftesën e të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përpiqeshin që të mos i konsideronin të rëndësishme fjalimet e tij dhe qëndronin indiferent ndaj tyre.

Megjithatë, kjo sure, në përgjithësi, rrotullohet mbi këto dy boshte:

Boshti i parë: Ajetet e saj të para tregojnë shenjat e Kiametit, përmbysjen dhe ndryshimin e madh që do të ndodhë në fund të kësaj bote, si dhe në nisjen e Ringjalljes.

Në boshtin e dytë, flitet për madhështinë e Kur'anit dhe se si ndikon ky Libër Hyjnor në zemrën e njeriut. Kjo pjesë vjen së bashku me betimet, që e zgjojnë njeriun, që janë të pasura me kuptime.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Janë transmetuar hadithe të shumta përsa i përket përmbajtjes, rëndësisë së leximit të kësaj sureje. Ndër to përmendim një hadith të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Ai që do të lexojë suren 'Tekuijr', All'llahu i Madhëruar do ta ruajë nga turpërimi kur do t'i jepen letrat e veprave."*.[1]

Po ashtu, në një hadith tjetër, transmetuar nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë *"Nëse dikush dëshiron, që në Ditën e Kiametit të më shikojë mua, le të lexojë suren 'Tekuijr'."*.[2]

Ky hadith është transmetuar edhe në një mënyrë tjetër: *"Nëse dikush do të mendojë dhe kërkon të shikojë Kiametin (A thua se po e shikon me sy?!), le të lexojë suren 'Tekuijr', suren 'Infitar'dhe suren 'Insheket'. Tek këto sure janë paraqitur shenjat e Kiametit. Kur njeriu i lexon ato, duket sikur e ka para syve skenën e asaj Dite tronditëse."*.[3]

Në hadithin e tretë lexojmë se, kur e kanë pyetur të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Përse janë shfaqur kaq shpejt te ti shenjat e pleqërisë?", ai është përgjigjur: *"Më kanë thinjur suret 'Hud', 'Uakia', 'Murselat', 'Nebe' dhe 'Shems'. Në këto sure është paraqitur ngjarja tronditëse e Kiametit dhe çdo njeri, që është i zgjuar, do të plakej shpejt."*.[4]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 441.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 441.
[3] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7017. Kuptimi i këtij hadithi mund të ketë kuptimin e hadithit të cituar më lart.
[4] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 513.

Në një tjetër hadith, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Çdokush që lexon suren 'Abese' dhe 'Tekuijr', do të jetë poshtë krahëve dhe mirësisë së All'llahut, në Xhennetin e përjetshëm. Ata do të qëndrojnë në hijen dhe mirësinë hyjnore, në kopshtet e Xhennetit. Kjo nuk është gjë e vështirë për All'llahun, nëse Ai dëshiron.*".[1]

Interpretimet që kanë ardhur në transmetimet e mësipërme, tregojnë shumë mirë qëllimin e leximit të kësaj sureje, e cila është burim i njohurisë, i besimit dhe i veprimit.

[1] "Theuabul A'mal", sipas transmetimit "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 512.

Ajetet 1 – 9

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ١ وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ٢ وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ٣ وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ٤ وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ٥ وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ٦ وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ٧ وَإِذَا الْمَوْءُودَةُ سُئِلَتْ٨ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ٩﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin."

"Kur yjet të rrëzohen."

"Dhe malet të lëvizin tutje."

"Kur devetë barrse të braktisen."

"Dhe egërsirat të tubohen."

"Kur detet të vlojnë."

"Dhe shpirtrat të bashkohen (me trupat)**."**

"Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet."

"Për çfarë faji ishte vrarë."

Komentimi

Ditën kur çdo gjë do të paloset!

Në fillimet e kësaj sureje, sikurse e kemi thënë edhe më parë, flitet shkurtimisht për ngjarjen tronditëse të Kiametit, pra, të fundit të kësaj bote. Më tej hasim fillimin e Ringjalljes, ku njeriu udhëton në një botë shumë të çuditshme. Në përgjithësi flitet për tetë shenja. Disa prej tyre janë:

Së pari, flitet për çastin kur dielli të ndryshojë: **"Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin."**.

Fjala *"kuiret"* vjen nga rrënja *"tekuijr"* dhe në origjinal ka kuptimin e ndërlikuar, e mbështjellë (po ashtu ka edhe kuptimin e lidhjes së çallmës). Ky informacion është marrë nga libra të ndryshëm të fjalorit dhe të komentimeve.

Ndonjëherë atë e kanë shpjeguar si "flakjen tutje" të diçkaje. Po ashtu e kanë shpjeguar me kuptimin e errësirës. Me sa duket të dy këto kuptime lidhen me rrënjën e parë.

Megjithatë, qëllimi këtu është për transformimin e dritës së Diellit dhe të errësirës, që do të krijohet pas këtij ndërlikimi. Dimë se Dielli është një planet jashtëzakonisht i nxehtë dhe përvëlues, saqë të gjithë përbërësit e tij dalin me presion në formën e gazit dhe përreth tij vijnë rrezet përvëluese, të cilat janë në largësi prej qindra e mijëra kilometrash. Nëse planeti i Tokës do të gjendet në mesin e një rrezeje të madhe, menjëherë do të shndërrohej në gaz. Por në fundin e kësaj bote dhe në afrimin e Ditës së Kiametit kjo nxehtësi do të ulet dhe do të grumbullohet. Ndriçimi i tij do të nisë të shuhet,

po ashtu edhe madhësia e tij do të nisë të zvogëlohet. Ky është kuptimi i "Tekuijrit".

Kuptimi i *"tekuijrit"* është shuarja e dritës së diellit dhe ndryshohet sitemi i krijimt të tij.

Kjo është një e vërtetë, e cila është cituar në dijen dhe në shkencën e ditëve të sotme. Po ashtu, është vërtetuar se Dielli dalëngadalë po shkon drejt errësimit dhe shuarjes. Më tej shton: **"Kur yjet të rrëzohen."**.

Fjala *"enkederet"* vjen nga rrënja *"el inkidar"* dhe ka kuptimin *"rënie"* dhe *"copëzim"*. Po ashtu, vjen edhe nga rrënja *"keduret"*, e cila ka kuptimin *"errësirë"* dhe *"vrenjtje"*. Këto dy kuptime janë të pranueshme. Në prag të ardhjes së Ditës së Kiametit, ndriçimi i yjeve do të zvogëlohet, ata do të bien dhe do të copëtohen. Kështu, pra, sistemi i botës shpërbëhet. Kjo gjë është cituar edhe në ajetet 1-2 të sures "El Infitar": **"Kur qielli të çahet dhe yjet të derdhen."**.

Po ashtu edhe në suren "Murselat", në ajetin 7 thuhet: **"Kur yjet të shuhen."**.

Sa i përket shenjës së tretë të Ringjalljes thotë: **"Malet të lëvizin tutje."**.

Sikurse e kemi cituar edhe më parë nga ajetet e ndryshme të Kur'anit, mund të kuptohet se në prag të ardhjes së Kiametit, malet kalojnë disa faza të ndryshme. Në fillim nisin të lëvizin e në stadin e fundit bëhen pluhur e dhè, si dhe shpërbëhen.[1]

[1] Më tepër informacion, për këtë fakt, do të gjeni në suren "Nebe", në ajetin 20 , në po këtë vëllim.

Për shenjën e katërt shton: **"Kur devetë barrse të braktisen."**

Fjala *"el ishar"* është shumësi i fjalës *"ashrau"*, e cila ka kuptimin e devesë barsë e nga barra e saj kanë kaluar 10 muaj. Tashmë ajo është në prag të pjelljes së saj, që do të thotë se nuk do të kalojë shumë kohë që deveja të pjellë e në gjinjtë e saj do të ketë plot qumësht. Ajo është deveja më e dashur dhe më e shtrenjutë te arabët.

Fjala *"ut'tilet"* vjen nga rrënja *"ta'tijl"*, që ka kuptimin *"braktisje", "një mall pa zot dhe bari"*.

Përdorimi i kësaj fjale ka si qëllim të tregojë se forca e tronditjes dhe e tmerrit të asaj Dite është aq e madhe, saqë çdo njeri do të harrojë gjënë më të shtrenjtë të tij.

I ndjeri Tabarsij, në tefsirin e tij "Mexhmaul Bejan" transmeton: Disa fjalën *"el isharu"* e kanë komentuar me kuptimin *"retë"*. Ndërsa fjalën *"ut'tilet"* e kanë komentuar me kuptimin e *"pushimit të shiut"*, që do të thotë se në atë ditë retë shfaqen në qiell, por nuk do të lëshojnë shi (është e mundur që këto re, për shkak të gazrave të ndryshme, ose për shkak të reve atome ata kthehen në dhè. Në këtë mënyrë ato shpërbëhen. Kështu dhe malet, në prag të Kiametit shpërbëhen dhe retë nuk kanë më shi).

Por sipas Tabarsijut, disa thonë se komentimi i fjalës *"el ishar"*, me kuptimin *"re"* nuk është njohur në fjalorin arab.

Çështja në fjalë është sjellë nga Turejhi në "Mexhmaul Bahrejn". Fjala *"el ishar"*, ka kuptimin *"deve"*, të cilat janë barrse, në muajin e dhjetë. Është e mundur që të ketë edhe kuptimin e reve, sepse edhe retë janë të ngarkuara, edhe pse retë, të cilat do të

shfaqen në faqen e qiellit, në prag të Kiametit, nuk do të jenë të ngarkuara.

Disa, po ashtu, fjalën *"el ishar"* e kanë komentuar me kuptimin e shtëpive ose tokat që mbillen, por në prag të Kiametit, shtëpitë dhe tokat do të mbeten bosh. Nga të gjitha këto komente, komenti i parë është më i njohur.

Në ajetin tjetër, ku flitet për shenjën e pestë, thuhet: **"Egërsirat të tubohen."**.

Ato kafshë, të cilat, në gjendjen e tyre normale, qëndrojnë larg njëra-tjetrës dhe tremben nga njëra-tjetra, gjatë kësaj ngjarjeje të tmerrshme dhe tronditëse, mblidhen rreth njëra-tjetrës dhe harrojnë çdo gjë. Me grumbullimin që bëjnë, duan të përballojnë frikën e tmerrshme të Ditës së Kiametit.

Me fjalë të tjera: Në kohën kur afrohet ajo ngjarje e tmerrshme, veçoritë e ndryshme të kafshëve të egra nuk ekzistojnë më. Po me njeriun çfarë bëhet?!

Shumë komentues, ajetin e mësipërm e kanë komentuar si "tubimin e kafshëve të egra" gjatë gjykimit në Ditën e Kiametit, sepse edhe ato, në botën e tyre, kanë përgjithësitë e tyre. Nëse i kanë bërë keq njëra-tjetrës, aty ato do të gjykohen.

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin 38 të sures "El En'am": **"Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju. Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre."**[1].

[1] Për llogaridhënien te kafshët, kemi folur dhe kemi diskutuar në suren "El En'am" në vazhdim të ajetit 38.

Ajo që mund të thuhet këtu është se, në përputhje me ajetet që po diskutojmë, vërejmë shenjat tronditëse të fundit të botës, si dhe fillimet e një Bote Tjetër. Ndër këto komentime, komentimi i parë është më i përshtatshmi.

Në përshkrimin e shenjës së gjashtë thuhet: **"Kur detet të vlojnë."**.

Fjala "*suxhxhiret*" vjen nga rrënja "*et tesxhijr*", që në origjinal ka kuptimin "*vlim*" dhe të tronditjes së zjarrit. E nëse ky interpretim kur'anor në të kaluarën është dukur i çuditshëm, në ditët e sotme kjo gjë nuk duket aspak e tillë, sepse ne e dimë që uji është i përbërë nga oksigjeni dhe hidrogjeni. Të dy këta përbërës janë të djegshëm. Nuk është e pamundur që në prag të Kiametit, uji i detit të jetë në këtë presion, saqë të dekompozohet e të shndërrohet në zjarr.

Disa këtë fjalë e kanë komentuar me kuptimin "*mbushur plot*". Edhe oxhakut të mbushur plot me zjarr, i thuhet "*musexhxher*". Edhe tërmetet që do të bien në prag të Kiametit dhe që do të shpërbëjnë malet, mund të bëhen shkak i mbushjes së detit, ose në to do të bien gurët e qiellit dhe do të mbushen plot. Edhe ujërat e stuhishëm dhe të zjarrtë derdhen në sipërfaqem e tokës.

Më tej, në shenjën e shtatë shton: **"Dhe shpirtrat të bashkohen** (me trupat)**."**.

Në Ditën e Kiametit, e cila do të jetë dita e ndarjes, këto safe (rreshta) do të jenë të ndara nga njëra-tjetra; të mirët me të mirët, punëkëqijtë më punëkëqijtë, të djathtët me të djathtët. Nëse në këtë botë njerëzit janë të përzier dhe kanë për fqinj një jobesimtar apo një punëmirë ose punëkeq, në Ditën e Kiametit nuk do të jetë kështu, por do të jenë të ndarë.

Në komentim të këtij ajeti është cituar edhe një tjetër mundësi. Në atë Ditë shpirtrat do të kthehen te trupat, ose shpirtrat e Xhennetit do të martohen me hyritë e Xhennetit, shpirtrat e Xhehennemit do të afrohen me shejtanët, ose çdo njeri do të afrohet te miku dhe shoku i tij, pasi vdekja të krijojë ndarjen midis tyre, ose çdo njeri do të jetë afër veprave të tij.

Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Në ajetet 7-11 të sures "Uakia" flitet për dëshminë e tyre: **"Ju,** (o njerëz) **do të ndaheni në tri grupe: njerëzit e së djathtës - sa të nderuar do të jenë fatlumët! Njerëzit e së majtës - sa të poshtëruar do të jenë fatkeqët! Dhe ata që kanë prirë** (në besim) **e që do të prijnë** (edhe në Xhennet)**. Ata janë të afërtit** (tek All'llahu)**."**.

Në të vërtetë, ky ajet vjen pas citimit të gjashtë ndryshimeve të mëdha, të cilat janë parathënie për Ringjalljen dhe tregon për ditën e parë të asaj Dite të Madhe, pra, të asaj dite ku çdokush do të jetë së bashku me llojin dhe sojin e tij.

Më tej flet për shenjën e tetë të ngjarjes së Ringjalljes: **"Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet." "Për çfarë faji ishte vrarë."**.

Fjala *"el meu'udetu"* vjen nga rrënja *"el vu'du"*, që ka kuptimin *"varrosje për së gjalli të vajzës pas lindjes së saj"*. Disa thanë se rrënja e saj është me kuptimin e gravitet dhe rëndesë. Këto vajza i varrosnin të gjalla dhe mbi to hidhnin dhè, ndaj dhe ky interpretim është përdorur për to. Në disa nga transmetimet, përsa i përket komentimit të këtij ajeti, është këshilluar që deri diku ky

interpretim përfshin çfarëdolloj ndërprerje familjare ose ndërprerje të marrëdhënies me Ehli Bejtin *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kur u pyet për komentimin e këtij ajeti, tha: 'Qëllimi është për personat që do të vriten në rrugën e dashurisë dhe të miqësisë sonë.'"*.[1]

Në një tjetër hadith lexojmë: Dëshmi e kësaj fjale është ajeti 23 i sures "Shuara": **"Thuaj: 'Unë nuk kërkoj asnjë shpërblim në këmbim të ftesës suaj për udhëzim, përveç dashurisë ndaj Ehli Bejtit tim.'"**[2]

Sigurisht që komentimi i parë është në përputhje me aparencën e ajetit. Porse koncepti është më i gjerë.

Hulumtim

1- Varrosja e vajzave të gjalla, është një ndër gjërat më të tmerrshme dhe më të dhimbshme që kryhej në epokën e injorancës (Xhahilijetit).

Për varrosjen e gjallë të tyre (el u'du) është folur shumë në Kur'anin e Shenjtë. Shumë besojnë se ky krim nuk ishte i përhapur te të gjitha fiset arabe, por vetëm në fiset Kendetu (ose në disa fise

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 432, Hadithi 7 dhe 11.
[2] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 432, Hadithi 7 dhe 11

të tjera). Në përgjithësi, kjo çështje nuk mund të konsiderohej e rrallë, përndryshe Kur'ani i Shenjtë nuk do ta theksonte këtë fakt në mënyrë të vazhdueshme, ose nuk do të fliste për këtë çështje. Përveç kësaj, kjo punë ishte aq e tmerrshme, saqë episode të tilla duhet të shqyrtohen me shumë saktësi.

Komentuesit thonë se në kohën e injorancës (Xhahilijetit), arabët hapnin një gropë në tokë dhe uleshin sipër saj, kur gratë e tyre ishin në prag të lindjes. Kur gratë e tyre lindnin, ata shikonin seksin e foshnjës. Nëse ishte vajzë, e fusnin të gjallë në varr (e hidhnin në gropën që kishin hapur) e, nëse ishte djalë, e mbanin. Ndaj dhe një prej sloganeve të tyre, që e thoshin me krenari ishte: *"E quajta foshnjën e sapolindur, vajzën, të vdekur, (që do të thotë, vajza vdes e djali jeton). Varri është dhëndri im, që e ka marrë atë (vajzën) dhe e ka lënë të heshtur."*.[1]

Shkaku i fillesës dhe i kryerjes së këtij krimi vjen për arsye të ndryshme. Si për shembull: Gruaja, në kohën e injorancës konsiderohej e pavlerë, pra, shikohej si njeri që nuk mbart vlera në shoqëri.

Një tjetër shkak ishte çështja e varfërisë së madhe, sepse vajzat nuk ishin të afta të siguronin të mira ekonomike, sikurse bënin djemtë. Vajzat nuk ishin pjesëmarrëse në plaçkitje. Po ashtu, kjo varfëri ishte edhe për shkak të luftërave që ekzistonin midis fiseve. Këto vajza mund të ziheshin robëresha dhe kështu ata do të mbeteshin të turpëruar. Këto shkaqe të ndryshme, kur bashkoheshin me njëra-tjetrën, sillnin këtë krim të tmerrshëm, varrosjen për së gjalli të vajzave. Duke shprehur keqardhjen e madhe, kjo çështje, për arsye të problemeve të tjera në kohën e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 444.

injorancës, sot është bërë e ligjshme në shumë vende, të cilët e konsiderojnë veten e tyre të qytetëruar. Nëse arabët këtë gjë e bënin, pasi fëmija të kishte lindur, njerëzit e epokës së ditëve të sotme e bëjnë në barkun e nënës.

Për më tepër, informacion përsa i përket kësaj fushe, mund të shikoni komentimin e ajetit 59, të sures "Neml".

2- Duhet të dini se Kur'ani i Shenjtë e konsideron çështjen e varrosjes për së gjalli të vajzave një akt shumë të pisët dhe të ulët, ndaj dhe për këtë gjë ka reaguar në mënyrë të prerë, duke e konsideruar atë primare në çështjen e dhënies llogari ndaj veprave në Ditën e Kiametit. Kjo tregon rëndësinë dhe vlerën e njeriut në veçanti të femrës sipas fesë islame.

3- Një tjetër pikë, e cila duhet pasur parasysh për këtë çështje është fakti se Kur'ani i Shenjtë nuk thotë do të pyeten vrasësit, përse i kryenin këto vrasje, por do të pyeten ato foshnja të pastra, se cili ishte mëkati i tyre që u varrosen e u vranë pa mëshirë. A thua, vrasësit nuk e kanë as vlerën e të pyeturit, është e mjaftueshëm dëshmia e viktimave.

Ajetet 10 – 14

﴿وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ١٠ وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ١١ وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِّرَتْ١٢ وَإِذَا الْجَنَّةُ أُزْلِفَتْ١٣ عَلِمَتْ نَفْسٌ مَا أَحْضَرَتْ١٤﴾

"Kur fletët të shpërndahen."

"Dhe qielli të zhvishet."

"Kur Xhehennemi të flakërojë."

"Dhe Xhenneti të afrohet."

"Atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë)**."**

Komentimi

Ditën kur njeriu do të shohë ato që ka bërë!!

Në ajetet e kaluara u fol për stadin e parë të Ringjalljes, që është stadi i shembjes së kësaj bote. Në ajetet që vijojnë, do të flasim për stadin e dytë të saj, që është shfaqja e Botës Tjetër, si dhe llogaridhënia për veprat që kemi kryer.

Në fillim thotë: **“Kur fletët të shpërndahen.”**.

Fjala *“es suhufu”* është shumësi i fjalës *“sahijfetun”*, që në origjinal ka kuptimin e diçkaje të përhapur, si për shembull faqja e fytyrës. Më pas i është atribuuar fletushkave dhe letrave, ku është shkruar ndonjë çështje. Shpalosja e fletushkave të veprave në Kiamet është edhe në sy të zotëruesve të tyre, që në këtë mënyrë ata mund të llogarisin dhe mund të gjykojnë vetveten. Kjo gjë është cituar edhe në suren “El Isra”, në ajetin 14: **“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”**

Më tej shton: **“Dhe qielli të zhvishet.”**.

Fjala *“kushitat”* vjen nga rrënja *“el keshtu”*, që sipas Ragibit, në librin “Mufredat”, ka kuptimin *“rrjepje e lëkurës”*. Sipas thënies së Ibn Mandhurit, në librin “Lisanul Arabi”, ka kuptimin *“heqje e perdes nga diçka”*. Përdoret ky interpretim, kur retë të copëtohen dhe të ndahen.

Ndaj dhe qëllimi për këtë ajet që po diskutojmë janë perdet, të cilat janë vendosur mbi këtë botë materiale dhe mbi Botën Tjetër, që është shkak i pengimit të njerëzve për të mos parë engjëjt, Xhennetin, Xhehennemin, të cilat janë në brendësi të kësaj bote. Ata do të kalojnë pranë dhe njerëzit do të shikojnë të vërtetën e universit. Kjo është përshkruar në ajetin e mëpasshëm, ku thuhet së Xhehennemi është ndezur flakë dhe se Xhenneti është afër njerëzve. Dita e Kiametit është dita, ku njerëzit do të shfaqin të vërtetën e gjërave dhe nga qielli do të hiqet perdja.

Në përputhje me këtë komentim, ajeti i mësipërm flet për ngjarjet e stadit të dytë të Ringjalljes, që është stadi i kthimit të

njeriut te jeta e re. Ajetet e mësipërme, si dhe ato të mëposhtmet, flasin për këtë kuptimin, pra, për jetën e Ringjalljes.

Shumë nga komentuesit e kanë komentuar atë me kuptimin e ndërlikimit të qiellit. Pra, aty ku flitet për ngjarjet e stadit të parë, që është konsideruar si shuarja e botës, gjë e cila duket shumë larg kuptimit të fjalës dhe rrënjës *"kushitat"*, e cila nuk është në përputhje me fjalën *"kushitat"* e as me fjalën *"el keshtu"*. Kuptimi i kësaj fjale është *"heqje lëkure"* dhe *"largim perdeje"*. Pra, ai kuptim nuk është në përputhje me rendin e ajeteve, të mësipërme e as me ato të mëposhtme.

Ndaj në ajetin tjetër thotë: **"Kur Xhehennemi të flakërojë."**.

Ky ajet është në përputhje me ajetin 49 të sures "Et Teube": **"Disa prej atyre** (hipokritëve) **thonë: 'Më lejo** (të mungoj në luftë) **dhe mos më vër në sprovë!'. Ja, ata ranë pikërisht në sprovë. Me të vërtetë, Xhehennemi i përfshin mohuesit."**.[1]

Xhehennemi është ekzistues edhe në ditët e sotme, po perdet janë ato që e mbajnë të fshehtë për syrin tonë, po ashtu edhe Xhenneti është gati për punëmirët dhe të devotshmit.[2]

Për këtë arsye edhe në ajetin tjetër thotë: **"Dhe Xhenneti të afrohet."**.

Po ky kuptim është edhe në ajetin 90 të sures "Esh Shu'ara", me të vetmin ndryshim, që në këtë ajet nuk është me emrin e

[1] Sure "Et Teube", ajeti 49.
[2] Sure "Ali Imran", ajeti 133; sure "Hadid", ajeti 21.

"mut'tekin" - *"të devotshmit"*, ndërsa atje është: **"Atë ditë Xhenneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm."**.

Fjala *"uzlifet"* vjen nga rrënja *"zulufun"* dhe *"zulfa"*, që ka kuptimin *"afrim"*, *"afërsi"*. Mund të ketë kuptimin e afërsisë së vendit apo të kohës, ose ka për qëllim të tregojë afrimin e mjeteve dhe kushteve, ose të gjitha këto kanë kuptimin e afrimit të Xhennetit te besimtarët, si nga ana e vendit, ashtu edhe nga ana e kohës. Të gjitha mjetet atje do të jenë të lehta.

Ajo çka vihet re është se ajeti kur'anor nuk thotë: Punëmirët afrohen pranë Xhennetit, por thotë që Xhenneti u afrohet atyre. Ky është interpretimi më i respektuar që mund të bëhet në këtë fushë. Sikurse thamë: Xhenneti dhe Xhehennemi është ekzistues, por në atë ditë Xhenneti është shumë afër, ndërsa Xhehennemi është ndezur flakë.

Si përfundim, ajeti 14 është plotësues i të gjithë ajeteve të kaluara: **"Atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur** (për këtë Ditë)**."**.

Ky interpretim tregon shumë mirë se të gjitha veprat e njeriut atje do të jenë të pranishme. Kjo e vërtetë është parë edhe në ajete të ndryshme të Kur'anit të Shenjtë. Në suren "El Kefh", në ajetin 49 lexojmë: **"...Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar..."**. Dhe në ajetet 7-8 të sures "Ez Zelzele" thuhet: **"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë. E kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."**.

Edhe këto ajete shpjegojnë trupëzimin e veprave në Ditën e Kiametit. Veprat e tona, për të cilat ne mëndojmë se zhduken në

këtë botë, ato nuk zhduken, por në Ditën e Kiametit do të shfaqen në mënyrë të përshtatshme dhe në formë trupi.

Hulumtim

1- Përpushmëria e ajeteve

Në ajetin për të cilin po diskutojmë, si dhe në ajetet e kaluara, është folur për dymbëdhjetë ngjarje që do të shoqërojnë çështjen e Ringjalljes. Gjashtë prej ngjarjeve të para kanë të bëjnë me stadin e parë, që është zhdukja e kësaj bote, ndërsa gjashtë ngjarjet e dyta kanë të bëjnë me stadin e dytë, që është jeta e dytë dhe jeta pas vdekjes.

Në pjesën e parë u fol për errësirën e Diellit, rënien e yjeve, tërmetin dhe lëvizjen e maleve, zjarrin që do të kenë detet, harrimin e mallit dhe të pasurisë, si dhe për frikësimin e kafshëve.

Ndërsa në stadin e dytë flitet për paraqitjen e njeriut në rreshta të ndara, pyeten vajzat e pafajshme, se përse i kanë varrosur të gjalla, hapen fletët e veprave, largohet perdja nga skena e qiellit, ndizet flaka e Xhehennemit, afrohet Xhenneti dhe në fund, njihet njeriu me veprat e tij.

Këto ajete, ndonëse janë të shkurtra, janë me plot kuptim, janë shumë "zhurmuese" dhe e zgjojnë njeriun. Të gjitha këto bëjnë që njeriu të vihet në lëvizje, të mendojë e të arsyetojë për

përfundimin e kësaj bote, për Ringjalljen e njerëzve. Të gjitha këto do t'i shfaqen njeriun në formën e trupit. Ajetet e Kur'anit janë paraqitur shumë bukur dhe janë interpretuar me plot kuptim. Ato janë shumë domethënëse dhe frymëzuese ndaj shenjave dhe shënimeve.

2- A shuhet sistemi i diellit dhe i planetëve?

Më parë duhet të dimë se Dielli, i cili është "ligji" i jetës sonë në këtë sistem, është më i vogël se sa planetet e tjera, por në krahasim me Tokën, ai është jashtëzakonisht i madh. Sipas studimeve që kanë bërë shkencëtarët, vëllimi i Diellit është një milion e treqind mijë herë më i madh se sa i Tokës. Vetëm largësia e tij nga Toka është përafërsisht njëqind e pesëdhjetë milionë kilometra. Për vizualitetin e madhështisë dhe nivelin e Diellit kjo masë është më se e mjaftueshme.

Nëse largësinë që ekziston sot midis Hënës dhe Tokës, do ta vendosim brenda Diellit, Hëna mund të rrotullohet lehtësisht përreth Tokës, pa dalë fare nga niveli i Diellit.

Nxehtësia e Diellit është rritur gjashtë mijë gradë celsius, ndërsa nxehtësia e thellësisë së tij është rritur disa milionë gradë.

Në çdo kohë që duam të dimë peshën e Diellit dhe ta përllogarisim atë në ton, numrin dy duhet ta shkruajmë me njëzet e shtatë zero. Gjatësia e rrezeve të Diellit arrin 160000 km (njëqind e gjashtëdhjetë mijë kilometra). Planeti i Tokës mund të humbasë në mesin e saj me shumë lehtësi, sepse planeti i Tokës nuk është më shumë se dymbëdhjetë mijë kilometër. Burimi i energjisë dhe i

nxehtësisë së ndriçimit të Diellit, në kundërshtim me atë që e përfytyrojnë disa, nuk është shkaktar i djegies. Sipas Xhorxh Gamuf, në librin "Dukja dhe vdekja e Diellit" (Pejdajeshi ve Marg Khorshid), nëse Dielli do të ishte ndërtuar nga thëngjilli i pastër dhe, nëse në kohën e Faraonit të parë të Egjiptit, do t'i ishte vënë flaka, deri në ditët e sotme gjithçka do të ishte djegur e nuk do të mbetej gjë përveç hirit. Po ashtu, nëse supozojmë se të gjitha llojet e materialeve djegëse, në vend të thëngjillit, t'i konsiderojmë gurë, do të kenë po këtë problem. E vërteta është se kuptimi i djegies, përsa i përket Diellit nuk është e vërtetë. Ajo çka e bën të vërtetë atë, është energjia që rezulton nga dekompozimi i atomeve. Ne e dimë se kjo energji është jashtëzakonisht e madhe.

Atomet e Diellit janë gjithmonë në gjendjen e dekompozimit dhe rrezatimi i tij shndërrohet në energji. Sipas përllogaritjes së shkencëtarëve, çdo sekondë që kalon, nga ai zvogëlohen katër milion ton. Por vëllimi i Diellit është aq i madh, saqë me kalimin e mijëra viteve, ai nuk "përkulet". Te ai nuk vihet re as edhe një ndryshim i jashtëm. Por duhet të dihet se po kjo gjendje, përgjatë kalimit të kohës, do të ndihmojë në zhdukjen e Diellit.[1]

Bazuar në ajetin e mësipërm, për errësimin dhe shpërbërjen e Diellit dhe të planeteve, sipas shkencës së ditëve të sotme, është plotësisht e koordinuar. Kur'ani i Shenjtë këtë të vërtetë e ka shpjeguar në një kohë kur jo vetëm Gadishulli Arabik nuk kishte njohuri për këtë çështje, por edhe në vende të tjera.

[1] Marrë nga librat "Pejdajesh ve Merg Khorshd" dhe "Nuxhum bi Teleskop", si dhe "Sakhteman Khorshid".

Ajetet 15 - 25

﴿فَلَا أُقْسِمُ بِالْخُنَّسِ١٥ الْجَوَارِ الْكُنَّسِ١٦ وَاللَّيْلِ إِذَا عَسْعَسَ١٧ وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ١٨ إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ١٩ ذِى قُوَّةٍ عِنْدَ ذِى الْعَرْشِ مَكِينٍ٢٠ مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ٢١ وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ٢٢ وَلَقَدْ رَآهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ٢٣ وَمَا هُوَ عَلَى الْغَيْبِ بِضَنِينٍ٢٤ وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ٢٥﴾

"Betohem për ata (planete) **që tërhiqen."**

"Që lindin e perëndojnë."

"Për natën kur bie terri."

"E për agimin kur nis të zbardhë."

"Se ky (Kuran) **është Fjalë e** (kumtuar prej) **një të Dërguari fisnik."**

"Që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Fronit."

"E që është i respektuar atje dhe besnik."

"Shoku juaj nuk është i marrë."

"Ai e ka parë atë në horizontin e qartë."

"Dhe nuk mbulon asnjë të fshehtë prej së Padukshmes."

"As ky (Kuran) **nuk është fjalë e djallit të mallkuar."**

Komentimi

Kur'anin e solli në i Dërguar fisnik

Pas ajeteve që cituam më lart, të cilat flisnin për Ringjalljen dhe përgatitjen për Ringjalljen, si dhe për një pjesë të ngjarjeve të asaj Dite të Madhe, në këto ajete do të flasim për ligjshmërinë e Kur'anit, si dhe për vërtetësinë e fjalës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajo që ka ardhur në ajetet e mësipërme për çështjen e Ringjalljes, thekson faktin që me citimin e pjesëve të ideve, përmbajtjen e bën më udhërrëfyese.

Në fillim thotë: **"Betohem për ata** (planete) **që tërhiqen."**. [1]**"Që lindin e perëndojnë."**

Fjala *"el khunnes"* është shumësi i fjalës *"khanisun"*, që vjen nga rrënja *"khanese"*, që ka kuptimin *"tkurrje"*, *"kthim"* dhe *"fshehje"*. Për këtë gjë, edhe shejtanit i thuhet *"khun'nas"*, sepse e fsheh veten e tij. Në kohën kur përmendet Emri i All'llahut, tkurret.

Kjo është cituar edhe në hadith: *"Shejtani vazhdimisht i bën robtë e All'llahut me dyshime e në kohën kur kujtojnë All'llahun ai kthehet."*.[2]

Fjala *"el xheuaru"* është shumësi i fjalës *"xharijetun"*, që ka kuptimin *"kalimtar i shpejtë"*.

[1]Në këtë rast shkronja *"la"*, e cila është mohuse në frazën *"la uksimu"*, ose e shtuar, për të theksuar diçka, bën që komentuesit të kenë diskutime. Por meqë, edhe në fillim të sures "Kiamet" kemi diskutuar për këtë gjë, nuk e shohim të nevojshme që të njëjtën gjë ta përsërisim edhe në këtë rast.

[2] "Lisanul Arabi" lënda "khunnes".

Fjala *"el kunnes"* është shumësi i fjalës *"kanisun"*, që vjen nga rrënja *"kenese"*, me kuptimin *"fshehje"*. Fjala *"kinas"* përdoret për foletë e shpendëve, si edhe për shpellat ku fshihen kafshët e egra. Përsa i përket faktit se cili është qëllimi për këto betime, shumë prej komentuesve besojnë se bëhet fjalë për pesë planetet e Sistemit Diellor, që shikohen me sy të lirë, si: Mërkuri, Afërdita, Marsi, Jupiteri dhe Saturni.

Shpjegimi për këtë është: Nëse do të vëzhgojmë qiellin disa net me radhë, do të shikojmë se yjet jo vetëm dalin në grupe, por edhe perëndojnë në grupe, pa patur asnjë lloj ndryshimi në largësi. Ata duken si perla, të cilat janë vendosur mbi një copë të zezë që janë qepur në një largësi të përcaktuar me njëra tjetrën. Nga kjo copë, një pjesë e saj shkon lart dhe një pjesë shkon poshtë. Vetëm pesë planete janë përjashtuar nga ky ligj i përgjithshëm. Ata lëvizin sipër yjeve të tjera dhe duken si pesë perla mbi këtë copë e që qëndrojnë sipër në mënyrë të lirë, duke rënë në shtigjet e tyre!

Këto, pra, janë ato pesë planete që janë pjesë e "familjes" së Sistemit Diellor. Lëvizjet e tyre janë për shkak të afërsisë që kanë me ne. Planetet e tjerë qiellorë do të kishin po të njëjtën lëvizje. Por meqë janë shumë larg nga ne, nuk mund ta ndiejmë lëvizjen e tyre. Nga ana tjetër lëvizjet e tjera nuk janë lëvizje mbi vijën e drejtë dhe duken sikur ata lëvizin për një kohë të gjatë dhe më pas kthehen pak. Ata, përgjatë rrotullimit të tyre, lëvizin dy herë. Për shkaqet e sajë është folur dhe është diskutuar shumë në "Ilmul Hei'et".

Ajetet e mësipërme mund të flasin për këtë gjë: Këto planete janë në lëvizje *(el xheuar)* dhe përgjatë lëvizjes së tyre kanë kthim *(el khunnes)*. Si përfundim, në kohën që zbardhet pak dita në mëngjes dhe Dielli është i fshehur, ngjan me gazelat, të cilat gjatë natës dalin

për të gjetur ushqim nëpër shkretëtirë, ndërsa në kohën që del dita, ato, nga frika e kafshëve të egra, fshihen në (kennes).

Ekziston edhe një tjetër mundësi interpretimi: Ndoshta qëllimi për fjalën (kunnes) ka të bëjë me fshehjen e tyre në rrezet e Diellit. Me këtë kuptim, kur ecën rreth Diellit, ndonjëherë arrihet në një pikë që mund të gjendesh në krah të tij dhe mund të mos dukesh. Shkencëtarët e astronomisë atë e interpretojnë si djegie. Kjo, pra, është një pikë shumë delikate, e cila bëhet e qartë në përputhje me saktësinë e gjendjes së yjeve.

Disa janë të mendimit se fjala *"kunnes"* tregon vendosjen e këtyre planetëve në kullat e qiellit, e cila ka ngjashmëri me fshehjen e gazelave në strofkat e tyre. Por është shumë e qartë se Sistemi Diellor nuk është përjashtuar nga këto pesë planete, sepse janë edhe tre planete të tjera, Urani, Plutoni dhe Neptuni, të cilët mund të shikohen vetëm me dylbi. Së bashku me planetin Tokë formojnë nëntë planetet e Sistemit Diellor.

Shumësi i fjalës *"el xheuarij"* është *"xheuarije"*. Një prej kuptimeve të saj është *"anije në lëvizje"*. Ky interpretim është shumë i këndshëm, sepse ngjan me lëvizjen e planeteve, që janë në qiell, duke i krahasuar ata me anijen që lundron në det.

Megjithatë duke se Kur'ani i Shenjtë me këto betime plot kuptim të cilat janë të përziera me një lloj paqartësie, i vë në lëvizje mendimtarët, në mënyrë që të mendojnë më tepër për çka ka krijuar All'llahu. Në këtë mënyrë ata kanë mundësi të mendojnë e ta njohin më tepër madhështinë e krijimit të kësaj pajisjeje të madhe.

Disa nga komentuesit kanë ofruar komentime të tjera për ajetet e mësipërme, por u pa e udhës që këto komentime të mos citohen.

Në një hadith nga Prijësi i besimtarëve Ali ibn ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ata janë pesë planete: Mërkuri, Afërdita, Marsi, Jupiteri dhe Saturni."*[1]

Për betimin e dytë thotë: **"Për natën kur bie terri."**.

Fjala *"as'as"* vjen nga rrënja *"as'ase"*, që në origjinal ka kuptimin *"errësirë"*, e cila nuk është plotësisht e errët, sepse në kohën kur, sapo nis të errësohet dhe në kohën sapo nis të zbardhë mëngjesi, errësira nuk është e madhe, por është e lehtë. Këtë kuptim e përdorin kur bie nata, ose kur ajo largohet. Ndaj dhe përkufizimi i fjalës *"as'as"* ka të bëjë me të deleguarit e natës. Edhe pse kjo fjali, sikurse e thamë, ka dy kuptime plotësisht të ndryshme, këtu, duke u bazuar në ajetin e mësipërm, flitet për mëngjesin dhe ka për qëllim të tregojë mbarimin e natës. Në të vërtetë, ky betim është i ngjashëm me betimin që është bërë në ajetin 33 të sures "Muddeththir": **"Për natën që largohet.".**

Praktikisht, sikurse e cituam edhe më parë, nata është një nga dhuratat e mëdha hyjnore. Ajo jo vetëm është shkak i qetësisë së shpirtit dhe i trupit, por është edhe shkak i ripërtëritjes së nxehtësisë së diellit dhe i vazhdimësisë së jetës së krijesave. Ndërsa mbështetja te përfundimi i natës mund të jetë, sepse në ato momente nis dita, pra, ndriçohet vendi. Duke i lënë mënjanë të gjitha këto, në atë kohë, pra, afër zbardhjes së ditës, është momenti

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 446.

më i mirë për të adhuruar All'llahun, në ato momente është fillimi i lëvizjes dhe i jetës në këtë botë.

Në ajetin tjetër hasim betimin e tretë: **"Betohem për agimin, kur nis të zbardhë."**.

Sa interpretim të bukur i është bërë mëngjesit! Atë e ka konsideruar si një qenie të gjallë, që frymën e parë e merr me lindjen e diellit dhe të gjithë krijesave u jep shpirt dhe jetë. A thua se fryma e tij është marrë nga "ushtria" e natës dhe me shkëndijën e parë të ditës, lirohen nga thundrat e saj dhe shpirti merr frymë lirisht.

Ky interpretim është i ngjashëm me ajetin 34 të sures "Muddeththir", që pas betimit për natën vjen betimi për agimin: **"Betohem e për agimin që zbardhëllon."**.

A thua se nata është si një perde e errët, që ka rënë mbi fytyrën e agimit dhe në kohën që vjen agimi, largon nga fytyra dy perde. Fytyra e ndritur është shenjë e jetës, që i tregohet botës. Në ajetin 19 flet për betimet që janë bërë: **"Ky** (Kur'an) **është Fjalë e** (kumtuar prej) **një të Dërguari fisnik."**.

Kjo është përgjigje për ata që e akuzonin Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se Kur'ani është i ndërtuar nga vetë ai dhe atë ia ka atribuuar All'llahut.

Në këtë ajet dhe në ajetet e mëposhtme janë cituar pesë përshkrime për Xhebrailin, i cili ka sjellë zbulesën te i Dërguari i All'llahut. Në të vërtetë, këto janë cilësi që për çdo të Dërguar, në fillim, duhet të krijohen kushtet e çdo shoqërie. Në fillim, cilësitë e

All'llahut shprehen me *"Kerim"* - *"Bujari"*. Ekzistenca e të Dërguarit pranë All'llahut është me shumë vlerë dhe me shumë rëndësi.

Më tej flet për cilësi të tjera: **"Zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Fronit."**.[1]

Termi **"Dhil Arshi"** tregon për Qenien e Pastër të All'llahut, edhe pse Ai është pronar i gjithë universit. Arshi, si të ketë kuptimin e përtej universit natyral, si të ketë pozitën e dijes së fshehur të All'llahut, ka një rëndësi të madhe, sepse atë e përshkruan si pronarin e Arshit.

Ndërsa përsa i përket fjalës *"dhi kuvetin"* - *"pposedues (zotërues) i fuqisë"* bëhet fjalë për Xhebrailin, sepse për të marrë një mesazh të madh dhe për ta shqiptuar atë në mënyrë elokuente, me shumë saktësi dhe forcë nevojitet një fuqi shumë e madhe. Në parim, çdo Profet duhet të ketë fuqi për përhapjen e misionit të tij, veçanërisht duhet të jetë përgjegjës nga çfarëdolloj harrese në fushën e mesazhit.

Fjala *"mekijn"* përdoret për një person që ka pozitë. Në thelb duhet të jetë i dërguar, një personalit i madh dhe i përzgjedhur që të marrë përsipër misionin e tij. Ai duhet të jetë i lidhur plotësisht me misionin e tij. Fjala *"inde"*-*"pranë"* nuk ka kuptimin e të qenit

[1] Fjala *"mekin"* vjen nga rrënja *"mekanet"*, që ka kuptimin *"pozitë"*. Sipas Ragibit, në librin "Mufredat" dhe të disa komentuesve të tjerë, kjo rrënjë është emër vendi, që vjen nga rrënja *"kun"* dhe më pas, për shkak të përdorimit që i është bërë shumë herë, atë e kanë marrë si rrënjën e foljes dhe fjala *"temekun"* ka rrjedhur nga ajo, sikurse ka rrjedhur fjala *"temeseken"* nga rrënja *"sekun"*.

pranë, si vend, sepse All'llahu nuk ka vend, por prania e Tij është pozitë dhe afrimitet shpirtëror.

Në përshkrimin e katërt dhe të pestë thuhet: **"Ai është urdhërzbatues dhe besnik!"**

Interpretimi me fjalën *"thum'me"* përdoret për të treguar këtë të vërtetë, që ndërlidh zbulesën e All'llahut me universin e engjëjve, që është depërtues i fjalës, që është bindje. Në përçimin e misionit të tij është më i besueshëm se kurrë.

Nëpërmjet transmetimeve kuptohet se ndonjëherë Xhebraili, për të përçuar ajetet kur'anore, shoqërohej nga një grup i madh engjëjsh. Sigurisht që midis tyre kishte udhëzues. Një i dërguar duhet të jetë udhëzues për ata që e ndjekin.

Në një hadith thuhet: "Në kohën e zbritjes së ajeteve, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Xhebrailit*: "Sa mirë, All'llahu ty të ka lavdëruar, kur të ka thënë: "Xhebraili është i fuqishëm dhe pranë All'llahut, që është pronar i Arshit. Ka fuqi dhe pozitë. Ai është i bindur dhe i besueshëm. Na jep ne një shembull për fuqinë dhe besimin tënd."*.

Xhebraili iu përgjigj: *"Përsa i përket fuqisë sime, po jap një shembull. Unë jam dërguar misionar për zhdukjen e qyteteve të popullit të Lutit. Ishin katër qytete dhe secili qytet kishte katër qind mijë luftëtarë. Përveç fëmijëve të tyre, të gjithë të tjerët unë i mora nga toka dhe i dërgova në qiell. Atje, kur engjëjt e tjerë dëgjuan zërin e kafshëve të tyre, ne i ulëm përsëri në tokë. Ndërsa përsa i përket shembullit të besnikërisë sime, unë*

asnjëherë nuk kam lënë pa kryer urdhrat që më janë dhënë dhe asnjëherë nuk kam bërë as shkeljen më të vogël."[1]

Pas kësaj, ata nuk i pranuan fjalët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke e quajtur të çmendur e duke i thënë shumë e shumë fjalë e shprehje të tjera. Por All'llahu thotë se shoku juaj, Profeti, nuk është i çmendur.

"Është i respektuar atje dhe besnik."

Fjala *"sahib"* ka kuptimin *"shok"* dhe *"shoqërues"*. Përveç kësaj, flet për pozitën dhe përulësinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në lidhje me të gjithë njerëzit.

Profeti i Nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kurrë nuk ka pasur qëllim të ishte më i miri. Ai ka jetuar shumë vite në mesin tuaj dhe po ashtu ishte shok me ju, është njohur nga ju si njeri i besës dhe mbajtës i amanetit, pra, si i atribuoni atij cilësinë e të çmendurit?! Përse e bëtë këtë? Mos vallë vetëm për faktin se ai është përzgjedhur për t'ju udhëzuar, apo, sepse nuk është në një mendje me besimet dhe ndjekjet qorrsokake që keni ju? Ndaj për të përjashtuar veten tuaj nga bindja dhe urdhrat, i atribuuat të tilla gjëra.

Sipas ajetit kur'anor, fjalën *"i çmendur"* e kanë përdorur për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtë cilësi ia kanë bërë armiqtë e pabindur:

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 446. Po kjo përmbajtje ka ardhur edhe në tefsirin tefsiri "El Menthur", në vazhdim të ajetit që po diskutojmë; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 18, f. 170.

"Kështu, sa herë që një i Dërguar vinte te popujt para tyre (mekasve)**, ata thoshin: 'Është magjistar' ose 'Është i çmendur!'."**.[1]

Sipas logjikës së tyre, i mençur është ai person që është i një mendje me ta dhe shkon pas dëshirave dhe epsheve të tyre. Kështu, i Dërguari duhet të ishte larg korrigjimeve dhe ndryshimeve, ndaj ata të gjithë, për gjatë gjithë historisë, e kanë quajtur të Dërguarin e All'llahut të çmendur.

Më tej, për të theksuar lidhjen e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Xhebrailin e besuar, thotë se ai e pa (Xhebrailin) në horizontin lindor.

"Ai e ka parë atë në horizontin e qartë."

Fjala "horizont" tregon horizontin e lartë, ku shikohen engjëjt në mënyrë të qartë. Këtu Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka parë Xhebrailin.

Disa, ajetin 7 të sures "En Nexhm": **"Në horizontin më të lartë.",** e kanë komentuar si dëshmi për këtë tefsir. Por, sikurse e shpjeguam dhe e komentuam në suren "Nexhm", ky ajet, sikurse edhe ajetet e tjera të kësaj sureje flet për një të vërtetë tjetër. Nëse do t'i referohemi asaj, do të qartësohemi. Disa të tjerë, po ashtu, kanë thënë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka parë Xhebrailin dy herë në formën e tij origjinale. Për herë të parë e ka parë në fillim të profetësisë së tij.

[1] Sure "Edh Dhariat", ajeti 52.

Xhebraili iu shfaq Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në horizontin e sipërm, ndërkohë që kishte mbuluar të gjithë lindjen dhe perëndimin. Aq i madh ishte Xhebraili, saqë Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u trondit.

Ndërsa për herë të dytë, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka parë Xhebrailin në qiejt e lartë, kur ishte në Miraxh. Ajeti që po diskutojmë flet për Xhebrailin. Po ashtu, është edhe një mundësi tjetër interpretimi: që qëllimi i të parit është të parit e All'llahun, nëpërmjet shqisave të brendshme.[1]

Më tej shton: **"Nuk mbulon asnjë të fshehtë prej së Padukshmes."**.

Gjithçka ia ka dedikuar robëve të All'llahut. Ai nuk është si të gjithë njerëzit që, kur arrijnë një të vërtetë të rëndësishme, mundohen ta fshehin atë. Zakonisht, edhe për shpjegimin e saj, janë koprracë. Ç'të presësh më tepër nga ata, për të shpjeguar më shumë rreth asaj që kanë zbuluar?!

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është i tillë. Ai, gjithçka që ka marrë nëpërmjet zbulesës, e ka shpjeguar për të gjithë, me gjithë bujarinë e tij. Po ashtu, edhe për ata që e kanë munduar dhe që nuk kanë pasur respekt për të, ai u ka shpjeguar gjithçka, me shpresën se do të udhëzohen e do të marrin Rrugën e Drejtë.

[1]Për më tepër shpjegim, përsa i përket kësaj çështjeje, referojuni Sures "En Nexhm", ajetet 5-13.

Fjala *"danijn"* vjen nga rrënja *"dannetun"*, që ka kuptimin *"koprraci në gjërat personale dhe ato të shtrenjta"*. Ky është një epitet që kurrë nuk ka ekzistuar te Profetët. E nëse të tjerët, për shkak të dijes së kufizuar, e kanë këtë cilësi, Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi ta dhe mbi familjen e tij!)*, i cili e merr dijen nga burimi i pashtershëm i dijes së All'llahut, është larg këtyre cilësive.

Më tej shton: **"As ky** (Kur'an) **nuk është fjalë e djallit të mallkuar."**.

Këto ajete kur'anore, nuk kanë kurrë lidhje me fjalët e priftërinjve, të cilët, nëpërmjet lidhjes së tyre me shejtanët, flisnin në atë mënyrë. Në këtë rast, e vërteta është shumë e qartë, sepse fjalët e priftërinjve ishin të lidhura me gënjeshtrën dhe me gabime të shumta. Gjithçka rrotullohej drejt dëshirave të tyre, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me Kur'anin e Shenjtë.

Në të vërtetë, e gjitha kjo është përgjigje për një nga thashethemet që jobesimtarët ia kishin atribuuar Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata thoshin se Profeti i fesë islame *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është prift dhe ajo çka ai ka sjellë, është prej shejtanit. Por në të vërtetë, fjala e shejtanit është e errët dhe e pa udhë, të çon drejt humbjes, ndërkohë që Kur'ani i Shenjtë është udhëzues dhe plot rrezatim për çdokënd, çdo ajet i Kur'anit është dritë.

Fjala *"rraxhijm"* vjen nga rrënja *"err rrexhm"* *"rrexham"* ka kuptimin *"gur"*. Kur gjuhet me gur, mund të trembësh ndonjë person ose kafshë. Më pas, ai ka marrë kuptime të ndryshme, përsa i përket refuzimit dhe largimit të një diçkaje. Në këtë rast, qëllimi i

përdorimit të fjalës "shejtan raxhijm" ka po këtë kuptim, pra, shejtani është refuzuar nga All'llahu.

Hulumtim

Pesë cilësitë që u cituan në ajetet e mësipërme për "Xhebrailin e besuar", i cili është i Dërguari i All'llahut, Pejgamberi i nderuar i fesë islame *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë cilësi që kanë shumë rëndësi për çdo të Dërguar, nëse marrim në konsideratë rrjedhën e tyre.

Në fillim *"kerameti"* – *"bujaria"* dhe pasja e cilësive më të mira shpirtërore, janë cilësi të rëndësishme për profetësinë e tij.

Pas kësaj thekson fuqinë (Dhi Kuetin), që të mund të përballet në mënyrë të prerë me çdokënd e të jetë larg nga çdo lloj pafuqie dhe dobësie.

Stadi i tretë tregon për pozitën dhe statusin pranë personit që ka pranuar profetësinë, që të mund të marrë më së miri mesazhet dhe ta transmetojë atë pa asnjë lloj frike dhe dyshimi.

Në stadin e katërt, ku urdhri i profetësisë është i rëndësishëm, theksohet prania e asistentit, që ta ndihmojnë atë në këtë punë. Asistenti duhet të jetë i dëgjuar, bashkëpunues me urdhëruesin dhe i bindur.

Në stadin e fundit ai duhet të jetë besnik, në mënyrë që, ata që duan të marrin mesazh prej tij, të kenë besim. Fjala e Profetit duhet të jetë pa asnjë mangësi dhe të konsiderohet e besuar.

Në kohën që këto pesë parime të konsiderohen si të kompletuara, atëherë e drejta e profetësisë është shlyer. Ne shikojmë se gjatë jetës së Profetit të Islamit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Profetëve të tjerë *(Paqja qoftë mbi ta!)* këto cilësi kanë qenë të pranishme te ata.

Një shembull i qartë është në suren "Teube", ku flitet për Prijësin e besimtarëve Ali ibn Ebu Talibin nga ana e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e t!)*, në përcjelljen e ajeteve në fillim të sures "Teube" flet për kushtet e veçanta të jobesimtarve të Mekës *"I Dërguari yt është treguesi i mendjes tënde, letra jote është treguesi i fjalës tënde."*[1]

[1] "Nehxhul Belaga" *Fjalët e urta*, fjala 301.

Ajetet 26 - 29

﴿فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ٢٦ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ٢٧ لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ٢٨ وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ٢٩﴾

"Prandaj, nga po ia mbani?"

"Ai është veçse këshillë për botët."

"Për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë Rrugën e Drejtë."

"Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e All'llahut, Zotit të botëve!"

Komentimi

Ku po shkoni o të shkujdesur?!

Në ajetet e kaluara është qartësuar kjo e vërtetë: Kur'ani i Shenjtë është Fjalë e All'llahut. Përmbajtja e tij tregon se nuk është fjalë e shejtanit, por është fjalë e mëshirës së All'llahut të Madhëruar. Ekziston një lidhje midis Zbulesës së All'llahut

Fuqiplotë dhe Profetit modest dhe zemërmirë. Profeti, në njoftimin e profetësisë nuk është treguar kurrë dorështrënguar. Atë që i është mësuar atij, e ka transmetuar pa hequr dhe pa shtuar asgjë.

Në ajetet 26-29, kundërshtarët, për shkak të mosndjekjes së Fjalës së mëshirës, janë qortuar. Ajeti thotë: **"Prandaj, nga po ia mbani?"**.

Përse e keni braktisur Rrugën e Drejtë? Përse hidhni hapa në vend të pasigurt? Përse i ktheni shpinën kësaj drite dhe shkoni drejt errësirës? A mos vallë jeni armiq të lumturisë dhe të shëndetit tuaj?

Më tej shton se Kur'ani është vetëm këshill për këtë botë: **"Ai është veçse këshillë për botët."**.

Kur'ani i Shenjtë i këshillon të gjithë, i paralajmëron të gjithë që të zgjohen nga gjumi i shpërfilljes.

Për të udhëzuar dhe për të edukuar nuk është i mjaftueshëm vetëm veprimtaria e subjektit, por është kusht që të ketë edhe aftësinë e të pranuarit. Ndërsa në ajetin tjetër shton se Kur'ani është burim zgjimi për ata që duan të ndjekin Rrugën e Drejtë: **"Për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë Rrugën e Drejtë."**.

Ajo çka të bën të kesh vëmendjen në këtë rast, është se ajeti i Kur'anit të Shenjtë thotë: Kur'ani është burim zgjimi për të gjithë botën. Në këtë ajet ai citon vetëm një grup të veçantë, ata që kanë vendosur të pranojnë udhëzimin dhe të ndjekin Rrugën e Drejtë. Ky është, pra, ndryshimi i ajetit të mësipërm. Ai shpjegoi përgjithësimin e kësaj mrekullie hyjnore.

Po ashtu, ky ajet është kushti i përfitimit ndaj kësaj kënaqësie, si dhe i të gjitha kënaqësive dhe dëshirave të kësaj bote, që origjinën e tyre e kanë të përgjithshme. Shfrytëzimi i tyre është i lidhur me vullnetin dhe vendimin e njeriut. E ngjashme me po këtë kuptim është edhe ajeti 2 i sures "El Bekare": **"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."**.

Megjithatë, ky ajet është prej ajeteve që tregojnë se All'llahu e ka krijuar njeriun të lirë dhe se vendimi përfundimtar për të zgjedhur Rrugën e Drejtë apo atë të gabuar e ka vetë në dorë.

Interpretimi i fjalës *"jestekijm"* është interesant, sepse tregon rrugën që duhet të ndjekë njeriu. Rruga e Drejtë është rruga e udhëzimit dhe e lumturisë. Rrugët e tjera janë të gjitha rrugë të humbura. Të gjitha forcat e brendshme dhe të jashtme të njeriut janë kthyer në vullnetarë, që ta udhëzojnë në këtë Rrugë të Drejtë.

Nëse nuk do të ndikohen nga propaganda e shejtanit dhe e të paudhëzuarve, njeriu do të ecë në po këtë Rrugë të Drejtë, sepse rruga më e afërme për të arritur finishin është Rruga e Drejtë.

Për të arritur dhe për të interpretuar këtë vullnet të njeriut mund të krijohet ky iluzion: Njeriu është shumë i lirë dhe nuk ka nevojë të ndjekë Rrugën e All'llahut, ndërsa ajeti tjetër, i cili është dhe ajeti i fundit i kësaj sureje, tregon dhe shpjegon ndikimin dhe vullnetin e All'llahut: **"Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e All'llahut, Zotit të botëve!"**.

Në të vërtetë, tema e këtyre dy ajeteve është çështja delikate sa i përket ekuilibrimit. Nga një anë thotë: "Vendimi për të vendosur është në dorën tuaj.", kurse, nga ana tjetër, thotë: "Nëse

All'llahu nuk dëshiron, nuk mund të merrni asnjë vendim.", që do të thotë se, nëse ju jeni krijuar të lirë, kjo liri dhe mundësi, është nga All'llahu. Ai dëshiron të jeni të tillë.

Njeriu, në veprat e tij, nuk është as i detyruar e as i lirë njëqind për qind, nuk është e drejtë as rruga e "*detyrimit*" - "*xhebrit*" e as rruga e "*lirisë së pakufizuar*" - "*tefvijd*". Gjithçka që ka njeriu, që nga arsyeja, inteligjenca, forca, trupi, pushteti, si dhe vendimmarrja vijnë nga All'llahu. Kjo e vërtetë është ajo që, nga një anë, e bën njeriun të jetë gjithmonë nevojtar dhe, nga ana tjetër, e bën atë të arrijë qëllimin e lirisë dhe të mundësisë për të pasur përgjegjësi.

Grupi emëror "*rab'bul alemin*" tregon vullnetin hyjnor në rrugën e edukimit dhe të zhvillimit të njeriut dhe të gjithë botëve. Ai kurrë nuk dëshiron që ndokush të jetë i paudhë, të mëkatojë apo të jetë larg dashurisë së All'llahut. All'llahu i mbështet të gjithë ata që duan të jenë në Rrugën e Tij.

Është interesante se mbështetësit e rrugës së "*xhebrit*" janë mbështetur vetëm te ajeti i dytë, ndërkohë që mbështetësit e nënshtrimit janë mbështetur te ajeti i parë. Kjo ndarje e ajeteve nga njëri-tjetri zakonisht është paragjykim i padrejtë dhe shërben si burim i humbjes së rrugës. Ajetet kur'anore duhet të vendosen pranë njëri-tjetrit dhe duhet të përfitohet në mënyrë të përgjithshme prej tyre.

Interesante është se një pjesë e komentuesve kanë transmetuar se, kur u shpall ajeti 28 (për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë Rrugën e Drejtë), Ebu Xhehli, i cili ishte ndër ndjekësit e besimit të nënshtrimit tha: "U bë mirë, të gjitha mundësitë janë me

ne, këtu qe zbriti ajeti 29 (Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e All'llahut, Zotit të botëve!).[1]

O All'llah! Dimë se ndjekja e Rrugës së Drejtë nuk arrihet vetëm se me dëshirën Tënde, ndaj na bëj të suksesshëm në këtë Rrugë!

O All'llah! Në kemi dëshirë të udhëzohemi e të ecim në Rrugën e Drejtë! Bëj që me vullnetin Tënd të na udhëzosh në këtë Rrugë!

O All'llah! Skena e Ditës së Kiametit dhe gjykimi i drejtë është shumë tronditës, ndërsa libri i veprave tona është bosh, në të nuk ka asnjë punë të mirë, na bëj vend dhe na mbro, na fal e mos na gjyko me peshën e drejtësisë!

Amin Ja Rabil Alemin.

Përfundimi i sures "Et Tekuir"

[1] "Ruhul Meanij", vëll. 30, f. 62 dhe "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 354.

Sure "El Infitâr"

Zbritur në Mekë

Ajete 19

Përmbajtja e sures "El Infitâr"

Kjo sure, si shumë sure të tjera të xhuzit të fundit të Kur'anit, flet për çështjet e Kiametit. Ajetet e kësaj sureje trajtojnë pesë tematika të ndryshme.

1- Flitet për ngjarje që do të ndodhin në prag të përfundimit të botës dhe në çastin e ardhjes së Kiametit.

2- Flitet për vëmendjen që njeriu duhet t'u kushtojë mirësive të All'llahut, mirësi që përfshijnë të gjithë qenien e tij, si dhe thyerjen e mendjemadhësisë së njeriut për t'u përgatitur për ngjarjen e Ringjalljes.

3- Flitet për engjëjt që janë përgjegjës të regjistrimit të veprave të njeriut.

4- Fati i të mirëve dhe të këqijve në Ditën e Kiametit.

5- Më tej, flitet për një pjesë të vështirësive në atë Ditë të Madhe (Ditën e dhënies së llogarisë).

Mirësitë e leximit të sures "El Infitâr"

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kushdo që i lexon këto dy sure, pra, suren 'El Infitâr' dhe suren 'El Inshikâk' në kohën që fal namazet e detyruara (vaxhib) dhe ato të pëlqyeshme (nafile), nuk do të ketë asnjë perde, që ta ndalojë atë nga All'llahu. Kështu, midis tij dhe All'llahut nuk futet askush. Nëse e vështron këtë sure me (syrin e zemrës), duket sikur vështron All'llahun dhe All'llahu (me mirësinë e Tij) shikon atë që ta lirojë nga llogaria e njerëzve."*.[1]

Pa dyshim që mirësia më e madhe është te qenit pranë All'llahut dhe largimi i perdeve midis njeriut dhe Krijuesit. Këto janë për ata që i mbartin këto dy sure në thellësinë e zemrës dhe e praktikojnë vetveten sipas këtyre sureve. Të mos mjaftohen vetëm me leximin e tyre, por t'i venë në praktikë të gjitha ato që lexojnë.

[1] "Mexhmaul Bejan, "vëll. 10, f. 447 dhe "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 520 (nga libri "Thebabul A'mal").

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ، وَإِذَا الْكَوَاكِبُ انْتَثَرَتْ، وَإِذَا الْبِحَارُ فُجِّرَتْ، وَإِذَا الْقُبُورُ بُعْثِرَتْ، عَلِمَتْ نَفْسٌ مَا قَدَّمَتْ وَأَخَّرَتْ﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Kur qielli të çahet."

"Dhe yjet të derdhen."

"Kur detet të përzihen."

"Dhe varret të rrotullohen."

"Atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe që ka lënë pa bërë."

Komentimi

Në kohën që sistemi i botës të çrregullohet

Në fillim të kësaj sureje hasim një pjesë të ngjarjeve të tmerrshme, që do të ndodhin në prag të Ringjalljes dhe do të përfshijnë të gjithë botën, anekënd.

Në fillim të sures thuhet: **"Kur qielli të çahet."**.

Më tej shton: **"Dhe yjet të derdhen."**.

Sistemi i botës do të çrregullohet dhe do të ketë shpërthime të mëdha, të cilat do të përfshijnë të gjitha planetet qiellore. Jo vetëm planetet do ta humbasin sistemin dhe rregullin e tyre, por edhe yjet do të dalin nga qarku i tyre. Të gjitha këto për shkak të tronditjes së madhe me njëri–tjetrin. Ata copëtohen e kështu jeta e kësaj bote përfundon, duke u shkatërruar gjithçka dhe mbi këtë shkatërrim do të lindë jeta e re e Ahiretit.

Fjala *"infeteret"* vjen nga rrënja e fjalës *"el infitar"* dhe ka kuptimin: *çarje*. Në shume ajete kur'anore është cekur i njëjti kuptim. Pra, është i ngjashëm me kuptimin që cituam më lart. Si shembull do të citojmë suren "El Inshikâk". Në fillim të kësaj sureje thuhet: *"Idhes semaaun feteret"*, ndërsa në ajetin 18 të sures "El Muzzemmil", thuhet: *"Es semaau munfetirun bihi"*.

Fjala *"intetheret"* rrjedh nga rrënja *"en nethru"* dheka kuptimin: *shpërndarje*. Fjala *"el intethar"* ka kuptimin: *u shpërndanë*. Meqenëse shpërndarja e yjeve bëhet shkak që ato të bien në ndonjë qosh apo vend, shumë komentues, e kanë komentuar atë me kuptimin "rënia e yjeve", e cila ka kuptimin edhe të shpërndarjes.

Fjala *"el keuakib"* është shumësi i fjalës *"keukebun"*. Kjo fjalë, në fjalorin arab, ka shumë kuptime, si për shembull: yje, planete, pemët e larta, lulëzimi i pemëve, shkëlqimi i çelikut, adoleshenti i bukur, shpata, uji, drejtuesi i një grupi ose presidenti i një grupi e shumë e shumë kuptime të tjera, përveç këtyre që kemi cituar. Në veçanti, perdja që del te syri quhet *"keukeb"*.

Po ajo çka është konstatuar, është se kuptimi i vërtetë i saj është "yll i shndritshëm". Kuptimet e tjera konsiderohen si virtuale, sepse kanë ngjashmëri me kuptimin e vërtetë të fjalës.

Askush nuk e di të vërtetën e shpërndarjes së yjeve, shpërthimit të planeteve qiellore dhe prishjes së sistemit të tyre, si dhe pse ndodh kjo gjë.

A ka përplasje apo jo? A prishet ekuilibri i forcës së shtytjes dhe i tërheqjes? Apo mbi të mbizotëron një forcë e madhe e mistershme, e cila ndikon fuqishëm te ajo? Apo zgjerimi gradual i botës së sotme, që sipas mendimit të shkencëtarëve, ka arritur kulmin, lidh këtë dukuri?

Në të vërtetë, askush nuk e di se cila është e vërteta. Por ne dimë se qëllimi i përdorimit të ajetit është për të lajmëruar mbi këtë çështje, që planetet e mëdha qiellore do të kenë këtë fat. Detyra e njeriut, në këtë mes, është konsideruar e dobët.

Të gjitha këto janë paralajmërime për njeriun në këtë tokë, e cila do të vdesë. E gjithë kjo është për shkak se njeriu të mos mendojë se ajo është shtëpia e tij e përhershme, të mos tërhiqet shumë pas saj e të mos bëjë mijëra mëkate për shkak të saj.

Më pas nga qielli vjen në tokë: **"Kur detet të përzihen."**.

Edhe pse në ditët e sotme, të gjitha detet mbi tokë (përveç liqeneve) kanë lidhje midis tyre, në prag të Ditës së Kiametit, për shkak të tërmeteve të mëdha, si dhe për shkak të shembjes së maleve dhe rënies së tyre mbi dete, ato do të mbushen plot. Ato do të mbushen aq shumë, saqë uji do të mbulojë të gjitha thatësirat dhe detet do të ngjajnë si oqeane.

Ajetin 6 të sures "Et Tekuir": *"Ue idhal biharu suxh'xhiret"* **kur detet të vlojnë**, e kanë komentuar me këtë kuptim. Ka mundësi që në komentimin e këtij ajeti dhe të ajetit 6 të sures "Et Tekuir" qëllimi i përdorimit të fjalës *"fuxh'xhiret"* dhe *"suxh'xhiret"* është të tregojë po atë shpërthim, që oqeanet do t'i shndërrojë në liqene me zjarr. Sikurse është cituar, uji është i përbërë nga dy elemente, të cilët janë djegëse (oksigjeni dhe hidrogjeni. Nëse uji shpërbehet dhe ndahen dy elemetët e tij, mjafton një shkëndijë e vogël zjarr dhe dy elementë, hidrogjeni dhe oksigjeni marrin flakë.

Më pas flitet për fazën e dytë të Ringjalljes, e cila është periudha e një jete të re jo vetëm e kësaj bote, por edhe e botës së të vdekurve: **"Dhe varret të rrotullohen."**.

Të vdekurit do të dalin nga varret dhe do të bëhen gati për të dhënë llogari.

Fjala *"bu'thiret"* ka kuptimin: *trazim* dhe *shpërndarje*.

Ragibi, në librin "Mufredat", midis të tjerash, thotë se kjo fjalë nuk është e përbërë nga fjalët *"ba'thun"* dhe *"uthijret"* ndaj dhe kuptimin e tyre e ka bashkuar në një fjalë. E ngjashme me fjalën *"bismilah"*, që është e përbërë nga fjalët *"bism"* dhe *"All'llah"*.

Sido që të jetë, ajo çka është paraqitur në ajetin e mëposhtëm, është e ngjashme me suren "Ez Zelzele", ku lexojmë: **"Toka do të nxjerrë jashtë atë çka brenda saj."**.Qëllimi i përdorimit të ajetit është të tregojë të vdekurit e varrosur në tokë. Një nga komentimet e njohura, është ky ajet.

Gjithashtu, ky ajet është i ngjashëm me ajetet 13-14 të sures "En Naziat": **"Por, ajo do të jetë veç një fryrje e vetme** (e Surit) **dhe ata përnjëherësh do të brofin** (të ringjallur)**."**.

Të gjitha këto interpretime tregojnë se Ringjallja dhe dalja e të vdekurve nga varret, do të kryhet në mënyrë të shpejtë dhe të papritur.

Pas citimit të këtyre shenjave, të cilat do të shfaqen përpara dhe pas Ringjalljes, fjalën e fundit e citon në këtë mënyrë: **"Atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe që ka lënë pa bërë."**.

Po, atë ditë, të gjitha perdet do të largohen, por ato perde do të ndahen në mes nga neglizhenca dhe krenaria e kështu e vërteta e botës së zhveshur është e qartë. Që nga ajo ditë, gjithçka është e qartë dhe e dukshme, pra, gjithçka do të jetë e dukshme si kristali. Njeriu do të shikojë të gjitha veprat e tij dhe do të informohet për të mirën dhe për të keqen, do të informohet dhe do të shikojë punët që i ka bërë më parë.

Jo vetëm kaq, por do të shikojë vlerat edhe frytet e punëve që i ka punuar në këtë botë e për të cilat do të kujtohet nga njerëzit. Ato do të jenë punët e mira, pra, mirësitë e tij, të cilat i ka kryer gjatë gjithë jetës së tij. Po ashtu, do të shikohen e do të vlerësohen punët që kanë pasur për qëllim kënaqësinë e All'llahut, do të

shikohen punët që kanë pasur si qëllim gëzimin dhe kënaqësinë e shejtanit.

Pra, sipas vlerave dhe qëllimeve që njeriu ka pasur për punën që ka kryer, do të shpërblehet. Këto janë disa shembuj për të cilat njeriu do të vlerësohet, si për mirësitë e kryerjes së një vepre të mirë, si për mirësitë e shkrimit të një libri. Këto vepra do të ndikojnë në jetën dhe në sjelljen e njerëzve. Këto janë disa shembuj nga veprat, ku rezultati shikohet më vonë dhe shëmbulli i Ahiretit është në ajetin e mësipërm.

Është e vërtetë se njeriu, pak a shumë, është i njohur në përgjithësi me veprat që kryen, por harresa, egoja dhe dashuria për vetveten, bën që shpeshherë të harrojë dhe të mos kujtojë veprat që ka kryer. Por në atë ditë shikohet gjithçka që është përfshirë në revolucion, po ashtu edhe shpirti e zemra e njeriut është e përfshirë në atë revolucion, ku do të marrë informacion për të gjitha veprat që ka kryer në mënyrë të përpiktë.

Gjithashtu, sipas ajetit 30 të sures "Ali Imran", i shikon të gjithë njerëzit pranë vetes: **"**(Kini frikë) **Ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq..."**.

Disa komentues, për këtë ajet, kanë dhënë mendime të ndryshme, si për shembull, punët për të cilat flet ajeti, janë punë dhe vepra që jo vetëm kanë qenë të pranishme në fillimin e jetës, por edhe janë lënë për në fund të jetës së njeriut.

Komentimi dhe interpretimi i parë është më i drejtë. Gjithashtu, qëllimi i përdorimit të fjalës *"nefsun"*, në këtë rast, nënkupton shpirtin e popullsisë njerëzore, pra, në këtë ajet, përfshihen të gjithë njerëzit.

Hulumtim

Veprat që mbeten nga njeriu

Përveç asaj që është cituar në ajetin e mësipërm, ne mund të shikojmë një sërë transmetimesh dhe hadithesh, të cilat mund t'i përdorim më së miri për çështjen e veprave që i mbeten njeriut pas. Njeriu mundet të ketë kryer punë e vepra që zgjasin për jetë, si dhe pas vdekjes së njeriut. Mirësitë e këtyre veprave mund të arrijnë deri në Ditën e Kiametit.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është transmetuar: *"Njeriut, pas vdekjes i mbyllet dosja e veprave. Tek ai nuk arrin më asgjë, as shpërblim, as mirësi, përveçse nëpërmjet tre rrugëve që janë të përbëra nga: a) gjërat e dobishme që janë në shërbim të njerëzve të cilat më pas (mbas vdekjes se njeriut) mbeten si trashëgimi (si spitalet, shkollat, etj.); b)udhëzimi dhe edukimi, të cilin e përcjellin brezat pas vdekjes së tij; c) lutja e fëmijëve të devotshëm për prindërit e tyre."*.[1]

Në një transmetim tjetër janë cituar gjashtë gjëra që u vijnë në ndihmë besimtarëve: fëmijët e devotshëm dhe të mbarë; leximi i Kur'ani; hapja e puseve të ujit; mbjellja e pemëve; sigurimi i ujit, si dhe tradita e pastër që lë pas njeriu dhe që pasohet nga të tjerët.[2]

[1] "Biharul Enuar" vëll. 71, f. 257.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 71, f. 257.

Në disa transmetime është theksuar, gjithashtu, edhe dija që njeriu lë në mesin e njerëzve.[1]

Për sa i përket çështjes së traditës së mirë dhe të pastër, kemi transmetime të ndryshme, transmetime që paralajmërojnë njerëzit të jenë të kujdesshëm, vigjilentë, sepse, për shkak të veprave të tyre, mund të ndryshojë tradita në mesin e njerëzve.

I ndjeri Et Tabarsij, në vazhdim të ajetit për të cilin folëm, transmeton një hadith: "Një ditë, një person, në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ngrit dhe kërkoi ndihmë nga njerëzit. Që të gjithë heshtën. Në këtë çast, një nga as'habët u ngrit dhe i solli diçka për të pirë. Të tjerët e ndoqën atë, duke e ndihmuar me gjëra të tjera.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Ai që lë te të tjerët një traditë të mirë dhe të tjerët e ndjekin atë, kjo gjë, në vetvete, ka shpërblimin e saj. Po ashtu, ata që e ndjekin këtë traditë të mirë, kanë shpërblimin e tyre, shpërblim që nuk shteron. Ndërsa ata që lënë traditë të keqe dhe të tjerët e ndjekin atë, kjo ka mëkatin e saj. Po ashtu, ata që e ndjekin këtë traditë, do të marrin mbi supe mëkatet e tyre, pa u shteruar dhe pa u pakësuar.*". Këtu Hudhejfe lexoi ajetin 5 të sures Infitar: **"Atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe që ka lënë pa bërë".** [2]

Po ashtu, transmetohet nga Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se ka thënë:"*Si do të jeni atëherë, kur të gjitha çështjet të përfundojnë? Atëherë kur varret të përmbysen dhe të gjithë ju të paraqiteni në skenën e Ditës së Gjykimit? Atje është vendi, ku*

[1] "Munijetul Murijd", f. 11.
[2] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 449.

të gjithë do të gjykohen për veprat e tyre. Të gjithë ata do të kthehen tek All'llahu, që është Mbikëqyrësi dhe Ruajtësi i vërtetë i tyre. Ata që i përshkruan All'llahut shok, nuk do e kujtojnë më në mendjet e tyre.".[1]

Këto ajete dhe transmetime të tjera paraqesin përgjegjësinë e njeriut karshi veprave të tij, sipas këndvështrimit të fesë islame. Po ashtu, ato tregojnë se njeriu, deri diku, është përgjegjës për veprat e tij. Ndonjëherë veprat e njeriut gjenden pas qindra vitesh, si dhe shpërblehet për veprën dhe ndikimin e mirë që ka lënë në mesin e njerëzve, ose ndodh e kundërta, që mbi supet e tij rëndojnë mëkatet dhe punët e veprat e këqija.

Për sa i përket këtij fakti, kemi folur në komentimin e Sures "En Nahl".

Ajetet 6 – 12

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbe 226.

﴿يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِيمِ٦ الَّذِى خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ٧ فِى أَيِّ صُورَةٍ مَا شَاءَ رَكَّبَكَ٨ كَلَّا بَلْ تُكَذِّبُونَ بِالدِّينِ٩ وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ١٠ كِرَامًا كَاتِبِينَ١١ يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ١٢﴾

"O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar?!"

"I Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi?1"

"Dhe, që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!"

"Por jo! Ju e quani të gënjeshtërt Gjykimin (pas ringjalljes)**."**

"Ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë)**."**

"Shënues të nderuar."

"Që dinë gjithçka që bëni."

Komentimi

O njeri ç'të bën ty të jesh mendjemadh?!

Ajetet që cituam më lart, flisnin për Ringjalljen, ndërsa ajetet që do të komentojmë tani, flasin për zgjimin e njerëzve nga gjumi i pavëmendjes dhe vëmendjes që njeriu ka ndaj përgjegjësive karshi Krijuesit të tij.

Në fillim, All'llahu i Madhëruar i ka vendosur atij një publik dhe me mirësjellje, duke e zgjuar njeriun, e pyet: **"O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar?!"**.

Në këtë rast, fjala *"insan"* – *"njeri"* është marrë si shembull i njerëzimit. Në këtë term përmblidhen të gjitha privilegjet që ka njeriu mbi krijesat e tjera të kësaj bote, ndaj edhe njeriu është vendosur në rolin e adresuesit. Më tej atë e vendos përballë Zotit, i Cili është Krijuesi i tij bujar, "Rabb".

Duke qenë se Krijuesi e ka mbështetur vazhdimisht njeriun, ka marrë përsipër edhe edukimin, edhe përsosmërinë e tij. Duke qenë se Krijuesi është bujar, njeriun e ka ulur mbi mirësitë dhe mbi të gjitha dhuratat, materiale dhe shpirtërore, pa i kërkuar dhe pa pritur nga ai asnjë gjë në këmbim si shpërblim. All'llahu nuk i vë në dukje gabimet e njeriut, ndaj, me bujarinë e Tij të gjithanshme, i fal ato.

A është e denjë, që një krijesë e tillë të jetë mendjemadhe ndaj një Krijuesi të tillë? Ose për një çast, të harrojë, të përhumbet dhe të mos e zbatojë urdhrin e një mbrojtësi të tillë. Në hadithin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) thuhet: "*Kur recitoi këtë ajet, tha: 'Padituria dhe injoranca e ka bërë njeriun të jetë i pavëmendshëm.'*"[1]

Këtu bëhet e qartë se qëllimi është i tillë që, duke u mbështetur te çështja e atributit dhe mirësisë së Zotit, që kontrollon dhe ushqen universin, si dhe te bujaria e Tij, bën që mendjemadhësia, pavëmendshmëria dhe neglizhimi i njeriut të thyhet. Në mënyrë të tillë që disa menduan se qëllimi i indoktrinimit të njeriut në tokë, është kërkimi i ndjesës dhe në përgjigje të tij të thotë: "mirësia mua më ka bërë mendjemadh".

Fadijl ibn Ajadh ka transmetuar: "E pyetën: 'Nëse në Ditën e Kiametit, Zoti do të të thërrasë e do të të pyesë ty: **"...ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar?!",** ti si do t'i përgjigjesh?'

- Do t'i përgjigjem kështu: 'Perdet që kisha hedhur përmbi mëkatet e mia, mua më bënë të pavëmendshëm dhe mendjemadh, - tha ai.".

Kjo fjali nuk është në përputhje me kuptimin e ajetit, por, në krahun e kundërt, ajo është e vendosur përballë vargut kryesor. Ajo ka për qëllim thyerjen e mendjemadhësisë dhe zgjimin nga gjumi i neglizhencës dhe nuk ka për qëllim hedhjen e perdes së re mbi perden e neglizhencës.

Si rezultat, nuk është e denjë që ajetin ta largojmë nga qëllimi që ka dhe të marrim rezultatin nga ana e kundërt e tij.

Fjala "*gar'reke*" vjen nga fjala "*el gurur*", që në origjinal, ka kuptimin: *neglizhencë në kohën e zgjimit, mashtrim*. Sipas një

[1] "Mexhmaul Bejan", vëllimi 10, f. 449. Po ky hadith është i cituar edhe në tefsiret: "Durr'rrul Menthur", "Ruhul Bejan", "Ruhul Meanij" dhe "Kurtubij"e ka cituar në vazhdim të ajetit që cituam.

interpretimi tjetër, ka kuptimin e neglizhencës në një vend, ku njeriu nuk duhet të jetë neglizhent. Për shkak se fjala *"neglizhencë"*, në disa raste, është edhe burim i kokëkrisjes ose i mendjemadhësisë, edhe në këtë rast fjala "*gurur*" – "*mendjemadhësi*" është komentuar me po këtë kuptim, sepse edhe shejtani ka këtë emër, pasi *"gurur"* – *"mendjemadhësia"* vjen nga ai, sepse ai i bën njerëzit neglizhentë dhe mendjemëdhenj, duke i gënjyer me veset e tyre.

Për fjalën *"kerijm"* janë dhënë interpretime të ndryshme, si për shembull: disa thonë se fjala *"kerijm"* – *"bujar"* përfshin atë person që të gjitha veprat e tij janë mirësi dhe kurrë nuk kërkon të përfitojë nga bujaria e Zotit.

Disa thanë se fjala *"kerijm"* i përket atij që është bujar me atë që ka dhe fal atë që nuk është e nevojshme.

Disa thanë se *"kerijm"* – *"bujar"* është ai që pranon edhe gjënë më të vogël dhe, në këmbim të saj, jep një çmim shumë të madh. Por në të vërtetë, të gjitha këto sa u thanë për fjalën *"kerijm"* – *"bujar"*, nëse do të merret parasysh Madhështia e All'llahut, sikurse është bujaria e Tij, nuk janë të mjaftueshme, për ta përshkruar si duhet. Por për sa i përket bujarisë së All'llahut, është e mjaftueshme të kujtohet mëshira e Tij e pakufishme, ndërkohë që mëkatari nuk kënaqet me kaq, por mëkatet (për ata që e meritojnë) Ai i kthen në mirësi.

Prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, në komentim të këtij ajeti, midis të tjerash, thotë: "*Ky ajet është argumenti më i goditur për ata që e dëgjojnë dhe është shfajësimi më i*

vendosur përballë personave mendjemëdhenj dhe atyre personave që injorancën dhe padituriné e konsiderojnë guxim dhe arrogancë.

O njeri! Çfarë të bën ty që të kesh guxim ndaj mëkateve? Ç'të shtyn, që të jesh i kënaqur, kur shkatërron vetveten? A nuk është e kotë kjo sëmundje?

Po ky gjumë, a nuk të shtyn të zgjohesh? Përse, të paktën, për aq sa ke mëshirë për të tjerët, ki mëshirë për veten tënde? Ti sa herë që shikon dikë në rrezet e diellit përvëlues, i bën hije. Sa herë që shikon të sëmurë, që nuk i durojnë dhimbjet, ti qan për ta nga dhembshuria. Pra ç'të bën ty, që të jesh i durueshëm me sëmundjen e ç'të bën ty të jesh i duruar ndaj mëkateve, ndonëse je dorëzuar për të qarë për veten, ndërkohë që njeriu më i dashur pranë teje është vetja? Si nuk zgjohesh nga frika natën, se mos ndoshta të vjen ndonjë e keqe, edhe pse je në mëshirë të fatit dhe jeton nën mbretërinë e Tij?

Eja, me ilaçin e vendimit dhe të vendosmërisë për të kuruar veten, shëroje sëmundjen e neglizhencës ndaj All'llahut. Largoje nga vetja gjumin e neglizhencës, gjumin që t'i ka mbyllur sytë! Eja dhe bindju All'llahut! Afrohu tek Ai! Mendoje mirë kohën, kur ti neglizhon All'llahun. Ndonëse ti neglizhon, Ai përsëri ty të fal plot mirësi. Ai të thërret, duke të vendosur nën petkun e mëshirës dhe të mirësive të Tij, ndërkohë që ti, o njeri, i ke kthyer shpinën Atij dhe je drejtuar diku tjetër. I madh është Zoti, i cili me mirësinë dhe fuqinë e Tij, është bujar. Ndërsa ti o njeri, me mangësitë dhe dobësinë tënde, sa shumë guxon të mëkatosh!"[1]

Më tej, pasi flet për mënyrën e zgjimit të njerëzve, flet për bujarinë dhe mirësinë e Zotit, duke e ndarë atë në katër stade.

[1] "Nehxhul Belaga", fjalimi, 223.

All'llahu thotë: **"Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!"**.

Kështu shpjegohen katër mënyrat apo stadet e krijimit, pra, të krijimit kryesor e më tej sistemimi. Pas sistemimit, me ajete të shkurtra, por shumë kuptimplota, sqarohet mënyra e vendosjes së gjithçkaje.

Në stadin e parë paraqitet origjina dhe gjëja më kryesore e krijimit, duke sqaruar se njeriu është krijuar nga një lëng që nuk ka asnjë vlerë e që qëndron në mitrën e nënës.

Më tej shpjegon se vjen stadi i sistemimit. Çdo pjesë e tij vendoset në vendin e caktuar, në një mënyrë shumë të saktë. Nëse e vështrojmë njeriun se si është ndërtuar, duke marrë një e nga një gjymtyrët e tij, do të shikojmë përkëdheljet dhe mirësitë Hyjnore në çdo njërën prej gjymtyrëve. Aty do të shikojmë fuqinë, bujarinë e shumë e shumë mirësi të tjera, që na janë dhuruar nga Zoti.

Aty shfaqen mrekulli që ndiqen nga shkencëtarët prej qindra vitesh. Kur pyeten për këto mrekulli, ata thonë se akoma janë në fillim të fletores.

Më tej flitet për stadin e tretë. Në këtë stad, radhën e kanë mirësitë që janë të mirëmenduara dhe të harmonizuara me njëra–tjetrën, sikurse është ekuilibri midis gjymtyrëve të trupit dhe marrëdhënia e tyre me njëra-tjetrën.

Trupi i njeriut, qëllimisht, është ndërtuar në dy pjesë. Këto dy pjesë janë në simetri me njëra–tjetrën. Duart dhe këmbët, sytë dhe veshët, kocka dhe skeleti i trupit, nervat dhe muskujt etj, të

gjitha këto janë në dy pjesët e trupit, si dhe janë në proporcion dhe plotësues të njëri-tjetrit.

Përveç këtyre, gjenden pjesë dhe gjymtyrë të tjera që janë plotësues të njëra tjetrës, si për shembull, aparati i frymëmarrjes që ndihmon në qarkullimin e gjakut. Për të përtypur një kafshatë ushqim, janë të nevojshëm dhëmbët, gjuha, gjëndrat e pështymës, si dhe muskujt përreth gojës, po ashtu edhe gryka. Të gjitha këto bëjnë që ajo kafshatë të përtypet lehtë.

Nga këtu e më tej harmonizohen edhe shumë gjëra të tjera, që ushqimi të përtypet dhe trupi ta pranojë atë. Të gjitha këto bëjnë që trupi të ketë fuqinë e nevojshme për t'u përpjekur dhe për të lëvizur. Të gjitha këto që ne thamë, janë të përshkruara në një fjalë, e cila është *"fe addeleke"*.

Disa, këtë fjalë e kanë përshkruar me atë që njeriu është i drejtë në mesin e llojeve të kafshëve. Gjë e cila konsiderohet si virtyt për njeriun. Ky kuptim është më i lidhur dhe më i përputhur me stadet që do vijnë, ndërsa kuptimi i mëparshëm është më i përmbledhur.

Po, Zoti e ka dalluar njeriun nga krijesat e tjera, sikurse janë kafshët dhe gjallesat e tjera. Njeriu ka një natyrë të zgjuar, si dhe është i gatshëm të pranojnë çfarëdolloj dije dhe ta mësojë atë.

Një tjetër ndryshim është se fytyrat e njerëzve janë të ndryshme, sikurse është thënë edhe në ajetin 22 të sures "Er Rrum": **"Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave** (racave) **tuaja..."**.

Përveç kësaj, njeriu ka edhe ndryshimet e jashtme, të cilat nuk janë vetëm në paraqitje, por janë edhe në fuqi, shije etj. Të gjitha këto, në vetvete, kanë mirësinë e tyre, që shoqëria të vijë e shëndetshme dhe të sigurojë të gjitha nevojat që ka, kështu paraqitja e jashtme dhe e brendshme e njeriut të jetë plotësuesi i njëri-tjetrit.

Si përfundim, mund të citojmë ajetin 4 të sures "Et Tin": **"Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer."**.

Me pak fjalë, në këto ajete dhe në shumë ajete të tjera të Kur'anit, All'llahu, këtë njeri mendjemadh dhe harrues, e detyron veten në mistikë, që nga fillesa e krijimit të tij në mitrën e nënës e deri në momentin e lindjes së tij.

Që aty e më tej, Zoti e vëzhgon njeriun me shumë saktësi, derisa të zhvillohet plotësisht. Më tej Zoti kontrollon që njeriu, në çdo hap dhe në çdo çast, të furnizohet me mirësi të reja. Kështu, njeriu, duke pasur të gjitha këto mirësi, nuk do të përhumbet në neglizhencën e tij, por do të jetë më falënderues dhe do të mbajë përgjegjësitë që i takojnë mbi supet e tij.

Kur'ani flet se kush është arsyeja dhe shtysa e gjithë kësaj neglizhence: **"Por jo! Ju e quani të gënjeshtërt Gjykimin** (pas ringjalljes)**."**.

Pra, çështja e neglizhencës nuk është mirësia që All'llahu ju ka dhënë njerëzve e as nuk është bujaria e Tij, por një tjetër gjë shumë e rëndësishme, që është mosbesimi i njerëzve në Ditën e

Kiametit, në Ditën e Ringjalljes. Njerëzit duhet të mendojnë për këtë ditë, Ditën e Ringjalljes.[1]

Nëse i vështrojmë njerëzit me shumë saktësi, shikojmë që njerëzit mohues dhe neglizhentë, thellë në shpirtin e tyre, në shumicën e rasteve, dyshojnë dhe e mohojnë Kiametin. Në zemrat e tyre ka zënë rrënjë frika. Shkaqet e tjera apo më mirë pretekstet e tjera që ata paraqesin, nuk janë argument për atë që thonë. Nëse themeli i besimit do të forcohej, kjo neglizhencë dhe mendjemadhësi nuk do të ekzistonte, por do të zhdukej.

Qëllimi i përdorimit të fjalës *"ed dijn"*, në këtë rast, ka të bëjë me dënimin dhe Ditën e dhënies së llogarisë. Disa janë të mendimit se fjala *"ed dijn"* përfshin fenë islame. Ky mendim nuk rezulton si argument i drejtë, sepse boshti i fjalimit, në këtë rast, është cituar në ajetin e mësipërm.

Më pas, për të larguar shkaqet e mendjemadhësisë dhe të neglizhencës, si dhe për të përforcuar besimin në Ditën e Ringjalljes, thotë: **"Ndonëse mbi ju ka rojtarë** (që ju vëzhgojnë)**."**.

Rojtarët që ju vëzhgojnë dhe ju ruajnë ju, kanë një pozitë të lartë pranë All'llahut. Ata janë ruajtësit që shënojnë veprat tuaja: **"Shënues të nderuar."**.

[1] Fjala *"kel'la"*, në këtë rast, është mohuese dhe përdoret për të mohuar një diskutim që është cituar apo është përmendur më parë. Në këtë rast, fjala *"kel'la"* mohon atë çka është përmendur më lart, gjithnjë sipas komentuesve. Pra, fjala *"kel'la"*, mohon të gjitha burimet e mendjemadhësisë dhe të neglizhencës, duke thënë se e gjithë kjo neglizhencë vjen si pasojë e besimit të dobët. Edhe Ragibi, në librin e tij "Mufredat", jep këtë variant për shpjegimin e fjalës *"kel'la"*.

Ata janë në dijeni për gjithçka që ju veproni. Ata dinë shumë mirë gjithçka: **"Dinë gjithçka që bëni."**.

Në këtë rast *"el hafidhijn"* janë engjëjt që janë caktuar të mbrojnë dhe të ruajnë veprat e njerëzve, si veprat e mira, ashtu edhe veprat e këqija. Këto vepra, në ajetin 18 të sures "Kaf" janë interpretuar me fjalët *"rakijb"* dhe *"atijd"*: **"Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm** (për ta shënuar atë)**."**.

Njeriu nuk mund të flasë apo të kryejë një veprim dhe që pranë tij të mos ndodhet engjëlli që është kujdestar i tij dhe është caktuar për të kryer detyrën e tij.

Në po këtë sure, në ajetin më sipër, thotë:**"Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta."**.

Kujtoni kohën kur dy engjëj, në krahun e djathtë dhe të majtë kujdesen për ju dhe shkruajnë veprat tuaja.

Gjithashtu, edhe në disa ajete të tjera, është folur për engjëjt që janë mbikëqyrësit e veprave tona. Padyshim që All'llahu, para çdokujt dhe më mirë se çdokush, është dëshmitar dhe vëzhgues i veprave tona. Por, për ta theksuar më tepër ndjenjën e përgjegjësisë së madhe, ka vendosur kujdestar të shumtë, që një grup prej tyre janë këto engjëj. Përveç këtyre ka edhe kujdestarë të tjerë, të cilët kanë mbuluar çdo pjesë. Shumica e tyre janë nën mbikëqyrjen e dëshmitarëve në Ditën e Kiametit. Këtë çështje e kemi cituar në shtat pjesë, në vazhdim të ajeteve 20-21 të sures "Fussilet". Këtu po përcjellim në formë të përgjithshme shatë pjesët:

E para: Në fillim, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kur'ani dhe**

çfarëdo pune që të bëni (o njerëz)**, Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të...”**.[1]

E dyta: Mbikëqyrësit e tjerë janë Profetët dhe pasardhësit: **“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty** (o Muhammed!) **për dëshmitar mbi të gjithë ata?!”**.[2]

E treta: Më pas vijnë duart, gjuha, këmbët dhe të gjitha gjymtyrët e trupit të njeriut:**“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.”**.[3]

E katërta: Mbikëqyrësi i katërt në radhë është lëkura e njeriut, veshi i tij dhe syri i tij: **“Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.”**.[4]

E Pesta: janë engjëjt:**“Çdo shpirt do të vijë i shoqëruar me një** (engjëll) **grahës dhe një** (engjëll) **dëshmitar.”**.[5]

E gjashta: Më pas vjen toka, ku njeriu ka jetuar, ku është bindur dhe ku ka kryer mëkate: **“Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj.”**.[6]

E Shtata: është koha. Ajo do të flasë, kur janë kryer veprat. Transmetohet nga imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se ka thënë:

[1] Sure “Junus”, ajeti 61.
[2] Sure “En Nisâ”, ajeti 41.
[3] Sure “En Nûr”, ajeti 24
[4] Sure “Fussilet”, ajeti 20.
[5] Sure “Kaf”, ajeti 21 dhe ajeti për të cilin po diskutojmë.
[6] Sure “Ez Zelzele”, ajeti 4.

"Kur vjen një ditë e re ajo i thotë njeriut: O biri i Ademit! Unë jamë një ditë e re dhe do të jem dëshmitare për ty."[1]

Në librin "Ihtixhaxhul Tabarsij" shkruhet se një person e pyeti Imam Sadikun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se cili ishte shkaku i ekzistencës së engjëjve kujdestarë, të cilët mbajnë shënim veprat e njerëzve. Ndërkohë që Zotit të gjithësisë nuk i fshihet asgjë. Ai di çdo gjë që mund të jetë e fshehtë.

Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* iu përgjigj: *"Zoti, këta engjëj, i ka ftuar që ta adhurojnë Atë. Ata i ka caktuar si dëshmitarë për robtë, që robtë, për hir të përkujdesjes së engjëjve, të jenë më të kujdesshëm për t'iu bindur Zotit, kështu ata do t'i largohen mëkatit ndaj Tij. Ka plot robër të Zotit, të cilët nisen të kryejnë një mëkat e, kur kujtohen se në krahët e tyre gjenden dy engjëj, të cilët shkruajnë veprat e tyre, i largohen mëkatit, duke thënë: 'Zoti më shikon mua dhe engjëjt, të cilët janë kujdestarët e veprave, do të dëshmojnë.' Përveç kësaj, All'llahu, me mëshirën e Tij, i ka caktuar përgjegjës të robëve, që nëpërmjet urdhrit të Zotit, ata të largojnë shejtanin nga ata, si dhe kafshët, që janë në tokë, si dhe ngjarjet të shumta që njerëzit nuk i shikojnë, derisa të vijë urdhri i All'llahut dhe ata të vdesin."*.[2]

Nga ky transmetim mund të kuptohet fare mirë se ata, janë caktuar të jenë përgjegjës për të regjistruar veprat dhe për të ruajtur njerëzit nga ngjarje të pakëndëshme, si dhe nga dëmtuesit dhe vesveset e shejtanit.[3]

---

[1] "Sefinetul Bihar", vëll. 2, çështja "Jeum"

[2] "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 522; "Biharul Enuar", vëll. 5, f. 323, (me pak ndryshim).

[3] Për detyrat e ndryshme të engjëjve dhe kujdestarinë e tyre, është dhënë një shpjegim më i gjerë në komentimin e ajetit 1 të sures "Fatir" po në këtë komentim.

Ajetet e mësipërme, duke shpjeguar engjëjt, thonë se ata kanë një pozitë të lartë pranë Zotit, që njerëzit të jenë më të kujdesshëm ndaj veprave që kryejnë, sepse sa më shumë mbikëqyrës me pozitë të ketë përmbi veprat e njeriut, aq më shumë njeriu do të kujdeset për veprat e tij dhe, nëse do të mëkatojë, aq më shumë do të turpërohet.

Fjala *"katibijn"*, tregon se ata nuk mjaftohen me faktin e të mbajturit mend të një diçkaje, por e shkruajnë dhe e regjistrojnë atë me saktësi. Kështu, në këtë mënyrë, atyre nuk u ikën asgjë, sepse ata regjistrojnë, si të madhen, ashtu edhe të voglën.

Fjalia: **"Ata e dinë atë që kryejnë"**, përsëri thekson edhe një herë se ky realitet, pra, mbajtja shënim e të gjitha veprave tona, pa asnjë përjashtim, është ekzistente, ndaj edhe ata janë në dijeni të veprave tona.

Po ashtu, të gjitha këto interpretime, janë shpjegues për lirinë dhe vullnetin e lirë të njeriut, sepse, nëse njeriu nuk do të ketë lirinë e tij, atëherë të gjitha këto regjistrime të veprave të njeriut, nuk do të ishin të drejta dhe nuk do të kishin asnjë kuptim.

Por, nga ana tjetër, të gjitha këto tregojnë se çështja e dhënies së llogarisë është çështje shumë e vështirë dhe serioze, sepse vetë All'llahu, kësaj çështje, i ka kushtuar një rëndësi të jashtëzakonshme.

Është e mjaftueshme vëmendja ndaj kësaj çështje, sepse ajo e edukon njeriun për t'u njohur me përgjegjësitë e tij, si dhe ndikon jashtëzakonisht mbi veprat që janë në kundërshtim me të.

Hulumtim

Kujdestarët e regjistrimit të veprave

Jo vetëm në ajetet e mësipërme, por edhe në shumë ajete të tjera dhe në shumë transmetime është cituar se All'llahu ka caktuar kujdestar për çdo njeri, të cilët kujdesën për veprat e njerëzve, si për veprat e mira, ashtu edhe për veprat e këqija. Në këtë mënyrë, bëhet gati libri, me të gjitha veprat që njeriu ka kryer, për Ditën e dhënies së llogarisë.

Për sa u përket cilësive të këtyre engjëjve, janë cituar interpretime me shumë kuptim, të cilat e zgjojnë njeriun. Dikush e pyet Imam Musa ibn Xhaferrin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Dy engjëjt që janë caktuar për të shkruar veprat e njeriut, a janë në dijeni edhe për nijetin e mirë dhe të keq të njeriut?"

Imami *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i përgjigjet: "*A është e njëjtë era e një pusi me ujë të pastër, me atë të parfumit?*"

Ai tha: "Jo!"

Imami *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* tha: "*Kur njeriu të ketë nijetin për të bërë një punë të mirë, fryma e tij, ka aromë të mirë dhe engjëlli që i qëndron në krahun e djathë të tij, që është caktuar të shkruajë të mirat e tij, i thotë engjëllit të krahut të majtë: 'Ngrihu, sepse ky njeri ka vendosur të kryejë një punë të mirë.' Kur ai e kryen atë, gjuha e këtij njeriu bëhet lapsi i engjëllit, pështyma e tij bëhet bojë e lapsit. Në këtë mënyrë regjistrohen veprat. Por, kur njeriu ka për qëllim të kryejë një mëkat, nga goja e tij vjen erë e keqe. Engjëlli i krahut të majtë i thotë engjëllit të krahut*

të djathtë: 'Ngrihu, sepse ky njeri ka për qëllim të bëjë mëkat.' Kur e kryen mëkatin, gjuha e tij bëhet laps dhe pështyma bojë. Kështu shkruan mëkatin.".[1]

Ky hadith tregon më së miri se nijeti i njeriu ndikon te e gjithë qenia e tij dhe engjëjt janë në dijeni për sekretet të brendshme të njeriut. Po të mos ishte kështu, ata, sigurisht që nuk do të mund t'i shkruanin veprat e tyre.

Duhet të dihet se, sikurse nijeti i pastër ndikon në vlerësimin e njeriut, ashtu edhe nijeti i keq ndikon jashtëzakonisht.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në një hadith të njohur, thotë:"*Veprat kanë lidhje me nijetet që ju keni."*.[2]

Diçka tjetër na bëhet e qartë, se gjuha jonë bëhet penë dhe pështyma jonë bëhet bojë për engjëjt.

Ata janë urdhëruar që, kur një njeri të ketë nijet për të bërë një punë të mirë, ta regjistrojnë si mirësi, por në momentin që e kryen atë punë të mirë, njeriut i shkruhen dhjetë mirësi. Ndërsa kur njeriu bën nijet të bëjë një punë të keqe, për sa kohë nuk e ka kryer atë, për të nuk shkruhet asgjë. Por në momentin që njeriu e kryen mëkatin, atij i shkruhet.[3]

Ky interpretim është shpjegues i mëshirës së Zotit ndaj njerëzve që nijetin e mëkatit e fal për njeriun, ndërsa për kryerjen e mëkatit, Zoti jep dënimin sipas rregullave të drejtësisë. Për sa i

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu, "Men Jehemmu bil hasenati eu sejjiati", Hadithi 3.
[2] "Uesailu Shiia", vëll. 6, f. 5, botim i "Ehli Bejtit".
[3] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu, "Men Jehemmu bil hasenati eu sejjiati", Hadithet 1- 2.

përket rrugës së bindjes, çdo nijet është mirësi dhe për çdo punë të mirë e shpërblen sipas punëve të mira dhe jo sipas rregullit të drejtësisë. Kjo gjë është shtysë dhe nxitje për të kryer punë të mira.

Në një hadith tjetër, thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi flet për ekzistencën e këtyre dy engjëjve, regjistrimin e mirësive me shpërblimin e dhjetë mirësive, thotë: "*Kur njeriu kryen një punë të keqe, engjëlli i krahut të djathtë i thotë engjëllit të krahut të majtë: 'Mos nxito për ta shkruar këtë mëkat, ndoshta do të bëjë ndonjë punë të mirë pas kësaj që ka bërë e mëkati i tij të mbulohet. Kur njeriu pendohet, mëkati falet, sepse engjëjt nuk e shkruajnë mëkatin për shtatë orë. Nëse për këto shtatë orë, njeriu nuk pendohet dhe nuk kryen një vepër të mirë, engjëlli i krahut të djathë i thotë engjëllit të krahut të majtë ta shkruajë mëkatin që ka bërë ky mjeran fatkeq*".[1]

Në një tjetër hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: "*Kur besimtarët duan të flasin me njëri-tjetrin diçka personale, mbrojtësit e veprave, i thonë njëri-tjetrit të largohen nga ata, se ndoshta kanë ndonjë sekret që Zoti ua ka mbuluar.*"[2]

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në njërën nga hytbet e tij, ku i fton njerëzit për devotshmëri, thotë: "*Dijeni, o robtë e Zotit, se për ju janë vendosur mbikëqyrës. Ata qëndrojnë në trupin tuaj. Dijeni, ata janë llogaritësit e drejtë, do të regjistrojnë veprat tuaja. Po ashtu, ata mbajnë të shënuar edhe numrin e frymëmarrjeve tuaja. Ju nuk mund të fshiheni nga ata, as në errësirën e natës dhe as nga dyert e forta, e nesërmja është afër.*"[3]

---

[1] Po aty, Hadithi 4.
[2] "Usulul Kafij", vëll. 2, Hadithi 2, f. 184; "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 110.
[3] "Nehxhul Belaga", Hytbe 157.

Ajetet 13 – 19

﴿إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ١٣ وَإِنَّ الْفُجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ١٤ يَصْلَوْنَهَا يَوْمَ الدِّينِ١٥ وَمَا هُمْ عَنْهَا بِغَائِبِينَ١٦ وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمُ الدِّينِ١٧ ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمُ الدِّينِ١٨ يَوْمَ لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِنَفْسٍ شَيْئًا وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ١٩﴾

"Vërtet, punëdrejtët do të jenë në Xhennet."

"Kurse fajtorët, me siguri, do të jenë në Zjarrin flakërues."

"Në të cilin do të digjen në Ditën e Gjykimit."

"Pa mundur t'i shmangen atij."

"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit?"

"Edhe njëherë: Kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit?"

"Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe, kur pushteti do të jetë vetëm i All'llahut."

Komentimi

Atë Ditë, askush nuk mund të bëj asgjë për askënd!

Në vazhdim të diskutimit që u bë në ajetet e mësipërme, për sa i përket regjistrimit dhe mbajtjes shënim të veprave të njerëzve nga engjëjt, do të shikojmë se në ajetet në vijim flitet për përfundimin e kësaj dashurie dhe llogarie, si dhe për rrugën përfundimtare të njerëzve vepërmirë dhe atyre vepërkëqij. **"Vërtet, punëdrejtët do të jenë në Xhennet, kurse fajtorët, me siguri, do të jenë në Zjarrin flakërues."**.

Fjala *"el ebrar"* është shumësi i fjalës *"barrun"* dhe *"berrun"* dhe ka kuptimin: *person punëmirë.* Fjala *"berrin"*, që ka zanoren *"kesre"*, ka kuptimin: *çfarëdolloj pune të mirë.* Në këtë rast, përfshin edhe besimin e mirë, edhe nijetet e mira, edhe veprat e mira.

Fjala *"naijmun"* është në numrin njëjës dhe ka kuptimin *en ni'metu, mirësi.* Këtu ka kuptimin Xhennet i përjetshëm. Përdoret në formën e mohimit për të shprehur rëndësinë, gjerësinë dhe madhështinë e këtij bekimi, që askush përveç Zotit nuk e di gjerësinë dhe madhështinë e tij. Përzgjedhja e*"naijmun"*, që, në këtë rast, është atribut i ngjashëm, është përdorur për të theksuar vazhdimësinë e kësaj mirësie. Zakonisht ky kuptim është i fshehur në një atribut të ngjashëm.

Fjala *"el fuxh'xhar"* është shumësi i fjalës *"faxhirun"*, vjen nga fjala *"fexhere"* dhe ka kuptimin: *thyerje për së gjeri, si dhe të lindjes së mëngjesit*. Ndaj edhe kur agon mëngjesi, është sikurse është ndarë perdja e zezë e natës me agimin.

Fjala *"el fuxhuru"* është përdorur për veprat e atyre që perden e pastërtisë dhe të devotshmërisë e heqin dhe hedhin hapat e tyre drejt mëkatit.

Fjala *"el xhehijmu"* vjen nga fjala *"el xhehmetu"* dhe ka kuptimin: *ndez zjarrin*, ndaj edhe *"xhehim"* është zjarri i ndezur me flakë. Zakonisht në Kur'an vjen me kuptimin: *Xhehennem*.

Ndërsa kur thotë se punëmirët janë në Xhennet dhe punëkëqijtë janë në Xhehennem, ndoshta ka këtë kuptim, që ata tani janë në Xhennet dhe në Xhehennem, sepse edhe në këtë botë, ata janë të përfshirë nga mirësitë e Xhennetit dhe nga dënimi i Xhehennemit.

Në ajetin 54 të sures "El Ankebût" thuhet: **"Xhehennemi është vendbanimi i jobesimtarëve."**. Disa thanë se interpretime të tilla flasin për të ardhmen që është e sigurt. Në gramatikën e gjuhës arabe, diçka që do të ndodhë dhe është e sigurt, vjen në kohën e tashme dhe ndonjëherë në kohën e shkuar.

Nëse shikojmë, kuptimi i parë është më i përngjashëm në pamje të jashtme, por kuptimi i dytë është më i përshtatshëm.

Në ajetin e mëposhtëm shpjegohet edhe më shumë fati i punëkëqijve, duke thënë: **"Në të cilin do të digjen në Ditën e Gjykimit."**.

Sa herë që kuptimi i ajetit të kaluar të jetë i tillë, që ata, në këtë çast do të futen në Xhehennem, ky ajet tregon se në Ditën e Kiametit ata do të futen më thellë në këtë zjarr dhe ndikimi i zjarrit do të ndihet shumë mirë.

Fjala *"jesleune"* vjen nga rrënja *"sala"* dhe ka kuptimin: *të digjesh brenda në zjarr*. Gjithashtu, ka kuptimin e durimit të dhimbjeve. Po ashtu, për shkak se folja është në kohën e shkuar, ajo argumenton vazhdimësinë.

Përsëri, për të theksuar më tepër, thotë: **"pa mundur t'i shmangen atij"**.

Shumë komentues, këtë fjali e kanë marrë si argument se dënimi atje do të jetë i përhershëm *"el fuxh'xhar"*. Në këtë mënyrë, ata kanë rënë në përfundimin se kuptimi dhe qëllimi i përdorimit të fjalës *"el fuxh'xhar"* në këto ajete, janë qafirët, pra, jobesimtarët, sepse *"el khulud"* dhe përjetësia nuk është për të tjerët. Për këtë arsye, me fjalën *"el fuxh'xhar"* janë përcaktuar ata persona që e kanë prerë perden e devotshmërisë dhe të nderit, sepse nuk besojnë dhe e mohojnë Ditën e dhënies së llogarisë dhe jo për shkak të egos, ndërkohë që kanë besim.

Interpretimi i këtij ajeti, përsëri vjen në kohën e tashme dhe thekson atë që u tha më lart, se të tillë persona, në këtë botë, nuk janë larg Xhehennemit, vetë jeta e tyre është Xhehennem. Po ashtu, edhe varri i tyre, sipas hadithit të njohur, është vatër nga vatrat e zjarrit. Kështu, të tillë persona do të vuajnë edhe zjarrin e kësaj bote, edhe të varrit, edhe të Xhehennemit.

Ajeti i mësipërm përsërit edhe një herë këtë të vërtetë, se dënimi i Xhehennemit nuk ka asnjë lloj pushimi, nuk mund të qëndrojnë larg tij për asnjë orë apo çast.

Më tej, për të treguar rëndësinë e asaj Dite të Madhe, thotë: **"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit?"**.

Nëse tmerri dhe vështirësia e Ditës së Kiametit janë të fshehura për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* me gjithë njohuritë e shumta dhe dijen e jashtëzakonshme në lidhje me Ditën e Kiametit, Krijimin dhe Ringjalljen, vallë si do të jetë gjendja e të tjerëve?!!

Ajo çka u tha më lart, është tregues dhe shpjegues i një të vërtete, që është Dita e Kiametit. Në atë ditë do të shikohen ngjarje të tmerrshme dhe tronditëse. Kiameti është aq shumë i madh dhe i zgjeruar, saqë nuk mund të shpjegohet apo të përshkruhet. Ashtu sikurse ne të burgosurit e kësaj bote nuk kemi njohuri për mirësitë e pafundme të Xhennetit, edhe për dënimin e Xhehennemit dhe ngjarjet e asaj Dite të Madhe nuk kemi njohuri.

Më tej, në ajetin e fundit të sures, flitet për një tjetër cilësi të asaj Dite, që në të vërtetë është përmbledhur gjithçka. Ajeti thotë: **"Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe, kur pushteti do të jetë vetëm i All'llahut."**.

Sigurisht që të gjitha punët në këtë botë janë në dorë të fuqisë së All'llahut, si dhe të gjithë janë nevojtar të Tij, por në këtë botë sidoqoftë ekzistojnë edhe pronarë, sundimtarë dhe zyrtarë të cilët ndonjëherë njerëzit sipërfaqësorë dhe injorantë i konsiderojnë ata si burim i pushtetit të pavarur, por atë Ditë ajo pronë dhe sovranitet zyrtar dhe virtual do të hiqet, dhe sovraniteti dhe pronësia absolute e Zotit mbi gjithçka është më e qartë se kurrë.

Kjo ka ardhur edhe në ajet të tjera të Kur'anit: "Për Ditën, kur ata do të paraqiten të zbuluar, kur asgjë e tyre nuk do të jetë

e fshehtë për All'llahun. Kujt i përket pushteti i asaj Dite? All'llahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!".[1]

Në parim, në atë Ditë çdokush do të jetë aq i zënë, saqë, edhe sikur ta zëmë se do të kishte ndonjë fuqi, nuk do të ketë mundësi të merret me të tjerët. Sikurse thotë ajeti: **"Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë."**.[2]

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Të gjitha punët, si në këtë ditë dhe si në atë ditë, janë në dorë të All'llahut. Por, kur të vijë Dita e Kiametit, të gjithë udhëheqësit do të dalin mënjanë dhe nuk do të ketë asnjë pushtet përveç pushtetit të All'llahut."*.[3]

Në këtë rast, lind pyetja: Ky interpretim, a mos kundërshton çështjen e (shefaatit) ndërmjetësimit të Profetëve, eulijave dhe engjëjve?

Përgjigjja e kësaj pyetje është një ndër diskutimet që e kemi trajtuar në temat e kaluara, te çështja e shefaatit. Aty bëhet e qartë se Kur'ani, në ajete të ndryshme, qartëson se shefaati bëhet me leje të Zotit dhe ata që bëjnë shefaat, nuk mund t'i bëjnë shefaat askujt, sikurse thotë vetë Kur'ani: **"Ai e di se ç'ka para tyre** (ç'kanë vepruar) **dhe ç'ka pas tyre** (çfarë do të veprojnë)**, ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur, e prej frikës së Tij qëndrojnë me nderim dhe frikë** (se mos i ndëshkon)**.".**[4]

---

[1] Sure "El Gafir", ajeti 16.
[2] Sure "Abese", ajeti 37.
[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 450; "Biharul Enuar", vëll. 7, f. 95.
[4] Sure "El Enbijâ", ajeti 28.

O All'llah! Në atë Ditë të tmerrshme, të gjithë sytë janë drejtuar nga Ti, po ashtu edhe ne në këtë ditë, i kemi drejtuar sytë nga Ti!

O All'llah! Mos na e bëj të ndaluar mirësinë dhe mëshirën Tënde, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër!

O All'llah! Na ruaj dhe na mbro ne nga shirku dhe mbështetja te të tjerët!

Amin Ja Rabel Alemin.

Fundi i sures "El Infitâr".

Sure “El Mutaffifîn”

Zbritur në Mekë

Ajete 36

Përmbajtja e sures "El Mutaffifîn"

Për vendin e zbritjes së kësaj sureje, në Mekë apo Medine, ka diskutime midis komentuesve.

Në ajetet e para të kësaj sureje flitet për shitësit. Në këtë rast, flitet për shitësit e Medines, të cilët hanin në peshë, nuk e tregonin peshën e vërtetë të mallit, kur e shisnin. Mënyra dhe toni i përdorur në këto ajete të kësaj sureje, ka ngjashmëri të madhe me suret mekase. Ajetet e tyre janë të shkurtra dhe kumbuese, sepse flasin për Ringjalljen dhe ngjarjet e Ditës së Kiametit.

Në veçanti, ajetet e fundit të kësaj sureje, që flasin për talljen e jobesimtarëve karshi myslimanëve, tregojnë gjendjen e mjedisit të Mekës, pasi besimtarët ishin pakicë, ndërsa jobesimtarët ishin shumicë. Ndaj dhe për këtë arsye, disa komentues, një pjesë të kësaj sureje e konsiderojnë mekase, kurse pjesën tjetër të saj medinase. Nëse përllogaritet e gjithë kjo sure, më tepër ka ngjashmëri me suret mekase.

Diskutimet e kësaj sureje janë të ndara në pesë boshte:

1- Paralajmërim dhe kërcënim të madh ndaj atyre që shesin (pra, ata që hanë peshën në shitje).

2- Tregon se mëkatet vijnë si pasojë e mos pasjes së besimit në Ditën e Gjykimit dhe të Ringjalljes.

3- Një pjesë e saj flet për fatin e shitësve në atë Ditë.

4- Një tjetër pjesë e saj, flet për dhuratat e mëdha që janë për shpirtrat e punëmirëve në Xhennet.

5- Flet për talljen që vjen nga injoranca e jobesimtarëve ndaj besimtarëve dhe ndryshimi që do të bëhet në Ditën e Kiametit.

Mirësitë e leximi të sures"El Mutaffifîn"

Në një hadith të të Dërguarit të All'llahut, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjet e tij!)*, lexojmë: *"Çdokush që e lexon suren 'El Mutaffifîn', All'llahu, në Ditën e Kiametit, do t'ia shuajë etjen me një pije të pastër. Këtë pije nuk e ka provuar më parë asnjë person."*[1]

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"Kushdo që e lexon suren 'El Mutaffifîn', në namazet e tij të detyruara, All'llahu do t'i sigurojë mbrojtje nga dënimi i Xhehennemit. Ai nuk e shikon zjarrin e Xhehennemit dhe as zjarri i Xhehennemit nuk e shikon atë."*.[2]

Është shumë e qartë se gjithë këto mirësi dhe begati janë për ata që jo vetëm lexojnë, por edhe i kthejnë në vepra ato çka lexojnë.

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 451.
[2] "Theuabul A'mal", në përputhje me "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 527.

Ajetet 1 - 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَيْلٌ لِلْمُطَفِّفِينَ١ الَّذِينَ إِذَا اكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ٢ وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وَزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ٣ أَلَا يَظُنُّ أُولَئِكَ أَنَّهُمْ مَبْعُوثُونَ٤ لِيَوْمٍ عَظِيمٍ٥ يَوْمَ يَقُومُ النَّاسُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ٦﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje)**."**

"Që, kur masin për veten, e marrin masën të plotë."

"Ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë."

"A nuk mendojnë ata se do të ringjallen?"

"Në një Ditë të Madhe?"

"Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?!"

Shkaku i zbritjes

Ibn Abasi thotë: "Kur Profeti i nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u fut në qytetin e Medines, shumë tregtarë ishin zhytur deri në grykë me punë të liga, sikurse është pesha. All'llahu i Madhëruar i zbriti këto ajete dhe ata tregtarë i pranuan ajetet. Më pas filluan të masin e të peshojnë në rregull.".[1]

Në një tjetër hadith thuhet: "Shumë qytetarë të Medines ishin tregtarë dhe një nga punët e tyre ishte shitja me peshë jo të rregullt. Kështu, shumë nga paktet që ata lidhnin, ishin haram, ndaj edhe këto ajete zbritën, që t'i këshillonin dhe t'i ndalonin ata nga kjo vepër e keqe. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ua lexoi ajetet e sures "El Mutaffifîn" banorëve të qytetit të Medines e më pas shtoi: "*Pesë gjëra janë përballë pesë gjërave të tjera!*"

Unë e pyeta të Dërguarin e All'llahut: "O i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, cilat janë ata pesë gjëra të cilat janë përballë pesë të tjerave?!

1- I Dërguari i All'llahut tha: "*Të gjithë popujt që kanë thyer premtimin (besën e dhënë), janë përballur me armiqtë, që All'llahu i ka përcaktuar si zotërues mbi ta.*

2- *Ai popull që nuk udhëhiqet me urdhrin hyjnor, tek ai popull do të mbizotërojë varfëria.*

[1] "Mexhmaul Bejan", në vijim të ajetit që po diskutojmë.

3- *Tek ai popull që është shfaqur në masë imoraliteti, është shtuar vdekja në masë.*

4- *Ata që peshojnë mangët, (nuk japin peshën e saktë), nuk kanë pasur bereqet te të mbjellat e tyre, ata i mbulon zija.*

5- *Ai popull që nuk e jep zekatin, është ndëshkuar me ndërprerje të shiut.".*[1]

I ndjeri Tabrasij, po ashtu, në tefsirin "Mexhmaul Bejan", për sa i përket shkakut të zbritjes së këtij ajeti, ka transmetuar: "Në qytetin e Medines jetonte një burrë, që quhej Abu Xhehijnetu. Ai mbante me vete dy peshore, një të vogël e një të madhe. Kur blinte vetë nga të tjerët, peshonte me peshoren e madhe dhe, kur njerëzit blinin tek ai, peshonte me peshoren e vogël. Kjo sure zbriti për të qortuar dhe për të këshilluar këtë burrë dhe burra e njerëz të tjerë që vepronin si ky.".[2]

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 31, f. 88. Po këtë kuptim kanë përdorur edhe komentuesit e tjerë, si Abul Fettuh Err Rrazij dhe Meragij, në tefsirin e tyre "Biharul Enuar", vëll. 70, f. 370.

[2] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 452.

Komentimi

Mjerë ata që peshojnë mangët!

Në këtë ajet kur'anor, më parë se gjithçka tjetër, kërcënohen rreptë ata që peshojnë mangët. Ndaj dhe All'llahu, në këtë ajet thotë: **"Mjerë për ata që hanë në peshë** (dhe matje)**."**.

Nëse vërehet me vëmendje, në mënyrë të hapur, ky ajet tregon nisjen e luftës (pra, nisjen e luftës nga ana e All'llahut) ndaj këtyre personave që janë shfrytëzues, të pisët dhe dhunues, të cilët kërkojnë si e si të vënë poshtë njerëzit dhe të shtypin të drejtat e tyre.

Fjala *"el mutaffifijn"* vjen nga rrënja *"et tatfijf"* dhe është marrë nga fjala *"fef"*. Kuptimi është: *cepat e diçkaje*. Ndaj dhe tokës së Kerbelasë i thonë fusha ***"Tef",*** pasi në bregun e lumit Eufrat ndodhi ngjarja e Kerbelasë.

Gjithashtu, çdo gjë që është e mangët, ose e paktë, identifikohej me termin *"et taf"*. Edhe peshoret që nuk peshojnë në mënyrë të rregullt, i thërrisnin me këtë emër. Më vonë, ky term është përdorur në mënyra të ndryshme për ata që peshojnë mangët.

Në këtë rast, fjala *"ueilul"* ka kuptimin: *sherr, pikëllim, hidhërim, shkatërrim, ndëshkim i dhimbshëm*; ose është përdorur për të treguar luginën e përvëluar të Xhehennemit. Zakonisht ky term është përdorur edhe kur mallkojmë, edhe kur tregojmë të këqijat e një gjëje.

Është një fjalë me pak shkronja, por që, në vetvete, mbart shumë kuptime. Është për t'u parë fakti se në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"All'llahu nuk e ka përdorur kurrë fjalën 'ueilun' për ndokënd e që të mos e ketë quajtur atë person jobesimtar.*

Thuhet: *'Mjerë jobesimtarët, të cilët do të shikojnë Ditën e Madhe!'"*.[1]

Nga ky transmetim mund të kuptojmë se ngrënia në peshë ka erën e jobesimtarit.

Më tej flitet për komentimin e punëve të atyre që peshojnë mangët. Ajeti thotë: **"Kur masin për veten, e marrin masën të plotë, ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë."**.

Disa komentues, ajetet e mësipërme i komentojnë në këtë mënyrë: Fjala *"muteffef"* përdoret për atë person që, kur ble, merr më tepër se sa i takon, ndërsa, kur ai shet, jep më pak se sa i takon. Ndaj dhe All'llahu i Madhëruar, për shkak të dy kaheve, ka vendosur termin *"ueilun"* tek ata.

Por kjo gjë është e gabuar, sepse fjala *"jesteufun"* ka kuptimin: *marrja e hakut të tyre, pra, ata që peshojnë e marrin në rregull hakun e tyre*. Ndaj, në këtë rast, nuk kemi asnjë gjë që të vërtetojë dhe të nënkuptojë se ky term ka për qëllim hakun. Aty ku shikojmë që All'llahu ata i ka ndëshkuar, ka të bëjë me krahasimin e këtyre dy gjendjeve, që në kohën e blerjes e merr hakun e tij në mënyrë të plotë, ndërsa, kur shet, e jep mangët. Është e vërtetë se kjo gjë

[1] "Usulul Kafij", në përputhje me "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 527.

qëndron, sikurse edhe themi në batutat e përditshme, "çdokush që ka për të marrë borxhin dikujt, e merr atë në kohën e duhur, ndërsa, kur vjen puna për të larë borxhin vetë, e shtyn atë me muaj të tërë".

Të marrësh hakun në kohën e duhur, nuk është punë e keqe. Punë e keqe është kur i krahason këto me njëra-tjetrën, (që është kërkimi në kohë, kur bëhet fjalë për të marrë dhe vonesa, kur bëhet fjalë për të dhënë).

Ajo çka vërehet, në këtë rast, është se, kur flitet për të marrë hakun, flitet vetëm për "*el kejl*", ndërsa kur bëhet fjalë për të marrë dhe për të dhënë, flitet edhe për "*el kejl*", edhe për "*uezn*".

Ky ndryshim interpretimi ndoshta është për këto dy arsye: Së pari, blerësit që blinin me shumicë, përdornin qëllimisht "*el kejl*", sepse nuk kishte peshore që ta peshonin mallin me shumicë. Por, për sa u përket masave të mëdha, ato gjendeshin shumë kollaj. Por kur njerëzit shisnin, ata shisnin edhe duke peshuar, edhe duke e matur me masë. Për të marrë hakun, është më mirë të përdoret peshorja, sepse është shumë e vështirë për të bërë manipulime në të. Ndërsa kur vjen puna për të shitur, zakonisht nuk përdorej peshorja, sepse ishte më mirë për t'ua hedhur të tjerëve, pa përdorur peshoren.

Një tjetër pikë që hasim, është se, edhe pse ajetet e mësipërme flasin për hakun e peshës, padyshim që kuptimi i saj është edhe më i gjerë, sepse në të përfshihet çfarëdolloj shitje, matje, mase etj. Ky ajet i përfshin edhe ata që në kohën e tyre të punës punojnë më pak se sa e kanë normën e tyre. Disa dëshirojnë ta zhvillojnë edhe më tej këtë ajet, duke përfshirë në të çdo lloj dhunimi, në lidhje me marrëdhëniet shoqërore dhe ato morale.

Edhe pse përdorimi i këtij kuptimi nuk është i qartë në fjali, kjo gjë nuk është e pakuptueshme. Abdullah Ibn Mes'udi, një nga shokët e njohur të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka transmetuar: "*Edhe namazi është i peshueshëm! Ai që e shlyen në mënyrë të plotë hakun e namazit, All'llahu i Madhëruar do ta shpërblejë atë në mënyrë të plotë. Ai që nuk e shlyen të plotë hakun e namazit, zbatohet urdhri i atyre që peshojnë mangët* ***"mutaffifijn"***.[1]

Më pas ata kërcënohen me një pyetje, që, në vetvete, është vërejtje: **"A nuk mendojnë ata se do të ringjallen në një Ditë të Madhe, Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?!"**.

Ajo ditë do të lajmërojë për dënimin e madh dhe llogarinë që do të japin të gjithë. Ajo ditë është e tmerrshme. **"Në Ditën kur njerëzit do të ngrihen nga varret dhe do të paraqiten pranë Zotit të botëve."**

Nëse ata do ta besonin Kiametin dhe dhënien e llogarisë, për çka kanë punuar dhe se do të dënohen dhe do të shpërblehen edhe për vepra që janë më të vogla se sa një majë gjilpëre, nuk do të bënin kurrë padrejtësi dhe nuk do ta hanin kurrë hakun e të tjerëve.

Shumë komentues, fjalën "*jedhunnune*", e cila vjen nga rrënja "*edh dhannu*", në këtë rast, e komentojnë me kuptimin "*binje*". Shembuj të ngjashëm me këtë kuptim, hasim shumë në Kur'an, si për shembull, në suren "El Bekare", në ajetin 249: **"...Por ata që ishin të bindur se do të takoheshin me All'llahun, thanë: 'Sa herë,**

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 542.

me ndihmën e All'llahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe!...'".

Ata që e dinin se do të takonin All'llahun (Zotin e tyre) dhe kishin besim në Ditën e Kiametit, thanë se grupi i vogël triumfoi ndaj një grupi të madh, me urdhër të All'llahut. Ky ajet flet për një grup nga Beni Israilët, të cilët e patën treguar besimin dhe qëndresën e tyre në stade të ndryshme.

Një tjetër dëshmi e kësaj fjale është edhe hadithi i Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Kur komenton ajetin: **"A nuk mendojnë ata se do të ringjallen..."**, thotë se kuptimi është: *"A nuk janë të bindur ata se do të ringjallen?"*.[1]

Është transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se fjala *"dhannun"* ka dy kuptime: Ajo çka është përmendur në Kur'an për Ringjaljen, është *"dhanni"* i bindjes dhe ajo çka ka ardhur për dynjanë, është *"dhanni"* i dyshimit".[2]

Një tjetër shpjegim për fjalën *"dhann"*, i dhënë nga një grup komentuesish, është edhe të menduarit për Kiametin, sepse të menduarit, në këtë rast, ndikon shumë në shpirtin dhe në zemrën e njeriut. Nëse dikush mendon për të dhe e pranon ekzistencën e një dite të tillë, duhet të largohet nga punë që janë në kundërshtim me atë ditë. Nëse njeriu e beson atë ditë, atëherë gjithçka do të ishte ndryshe.

Pra, vetë fakti që e mendon, të bën të kuptosh dhe të ndryshosh. Nëse e beson, atëherë gjithçka do të ishte shumë më

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 38.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, f. 528.

ndryshe, do të bënte që njeriu të mos kryente asnjë vepër në kundërshtim me rregullat. Por ajo çka vërehet, është se këta jo vetëm që nuk besojnë në Ditën e Kiametit, por as që e mendojnë këtë ditë. Për shkak të shkaqeve që u thanë, komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Është e rëndësishme që fjala dyshim *"dhann"*, sipas Ragibit, në librin e tij "Mufredat", në kontekstin e emrit është për gjendjen që rezulton nga ekzistenca e provave në mendjen e njeriut. Nëse shenjat janë të forta, ajo sjell njohuri dhe siguri, dhe nëse shenjat janë të dobta, ajo sjell dyshim dhe nuk shkon më lart.[1]

Sipas kësaj kjo fjalë në kundërshtim me atë çka është e njohur në mesin tonë ka kuptime të gjera, ku përfshihet edhe shkenca edhe spekullimi. Andaj ndonjëherë përdoret për njërën dhe ndonjëherë për tjetrën.

Hulumtimi

Shitja e mangët është një nga shkaqet e korrupsionit

Në ajetet e Kur'anit të Shenjtë, në mënyrë të përsëritur, flitet për fajësimin e ngrënies në peshë. Në tregimet e Profetit Shuajb *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* janë shumë të qarta qortimet që ai i nderuar u bën njerëzve të popullit të tij, ku thotë:**"Bëjeni drejt**

[1] "Mufredat" i Ragibit, çështja e dyshimit "dhannun".

matjen dhe mos u bëni nga ata që hanë (në matje)**. Peshoni drejtësisht me peshore të saktë, mos ua pakësoni njerëzve gjërat e tyre, mos bëni ngatërresa në Tokë."**.[1]

Kështu që ngrënia e peshës dhe braktisja e drejtësisë rreshtohen në radhët e korrupsionit në këtë tokë. E gjithë kjo është argument për dimensionet e korrupsionit social. Po ashtu, në ajetet 7- 8 të sures "Er Rrahman" përpikëria e drejtësisë në peshë, si dhe të peshuarit mangët futen në radhët e ruajtjes së drejtësisë në sistemin e krijimit në këtë botë universale.

Aty ku thuhet: **"All'llahu ngriti qiejt dhe tek të gjitha gjërat vendosi peshoren dhe llogarinë, që ju të mos kaloni kufirin në peshore dhe në drejtësi."**, tregon se çështja e peshës dhe e drejtësisë, nuk është një çështje e parëndësishme. Në të vërtetë, ajo është një pjesë nga pjesët kryesore të drejtësisë në sistemin e universit. Për këtë arsye, udhëheqësit e mëdhenj të fesë islame i kanë dhënë shumë rëndësi kësaj çështje.

Në një hadith të njohur të Asbekhe Bin Nebate thuhet: "Kam dëgjuar nga Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *'O grupi i tregtarëve, në radhë të parë, mësoni ligjin (Fik'hun, Jurisprudencën) e më pas bëni tregti!'*".

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, këtë fjali e ka cituar tri herë dhe në përfundim të fjalës së tij, shtoi: "*Tregtari i pandershëm është në zjarr, përveç atij që merr më të drejtë tek njerëzit dhe jep me të drejtë tek ata*".[2]

---

[1] Sure "Esh Shu'arâ", ajetet 181 - 183.

[2] Tefsiri "El Kafij", vëll. 5, f. 150, çështja rregullat e tregtisë "Adabu Tixharati", Hadithi 10.

Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* transmeton: "Kur Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* qëndronte në Kufe, çdo ditë, në mëngjes, kalonte nga tregu i Kufes. I kalonte të gjithë tregtarët dhe në dorë mbante kamxhikun (për të qëlluar ata që nuk e zbatonin rregullin e tregtisë). Më pas qëndronte në mes të tregut dhe me zë të lartë thërriste: *'O tregtarë! Kini frikë nga All'llahu!'*.

Kur dëgjohej zëri i Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, çdo gjë që kishin në dorë e vendosnin në tokë dhe me gjithë zemër dëgjonin fjalimin e tij. Më pas, ai shtonte: *'Kërkoni nga All'llahu i Madhëruar më tepër se çdo gjë tjetër, mirësi, lehtësim në punë, bereqet. Jini të afrueshëm me blerësit! Bukuria juaj, le të jetë butësia juaj! Qëndroni larg betimit, qëndroni larg Xhehennemit! Mos dhunoni! Jepni hakun që u takon të dhunuarve! Jini të drejtë në çështjen e të dhunuarve! Mos iu afroni fajdes! Peshoni me drejtësi! Mos u jepni më pak se sa u takon njerëzve dhe mos u bëni prishës të rendit në tokë!'"*.

Kështu Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i binte rreth e përqark pazarit të Kufes e më pas kthehej në Darul Imare dhe merrej me gjykimin e njerëzve.[1]

Sikurse është thënë edhe në zbritjen e ajeteve kur'anore, Profeti i nderuar thotë: *"Çdo grup që peshon mangët, është i ndëshkuar nga All'llahu me heqjen e bereqetit dhe me pakësim të të mbjellave!"*.

[1] Tefsiri "El Kafij", vëll. 5, f.151, Kapitulli. "Adabu Tixhareti", Hadithi 3 (me pak shkurtim).

Nga përmbledhja që u tha më lart, mësohet se një nga shkaqet e rëndësishme të zhdukjes dhe tëndëshkimit të disa nga popujt e mëparshëm, ka qenë çështja e mangësisë në peshë, e cila është bërë edhe shkak i prishjes së rendit në ekonomi e kështu ka zbritur ndëshkimi i Allahut.

Gjithashtu, në transmetimet që flasin për rregullat dhe kulturën në tregti, thuhet se besimtarët më të mirë janë ata që, kur peshojnë, japin pak më tepër se sa duhet dhe, kur duan të marrin hakun e tyre, marrin pak më pak se sa u takon.

Pra, është e kundërta e atyre personave që u përmendën në ajetet e mësipërme. Ata asnjëherë nuk u jepnin njerëzve hakun e tyre.[1]

Nga ana tjetër, ashtu sikurse e kemi cituar në ajetin e mësipërm, çështja e ngrënies në peshë, sipas mendimit të disa dijetarëve, ka kuptim të gjerë dhe përfshin jo vetëm peshën e mangët, por edhe kryerjen e detyrës personale, shoqërore dhe hyjnore.

[1] Mund të riktheheni e të shikoni vëllimin 12 të librit "Uesailul Shiia", "Ebuabul Tixhareti", kreu. 7, f. 290.

Ajetet 7 – 10

﴿كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْفُجَّارِ لَفِي سِجِّينٍ٧ وَمَا أَدْرَاكَ مَا سِجِّينٌ٨ كِتَابٌ مَرْقُومٌ٩ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ١٠﴾

"Sigurisht (që do të ringjallen)**, dhe Libri i punëmbrapshtëve do të jetë në *Sixh'xhîn*!"**

"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është *Sixh'xhîn*?!"

"Është një libër i shkruar!"

"Mjerë mohuesit atë Ditë..."

Komentimi

Çfarë është "Sixh'xhijni"?

Ajetet që cituam më lart, flisnin për çështjen e ngrënies në peshë, lidhjen midis mëkatit, mospasjes së besimit të sinqertë te Dita e Ringjalljes. Gjithashtu, ato jepnin fatin e punëkëqinjëve dhe të pandershmëve.

Ajetet kur'anore thonë: **"Sigurisht** (që do të ringjallen)**, dhe Libri i punëmbrapshtëve do të jetë në *Sixh'xhîjn*! E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është *Sixh'xhîn*?!"**.

Për komentimin e këtyre ajeteve, ekzistojnë dy mendime:

Së pari, mendohet se fjala *Kitab*, Libri, në këtë ajet, nënkupton librin ku janë shkruar të gjitha veprat e njerëzve. Në këtë libër nuk ka mbetur pa u shkruar edhe gjëja më e vogël, pra, çdo vepër është e shkruar në të, pa asnjë shtesë dhe pa asnjë mangësi.

Së dyti, për sa i përket *Sixh'xhînjit,* ai është një libër i përgjithshëm, ku shkruhen të gjitha veprat e njerëzve, por në mënyrë të përgjithshme dhe të thjeshtë, pra, është i ngjashëm me një fletore të përgjithshme, ku në një faqe autonome janë regjistruar të gjitha veprat e kreditorëve dhe të debitorëve. **"Është një libër i shkruar!"**.

Por nga këto ajete dhe nga ajetet që do të vijnë më poshtë, kuptohet se veprat e të gjithë punëkëqinjëve janë të shkruara në një libër me emrin *"Sixh'xhîjn"*, ndërsa veprat e punëmirëve janë të shkruara në një tjetër libër me emrin *"Ilijjun"*.

Fjala *"sixh'xhîjn"* vjen nga rrënja *"es sixhnu"*, që ka kuptimin *"burg"*. Ka edhe kuptime të ndryshme, si: burg i vështirë, çdo qenie është e ngurtë dhe e fortë, luginë e përmbytur dhe shumë e tmerrshme në thellësinë e Xhehennemit, vendi ku qëndrojnë veprat e punëkeqinjëve, si dhe zjarr i Xhehennemit.[1]

[1] Marrë nga "Lisanul Arab", kapitulli " Sixh'xhijn".

Et Turejhi në librin "Mexhmaul Bahrejn", për sa i përket shpjegimit të fjalës *"sixh'xhîjn"* thotë: "Në tefsir citohet se *"sixh'xhîjn"* është libër që përmbledh veprat e këqija të jobesimtarëve, shkelësit e fjalës, xhindët dhe njerëzit. Medet për gënjeshtarët, sepse atë ditë do të shkatërrohen! **"Mjerë mohuesit atë Ditë..."**.

(Et Turejhi nuk e ka sqaruar se cili është qëllimi i këtij komentimi, dhe nga ku është marrë, a është marrë nga "Masumët" të pastërit apo nga të tjerë).

Provat që e konfirmojnë këtë kuptim janë:

1- Interpretimi për librin në Kur'anin Famëlartë në të tilla raste shpreh kuptimin e librit të veprave.

2- Në pamjen e jashtme ajeti në vazhdim: **"Është një libër i shkruar!",** tregon për komentimin e fjalës Sixh'xhijn.

3- Disa kanë thënë se Sixh'xhijn dhe Sixh'xhijl kanë një kuptim, ne e dimë që Sixh'xhijl ka kuptimin libër i madh.

4- Nga ajetet e tjera të Kur'anit kuptojmë që veprat e njerëzve rregjistrohen në disa libra, që në momentin e dhënies së llogarisë të mos nxjerrin asnjë justifikim dhe pretekst.

Së pari vjen libri personal i veprave që u jepet secilit në dorë në Ditën e Kiametit, punëmirët e marrin nga krahu i djathtë, ndërsa punëkëqinjtë e marrin atë nga krahu i majtë. Sa i përket kësaj çështje Kur'ani i Shenjtë ka folur shumë.

Libri i dytë është libri i cili mund të quhet edhe ky libri i veprave të popujve, ku është përmendur në ajetin 28 të sures "Xhathije".

Së treti është libri i përgjithshëm ku në të janë të shkruar edhe vepërmirët edhe vepërkëqinjtë, ku në ajetet për të cilat diskutuam dhe në ajetet në vazhdim do të përmendet me emrin Sixh'xhijn dhe Ilijjin.

Me fjalë përmbledhëse, sipas këtij komentimi Sixh'xhijn është libri i përgjithshëm ku në të janë përmbledhur edhe vepërmirët edhe vepërkëqinjtë. Ndërsa sa i përket emërtimit me emrin Sixh'xhijn ndoshta është për shkak se veprat e tyre bëhen shkaku i mbylljes së tyre në burgun e Xhehennemit. Ose vetë ky libër e ka vendin në fund të Xhehennemit, në kundërshtim me librin e vepërmirve që ndodhet në gradën më të lartë të Xhennetit.

Komentimi i dytë është se fjala Sixh'xhijn është me atë kuptimin e njohur, që është Xhehennemi, i cili është një burg i madh për të gjithë punëkëqinjtë, ose është një vend i vështirë i Xhehennemit. Ndërsa sa i përket qëllimit për " *Kitabul Fuxh'xhar"*është fati i tyre i shkruar. Në bazë të këtij ajeti, kuptimi i ajetit është i tillë: Fati i punëkëqinjve është në Xhehennem dhe përdorimi i fjalës libër në këtë kuptim është përmendur jo pak në Kur'an, sikurse në ajetin 24 të sures "Nisa" po ashtu edhe në ajetin 75 të sures "Enfal". Atëhere çështjen që ky komentim e konfirmon është se Sixh'xhijn ka kuptimin e sajë të njohur i cili është Xhehennem, dhe që është i përmendur në librat dhe në veprat islame.

Në komentimin e Ali ibn Ibrahim po ashtu është transmetuar se kuptimi i " *Inne kitabel fuxh'xhari lefij sixh'xhijn"* është se ajo që u është përshkruar atyre nga dënimi është shkruar në sixh'xhin (Xhehennemi).

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të)* lexojmë: *Sixh'xhijn është toka e shtatë dhe Ilijjin është qielli i shtatë* (pra tregon vendin më të ulët dhe më të lartë).

Nga transmetime të shumta kuptojmë se veprat të cilat nuk janëtë denja për tu afruar tek Zoti bien dhe vendosen në Sixh'xhijn (Xhehennem). Ashtu sikurse edhe thuhet në një hadith të Profetit të Shenjtë *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar)*: Ndonjëherë engjëlli e ngre një punë të krijesave me gëzim dhe lumturi lart, All'llahu i Madhëruar i thotë ta zbresë poshtë sepse nuk ka qenë ajo vepër për hirëtë Tij (pra nuk është bërë puna për të kënaqur Zotitn)!. Nga të gjitha këto transmetime kuptohet se "Sixh'xhijn" është një vend shumë i ulët në Xhehennem, ku veprat dhe libri i veprave të punëkëqinjve është i vendosur në të, osë fati i tyre është në atë burg. Në përputhje me këtë komentim fjalia " *Kitabun merkum"* është një theksim për fjalin " *Inne Kitabul Fuxh'xharilefi Sixh'xhin" (dhe nuk është komentim për të)* domethënë, është një dënim i cili është përcaktuar për ta dhe është i sigurtë.

Fjala "*merkum"* vjen nga rrënja e fjalës "*rakm"* dhe ka kuptimin vizë e trashë. Për faktin që vizat e trasha janë të qarta dhe nuk ka dyshim në to, mundet që ky interpretim të flasë për përcaktimin dhe mospasjen e asnjë dyshimi, gjë e cila asnjëherë as nuk zhduket e as nuk harrohet.

Bashkimi i këtyre dy komentimeve nuk përbën problem, për shkak se *"sixh'xhijn"* në komentimin e parë ka kuptimin e librit të veprave të të gjithë punëkëqinjëve, ndërsa në komentimin e dytë ka kuptimin e Xhehennemit apo fundin e tokës. Është e qartë se këto janë shkaku dhe pasoja e njëri-tjetrit, pra në kohën që libri i veprave të njeriut do të vendoset në librin e veprave të të gjithë punëkëqinjve, bëhet shkak që ai të hidhet në vendin më të keq dhe më të ulët të Xhehennemit.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë flitet për fatin e mohuesve duke thënë se: **"Mjerë për mohuesit."**. Të qenurit mohues është burim i mëkateve të ndryshme, ndër këto është edhe ngrënia në peshë, edhe dhunimi i tjetrit. Në ajetin e parë të sures thuhet: **"Mjerë për ata që hanë në peshë** (dhe matje)**."**.

Ky interpretim, edhe pse është shumë i sforcuar, tregon për llojet e dënimeve, si dhe për atë ngjarje shumë të tmerrshme, Ditën e Gjykimit.

Është për t'u përmendur se në ajetin e parë të sures flitet për ata që peshojnë mangët. Më tej flitet për ata që punojnë keq.

Në ajetin e fundit flitet për mohuesit e Ditës së Kiametit. Kjo tregon shumë mirë se midis këtij besimi dhe atyre veprave, mund të lidhet një marrëdhënie e afërt, gjë të cilën do e pasqyrojmë edhe më qartë në ajetet pasuese.

Ajetet 11 – 17

﴿الَّذِينَ يُكَذِّبُونَ بِيَوْمِ الدِّينِ١١ وَمَا يُكَذِّبُ بِهِ إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ١٢ إِذَا تُتْلَى عَلَيْهِ آيَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ١٣ كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ١٤ كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَحْجُوبُونَ١٥ ثُمَّ إِنَّهُمْ لَصَالُو الْجَحِيمِ١٦ ثُمَّ يُقَالُ هَذَا الَّذِى كُنْتُمْ بِهِ تُكَذِّبُونَ١٧﴾

"Të cilët mohuan Ditën e Gjykimit!"

"Askush nuk e mohon atë, përveç gjynahqarëve që shkelin çdo kufi."

"E të cilët, kur u lexohen Shpalljet Tona, thonë: 'Këto janë përralla të popujve të lashtë!'"

"Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) **ua kanë mbuluar zemrat."**

"Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t'i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre."

"Pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehennemit."

"E do t'u thuhet: 'Ja, kjo ajo që e quanit të gënjeshtërt!'"

Komentimi

Ndryshku i mëkateve

Në ajetet që cituam më lart, u fol për veprat dhe punët e mohuesve dhe fatin e tyre. Ndërsa tani do të flasim për njohjen e tyre. Ata janë persona që **"mohuan Ditën e Gjykimit"**.

Më pas shton se të vetmit persona që e mohojnë Ditën e dhënies së Llogarisë janë agresivët dhe mëkatarët: **"Askush nuk e mohon atë, përveç gjynahqarëve që shkelin çdo kufi..."**.

Mohimi i Ditës së Kiametit nuk është bërë në bazë të logjikës apo të argumentit, por ata persona, që kryejnë vazhdimisht dhunë dhe janë të zhytur në mëkat, janë edhe mohues të së vërtetës dhe të Ditës së Kiametit. (Duhet të dini se fjala *"ethijm"* është mbiemër dhe nënkupton vazhdimësinë e kryerjes së mëkatit nga njeriu.)

Ata duan të vazhdojnë të kryejnë mëkate, pa pasur asnjë përgjegjësi mbi vete, si dhe pa u ndier fajtor për mëkatet që kryejnë. Ata duan të jenë plotësisht të lirë në kryerjen e mëkateve të shëmtuara. Po ashtu, ata nuk njohin asnjë ligj dhe nuk duan t'ia dinë për asgjë. Këtë ide e hasim në suren "El Kijame", ajeti 5: **"Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë."**.

Njeriu dëshiron që jetën e tij ta kalojë vazhdimisht në mëkat ndaj dhe e mohon Kiametin.

Kështu, ashtu si besimi ndikon në kryerjen e veprave, edhe veprat e pista ndikojnë në formimin e besimit. Kuptimi i kësaj thënie do të qartësohet në komentimin e ajeteve të mëposhtme.

Në ajetin e mëposhtëm flitet për cilësinë e tretë të mohuesve të Kiametit. Kur atyre do t'u lexohen ajetet tona, ata do të thonë se këto janë legjenda të të parëve, pra, për ta nuk kanë asnjë vlerë. **"Kur u lexohen Shpalljet Tona, thonë: 'Këto janë përralla të popujve të lashtë!'"**.

Askush nuk e mohon atë, përveç gjynahqarëve që shkelin çdo kufi.Ata, përveçse janë dhunues dhe mëkatarë, janë edhe arrogantë, kur thonë se ato ajete janë legjenda të të parëve, pra, janë tregime dhe histori të pavlera. E ngjashme me historinë dhe kohën e të parëve (periudha e injorancës) ka mbetur në kujtesë,[1] me pretekstin e lënies së vetes së tyre jashtë çdo përgjegjësie karshi ajeteve kur'anore. Jo vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera, në Kur'anin e Shenjtë lexojmë se arrogantët guximtarë, me pretekstin për t'u larguar nga përgjigjja thirrëse e Krijuesit, mbështeten te fjala e tyre, duke i konsideruar ajetet kur'anore si legjenda të të parëve.

Në nëntë ajete të Kur'anit të Shenjtë janë paraqitur dredhitë dhe mbështetja e jobesimtarëve te legjendat dhe tregimet. Mbështetjen e tyre te legjendat dhe tregimet e hasim në suren "Furkan", në ajetin 5: **"Dhe ata thonë: 'Këto janë përralla të popujve të lashtë; të cilat i ka vënë t'i shkruhen e t'i lexohen atij në mëngjes e mbrëmje.'"**.

[1] Fjala *"esatijr"* është shumësi i fjalës *"usturetun"*. Kjo fjalë, më tepër është përdorur për tregimet, legjendat dhe për fjalimet e rreme.

Po ashtu, ajeti 17 i sures "El Ahkaf", flet për një djalë të ri që është shumë arrogant ndaj prindërve të tij, të cilët janë shumë bujarë dhe besimtarë. Në këtë ajet, lexojmë se ai, të gjitha të mirat e tyre, i hodhi poshtë me një fjalë, duke thënë: **"Mjerë për ty! Beso, sepse premtimi i All'llahut është i vërtetë!"**, ai përgjigjet: **"Këto janë vetëm përrallat e popujve të lashtë!"**. Disa komentues thonë se ajeti që u citua më lart, zbriti për djalin e hallës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai ishte një nga krerët e kufrit. Është e qartë se zbritja e ajetit është për një rast të veçantë. Kjo nuk pengon që kjo e vërtetë të jetë edhe për të tjerët.

Sido që të jetë, arrogantët dhe kryeneçët, për të shpëtuar nga qortimet dhe kritikat e ndërgjegjes, nga një anë dhe nga ana tjetër, për të shpëtuar nga protestat e njerëzve që kërkojnë të vërtetën, gjithmonë nxirrnin pretekste të ndryshme për të qetësuar veten e tyre.

Ajo çka është e çuditshme, është se ata, shpeshherë, kishin programe të njëtrajtshme, saqë dukej sikurse përgjatë gjithë historisë atë e lexonin në veshët e njëri-tjetrit. Shembuj të tillë kishin plot, sikurse ishte: magjia, priftërinjtë, marrosja, legjendat, e shumë gjëra si këto.

Kur'ani i Shenjtë, në ajetin tjetër, edhe një herë, shpjegon, kthehet e rikthehet në rrënjën origjinale të arrogancës dhe të kryeneçësisë, duke thënë se nuk është ashtu si ata mendojnë, por veprat e tyre janë të vendosura në zemrat e tyre sikur plaga dhe janë të penguar për të kuptuar të vërtetën.

Sa interpretim i këndshëm dhe tronditës! Veprat e tyre janë të ulura mbi ta sikurse plaga qëndron në trupin e njeriut, ndërsa drita, rrezatimi që i është dhënë njeriut, nga ana e Krijuesit, është venitur. Fytyra e së vërtetës është e ndriçuar sikur rrezet e diellit, kurse në fytyrat e arrogantëve nuk shikohet gjë tjetër vetëm se venitje, sepse drita hyjnore e zbulesës nuk pasqyrohet tek ata.

Fjala *"rane"* vjen nga rrënja *"er rejn"*, që sipas Ragibit, në librin "Mufredat" ka kuptimin e plagës dhe të ndryshkut që mbetet në sendet që kanë vlerë të madhe.

Ndërsa sipas mendimit të disa dijetarëve të tjerë të fjalorëve, ka kuptimin e një cipe të kuqe, e cila, për shkak të lagështisë së motit, shfaqet mbi metale. Në gjuhën perse quhet ndryshk. Kur në një metal apo në ndonjë send tjetër shfaqet ndryshku, është shenjë e rrjepjes së metalit, ose e venitjes së rrobës apo të një sendi tjetër. Natyrisht që largimi i shkëlqimit tregon dobësimin e rrezatimit. Ndonjëherë ajo ka marrë edhe kuptimin e dominimit të një objekti ndaj një objekti tjetër. Po ashtu, ka edhe kuptimin e rënies në një vend, ku nuk ka rrugëdalje. Të gjitha këto shpjegime janë të nevojshme, për të kuptuar më mirë atë që u tha më lart, që është edhe më kryesorja.[1]

Për sa i përket ndikimit shkatërrues të mëkatit, për largimin e rrezatimit dhe të cilësive të zemrës, kemi një diskutim të cilin do ta paraqesin te këshillat.

[1] Shikoni në tefsirin e Fakhri Rrazit, në vazhdim të ajetit që diskutuam. Ndërsa për sa i përket rrënjës *"rejn"*, shikoni "El Munxhid".

Më tej, All'llahu në Kur'an shton: **"Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t'i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre."**.

Kjo për ta, do të jetë një ndër dënimet më të dhimbshme, sepse, ashtu si për punëmirët takimi shpirtëror dhe prania e tyre te Krijuesi është afrimitet, dashuri dhe kënaqësi, po ashtu edhe për ata është pjesa më me vlerë.

Fjala *"kel'la"* zakonisht përdoret për të mohuar diçka qëështë thënë më parë. Edhe në këtë rast, komentuesit kanë dhënë shpjegime të ndryshme. Një ndër to është përmenduar se është theksim për fjalën *"kel'la"*, e cila ka ardhur në ajetin e mëparshëm, që do të thotë se ata, në Ditën e Kiametit do t'i prezantojnë si legjenda dhe histori; ose kur thuhet: "Nuk është ashtu, sepse ndryshku që është vendosur në zemrat e tyre për shkak të mëkateve, bën që ata të mos e shijojnë të vërtetën as në këtë botë dhe as në Botën Tjetër".

Edhe pse në ajetet e tjera të Kur'anit thuhet se ata pretendonin se, edhe nëse do të ndodhte Kiameti, edhe atje do të ishin subjekt i bekimeve të ndryshme të All'llahut.[1] Jo, nuk është ashtu sikurse ata mendojnë. Në Kiamet ata do të jenë në një pozitë shumë të vështirë dhe do të vuajnë dënimin më të vështirë.

Po, Bota e Përtejme (Ahireti) është treguesi dhe paraqitja e madhe e veprave të njeriut në këtë botë. Ata që ulin shikimet e tyre

[1] Në ajetin 36 të sures "Kehf" thuhet: **"Unë kurrë nuk e besoj se mund të ketë Kiamet, edhe nëse do kthehem përsëri tek All'llahu dhe Kiameti të ndodhë, do të kem një vend më të mirë se ky që kam tani."**. E ngjashme me këtë fjali është edhe ajeti 50 i sures "Fussilet".

në këtë botë, për të mos parë të vërtetën dhe veprat e tyre, qëndrojnë në zemrat e tyre sikurse qëndron ndryshku mbi hekur apo mbi rrobë, edhe atje, ata janë të penguar nga All'llahu dhe në atë botë nuk do të kenë asnjë mik. Ata e kanë të ndaluar takimin me Krijuesin. **"Pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehennemit."**

Hyrja në zjarrin e Xhehennemit është përfundimi i pengesës së takimit me All'llahun, dhe nuk mund të ndahet prej tij. Në mënyrë shumë të qartë, zjarri është pengesë për të parë të vërtetën, e cila është më djegëse se sa zjarri i Xhehennemit.

Në ajetin 17 lexojmë: **"E do t'u thuhet: 'Ja, kjo ajo që e quanit të gënjeshtërt!'"**.

Kjo gjë atyre u thuhen në mënyrë qortimi dhe rikujtuese, për sa i përket të ardhmes dhe fatit të tyre. Dënimi për këtë grup kokëfortë është shpirtëror.

Dy hulumtime

1- Përse mëkati është ndryshk i zemrës?

Jo vetëm ajetet e kësaj sureje flasin për ndikimet e mëkatit me errësirën e zemrës, por edhe në shumë sure dhe ajete të tjera tëKur'anit të Shenjtë flitet në mënyrë të përsëritur për këtë gjë.

Në një tjetër vend thuhet:**"...Kështu, All'llahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi e dhunuesi."**.[1]

Në një ajet tjetër, për një grup nga grupet mëkatare dhe kryeneçe, thuhet: **"All'llahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh."**.[2]

Në ajetin 46 të sures "El Haxhxh", lexojmë: **"...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë** (në këto gjëra)**, por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor."**.

Po, është e vërtetë se ndikimi më i keq i mëkatit është verbimi i zemrës. Ai i rrëmben zemrës nurin, dritën e dijes dhe ndjesinë e të përcaktuarit. Gjymtyrët zbresin poshtë zemrës dhe zemrën e shndërrojnë në një moçal të qelbur dhe të kalbur, duke e maskuar. Ata nuk dinë ta dallojnë pusin. Kështu ata kryejnë një gabim shumë të madh, saqë i shqetësojnë të gjithë. Njeriu, me duart e tij, vendos që të prishë lumturinë e jetës së tij dhe pasurinë e lumturisë së tij e hedh në erë.

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Mëkatet e shumta e prishin zemrën e njeriut."*.[3]

Në një tjetër hadith, po të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Kur një rob i Zotit bën një mëkat, në zemrën e tij vihet një pikë e zezë. Nëse ai pendohet dhe largohet nga ai mëkat, zemra e tij pastrohet, por, nëse përsëri ai kthehet*

[1] Sure "El Gafir", ajeti 35.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 7.
[3] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 326.

dhe e kryen atë mëkat, pika e zezë shtohet edhe më shumë, saqë i përfshin të gjithë zemrën e tij.".

Kjo pikë e zezë është ndryshku që e përmendëm më lart në ajetin: **"Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t'i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre."**.[1]

Ngjashëm me këtë kuptim, por me pak ndryshim, transmeton edhe Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Hadithi gjendet në veprën "Usulul Kafij".[2]

Po ashtu, në të njëjtin libër, nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar)* është transmetuar: *"Bisedoni dhe takoni njëri–tjetrin. Transmetoni hadithet e të parëve, sepse hadithet janë dritë për zemrat dhe shpirtin e njeriut, zemrat marrin ngjyra. Ashtu si ndryshket shpata, edhe zemra ndryshket, atëherë lëmojeni atë me hadith."*.[3]

Sipas parimit të psikologjisë, është vërtetuar që veprat e njeriut reflektojnë gjithmonë në zemrën e tij dhe në mënyrë graduale e kthejnë njeriun në formën e tyre. Gjithashtu, veprat e njeriut ndikojnë edhe në gjykimin që ai jep.

Duhet ditur se, nëse njeriu e vazhdon mëkatin, çast për çast, ai e errëson shpirtin e tij, saqë arrin në një nivel që thotë se mëkatet e zbukurojnë atë, kështu njeriu arrin në stadin e krenarisë për mëkatet që kryen.

---

[1] Sure "El Mutaffifîn", ajeti 15.
[2] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 325.
[3] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 531, Hadithet 22 - 23.

Ja, kështu njeriu i mbyll portat e kthimit e në këtë mënyrë të gjitha urat e ngritura, shkatërrohen pas tij. Kjo është gjëja më e rrezikshme që mund t'i ndodhë njeriut në jetë.

2- Perdet që mbulojnë fytyrën e shpirtit

Edhe pse shumë komentues janë përpjekur që nga ajeti: **"Nuk është ashtu! Por veprat e tyre** (të këqija) **ua kanë mbuluar zemrat."**, të vlerësojnë diçka vetë, sipas mendimit të tyre thonë se këta mëkatarë janë larg mëshirës së All'llahut, ose janë larg mirëbërësve, dinjitetit e sevapit, faktikisht, ky ajet nuk ka aspak nevojë për vlerësim, sepse është thënë shumë qartë se ata ndalohen e pengohen nga All'llahu. Kur punëmirët, të drejtët dhe të pastrit do të nisin Rrugën drejt Krijuesit, për ta parë e për ta takuar të dashurin e tyre, në intuitën e brendshme, nuk ka kënaqësi më të madhe se sa ai takim, Xhehennemlinjtë, të pa fe dhe mëkatarë, pengohen ta shijojnë këtë kënaqësi të paparë.

Disa besimtarë, që e kanë zemrën e pastër, janë të përkëdhelur jo vetëm në këtë botë, por edhe në Botën Tjetër e shijojnë kënaqësinë e takimit me All'llahun, ndërsa arrogantët, që e kanë zemrën e tyre të verbuar, e kanë të ndaluar këtë kënaqësi jo vetëm në këtë botë, por edhe të parët e Krijuesit të Madhëruar në Botën Tjetër.

Ata vazhdimisht janë të pranishëm dhe nuk lejojnë që zemra e tyre të errësohet. Ata kënaqen pa masë, kur, nëpërmjet shpirtit të tyre, bisedojnë e flasin me Krijuesin, duke shfaqur çdo ndjenjë të

pastër nga thellësia zemrës. Ata kënaqen aq shumë, saqë e gjithë kjo nuk mund të shpjegohet apo të krahasohet me ndonjë gjë.

Por jobesimtarët janë zhytur aq shumë në mëkat, saqë për ta nuk ka rrugë shpëtimi. Po e ilustrojmë me disa fjalë të një poeti: "O ti që botën nuk do ta lësh mënjanë, si mund të kërkosh të arrish të vërtetën? E vërteta perde s'ka. Nëse ti e largon pluhurin, atëherë ka shans që të shikosh të vërtetën.

Prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, në lutjen e njohur të Komejlit, thotë: - "*Zoti im, edhe sikur të bëj durim përballë dënimit Tënd, si mund t'a duroj unë ndarjen prej Teje?"*

Ajetet 18 – 28

﴿كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْأَبْرَارِ لَفِي عِلِّيِّينَ١٨ وَمَا أَدْرَاكَ مَا عِلِّيُّونَ١٩ كِتَابٌ مَرْقُومٌ٢٠ يَشْهَدُهُ الْمُقَرَّبُونَ٢١ إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ٢٢ عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ٢٣ تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ النَّعِيمِ٢٤ يُسْقَوْنَ مِنْ رَحِيقٍ مَخْتُومٍ٢٥ خِتَامُهُ مِسْكٌ وَفِي ذَلِكَ فَلْيَتَنَافَسِ الْمُتَنَافِسُونَ٢٦ وَمِزَاجُهُ مِنْ تَسْنِيمٍ٢٧ عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا الْمُقَرَّبُونَ٢٨﴾

"Ndërsa Libri i punëdrejtëve me siguri që do të jetë në *Il'lijûn*."

"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është *Il'lijjûn*?"

"Është një libër i shkruar!"

"Atë e dëshmojnë të afërmit (e All'llahut)**."**

"Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhennet."

"Duke shikuar nga divanet."

"Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë."

"Atyre do t'u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë."

"Fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen."

"Dhe ai (musht) **do të përzihet me ujin e *Tesnimit*."**

"Nga burimi i të cilit do të pinë më të afërmit (e All'llahut)**."**

Komentimi

Të lartit në pritje të të mirëve

Në ajetet e lartpërmendura, u fol për librin e veprave dhe fatin e tyre. Në këto ajete do të flitet për një grup tjetër. Përballë imoralëve, qëndrojnë krenarë të drejtët.

Ajeti 18 thotë se nuk është ashtu si mendojnë ata për Ringjalljen, por libri i punëmirëve është në Il'lij'jin. **"Ndërsa Libri i punëdrejtëve me siguri që do të jetë në *Il'lijûn.*"**.

Fjala *"Il'lij'jin"* është shumësi i fjalës *"ili"* dhe ka kuptimin: *vend i lartë, të banuarit në një vend të lartë (pra, persona që banojnë në një vend malor)*.

Gjithashtu, u referohet edhe banorëve të malësisë dhe maleve. Në këtë rast, shumësi i tij ka kuptimin, vendi më i mirë në qiell. Këtë gjë e kanë komentuar edhe komentuesit.

Disa komentues kanë thënë se citimi i këtij termi është për shkak të theksimit dhe ka kuptimin "lartësi në lartësi".

Disa komentues, kanë thënë se fraza *"kitabul ebrar"*, tregon emrin e librit të besimtarëve dhe të punëmirëve. Në këtë libër janë shkruar të gjitha veprat e tyre, që tregon të gjitha punët e besimtarëve. Ky libër është në lartësi dhe pozitë shumë të lartë.

Gjithashtu, ky grup emëror, tregon se libri i veprave të tyre është mbi ta, në një vend shumë të shenjtë, ose qëndron në pozitën më të lartë tëXhennetit. Të gjitha këto janë shenja dhe tregojnë se pozita e tyre është jashtëzakonisht e lartë.

Në një hadith lexojmë: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Fjala *"Il'lijnin"* ka për qëllim shtatë qiejt, të cilët qëndrojnë nën Arshin e All'llahut".[1]

Kjo fjali është kundërvënie e librit të veprave të "fuxh'xharëve", të cilët do të qëndrojnë në vendin më të ulët dhe më të shpifur të kateve të Xhehennemit.

Një tjetër komentim që i është bërë fjalës *"kitab"*, ka kuptimin e të ardhmes dhe fatit të njeriut, si dhe gjykimit përfundimtar të Krijuesit, i cili ka përcaktuar që punëmirët të qëndrojnë në lartësinë më të lartë të Xhennetit.

Po ashtu, përmbledhja midis dy tefsireve është i mundur, që edhe libri i veprave të tyre të jetë i vendosur në një libër të vetëm, si dhe mbledhja e atij libri qëndron mbi qiejt, ku në to reflekton urdhri i All'llahut, që vetë ata të qëndrojnë në stadin më të lartë të Xhennetit.

---

[1] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7053; Tefsiri "Mexhmaul Bahrejn" nga rrënja "uluv".

Më tej, për të treguar rëndësinë dhe madhështinë e *"Il'lij'jin"* thotë: **"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është *Il'lijjûn*?"**.

E gjithë kjo tregon se vendi dhe pozita e tij është shumë më e mirë se sa "imagjinata, krahasimi, spekulimi dhe fantazia". Madje askush, as vetë Profeti Muhammed*(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk mund të shikojë madhështinë e Tij.

Më tej, vetë Kur'ani nis dhe shpjegon edhe më shumë këtë fjalë: **"Është një libër i shkruar!"**.

Sipas një interpretimi, fjala *"Il'lij'jin"* ka kuptimin e një libri të përgjithshëm të veprave, por sipas një interpretim tjetër, kuptimi i ajetit është: Ky fat është i sigurt, sepse All'llahu atë e ka bërë shkallën më të lartë të vendbanimit dhe të Xhennetit. (për këtë shkak, edhe grupi emëror *"Kitabun Merkum"* është sqarim për *"Kitabul Ebrar"* dhe jo për fjalën *"Inlijin"*.

Më tej shton se ky libër është libër mbi të cilin shikohen të afërmit, ose ku ata dëshmojnë: **"Atë e dëshmojnë të afërmit** (e All'llahut)**."**.

Një grup komentuesish, fjalën *"mukarr'rrabun"*, në këtë ajet, e kanë komentuar me kuptimin e engjëjve, të cilët janë të afërmit e All'llahut. Këta engjëj që janë të pranishëm në shkrimin e fatit, janë të pranishëm në shkrimin e fatit të punëmirëve. Por në ajetin e mëposhtëm sqarohet fare mirë se *"mukarr'rrabun"*, të afërmit, është një grup i veçantë, i përzgjedhur për besimtarët, të cilët kanë një pozitë shumë të madhe. Ata janë vëzhguesit e kryerjes së veprave dhe, po ashtu, janë vëzhguesit e librit.

Në ajetet 10-11 të sures "El Uakia", pas citimit të dy grupeve *"Es'habul'l Mejmene"* dhe *"Es'habul "Mesh'emeh",* thotë: **"Ata që kanë prirë** (në besim) **e që do të prijnë** (edhe në Xhennet)**. Ata janë të afërtit** (tek All'llahu)**."**.

Në ajetin 89 të sures "Nahl", lexojmë: **"Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty** (Muhammed) **dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët."**.

Më tej, në ajetin 22 të sures që po diskutojmë, flitet për një pjesë të shpërblimeve të mëdha të punëmirëve. Të mirët qëndrojnë në mesin e bekimeve. Ata i përjetojnë kënaqësitë. **"Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhennet."**.

Kuptimi kryesor i fjalës *"en neijm"*, sipas thënies së Ragibit, në librin "Mufredat" është një bekim i madh. Në këtë rast, është arsyetim dhe argument për një gjë shumë të madhe. Ata janë plot mirësi dhe plot bereqet, saqë nuk mund ta shpjegojmë. Ky interpretim i plotë dhe i përgjithshëm, tregon për të gjitha dhuratat materiale dhe shpirtërore të Xhennetit.

Pas kësaj është folur për disa nga ato mirësi dhe bereqete. Ata janë mbështetur në kolltukët e bukur të Xhennetit, duke vështruar bukuritë e tij.[1]

"Duke shikuar nga divanet."

[1] Në këtë fjali, kryefjala është lënë jashtë. Në këtë rast, do të ishte: "Hum alel Eraiki Jendhurun". Në këtë fjali, fjala *"jendhurun"* tregon gjendjen, edhe pse fjala *"Ala Eraik"* ka kuptimin "lajm pas lajmi".

Fjala *"el eraik"* është shumësi i fjalës *"erijketu"*, që ka kuptimin: *kolltukë të bukur mbretërore, ose kolltukë me plot shkëlqim e bukuri, që vendosen nëpër frone*. Në këtë rast, flitet për kolltukë shumë të bukur të Xhennetit, ku në to janë mbështetur dhe ulur punëmirët.

Disa besojnë se origjina e kësaj fjale vjen nga gjuha perse. Fjala *"urkun"* ka kuptimin: *kështjellë mbretërore*. (Kjo fjali, gjithashtu, ka kuptimin e një kështjelle, e cila është brenda qytetit, sepse kështjellat brenda qytetit janë vetëm për mbretërit, ndaj edhe i është referuar kësaj fjale).

Disa të tjerë janë të mendimit se fjala *"eraik"* është njëjës dhe vjen nga fjala perse *"erak"* ose *"eraik"*, që ka kuptimin: *kolltuk i mbretit*. Gjithashtu, ky term është etiketuar edhe me kuptimin e kryeqytetit. Ndaj dhe qyteti i Irakut është quajtur i tillë, sepse është marrë nga fjala "irak".

Thuhet se fjala *"era'ik"* ka edhe kuptimin e fjalës *"kolltuk"* dhe të fjalës *"mbretëri"* në qytet.

Disa dijetarë të gjuhës arabe, rrënjën e kësaj fjale e konsiderojnë arabe dhe besojnë se fjala vjen nga rrënja *"erak"*, që është emri i një peme të njohur me të cilën ndërtonin kolltukë, strehë etj.[1]

Por në Kur'anin e Shenjtë, fjala *"erak"* është përdorur me kuptimin e kolltukëve ose froneve të bukura, frone që përdoren nga pronarë që kanë bekim dhe pushtet.

[1] Shikoni në veprat: "Lugat Name Dekhoda", "Divan Din", "Mufredat Ragib" dhe "Burhan Khate".

Sa i përket përdorimit të termit *"jendhurun"* - *"shikojnë"* e cila nuk shprehet qartë se çfar shikojnë ata? Në mënyrë që të këtë një kuptim sa më të gjerë dhe të përgjithshëm. Po, ata me mirësinë e Zotit shikojnë, ata shikojnë nga mirësia e All'llahut, ata shikojnë bukuritë e pashembullta të Tij, si bekime të Xhennetit.

Në këtë rast, të parët është dhurata më e madhe e njeriut, sepse një ndër gjërat më të rëndësishme të kënaqësive të njeriut është kënaqësia e të parit.

Më poshtë shton se në fytyrat e tyre mund të shikohet freskia dhe kënaqësia e mirësisë: **"Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë."**.

Në këtë rast, ajeti tregon gëzimin, kënaqësinë dhe lumturinë që vërehet në fytyrat e tyre. Gjithçka është e dukshme në fytyrat e tyre dhe nuk ka vend për pyetje. Te xhehennemlinjtë është e kundërta. Nëse vështrojmë fytyrat e tyre, nuk shikohet tjetër përveç hidhërimit, dhimbjes, trishtimit dhe fatkeqësisë. Të gjitha këto janë të dukshme në fytyrat e tyre.

Për sa i përket fjalës *"nedhretun"*, sikurse është cituar edhe më parë, ka kuptimin e freskisë dhe të fuqisë, e cila vihet re në fytyrat e të pasurve.

Pasi flet për bukurinë dhe mirësinë e të parit, si dhe për kënaqësinë dhe fuqinë, kthehet te një tjetër bekim, i cili është të pirët. Atyre do t'u jepet për të pirë nga enë të mbyllura. **"Atyre do t'u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë."**.

Pija e atjeshme është e freskët dhe plot bekime. Nuk është si pijet e këtushme, të cilat janë të përziera me mëkatin, budallallëkun

dhe dehjen e keqe. E kundërta është me pijen në Xhennet. Ajo të sjell kënaqësi dhe dashuri.

Shumica e komentuesve të tefsirëve, fjalën *"rrahijk"* e kanë marrë me kuptimin e pijes së pastër të papërzier, pije që, në vetvete, nuk përmban asnjë lloj papastërtie.

Fjala *"mekhtum"*, në gjuhën e sotme perse, është zëvendësuar me fjalën *"derbeste" – "kokë apo derë e mbyllur, e vulosur"*. Kjo tregon se ajo është e pastër dhe e paprekur nga askush. Përveç kësaj, përdorimi i një ene të tillë tregon respektimin e mikut, pra, është enë e mbyllur dhe e vulosur dhe vula e tij mund të hiqet nga vetë miku.[1]

Më tej shton se kësaj pijeje i vjen era misk: **"Fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen."**.

"Khitamuhu Misk...". Këto enë nuk janë si enët që i përdorim ne në këtë botë, që, kur bëjmë t'i hapim, duart na bëhen pis, pra, pija e Xhennetit nuk është e tillë. Kur e hapim, jo vetëm duart tona aromatizohen, por i gjithë mjedisi.

Disa të tjerë, thonë se qëllimi i përdorimit të kësaj fjale është të tregojë se, kur përfundon së piri pijen, nga goja e njeriut vjen erë e këndshme misku, e kundërta e pijeve alkoolike, të cilat janë të ndyta dhe, kur i pi, goja të hidhërohet e të merr aromë të keqe. Por

[1] Jo vetëm në kohët e mëparshme, por edhe në ditët tona, zakonisht përdoren enë që nuk ka ngrënë njeri më parë. Pra, shikohet dhe vërtetohet që ena të jetë e pastër e paprekur nga askush tjetër. Për ta vërtetuar se ena nuk është e përdorur, ajo mbyllet hermetikisht, ose me një fill në formë nyje. Mbi të, më herët, vendosej baltë, e cila thahej dhe forcohej, ose lidhej me diçka, duke e bërë nyje, me një shenjë apo vulë. Për ta hapur enën, nuk kishte rrrugë tjetër përveçse të thyhej koka apo vula që kishte ena. Arabët këtë lloj mbyllje e quajnë "mekhtum".

duke pasur parasysh interpretimin që i është bërë ajetit të mëparshëm, ky komentim është i pamundur.

Pasi citohen cilësitë e pijeve të freskëta të Xhennetit, thuhet se për këtë mirësi të Xhennetit dhe veçanërisht ndaj kësaj pije të pastër, njerëzit vihen në konkurrencë se, kush do të dalë i pari për ta pirë.

Një nga komentuesit e mëdhenj, si Tabrisi,në tefsirin e tij "Mexhmaul Bejan", thotë se fjala "*tenafis*" ka kuptimin e shpresës dhe përpjekjes së dy personave që dëshirojnë që diçka të mirë, ta bëjë pjesë të tyren.

Ndërsa në tefsirin"Mexhmaul Bahrejn" thuhet se fjala "*tenafis*" ka kuptimin e konkurrencës së drejtë.

Ragibi, në librin e tij "Mufredat", thotë se fjala "*munafese*" ka kuptimin e përpjekjes së njeriut për të qenë i ngjashëm me njerëzit më të mirë. Gjithashtu, tregon bashkimin e njeriut me të tjerët, por pa u bërë dëm atyre.

Në të vërtetë, ky ajet ka ngjashmëri me ajetin 21 të sures "El Hadid": **"Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka..."**.

Në ajetin 133, të sures "Ali Imran", thuhet: **"Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhennetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka..."**.

Megjithatë, interpretimi që është bërë në këtë ajet, është i mrekullueshëm, që bëhet për të nxitur njerëzit që të grumbullojnë sa më tepër mirësi nëpërmjet besimit dhe veprave të tyre. Kur'ani

i Shenjtë flet shumë qartë për këtë punë, si dhe e pasqyron atë në mënyrën më të rregullt.[1-2]

Kur arrin në fund të mirësisë, për të cilën u cituan një sërë ajetesh, thotë se kjo pije e (pastër) është e përzier me tesnim" (pije më e mirë). Është po ai burim në të cilin do të pinë më të afërmit.[3]

"Dhe ai (musht) **do të përzihet me ujin e *Tesnimjit*, nga burimi i të cilit do të pinë më të afërmit** (e All'llahut)**."**.

Nga këto ajete kuptohet se fjala *"tesnijm"* tregon pijen më të mirë e më të pastër të Xhennetit, të cilën do ta pinë të afërmit e All'llahut. Ndërsa për disa nga punëmirët e të devotshmit, një pjesë të pijes do të përziet me *"Rrahjikul Mekhtum"*, *"Rrahijkul Mekhtum"*, është një lloj tjetër nga pijet e pastra të Xhennetit.

Ka disa mendime nga komentuesit e Kur'anit, se përse kjo pije apo ky burim quhet *Tesnijm*. Disa janë të mendimet se është quajtur *"Tesnijm"*, sepse ka kuptimin e burimit që vjen nga lart poshtë.

---

[1] Ajo që u tha në komentim të ajetit, është shumë e qartë dhe qartëson se në fjalën *"dhalik"* të gjitha mirësitë janë të Xhennetit. Ajo çka e bën të veçantë këtë pije, është pastërtia dhe cilësitë e tjera që u cituan në ajetin kur'anor.

[2] Për shkak se ajetin kur'anor: **"ue fi dhalike fel jetenafesil mutenafisun"**, është lidhësja *"uau"* dhe *"fa"*, shtrohet pyetja: Si ka mundësi, të vijnë njëra pas tjetrës dy lidhëza? Përgjigjja më e përshtatshme është: Në këtë rast, fjala që përcjell kushtin, është hequr. Duhet të ishte: "Ve In Uride Tenafesu fi shei feljetenafes fi dhalikel mutenafisun". Në këtë mënyrë, fjala e kushtëzuar dhe fjalia e kushtëzuar është hequar dhe fjala *"dhalike"*, gjithashtu, ka qenë e paraprirë.

[3] Ka shumë mendime për të shpjeguar se pse fjala *"ajnen"* është emër. Disa kanë thënë se shpreh gjendjen për fjalën *"tesnijm"*, ose shpreh pastërtinë, ose është lavdërim dhe vlerësim. Ndërsa shkronja *"ba"* te *"biha"* është e shtuar, ose ka ardhur me kuptimin *"min"*, që kjo e fundit është më e përshtatur për të.

Disa mendimtarë të tjerë, janë të mendimit se ky burim është i veçantë dhe qëndron në katet e larta të Xhennetit.

Ndërsa disa të tjerë thanë se është pije e Xhennetit e cila zbret poshtë.

Në të vërtetë, pijet e Xhennetit janë të shumëllojta. Disa burojnë nga lumenjtë dhe janë citur në ajete të ndryshme të Kur'anit: **"Ja përshkrimi i Xhennetit, që u premtohet të përkushtuarve** (ndaj All'llahut)**: një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehennemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!"**.[1]

Disa janë të mbyllura dhe të vulosura në enë, sikurse u tha në ajetin e mësipërm. Është e rëndësishme të theksojmë se ajo është një pije që vjen nga qiejt e lartë të Xhennetit. Pra, buron nga lart. Kjo pije quhet *"Tesnijm"*.

Këtë pije nuk e arrin asnjë nga pijet e tjera të Xhennetit. Natyrisht, ndikimin që ka për shpirtrat e xhennetlinjëve, është ai më i miri dhe më tërheqësi, e cila nuk mund të shpjegohet.

Këtë të vërtetë duhet ta përsërisim edhe një herë tjetër, sepse të gjitha këto janë frymë që shikohen nga larg, sepse përshkrimi i mirësive të paarritshme të Xhennetit nuk mund të bëhen me asnjë kalem apo gjuhë. Sikurse e thotë vetë Kur'ani i Shenjtë: **"Askush**

[1] Sure "Muhammed", ajeti 15.

nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në Jetën Tjetër)**, si shpërblim për punët e mira që kanë bërë."**.[1]

Hulumtim

Në ajetet e Kur'anit të Shenjtë është cituar shumë herë për fjalën *"ebrar"*, punëmirët të devotshmit dhe për fjalën *"mukarr'rrabun"*, më të afërmit me All'llahun. Gjithashtu, është folur edhe për pozitën dhe shpërblimet e mëdha të tyre. Në ajetin 193 të sures "Ali Imran" lexojmë se "ulul elbab" – *"pronarët e ideve të forta"* bëjnë kërkesë që fundi i jetës së tyre të jetë me *"ebrarët"* – "vepërmirët, të devotshmit". Ndërsa në ajetet e sures "El Insan" janë cituar shpërblime të rëndësishme për ta: **"Sigurisht, të ndershmit besimtarë do të pinë** (në Xhennet) **kupa me pije të përzier me Kafur, nga burimi që vetëm robtë e All'llahut pinë dhe të cilin mund ta çojnë nga të duan. Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës** (së Kiametit)**, tmerri i së cilës përhapet gjithkund. Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: 'Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.'"**

[1] Sure "Es Sexhde", ajeti 17.

“Por All’llahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim dhe, për durimin e tyre, Ai do t’i shpërblejë me Xhennet dhe petka të mëndafshta.”

“Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë. Hija e pemëve të tij (Xhennetit) **është afër mbi kokat e tyre, ndërsa frutat e tyre do t’i kenë afër sa t’i arrijnë me dorë. Aty do t’u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali, kupa të tejdukshme argjendi, madhësinë e të cilave** (do ta zgjedhin) **sipas dëshirës. Aty do të pinë gota me pije të përzier me Xhenxhefil, prej një burimi të quajtur Selsebil. Atyre do t’u shërbejnë djem përherë të rinj, që, kur i shikon, të duken si margaritarë të shpërndarë. Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe. Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjendtë. Zoti i tyre do t’u japë të pinë pije të pastër. Ky do të jetë me të vërtetë shpërblimi juaj; përpjekjet tuaja do të jenë të pranuara.”**.[1]

Po ashtu, në suren “El Infitâr” ajeti 13, si dhe në ajetin që po diskutojmë tani, te surja “Mutaffifîn” janë përmendur vazhdimisht mirësitë dhe përkëdheljet Hyjnore në lidhje me ta.

Fjala *“el ebraru”* – *“vepërmirët”*, sikurse e cituam edhe më lart, është shumësi i fjalës *“berr'rru”*, pra, vepërmirët janë ata që kanë shpirt të gjerë, të lartë si dhe besim e vepra të mira. Ndërsa fjala *“mukarr'rrabun”*, tregon afrimitetin dhe pozitën tek All’llahu.

Midis këtyre dyve ekziston e përgjithshmja dhe e veçanta absolute, që do të thotë se të gjithë të afërmit *“mukarr'rrabun”* janë

[1] Sure “El Insan”, ajetet 5–22.

nga *"el ebraru"* – *"vepërmirët"*, por jo të gjithë *"el ebraru"* – *"vepërmirët"* qëndrojnë në vendin e të afërmve të All'llahut *(mukar'rebaneve)*.

Në një hadith nga Imam Hasan Muxhteba *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Kudo që, në Kur'anin e Shenjtë, shikon fjalën 'ebrar' – 'vepërmirë', ju betohem në Zot, se fjala është për Ali ibn Ebu Talibin, Fatimen, Mua (Hasanin) dhe Husejnn."*.[1]

Padyshim që pesë të dëlirët, ato pesë drita të shenjta, janë shembulli më i qartë dhe më i afërm për fjalët *"ebrar"* dhe *"mukar'rebin"*.

Edhe në komentimin e sures "El Insan", është thënë kjo sure flet për Ali ibn Ebu Talibin, Fatimen, Hasanin dhe Husejnn *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*. Në tetëmbëdhjetë ajete flitet për cilësitë e tyre, edhe pse zbritja e ajeteve nuk është pengesë për përgjithësimin dhe përhapjen e kuptimit të ajeteve.

Nga ajetet e ndryshme të Kur'anit të Shenjtë kuptohet më së miri se në Xhennet ka lloje të ndryshme pijesh të pastra, me emra dhe me cilësi të ndryshme. Këto pije, nga cilado anë që të merren, janë të ndryshme nga pijet e kësaj bote. Pijet e kësaj bote, mendjen e njeriut e lënë mënjanë, e budallallepsin njeriun, bëhen shkak i gjakmarrjes, shtojnë gjakderdhjen dhe korrupsionin, janë të shpifura në aromë dhe në shije.

Pijet e Xhennetit bëjnë që mendja e njeriut të jetë e gëzuar, shton dashurinë, kanë aromë të këndshme dhe janë të freskëta e të

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 533, Hadithi 33; "Biharul Enuar", vëll. 24, f. 3 (me pak ndryshim).

pastra. Personat që pinë nga ato pije, shkojnë në ekstazë shpirtërore të papërshkruar. Dy prej tyre janë cituar në këtë sure *"Rrahijkul Makhtum"* dhe *"Tesnijm"*.

Ndërsa llojet e tjera janë cituar në suren "El Insan" dhe në suret e tjera të Kur'anit të Shenjtë. Secilën prej tyre e kemi përshkruar më parë.

Është për t'u habitur se si në hadithe të ndryshme është cituar fakti se këto pije të Xhennetit janë shpërblim i atyre që kanë hequr dorë nga pijet alkoolike të kësaj bote. Pijet e Xhennetit e shuajnë etjen e të eturve dhe shuajnë zjarrin e hidhërimit e të trishtimit në zemrat e besimtarëve.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thotë Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"O Ali! Ai që, për hir të All'llahut, heq dorë nga pijet alkoolike, All'llahu i Madhëruar do t'i shuajë etjen atij me ujë Xhenneti, ujë që është i vulosur."*[1] (Pra, All'llahu e shpërblen atë jo me çfardolloj uji, por e thekson, me ujë të vulosur).

Po ashtu, në një tjetër hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, thuhet: *"Edhe nëse heqin dorë nga pijet alkoolike dhe nuk e bëjnë për hir të All'llahut, përsëri All'llahu Mëshirëplotë u jep atyre të pinë nga uji i Xhennetit."*.

Më pas Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, e pyet: "O Resulullah, edhe për ata që nuk e pinë për hir të All'llahut?"

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 534, Hadithi 37 dhe 40; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 114.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *"Po! Nëse dikush, për të ruajtur shpirtin e tij, heq dorë nga pijet alkoolike të kësaj bote, All'llahu ia shuan etjen atij nga pija e 'Rrahijkul Makhtum'."*.[1] Po ky grup që e lë pijen për të ruajtur shëndetin e tij, është nga *ulul elbab,* të zotët e mendjes, sikurse thuhet edhe në ajetin 193 të sures "Ali Imran".

"Ulul elbab" – *"të zotët e mendjes"* janë afër të mirëve dhe do të shijojnë pijet e pastra të Xhennetit.

Në një hadith të transmetuar nga Ali ibn Husejn *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Nëse dikush shuan etjen e një besimtari, All'llahu i shuan atij etjen nga uji 'Rrahijkul Makhtum'."*.[2]

Në një tjetër hadith, thuhet: *"Ai që në ditët e nxehta të verës mban agjërim, në Ditën e Kiametit, All'llahu do t'ia shuajë etjen me 'Rrahijkul Makhtum'."*.[3]

[1] Shiko futnotën e mësipërme.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 534, Hadithi 35; Tefsiri "Kafij", vëll. 2, f. 201.
[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 456, në vazhdim të ajetit për të cilin u diskutua; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 114.

Ajetet 29 – 36

﴿إِنَّ الَّذِينَ أَجْرَمُوا كَانُوا مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا يَضْحَكُونَ٢٩ وَإِذَا مَرُّوا بِهِمْ يَتَغَامَزُونَ٣٠ وَإِذَا انْقَلَبُوا إِلَى أَهْلِهِمُ انْقَلَبُوا فَكِهِينَ٣١ وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوا إِنَّ هَؤُلَاءِ لَضَالُّونَ٣٢ وَمَا أُرْسِلُوا عَلَيْهِمْ حَافِظِينَ٣٣ فَالْيَوْمَ الَّذِينَ آمَنُوا مِنَ الْكُفَّارِ يَضْحَكُونَ٣٤ عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ٣٥ هَلْ ثُوِّبَ الْكُفَّارُ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ٣٦﴾

“Vërtet, keqbërësit qeshnin me ata që besonin.”

“Duke ia shkelur syrin njëri-tjetrit, sa herë që ata kalonin pranë tyre.”

“Kur ktheheshin te njerëzit e vet, ata talleshin (me besimtarët)**.”**

“Dhe, kur i shihnin ata, thoshin: ‘Këta janë të humbur’.”

“Ndonëse nuk qenë dërguar për kujdestarë të tyre.”

“Por sot, ata që kanë besuar, do t’i përqeshin jobesimtarët.”

“E nga divanet e ngritura do t’i shikojnë.”

”A janë shpërblyer meritueshëm mohuesit për atë që kanë bërë?!”

Komentimi

Deri dje talleshin me besimtarët, por...!!

Komentuesit e Kur'anit kanë cituar dy shkaqe për zbritjen e këtyre ajeteve. Shkaku i parë: Thuhet se, kur Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe disa besimtarë po kalonin pranë një grupi jobesimtarësh të Mekës, ata qeshën me të dhe me besimtarët që e shoqëronin. Ajetet zbritën për të qartësuar fatin e këtij grupi jobesimtarësh, të cilët fyen dhe ofenduan besimtarët.

Hakem Abulkasem Hesekanij, në librin e tij "Sheuahidul Tenzijl" transmeton nga Ibn Abazi se përdorimi i grupit emëror "*Inel'ledhine Exhremu*", ka si qëllim të tregojë jobesimtarët kurejsh, ndërsa përdorimi i "*El'ldhine Amenu*", ka si qëllim të tregojë Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe shokët e tij.[1]

Për më tepër ajetet e mësipërme kanë zbritur për njerëz të tillë sikurse është Amari, Suhejbi, Khabbabi, si dhe për besimtarët të tjerë që ishin të varfër. Këta njerëz ofendoheshin dhe talleshin nga Ebu Xhehli, Uelijd ibn Mugijretu dhe El As ibn Uaili.[2]

Përmbledhja midis këtyre dy shpalljeve është plotësisht i mundur.

Në ajetet e mësipërme u fol për mirësitë dhe begatitë e mëdha të njerëzve të mirëve "Ebrar" dhe "Mukarr'rrabun". Ndërsa

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 457. Ky ajet ka zbritur për Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe jobesimtarët e Mekës. Në shumë tefsire, si: "Kurtubij", "Ruhul Meanij", "Kesh'shaf", "Fakhri Rrazij" dhe të tjerë si këta, është folur për zbritjen e këtyre ajeteve.

[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 3, f. 76.

në ajetet që po diskutojmë, flitet për një pjesë të jetës së besimtarëve, që vuajnë dhe heqin keq për shkak të besimit dhe të devotshmërisë së tyre. Këtu qartësohet se ai shpërblim i madh nuk është i pallogaritur. Në këto ajete flitet për sjelljen e pahijshme të jobesimtarëve dhe për katër llojet e reagimeve të tyre.

Së pari, thuhet se punëkëqinjtë (në këtë botë) tallen vazhdimisht me besimtarët: **"Vërtet, keqbërësit qeshnin me ata që besonin."**.

Qeshja me ironi dhe me poshtërim vinte nga personat arrogantë, mendjemëdhenj. Ata, për të ofenduar besimtarët e devotshëm, silleshin në këtë mënyrë të turpshme.

Fjala *"exhremu"* është vendosur në vend të fjalës *"keferu"* dhe tregon se personat jobesimtarë dhe pa besim mund të njihen nga veprat e tyre të pista, sepse mungesa e besimit është burim i krimit dhe i rebelimit.

Në ajetin tjetër shikohet sjellja e keqe e tyre, që, kur kalojnë pranë tyre, i tallin ata duke i treguar me gisht: **"Duke ia shkelur syrin njëri-tjetrit, sa herë që ata kalonin pranë tyre."**.

Me këto shenja dhe me këto gjeste, ata thoshin: "Shikoni këta që nuk kanë kokë e nuk kanë këmbë, ata janë afër Krijuesit! Shikoni këta mëngëgrisur dhe këta këmbëzbathur, që pretendojnë se janë mbartësit e Shpalljes Hyjnore! Shikoni këtë grup injorantësh, që thonë se eshtrat e bëra dhe do të ringjallen edhe një herë!".

Të gjithë këto ishin shembuj, nga fjalët dhe gjestet që përdornin mushrikët për të ofenduar dhe për të injoruar besimtarët.

Duket sikur buzëqeshja dhe tallja e jobesimtarëve niste kur besimtarët mbidheshin me njëri–tjetrin. Kur jobesimtarët i shikonin, ata nisnin t'i tallnin e të bënin me shenjë, kur nuk kishin mundësi të flisnin me fjalë. Por në vendet ku myslimanët ishin në numër të paktë, jobesimtarët i tallnin ata me shumë lehtësi.[1]

Fjala *"jetegamezune"* vjen nga rrënja e fjalës *"el gamzu"*, që ka kuptimin e të bërit shenjë me sy apo me dorë, në një diçka që është për t'u qortuar apo që është vënë në shënjestër të përflitet me fjalë fyese. Ndodh që ky term të përdoret në të gjitha mënyrat, pra, si duke bërë shenja me mimikën e fytyrës apo duke ofenduar me fjalë.

Prandaj dhe është përdorur kjo fjalë *"et tegamuz"*, sepse është argument për ata që e bënin këtë fyerje përballë njëri-tjetrit, pra, dikush ofendonte me gojë dhe dikush tjetër bënte me shenja. Këto ishin veprime skandaloze.

Ndërsa për sa i përket përballjes së tretë, thotë: Të gjitha këto ishin reagimet dhe sjelljet e tyre me besimtarët. Po ashtu, edhe në takimet personale, ishte po i njëjti ritual. Ata fyenin dhe ofendonin besimtarët, ashtu si thotë edhe vetë ajeti kur'anor: **"Kur ktheheshin te njerëzit e vet, ata talleshin** (me besimtarët)**."**.

[1] Komentuesit kanë dhënë dy mundësi për qëllimin e përdorimit të përemrit *"meru"* dhe *"bihim"*. Disa janë të mendimit se përemri i parë u referohet jobesimtarëve dhe i dyti u referohet besimtarëve. Disa të tjerë kanë dhënë të kundërtën e asaj që thamë. Mendimi i parë duket më i përshtatshëm.

Kur ktheheshin në mesin e familjarëve të tyre, ishin të qeshur dhe të lumtur. Duken sikur kanë fituar, krenohen me çka bëjnë dhe e vazhdojnë ofendimin dhe fyerjen.

Fjala *"fakihijn"* është shumësi i fjalës *"fekkeh"* dhe është mbiemër. Ky mbiemër vjen nga fjala *"el fekahatu"* dhe ka kuptimin: *tallje dhe shaka*.

Në të vërtetë, fjala *"fakihatu"* ka kuptimin: *fryt*.

Ata, nëpërmjet talljeve dhe bisedave, ndienin kënaqësi, njëjtë siç ndihet kënaqësi nga ngrënia e frutave. Po ashtu, bisedat e ëmbla midis miqsh quheshin *"fukahatu"*.

Edhe pse fjala *"ehlu"*, zakonisht ka kuptimin e familjes dhe të afërmve, në këtë rast, mund të ketë kuptim të gjerë. Kjo fjalë i përfshin gjithashtu, edhe miqtë e afërm.

Reagimi i katërt i lig i tyre ndaj besimtarëve ishte që ata i quanin të humbur: **"Dhe, kur i shihnin ata, thoshin: 'Këta janë të humbur.'"**.

Ata i konsideronin të humbur, sepse ishin larguar nga tradita e adhurimit të idhujve dhe kishin përqafuar fenë islame dhe besonin në një Zot. Kështu, sipas mendimit të jobesimtarëve, këta ishin të humbur.

Ky interpretim që ata bënë për besimtarët, mund të këtë faza: Tallja për ta ishte e pashmangshme, sepse ishte pjesë e së kaluarës; tregon më shumë intensitet, ndaj dhe gjithmonë, kur shfaqej një Profet i madh dhe një traditë e re, domosdo që do të kishte reagime dhe kundërshtime nga armiqtë. Si fillim, ata

reagonin duke i tallur dhe duke i ofenduar këta njerëz. Ata, traditën e re, e shikonin si diçka të pavlerë dhe nuk merreshin seriozisht me të, që të kuptojnë, por, kur feja hyjnore depërton në zemrat e njerëzve dhe mbledh pas vetes sa më shumë njerëz, jobesimtarët ndihen në rrezik dhe kështu që e marrin si problem serioz këtë çështje.

Ata, për t'u përballur me besimtarët, nisnin disa faza dhe i bënin më intensive. Pra, në fillim e nisën me tallje, më pas duke ofenduar e duke i konsideruar besimtarët të humbur e më tej nisnin luftëra të përgjakura. Pra, faza e fundit e tyre ishte lufta.

Zakonisht besimtarët nuk ishin mirë nga gjendja ekonomike, ndaj dhe jobesimtarët i shikonin ata me syrin e poshtërimit dhe të përulësisë. Besimi i tyre konsiderohej si i pavlerë dhe feja e tyre konsiderohej si gjë e çuar dëm. Kur'ani, në ajetin tjetër, thotë: **"Ndonëse nuk qenë dërguar për kujdestarë të tyre."**.

Pra, me ç'të drejtë dhe sipas cilës logjikë kërkonin t'i mbronin ata?!

Në ajetin 27 të sures "Hud" lexojmë se të pasurit dhe të fuqishmit e popullit të Profetit Nuh *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i thoshin atij: **"Por, paria e popullit të tij, e cila nuk besoi, tha: 'Ne shohim se ti je thjesht njeri si ne dhe, shohim, që ty të shkojnë pas vetëm më të pavlerët nga ne, pa menduar fare. Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne, madje ju quajmë gënjeshtarë.'"**.

Profeti Nuh *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u përgjigjej: **"Unë nuk ju them se kam thesarin e All'llahut apo që e di të padukshmen. As nuk them se unë jam engjëll e as do t'u them atyre, të cilët sytë tuaj i nënçmojnë, se All'llahu nuk do t'u japë kurrfarë të mire.**

All'llahu e di më mirë se ç'ka në shpirtrat e tyre. Atëherë, sigurisht që do të isha prej të padrejtëve.".[1]

Kjo është përgjigje për ata njerëz egoistë, që thonë se ç'ju duhet ju, se nga cili grup jeni ju. Ju lexoni tekstin e ftesës dhe përmbajtjen e fesë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Por në Ditën e Kiametit, çështja do të jetë ndryshe, saqë në ajetin tjetër thotë: **"Por sot, ata që kanë besuar, do t'i përqeshin jobesimtarët."**.

Kiameti pasqyron veprat e njeriut në këtë botë, sepse atje duhet të kryhet drejtësia Hyjnore. Drejtësi kryhet atje ku besimtarët e pastër do t'u thonë jobesimtarëve, të njëjtën gjë që ata u thoshin atyre në këtë botë. Kjo, në vetvete, është një lloj dhimbje e madhe për mendjemëdhenjtë.

Në disa nga hadithet e transmetuara nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Në atë ditë (Dita e Kiametit) do të hapet një derë për jobesimtarët nga Xhenneti. Ata, duke menduar se ka ardhur urdhri i lirisë së tyre nga Xhehennemi dhe hyrjes së tyre në Xhennet, nisen drejt asaj dere. Kur arrijnë pranë asaj dere, papritur dera mbyllet. Kjo gjë për ata përsëritet disa herë, ndërsa besimtarët që janë në Xhennet, e shikojnë këtë gjë dhe qeshin."*.[2]

[1] Sure "Hud", ajeti 31.
[2] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 327 (me pak ndryshim).

Ndaj edhe në ajetin më pas thotë: **"E nga divanet e ngritura do t'i shikojnë."**.Ata janë të ulur në divanet e zbukuruara të Xhennetit dhe shijojnë fatin e atyre.

Ku shikojnë ata? Te të gjitha ato mirësi të pafundme të All'llahut, tek ato dhurata të paimagjinuara, tek ajo qetësi dhe madhështi respekti, tek ai dënim i dhimbshëm që qafirët mendjemëdhenj dhe egoistë do të vuajnë poshtërimin.

Si përfundim, në ajetin e fundit të kësaj sureje, me një fjali pyetëse thotë: **"A janë shpërblyer merituesshëm mohuesit për atë që kanë bërë?!"**.

Ky fjalim si të jetë nga ana e All'llahut, si të jetë nga ana e engjëjve apo e besimtarëve, është një lloj tallje dhe sharje për jobesimtarët dhe pretenduesit mendjemëdhenj, të cilët ishin në pritje që, në përballje të veprave të tyre të këqija, të merrnin dhuratë dhe shpërblim nga All'llahu. Kundrejt këtij iluzioni të rremë, thotë: "A e kanë marrë shpërblimin e tyre jobesimtarët për atë që bënë?".

Shumë komentues, këtë fjali e konsiderojnë si fjali të pavarur, ndërkohë që disa besojnë se është vazhdim i ajetit të mëparshëm, që thotë se besimtarët janë të ulur në divane të zbukuruara dhe shikojnë jobesimtarët, nëse e kanë marrë apo jo shpërblimin e punëve dhe veprave që kanë bërë në kundërshtim me fenë islame. Po, nëse ata do të marrin shpërblim (jobesimtarët), duhet ta marrin nga shejtani. Por a mund ta marrin shpërblimin ata të varfër nga një i varfër dhe përfshirë këtë çështje?!

Fjala *"theuuebe"* vjen nga rrënja *"eth theub"*, që ka kuptimin e kthimit të një gjëje në gjendjen e mëparshme. *"Eth theuab"* i thonë një shpërblimi që i jepet njeriut në këmbim të veprave që kryen.

Sepse rezultati i veprave që ne kryejmë, rikthehet tek ne. Kjo fjalë përdoret edhe për punët dhe veprat e mira, edhe për punët dhe veprat e këqija, edhe pse ndodh që kjo fjali të përdoret edhe për gjëra të tjera.[1]

Ajeti i mësipërm tregon llojet e sharjeve për jobesimtarët dhe duhet të jetë i tillë, sepse ata, gjithmonë, talleshin me besimtarët dhe me ajetet e All'llahut. Ndaj dhe në atë ditë, ata do të shikojnë rezultatin e veprave të tyre.

Hulumtim

Tallja është arma e të dëshpëruarit

Për gjatë gjithë historisë, lexojmë se Profetët *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*, në mënyrë të përsëritur, kanë pasur luftë me talljet e njerëzve, pra, të jobesimtarëve. Ajetet e Kur'anit të Shenjtë e kanë pasqyruar më së miri këtë çështje, për vetë faktin se talljet dhe ofendimet dalin nga goja e jobesimtarëve dhe e mendjemëdhenjve apo të atyre që janë të dehur dhe veten e tyre e konsiderojnë më të mirë se të tjerët.

[1] "Mufredat" i Ragibit, Termi "theuab".

Kështu, si rezultat i mendjemadhësisë, ata i shikonin të tjerët me syrin e përçmimit. Nuk është për t'u habitur që jobesimtarët kokëfortë dhe arrogant të kishin këtë lloj sjellje karshi besimtarëve.

Edhe në ditët tona e shikojmë dhe e hasim këtë gjë, si në median e shkruar, ashtu edhe atë vizive, në shkrime dhe programe të ndryshme, ku ofendimin dhe talljen e fesë e kanë në shënjestër. Ndërsa besimtarët, duke iu referuar premtimeve hyjnore, që shembulli i tyre është edhe në ajetet e lartpërmendura, bëjnë që njeriu të qetësohet dhe shpirti të përforcohet. E kundërta ndodh te jobesimtarët, sepse zemrat e tyre errësohen dhe shpirti i tyre lodhet.

Në parim, "sharja dhe ofendimi", e tallura dhe të qeshurat ndaj së vërtetës që u cituan në ajetet e mësipërme, janë të gjitha mëkate të mëdha, si dhe tregojnë injorancën dhe mendjemadhësinë. Një njeri i mençur dhe inteligjent e përdor arsyen e mendjes së tij. Edhe nëse nuk ka asnjë lloj besimi, vetëm duke përdorur logjikën, arrin të kuptojë. Ndaj dhe nuk e lejon veten e tij që të marrë pjesë në të tilla luftëra.

O All'llah, na ruaj nga mendjemadhësia dhe nga injoranca!

O All'llah, na bëj kërkues të së drejtës dhe na fal modestinë!

O All'llah, librin e punëve dhe të veprave tona na e vendos në Il'lij'jin dhe na largo nga "Sixh'xhinët".

Amin Ja Rabil Alemin.

Fundi i sures "El Mutaffifîjn".

Sure "El Inshikâk"

Zbritur në Mekë

Ajete 25

Përmbajtja e sures "El Inshikâk"

Kjo sure, sikurse edhe shumica e sureve të xhuzit të fundit të Kur'anit, flet për çështjen e Ringjalljes.

Në fillim të saj flitet për ngjarjen e tmerrshme dhe tronditëse të fundit të kësaj bote, si dhe për fillimin e Kiametit.

Në fazën e dytë, kjo sure flet për çështjen e Ringjalljes, të llogarisë së veprave të punëmirëve dhe të punëkëqinjëve, si dhe për fatin e tyre.

Në fazën e tretë, kjo sure flet për një pjesë të veprave dhe besimeve, që bëhen shkak i dënimit të All'llahut.

Ndërsa në fazën e katërt, kjo sure, pasi citon betimet e All'llahut, flet për etapën e udhëtimit të njeriut, për fatin e tij gjatë gjithë jetës së tij në këtë botë, si dhe për Botën e Përtejme, Ahiretin.

Në fazën e pestë, përsëri flitet për punët dhe veprat e mira, për punët dhe veprat e këqija të njerëzve, si dhe për shpërblimet e tyre.

Mirësitë e leximit të sures "El Inshikâk"

Për sa u përket mirësive të leximit të sures "El Inshikâk" Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në një hadith, thotë: *"Kush e lexon suren 'ElInshikâk', All'llahu e begaton, duke e mbrojtur që libri i veprave të tij, në Ditën e Kiametit të mos i vijë nga prapa kurrizit."*.[1]

Në librin "Theuabul A'mal" në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Kushdo që lexon këto dy sure; suren'Infitâr' dhe suren 'El Inshikâk' gjatë faljes së namazeve të detyruara dhe ato vullnetare, All'llahu i Madhëruar ia plotëson të gjitha dëshirat dhe midis tij dhe All'llahut nuk futet asnjë gjë. Ai është vazhdimisht në kujdesin e All'llahut, derisa të largohet nga mesi i njerëzve."*.[2]

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 458.
[2] "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 536.

Ajetet 1 – 9

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِذَا السَّمَاءُ انْشَقَّتْ١ وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ٢ وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ٣ وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ٤ وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ٥ يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَى رَبِّكَ كَدْحًا فَمُلَاقِيهِ٦ فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ٧ فَسَوْفَ يُحَاسَبُ حِسَابًا يَسِيرًا٨ وَيَنْقَلِبُ إِلَى أَهْلِهِ مَسْرُورًا٩﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Kur qielli të çahet."

"Duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e ka për detyrë."

"Kur Toka të sheshohet (nga rrënimi i maleve)**."**

"Dhe të flakë atë që ka brenda e të zbrazet."

"Duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e ka për detyrë."

"Atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt."

"Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë."

“Do ta ketë të lehtë llogarinë.”

“Dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij.”

Komentimi

Përpjekja plot mundim drejt përsosmërisë absolute

Sikurse u tha edhe në përshkrimin e përmbajtjes së kësaj sureje, kjo sure, në fillim, hapet me ngjarje të mëdha dhe të çuditshme, si dhe tregon mënyrën e çuditshme të përfundimit të kësaj bote.

Në fillim thuhet: **“Kur qielli të çahet.”**, pra kur planetet do të shpërbëhen dhe sistemi planetar të shkatërrohet. Të ngjashme me këtë ajet, shikojmë ajetet 1–2 të sures “El Infitâr”, ku thuhet: **“Kur qielli të çahet dhe yjet të derdhen.”**.

Me këto ajetet bëhet lajmërimi i përfundimit, vjen fundi i botës dhe shkatërrimi i saj.

Më tej shton: **“Duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e ka për detyrë.”**.

Qielli, me gjithë atë madhështi, përballë urdhrit të All’llahut, qëndron si një rob i bindur, është i nënshtruar.

Fjala *"edhinet"*, e ka origjinën nga fjala *"el idhnu"* dhe ka kuptimin e *mjetit të dëgjimit*. Përdoret edhe për atë që dëgjon shumë me vëmendje. Në këtë rast, kuptimi i tij është eufemizëm ndaj bindjes dhe nënshtrimit.

Fjala *"huk'ket"* vjen nga rrënja e fjalës *"el hakku"*, që do të thotë: *e denjë të zbatojë urdhërin e Zotit të saj*. E si mundet që të mos jetë i bindur qielli, ndërkohë që ekzistenca e tij është nga ana e Krijuesit të Madhërishëm, moment për moment?! Nëse kjo lidhje do të shkëputej, qoftë edhe për një çast, qielli do të shkatërrohej dhe do të zhdukej.

Po, është e vërtetë që qielli dhe toka, jo vetëm në fillimin e krijimit kanë qenë të bindur, por edhe në përfundim të jetës së tyre, ata janë të bindur ndaj Krijuesit. Këtë e shikojmë edhe në ajetin 11 të sures "Fussilet": **"...Ata u përgjigjën: 'Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur!'"**.

Disa janë të mendimit se qëllimi i përdorimit të fjalës *"huk'kat"*, është të tregojë frikën dhe tmerrin e Ditës së Kiametit. Pra, ajo ditë është aq e frikshme, saqë qielli është i denjë që të çahet.

Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Në fazën tjetër, flitet për gjendjen e tokës: **"Kur Toka të sheshohet** (nga rrënimi i maleve)**."**.

Sipas dëshmisë së ajeteve të shumta të Kur'anit të Shenjtë, malet do të shkatërrohen dhe do të prishen, kështu që të gjitha të këqijat do të largohen. Toka e qetë dhe e gjerë, është e gatshme të presë të gjithë robtë që do të qëndrojnë në skenë. Këtë gjë e shpjegon shumë bukur surja "Tâ Hâ" në ajetet 105–107: **"Kur të të**

pyesin ty (o Muhammed) **për malet, thuaj: 'Ato do t'i bëjë hi e pluhur Zoti im, ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje.'"**.

Një gjykatë e madhe, në të cilën do të tubohen krijesat, nga fillimi e deri në fund, e ka të nevojshme një vend të tillë për t'u mbledhur.

Disa komentues thanë se kuptimi i ajetit është: All'llahu, tokën ku do të paraqitemi në Ditën e Kiametit, e ka krijuar më të gjerë se sa kjo që shikojmë në ditët e sotme, për të pasur përgatitjen e duhur, për të gjitha krijesat e grumbulluara.[1]

Në fazën e tretë thuhet: **"Dhe të flakë atë që ka brenda e të zbrazet."**. Komentuesit e Kur'anit, për këtë fakt, thonë se të gjithë të vdekurit që flinin brenda tokës, do të ngrihen njëherësh, pra, toka do t'i nxjerrë ata, duke i hedhur. Ata do të veshin rrobat e jetës. Kjo është e ngjashme me ajetin e dytë të sures "Ez Zelzele": **"Kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj."**.

Gjithashtu, në ajetet 13-14, të sures "En Nâzi'ât" thuhet: **"Por, ajo do të jetë veç një fryrje e vetme** (e Surit) **dhe ata përnjëherësh do të brofin** (të ringjallur)**."**.

Disa komentues thonë se, përveç njerëzve, do të dalin edhe mineralet e thesaret që janë fshehur në tokë. Të gjitha do të dalin jashtë.

Ky argument mund të jepet edhe për komentimin e ajetit: çdo gjë që është në tokë, pra, në brendësi të saj, tërmetet e

[1] Tefsiri "Fakhri Rrazij", në vazhdimt të ajetit për të cilin diskutuam.

tmerrshme do të nxjerrin gjithçka jashtë, të gjitha pisllëqet. Më pas, thellësia e tokës do të boshatiset me ngadalë.

Ajeti 5 shton: **"Duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e ka për detyrë."**.

Këto ngjarje të mëdha, të cilat janë të shoqëruara me bindje të plotë, nga një anë, tregojnë përfundimin e kësaj bote, përfundimin e tokës, të qiellit, njerëzve, thesareve dhe, nga ana tjetër, janë argument për krijimin e një pikëlidhjeje në këtë botë. Ato tregojnë një fazë të re të ekzistencës.

Me këto faza, tregohet fuqia dhe pushteti i All'llahut të Madhëruar ndaj të gjitha Krijesave, veçanërisht për sa i përket çështjes së Ringjalljes.

Po, është e vërtetë, se, kur do të ndodhin këto ngjarje, njeriu do të shikojë përfundimin e punëve dhe veprave të këqija dhe të mira.

Më pas Krijuesi i vendos njerëzit si dëgjues dhe u qartëson atyre rrugën, duke u thënë: **"Atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt."**.

O njeri! Ti me mund e përpjekje do të shkosh drejt Krijuesit tënd dhe do e takosh Atë.

Fjala "*el ked'hu*" ka kuptimin: *përpjekje* dhe *mundim, që shoqërohet me dhimbje dhe lodhje, që ndikon në trupin, në organizmin dhe në shpirtin e njeriut*.

Po ashtu, edhe kau që tërheq parmendën dhe punon shumë, në trupin e tij shfaqen shenjat e lodhjes. Në tefsirin "Kesh'shaf",

"Fakhri Rrazij" dhe "Ruhul Meanij" thuhet se kjo fjali ka kuptimin: *gërvishtje që shfaqet në lëkurën e trupit dhe për këtë shkak, edhe mundimet dhe përpjekjet e njeriut, që ndikojnë në shpirtin e tij, i quajnë me këtë emër*.

Në të vërtetë, ky ajet është tregues thelbësor, sepse i referohet një dukurie shumë të rëndësishme të jetës së njeriut, i cili gjithmonë gjatë jetës së tij mundohet dhe përpiqet shumë për të realizuar qëllimet e tij. Edhe kur njeriu dëshiron të arrijë Ahiretin dhe lumturinë e përjetshme, që është afrimiteti me Krijuesin e tij, përpjekja dhe mundimi është natyrë e jetës në këtë botë. Edhe njerëzit që jetojnë midis gjithë të mirave, edhe ata nuk jetojnë larg mundimit dhe përpjekjes.

Për sa i përket interpretimit për takimin me Krijuesin, në këtë rast, si të jetë për takimin në skenën e Kiametit, si të jetë për sundimin absolut të Tij, apo si të jetë për takimin e dhënies së dënimit apo të shpërblimit, apo për takimin nëpërmjet intuitës së brendshme, tregojnë se kjo dhimbje, lodhje dhe mundim do të vazhdojë deri në atë ditë. Kur këto do të përfundojnë, kjo botë do të mbyllet dhe njeriu, me veprat e tij të pastra, do të takojë Krijuesin e tij.

Po, qetësia dhe rehatia pa lodhje dhe mundim është vetëm atje.

Kjo bisedë që i drejtohet njeriut, i përfshin të gjithë njerëzit, (duke u mbështetur në humanizmin e tyre), tregon të vërtetën që All'llahu ka krijuar forca të nevojshme për lëvizjen e vazhdueshme të Krijuesit në qenien e krijesave. Ndaj dhe mbështetja te fjala *"rabb"* tregon se kjo përpjekje dhe mundim është shpërblim për programin e përsosmërisë dhe edukimin e njeriut.

Po, ne të gjithë jemi mysafirë.

Ky kuptim është edhe në ajetet e tjera të Kur'anit, si: **"Te Zoti yt do të jetë kthim"**.[1]

Më tej thotë: **"Kthimi është tek All'llahu."**.[2]

Gjithashtu, edhe në ajetet e tjera tregohet për këtë udhëtim të vazhdueshëm të përsosmërisë së krijesave drejt Krijuesit të Madhëruar.

Por në këtë rast, njerëzit ndahen në dy grupe, sikurse thonë edhe ajetet 7-9 të sures që po diskutojmë: **"Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij."**.

Këto janë personat që lëvizin në orbitën kryesore të krijimit, në atë orbitë që All'llahu, për njeriun, ka përcaktuar kapital dhe fuqi. Po ashtu, edhe përpjekja, edhe mundimi i tyre është gjithmonë për All'llahun, ndaj edhe përpjekja, edhe lëvizja e tyre është drejt All'llahut. Ata, në atë Ditë, të veprave dhe të punëve të tyre do e marrin librin nga krahu i djathtë. Kjo tregon jo vetëm besimin e pastër të tyre, por edhe të veprave të tyre. Ai libër që vjen nga krahu i djathtë, është shpëtim në Ditën e Kiametit, si dhe burim i gëzimit, i lumturisë e i krenarisë për të gjithë ata që do jenë të pranishëm në atë Ditë.

Në kohën që ata vihen në peshoren e drejtësisë, pesha më e vogël për ta do të llogaritet dhe do të jetë lehtësim për ta nga ana e All'llahut. All'llahu u fal atyre mangësitë që kanë dhe, për shkak të besimit dhe veprave të pastra, punët e tyre shndërrohen në mirësi.

[1] Sure "En Nexhm", ajeti 42.
[2] Sure "El Fâtir", ajeti 18.

Disa komentues dhe dijetarë, thonë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"hisabul jesijr"*, është të tregojë lehtësimin në dhënien e llogarisë, pra, që atyre të mos u vështirësohet dhënia e llogarisë, por, përkundrazi të merren në pyetje, duke i anashkaluar gabimet e shumta dhe duke u dhënë shpërblim për mirësitë që kanë kryer.

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Nëse te një njeri gjenden tri cilësi, All'llahu e merr me të butë (me lehtësi) llogarinë e tij dhe me mëshirën e Tij, e dërgon në Xhennet."*.

Të pranishmit e pyetën Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Cilat janë ato tri cilësi, o i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?"

Ai tha: *"Jepi ati që nuk të jep, mbaj lidhjet me ata që i kanë ndërprerë lidhjet me ty dhe fale atë që të ka bërë padrejtësi."*.[1]

Nga hadithi mund të kuptohet e të merret mësim se kujdesi, përpikëria dhe ashpërsia në dhënien e llogarisë, në Ditën e Kiametit, ka të bëjë me peshën e mendjes, të njohurive e të diturisë së njeriut.

Për këtë fakt, Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thotë: *"All'llahu, në Ditën e Kiametit, i merr në llogari njerëzit sipas mendjes që u ka dhënë atyre në këtë botë. Ai do të jetë i kujdesshëm dhe i ashpër."*.[2]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", në vazhdim të ajetit për të cilin diskutuam; "Biharul Enuar", vëll. 7, f. 97.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 537; Tefsiri "Kafij", vëll. 1, f. 11 (me pak ndryshim).

Ndërsa për sa i përket fjalës *"el ehlu"*, janë cituar komentime të ndryshme.

Disa komentues thanë se bëhet fjalë për bashkëshortët dhe fëmijët e tij besimtarë, që atyre do t'u bashkohen besimtarët në Xhennet. Në vetvete, kjo gjë është mirësi dhe shpërblim i madh për ata njerëz, që do ta kenë këtë fat, që mendjen e tyre do ta shikojnë në Xhennet dhe do të jenë pranë të afërmve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Disa mendimtarë dhe komentues të tjerë, janë të mendimit se fjala *"ahl"* ka kuptimin e hyrive të Xhennetit, të cilat janë përcaktuar për besimtarët.

Ndërsa disa të tjerë, janë të mendimit se kjo fjalë është përcaktuar për besimtarët që, në këtë botë, kanë dashur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe kanë ndjekur vijën e tij.

Është e mundur që përmbledhja midis këtyre kuptimeve, të jetë e mundur.

Hulumtim

1- Merre dijen nga Aliu

Në një hadith të Prijësit të besimtarëve Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për komentimin e ajetit: **"Idhes Semaun Shek'kat"**, lexojmë: *"Qiejt do të ndahen nga planetet!"*.[1]

Ky hadith është kuptimplotë dhe duhet trajtuar me saktësi, sepse konsiderohet e përllogaritet si mrekulli e dijes. Ky hadith ka nxjerrë në pah një të vërtetë, që në atë kohë, asnjë nga dijetarët nuk kishte mundur ta arrijë këtë. Dijetarët e ditëve të sotme, me vëzhgimet e tyre astronomike, si dhe me teleskopët e mëdhenj dhe të fuqishëm, kanë vërtetuar se bota është e përbërë nga planete dhe yje. Secili është pjesë e sistemit diellor, ndaj dhe për këtë arsye, e kanë quajtur atë "Rruga e Qumështit". Kjo është shumë e njohur dhe mund të shikohet me sy. Një pjesë e saj është shumë larg nga ne, saqë yjet duken si re të bardha, por në të vërtetë janë njolla të ndritshme, të ngjitura pranë njëra-tjetrës.

Por ajo që është afër nesh, janë yje që duken prej nesh, që i shikojmë në darkë. Në këtë mënyrë, sistemi ynë diellor është pjesë e këtij planeti.

Në përputhje me hadithin e mësipërm, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Në prag të Kiametit, këto planete do t'i shikojmë që do të ndahen dhe i gjithë sistemi do të shkatërrohet*".

Në atë kohë, kush e dinte se yjet që ne shikojmë, janë pjesë e planeteve dhe kjo pjesë e planeteve është edhe Rruga e Qumështit.

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 30, f. 87; Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 329.

Këtë gjë e dinte vetëm ai që zemrën e tij e kishte të lidhur me dijen e fshehtë dhe burimi i dijes merrej vetëm nëpërmjet All'llahut.

2- Dynjaja vendi i vështirësive

Fjala *"kadihun"*, në ajetet e mësipërme, ka të bëjë me përpjekjet dhe mundimet e vështira. Duke e ditur se dëgjuesi është njeriu, atëherë kjo gjë tregon natyrshmërinë e jetës së kësaj bote, e cila në asnjë stad, nuk është e lënë mënjanë nga problemet, mërzitja, stresi, përpjekja, mundimi etj. Këto probleme, si të jenë pjesë e trupit të njeriut, pra, fizikisht, apo si të jenë pjesë e shpirtit të njeriut, apo të mendjes, nuk ka njeri që nuk përfshihet nga këto probleme.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Ali ibn Husejn *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë:"*Rehatia për këtë botë dhe për njerëzit e kësaj bote nuk ekziston. Rehati është vetëm Xhenneti. Kjo botë është krijuar që të ketë mundim dhe vuajtje. Gjithashtu, edhe ata që qëndrojnë në këtë botë, vuajnë e mundohen. Ndaj edhe shpërblimet janë dyfish i asaj që bëjnë. Ata që kanë më shumë në këtë botë, janë më të varfër, sepse ata janë nevojtarë të të tjerëve, për të ruajtur pasurinë që kanë. Kështu ata janë nevojtarë të shumë mjeteve dhe sendeve të ndryshme, për të ruajtur pasurinë e tyre, për këtë shkak, për të pasurit e kësaj bote nuk ekziston rehati.*".

Më pas, Imam Ali ibn Husejn *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, në vazhdim të fjalës së tij, thotë:"*Kurrë nuk heqin keq dhe nuk vuajnë miqtë e All'llahut në këtë botë, për hir të kësaj bote, por vuajtja dhe mundimi i tyre, në këtë botë, është për Ahiretin (Botën e Përtejme).*".[1]

[1] "El Khisalu, i Es Saduk", vëll. 1, f. 64, kapitulli "El Dunja vel akhiret ke kefetej el mijzan", hadithi 95.

Ajetet 10 – 15

﴿وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ١٠ فَسَوْفَ يَدْعُو ثُبُورًا١١ وَيَصْلَى سَعِيرًا١٢ إِنَّهُ كَانَ فِي أَهْلِهِ مَسْرُورًا١٣ إِنَّهُ ظَنَّ أَنْ لَنْ يَحُورَ١٤ بَلَى إِنَّ رَبَّهُ كَانَ بِهِ بَصِيرًا١٥﴾

“Kurse ai, të cilit do t’i jepet libri i tij pas shpinës.”

“Do të lutet për të vdekur.”

“Dhe në zjarr do të digjet.”

“Sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij.”

“Duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari)**.”**

“Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij!”

Komentimi

Ata që e marrin nga prapa librin e veprave të tyre

Më lart u fol për besimtarët, që librin e veprave të tyre, do ta marrin nga krahu i djathtë. Në këto ajete do të flitet për ata njerëz, që librin e veprave të tyre, do ta marrin prapa shpine. Këta do të jenë jobesimtarët, punëkëqijtë, etj.

Në ajetet 10-12 thuhet: **"Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet."**.

Për sa i përket marrjes në dorë të librit të punëve dhe veprave të njeriut prapa shpine dhe se si lidhet ky ajet me ajetet e tjera, që thonë se librin e punëve dhe të veprave të tyre, njerëzit do ta marrin nga krahu i majtë, komentuesit kanë bërë komentime të ndryshme. Disa prej tyre thonë se, kur do ta marrin librin e veprave, dorën e djathtë të tyre do t'ua lidhin me zinxhir në qafën e tyre dhe librin e veprave të tyre do t'ua japin me dorën e majtë dhe prapa shpine. Ky gjest tregon poshtërim dhe turpërim.

Disa të tjerë janë të mendimit se të dy duart e njeriut janë të lidhura prapa shpine, sikurse lidhen pengjet dhe librin e veprave do t'ua japin me dorën e majtë.

Të tjerë komentues janë të mendimit se, në përputhje me ajetin 47 të sures "En Nisâ": **"O ju, të cilëve ju është dhënë Libri! Besoni atë që kemi zbritur si vërtetues të asaj që keni në duar para se t'jua fshijmë fytyrat e t'jua kthejmë prapa ose t'ju**

mallkojmë ashtu siç i mallkuam shkelësit e Sabatit. Urdhri i All'llahut do të zbatohet doemos.", ky grup kriminelësh e kthen kokën pas, sepse duhet ta lexojnë vetë librin e veprave të tyre, ndaj libri i punëve dhe veprave të tyre u jepet nga krahu i majtë.

Por është më e përshtatshme të thuhet se ata, të djathtët, me kokën lart, me krenari e kënaqësi, marrin librin e veprave të tyre, nga krahu i djathtë dhe thërrasin: "O ithtarë të Kiametit, ejani lexoni dhe shikoni veprat tona!".

Por, kur kriminelëve punëkëqij u jepet libri i veprave që kanë kryer, ata, nga turpërimi dhe nga mundimi, e kapin dorën e majtë të tyre dhe e vendosin pas qafe, që të mund të fshehin dokumentin e tyre, pra, librin e veprave. Por ç'vlerë ka? Atje asgjë nuk mund të fshihet.

Fjalia *"jed'u thubura"* mund të interpretohet, duke u bazuar në kulturën arabe, kur dikujt i ndodh ndonjë ngjarje e tmerrshme, thërret: – "Mjerë për mua, u shkatërrova!".

Fjala *"thubura"* ka kuptimin e shkatërrimit. Por britmat dhe ulërimat e tyre nuk janë të mjaftueshme, sepse, pas atyre, do të vijë djegia në zjarrin e Xhehennemit.

Më tej flitet për shkakun e këtij fati. Ata, të afërmit dhe familjarët e tyre, ishin vazhdimisht të përlyer në mëkat: **"Ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej** (për të dhënë llogari)**."**

Kënaqësia e përzier me mendjemadhësinë dhe mendjemadhësia e përzier me neglizhencën dhe me mos

informimin për Krijuesin, bën që kjo të mos i kushtojë vëmendje se çfarë do të ndodhë pas vdekjes.

Është e qartë se kënaqësia dhe gëzimi, nga ana njerëzore, nuk është i dënueshëm, por besimtari duhet të jetë i kënaqur me mirësinë e All'llahut.

Ndaj edhe në ajetin tjetër, shton: **"Duke menduar se kurrë nuk do të kthehej** (për të dhënë llogari)**."**.

Burimi kryesor i fatkeqësisë së tij është besimi i keq dhe mendimi i gabuar për të refuzuar Ringjalljen. Po ky besim dhe mendim i gabuar bëhet shkak i mendjemadhësisë dhe i kryeneçësisë. Kjo gjë e ka larguar atë nga All'llahu dhe e ka bërë të ndjekë epshet e tij, saqë arrin deri aty, që ftesën e Profetëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* ta marrë për tallje. Ndërsa, kur shkon pranë familjes së tij, gëzon për atë çka ka bërë. Po i njëjti kuptim është edhe në ajetin 31 të sures "El Mutaffifîjn": **"Kur ktheheshin te njerëzit e vet, ata talleshin** (me besimtarët)**."**.

Edhe në tregimin e Karunit lexojmë se atë njeri, pasanik dhe mendjemadh, e këshilluan që të mos jetë kaq mendjemadh për pasurinë që kishte, sepse Zoti nuk i do ata që mburren për pasurinë. Pra, Beni Israilët, atij në mënyrë të hapur, i thoshin: **"Mos u ngazëlle me pasurinë që ke, sepse All'llahu nuk i do ata që ngazëllehen!"**.[1]

[1] Sure "El Kasas", ajeti 76.

Fjala *"len jehuru"* vjen nga rrënja *"hur"* dhe ka kuptimin: *dyshim* dhe *vajtje ardhje*. Sido që të jetë kjo e vajtur dhe e ardhur, pra, në veprim apo në mendje. Po ashtu, edhe për ujin që qëndron në pishinë, përdorin këtë fjalë.

"El Mihver" quhet boshti rreth së cilës rrotullohet timoni. Ndërsa fjala *"mehavere"*ka kuptimin: *vajtje e ardhje*, *refuzim* dhe *shkëmbim idesh dhe diskutimesh*.

Fjala *"hievar"*, gjithashtu, ka të njëjtin kuptim me atë që thamë me lart. Ndonjëherë ka kuptimin *"britmë"* dhe *"ulërimë"*, në kohën që diskutohet.

Disa janë të bindur se rrënja e fjalës është *"habshij"*. Nga Ibn Abasi është transmetuar: "Unë nuk e dija kuptimin e kësaj fjale në Kur'an, derisa një beduine që po i thërriste vajzës së tij të vogël: *'Huri'*, që do të thotë *'kthehu'*".[1]

Fjala *"el hauarij"* është interpretuar edhe për të afërmit e Profetit Isa *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, edhe për të afërmit e çdokujt. Janë quajtur kështu, ndoshta sepse shkonin dhe vinin shpesh pranë tij.

Disa komentues, gjithashtu, e njohin fjalën *"hur"*, me kuptimin e larjes dhe të zbardhjes, sepse ata pastronin zemrat e njerëzve nga ndryshku i mëkateve.

[1] "Mufredad" i Ragibit, tefsiri "Fakhru Rrazij", "Abul Fetuhu Rrazij" dhe libra të tjerë.

Hyritë e Xhennetit e kanë marrë këtë emër, sepse janë me lëkurë të bardhë dhe bebja e bardhë e syve të tyre është shumë e qartë.

Disa janë të mendimit se kjo fjalë i referohet hyrive të Xhennetit, sepse ato janë aq të bukura, saqë sytë mahniten, kur i shikojnë ato.

Megjithatë, kjo fjali, në ajetin që diskutuam, ka kuptimin e kthimit dhe të Ringjalljes. Gjithashtu, ky ajet tregon se mosbesimi në Ringjallje është burim i neglizhencës, i mendjemadhësisë, si dhe i përlyerjes më mëkate të ndryshme.

Ajeti 15, për të mohuar besimin e pavlefshëm të tyre, thotë: **"Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij!"**.

Të gjitha veprat e tij i ka regjistruar dhe i ka dokumentuar. Në Ditën e Dhënies së Llogarisë, këto vepra do të pasqyrohen në librin e veprave të tyre.

Këto dy ajete, mund të merren si argument për çështjen e Ringjalljes, sepse tek të dy ajetet theksi është vendosur te fjala *"rabb"*. Rrugëtimi i përsosmërisë së njeriut drejt Krijuesit, nuk mund të ndalojë me vdekjen e tij, po ashtu edhe jeta në këtë botë, ka këtë qëllim.

Shikueshmëria e Zotit, për veprat e njerëzve, dokumentimi dhe mbajtja e tyre, me patjetër që është fillimi dhe hyrja për llogarinë dhe dënimin, përndryshe do të ishte e pavlefshme.

Ajetet 16 – 25

﴿فَلَا أُقْسِمُ بِالشَّفَقِ١٦ وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقَ١٧ وَالْقَمَرِ إِذَا اتَّسَقَ١٨ لَتَرْكَبُنَّ طَبَقًا عَنْ طَبَقٍ١٩ فَمَا لَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ٢٠ وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا يَسْجُدُونَ ٢١ بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا يُكَذِّبُونَ٢٢ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُوعُونَ٢٣ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ٢٤ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ٢٥﴾

“Betohem në kuqërrimin e muzgut.”

“Në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj.”

“Si dhe në hënën e plotë.”

“Se ju, me siguri, do të kaloni nga e keqja te më e keqja!”

“Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?!”

“E përse, kur u lexohet Kur’ani, nuk përulen në sexhde?!”

“Përkundrazi, ata që nuk besojnë e quajnë atë gënjeshtër.”

“Por All’llahu e di mirë çfarë fshehin ata.”

"Prandaj shpallu atyre dënimin e dhembshëm (që i pret të gjithë)**."**

"Përveç atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të shpërblehen pandërprerë."

Komentimi

Ligji i ndryshimit!

Për të sqaruar më mirë çështjen e përsosmërisë së njeriut, në udhëtimin e tij drejt Zotit, vijon ky grup ajetesh.

Ajetet 16-19 thonë: **"Betohem në kuqërrimin e muzgut, në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj, si dhe në hënën e plotë, se ju, me siguri, do të kaloni nga e keqja te më e keqja!"**.

Shkronja *"la"*, në fjalinë: *"fela uksimu"*, sikurse e kemi shpjeguar edhe më parë, është e shtuar dhe përdoret për të theksuar diçka. Disa janë të mendimit se, në këtë rast, përdoret për të mohuar diçka, që do të thotë, se atyre nuk u kujtohet betimi, sepse përmbajtja është e dukshme, e qartë dhe nuk është e nevojshme të betohet. Ose, përmbajtja është kaq shumë e rëndësishme, saqë nuk është e përshtatshme që të bëhen këto betime. Ose, çështjet për të cilat u betua, kanë kaq shumë rëndësi, saqë është e përshtatshme që të mos betohet në to.

Kuptimi i parë "i shtuar dhe i theksuar" është kuptimi më i përshtatshëm.

Sipas Ragibit, në librin "Mufredat", fjala "*shefek*" është e përzier me shkëlqimin e ditës dhe më errësirën e natës, ndaj edhe fjala "*ishfak*" ka kuptimin e vëmendjes dhe të kërkimit të përzier me frikë.

Si për shembull, njeriu pëlqen dikë, por në të njëjtën kohë, ai është i frikësuar për ngjarjet që e rrethojnë atë. Kësaj gjendje i thonë "*ishfak*" dhe personit në fjalë i thonë "*mushfik*".

Por Fakhru Rrazij është i bindur se fjala "*shefek*", në origjinal, ka kuptimin "*e hollë*" dhe "*e tejdukshme*", pra, rrobat që janë shumë të holla, të tejdukshme quhen "*shefek*" dhe gjendja "*esh shefekatu*" është përshtatur për hollësinë e zemrës. Por më e saktë dhe më e përshtatshme është mendimi i Ragibit, në librin "Mufredat".

Megjithatë, qëllimi i përdorimit të fjalës "*shefek*", në këtë rast, është për të treguar shkëlqimin e përzier me errësirën në fillim të natës. Para se të bjerë mbrëmja, shfaqet një ngjyrë e kuqërremtë para perëndimit të diellit. Më tej, në horizont, vendin e saj e zë ngjyra e bardhë. Është menduar se për kë bëhet fjalë në këtë rast, pra, çfarë është "*shefek*", e kuqërremta apo e bardha.

Dijetarët dhe komentuesit janë të mendimit se i referohet kuptimit të parë, sepse mbi të është vendosur edhe theksi, ndaj edhe martirëve u është thënë "*dimau shuheda*" - "*gjaku i martirëve*".

Edhe pse disa janë të mendimit se kuptimi i dytë është i vlefshëm dhe e kanë zgjedhur atë, themi se është shumë i dobët, sepse, sipas fjalorit, kjo fjaë ka kuptimin horizont. Ajo është më e

përshtatshme me ngjyrën e kuqërremtë të horizontit, i cila vjen nga dielli.

Megjithatë, shfaqja e *"shefekut"* është tregues i gjendjes, i transformimit të thellë në këtë botë. Gjithashtu, është tregues dhe lajmërues i përfundimit të ditës dhe fillimit të natës. Përveçse është e përbërë nga një veçori dhe efekt i bukur, mbi të gjitha këto, tregon ardhjen e namazit të perëndimit. All'llahu është betuar në të, që të gjithë të futen në mendim për këtë krijim të bukur, sikurse është qielli.

Por, për qëllimin e betimit për natën, për shkak të efekteve dhe mistereve të shumta që janë të fshehura në të, kemi folur edhe në të kaluarën.[1]

Fjala *"ma ueseka"*[2] ka kuptimin e përmbledhjes dhe të grumbullimit të gjërave të shpërndara.[3] Kjo fjalë tregon për kthimin e llojeve të kafshëve dhe të shpendëve, si edhe për njerëzit që kthehen natën në shtëpitë e tyre.

Përfundimi është qetësimi dhe pushimi i përgjithshëm, i cili konsiderohet si një nga misteret me më shumë rëndësi të natës.

Ky fakt është cituar edhe në suren "El Gâfir", në ajetin 61: **"All'llahu e ka bërë natën që ju të pushoni..."**.

---

[1] Shikoni në vazhdim të ajeteve 71-73 të sures "Kasas" në këtë komentim.

[2] *"Ma"* te fjala *"ma uesek"* është lidhës. Mundësia për të qenë paskajore është shumë e dobët. Gjithashtu, kthimi i saj është i fshehur. Në origjinal do të ishte: *"ue ma ueseku"*.

[3] Fjala *"uesek"* ka kuptimin e një ngarkesë që i bëhet devesë, si dhe ka kuptimin e matjes së peshës. Për shembull: thuhej gjashtëdhjetë *"sa"*. Çdo *"sa"* kishte afërsisht 3 kg.

Këtu bëhet e qartë se interpretimi i fjalës "*idha teseka*", e cila vjen nga e njëjta rrënjë, ka kuptimin: *tubim, grumbullim*. Në këtë rast, ka kuptimin e përsosmërisë së hënës në natën e katërmbëdhjetë (pra, kur hëna është e plotë). Në këtë natë, hëna ka një shkëlqim të jashtëzakonshëm dhe njerëzit i tërheq përreth saj. Shkëlqimi i hënës e ndriçon tokën dhe drita e saj nuk shqetëson qetësinë e natës. Në të njëjtën kohë, ajo ndriçon e hap rrugën për udhëtarët e natës. Ndaj edhe ajeti është ndër ajetet e mëdha të All'llahut të Madhëruar, prandaj edhe është betuar në të.

Është për t'u pasur në qendër të vëmendjes, se të katër temat e cituara në këto ajete, të cilat përmbajnë në vetvete betimin (për *shefekun*; natën; krijesat që mblidhen natën; hënën që është e plotë) kanë të bëjnë me njëra-tjetrën dhe janë plotësuese të njëra–tjetrës. Ato formojnë një harmoni të mrekullueshme, që mendjen e njeriut e nxit të meditojë për fuqinë e madhe të krijimit. Nga ky ndryshim dhe informacion, bën që në mënyrë më të shpejtë, të arrijë të njohë çështjen e Ringjalljes dhe të fuqisë së All'llahut.

Është interesante se, këto pjesë i referohen gjendjeve dhe transformimeve që ndodhin njëra pas tjetrës në botën e krijimit, djelli fshihet nën vello, aurora e cila është pjesë e dritës së tij, shfaqet. Krijesat e gjalla kthehen me shpejtësi në strofullat e tyre. (Hëna e plotë ndriçon). Hëna, në natën e katërmbëdhjetë, lind në fillim të mbrëmjes. Këto betime që All'llahu i bën, i vendos si parathënie apo hyrje për fjalinë: "*Le terkebun'ne Tabeken an Tabek*", të cilat tregojnë gjendjet e ndryshme të njeriut përgjatë jetës së tij.

Për këtë fjali janë cituar komentime të shumta, si për shembull:

1- Kur flitet për gjendjet e ndryshme të njeriut, nënkuptohen gjendjet e ndryshme të tij përgjatë jetës, pra, gjatë rrugës me plot vështirësi, ai gjen mënyrën për të arritur përsosmërinë absolute drejt All'llahut. Në fillim bota, më pas bota e pastrimit dhe më pas ringjallja, si dhe gjendjet e ndryshme të saj. (Duhet të dini se fjala "*tabeke*" vjen nga rrënja "*mutabeke*", e cila do të thotë "vendosje e diçkaje sipër një diçkaje tjetër". Gjithashtu, ka kuptimin e zbritjes që kryen njeriu përgjatë jetës së tij).

2- Ndërsa për çështjen e gjendjes së njeriut, që nga momenti që është në barkun e nënës e derisa ai vdes, disa dijetarë janë të mendimit se përgjatë gjithë kësaj kohe, njeriut i numërohen 37 gjendje të ndryshme.

3- Ajo çka nënkuptohet me gjendje të ndryshme, ka të bëjë edhe me udhëtimet që njeriu i kryen përgjatë jetës së tij. Sikurse është: shëndeti, sëmundja, gëzimi e hidhërimi, vështirësia dhe lehtësimi paqja dhe lufta.

4- Njeriu do të përballet me vështirësi të ndryshme në Ditën e Kiametit, derisa të lirohet nga dhënia e llogarisë. Çdokush do të shkojë drejt përfundimit të veprave që ka kryer, pra, ose në Xhennet, ose në Xhehennem.

5- Qëllimi i rrëfimit për gjendjen që kanë kaluar të afërmit dhe popujt e mëparshëm, pra, ato ngjarje të hidhura dhe të këndshme, si dhe llojet e dënimeve dhe mohimet e ndryshme që janë bërë, është t'u tërheqë vëmendjen se këto do të ndodhin edhe te ky popull. Këtë e shikojmë në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Megjithatë, përmbledhja e këtyre komentimeve nuk ka kuptim. Është e mundur që ajeti flet për ndryshimet dhe stadet që ndjek njeriu përgjatë jetës dhe rrugës së tij.

Disa komentues janë të mendimit se ky ajet i është adresuar të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se ajeti flet për qiejt. Dihet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në Natën e Miraxhit ka kaluar nëpër to.

Por për vetë faktin se shkronja *"b"* te fjala *"leterkebun"* ndiqet nga zanorja *"u"*, që tregon shumësin, ky komentim nuk është i përshtatshëm. Ajeti i mësipërm u adresohet të gjithë njerëzve.

Megjithatë, dukuria e këtyre rasteve dhe mosvendosja e një njeriu në njërin prej rasteve:

Së pari, argumenti i të qenit krijesë, është tregues i domosdoshmërisë të të pasurit Krijues.

Së dyti, ky është argument për paqëndrueshmërinë e kësaj bote.

Së treti, është tregues për lëvizjen e vazhdueshme të njeriut drejt qenies së Krijuesit dhe çështjes së Ringjalljes, sikurse është cituar edhe në ajetet e mësipërme: *"Ja ej'juhal Insanu in'neke kadihun ila rab'bike ked'hen femulakijhi"*.

Më tej bëhet një përmbledhje e përgjithshme e diskutimeve të mëparshme, ku pyetet: **"Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?!"**.

Megjithëse argumentet janë të vërteta, të qarta dhe të dukshme, sikurse është argumenti i Njëshmërisë së All'llahut dhe njohjes së Tij. Po ashtu edhe argumentet e Ringjalljes si dhe ajetet e ngjarjeve, që në krijimin e natës, ditës, hënës, diellit, dritës, errësirës, lindjes dhe perëndimit të diellit, e kuqërremta që shfaqet në horizont, si dhe errësira e natës, përsosmëria dhe qartësia e natës, të gjitha këto, janë argumente për ata që mendojnë e logjikojnë.

Gjithashtu, argument tjetër janë ajetet shpirtërore, që kur embrioni vendoset në mitrën e nënës dhe më tej, përçon stade të ndryshme përgjatë udhëtimit. Me të gjithë këto shenja dhe argumente të qarta, përse ata nuk besojnë?!

Me tej Kur'ani shton: **"E përse, kur u lexohet Kur'ani, nuk përulen në sexhde?!"**.

Kur'ani është argument i qartë, rrezaton sikurse dielli. Ai është i qartë, i dukshëm, sikurse është drita. Ai, nga çdo aspekt, është mrekulli. Përmbajtja e tij është argument i qartë, sepse është marrë nga burimi i Shpalljes.

Kur'ani, që çdo vëzhgues e konsideron të paanshëm, nuk mund të jetë i lindur në mendjen e njeriut dhe aq më shumë i një njeriu që kurrë nuk kishte mësuar të lexojë dhe jetonte në një mjedis të tillë që ishte i mbushur me dhunë dhe besëtytni të kultivuara.

Qëllimi i përdorimit të fjalës *"sexhde"*, në këtë rast, ka të bëjë me përulësinë dhe bindjen.[1]

[1] Një tjetër dëshmi, për sa i përket këtij kuptimi, përveç ajeteve të kaluara dhe ato që do të vijnë, është se fjala *"sexhde"*, ka kuptimin e vendosjes së ballit në

Ka të bëjë edhe me mënyrën e njohur të bërjes sexhde, vendosja e ballit në tokë. Ky koncept është i përgjithshëm. Në disa hadithe thuhet se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e lexoi këtë ajet, bëri sexhde.

Sipas fetvasë së juristëve të njohur të Ehli Bejtit, kjo sexhde është nga sexhdet mustehab (e pëlqyeshme) të Kur'anit. Katër medh'hebet e Ehli Synetit, këtë sexhde e konsiderojnë vaxhib (të detyruar), në kohën që lexohet surja dhe arrihet tek ajeti që ka shenjën e sexhdes, kryhet sexhdja.

Malikitët janë të mendimit se, pasi përfundohet e gjithë surja, kryhet sexhdja.[1]

Në ajetin tjetër, shtohet: **"Përkundrazi, ata që nuk besojnë e quajnë atë gënjeshtër."**.

Përdorimi i foljes në këtë rast, ka kuptimin e vazhdimësisë. Por ndonjëherë përdoret për të kuptuar se ata ngulnin këmbë në gënjeshtrat e tyre. Këmbëngulja e tyre vinte për shkak të kokëfortësisë së tyre. Mohimi i tyre nuk vinte sepse ata kishin argumente të drejta, por për shkak të intolerancës dhe ndjekjes së padenjë, pra, qorrazi të të afërmve të tyre, për të ruajtur pasuritë materiale, si dhe për të fituar lirinë, për të bërë çdo gjë, sikurse edhe shejtani.

---

tokë, në kohën kur këndohet Kur'ani, pra, tek ajetet që janë të kufizuara, pra, nuk është as e detyruar e as nuk është e pëlqyer. Ndaj, kur pyetet se, përse ata nuk bien në sexhde, kur këndohet Kur'ani, thekson se rënia në sexhde, ka kuptimin e dorëzimit dhe të bindjes ndaj gjithë Kur'anit.

[1] Tefsisri "Ruhul Bejan", vëll. 1, f. 1382.

Më tej, All'llahu i Madhëruar, me ton kërcënues thotë: **"Por All'llahu e di mirë çfarë fshehin ata."**.

All'llahu është në dijeni jo vetëm për qëllimet e tyre, por edhe për nxitjet që bëhen shkak i këtyre gënjeshtrave të vazhdueshme. All'llahu është në dijeni, sado që ata të fshihen prapa perdeve. Si përfundim, ata do ta marrin ndëshkimin nga Zoti.

Fjala *"ju'uune"* vjen nga rrënja *"el uiau"* dhe ka kuptimin: *enë*.

Në "Nehxhul Belaga", Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë se këto zemra janë enë. Më e mira ndër to, është ajo zemër që ka më tepër hapësirë për të ruajtur.[1]

Ajeti 24 thekson: **"Prandaj shpallu atyre dënimin e dhembshëm** (që i pret të gjithë)**."**.

Fjala *"bisharatu"*, ka kuptimin: *lajm*. Në këtë rast, është përdorur për të njoftuar për një lajm të hidhur, ndonëse në realitet fjala *"bisharatu"* – *"njoftim"* përdorej për lajme të gëzuara dhe jo për të njoftuar për dënim dhe ndëshkim.

Fjala *"el bisharatu"* - *"lajm"*, në këtë rast, është për të fajësuar, ndërkohë që besimtarët, në të vërtetë, marrin shpërblimin e tyre me Xhennet, kurse mohuesit shkojnë në Xhehennem.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, edhe një herë tjetër, flitet për fatin e besimtarëve të pastër dhe vepërmirë ku thotë: **"Përveç**

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 147.

atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të shpërblehen pandërprerë.”.

Fjala *“memnun”* vjen nga rrënja *“men”* dhe ka kuptimin: *“kat’e”* – *“ndërprerje”* dhe *“nuksan”*, *mangësi*.

Fjala *“minet” (menun)* ka kuptimin: *vdekje* dhe vjen nga kjo rrënjë.

Të gjitha këto kuptime mund të jenë të përmbledhura këtu, sepse mirësitë e Ahiretit, në kundërshtim me ato të kësaj bote, të cilat janë mirësi që e kanë një përfundim apo mangësi, janë të pafundme. Gjithashtu, ato, zakonisht, janë të përziera me ndonjë efekt anësor, ndërsa në Xhennet nuk ekziston, mangësia, vdekja, efektet anësore, gjithçka është e përhershme, pra, në Xhennet, gjithçka është e përsosur, pa asnjë mangësi.

Në mesin e komentuesve diskutohet se ky privilegj apo përjashtim është i vazhdueshëm apo me ndërprerje.

Disa janë të mendimit se këto përjashtime dhe privilegje mund të ndërpriten, sepse ajeti për të cilin diskutuam, e ka lënë mënjanë shpjegimin e gjendjes së jobesimtarëve dhe ka shpjeguar shpërblimin e përhershëm të besimtarëve.

Është më e përshtatshme që përjashtimi të jetë i vazhdueshëm, dhe qëllimi është që për jobesimtarët të ketë mundësi kthimi, e të thotë: ky dënim i madh mesiguri do të hiqet nga personat të cilët pendohen, besojnë në All’llah,bëjnë vepra të mira. Atyre u jep shpërblim të qëndrueshëm.

Hulumtim

I ndjeri Tabrasij, në komentimin e tij "Mexhmaul Bejan", përdor lirinë e plotë dhe dispozitën kryesore që njeriu ka, vullnetin e tij. All'llahu nuk i detyron njerëzit të kryejnë një gjë për të cilën nuk i ka njoftuar më parë.

Gjithashtu, All'llahu nuk e fajëson njeriun për moskryerje të namazit apo sexhdes, nëse vetë All'llahu e ka detyruar njeriun që të mos e kryejë atë.

Pra, nëse njeriu është i detyruar për të mos e kryer namazin, atëherë ndëshkimi, nga ana e All'llahut, do të ishte i pahijshëm, sepse, sikurse e thamë edhe më lart, nëse ne nuk kemi vullnet të lirë, si mund të ndëshkohemi apo si mund të vlerësohemi për diçka që nuk është në dorën tonë? Kur All'llahu thotë: **"Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?!""E përse, kur u lexohet Kur'ani, nuk përulen në sexhde?!"** është argument i qartë për çështjen e vullnetit, pra, ne kemi vullnet, jemi të lirë të zgjedhim, se si të veprojmë, ndaj edhe vlerësohemi, edhe dënohemi, kur nuk e kryejmë atë çka na është besuar.

Së dyti, qortimi për çështjen e sexhdes është argument për jobesimtarët, sepse ashtu sikurse ata kanë detyrim parimet kryesore të fesë, gjithashtu, kanë detyrime edhe për imtësitë që feja parashtron. Ky paragraf u tha për shkak se sexhdja, në ajetin e mësipërm, ka kuptimin e sexhdes së detyruar në namaz, ose ka kuptim të gjerë, ku përfshihet edhe ky kuptim.

O All'llah! Kur të gjithë do të paraqitemi para drejtësisë Tënde, na e lehtëso llogarinë!

O All'llah! Kur të gjitha krijesat lëvizin, ne na drejto e na udhëzo në Rrugën e Drejtë, drejt Teje!

O All'llah! Ne jemi dorëzuar para Kur'anit të Shenjtë, na jep mundësinë ta veprojmë e të zbatojmë atë!

Na fal o All'llah!

Përfundimi i sures "El Inshikâk"

Sure "El Burûxh"

Zbritur në Mekë

Ajete 22

Përmbajtja e sures "El Burûxh"

Besimtarët e qytetit të Mekës, në fillimet e thirrjes së Profetit Muhammed*(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin vazhdimisht nën presion dhe në vështirësi. Ata sulmoheshin nga armiqtë e fesë islame, si nga ana fizike, ashtu edhe nga ana shpirtërore, që të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Pati prej tyre që u bënë ballë dhe qëndresë dhunimeve dhe fyerjeve të vazhdueshme të armiqve të Islamit, por pati edhe nga ata që u thyen, u bindën e u kthyen përsëri aty ku kishin qenë më parë.

Duke ditur se kjo sure është nga suret mekase, duket se qëllimi kryesor është për të përforcuar zemrat e besimtarëve dhe për t'u dhënë atyre kurajë ndaj dhunimeve dhe vuajtjeve që hasin për të ruajtur besimin e tyre. Dhe, pikërisht për këtë, në këtë sure flitet për tregimin e As'habul Ukhdud, ata që hapën hendeqe dhe hendeqeve u vunë zjarrin. Në flakët e zjarrit hidhnin besimtarët. Këta besimtarë qëndruan në besimin e tyre dhe nuk u penduan.

Në një tjetër pjesë të kësaj sureje, flitet për jobesimtarët, të cilët i vendosnin besimtarët nën presion dhe i sulmonin me se mundeshin. All'llahu, ata jobesimtarë, i kërcënon me zjarrin e Xhehennemit, ndërkohë që besimtarët i përgëzon me Xhennet qëështë i mbushur plot e përplot me mirësi.

Më pas ata i kthen në të kaluarën, duke u treguar historinë e Faraonit, të Themudit dhe të popujve që ishin agresivë dhe të dhunshëm ndaj të tjerëve. All'llahu u flet atyre, duke u treguar ngjarje të vërteta dhe se si ata kanë rënë në gjunjë përballë dënimit të All'llahut dhe janë shuar nga faqja e dheut. Kështu që jobesimtarët e Mekës t'i bëjnë mirë llogaritë e tyre, sepse, nëse i

krahasojmë ata me çka cituam më lart, nuk kanë asnjë pushtet apo fuqi më shumë se ata.

Nga ana tjetër, kjo sure është ngushëllim dhe mbështetje për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe për besimtarët që nuk heqin dorë nga feja e tyre islame.

Në pjesën e fundit të sures, flitet për madhështinë e Ku'anit të Shenjtë dhe rëndësinë e jashtëzakonshme të tij dhe në këtë mënyrë e përfundon suren.

Në përgjithësi, kjo sure flet për qëndresën, për burrërinë dhe përpjekjet e besimtarëve përballë presionit dhe dhunës që jobesimtarët u bënin besimtarëve. Në këtë sure, gjithashtu, dallojmë premtimin që All'llahu u bën besimtarëve.

Kjo sure u quajt sure "Burûxh" - "Galaktikat", sepse në fillim të ajetit betohet për qiellin ku udhëtojnë yjet.

Mirësitë e leximit të sures "El Burûxh"

Është e mjaftueshme vetëm fjala e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që thotë: *"Çdokush që e lexon këtë sure, All'llahu i Madhëruar i jep dhjetë mirësi me masën e të gjithë atyre që mblidhen në faljen e ditës së xhuma dhe të gjithë atyre që në Ditën e Arafatit mblidhen në Arafat. All'llahu, atë njeri, e mbron nga frika dhe vështirësitë."*.[1]

Një nga interpretimet e vargut "dëshmitari i ditës së xhuma dhe Ditës së Arafatit" është All'llahu, si dhe për shkak se kjo sure flet për qëndrueshmërinë e madhe të besimtarëve të mëparshëm ndaj vështirësive dhe presioneve të shumta, përshtatshmëria e këtyre mirësive qartësohet me përmbajtjen e sures.

Gjithashtu, tregon se të gjitha këto shpërblime dhe mirësi janë për ata që jo vetëm e lexojnë suren dhe mendojnë rreth saj, por edhe praktikojnë atë çka lexojnë.

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 445.

Ajetet 1 – 9

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ۱ وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ۲ وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ۳ قُتِلَ أَصْحَابُ الْأُخْدُودِ۴ النَّارِ ذَاتِ الْوَقُودِ۵ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ۶ وَهُمْ عَلَى مَا يَفْعَلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ۷ وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَنْ يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ۸ الَّذِى لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَىْءٍ شَهِيدٌ۹﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Për qiellin me yjësi."

"Për Ditën e premtuar."

"Për dëshmitarin dhe për atë që dëshmohet!"

"Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut."

"Zjarrit (të ushqyer) **me lëndë djegëse."**

"Kur rrinin ulur rreth tij."

"Duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve!"

“Ata i munduan besimtarët, vetëm pse këta i besuan All’llahut, të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”

“Të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe që është Dëshmitar i çdo gjëje.”

Komentimi

Besimi i rrënjosur është më i mirë se gropat e zjarrit

E dimë që myslimanët e Mekës, në fillimet e tyre, kanë qenë në vështirësi të madhe. Armiqtë i dhunonin ata me se mundeshin. Sikurse e thamë edhe në përshkrimin e sures, qëllimi i zbritjes së sures ishte paralajmërimi i njerëzve që dhunonin besimtarët.

Nga ana tjetër, kjo sure është ngushëllim dhe përforcim jo vetëm i zemrës së besimtarëve të parë myslimanë, por për të gjithë myslimanët, përgjatë gjithë historisë. Surja hapet me një betim: **“Për qiellin me yjësi.”**.

Fjala *“el burûxh”* është shumësi i fjalës *“burxh”* dhe ka kuptimin: *kala*. Disa e kanë quajtur *“shej'un dhahirun”* – *“diçka e dukshme dhe e qartë”*. Vendosja e emrit të kalave dhe të ndërtesave të larta është për shkak të qartësisë dhe pamjes që ofrohet nga lartësia e tyre. Po për këtë shkak, një pjesë e veçantë e mureve përreth qytetit, ose vendi ku mblidheshin luftëtarët, të cilët kanë

një shfaqje të veçantë, i quanin *"burxh"*. Po ashtu kur një grua e shfaq bukurinë e saj, i thonë: "Teberuxhet el Merehu".[1]

Kullat qiellore kanë edhe kuptimin e yjeve të shndritshëm dhe të qartë të qiellit, ose kanë kuptimin e yjësive, që do të thotë "grup yjesh". Sipas mendimit tonë, ka ngjashmëri me një nga krijesat e tokës.

Kulla e dymbëdhjetë është e dymbëdhjetë yjësive, ku dielli bën udhëtimin e tij vjetor dhe për çdo muaj ai merr pamjen e njërit prej tyre (në të vërtetë dielli nuk lëviz, por është toka ajo që lëviz përreth tij dhe duket sikur dielli lëviz sa në një vend në një tjetër dhe merr formën e njërës prej këtyre yjësive).[2]

Çfarëdo kuptimi të ketë betimi, tregon për një ngjarje të madhe, madhështia e të cilës, në atë kohë, për arabët, nuk ka qenë e qartë, por në ditët e sotme, për ne, është shumë e qartë, edhe pse mendohet se janë galaktikat dhe qielli nëpër të cilin udhëtojnë yjet.

Në një hadith të transmetuar, thuhet se, kur e kanë pyetur Profetin Muhammed*(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për komentimin e këtij ajeti, ai është përgjigjur se bëhet fjalë për "planetet dhe yjet".[3]

Më pas shton: **"Për Ditën e premtuar."**.

---

[1] Disa studiues janë të mendimit se kjo fjalë është dhe vjen nga fjala perse *"berz"*, që ka kuptimin: *lartësi*. (shikoni te "Burhan Kate'eh" dhe shënimet e saj.)

[2] Dymbëdhjetë fytyrat janë shenjat që përdoren nga astrologët për horoskopin, si: dashi, demi, luani, virgjiresha, peshorja, akrepi etj.

[3] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 331.

Për këtë ditë të premtuar kanë folur të gjithë të Dërguarit dhe Profetët. Për këtë ditë kanë zbritur qindra ajete, nëpërmjet të cilave Kur'ani i Shenjtë lajmëron. Ajo është dita, kur kohëzgjatja dhe premtimi i të gjithëve, është i të parëve dhe i të fundmëve, ajo është dita, ku të gjithë do të japin llogari dhe të bëjnë shlyerjet e tyre.

Në betimin e tretë dhe të katërt thuhet: **"Për dëshmitarin dhe për atë që dëshmohet."**.

Janë dhënë komentime të shumta, se çfarë përfshin fjala *"shehid"* – *"dëshmitar"* dhe *"mesh'hud"* – *"për atë që dëshmohet"*. Do të citojmë më të rëndësishmit:

1- Fjala *"esh shahidu"* – *"dëshmitari"*, përfshin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sikurse thotë vetë Kur'ani: **"O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues."**.[1]

"Mesh'hud" është Dita e Kiametit, sikurse është thënë në Kur'anin e Shenjtë: *"dhalike jeumun mexhmu'un lehun'nasu ue dhalike Jeumun Mesh'hudun"* – **"...Ajo është Dita në të cilën do të tubohen të gjithë njerëzit; ajo është Ditë e dëshmuar."**.[2]

2- Fjala *"esh shahidu"*, ka të bëjë me dëshmitarët e veprave të njeriut, sikurse janë gjymtyrët e trupit, që dëshmojnë për të. Këtë gjë e shikojmë në ajetin 24 të sures "Nur": **"Ditën që, gjuha, duart, këmbët do të dëshmojnë për veprat që kanë kryer ata."**.*"Mesh'hud"* janë njerëzit dhe veprat e tyre.

[1] Sure "El Ahzâb", ajeti 45.
[2] Sure "Hûd", ajeti 103.

3- Fjala *"esh shahid"* ka kuptimin e ditës së xhuma, e cila është dëshmuese e xhematit të myslimanëve, në një ceremoni shumë të madhe, siç është namazi i asaj dite.

"Mesh'hud" është Dita e Arafatit. Vizitorët dhe pelegrinët e Shtëpisë së All'llahut të Madhëruar, janë dëshmitarë dhe të pranishëm në këtë ditë. Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të transmetuar nga Imam Bakiri dhe Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*është përmendur ky koment.[1]

4- *"Shahid"* është edhe dita e Kurban Bajramit dhe *"mesh'hud"* është Dita e Arafatit (një ditë para saj).

Thuhet në një hadith : "Një burrë u fut në xhaminë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe pa dikë të ulur, që po transmetonte hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai thoshte: 'Kur pyeta për komentimin e këtij ajeti, ai më tha se fjala *"shahid"* nënkupton ditën e xhuma, kurse fjala *"mesh'hud"*, Ditën e Arafatit.'

Kalova nga ai burrë dhe arrita te një tjetër, që po transmetonte hadith dhe fliste për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Unë e pyeta për komentimin e këtij ajeti dhe ai u përgjigj: 'Fjala *"shahid"* është dita e xhuma, kurse *"mesh'hud"* është dita e Kurban Bajramit.'

E kalova edhe këtë person dhe arrita pranë një djali të ri, i cili, gjithashtu, po transmetonte hadithe nga Profeti Muhammed

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 466.

(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Unë e pyeta edhe këtë person për komentimin e këtij ajeti dhe ai m'u përgjigj: *'Shahid'* është Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse *"mesh'hud"* është Dita e Kiametit. A nuk ke dëgjuar që All'llahu thotë: **'O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues.'"**.[1]

Unë e pyeta, cili ishte personi i parë që ti pyete, tha: 'I pari person , ishte, Ibn Abasi, i dyti ishte Abdullah ibn Omeri dhe i treti person ishte Husejn ibn Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[2]

5- Qëllimi i përdorimit të fjalës *"shahid"*, është të tregojë ditët dhe netët, kurse qëllimi i përdorimit të fjalës *"mesh'hud"*, është të tregojë për bijtë e Ademit, që dëshmojnë për veprat, sikurse edhe citohet në lutjen e mëngjesit të Imam Zejnul Abidinit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"Kjo është një ditë e re, që dëshmuesi ka ardhur për veprat tona. Nëse do të bëjmë mirë, ai do të largohet me falënderime, nëse veprojmë keq e bëjmë të këqija, ai do të largohet me trishtim dhe dhimbje"*.[3]

6- Në këtë rast, fjala *"shahid"* ka kuptimin: *engjëjt*, kurse fjala *"mesh'hud"* është Kur'ani.

7- Gjithashtu thuhet se fjala *"shehid"* është Guri i Zi "Haxherul Esued", kurse fjala *"mesh'hud"* haxhinjtë, pelegrinët që vijnë rreth tij dhe zgjasin duart për ta prekur.

---

[1] Sure Ahzab, ajeti 45.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 543; Kuptim të ngjashëm kanë sjellë edhe komentuesit, Abul Fet'hu Rrazij dhe Tabrasij, në tefsiret e tyre.
[3] "Sahife Saxhadije", Duaja e gjashtë.

8- Fjala *"shahid"* – *"dëshmuesi"* është njeriu, kurse fjala *"mesh'hud"* tregon *"për atë që dëshmohet, është hak"*.

9- Fjala *"shahid"* është ymeti islam, kurse fjala *"mesh'hud"* janë ymetet e tjera, ashtu sikurse ka ardhur në ajetin 143 të sures "El Bekare": **"...i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju."**.

10- *"Esh Shahid"* është Profeti i Islamit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)* dhe *"mesh'hud"* janë Profetët e tjerë, sipas ajetit 41 të sures "En Nisa": **"...dhe të të sjellin ty** (o Muhammed!) **për dëshmitar mbi të gjithë ata?!"**.

11- *"Esh shahid"* mund të jetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe *"mesh'hud* të jetë Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Sigurisht, përshtatja e këtij ajeti me ajetet e mësipërm, tregon se bëhet fjalë për "intuitën" e Ditës së Kiametit, si dhe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Profetëve të tjerë, në lidhje me popujt e tyre.

Po ashtu edhe engjëjt, edhe gjymtyrët e njerëzve, si dhe dita e nata. Fjala *"mesh'hud"* përfshin njerëzit, ose veprat e tyre. Kështu, shumë nga këto interpretime përmblidhen me njëri-tjetrin dhe në fund, do të përmblidhen në një grup, me një koncept të gjerë.

Por komentime të tilla, si: dita e xhuma, Dita e Arafatit dhe dita e festës, janë të ndara nga ky kuptim, edhe pse këto do të jenë dëshmitare në Ditën e Kiametit, për veprat e njerëzve. Por çdonjëra nga këto periudha, me plot popullim, do të përllogaritet si skenë e ringjalljes në këtë botë.

Sipas këtyre shpjegimeve, bëhet e qartë se midis komentimeve të mësipërme nuk ka ndonjë konflikt dhe kuptimi i fjalës *"shehid"* dhe *"mesh'hud"* mund të jetë i përmbledhur, gjë që tregon madhështinë e Kur'anit, i cili përmban, në vetvete, kuptime shumë të gjera dhe mbart komentime të shumta.

Fjala *"esh shahid"* përmbledh çfarëdolloj dëshmie dhe fjala *"mesh'hud"* përmbledh çdo gjë që dëshmohet. Të dyja këto kanë ardhur në mënyrë të papërcaktuar, duke treguar madhështinë e këtyre fjalëve.

Vihet re se midis këtyre katër pjesëve është një lidhje delikate, nga një anë dhe nga ana tjetër, është subjekti për të cilin betohet. Qielli, yjet e ndritshëm dhe kullat, që të gjitha këto janë shenjë e rendit dhe e llogarisë.

Gjithashtu, edhe *"Jeumul meu'ud"* është një skenë e qartë nga dhënia e llogarisë. Edhe dëshmitari, edhe i dukshmi, janë mjete për të arritur saktësisht te kjo llogari. Për më tepër, të gjitha këto betime janë për të paralajmëruar torturuesit mizorë. Veprat e tyre përballë besimtarëve të vërtetë janë të regjistruara dhe të gjitha ruhen për Ditën e Premtuar. Dëshmitarët që janë rreth jush, si: engjëjt, gjymtyrët e trupit, nata dhe dita dhe të tjerë si këto, i kanë nën kontroll.

Në atë Ditë ata do të dëshmojnë.[1]

[1] Në këtë rast, përgjigjja e betimit është e fshehur, ashtu siç shikohet te fjalia: *"Kutile As'habul Ukhdud"*, ose *"In'nel'ledhine fetenu mu'minine uel mu'minat"*.

Ndaj, pas këtyre betimeve All'llahu thotë: **"Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut, zjarrit** (të ushqyer) **me lëndë djegëse, kur rrinin ulur rreth tij, duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve!"**.

Fjala *"ukhdud"*, sipas Ragibit, në librin "Mufredat", ka kuptimin e një hendeku të gjerë, të thellë dhe të përhapur në tokë. Sipas një tjetër interpretimi, *"ukhdud"* kanë quajtur gropa të mëdha, ose kanale. Shumësi i kësaj fjale është *"ekhadid"*,është marrë nga *"khudun"*. Arabët quajnë *"khudun"* dy kanalet anësore të hundës së njeriut, që nëpërmjet tyre rrjedhin lotët kur njeriu qan. Gjithashtu, edhe përrenjtë apo edhe kanalet që shfaqen mbi tokë, janë quajtur *"khudun"*.

Ndërsa për sa i përket rastit se, kush ishin ata që dhunuan dhe se cilës periudhë i përkisnin, janë dhënë shumë mendime nga komentuesit.

Këto do t'i citojmë një e nga një, në vazhdim të ajetit. Po një gjë është e sigurt, se ata kishin bërë gati hendeqe të mëdhenj me zjarr dhe i detyronin besimtarët që të hiqnin dorë nga besimi i tyre, pasi, në të kundërt, do t'i hidhnin në zjarr. Kur ata u përballën me qëndresën e besimtarëve, një grup prej tyre i hodhën në hendeqet me zjarr dhe i dogjën.

Fjala *"uekud"*, në origjinal, ka kuptimin e një "lënde djegëse", si për shembull, druri, qymyri, etj. Interpretimi me togfjalëshin *"dhatul uekud"*, në këtë rast, bëhet fjalë për diçka të shtuar në zjarr, përveç drurit apo lëndëve të tjera djegëse, që ata përdorën për të djegur besimtarët.

Nëse disa, togfjalëshin *"dhatul uekud"*, e kanë komentuar si *"flakë zjarri"*, me sa duket, në këtë rast, është për këtë arsye dhe nuk është sipas asaj që menduan disa nga komentuesit.

Ata mendonin se fjala *"uekud"* ka dy kuptime, njëri *"hizum"* - *"dru zjarri"* dhe tjetri *"flakë"*. Kështu ata u zhgënjyen se përse komentuesit dhe përkthyesit nuk i kushtuan vëmendje këtij rasti.

Sa i përket qëllimit për ajetin: **"Kur rrinin ulur rreth tij."** dhe ajetin që vjen pas tij, tregon se një grup jo vetëm që përgatiti me gjakftohtësi një skenë dhune, por edhe e shikonte atë me kënaqësi. Kjo gjë, përfundimisht, tregon shkallën e lartë të mizorisë së tyre.

Disa thanë se ky grup ishte udhëzuar që të kryente masakra ndaj besimtarëve, që ata të hiqnin dorë nga besimi dhe medh'hebi i drejtë i tyre.

Të tjerë thanë se ata ishin dy grupe, njëri i dhunonte ata dhe grupi tjetër i vëzhgonte ata në kohën që dhunoheshin. Për shkak se vëzhguesit ishin dakord me veprat e dhunuesve, ky veprim u atribuohet edhe atyre. Është e natyrshme se gjithmonë kur kryhen të tilla gjëra, një grup vepron, një grup vështron dhe përveç këtyre, janë edhe udhëheqësit e këtyre njerëzve, që urdhërojnë shtresat më të ulëta për t'i kryer veprimet.

Gjithashtu, është thënë se një grup tjetër ishte ulur dhe kujdesej për punën që kryenin mizorët, që të mos e linin pa kryer programin që kishin për besimtarët. Kështu, ata raportonin çdo gjë te drejtuesit e tyre. Kompozimi i këtij grupi nuk ishte i paimagjinuar, ndaj përmbledhja e interpretimeve midis tyre është e mundur.

Folja *"jef'alun"* tregon se ky veprim nuk ka qenë vetëm një ngjarje, por i vazhdueshëm.

Po, i vetmi mëkat i tyre ishte besimi në All'llahun e Madhëruar, Zoti i Plotfuqishëm, që meriton çdo lloj adhurimi, që është gjithëpërfshirës dhe i përsosur.

A mos vallë ishte mëkat të kesh besim në të tillë Zot?

A mos vallë, ishte më mirë të adhuroheshin idhujt që nuk kanë asgjë, as mendje e as arsye?!

Fjala *"nekamu"* vjen nga rrënja *"en nekmu"* dhe ka kuptimin: mohim të diçkaje, qoftë ky mohim me gojë, qoftë me vepra, nëpërmjet mrekullive.

Gjithashtu, edhe fjala *"intikam"* vjen nga e njëjta rrënjë. Padyshim se një punë e tillë kryhet përballë një mëkati të madh dhe të dukshëm dhe nuk është përballë besimit në All'llahun e Madhëruar dhe të Plotfuqishëm, që meriton të gjitha adhurimet. Kjo gjë tregon se sa e shthurur ka qenë kultura e atij populli, që krenarinë më të madhe, që është besimi i njeriut në Zot, e konsiderojnë si mëkat.

Megjithatë, kjo gjë është e ngjashme me ajetin 126 të sures "El A'Arâf": **"Ti po hakmerresh ndaj nesh vetëm pse besuam shenjat e Zotit tonë, posa na erdhën. O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!"**.

Interpretimi me fjalën *"azijz"* dhe *"hamijd"*, është përgjigje dhe argument ndaj mizorive dhe krimeve të tyre, që do të thotë se mos vallë është mëkat të besosh një Zot të tillë, me të gjitha cilësitë

dhe përsosmëritë?! Përveç kërcënimit dhe paralajmërimit, këta mizorë, përgjatë gjithë historisë, do të konsiderohen si kriminelë. All'llahu i Madhëruar, i Plotfuqishëm dhe i denjë për t'u adhuruar, atyre u ka vënë pritë.

Më tej shton edhe dy prej cilësive të Krijuesit: **"Të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe që është Dëshmitar i çdo gjëje."**.

Këto katër cilësi prej cilësive të Krijuesit, janë sigurisht cilësi që e meritojnë denjësisht adhurimin e Tij. Fuqia dhe pushteti i Zotit, tregojnë se Ai është pronar i tokës dhe i qiellit dhe perceptuesi i çfarëdolloj përsosmërie.

Ndërkohë që për besimtarët, Zoti është i pranishëm në çdo çast. Sigurisht, t'i kushtosh vëmendje kësaj të vërtete, të jep fuqi dhe gëzim.

Nga ana tjetër, për armiqtë është paralajmërim, për t'i njoftuar ata se, nëse All'llahu nuk bëhet pengesë për punën që kryejnë ata, nuk do të thotë se nuk është në dijeni apo nuk ka pushtet e forcë për ta ndaluar një gjë të tillë, por All'llahu i vë në provë ata.

Në përfundim, ata do ta shijojnë ushqimin e hidhur dhe të dhimbshëm të All'llahut.

Dy hulumtime

Kush ishin "As'hab Ukhdud"?

Thamë se fjala *"ukhdud"* ka kuptimin e hendekut të madh, ose të një kanali të madh. Në këtë rast, bëhet fjalë për hendeqe shumë të mëdhenj, të cilat ishin të mbushura me zjarr. Në këto hendeqe, besimtarët i hidhnin për t'i djegur turma-turma.

Midis komentueseve ka diskutime se, kur ka ndodhur kjo ngjarje dhe te cili popull apo pjesë e botës.

Ndërmjet komentuesve është e njohur se kjo ngjarje ka të bëjë me Dhu Nuvasin, mbreti i fundit i dinastisë Hemir,[1] që jetonte në tokën e Jemenit. Shpjegim: Dhu Nuvasi ishte personi i fundit nga dinastia e fisit Hemir, i cili u kthye në jehudi, po ashtu fisi Hamir e ndoqi atë në këtë përzgjedhje, ai e ndryshoi emrin e tij duke përzgjedhur emrin Jusuf. Si kaloi pak kohë atë e njoftuan se në tokën e Nexhranit (në jug të Jemenit) ka akoma njerëz dhe grupe që ndjekin fenë e krishterë. Ndjekësit e fesë së Dhu Nevasit i thanë atij që t'i detyronte ata të Nexhranit, që të ndjekin fenë jehude. Kështu ai u nis drejt Nexhranit. Si arriti atje, i mblodhi të gjithë banorët dhe u foli për fenë jehude, si dhe këmbënguli që ata ta pranojnë fenë jehude. Ata nuk pranuan, madje ishin gati të binin dëshmorë, për të mbrojtur fenë e tyre.

[1] Humejr ishte një fis i njohur në Jemen.

Dhu Nevasi dha urdhër që të hapin një hendek të madh dhe në të të vënë dru zjarri dhe lëndë të tjera djegëse. Njerëzit i hodhën të gjallë në hendekun me zjarr.

Një grup tjetër prej tyre i vranë me shpata dhe i bënë copa–copa. Të djegurit dhe të vrarët arritën në njëzetmijë.[1]

Disa të tjerë shtuan se njëri nga besimtarët, Nasrani shpëtoi dhe iku për të kërkuar ndihmë në Rum, ku i tregoi mbretit për mizorinë dhe krimin e Dhu Nuvasit.

Mbreti iu përgjigj: "Toka juaj është shumë larg nga këtu, por do t'i shkruaj një letër mbretit të Habeshes (Abisini). Ai është i krishterë dhe është afër jush, ndaj do t'i kërkoj atij t'ju ndihmojë.".

Më pas ai e shkroi letrën dhe i kërkoi atij që të marrë hakun e gjakut të krishterëve të Nexhranit. Kështu burri nga Nexhrani vajti pranë mbretit të Habashesit dhe i foli për çfarë kishte ngjarë. Mbreti Nexhash u prek shumë nga kjo ngjarje e tmerrshme, për humbjen e këtyre besimtarëve të Profetit Mesi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Nexhashi vendosi të hakmerrej dhe e mori hakun e besimtarëve. Ushtria e Habeshes u nis drejt Jemenit dhe e mundi ushtrinë e Dhu Nevasit. Shumë prej tyre u vranë. Nuk zgjati shumë dhe pushteti i Jemenit ra në dorën e Nexhashit dhe u konsideruan si shtet i bashkuar i Habashes.[2]

[1] Tefsiri i "Ali ibn Ibrahim Kummij", vëll. 2, f. 414.
[2] "Kasesul Kur'an, i Belagij", f. 288.

Thellësia e hendekut, ku u dogjën besimtarët ishte dyzet "dhera"[1] dhe gjerësia e tij dymbëdhjetë "dhera"dhe çdo "dher" është afërsisht gjysmë metri. Ndonjëherë thuhet se është përdorur "*gez*", e cila është masë matëse më e madhe se një metër.

Disa komentues kanë transmetuar se thellësia ka qenë shtatë gropa dhe gjerësia e secilës prej tyre ishte në të njëjtën masë me atë që thamë më lart.

Ngjarja e mësipërme është transmetuar në mënyra të ndryshme, në shumë prej librave të tefsireve dhe të historisë.[2] Ndër komentuesit citohen: Tabrisi, në tefsirin "Mexhmaul Bejan", Abul Fetuh Razi, në tefsirin e tij "Fakhri Razi", në tefsirin "Kebir", Alusi, në tefsirin "Ruhul Meanij", Kurtubi në tefsirin e tij dhe Ibn Hishami në librin e tij (vëllimi, i parë, faqe 35), etj.

Nga se u tha më lart, bëhet e qartë se këta dhunues të pashpirt e morën dënimin e tyre dhe u mor haku i gjakut të dredhur nga besimtarët, në këtë botë, ndërsa dënimi i zjarrit të nxehtë i pret ata në Kiamet.

Grupi që dogji njerëzit për së gjalli, ishte nga jehuditët. Ka mundësi që për gjatë gjithë historisë, ky ishte grupi i fundit që dogji njerëz. Po është për t'u habitur se kjo risi mizore kundër njeriut, hyri në prehrin e vetë jehudive, sikurse e dimë grupe të shumta prej tyre në ngjarjen e Gjermanisë Hitleriste, u dogjën dhe ky veprim është bërë në këtë botë për këta njerëz.

---

[1] *Dhera*, është njësi matëse që përdorin arabët.

[2] Tefsiri "Ruhul Meanji" dhe "Abul Fetuh Rrazij", nëvazhdim të ajetit për të cilin diskutuam.

Përveç kësaj, Dhu Nevasi jehudi, i cili ishte themeluesi i kësaj mizorie, nuk mbeti pa lagur nga sherri i veprave të tij.

Në një transmetim të Prijësittë besimtarëveAli ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "Një magjistar i Ehli Kitabit[1] po vepronte sipas librit të tij qiellor. Një prej mbretërve kishte fjetur me motrën e tij. Ajo grua i kërkoi mbretit që ta lejonte martesën me motrën, por populli nuk e pranoi dhe nuk u bind që të lejohej ky akt. Mbreti, për t'i dënuar ata, hapi një hendek dhe në të ndezi zjarr. Njerëzit që nuk besuan dhe vepruan sipas librit të tyre qiellor, i dogji në hendekun me zjarr.

Dhe kjo është për As'habul Ukhdud Furs (Persian), si dhe me As'hab Ukhdud të Shamit. (Atje jetonin njerëz besimtarë dhe jobesimtarë, të cilët u hodhën në një hendek me zjarr).

Disa të tjerë, janë të mendimit se As'habul Ukhdud ka të bëjnë me ngjarjen e Profetit Daniel, profet i njohur i Beni Israilëve, dhe miqve e tij, i cili është cituar në librin Daniel nga "Teurati". Po ashtu dhe Thelebiu, i ka përputhur edhe Ukhdudët e Fursit me ta.[2]

Nuk është e pamundur që As'habul Ukhdud t'i përfshijë të gjithë këto, megjithëse përputhja më e njohur dhe më e famshme është ajo e Dhu Nuvasit në tokën e Jemenit.

[1] *Ehli Kitab*, janë ata njerëz besimtarë që kanë pasur libra nga ana e Zotit.
[2] "A'lamul Kur'an", f. 137 - 138.

2- Qëndresa në rrugën e ruajtjes së besimit

Për sa i përket flijimit për ruajtjen e besimit, si në të kaluarën, ashtu edhe në kohët e sotme, kemi parë shumë raste trimërie. Historia na ka treguar shumë persona, që e kanë shijuar dhimbjen drejt rrugës së besimit, me shumë dëshirë e dashuri. Disa janë varur, disa janë vrarë me shpata e shumë të tjerë janë djegur në zjarrin e mizorëve. Emrat e shenjtë të tyre janë regjistruar në histori.

Ndër to është edhe ngjarja e bashkëshortes së Faraonit, Asia, e cila për shkak të besimit që kishte te Profeti Musa bin Imrani, u përball me të gjitha torturat, derisa shpirtin e saj e dha në këtë rrugë.

Në një hadith të Prijësittë besimtarëve Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Zoti i Madhëruar përzgjodhi në mesin e njerëzve të Habeshes një Profet dhe njerëzit u ngritën në këmbë dhe e mohuan atë. Në mesin e tyre nisi një luftë. Shokët e atij Profeti i vranë. Një grup prej tyre i morën peng. Më pas përgatitën një vend dhe aty ndezën zjarr. Njerëzit i afruan te zjarri dhe u thanë se kush ishte në fenë e tyre, le të largohej dhe kush kishte fe tjetër, le të hidhej vetë në zjarr. Shokët e atij Profeti, kur e panë se nuk kishte rrugë tjetër, me guxim, u hodhën vetë në zjarr, duke garuar me njëri-tjetrin. Në këtë çast erdhi një grua. Në krahë mbante një fëmijë të vogël, një muajsh. Kur deshi të hidhej, instinkti i nënës nuk e la, u trishtua dhe u ndal. Fëmija i vogël i thirri: 'Nënë, mos ki frikë, hidhu edhe ti bashkë me mua!'*

Betohem në Zot, se një akt i tillë në Rrugën e All'llahut është një gjë shumë e vogël. Ky fëmijë ishte prej atyre personave që foli në moshë të vogël.".[1]

[1] Tefsiri "El Ajashij", në përputhje me transmetimin e tefsirit "El Mijzan", vëll. 20, f. 377.

Nga ky tregim mësohet se grupi i katërt i As'habul Ukhdudit ishte në Habeshe.

Historia e prindërve të Amar Jasirit, si dhe e personave të tjerë që përmendëm më lart, apo historia e shokëve të Imam Hysejnit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, të cilët garonin me njëri-tjetri në fushën e Kerbelasë, se kush e kush të binte dëshmor në Rrugën e Zotit, të tilla ngjarje, në historinë e fesë islame janë të njohura.

Edhe sot, mund të sjellim shembuj të shumtë për këtë fakt. Këta shembuj i kemi parë me sytë tanë, ose kemi dëgjuar që si i moshuari, si i riu jep jetën e tij për të mbrojtur fenë. Këta njerëz me njohuri dhe me dije kanë hedhur hapat e tyre me dashuri drejt martirizimit. Qëndresa e fesë hyjnore, si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët e sotme, nuk është e mundur pa të tilla sakrifica.[1]

[1] Citova lufën e Irakut ndaj Rrepublikës Islamike të Iranit. Luftëtarët, për të mbrojtur besimin dhe vendin e tyre, e vendosnin veten e tyre mbi mina. Gjithashtu, janë shtrirë në telat me gjemba, që shokët e tjerë të kalonin.

Ajetet 10 – 16

﴿إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَلَهُمْ عَذَابُ الْحَرِيقِ١٠ إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْكَبِيرُ١١ إِنَّ بَطْشَ رَبِّكَ لَشَدِيدٌ١٢ إِنَّهُ هُوَ يُبْدِئُ وَيُعِيدُ١٣ وَهُوَ الْغَفُورُ الْوَدُودُ١٤ ذُو الْعَرْشِ الْمَجِيدُ١٥ فَعَّالٌ لِمَا يُرِيدُ١٦﴾

"Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtaret e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehennemit dhe dënimi me djegie."

"Kurse për ata, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore."

"Vërtet, ndëshkimi i Zotit tënd është i ashpër!"

"Vërtet, Ai e zë fill krijimin dhe e përsërit atë."

"Ai është Falësi i madh, i Dhembshuri."

"Zotëruesi i Fronit të Lavdishëm"

"Vepruesi i gjithçkaje që dëshiron."

Komentimi

Dënimi i Alla'llahut për kriminelët

Në ajetet e mëparshme u fol për mizorinë dhe torturat e paimagjinueshme, duke i futur në zjarr për së gjalli, që iu bënë popujve qëndrestarë. Në ajetet që do të komentojmë, do të flitet për dënimin Hyjnor që do të marrin ata mizorë. Gjithashtu, do të flitet edhe për shpërblimin e madh që do të marrin këta besimtarë.

Ajeti 10 thotë: **"Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtaret e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehennemit dhe dënimi me djegie."**.

Fjala *"fetenu"* vjen nga rrënja e fjalës *"fetene"* dhe ka kuptimin: vendosja në zjarr e floririt, që të bëhet e qartë pesha e vërtetë e tij.

Më pas, këtë rrënjë (fetene) e kanë përdorur edhe me kuptimin e marrjes në provim, si dhe me kuptimin dënim. Gjithashtu, është përdorur edhe për ata që nuk janë në Rrugë të Drejtë, si dhe për ata që bëjnë shirk (i vënë shok All'llahut).

Në ajetin për të cilin po flasim, është me kuptimin *"dënim"* dhe *"torturë"*. E ngjashme me këtë ajet janë edhe ajetet 13-14 të sures "Edh Dharijat": **"Atë Ditë ata do të përcëllohen në zjarr!** (Do t'u thuhet): **'Shijoni dënimin tuaj! Këtë kërkuat t'ju shpejtohet!'"**.

Fjalia: "*E nëse pendohen"*tregon se edhe për të tillë njerëz mizorë dhe torturues, dera e pendesës është e hapur. Kjo tregon

përfundimin e mirësisë së All'llahut në lidhje me mëkatarët. Gjithashtu, është paralajmërim për njerëzit e Mekës, se asnjëherë nuk është bërë vonë të heqin dorë nga torturat e besimtarëve dhe të kthehen drejt Zotit.

Në parim, Kur'ani nuk e mbyll derën e tij ndaj njerëzve dhe kjo gjë është shenjë për të vendosur dënimet e mëdha, për të korrigjuar të korruptuarit dhe korruptuesit, që të kthehen drejt së vërtetës (Zotit).

Ajo çka bie në sy, është se për këta njerëz janë cituar dy lloje dënimesh, dënimi i Xhehennemit dhe dënimi me zjarr djegës.

Citimi i këtyre dy dënimeve ndoshta është për shkak se në Xhehennem ka lloje të ndryshme dënimesh. Një prej tyre është me zjarr përvëlues. Citimi i këtij lloj dënimi është për shkak se mizorët dhe torturuesit i dogjën besimtarët me zjarr dhe ata, atje duhet të dënohen, me të njëjtën mënyrë.

Por duhet të dihet se ky zjarr, me atë zjarr, nuk ka të krahasuar. Zjarri i Xhehennemit është me flakët e hidhërimit të All'llahut, është zjarr i përhershëm. Ndërsa zjarri i kësaj bote është zjarr i paqëndrueshëm, i cili ndizet me dorën e njeriut. Ndaj dhe është i dobët dhe besimtarët që digjen në të, shkojnë me kokën lart dhe krenarë. Ata e kanë vendin në rreshtat e parë të martirëve që kanë rënë në Rrugën e Zotit.

Disa janë të mendimit se dënimi me Xhehennem është për mos besimin e tyre, ndërsa dënimi me zjarr është për veprat e tyre dhe torturën që kryen.

Më tej flitet për shpërblimin e besimtarëve: **"Kurse për ata, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj."**.

E ç'duhet më tepër se kjo fitore?! Ku ka më mirë se sa të rrish pranë Zotit, në mesin e të gjitha mirësive, që janë të përjetshme?! Ata, me kokën lart dhe me krenari, do të zënë vend pranë Krijuesit. Nuk duhet të harrojmë se çelësi kryesor i kësaj fitoreje të madhe ishte besimi dhe veprat e mira të tyre. Kjo është pasuria e kësaj rruge. Të tjerat, cilatdo qofshin, janë degë dhe gjethe.

Interpretimi me *"amilu salihati"*, tregon se vepra e mirë nuk është e kufizuar me diçka të posaçme, por, në çdo gjë, duhet të kemi program për të kryer vepra të mira (amelu saleh) për gjatë gjithë jetës, sa jemi gjallë.

Fjala *"dhalike"*, në gjuhën arabe, përdoret për të treguar nga larg dhe interpretimi me këtë fjalë, në këtë rast, tregon rëndësi dhe pozitë, që do të thotë, se fitorja dhe shpëtimi, si dhe krenaria e tyre është aq e madhe, saqë ne nuk arrijmë ta perceptojmë, pra është jashtë fuqive tona perceptuese.

Më pas, edhe një herë tjetër jobesimtarët mizorë kërcënohen: **"Vërtet, ndëshkimi i Zotit tënd është i ashpër!".**

Më tej u tërheq vëmendjen, duke u thënë se mos mendoni se Kiameti nuk ekziston apo se kthimi dhe ringjallja juaj është problem për ne: **"Vërtet, Ai e zë fill krijimin dhe e përsërit atë.".**

Fjala *"el batshu"* ka kuptimin *"fuqi"* dhe *"pushtet me zemërim"* dhe për shkak se kjo gjë zakonisht është hyrje e ndëshkimeve, këtë fjalë e kanë sjellë me kuptimin e ndëshkimit.

Përdorimi i fjalës *"Rabbeke" – "Zoti yt"*, është për të qetësuar mendjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për të theksuar mbështetjen e All'llahut ndaj tij.

Është për t'u theksuar fakti se në ajetin e mësipërm janë mbledhur disa fakte. Vetë fjala *"batshun"*, vetvetiu, mbart kuptimin e ashpërsisë së *"zemërimit dhe ndëshkimit"*.

Gjithashtu, *"fjalia emërore"* zakonisht vjen për të theksuar diçka.

Së treti, ndëshkimi është cilësuar i ashpër me fjalën *"shedijden"*.

Së katërti, prania e fjalës *"inne"* dhe e lam-it të vërtetësisë si dhe vërtetësia që përmban thënia e Allahut të Madhëruar: **"Vërtet, Ai e zë fill krijimin dhe e përsërit atë."** që është argument i përgjithshëm për Ringjalljen.[1]

Më tej, Kur'ani i **S**henjtë na njeh me pesë cilësi të tjera të Krijuesit të Plotfuqishëm: **"Ai është Falësi i madh, i Dhembshuri, Zotëruesi i Fronit të Lavdishëm, Vepruesi i gjithçkaje që dëshiron."**.

Fjalët: *"el gafur"* dhe *"el eudud"*, tregojnë pafundësinë e faljes dhe të dashurisë së All'llahut. Ai është Mëshirues dhe fal ata që

[1] Argumenti i mësipërm është një argument i bukur për çështjen e Ringjalljes. Në fund të sures "Ja Sin", ajeti 79, thuhet: **"Thuaj Ai që të krijoi në fillim, do të të ringjallë edhe një tjetër herë dhe Ai është në dijeni për të gjitha krijesat e Tij."**. Thonë se Ferabiu dëshironte që Aristoteli, filozofi grek, të ishte gjallë dhe të dëgjonte këtë argument të fortë dhe të bukur për çështjen e Ringjalljes, nëpërmjet Kur'anit.

pendohen. Ka dashuri pa fund për punëmirët. Në të vërtetë, citimi i cilësive përpallë kërcënimeve, në ajetet e mësipërme, janë për të shprehur këtë të vërtetë, se rruga e kthimit për mëkatarët është e hapur dhe All'llahu, në të njëjtën kohë që është Ndëshkues i rreptë, është Falës, i Dashur, Mëshirues dhe Mëshirëbërës.

Nga sa u tha, bëhet e qartë se fjala *"eudud"*, në këtë rast, shpreh dashurinë e Zotit në lidhje me robtë e Tij dhe jo dashurinë e njerëzve në lidhje me Zotin.

Cilësia e tretë që është *"Dhul Arsh"*. Fjala *"arshun"* ka kuptimin e fronit të lartë, por në këtë rast, tregon pushtet, fuqi.

Fjalia: *"Fea'alun Lima Jurijd"*, tregon të vërtetën e pushtetit absolut të All'llahut.

Si përfundim, pushteti dhe fuqia e Zotit, tregon për çështjen e Ringjalljes së të vdekurve dhe të dënimit të mizorëve.

Fjala *"mexhijd"* vjen nga rrënja *"mexhed"*, me kuptimin: *përhapje e lavdisë*. Kjo cilësi është veçanërisht për Zotin dhe për të tjerët përdoret shumë pak.[1]

Këto pesë atribute kanë një koherencë të qartë, sepse *"el gafur"* dhe *"el uedud"* bëhen të vleftëshme kur personi të ketë pushtet, si dhe mëshira e tij të jetë e gjerë dhe bekimet e tij tëjemë tëpafundme, në mënyrë që çfarë dëshiron ta kryej, mos të ketë pengesa për kryerjen e një punë apo diçkaje, po ashtu tëmos ketë përson tjetër, që t'ia rrëzojë ato çka bën e vepron, mos ta kundërshtojë askush. Në vullnetin e Tij, nuk ekziston dobësia, frika dhe lodhja.

[1] Duhet të dihet se fjala *"mexhijd"*, në ajetin e mësipërm, sipas leximit të njohur, është me zanoren *"u"* dhe është ndër cilësitë e Zotit. Nuk është me zanoren *"i"* nga cilësitë e Arshit.

Ajetet 17 – 22

﴿هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْجُنُودِ ١٧ فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ ١٨ بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي تَكْذِيبٍ ١٩ وَاللَّهُ مِنْ وَرَائِهِمْ مُحِيطٌ ٢٠ بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَجِيدٌ ٢١ فِي لَوْحٍ مَحْفُوظٍ ٢٢﴾

"A e ke dëgjuar ndodhinë e ushtrive"

"të Faraonit dhe të fisit Themud?"

"E megjithatë, ata që nuk besojnë, vazhdojnë ta quajnë atë (Kur'anin) **të rremë."**

"Ndonëse All'llahu është pas tyre e i ka nën kontroll."

"Përkundrazi, ai është një Kur'an i lavdishëm."

"Në Pllakën e Ruajtur mirë (Leuhi Mahfûdh)**."**

Komentimi

A nuk ke dëgjuar se çfarë i ndodhi ushtrisë së Faraonit dhe Themudit?!

Ajetet e mësipërme tregojnë pushtetin dhe fuqinë absolute të Zotit. Pushteti dhe kërcënimi i Tij ndaj mizorëve është që këto kërcënime të qartësohen. Ato nuk janë vetëm parulla, por janë kërcënime praktike. Ajetet në vazhdim i flasin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"A e ke dëgjuar ndodhinë e ushtrive të Faraonit dhe të fisit Themud?"**.

Ushtri të mëdha qëndronin përballë Profetëve të Zotit, që janë rreshtuar për të luftuar e për t'u përballur me fuqinë e Zotit. Ata mendonin se mund të qëndronin, të triumfonin përballë pushtetit të Zotit.

Pas kësaj flitet për dy shembuj të qartë. Njëri prej tyre ka ndodhur në kohë shumë të largëta dhe tjetri në një epokë më të afërt. Këto ushtri janë ushtri të Faraonit dhe të fisit Themud.

Disa, perëndimin dhe lindjen e botës, e vendosen nën pushtetin e tyre. Të tjerë çanë malet dhe gurët e mëdhenj i përdorën për të ndërtuar shtëpi dhe kështjella të mëdha. Por All'llahu, grupin e parë, e ndëshkoi me ujë dhe grupin e dytë e ndëshkoi me erën, të dyja këto janë mjete të nevojshme për jetesën e njeriut.

Dallgët e Nilit mbytën Faraonin dhe ushtrinë e tij, ndërsa era e ftohtë dhe e fortë e hodhi sa në një anë në tjetrën popullin e Themudit. Më pas, trupat e tyre, pa shpirt, u shtrinë mbi tokë.

Kjo u thuhet jobesimtarëve arabë se ata nuk mund të bëjnë asgjë, Zoti mori hak te kjo ushtri e madhe dhe e fuqishme, ndaj është e qartë se, sado të fortë dhe të dobëta të jenë ushtritë e tyre, për Zotin nuk përbën asnjë problem.

Përzgjedhja e popullit të Faraonit dhe të Themudit ndërmjet të gjithë popujve të mëparshëm, si shembull nga popujt kryeneçë, tregon se këta popuj ishin në kulmin e pushtetit dhe të fuqisë. Njëri prej tyre ka lidhje me të kaluarën, që është populli i Faraonit, ndërsa populli tjetër, ka të bëjë me një të kaluar më të afërt. Populli arab ishte i njohur në përgjithësi me emrin e popullit të Faraonit.

Më pas shton: **"E megjithatë, ata që nuk besojnë, vazhdojnë ta quajnë atë** (Kur'anin) **të rremë."**.

Për askënd nuk janë të fshehura shenjat e Krijimit dhe të ekzistencës së Zotit, por kokëfortësia dhe mendjemadhësia nuk lejon që disa të gjejnë Rrugën e Drejtë.

Interpretimi me fjalën *"bel"* tregon për të kaluar nga diçka në diçka tjetër, që tregon se ky grup jobesimtarësh, prej popullit të Faraonit dhe të Themudit, është ndër më të këqijtë, edhe më kokëfortët. Ata vazhdimisht janë të gatshëm të mohojnë dhe të thonë se Kur'ani është i rremë. Në këtë mënyrë dhe me këto mjete ata përfitojnë. Por ata duhet të dinë se All'llahu i ka në dorë ata, është zotërues i tyre, sikurse thotë ajeti: **"All'llahu është pas tyre e i ka nën kontroll."**.

Nëse All'llahu do që atyre t'u japë kohë, nuk është për shkak se nuk është i pushtetshëm apo i pafuqishëm, kur nuk i dënon ata shpejt, nuk është se nuk mundet t'i dënojë.

Fjala *"ueraihim"* – *"prapa tyre"* tregon se ata, nga të gjitha anët, janë nën pushtetin e Zotit dhe Zoti është mbikëqyrësi i tyre kudo. Ndaj është e pamundur që ata të jenë larg drejtësisë së Tij.

Ekziston edhe një tjetër mundësi, për sa i përket mbikëqyrjes që Zoti ka ndaj krijesave të Tij dhe ajo është dija që Ai ka për veprat e tyre, në të gjitha aspektet. Dija e All'llahut është në mënyrë të atillë, saqë as edhe një mendim apo nijet nuk mund t'i fshihet.

Në vazhdim shton se këmbëngulja e tyre për ta quajtur Kur'anin të rremë dhe për ta konsideruar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* magjistar dhe poet, janë të kota, sepse Kur'ani është i shenjtë dhe i lavdishëm, sikurse thotë vetë ajeti: "Përkundrazi, ai është një Kur'an i lavdishëm.".

Fjala e Kur'anit është regjistruar në pllakën Leuhi Mahfûdh, e cila ruhet e aty nuk arrin dora e të padëshiruarve, e shejtanit dhe e punëkëqijve. Ajo është larg çfarëdolloj ndryshimi, ceni apo shtese, sepse ajo, sikurse ajeti thotë, është *"Fi Leuhi Mahfudh"* – **"Në Pllakën e Ruajtur mirë** (Leuhil Mahfûdh)**."**.

Për këtë arsye, All'llahu e ngushëllon Profetin e Tij, duke i thënë se, nëse ata ty të mveshin gjëra që nuk i ke dhe, nëse ty të ofendojnë, duke të quajtur poet, magjistar, apo budalla, mos u trishto, sepse vendi ku ti mbështetesh, është i qëndrueshëm, i fortë, i rehatshëm dhe i qartë. Pra, mbështetësi yt është i Fuqishëm.

Këtu fjala "*mexhijd*", sikurse e kemi thënë, vjen nga rrënja "*el mexhdu*", që ka kuptimin: *bollëk, përhapje, dashamirësi dhe lavdi*. Ky kuptim, për Kur'anin e Shenjtë, është plotësisht i drejtë, sepse përmbajtja e tij është aq e madhe dhe e përhapur, saqë kuptimi i tij arrin majat më të larta, si në fushën e dijes, njohurive, besimit dhe të moralit, ashtu edhe në fushën e jurisprudencës dhe të traditës.

Fjala "*leuhun*" (me zanoren *fet'he*) ka kuptimin*: pllakë e madhe ku mbi të shkruhet*. Fjala "*luh*" (me zanoren *dammeh*) ka kuptimin *etje*. Gjithashtu, ka kuptimin e ajrit që është i vendosur midis qiellit dhe tokës.

Folja që në fillim është e përbërë, ka kuptimin e daljes në pah dhe të shkëlqimit. Gjithsesi, në këtë rast, qëllimi është për skenën ku është shkruar dhe është ruajtur Kur'ani i Shenjtë, por kjo skenë nuk është sikurse janë skenat e zakonshme midis nesh.

Në tefsirin e Ibn Abasit thuhet se gjatësia e *Leuhi Mahfûdhit* është sa përmasat e largësisë së tokës me qiellin, ndërsa gjerësia është në përmasën e largësisë së lindjes dhe perëndimit.

Këtu mendohet se *Leuhi Mahfûdhi* është po ajo skenë e dijes së All'llahut, dije që përfshin, në vetvete, lindjen dhe perëndimin. Kjo dije është e ruajtur nga çdo ndryshim.

Po, është e vërtetë, që Kur'ani, dijen e tij e ka marrë nga burimi i pashterur. Ai nuk është pjellë e mendjes së njeriut dhe as trillim i shejtanit. Përmbajtja e Kur'anit është dëshmi e këtij pretendimi.

Ka mundësi që kjo gjë të jetë në përputhje me interpretimin e vetë Kur'anit të Shenjtë, ku vetë Kur'ani vetveten e emërton me

emrin "Kitabul Mubijn" dhe ndonjëherë emërtohet me emrin "Ummul Kitab", sikurse e shikojmë edhe në ajetin 39 të sures "Er Ra'd": **"All'llahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë** (në këtë libër)**; dhe tek Ai është Libri Amëz."**.

Në ajetin 59 të sures "El En'âm", thuhet: **"Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë** (Leuhi Mahfûdhi)**."**.

Gjithashtu, është për t'u përmendur, se fjala *"Leuhil Mahfûdh"* në "Kur'anin e Shenjtë, është përmendur vetëm në këtë rast.

O All'llah, për hir të këtij Libri të madh qiellor, na bëj ne prej njohësve të së vërtetës!

O All'llah, në ditën kur besimtarët e pastër dhe punëmirë, të paraqiten pranë Teje dhe jobesimtarët të dënohen për punët e tyre, na vendos në mbrojtjen Tënde!

O All'llah, Ti je Falës e Mëshirues, i Dashur dhe Bujar, mos na dëno për veprat tona, por na mëshiro me cilësitë e Tua qiellore!

Amin ya rabel Alemin

Fundi i sures "El Burûxh".

Sure "Et Târik"

Zbritur në Mekë

Ajete 17

Përmbajtja e sures "Et Târik"

Çështjet që trajton kjo sure, përgjithësisht, rrotullohen në dy boshte:

1- Boshti i Ringjalljes

2- Boshti i Kur'anit të Shenjtë, vlerat dhe rëndësia e tij.

Surja fillon me betimet që të bëjnë të mendosh, flet për ekzistencën e kujdestarëve dhe mbrojtësve Hyjnorë të njerëzve. Më pas, për të vërtetuar ekzistencën e Ringjalljes, flet për jetën e njeriut, si dhe për krijimin e tij nga lëngu që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve të mashkullit.

Më tej, duke bërë një përmbledhje për gjithë sa u tha, nxjerr përfundimin se All'llahu që ka fuqi të krijojë një qenie njerëzore nga lëngu që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve të mashkullit (sperma), e cila është e pa vlerë, gjithashtu, ka fuqi ta ringjallë atë njeri përsëri.

Në fund të kësaj sureje, flitet për disa cilësi të Ditës së Ringjalljes. Më tej, pasi citon betimet e ndryshme, rikujton edhe një herë tjetër rëndësinë e Kur'anit të Shenjtë. Surja mbyllet me kërcënimin që u bën jobesimtarëve, për dënimin që do të marrin nga vetë All'llahu.

Mirësitë e leximit të sures "Et Târik"

Për sa i përket mirësive të leximit të kësaj sureje, përmendim një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Kushdo që e lexon këtë sure, All'llahu i jep shpërblimin dhjetë herë me sasinë e çdo ylli që ndodhet në qiell."*.[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"Çdokush që në namazet e detyruara, lexon suren "Ues'semai uet Târik"", në Ditën e Kiametit do të ketë pozitë të madhe pranë All'llahut. Në Xhennet do të jetë prej shokëve dhe miqve të Profetëve (Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)."*.[2]

Por duhet pasur kujdes se leximi i sures duhet të jetë në përputhje me veprën dhe jo lexim i thjeshtë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 469; "Uesailu Esh Shiati", vëll. 6, f. 149, Hadithi 7586, botim i Ehli Bejtit.
[2] Tefsiri "Theuabul Amal", në përputhje me tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 549.

Ajetet 1 – 10

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ١ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ٢ النَّجْمُ الثَّاقِبُ٣ إِنْ كُلُّ نَفْسٍ لَمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ٤ فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ٥ خُلِقَ مِنْ مَاءٍ دَافِقٍ٦ يَخْرُجُ مِنْ بَيْنِ الصُّلْبِ وَالتَّرَائِبِ٧ إِنَّهُ عَلَى رَجْعِهِ لَقَادِرٌ٨ يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ٩ فَمَا لَهُ مِنْ قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ١٠﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Për qiellin dhe për vizitorin e natës!"

"E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës?"

"Ai është ylli që shpon terrin."

"Për çdo njeri ka mbikëqyrës."

"Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar."

"Është krijuar prej një lëngu që hidhet."

"E që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve."

"Me të vërtetë, Ai është i Fuqishëm për ta kthyer (në jetë) **atë."**

"Ditën, kur do të zbulohen të fshehtat."

"Kur njeriu nuk do të ketë as fuqi, as ndihmës."

Komentimi

O njeri, shiko dhe mendo se nga se je krijuar!

Edhe kjo sure, si shumë prej sureve të xhuzit të fundit të Kur'anit të Shenjtë, nis me betime të bukura, që e vendosin mendjen e njeriut në punë. Këto betime, janë parathënie dhe fillesë për shpjegimin e një të vërtete të madhe.

"'Për qiellin dhe për vizitorin e natës!'. 'E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës?'. 'Ai është ylli që shpon terrin.'".

Fjala *"et târik"* vjen nga rrënja *"et tarku"* dhe ka kuptimin: *trokitje*. Për këtë shkak, arabët, edhe rrugën e kanë quajtur *"et târik"*, sepse gjatë ecjes, këmbët lëshojnë një melodi, pra, trokasin.

Fjala *"el matrakatu"* ka kuptimin e çekiçit që e përdorim për të goditur hekurin, çelikun, si dhe përbërës të tjerë të këtij lloji.

Gjithashtu, është quajtur *"et târik"*, edhe për shkak se në mbrëmje, kur dyert mbyllen dhe dikush do të hyjë brenda, është i detyruar të trokasë në derë.

Si rrjedhim, edhe personat që hyjnë brenda në mbrëmje, quhen *"et târik"*.

Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thotë për munafikun Esh'ath ibn Kajs. *"Kur ai erdhi pranë meje, me vete kishte sjellë ëmbëlsirë për të më korruptuar. Ai mendonte se me këtë veprim, do të tërhiqte vëmendjen time, që gjatë gjykimit, të mbaja anën e tij dhe ta mbroja atë. Më e çuditshme se kaq, është ngjarja e personit, kur trokiti natën në shtëpi dhe kërkoi të hynte brenda. Në dorë mbante një enë të mbushur plot me hallvë …"*.[1]

Vetë Kur'ani, në këtë rast, fjalën *"et târik"*, e komenton duke thënë se ky mik i natës, është ylli i shndritshëm që shfaqet në qiell. Ai është aq i lartë, saqë duket sikur do ta shpojë tavanin e qiellit. Drita e tij është kaq mirëbërëse, saqë e thyen errësirën dhe ndikon në brendësinë e syve të njerëzve.

(Vini re, fjala *"eth thakib"* vjen nga rrënja *"thekeb"* dhe ka kuptimin: *"bëj vrimë")*.

Ndërsa, për sa i përket emrit të planetit që ndriçon, komentuesit kanë mendime të ndryshme. Disa janë të mendimit se planeti ndriçues është Plejada (*Thureja, për shkak të lartësisë dhe të largësisë në qiell), ose Saturni, ose Venusi ose Meteorët*. Ky mendim vjen për shkak të largësisë dhe lartësisë që ka ky planet në qiell. Disa të tjerë mendojnë për planetin Saturn, Afërdita ose për meteor. Këto planete janë përmendur, për shkak të ndriçimit të tyre. Ose mund të bëhet fjalë për të gjitha planetet në qiell. Por, duke parë dhe duke iu përmbajtur tekstit që vjen më poshtë, shikojmë se

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbe 224.

planeti është emëruar me emrin *"Nexhmul Thakib"* – *"Ylli depërtues"*.

Në këtë rast, bëhet e qartë se nuk bëhet fjalë për cilindo yll, por për një yll që shndrin, që drita e tij çan perdet e errësirës dhe në sy të njerëzve ka ndikim.

Në disa transmetime, është thënë se *"Nexhmul Thakib"* është planeti i Saturnit, sepse Saturni e ka perëndimin në qiellin e shtatë dhe drita e tij çan qiejt dhe arrin në qiellin e fundit ndaj edhe All'llahu atë e ka quajtur *"Nexhmu Thakib"*.[1]

Këtë kuptim e kemi përputhur me një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "Dikush e pyeti Imam Sadikun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se cili është kuptimi i fjalës *'thakib'*, në ajetin kur'anor: 'El Nexhmu etth Thakib'."

Imami iu përgjigj: "Bëhet fjalë për planetin Saturn. Ky planet është i gjatë deri në qiellin e shtatë. Drita e tij i çan qiejt, duke arritur deri në qiellin e fundit. Ndaj edhe Zoti e ka quajtur me këtë emër, *Nexhmu Thakib*.[2]

Saturni është planeti i fundit dhe më i largëti i sistemit diellor, që shikohet me teleskop. Sipas përllogaritjes së orbitës së Hënës dhe, për shkak të renditjes së tij në sistemin diellor, është i vendosur në orbitën e shtatë, ndaj edhe Imami *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në këtë hadith, orbitën e tij e ka përllogaritur të shtatin.

Ky planet ka cilësi aq të vlefshme, sa Zoti betohet për të. Nga ana tjetër, edhe pse është planeti më i largët, mund të shikohet në

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 550, Hadithi 4.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5 , f. 550, Hadithi 4.

sistemin diellor. Për këtë arsye, në gramatikën arabe, çdo gjë të lartë, e krahasojnë me planetin Saturn. Për këtë arsye, ky planet është quajtur edhe "*Sheihul Nuxhum*".[1]

Planeti i Saturnit, që në gjuhën perse quhet "*Keivan*" është i përbërë nga rrathë të ndryshëm të shndritshëm. Këta rrathë e përfshijnë atë, edhe pse ai është i përbërë, gjithashtu, edhe prej tetë rrathësh të tjerë. Rrathët e shndritshëm të Saturnit, që e kanë rrethuar atë, janë ndër dukuritë më të çuditshme të qiellit. Shkencëtarët e planeteve, për këtë rast, kanë dhënë mendime të ndryshme, sepse këto dukuri akoma konsiderohen misterioze.

Disa shkencëtarë janë të mendimit se planeti Saturn ka dhjetë rrathë, ku tetë prej tyre mund të shikohen me teleskop të zakonshëm, kurse dy prej tyre mund të shikohen me teleskop profesional.[2]

Këto fakte, nuk kanë qenë të qarta për asnjë njeri, në kohën kur ka zbritur Kur'ani. Më pas, me kalimin e shumë shekujve, janë zbuluar dhe janë vërtetuar ato çka ka cituar Kur'ani i Shenjtë.

Por sido që të jetë, ka mundësi që qëllimi i përdorimit të fjalës "*nexhmu eth thakib*" mund të jetë për të shpjeguar një kriter të qartë, i cili nuk kundërshtohet, si dhe të tregojë yje të tjerë të lartë dhe ndriçues të qiellit.

Në transmetimet tona ka shumë komentime që kanë ardhur për këtë çështje. Po përmendim disa prej tyre.

---

[1] "Daru'l Mearif Dekhoda", kapitulli "Zuhel".
[2] "Daru'l Mearif Dekhoda", kapitulli "Zohel".

Në ajetin dhjetë të sures "Es Saffat" lexojmë: **"Djajtë nuk përgjojnë dot, veç atij që grabit diçka e që e ndjek një yll verbues."**.

Në këtë ajet, fjala *"esh shehab"* është përshkruese e fjalës *"thakib"*. Ndonëse ylli verbues është nga krijimet e çuditshme qiellore të kësaj bote, mundet që edhe njëri prej komentimeve të ajetit, të ketë diskutime për këtë rast të cituar.

Shkaqet e zbritjes së këtij ajeti, në disa prej librave të komentimit, janë miratuar.[1]

Le të shikojmë se përse janë këto betime. Në ajetin e mëposhtëm thotë: **"Për çdo njeri ka mbikëqyrës."**,që i regjistron dhe i ruan veprat për Ditën e Llogarisë.

Në ajetet 10-11-12 të sures "El Infitâr" lexojmë: **"Ndonëse mbi ju ka rojtarë** (që ju vëzhgojnë)**, shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni."**.

Në këtë mënyrë, ju nuk jeni kurrë vetëm. Kushdo qofshi, kudo qofshi, jeni nën kujdestarinë e engjëjve hyjnorë dhe të kujdestarëve të Krijuesit. Kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për edukimin dhe korrigjimin e njeriut.

Por çka është e rëndësishme, në këtë rast e që nuk është shpjeguar, është fjala se cili është ky mbikëqyrës? Çfarë çështjesh mbikëqyr dhe ruan ai? Këtë çështje e qartësojnë dhe e sqarojnë fare mirë ajetet në vijim. Ajetet dëshmojnë se mbrojtësit janë engjëjt dhe ajo çka ata ruajnë, janë veprat dhe punët e njeriu. Gjithashtu, është

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 397.

dhënë edhe një tjetër shpjegim, se bëhet fjalë për ruajtjen e njeriut nga ngjarjet dhe fatkeqësitë e papritura. Është e vërtetë se, nëse nuk do të ishte kujdesi Hyjnor, shumë pak njerëz do të vdisnin në mënyrë të natyrshme, sepse përmasat e ndodhive dhe ngjarjeve aksidentale janë kaq shumë të mëdha, saqë asnjë njeri nuk mund të dalë shëndoshë e mirë prej tyre, veçanërisht fëmijët e vegjël.

Ky ajet mund të ketë për qëllim edhe ruajtjen e njeriut nga vesveset e shejtanit, sepse, nëse nuk do të ishte mbrojtja Hyjnore, vesveset e shejtanit, xhindëve dhe njerëzve do të ishin kaq shumë të përhapura dhe të mëdha, saqë asnjë njeri nuk mund të shpëtonte i gjallë. Por, duke ditur se ajetet që vijnë më poshtë flasin për çështjen e Ringjalljes dhe dhënien e llogarisë për veprat që njeriu kryen, atëherë del në pah se komentimi i parë është më i përshtatshëm, edhe pse përmbledhja e tri tefsireve, për sa i përket ajetit, në fjalë nuk duket i paarritshëm.

Është e çuditshme se midis betimeve të cituara më parë, ka një lidhje të prekshme dhe të gjallë me çështjen e kujdesit të engjëjve ndaj veprave të njeriut, e cila përllogaritet si përgjigje e betimit, sepse qielli i lartë dhe yjet, që ecin në rrugën e tyre, janë argumente për ekzistencën e një rregulli dhe dhënies së llogarisë në këtë botë të madhe. Ndaj si mund të jetë e mundur që veprat e njeriut të jenë pa gjykim dhe pa kujdestar Hyjnor?

Më pas, për të argumentuar, për ata që e konsiderojnë të pamundur çështjen e Ringjalljes, thotë: **"Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar."**.

Me këtë fjali, All'llahu u thotë njerëzve se Kur'ani dhe mesazhi i Tij ka arritur te ju, pra, ai është në duart tuaja. Nuk ka

mënyrë më të bukur se kjo për t'i kujtuar njeriut nga se është krijuar. All'llahu i Madhëruar, me një fjali i pyet njerëzit se si është krijimi juaj. All'llahu i përgjigjet vetë kësaj pyetje, pa pritur përgjigjen e njerëzve, duke thënë: **"Është krijuar prej një lëngu që hidhet."**.

Në këtë rast, shpjegon se termi **"uji i hedhur"** është sperma. Më tej ajeti shpjegon se ky lëng del nga shtylla kurrizore dhe brinjët e mashkullit: **"E që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve."**.

Fjala *"es sulb"* ka kuptimin: *"shtyllë kurrizore"*, ndërsa fjala *"et teraib"* është shumësi i fjalës *"terjibe"*, që sipas njohësve të fjalorit, bëhet fjalë për brinjët e sipërme.

Në të njëjtën kohë, për kuptimin e kësaj fjale janë dhënë kuptime të ndryshme, duke e konsideruar si pjesë të parme të trupit të njeriut. Gjithashtu, fjala *"et teraib"* ka kuptimin e duarve, këmbëve dhe syve, ose një pjesë e kraharorit, ku përfshihen katër brinjët e krahut të majtë dhe të djathtë.

Gjithsesi, për sa i përket faktit se ç'kuptim kanë fjalët *"sulb"* dhe *"teraib"*, në këtë ajet të nderuar, ka shumë diskutime ndërmjet komentuesve. Për këto fjalë janë dhënë komentime të shumta, si për shembull:

1- Fjala *"sulb"* u referohet burrave, ndërsa fjala *"teraib"* u referohet grave. Struktura trupore e mashkullit tregon forcën fizike të tij. Ndërsa struktura trupore e gruas tregon butësinë dhe hijeshinë e saj. Duke u bazuar në këtë ajeti i referohet përbërjes së spermës së njeriut, burrit dhe gruas, që në terminologjinë e sotme, njihet si spermatozoid dhe Ovola.

2- Fjala *"sulb"* i referohet shtyllës kurrizore të burrit, ndërsa fjala *"teraib"* i referohet kraharorit dhe pjesës së përparme të trupit të tij. Ndaj dhe fjala *"sulb"* tregon spermën e burrit që është e vendosur në pjesët e brendshme të barkut dhe del nga organi gjenital i tij.

3- Disa janë të mendimit se bëhet fjalë për daljen e embrionit nga mitra e nënës, i cili është e vendosur midis pjesës së prapme të shtyllës kurrizore dhe pjesës së parme të trupit të saj.

4- Komentues të tjerë janë të mendimit se ky ajet flet për një çështje shumë të rëndësishme shkencore, që shkenca e ka qartësuar. Ndërkohë që kur ka zbritur Kur'ani, kjo gjë ishte e fshehtë për të gjithë. Shkencëtarët e embrionologjisë e kanë qartësuar faktin që sperma merret nga testikujt e burrit dhe që, nëpërmjet aktit seksual, shkon drejt vezëve të gruas. Studimet e shkencëtarëve të embrionit tregojnë se këto të dyja në fillim shfaqen në embrion, ku rrinë afër veshkave dhe përafërsisht përballë shtyllës kurrizore. Në krah të saj gjenden brinjët e prapme, si dhe brinjët që qëndrojnë më poshtë kraharorit të njeriut. Më pas, me kalimin e kohës dhe zhvillimin e këtyre dy pjesëve, gradualisht zbresin poshtë dhe, që të dy, vendosen në pozicionin e mëparshëm. Vendi kryesor i tyre është midis shtyllës kurrizore dhe brinjëve të kraharorit.

Kur'ani i Shenjtë ka përzgjedhur këtë interpretim, që në atë periudhë nuk ka qenë i qartë dhe i njohur për asnjë njeri, ndërkohë që shkenca e embrionologjisë e ka qartësuar tashmë këtë çështje.

5- Komentues të tjerë janë të mendimit se nga kjo fjali kuptohet që sperma merret nga të gjitha pjesët e trupit të njeriut, ndaj edhe në kohën e daljes së saj ajo është e kombinuar me të gjithë forcën e trupit. Pas daljes së saj, i gjithë trupi dobësohet. Për këtë shkak, shtylla kurrizore dhe brinjët e kraharorit, i referohen të gjithë pjesës së prapme dhe të gjithë pjesës së parme të njeriut.

6- Komentues të tjerë janë të mendimit se shkak kryesor i shfaqjes së spermës është palca kurrizore, e cila ndodhet prapa kurrizit dhe, më pas, është zemra dhe mëlçia që, njëra qëndron poshtë brinjëve të kraharorit dhe tjetra qëndron në mesin e këtyre dyve. Kjo dukuri është shkak i citimit të këtyre dy emrave *"sulb"* dhe *"teraib"*.

Por përpara çdo gjëje, duhet të kihet parasysh një çështje e rëndësishme, për të zgjidhur problemin dhe ai është: Më lart u fol vetëm për spermën e burrit, sepse termi i mësipërm *"main dafik"* – *"ujë kërcyes"* është cituar për spermën e burrit dhe jo për gruan.

Përemri i fjalës *"jekhruxhu"* rikthehet në ajetin më pas, duke thënë se ky ujë kërcyes del në mesin e shtyllës kurrizore dhe brinjëve të kraharorit. Të gjendur përpara këtij fakti, përzierja e gruas në këtë çështje kur'anore, nuk duket e përshtatshme. Por, më e përshtatshme është fakti se Kur'ani i është referuar njërit prej dy pjesëve kryesore të spermës, e cila është e prekshme për të gjithë.

Ndërsa qëllimi i përdorimit të fjalës *"sulb"* dhe *"teraib"* është të tregojë pjesën e prapme dhe të përparme e njeriut; sepse sperma që del nga burri, është e vendosur midis këtyre të dyjave.[1]

[1] Gjithashtu, në ajetet e tjera të sureve të Kur'anit, kur flitet për krijimin e njeriut dhe për spermën, është folur vetëm për spermën e burrit, për shkak se

Ky është një komentim i qartë, nuk është i përdredhur, është në një koordinim me atë çka u citua në librin e fjalorit. Në të njëjtën kohë, në këtë ajet, mund të jetë e fshehur një e vërtetë e rëndësishme, që ne nuk kemi fuqi dijeje për ta kapur. Ndoshta shkencëtarët, më vonë do të mund të na sqarojnë edhe më qartë.

Pas përshkrimit dhe marrjes së rezultatit, ajeti tjetër thotë se Ai që e ka krijuar njeriun nga lëngu (sperma), është i aftë ta rikthejë përsëri në jetë.

"Me të vërtetë, Ai është i Fuqishëm për ta kthyer (në jetë) **atë."**

Njeriu në fillim ishte baltë, më pas, përgjatë stadeve, është kthyer në formën e spermës dhe pas kalimit të stadeve të ndërlikuara dhe të habitshme, është shndërruar në një njeri të përsosur. Ndaj rikthimi i tij në jetë nuk është aspak problem.

I ngjashëm me këtë shpjegim është edhe ajeti 5 i sures "El Haxhxh": **"O njerëz, nëse ju dyshoni në Ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës..."**.

Gjithashtu, në ajetin 67 të sures "Merjem" lexojmë: "**A nuk e mban mend njeriu se Ne e kemi krijuar atë, kur ende nuk ishte asgjë?!".**

Në ajetin tjetër, All'llahu përshkruan atë ngjarje dhe Ditë të Madhe. Ky rikthim do të ndodhë një ditë dhe në atë ditë do të dalin në shesh sekretet e fshehura: **"Ditën, kur do të zbulohen të fshehtat."**

---

konsiderohet si çështje e prekshme. (shiko ajetin 46 të sures "En Nexhm", ajetin 37 të sures "El Kijame").

Fjala "*tubla*" vjen nga rrënja "*el beleua*", që ka kuptimin: *provë* dhe *provim*.

Kur njihet me provimin e vërtetë të sendeve të jashtme, atëherë rrënja e saj, në këtë rast, ka kuptimin: *shfaqje*.

Fjala "*serair*" është shumësi i fjalës "*seriretun*", që ka kuptimin: *gjendje, cilësi dhe nijete të brendshme dhe të fshehura.*

Në ditën kur gjithçka do të jetë e dukshme (JeumuBuruz) dhe e shfaqur (Jeumu Dhuhur), sekretet e brendshme do të dalin në shesh, përfshirë ato të besimit, të mosbesimit, të mosmarrëveshjes, nijetet e mira apo ato të këqija, hipokrizia dhe sinqeriteti, et.j, të gjitha këto, për besimtarët, janë tregues i krenarisë dhe më shumë se kaq, janë tregues i mirësisë.

Ndërsa për kriminelët, nga sa u tha më lart, do të jetë turpërim, ulje e dinjitetit, poshtërim etj. Por sa gjë e dhimbshme është që njeriu të kalojë një jetë duke fshehur brenda vetës së tij të këqijat që mbart në mendje, duke u hequr para njerëzve si njeri i mirë, me dinjitet e karakter, etj.

Por, në atë ditë, nuk do të ketë vlerë asgjë nga këto sa u tha, sepse të gjitha sekretet do të dalin në shesh. Ky turpërim ndonjëherë është më i hidhur dhe më i tmerrshëm se sa dhimbja që shkakton zjarri i Xhehennemit.

Në ajetin 41 të sures "Er Rrahmân" thuhet: **"Në Ditën e Kiametit mëkatarët do të dallohen nga fytyrat e tyre. Keqbërësit do të njihen sipas shenjave dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh."**.

Në një tjetër ajet, thuhet: **“Fytyrat e një grupi do të jenë të shndritshme dhe të qarta, ndërsa fytyrat e një grupi tjetër do të jenë të vrenjtura dhe të mbuluara nga pluhuri.”**.[1]

Ashtu si në mbrëmje shfaqen yjet në qiell, duke dalë nga vendi ku janë fshehur, ashtu do të shfaqen edhe kujdestarët dhe ruajtësit e veprave të njeriut.

Në një transmetim të Muadh ibn Xhebel thuhet: “E pyetëm të Dërguarin e All’llahut *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* për komentimin e fjalës *“serair”* , të përmendur në ajetin e mësipërm.

Pyetja ishte: Çfarë fshihet te njerëzit, që All’llahu do t’i provojë ata në Ahiret?

I Dërguari i All’llahut *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: *‘Sekretet, të fshehtat tuaja janë veprat që kryeni, sikurse është: namazi, agjërimi, zekati, abdesi, guslii xhunubit dhe çfarëdolloj vepre e pune e detyruar e juaja, sepse këto vepra janë të fshehta, sekrete, sepse njeriu mund të thotë që fala namazin, ndërkohë që nuk e ka falur, mund të thotë po agjëroj, ndërkohë që nuk po agjëron; mund të thotë kam abdes, ndërkohë që nuk ka marrë abdes.*[2]

Por, në atë ditë ka një problem të madh, sepse asnjë njeri nuk do të ketë as forca të brendshme e as të jashtme për t’i ndihmuar ata. **“Kur njeriu nuk do të ketë as fuqi, as ndihmës”**. Nuk do të ketë forcë, që të mbulojë të këqijat, pisllëqet dhe nijetet e tyre. Nuk do të ketë asnjë mik që ta mbrojnë ata nga dënimi i All’llahut. Ky

[1] Sure “Abese”, ajetet 38-41.
[2] Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 10, f. 472. I ngjashëm me këtë kuptim është edhe tefsiri “Durr’rrul Menthur”, vëll. 6, f. 336.

kuptim është përmendur në shumë ajete të tjera kur'anore, ku thuhet se në atë ditë, nuk do të ketë as shok, as ndihmës, as shpenzim dhe as flijim, nuk do të ketë as rrugë për t'u larguar e as rrugë për t'u kthyer nga xhungla e drejtësisë. E vetmja mënyrë shpëtimi është besimi dhe punët e mira. Po, burimi i shpëtimit është vetëm besimi.

Ajetet 11 – 17

﴿وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ١١ وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ١٢ إِنَّهُ لَقَوْلٌ فَصْلٌ١٣ وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ١٤ إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا١٥ وَأَكِيدُ كَيْدًا١٦ فَمَهِّلِ الْكَافِرِينَ أَمْهِلْهُمْ رُوَيْدًا١٧﴾

“Për qiellin që kthehet pareshtur.”

“Dhe për Tokën që plasaritet.”

“Që kjo është një Fjalë ndarëse.”

“Dhe nuk është aspak shaka!”

“Në të vërtetë, ata ngrenë kurthe.”

“Por dhe Unë ua pres me kurth.”

“Prandaj, jepu pak afat jobesimtarëve, lëri të qetë edhe për pak.”

Komentimi

I shkatërroj planet e armiqve

Në ajetet e mësipërme u fol për krijimin e njeriut nga sperma. Ndërsa në këto ajete do të flitet për çështjen e Ringjalljes, duke iu referuar disa argumenteve të tjera, sikurse është betimi.

Betohem për qiellin me plot shi: **"Për qiellin që kthehet pareshtur."**.

Betohem për tokën që plasaritet dhe që prej saj dalin bimët: **"Për Tokën që plasaritet."**.

Kjo është një fjalë e vërtetë, që ju do të ringjalleni: **"Kjo është një Fjalë ndarëse."**.

Është një çështje serioze, në të nuk përfshihet asnjë shaka: **"Nuk është aspak shaka!"**.

Fjala *"err rrexh'u"* vjen nga rrënja e fjalës *"err rruxhu'u"* dhe ka kuptimin: *kthim*. Arabët edhe shiut i thonë *"err rrexh'u"*, për shkak se uji ngrihet nga toka dhe deti e më pas, nëpërmjet reve, kthehet përsëri në tokë në formë shiu. Gjithashtu, në një kohë të shkurtër kohore, rënia e shiut përsëritet.

Edhe gropat që janë të mbushura me ujë shiu quhen *"err rrexh'u"*, për shkak të grumbullimit të ujit të shiut në to. Valët që

tunden, si pasojë e flladit dhe bëhet i qartë mbi sipërfaqe, quhen *"err rrexh'u"*.[1]

Fjala *"es sad'u"* ka kuptimin: *thyerje e trupave të ngurtë*. Duke u bazuar te kuptimi i fjalës *"err rrexh'u"*, të cilën e cituam më lart, shikojmë se ajo i referohet edhe thyerjes, ose çarjes së tokës së tharë, pas zbritjes së shiut dhe pas zhvillimit të bimëve.

Në të vërtetë, këto dy betime i referohen ringjalljes së tokës së vdekur nëpërmjet shiut, argument të cilin Kur'ani i Shenjtë e ka cituar shumë herë për çështjen e Ringjalljes, siç është ajeti 11 i sures "Kaf": **"Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe Ringjallja."**.

Vërehet një përputhje e qartë midis këtyre betimeve dhe ajo çka është rikujtuar për shkak të betimeve. Kjo gjë tregon butësinë e elokuencës së Kur'anit, sepse ndërmjet betimeve dhe për atë që është bërë betimi, ekziston një përputhje e habitshme.

Me fjalë të tjera: Në ajetin 5 të sures "Haxhxh" flitet për argumentin e çështjes së Ringjalljes, flitet dhe argumentohet çështja e krijimit të njeriut nga sperma dhe evolucioni embrionik. Edhe argumenti i ringjalljes së tokës së vdekur për shkak të rënies së shiut është cituar dhe është theksuar në suren "Et Târik".

Komentues të tjerë, ajetin 11 të sures "Et Târik" e kanë komentuar kështu: Gjithçka ka jetën e saj ciklike: rrotullimi i planeteve qiellore dhe rikthimi i tyre në gjendjen e mëparshme përgjatë periudhave të ndryshme, rrotullimi i tokës rreth vetes dhe rreth diellit, lëvizja e planeteve përreth sistemit diellor dhe lëvizja

[1] Ragibi "Mufredat", rrënja "rrexh'a".

e lindjes dhe e perëndimit të diellit, hënës dhe yjeve që janë gjithmonë në lëvizje, kanë rikthim.

Ekzistenca e këtij rikthimi është shenjë për rikthimin e përgjithshëm të njeriut në jetë. Kuptimi i parë i komentimit të ajetit ka më tepër përputhje me çështjen e çarjes së tokës dhe me argumentet e Ringjalljes.

Termi *"el kaulul fasl"*, do të thotë të ndash të drejtën midis të padrejtës. Në këtë rast, në simetri me ajetet e kaluara, përmbledhjen e saj e kanë konsideruar si referim të Ringjalljes.

Ndërkohë që komentues të tjerë atë ia kanë referuar Kur'anit. Sipas disa transmetimeve të Imamëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* këtë ia kanë referuar Kur'anit të Shenjtë.

Sigurisht që interpretimi për Kiametin me fjalën *"jemul fasl"* është parë edhe në ajete të tjera të Kur'anit. Kjo mundësi, gjithashtu, është e mundur, sepse ky interpretim u referohet ajeteve të Kur'anit, sepse ato, në të njëjtën kohë, na japin informacion për Ringjalljen, kështu në këtë mënyrë mund të përmblidhen të dy komentimet.

Prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* transmeton një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Shumë shpejt, në mesin tuaj do të shfaqen fitne."*.

O i Dërguari i All'llahut! Cila është rruga e shpëtimit prej saj?, - e pyeta

Ai u përgjigj: Kur'ani është shpëtuesi, sepse na jep informacion për paraardhësit dhe ata që do vijnë, Kur'ani do të jetë gjykatësi midis jush. Kur'ani është Fjala e Drejtë, fjala që do të ndajë të drejtën nga e padrejta. Ajo fjalë nuk është shaka, por është fjalë serioze. Çdo tiran që e braktis atë, All'llahu e shkatërron dhe çdokush që të vërtetën e kërkon diku tjetër, All'llahu i humbet ata, - tha Imami.[1]

Më pas, për të ngushëlluar mendjen e Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të besimtarëve njëkohësisht, si dhe për të kërcënuar armiqtë e Islamit thotë se ata vazhdimisht do të bëjnë hile dhe do të thurin kurthe: **"Në të vërtetë, ata ngrenë kurthe."**.

Më tej All'llahu shton se do t'jua prish kurthet dhe hilet: **"Por dhe Unë ua pres me kurth."**.

Tashmë, meqë është kështu jepu pak kohë jobesimtarëve, që të mund të shikojnë përfundimisht pasojat e punëve të tyre: **"Prandaj, jepu pak afat jobesimtarëve, lëri të qetë edhe për pak."**.

Po, ata gjithmonë do të thurin kurthe të papërshtatshme për të të luftuar ty:

Ndonjëherë nëpërmjet talljes.

Ndonjëherë nëpërmjet bllokadës ekonomike.

Ndonjëherë ata dhunojnë dhe torturojnë besimtarët.

[1] "Sahihul Tirmidhij"sipas transmetimit te tefsirit "Ruhul Meanij", vëll. 3, f. 100 dhe tefsirit "Meragij", vëll. 30, f. 118.

Ndonjëherë nuk lejojnë të dëgjohet Kur'ani; ndonjëherë bëjnë zhurmë, kur dikush e lexon atë.

Ndonjëherë do të të thonë magjistar.

Ndonjëherë do të të ofendojnë rëndë.

Ndonjëherë do të të konsiderojnë të budallallepsur.

Ndonjëherë, në mëngjes, do të bëhen me ty besimtarë e në mbrëmje do të bëhen qafirë, që të marrin nga pas njerëz.

Ndonjëherë do të të thonë se personat që të rrethojnë ty, janë të varfër dhe të dobët, prandaj largoi që ata të të qëndrojnë pranë.

Ndonjëherë do të të thonë që të paktën të njohësh disa prej zotave të tyre, që të të vinë nga pas.

Ndonjëherë do të thurin plane se si dhe kur do të të largojnë e të të vrasin.

Përfundimisht, ata do të shndërrohen në fytyra të ndryshme, që të hapin panik dhe të ndajnë grupin tënd. Ata do të përpiqen që miqtë dhe shokët të t'i vendosin në vështirësi, ose ty të të largojnë prej tyre, që ta shuajnë Dritën e All'llahut.

Por ata duhet ta dinë se All'llahu ka dashur që kjo dritë të jetë kudo, kjo dritë hyjnore nuk mund të shuhet e të fiket me pështymën e tyre.

Kjo është dritë e zbritur nga qielli, nuk mund të shuhet duke mbyllur sytë. Ata thurin plane dhe ne thurim plane.

Për komentimin e këtij ajeti, Ragibi, në librin "Mufredat", thotë se fjala *"el kejdu"*, ka kuptimin e një lloj zgjidhje të problemit (zgjidhet fshehurazi, ose duke parapërgatitur një mënyrë), që është dy llojesh: nuk dënohet, pëlqehet. Përgjatë përdorimit të saj, më tepër anon nga kritika.

Në të njëjtën kohë përdoret edhe si zgjidhje e problemit, sikurse është përdorur në ajetin 76, të sures "Jusuf": **"... Kështu, Ne e mësuam Jusufin, që ta bënte këtë dredhi..."**.

Në ajet dredhia e armiqve është e qartë, shembujt i sollëm më lart dhe në Kur'an ka plot ajete që flasin për plane të liga, por, në këtë rast, fjala *"kejd"* ka kuptimin e dhënies kohë.

Si rrjedhim, përfundon me një dënim të dhimbshëm. Më e përshtatshme është të thuhet se qëllimi është butësia që përfshin gjendjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të besimtarëve. Ndërsa armiqtë e Islamit i gjen të papërgatitur dhe përpjekjet e tyre i largon, duke shkatërruar edhe planet e tyre. Shembujt e këtij lloji janë të shumta.

Në këto ajete, veçanërisht Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i jep urdhër, që të jetë tolerant me ta e t'u japë kohë, të mos nxitojë për t'i shkatërruar ata. Le t'u jepet kohë e mjaftueshme për ta përthithur mesazhin. Ata që kanë sadopak parapërgatitje, t'i bashkohen fesë islame.

Ai që nxiton, ka frikë se mos i humbasin mundësitë. Kjo për Krijuesin nuk ka asnjë kuptim. Aty ku thuhet që t'u jepet kohë jobesimtarëve dhe më pas përsëritet jepu kohë, është mënyrë e të shprehurit, që të mos vijë rëndë në veshin e dëgjuesit.

Fjala *"ruejden"* vjen nga fjala *"er reudu"* dhe ka kuptimin *"shkoj dhe vij"*, si dhe përpjekje për të kryer me butësi së bashku diçka. Në këtë mënyrë, All'llahu, në këtë fjali të shkurtër, i jep tri herë urdhër Profetit të Tij, që të jetë i butë e t'u japë kohë. Kjo mënyrë e sjelljes është kryefjalë për të gjithë myslimanët, që të jenë të duruar përballë armiqve të tyre.

Gjithashtu, kur propagandojmë Rrugën e Drejtë, duhet të mos jemi të nxituar, në mënyrë që të gjithë ata që duan të udhëzohen, të mund të udhëzohen. Të gjithëve le t'u jepet mundësia dhe të marrin argumentin, që në Ditën e Kiametit të mos kenë shfajësim se nuk na ka ardhur argumenti i Zotit.

Ndërsa, për sa i përket faktit, se përse ky afat është cilësuar si i paktë dhe i shkurtër, ka dy përgjigje, ose për shkak se feja islame triumfoi mbi armiqtë e saj në një periudhë të shkurtër kohore. Planet e armiqve u thyen dhe thyerjen e parë e kanë shijuar në Luftën e Bedrit e më pas në mejdanin e Ahzabit, Khajberit dhe të Siffijnit. Kështu, planet e tyre u thyen dhe shtyllat e kalasë së pushtetit të tyre ranë.

Në fund të jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i gjithë Gadishulli Arabik ishte i ndriçuar nga drita islame. Pa kaluar një shekull, një pjesë e madhe e botës e asaj kohe, ishte e ndriçuar nga drita islame.

Përgjigjja tjetër është se edhe dënimi dhe ardhja e Kiametit është afër. Parimisht ajo çka është e prerë dhe faktive, si dhe e pakthyeshme, konsiderohet e afërt.

Sidoqoftë, kjo sure nis duke u betuar për qiej dhe planetet dhe përfundon duke kërcënuar armiqtë dhe planet e armiqve. Në

mes të sures shikohen argumente mbi Ringjalljen, të cilat janë sjellë shumë bukur dhe ndikojnë shumë te njeriu.

Gjithashtu, flitet për kujdesin që All'llahu ka për njeriun, ngushëllimi që i bën, si dhe i jep zemër besimtarit. Të gjitha këto, edhe pse janë sjellë me shprehje shumë të shkurtra, tregojnë butësi dhe rigorozitet.

O All'llah! Planet e thurura nga armiqtë, të cilat janë të shumta në kohën tonë, shkatërroi dhe bëj që ata të kuptojnë!

O All'llah! Në ditën që do të shfaqet e fshehta, mos na lër ne të turpërohemi!

O All'llah! Nuk kemi mbikëqyrës tjetër veç Teje, mos na lër në dorë të të tjerëve, përveç dorës tënde!

Amin Ya Rabil Alemin

Fundi i sures "Et Târik".

Sure "El A'lâ"

Zbritur në MekË

Ajete 19

Përmbajtja e sures "El A'lâ"

Kjo sure është e përbërë prej dy boshtesh. Njëri bosht flet për personalitetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për disiplinat në fushën e adhurimit të All'llahut dhe të përmbushjes së misionit.

Gjithashtu, numëron edhe shtatë prej cilësive të All'llahut të Madhëruar.

Boshti tjetër flet për besimtarët e nënshtruar, jobesimtarët e ligj. Më tej, në mënyrë të shkurtër, flitet për shkaqet e lumturisë dhe të fatkeqësisë së këtyre dy grupeve.

Në fund, kjo sure na njofton se këto çështje nuk janë cituar vetëm në Kur'anin e Shenjtë, por edhe në fletushkat dhe librat e Profetit Ibrahim dhe Musa.

Mirësitë e leximit të sures "El A'lâ"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, janë cituar shumë transmetime. Ndër to do të citojmë një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Çdokush që e lexon suren 'El A'lâ', do të shpërblehet me numrin e çdo fjale që i është shpallur Profetit Ibrahim (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), Profetit Musa (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) dhe Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).*".[1]

Në një tjetër hadith, nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Ai që e lexon suren 'El A'lâ' në namazet e detyruara ose ato nafile, atij personi, në Ditën e Kiametit, do t'i thuhet të zgjedhë nga cila derë dëshiron të hyjë në Xhennet, në dashtë All'llahu.*".[2]

Në hadithe të ndryshme thuhet se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* kur e lexonin këtë sure, thonin: I lartësuar ështëAll'llahu! *(Subhane Rabbil A'lâ)*.[3]

Ndërsa në një tjetër hadith lexojmë: "Një shok i Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: 'Kam falur namaz njëzet net pa ndërprerje, pas Imam Aliut. Në këto njëzet net nuk dëgjova të recitohej tjetër sure përveç sures "Sebbihisme Rabbikel A'la".

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* më tha: 'Nëse do ta dinit se sa mirësi dhe bereqet sjell kjo sure, secili nga ju nuk do ta linte pa e recituar këtë sure dhjetë herë në ditë. Çdokush që e

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 533.
[2] 1 dhe 2 Tefsiri " Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 533.
[3] Tefsiri "Nuruth Thekalejn" vëll. 5, f. 544.

reciton këtë sure, është njëjtë sikur ka recituar librin e Profetit Musa dhe Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*'".[1]

Shkurtimisht, nga të gjitha transmetimet dhe hadithet që janë cituar për këtë sure, mësojmë se kjo sure ka rëndësi të madhe, pra, është e një kalibri të veçantë.

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë se kjo sure ka qenë e dashur për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*[2]

Ndërsa se ku ka zbritur kjo sure, në Mekë apo Medine, midis dijetarëve dhe komentuesve ka diskutime. Ajo çka është e njohur dhe popullore, është fakti se kjo sure ka zbritur në Mekë.

Disa komentues të tjerë janë të mendimet se kjo sure ka zbritur në Medine.

Eruditi Tabatabai *(All'llahut qoftë i kënaqur me të!)* i jep më tepër përparësi mendimit se pjesa e parë e sures është mekase, kurse vazhdimi i saj është medinase. Ai komenton se vazhdimi i sures është medinase, sepse ajo flet për namazin dhe zekatin.

Për këto dy fakte, sipas komentimit që kemi marrë nga Imamët e Ehli Bejtit *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*, bëhet fjalë për namazin e Fitër Bajramit dhe për zekatin e Fitër Bajramit, sepse sikurse dihet, urdhri për agjërim në muajin e bekuar të Ramazanit, si dhe për namazin dhe zekatin, ka zbritur në Medine.[3]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 472.
[2] Tefsiri "El Mijzan" vëll. 20, f. 386.
[3] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 337. Ky hadith është tepër i zgjatur, por ne cituam një pjesë të tij.

Gjithashtu, ekziston edhe kjo mundësi, që urdhri për faljen e namazit dhe dhënien e zekatit, në fund të kësaj sureje, të jetë një urdhër i përgjithshëm, edhe pse namazi dhe festa e Fitër Bajramit dhe e zekatit të Fitrit është dhe përllogaritet si një nga shembujt më të qartë, sepse ne e dimë se komentimet me shembuj të qartë, në hadithet e Ehli Bejtit *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* janë të panumërt.

Prandaj mendimi i njohur, që thotë se e gjithë surja është mekase, nuk është vështirë për t'u menduar, veçanërisht për faktin se ajetet e para të sures dhe përfundimi i saj është plotësisht në përputhje me ndarjet e shkronjave. Ndaj është pak vështirë të thuhet se një pjesë e kësaj sureje të jetë mekase dhe pjesa tjetër e saj të jetë medinase.

Në një transmetim thuhet se çdo grup mysliman që hynte në qytetin e Medines, këtë sure e lexonte për njerëzit e Medines. Kështu që mundësia për të qenë medinase kjo sure, është vështirë për t'u besuar.

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿سَبِّحِ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى، الَّذِى خَلَقَ فَسَوَّى، وَالَّذِى قَدَّرَ فَهَدَى، وَالَّذِى أَخْرَجَ الْمَرْعَى، فَجَعَلَهُ غُثَاءً أَحْوَى﴾

Me Emrin e All'llahit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Lavdëro Emrin e Zotit tënd, më të Lartit."

"Që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjestuar drejt."

"Që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën."

"Që bën të rriten kullotat."

"Dhe pastaj të shndërrohen, të thahen e të vyshken."

Komentimi

Lavdëro emrin e All'llahut tënd!

Kjo sure, që nis me adhurimin dhe lavdërimin e Emrit të All'llahut, është ekstrakt i shkollës së Profetëve dhe i thirrjes së tyre. Që në fillim, surja i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Lavdëro Emrin e Zotit tënd, më të Larti t!".

Një grup komentuesish besojnë se, në këtë rast, fjala *"ismun"* ka të bëjë me fjalën *"musemma"*. Të tjerë thanë se kjo fjalë ka për qëllim të tregojë Emrin e All'llahut. Në të vërtetë, fjala *"ismun"* argumenton fjalën *"musemma"*. Mes këtyre dy komentimeve nuk ka ndonjë ndryshim të madh.

Qëllimi i vendosjes së emrit është sepse Emri i All'llahut nuk mund të vendoset në një rresht me emrat e idhujve. Qenia e Pastër e All'llahut është larg çfarëdolloj mangësie, të mete apo cilësie, që i përfshin krijesat, apo komplikimet fizike dhe materiale, apo çfarëdolloj kushtëzimi apo kufizimi që mund të mendohet. Ndërkohë që idhujtarët, Emrin e All'llahut e vendosnin pranë emrave të idhujve të tyre. Të tjerë mendonin se All'llahu është trup dhe, si i tillë, njihet apo konsiderohet si trup fizik.

Interpretimi me termin "El A'lâ" është tregues i kësaj të vërtete: All'llahu është më i pastër, më i dëlirë, më i qartë dhe më i lartë se çdokush apo çdo gjë që mund të mendojmë, apo çdo gjë që mund të meditojmë, apo të ëndërrojmë.

Interpretimi me fjalën "*Rabbeke*" - "*Zoti yt*" tregon se Zoti yt, në të cilin ti fton njerëzit, është ndryshe nga zoti i idhujtarëve.

Më tej, pas këtyre dy shpjegimeve për fjalët "Rabbi" dhe "El A'lâ", në vazhdim, shpjegon edhe pesë cilësi të tjera. Të gjitha këto komentojnë Veten e Qenies të Zotit. Ajeti thotë: "Që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjesëtuar drejt.".

Fjala "*seua*" vjen nga rrënja "*et tesuijetu*", me kuptimin: *sistemoj* dhe *klasifikoj*, pra, sistemoj gjithçka. Gjithashtu, kjo fjalë ka kuptimin e një koncepti më të gjerë, ku përfshin të gjithë sistemin e botës, përfshirë atë sistem që mbështetet te planetet qiellore dhe në sistemin që sundon veçanërisht njerëzit.

Disa komentues, këtë sistem e komentuan si sistemin e veçantë të duarve, këmbëve, syve, gjymtyrëve dhe të shpirtit të njeriut. Por të vërtetë, nga ky koncept i gjerë kuptojmë qëllimin e kufizimit.

Ndaj dhe sistemi i krijimit të universit, që përfshin edhe sistemin më të madh qiellor, është dëshmitar për të vërtetuar ekzistencën e Krijuesit. Kjo gjë vërtetohet edhe me çështje shumë të thjeshta, sikurse është çështja e vijave të gishtërinjve të njeriut, e cila është cituar në suren "El Kijâme": **"Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij."**.[1]

Ajeti i sures "El Kijâme" është dëshmi e qartë për të vërtetuar ekzistencën e All'llahut. Pra, ne vërejmë se në një ajet të shkurtër ka një botë të tërë me informacion.

[1] Sure "El Kijâme", ajeti 4.

Pasi flitet për sistemin e krijimit dhe sistemimin e krijesave, citohet një tjetër temë, jo pak e rëndësishme, që është programimi i udhëzimit të krijesave në rrugën e përsosmërisë. Ajeti thotë: **"Që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën."**.

Fjala *"el kaderu"* ka kuptimin: *caktim, përcaktim i një programi, i cili lëviz drejt një qëllimi, qëllim që është krijuar për krijesat*.

Fjala *"huda"* ka kuptimin e udhëzimit që nga gjeneza (lindja), e cila vjen si motivim, ku mbi to mbizotëron ligji. Ky motivim, si të jetë i brendshëm apo si të jetë i jashtëm, përfshin mbizotërimin e ligjit. Për ta ilustruar këtë komentim, do të sjellim shembullin e nënës me fëmijën. All'llahu ka krijuar gjoksin e nënës, që nëpërmjet tij të ushqehet fëmija dhe nëna të ketë një dashuri shumë të madhe për fëmijën.

Nga ana tjetër, te fëmija është krijuar motivimi, që atë e tërheq drejt gjoksit të nënës. Ky motivim dhe përgatitje midis dy palëve është i dyanshëm, për të arritur rrugën drejt qëllimit. Kjo gjë vërehet te të gjitha krijesat.

Përfundimisht, kur shikojmë këtë programim te të gjitha krijesat dhe rrugën që ato ndjekin përgjatë gjithë jetës së tyre, kuptojmë se kjo e vërtetë ka një programim shumë të saktë dhe se pas saj qëndron një dorë udhëzuese shumë e fuqishme, e cila ndihmon në mbarëvajtjen e menaxhimit të programit. Dhe, kjo është një tjetër shenjë e Njëshmërisë së All'llahut.

"Në fakt, për njeriun, përveç udhëzimit që nga gjeneza, ekziston edhe një tjetër udhëzim, i cili vjen nëpërmjet të Dërguarve dhe Shpalljes. Ky lloj udhëzimi quhet udhëzim i diktuar. Është

interesant se udhëzimi i diktuar i njeriut është plotësuesi i udhëzimit të lindur të njeriut, në të gjitha fushat e tij".

I ngjashëm me këtë kuptim janë edhe ajetet 49-50 të sures "Ta Ha". Profeti Musa *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i përgjigjet pyetjes së Faraonit: **"**(Faraoni) **tha: 'E, kush është Zoti juaj, o Musa?'"**

"(Musai) **tha: 'Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.'"**.

Kuptimi i këtij fjalimi, në kohën e Profetit Musa bin Imranit apo të zbritjes së Kur'anit, ishte pjesërisht i qartë. Në ditët e sotme, me përparimin dhe zhvillimin e dijes dhe të teknologjisë, të fushës së njohjes së llojeve të ndryshme të krijesave, veçanërisht kafshët dhe bimët, ky kuptim është qartësuar.

Por, për sa i përket *"takdirit"* - *"fatit"* dhe *"hidajetit"* - *"udhëzimi i lindur"* janë shkruar me qindra e qindra libra. Ata pranojnë se ajo që ka mbetur pa u thënë akoma, është shumë e shumë më larg nga ajo që është thënë.

Në stadin tjetër flitet për bimët dhe në veçanti për ato me të cilat ushqehen kafshët: "Që bën të rriten kullotat.".

Interpretimi me fjalën *"ekhrexhe"*, që vjen nga rrënja *"ikhraxh",* tregon se të gjitha këto kanë ekzistuar në zemër të tokës dhe Zoti i ka nxjerrë jashtë ato. Natyrisht që ushqimi i kafshëve është ushqim edhe për njerëzit dhe dobia, si përfundim, kthehet te njerëzit.

Më pas shton: **"Dhe pastaj të shndërrohen, të thahen e të vyshken."**.

Fjala *"guthaen"* ka kuptimin: *bimë të thata që qëndrojnë mbi ujë*. Në ajetin që po diskutojmë, ka kuptimin: "bimë të thata që janë të vendosura mbi njëra–tjetrën".

Fjala *"ahuaa"* vjen nga rrënja *"el hautu"* dhe ka kuptimin: *ngjyrë jeshile.* Ndonjëherë ka pasur kuptimin e ngjyrës së zezë. Që të dyja këto kthehen te kuptimi i parë, sepse ngjyra jeshile e errët gjithmonë ka qenë e përafërt me ngjyrën e zezë. Ndaj dhe ky interpretim është për shkak se bimët e thata në kohën që mbivendosen, bëhen të përafërta në ngjyrë.

Përzgjedhja e këtij interpretimi shpjegon mirësitë e Zotit. Mundet të jetë edhe për shkak të këtyre tri arsyetimeve:

Së pari, kjo gjendje e bimëve tregon vdekjen e kësaj bote, e cila është përllogaritur si mësim për njerëzit. Sikurse bimët dhe pemët, në stinën e pranverës, lulëzojnë. Gjithashtu, ato, me kalimin e kohës, thahen dhe bëhen pa jetë dhe me ngjyrë të zezë. Me gjuhën e tyre, bimët janë tregues i vdekjes së kësaj bote dhe të kalimit të shpejtë të ditëve tona.

Së dyti, një tjetër veçori e bimëve të thata është se ato kalben dhe kthehen në pleh natyral, gjë që i shërben shumë tokës për të qenë sa më e fuqishme për të rritur bimët e reja.

Së treti, disa mendimtarë janë të mendimit se në këtë ajet flitet për çështjen e gjetjes së qymyrit, i cili është një burim mjaft i dobishëm energjie në rruzullin tokësor. Njeriu, në jetën e tij të përditshme dhe në industrinë e tij, e ka përdorur shumë qymyrin. Mbetjet e bimëve dhe të pemëve, të cilat janë tharë para miliona viteve, janë varrosur në tokë e me kalimin e kohës ngjyra e tyre është shndërruar në të zezë.

Gjithashtu, disa dijetarë besojnë se qymyri, zanafillën e tij e ka dyqind e pesëdhjetë milion vite më parë. Ai qëndron i varrosur në zemër të tokës. Këto vende me qymyr janë aq të shumta, saqë, nëse do të marrim parasysh përdorimin e sotëm të qymyrit në botë, do të shohim se ai u siguron njerëzve edhe katër mijë vite lënde djegëse.[1]

Sigurisht që komentimi i ajetit, veçanërisht për sa i përket mendimit për çështjen e qymyrit, duket shumë i largët, por ky ajet mund të ketë një kuptim të përgjithshëm, ku në të mund të përmblidhen të tri mendimet që u cituan. Gjithsesi, termi "*guthaen ehua*" – "*bimë të thara me ngjyrë të errët*", ka kuptime të shumta. Gjithashtu, ato bimë janë të dobishme për kafshët përgjatë dimrit. Ato janë mjet ndihmese për njeriun, si për djegie, si për pleh për tokën.

Duhet të kihet parasysh se në këto shtatë këshilla që u cituan në ajetet e mësipërme, u fol për cilësinë e Zotit, për të kontrolluar dhe për të furnizuar gjithësinë, lartësinë, Krijimin, marrëdhënien e drejtë, përcaktimin, udhëzimin, mbirjen e bimëve. Të gjitha këto, në të vërtetë, tregojnë për cilësinë e Krijuesit.

Kjo cilësi, së bashku me pesë cilësitë e fundit, janë komentuar në mënyrë të përpiktë. Studimi i këtyre cilësive bën që njeriu të njohë më së miri pozitën më të lartë të Krijuesit e në këtë mënyrë, në zemrën e tij lind drita e besimit. Kjo tregon edhe një herë, në mënyrë të përgjithshme, mirësinë më të rëndësishme të

[1] Komentimi i fundit është shkruar në librin "Kur'an ber feraz Asar", shkruar nga Ajn – Nufel, përkthyer nga Behram Pur, faqe 123.

Krijuesit. Gjithashtu, bën që ndjenja e falënderimit te njeriu të rilindë.

Hulumtim

Çështja e përcaktimit dhe e udhëzimit të përgjithshëm të krijesave, që u citua në ajetet e mësipërme, është përllogaritur ndër manifestimet e cilësive të Krijuesit. Këto janë çështje, që sado që të kalojë koha dhe dija e njerëzimit të përparojë, aq më shumë të vërteta do të gjenden në të.

Zbulimet shkencore na ndihmojnë dhe na japin mundësinë që të mendojmë ndryshe për përcaktimin dhe udhëzimin në të gjitha aspektet.

Disa komentues, duke u bazuar në shkrimet e dijetarit të njohur Kerisi Murisin, në librin "Raz Aferinesh Insan", kanë sjellë shembuj të ndryshëm, për sa i përket udhëzimit të kafshëve dhe llojeve të ndryshme të tyre, të cilat do të vijnë në vazhdim me pak ndryshim dhe plotësim.

1- Shpendët shtegtarë, ndonjëherë bëjnë në vit, qindra mijëra kilometra fluturim mbi xhungël, shkretëtirë dhe oqeane. Ata nuk e harrojnë folenë e tyre, kështu, kur kthehen nga udhëtimi, shkojnë drejt e në vatanin e tyre.

Edhe bletët që largohen nga hojet e tyre për t'u ushqyer, ose i merr era dhe i largon, kthehen përsëri saktësisht në folenë e tyre, ndërkohë që kjo gjë për njeriun është shumë më e vështirë. Ne kemi nevojë për adresë të saktë dhe shenja të sakta për t'u kthyer në vendin tonë.

2- Insektet kanë sy të vegjël, mikroskopikë, që na habisin, se si mund të shikojnë ndërtesa të larta me ato sy aq mikroskopikë.

3– Njeriu, për të gjetur rrugën e tij natën, duhet të përdorë elektrik apo mjete të tjera ndriçuese. Shumë shpendë, në terrin e natës, shikojnë pa u nevojitur ndriçues apo ndonjë mjet tjetër. Mund ta zënë prenë e tyre në errësirë. Ata janë të ndjeshëm ndaj rrezeve infra të kuqe. Njësi të tilla administrative si këto, tek disa janë lënë me besim.

4– Qentë, për shkak se kanë membranë të tepërt, mund të dallojnë nëpërmjet nuhatjes cilëndo kafshë që kalon në rrugën e tyre. Ndërkohë që njeriu, edhe me mjete, nuk është i aftë ta ketë këtë aftësi.

5– Të gjitha kafshët kanë fuqi të dëgjojnë zëra që ne nuk i dëgjojmë, pra, ne nuk kemi aftësi të tillë, edhe pse jemi përpjekur shumë, që të tilla çështje t'i zëvendësojmë me mjete shkencore. Njeriu ka arritur të dëgjojë me mjete shkencore zërin e krahëve të mizave që ndodhen me kilometra larg. Zëri dëgjohet aq afër, saqë duket sikur mizat qëndrojnë mbi vesh. Ndoshta këto dallime dhe ndryshime bëjnë që të dallohet fuqia e All'llahut dhe ndryshimi që All'llahu ka vendosur midis njerëzve dhe kafshëve. Ndaj për këtë shkak, njeriu i zëvendëson këto mangësi nëpërmjet arsyes dhe shkencës, këtë mundësi kafshët nuk e gëzojnë.

6- Në det ndodhet një lloj peshku i vogël, i cili qëndron në det për vite me radhë dhe në momentin që do të lëshojë vezët e tij për t'u shumuar, shkon në vendlindje, duke udhëtuar nga ana e kundërt e rrymës. Ai e gjen shtëpinë e lindjes së tij pas shumë vitesh që është larguar.

7- Por më e çuditshme se kaq është ngjarja e disa kafshëve nënujore, të cilat ndjekin të kundërtën e kësaj rruge.

Ajetet 6 – 13

﴿سَنُقْرِئُكَ فَلَا تَنْسَى٦ إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ إِنَّهُ يَعْلَمُ الْجَهْرَ وَمَا يَخْفَى٧ وَنُيَسِّرُكَ لِلْيُسْرَى٨ فَذَكِّرْ إِنْ نَفَعَتِ الذِّكْرَى٩ سَيَذَّكَّرُ مَنْ يَخْشَى١٠ وَيَتَجَنَّبُهَا الْأَشْقَى١١ الَّذِي يَصْلَى النَّارَ الْكُبْرَى١٢ ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى١٣﴾

“Ne do të të bëjmë ty (Muhammed) **të lexosh** (Shpalljet Tona)**, kështu që nuk ke për të harruar.”**

“Përveç asaj që do All’llahu. Vërtet, Ai e di të dukshmen dhe çka është e fshehtë.”

“Do të ta lehtësojmë ty Rrugën e Drejtë.”

“Prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme!”

“Asaj do t’ia vërë veshin ai që (i) **frikësohet** (All’llahut)**.”**

“E do t’i shmanget vetëm më i keqi.”

“I cili do të digjet në zjarrin e madh.”

“Ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë.”

Komentimi

Suksesi hyjnor

Në ajetet e mësipërme u fol për sundimin dhe Njëshmërinë e All'llahut. Në vazhdim të tyre do të flasim për Kur'anin dhe profetësinë e Profetit Muhammed*(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Më lart, gjithashtu, u fol për udhëzimin në përgjithësi të krijesave, ndërsa në ajetet në vazhdim do të flasim për udhëzimin e njeriut.

Në ajetet e mësipërme ne pamë lavdërimin e All'llahut të Madhëruar, ndërsa në këto ajete flitet për Kur'anin që është shpjeguesi i këtyre ajeteve.

"Ne do të të bëjmë ty (Muhammed) **të lexosh** (Shpalljet Tona)**, kështu që nuk ke për të harruar."**.

Pra, në kohën e Shpalljes së mesazhit, mos u nxito, mos u tremb kurrë, se do të harrosh atë çka të kemi Shpallur. Sepse Ai që i ka zbritur këto ajete, për të të udhëzuar dhe për të të drejtuar në Rrugë të Drejtë, është Vetë mbrojtësi i tyre.

Hartën e këtyre ajeteve Ai e ka ruajtur në mënyrë të qëndrueshme në zemrën tënde të pastër. Ato janë ruajtur në atë mënyrë, që në to të mos bjerë kurrë pluhuri i harresës.

I ngjashëm me këtë ajet është edhe ajeti 114 i sures "Ta Ha": **"I Lartësuar qoftë All'llahu, Sunduesi i Vërtetë! Mos nxito për ta**

lexuar Kur'anin para se të përfundojë Shpallja e tij dhe thuaj: 'O Zoti im, shtoma dijeninë!'".[1]

Ndërsa në ajetet 16-17 të sures "El Kijâme" lexojmë: **"Mos nxito (o Muhammed) në leximin e Kur'anit me gjuhën tënde![2] Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë.".**

Më tej, për të vërtetuar fuqinë e All'llahut dhe se çdo mirësi dhe bekim vjen nga All'llahu, se Ai njeh të shfaqurën dhe të fshehtën, thotë se ti nuk do të harrosh asgjë prej ajeteve hyjnore, **"Përveç asaj që do All'llahu. Vërtet, Ai e di të dukshmen dhe çka është e fshehtë."**.

Ne do të të bëjmë ty Muhammed të lexosh Shpalljet Tona, kështu që nuk ke për të harruar, përveç asaj që do All'llahu. Vërtet, Ai e di të dukshmen dhe çka është e fshehtë.

Ky interpretim nuk tregon se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të harronte diçka prej ajeteve hyjnore, por qëllimi është të tregojë një të vërtetë, që është ruajtja e ajeteve hyjnore, e cila është në dorën e All'llahut. Ndaj All'llahu mund t'i marrë ato nga Profeti i Tij në çdo moment.

---

[1] Zoti ka urdhëruar kërkimin dhe përvetësimin e diturisë, sepse dituria është një det i pafund. Ai na ka këshilluar ta marrim diturinë në baza të shëndosha dhe na ka dërguar Profetë, për të na dhënë dituri të saktë e të qartë. Gjithashtu, Ai na ka këshilluar që të mos flasim pa argumente dhe pa baza të shëndosha. Andaj, dituria me hamendje nuk mund të pranohet. (përkthyesi).

[2] Në fillimet e Shpalljes Hyjnore, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte shumë i shqetësuar se nuk do të mbante dot mend atë që i përcillte Xhebraili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Për këtë arsye, ai nxitonte të recitonte menjëherë pas tij pjesët e shpallura, duke humbur përqendrimin për pjesët që do t'i shpalleshin akoma.

Me fjalë të tjera: Qëllimi është të tregojë ndryshimin e dijes së Qenësishme të All'llahut dhe dijes së dhuruar të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin 108 të sures "Hud" për përjetësinë e Xhennetit: **"Kurse fatlumët, do të hyjnë në Xhennet, ku do të qëndrojnë përherë, derisa të jenë qiejt dhe Toka, veç si të dojë Zoti yt. Kjo është dhuratë e pandërprerë."**.

Padyshim që, xhennetlinjtë kurrë nuk dalin nga Xhenneti. Vazhdimi i ajetit është dëshmitar i kësaj çështje. Prandaj fjalia: ..."**veç si të dojë Zoti yt"...** flet për fuqinë e All'llahut dhe lidhjen e të gjitha gjërave me dëshirën dhe vullnetin e Tij, si në fillim të shfaqjes, pra, të krijimit, ashtu edhe në mbijetesë.

Për shembull, ato çka e dëshmojnë këtë gjë, janë disa dukuri apo çështje që u ndodhin të gjithë njerëzve. E ato janë harresat që i bëjnë njerëzit. Ky rezultat nuk është privilegj që All'llahu e jep si rezultat i dashurisë apo si dhuratë për Profetin e Tij, por, në këtë rast, ai shpjegon se ka për qëllim ruajtjen e të gjithë ajeteve kur'anore, të legjislacionit e të njohurive islame.

Disa janë të mendimit se qëllimi për këtë përjashtim është për ajetet, ku edhe përmbajtja, edhe leximi i tyre është shfuqizuar.[1]

[1] Për sa i përket shpjegimit se disa ajete kur'anore, pasi shpjegonin në mënyrë të shkurtuar dispozitat dhe ato ishin të detyruara për myslimanët, ndodhte që ndonjëherë ai urdhër, pas përfundimit të periudhës së përcaktuar, shfuqizohej. Por vetë ajeti dhe të lexuarit të tij nuk shfuqizohet. Ndonjëherë ndodh që edhe urdhri, edhe të recituarit shfuqizohen, pra, nuk llogaritet si pjesë e Kur'anit.

Ky komentim duket i pamundur. Parimisht, ekzistenca e ajeteve të tilla është e paqëndrueshme. Komentues të tjerë kanë dhënë mendimin se përjashtimi mund të jetë për shkak të të lexuarit, prandaj edhe kuptimi i ajetit mund të jetë i tillë: Ne do të lexojmë për ty, për të të shpjeguar ajetet tona. A mos ndoshta ajetet që All'llahu i ka përcaktuar me vullnetin e Tij, dëshiron që të mbeten të fshehta? Ky komentim, edhe duke u bazuar në stilin e ajetit, duket i pamundur për t'u konceptuar në këtë mënyrë.

Fjalia: "*përveç asaj që do Allahu. Vërtet, Ai e di të dukshmen dhe çka është e fshehtë*", shpjegon shkakun e çështjes që u trajtua në fjalinë *(Ne do të të bëjmë ty (Muhamed) të lexosh (Shpalljet Tona),kështu që nuk ke për të harruar),* ku trajtonte faktin që All'llahu i Madhëruar është në dijeni të asaj që është e shfaqur dhe e fshehur. Ajo çka i nevojitet njeriut tani dhe ajo çka do t'i nevojitet më vonë, është qartësuar nëpërmjet Shpalljes dhe në këtë fushë nuk do të jetë pakujdesi.

Gjithashtu, ekziston edhe një tjetër mundësi, që ka si qëllim të tregojë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të mos nxitojë, kur merr Shpalljen dhe të mos frikësohet se mos ndoshta do të harrojë ndonjë frazë nga ajo që i Shpallet, sepse All'llahu është në dijeni të asaj që është e shfaqur dhe të asaj që është e fshehtë dhe ka premtuar që ai të mos harrojë asgjë.

Sidoqoftë, kjo është një nga mrekullitë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të gjitha ajetet dhe suret i memorizonte vetëm me një herë të lexuar nga ana e Xhebrailit. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk harronte asgjë nga ajo që i Shpallej.

Më pas, e nxit Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke i thënë se do të të japim sukses në kryerjen e punëve të mira dhe do të t'i lehtësojmë punët.**"Do të ta lehtësojmë ty Rrugën e Drejtë."**.

Me fjalë të tjera, qëllimi, në këtë rast, është shprehja e kësaj të vërtete, që në rrugën që ti do të ndjekësh, do të hasësh plot vështirësi dhe probleme, si në rrugën e marrjes së Shpalljes dhe të memorizimit, ashtu edhe në propagandimin dhe vazhdimësinë e saj. Vështirësi do të kesh edhe në kryerjen e punëve dhe të veprave të mira, ndaj Ne do të të jemi pranë, për të t'i zgjidhur këto probleme e vështirësi, që ato të bëhen sa më të lehta.

Kjo fjali, ndoshta ka për qëllim të tregojë përmbajtjen e ftesës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe detyrat dhe programet Hyjnore, që do të thotë se përmbajtja e saj është e lehtë dhe Sheriati është i lehtë. Gjithashtu, tregon se në këtë ajet, detyrat nuk janë të rënda.Për këtë arsye, ajeti i mësipërm ka një kuptim shumë më të zgjeruar, edhe pse disa komentues e kanë kufizuar atë.Ndaj, nëse nuk do të ishte vullneti Hyjnor për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ai do ta kishte shumë të vështirë, që t'ia dilte mbanë, të fitonte ndaj vështirësive.

Vetë jeta e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është një shembull i plotë e i qartë për të mësuar këtë të vërtetë. Ai kurrë nuk ka qenë i ashpër në asnjë çështje, si të bëhej fjalë për rrobat, ngrënien, mjetet e jetesës etj. Ai ushqehej me çfarëdolloj ushqimi që ishte i përshtatshëm, vishej thjesht, ulej kudo, edhe në rërë të shkretëtirës. Ai ishte i lirë prej çfarëdolloj përkatësie dhe angazhimi.

Pasi shpjegohet dhurata qiellore e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe premtimi i suksesit dhe lehtësimi i çështjeve të tij, citohet detyra më e rëndësishme: **"Prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme!"**.

Disa komentues janë të mendimit se, në këtë rast, qëllimi për të këshilluar është i vlefshëm në çdo rast. Ata që nuk përfitojnë nga këshillimi, janë të paktë, ose të paktën mesazhi për mohuesit përçohet deri në fund. Kjo gjë, në vetvete, është një përfitim i madh.[1]

Ndërkohë që ka prej atyre që besojnë se ajeti nënkupton këshillimin, si të jetë i dobishëm, si të mos jetë. Pra, ka dijetarë që mendojnë se ajeti ka ngjashmëri me ajetin 81 të sures "En Nahl": **"...ka bërë për ju rroba që t'ju mbrojnë nga nxehtësia..."**.

All'llahu i Madhëruar ka vendosur për ju veshje që t'ju mbrojnë nga i nxehti dhe i ftohti. Në këtë ajet është cituar vetëm fjala e (nxehtë), ndërkohë që fjala (ftohtë) nënkuptohet si marrëveshje simetrie.

Por përsëri, disa komentues këmbëngulin se, në këtë rast, fjalia kushtore ka kuptim. Dhe, kuptimi e qëllimi i fjalisë është këshillimi aty ku mendohet se këshilla është e dobishme, pra, ka

[1] Në ajetin kur'anor thuhet: **"Për ta është njësoj si t'i këshillosh e si të mos i këshillosh."**. Sure "El Bekare", ajeti 6.
Në përgjithësi, këshillimi është i dobishëm, pra, duam apo nuk duam ne. Nëse do të këshillojmë, këshilla do të zërë vend. Te disa, ndikimi do të jetë më i madh, kurse te disa të tjerë, më i dobët. Gjithsesi, atyre që nuk u bën dobi këshilla, janë të paktë, sepse, në përgjithësi, fjalët e menduara mirë zënë vend, për këtë arsye, fjalia kushtore në këtë rast, është kryesore.

vlerë, ndërsa në rastet ku shikohet se këshilla nuk ka dobi, nuk është e nevojshme të këshillohet. Po ashtu një tjetër mundësi është dhënë për termin *"inne"*, sepse mendohet se ky term, në këtë rast, nuk tregon kushtin në fjali, por ka kuptimin e fjalës *"kad"*, e cila është cituar për të vërtetuar dhe për të përforcuar. Ndaj kuptimi i fjalisë është i tillë: Këshillo, se këshilla është e dobishme.

Ndërmjet këtyre katër komentimeve, komentimi i parë, sipas nesh, është më i përshtatshëm.

Këtë gjë e dëshmon edhe veprimtaria e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai, në propagandën dhe këshillat që bënte, nuk vinte kushte. Predikonte për të gjithë dhe i këshillonte të gjithë.

Në ajetin e ardhshëm do të shikojmë reagimin e njerëzve që janë këshilluar. Ata i ndajmë në dy grupe. Shumë shpejt ata që frikësohen nga All'llahu dhe e ndiejnë në vetvete ndjenjën e përgjegjësisë, e pranojnë këshillën.

Ajeti thotë: **"Asaj do t'ia vërë veshin ai që** (i) **frikësohet** (All'llahut)**."**.

Është e vërtetë se për sa kohë që në qenien e njeriut të mos ekzistojë shpirti i frikësuar dhe kërkues i së vërtetës, sigurisht që nuk do të dojë të këshillohet, apo këshillat hyjnore të Profetëve të kenë për të dobi. Për këtë arsye, në fillim të sures "El Bekare", All'llahu thotë se Kur'ani është burim udhëzimi për njerëzit që janë punë mirë.

Në ajetin më pas flitet për grupin e dytë, për fatkeqit: **"Do t'i shmanget vetëm më i keqi."** Në disa transmetime thuhet se Ibn

Abasi ka thënë se ajeti 10 i sures "El Al'â": **"Asaj do t'ia vërë veshin ai që** (i) **frikësohet** (All'llahut)**."**, ka zbritur për Abdullah bin umi Mektumin. Ky burrë ishte zemërpastër, kërkues i së vërtetës, edhe pse ishte i verbër.[1]

Disa komentues janë të mendimit se ajeti 11 i sures "El Al'â": **"E do t'i shmanget vetëm më i keqi."** ka zbritur për Velid bin Mugheire dhe Utbe bin Rebijen, të cilët ishin kryetarëve të shirkut dhe të mosbesimit.[2]

Disa janë të mendimit se qëllimi i fjalës *"eshka"*, në këtë rast, është për armiqtë e të vërtetës, sepse njerëzit janë të ndarë në tri grupe, një grup është i urtë, mistik dhe i informuar, një grup tjetër është i ndaluar dhe grupi i tretë është kokëfortë dhe armik. Është e natyrshme që grupi i parë dhe i dytë mund të përfitojnë prej këshillës, ndërsa grupi i tretë është ai grup që nuk merr asnjë përfitim nga këshilla. E vetmja gjë që mund të ndikojë te ky grup është vetëm përçimi dhe plotësimi i argumentit.

Gjithashtu, nga ky ajet kuptohet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* edhe grupin e tretë e ka subjekt të këshillës, por ata largohen dhe fytyrat i kthejnë anash. Është për t'u theksuar fakti se në këto dy ajete, vështirësitë janë vendosur si kundërpesha e frikës, ndërkohë që, sipas rregullit, duhet të vendoset përballë lumturisë. Kjo gjë ndodh sepse rrënja kryesore e lumturisë dhe e frikës është njeriu, pra, njeriu ndihet përgjegjës dhe i frikësuar.

---

[1] Tefsiri i "Kurtubiut", vëll. 10, f. 7110; vëll. 20, f. 20.

[2] Tefsiri i Kurtubiut, vëll. 10, f. 7110; vëll. 20, f. 20; Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 243, në vazhdim të ajetit që diskutuam.

Në ajetin në vazhdim, fati i grupit të tretë shpjegohet në këtë mënyrë: Ata do të digjen në zjarrin e madh: **"Do të digjet në zjarrin e madh, ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë."**.

Ata do të qëndrojnë në zjarr përgjithmonë, nuk vdesin dhe as nuk ringjallen, sepse gjendja ku ndodhen është vazhdimisht midis vdekjes dhe jetës, kjo gjendje për ta është një bela e madhe.

Disa komentues kanë thënë se togfjalëshi: *"el narul kubra"* - *"zjarr i madh"*, ka për qëllim të tregojë kategorinë dhe katin më të ulët të Xhehennemit dhe *"esfelul safilijn"*. Kjo kategori është më e ulët, sepse ata janë më mizorët dhe armiqtë më të këqij, ndaj dhe dënimi i tyre duhet të jetë më i vështiri dhe më i tmerrshmi.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se përshkrimi i këtij zjarri me fjalën *"kubra"* –*"i madh"*, kundrejt zjarrit *"sugra"* – *"të vogël"*, ka për qëllim zjarret e kësaj bote.

Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ky zjarr është pjesë e shtatëdhjetë zjarreve të Xhehennemit, që është shuar shtatëdhjetë herë me ujë dhe përsëri është ndezur. Nëse nuk do të ishte kështu, asnjë njeri nuk do të kishte fuqinë për ta duruar, e as që do të mundej t'i qëndronte në anë."*.[1]

Në lutjen e njohur (Kumeil), të thënë nga Prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, kur flitet për krahasimin e zjarrit të kësaj bote me atë të Ahiretit lexojmë: "Këto janë pësime e gjëra të padëshiruara, që kalojnë në pak kohë. Përballohen me lehtësi dhe brenda një afati shumë të shkurtër".

[1] "Biharul Enuar", vëll. 8, Hadithi 21, f. 288.

Ajetet 14 – 19

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى١٤ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى١٥ بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا١٦ وَالْآخِرَةُ خَيْرٌ وَأَبْقَى١٧ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى١٨ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى١٩﴾

“I shpëtuar është ai që pastrohet.”

“Që e përmend Emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!”

“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote.”

“Ndonëse Jeta Tjetër është më e mirë dhe e amshuar.”

“Kjo, me të vërtetë, ndodhet në Fletët e lashta.”

“Në Fletët e Ibrahimit dhe Musait.”

Komentimi

Programet që kanë ardhur në të gjitha librat qiellorë

Në ajetet e para u fol për dënimin e vështirë të jobesimtarëve kokëfortë dhe të armiqëve të së vërtetës, ndërsa në këto ajete, do të diskutojmë për shpëtimin e besimtarëve.

Ajeti 14 thotë se ai që pastrohet, do të jetë i shpëtuar: **"I shpëtuar është ai që pastrohet."**.

Jo vetëm kaq, por që përkujton Emrin e All'llahut e pas përkujtimit të Emrit të All'llahut, fal namaz: **"Që e përmend Emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!"**.

Sipas këtij rendi, vepra e mirë, pastërtia dhe shpëtimi vijnë në fillim e më pas vjen namazi. Pra, së pari duhet të pastrohemi, të përmendim Emrin e All'llahut e më pas të falim namazin.

Ndërsa për sa i përket qëllimit të pastrimit, ka pasur mendime të ndryshme nga komentuesit. Së pari, është thënë se me fjala *"pastërti"* nënkupton pastrimin e shpirtit nga shirku, pra, i vendosin shok All'llahut.

Një tjetër mendim është se fjala *"pastërti"* ka për qëllim kryerjen e punëve të mira dhe pastërtinë e zemrës nga të ligat dhe nga morali i keq.

Në mënyrë simetrike, ajetet që renditen si shpëtim në Kur'anin e Shenjtë, si për shembull ajeti që është në fillim të sures"El Muminûn",shpëtimin e rendit në grupin e punëmirëve.

Po ashtu, sipas simetrisë së ajetit 9 të sures "EshShems", pas citimit të çështjes së devotshmërisë dhe imoralitetit thotë se i shpëtuar është ai që shpirtin e tij e ka pastruar nga imoraliteti dhe punët e këqija, e i ka hapur krahët bukurisë së devotshmërisë: **"Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë."** Një tjetër mendim është se me fjalën pastërti ka përqëllim "Zekatin i Fitrit"që ka të bëjë me ditën e Fitër Bajramit, që në fillim duhet të jepet zekati i Fitër Bajramit e më pas të falet namazi i Bajramit. Ndërsa ky kuptim është transmetuar në disa transmetime nga Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*[1] I njëjti kuptim është cituar edhe në burimet e Ehli Sunetit, nga Emirul Mu'minijn Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[2] Në këtë rast lind pyetja: Si ka mundësi që surja "El A'lâ" është sure mekase dhe në Mekë nuk ishte caktuar as zekati i Fitër Bajramit, as agjërimi dhe as nuk ishte organizuar programi i faljes së Fitër Bajramit?

Disa i janë përgjigjur se nuk ka asnjë pengesë për këtë çështje, sepse fillimi i kësaj sureje është shpallur në Mekë dhe fundi i saj është në Medine.

Komentimi i mësipërm tregon me qartësi të vërtetën dhe përshkrimi i ajetit është i qartë për njeriun. Disa komentues të Kur'anit, janë të mendimit se fjala *"tezkije"*, në këtë rast, ka kuptimin e dhënies së sadakasë së mallit. Por e rëndësishme është se fjala *"tezkije"* ka kuptim të gjerë, ku përfshin: pastërtinë e shpirtit nga shirku, pastërtinë e moralit nga veset, pastërtinë e veprave nga gjërat e ndaluara dhe nga çfarëdolloj hipokrizie, pastërtinë e mallit, të shpirtit, duke dhënë zekatin në Rrugë të All'llahut, sepse sipas

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 556, Hadithi 19 – 20.
[2] Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 740.

ajetit 103 të sures "Et Teube" dhënia e zekatit është shkak për të pastruar shpirtin: **"Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. All'llahu dëgjon dhe di gjithçka."**.[1]

Prandaj është e mundur që të gjithë komentimet të jenë përmbledhur në një kuptim.

Është për t'u theksuar fakti se në ajetin e mësipërm, së pari, është folur për pastërtinë, më pas është folur për adhurimin e All'llahut dhe në fund për faljen e namazit.

Sipas mendimit të disa komentuesve, nivelet e veprave të detyruara janë tri:

Së pari, ai duhet të pastrojë zemrën nga besimi i ndyrë, më pas, në zemrën e tij duhet të jetë e pranishme dija e All'llahut, cilësitë dhe Emrat e Tij, së treti, vënia në punë e aftësive për të shërbyer. Ajetet e lartpërmendura, në tre fjali të shkurtra, cituan këto tri nivele.[2] Është për t'u vënë re se *"namazi"* numërohet si tek dhe detyrim për adhurimin e All'llahut, e kjo për shkak se për sa kohë nuk e kujtojmë Krijuesin, nuk do të kujtojmë të falim namazin. Namazi është i vlefshëm kur falet së bashku me përkujtimin e All'llahut. Disa, adhurimin e All'llahut, e kanë komentuar vetëm me përmendjen e shprehjeve: "All'llahu Ekber" dhe "Bismilahir Rrahmanir Rrahim", të cilat citohen në fillim të faljes së namazit, që në të vërtetë janë shpjeguese. Më tej flitet për veprat e devijuara nga programi i shpëtimit: **"Por ju, përkundrazi,**

[1] Sure "Et Teube", ajeti 103.
[2] Tefsiri "Fakhri Rrazij", vëll. 31, f. 147.

më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse Jeta Tjetër është më e mirë dhe e amshuar.".

Këto ajete tregojnë atë çka është transmetuar në hadithin*"Dashuria për këtë botë është burim i çdo gjynahu."*.[1]

Ndërkohë që asnjë mendje racionale nuk lejon që njeriu të ndërrojë apo të shesë jetën e tij të përhershme me atë kalimtaren, sepse jeta kalimtare ka kënaqësi që përfundojnë, janë të shkurtra e të mbushura me lloje të ndryshme dhimbjesh e mundimesh, ndërkohë që jeta e përhershme nuk i ka këto vështirësi dhe mundime.

Në përfundim të sures thuhet se këto rregulla dhe urdhra që u thanë, nuk janë të përfshira vetëm në këtë libër qiellor, por janë thënë edhe më parë në fletushkat e në librat e Profetëve të mëparshëm: **"Kjo, me të vërtetë, ndodhet në Fletët e lashta, në Fletët e Ibrahimit dhe Musait."**.[2]

Disa komentues janë të mendimit se flitet për urdhrat që janë dhënë kohët e fundit në fushën e pastërtisë shpirtërore, namazit, si dhe të pasurit parësor Ahiretin dhe jo jetën e kësaj bote. Këto janë mësime, urdhra dhe rregulla që janë përcjellë për

[1] Ky hadith është transmetuar jo vetëm nga Profetët, por edhe nga Imam Sadiku dhe Imam Saxhad Ali ibn Husejni *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*. Ky është argument për rëndësinë e jashtëzakonshme që ka ky transmetim. (Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 556 - 557)

[2] Ndoshta fjalia: **"Suhufi Ibrahime ue Musa" - "Fletët e Ibrahimit dhe Musait."**, është shpjegim për *"El Suhufi Ula"*, sepse është e mundur që shpjegimi dhe qëllimi i qartë i saj, në radhë të parë, të përfshijë të gjithë librat e Profetëve të mëparshëm, ndërsa, në rastin e dytë, përfshin vetëm *Suhufin e Ibrahimit dhe të Musai (Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*.

njerëzimin, nga të gjithë Profetët *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* në librat e tyre qiellorë.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se flitet për të gjithë suren dhe jo për disa ajete, sepse gjithçka nis nga njëshmëria e All'llahut, vazhdon me Profetët dhe përfundon duke i vënë në veprim programet e All'llahut.

Sido që të jetë, ky interpretim tregon se kjo sure ka një përmbajtje shumë të rëndësishme, ku në ajetet e fundit flitet për parimet më kryesore të botës së kulteve, si dhe mësimet që na ofrojnë të gjithë Profetët. Kjo tregon madhështinë dhe rëndësinë e mësimeve, që mbart në vetvete kjo sure. Fjala "*suhuf*" është shumësi i fjalës "*sehife*", që, në këtë rast, ka kuptimin e fletës që shkruhet mbi të. Ajetet e mësipërme tregojnë se Profeti Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe Profeti Musa *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* kanë pasur libra qiellorë.

Në një transmetim të Ebu Dherrit lexojmë: "E pyeta Profetin e nderuar se sa vetë kanë qenë Enbija".

- *Njëqind e njëzet e katër mijë persona,* - tha ai.

- Po të Dërguar, sa vetë kanë qenë?- e pyeta.

- *Treqind e trembëdhjetë dhe të tjerët kanë qenë Nebi,* - m'u përgjigj.

- Ademi, ishte Nebi? - e pyeta sërish.

- *Po, All'llahu foli me të dhe e krijoi atë me dorën e Tij,* - tha.

Më pas, Profeti i nderuar shtoi: "*O Ebu Dherr! Katër vetë prej Enbijave ishin arabë: Hudi, Salihi, Shuajbi dhe Profeti yt*".

- O i Dërguari i All'llahut! Sa libra ka zbritur All'llahu? - i thashë:

- Njëqind e katër libra, dhjetë libra për Ademin, pesëdhjetë libra për Shitin, tridhjetë libra për Idrizin. Ky është i pari person që ka shkruar me laps. Për Ibrahimin dhjetë libra. Ka dërguar: Teuratin për Musain, Zeburin për Daudin,Inxhilin për Isain dhe dhe Furkanin (Kur'anin) për Profetin e Islamit, tha Profeti i nderuar.[1] Fjala "El Suhufi Ula" përfshin librat e Ibrahimit dhe të Musait, fletët e fundit që iu shpallën Profetit Isa dhe Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Hulumtim

Sigurisht që shqyrtimi i hadithit për personat besimtarë, për sa i përket përllogaritjes kur'anore, që është cituar në ajetet e mësipërme dhe që krahason jetën e kësaj bote me atë të Botës së Përtejme, që thotë se Ahireti është më i mirë dhe më i qëndrueshëm, është shumë i qartë, megjithatë, si mundet një njeri besimtar ta ndyjë veten e tij në mëkate dhe të lëre pas dore dijen e tij?!

Përgjigjja e kësaj pyetje është një fjali: Mbizotërimi i epsheve në qenien e njeriut. Burimi i mbizotërimit të epsheve, është dashuria për këtë botë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 476.

Dashuria për këtë botë përfshin dashurinë, për: materializmin, pozitën, epshin fizik, superioritet, përparësinë, zhvillimin e trupit, hakmarrjen e të tjera si këto. Ndonjëherë, në shpirtin e njeriut zhvillohet një tufan që i fluturon tutje të gjitha ato çka di ai.

Ndonjëherë, edhe perceptimi e largon atë nga vetja dhe, si përfundim, del më parësore jeta e kësaj bote se sa Jeta e Përhershme e Ahiretit.

Transmetimet islame gjithnjë e kanë konsideruar si burim të mëkatit dashurinë për këtë botë, e cila është një e vërtetë e prekshme, që është hasur dhe është provuar në jetët tona.

Prandaj, për të prerë rrënjën e mëkatit, nuk ka tjetër rrugë përveçse të largojmë nga zemra dashurinë për këtë botë. Këtë botë duhet ta konsiderojmë si mjet kalimtar, si urë, apo si vresht.

Është e pamundur që të dashuruarit me këtë botë të mund të zgjedhin kënaqësinë e Zotit, nëse gjenden në mes dy rrugësh, pra, nëse u thua kë keni parësore, pasurinë dhe kënaqësitë e kësaj bote apo kënaqësinë e Zotit, ata nuk do të mund ta vendosin si parësore të dytën.

Nëse shikojmë me kujdes dosjet e krimeve, do të kuptojmë më së miri të vërtetën e asaj sa u tha më sipër.

Këtë gjë e vërejmë edhe në grindjet dhe vrasjet midis vëllezërish, shokëve, fqinjëve dhe vendeve, etj. Tek të gjithë, shkak është dashuria për këtë botë.

Por si mund ta largojmë ne nga zemra dashurinë për këtë botë, duke qenë se të gjithë ne jemi bijë të kësaj bote dhe dashuria e fëmijës për nënën është një gjë e natyrshme?!

Këtu lind nevoja për të ushtruar mendjen, kulturën e besimit e më pas edukimin e shpirtit e të egos tonë.

Ndër çështjet që mund të na japin ndihmesën më të madhe në këtë rrugë, është shqyrtimi i përfundimit të punëve që kryejnë adhuruesit e kësaj bote.

Faraonët çfarë fundi patën, pavarësisht pushtetit dhe mundësive materiale që kishin.

Karuni, me gjithë thesaret e tij dhe me gjithë ato çelësa e burra të fuqishëm që mbante me vete, çfarë mori me vete?

Gjithashtu, fuqitë e mëdha që ne i shikojmë me sytë tanë në ditët e sotme, jeta e tyre, përdhoset me një zyrë dhe me rrotullimin apo po me xhiron e natës e të ditës, ata zbresin nga karrigia e pushtetit. Kështjellat dhe pasuritë e tyre kalohen te të tjerët, ose zhduken nën dhé. Të gjitha këto janë mësim për ne.

Këtë fjalim do ta përfundojmë me një hadith të Imam Ali ibn Husejnit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Kur e pyetën Imam Ali ibn Husejnin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se cila është vepra më e mirë te Zoti, ai tha: *"Nuk ka vepër më të mirë, pas njohjes së All'llahut dhe Profetit të Tij, se sa armiqësia me këtë botë."*.

Më pas vazhdoi: "Ka pikëpyetje të shumta, për sa i përket dashurisë së kësaj bote, po ashtu edhe mekati ka shumë degë, sepse, e para gjë që çoi në mëkat, ishte mendjemadhësia e Iblisit. Ai u bë qafir për këtë shkak.

Tjetër burim i mëkatit është smira, ajo bëri që Profeti Adem dhe Havaja të largohen nga Xhenneti. Në atë kohë, All'llahu i Madhëruar e urdhëroi Ademin dhe Havanë të hanë çdo gjë të Xhennetit, përveç një peme. Nëse i afroheshin, do të konsideroheshin punëkëqij. Ata vajtën pranë një gjëje për të cilën nuk kishin nevojë të shkonin. Kjo gjë bëri që fëmijët e tyre ta vuajnë dënimin deri në Ditën e Kiametit. Ky është një mësim për ata që racionalizojnë, sepse, normalisht, njeriu kërkon gjëra për të cilat nuk ka nevojë. Përgjithësisht, nevoja nuk është shkak apo pikënisja e mëkatit, por ajo që bëhet shkak apo pikënisje e mëkatit janë dëshirat dhe çështjet që i bashkëngjiten dëshirave.

Më pas ishte smira ajo që u bë shkak i mëkatit te fëmijët e Ademit e të Havasë. Djali i tij u bë xheloz për vëllanë dhe e vrau atë.

Gjithashtu, ka plot degë të tjera të xhelozisë, si: kënaqësia për gratë, kënaqësia për dynjanë[1], kënaqësia për të udhëhequr, kënaqësia për rehati, kënaqësia për të folur, kënaqësia për të qenë më i miri, kënaqësia për pasuri etj. Këto janë shtatë cilësi që janë të përfshira te kënaqësitë e kësaj bote. Ndaj edhe Profetët, edhe

[1] Mendohet se në këtë rast, qëllimi për dashurinë e kësaj bote ka të bëjë me dashurinë e përjetësisës, gjë e cila konsiderohet si një nga shtatë degët e dashurisë së kësaj bote, zakonisht këto shfaqen në mënyrë të hapur tek (vazhdimësia e veprës).

dijetarët, pasi u njohën me këtë të vërtetë, thanë: *'Dashuria për këtë botë është shkaku dhe kreu i gjithë ligësive'"*.[1]

O All'llah, largoje nga zemrat tona kënaqësinë e kësaj bote, sepse ajo është rrënja e mëkatit!

O All'llah! Na udhëzo dhe na mbaj dorën në këto rrugë plot me kthesa! Na udhëzo drejt përsosmërisë dhe na dërgo drejt rrugës së udhëzimit!

O All'llah! Ti je në dijeni të së dukshmes dhe të së fshehtës, na i fal mëkatet tona me mëshirën Tënde!

Aminin! Ja Rabil Alemin.

Fundi i Sures "El A'lâ".

[1] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 2, K. "Hubul Dun'ja uel Heres alejha", Hadithi 8. Gjithashtu, nga ky kapitull, janë cituar 17 transmetime të tjera të po kësaj fushe, të cilat janë mësimdhënëse.

Sure "El Gâshije"

Zbritur në Mekë

Ajete 26

Përmbajtja e sures “El Gâshije”

Kjo është nga suret mekase dhe trajton tri çështje:

Së pari, surja trajton çështjen e Ringjalljes, e në veçanti flet për dënimet e dhimbshme të kriminelëve, si dhe për shpërblimet e besimtarëve.

Në diskutimin e dytë të sures, flitet për Teuhidin, njëshmërinë e All’llahut. Njëshmëria është cituar duke u sjellë në mend njerëzve tri çështje shumë misterioze, sikurse është krijimi i qiejve, krijimi i maleve dhe i tokës.

Boshti i tretë i sures flet për çështjen e profetësisë, si dhe një pjesë të detyrimeve të Profetit të Islamit. Në përgjithësi flet për qëllimet e sureve mekase, të cilat, që në themelet e tyre, flasin për forcimin e besimit.

Mirësitë e leximit të sures "El Gâshije"

Për sa u përket mirësive të leximit të kësaj sureje, në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Çdokush që e lexon këtë sure, llogaria do t'i bëhet e lehtë në Ditën e Kiametit nga ana e All'llahut.*".[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Ai që e lexon këtë sure në namazet e detyruara dhe ato nafile, All'llahu, atë njeri, do ta vendosë nën mbrojtjen e Tij në këtë botë, kurse në Botën Tjetër do ta ruajë nga dënimi i zjarrit.*".[2]

Sigurisht që këto mirësi përftohen kur njeriu e lexon suren, duke e ndier atë dhe duke pasur dëshirën për t'i vënë në zbatim ato që lexon.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 477.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 477.

Ajetet 1 - 7

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ١ وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ خَاشِعَةٌ٢ عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ٣ تَصْلَى نَارًا حَامِيَةً٤ تُسْقَى مِنْ عَيْنٍ آنِيَةٍ٥ لَيْسَ لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِنْ ضَرِيعٍ٦ لَا يُسْمِنُ وَلَا يُغْنِي مِنْ جُوعٍ٧﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse (Kiametin)**?"**

"Atë Ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish."

"Që kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë)**."**

"Ata do të digjen në zjarr të nxehtë."

"E do të pinë nga burime të valuara."

"Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese."

"Të cilat as nuk do t'i mbajnë, as nuk do t'ua shuajn urinë."

Komentimi

Të lodhurit e humbur!

Në fillim të kësaj sureje hasim me një emër të ri, për sa i përket Kiametit, që është "Gashieh": "**A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse** (Kiametin)**?"**.

Fjala *"el gashijetu"* vjen nga rrënja e fjalës *"el gishauetu"*, që ka kuptimin "*mbulesë*". Përzgjedhja e kësaj fjale, për të identifikuar Kiametin, është bërë, sepse ngjarjet e tmerrshme të asaj dite do të mbulojnë papritur gjithçka, pra, do i vendos njerëzit papritur nën mbulojën e tij.

Disa komentues janë të mendimit se është quajtur *"el gishauetu"*, sepse në atë ditë, të gjitha krijesat do të mblidhen, për të dhënë llogari, nga i pari deri tek i fundit.

Disa të tjerë janë të mendimit se kjo fjalë ka për qëllim zjarrin që do të mbulojë fytyrat e kriminelëve dhe të jobesimtarëve.

Mendohet se komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Në paraqitje të jashtme, ky ajet i referohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Citimi i fjalisë në mënyrë pyetëse për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është për të treguar madhështinë dhe rëndësinë e asaj dite, sikurse është Kiameti.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se në këtë ajet kur'anor, All'llahu i Madhëruar u është drejtuar të gjithë njerëzve. Ky kuptim duket i papranueshëm.

Pasi flet për fjalën *"el gashijetu"*, flet për gjendjen e kriminelëve, duke treguar se si janë katandisur fytyrat e tyre në atë ditë: **"Atë Ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish."**.

Poshtërimi dhe frika nga dënimi i madh, atë ditë, do të përfshijë të gjithë qenien e tyre. Gjendja e tyre, më shumë se në çdo vend tjetër të trupit, shfaqet në fytyrat e tyre. Aty shikohet poshtërimi, frika, e cila ua përshkon dhe ua mbulon të gjithë fytyrën.

Disa komentues janë të mendimit se, në këtë rast, qëllimi i përdorimit të fjalës *"vuxhuhun"*, ka të bëjë me kryetarët e jobesimtarëve, të cilët e kanë vendosur veten e tyre në një poshtërim të thellë. Kuptimi i parë duket se është më i përshtatshëm.

Më tej, Kur'ani i Shenjtë thotë se këta janë persona që vazhdimisht kanë punuar dhe janë lodhur: **"Që kanë punuar e janë rraskapitur** (duke bërë të këqija në këtë botë)**."**.

Ata janë përpjekur shumë për jetën e tyre në këtë botë, por në të vërtetë ajo përpjekje nuk u ka vlejtur, përveçse u ka shkaktuar lodhje. Ata nuk kanë pranë Zotit as vepër të pranuar dhe as nuk kanë për të marrë gjë me vete nga pasuria e tyre, ata nuk i lanë vend vetes, që të lënë emër të mirë dhe as nuk edukuan fëmijë të drejtë. Ata janë njerëz që përpiqen, por që nuk ua shikojnë vlerën gjërave, përsëri mbetën të varfër.

Sa bukur e përçon fjalën: *"Amiletun Nasibetun"* tek adresuesi: **"Ata kanë punuar e janë rraskapitur."**.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se qëllimi i përdorimit të kësaj fjalie është për ata që kanë punuar në këtë botë, por që rraskapitjen dhe lodhjen do e marrin në Ahiret.

Gjithashtu, komentues të tjerë janë të mendimit se kriminelët, në Xhehennem i vendosin të kryejnë punë, me qëllim që të shikojnë më shumë vuajtje.

Ndër këto komentime, komentimi i parë duket më i drejtë dhe më i përshtatshëm.

Në përfundim, këta njerëz të lodhur e të rraskapitur futen në zjarr të nxehtë dhe digjen aty: **"Ata do të digjen në zjarr të nxehtë."**.

Fjala *"tesla"* vjen nga rrënja e fjalës *"sala"*, që ka kuptimin e futjes në zjarr. Por dënimi i tyre nuk përfundon këtu. Kur ata i merr etja, për shkak të nxehtësisë, aty u jepet të pinë nga një burim që është jashtëzakonisht i nxehtë: **"E do të pinë nga burime të valuara."**.

Fjala *"anijetun* është gjinia femërore e fjalës *"el enij"*, që ka kuptimin: "vonesë", e lë për më vonë. Gjithashtu, citohet për të shprehur ardhjen e momentit apo të kohës së një diçkaje. Në këtë rast, ka kuptimin e ujit të nxehtë, i cili ka arritur në gradën e nxehtësisë.

Në ajetin 29 të sures "El Kehf"lexojmë: **"...Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t'ua përcëllojë fytyrat...!"**.

Në ajetin tjetër flitet për ngrënien e tyre në kohën kur janë të uritur, ajeti thotë: **"Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese."**.

Komentuesit e Kur'anit, fjalën *"ed dari'u"* e kanë komentuar në mënyra të ndryshme. Disa janë të mendimit se fjala *"dari'un"* është një lloj gjembi që i ngjitet tokës dhe kurejshët atë e quanin *"esh shebreku"*, kur është i njomë. Kur thahej, atë e quanin *"dari'un"*. Gjembi është bimë që nuk e ha asnjë lloj kafshe apo shpendi, pra, nuk i afrohet asgjë, sepse është helmues.[1]

Khalili, dijetari i madh i gjuhës, për këtë gjemb, thotë: "*Dari'n* është bimë e gjelbër, me erë të keqe, që del nga deti.".

Ibn Abasi ka thënë: "*Dari'un* është pemë prej zjarri e, nëse do të ishte në tokë, ajo do të digjte tokën dhe gjithçka tjetër!".

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Dari'un është diçka që qëndron në zjarrin e Xhehennemit, është i ngjashëm me gjembin dhe është më i hidhur se durimi, është më kundërmues se sa vdekja, është më djegës se sa zjarri. All'llahu e ka quajtur atë me emrin 'dari'un'."*.[2]

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se *"dari'un"* është një lloj ushqimi që është krijuar posaçërisht për xhehennemlinjtë. Ata, për të gjetur shpëtim nga ai ushqim shumë i ndytë, i luten

[1] Tefsiri "Kurtubi", vëll. 10, f. 7119.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 7, f. 169; Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 336.

All'llahut.[1] (Mos harroni se rrënja e fjalës *"dari'un"*, do të thotë: dobësi, poshtërim, përulësi.)[2] Këto komentime nuk kanë kundërshtime apo konflikt me njëri-tjetrin, është e mundur që të gjitha këto kuptime të jenë përmbledhur në një kuptim. Më tej shton: **"As nuk do t'i mbajnë, as nuk do t'ua shuajnë urinë."**.

Padyshim, që një dënim i tillë nuk është për t'u forcuar trupin e as për t'u shuar urinë. Ai ushqim të zihet në grykë. Kjo gjendje, në vetvete, është një lloj dënimi. Sikurse lexojmë në ajetin e 13 të sures "El Muzzemmil": **"...ushqime që ngecin në fyt dhe dënime të dhembshme."**.

Ata që në këtë botë janë ushqyer me ushqim të mirë e të shijshëm, duke dhunuar dhe duke marrë me dhunë të drejtën dhe hakun e të tjerëve, apo ata që nuk lejuan që të izoluarit të mos përdorin ushqim tjetër përveç ushqimit që të mbetet në fyt, atje duhet të kenë ushqim prej të cilit të dënohen rëndë. Por sikurse e kemi thënë shumë herë, për ne të burgosurit e kësaj bote, nuk është e mundur të shpjegojmë, apo të shprehemi si duhet për mirësitë e Xhennetit apo për dënimet e Xhehennemit. Të gjitha këto sa thamë, janë shenja dhe përafrime që ne i shohim nga larg.

[1] Tefsiri "Kurtubi", vëll. 10, f. 7120.

[2] Një tjetër diskutim, për sa u përket ushqimeve të xhehenemlinjëve, që në Kur'anin e Shenjtë janë cituar me emra të ndryshëm, si: dari'un, zekkum dhe gaslijn. Këto janë përmendur në këtë komentim, në vazhdim të ajetit 36 të sures "Hakk", ku u është bërë një interpretim dhe shpjegim i qartë, si dhe ndryshimin që kanë këto emra nga njëri-tjetri.

Ajetet 8 – 16

﴿وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَاعِمَةٌ۸ لِسَعْيِهَا رَاضِيَةٌ۹ فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ۱۰ لَا تَسْمَعُ فِيهَا لَاغِيَةً۱۱ فِيهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ۱۲ فِيهَا سُرُرٌ مَرْفُوعَةٌ۱۳ وَأَكْوَابٌ مَوْضُوعَةٌ۱۴ وَنَمَارِقُ مَصْفُوفَةٌ۱۵ وَزَرَابِيُّ مَبْثُوثَةٌ۱۶﴾

"Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara."

"Të kënaqura për punët e bëra."

"Ata do të jenë në kopshtin e lartë."

"Në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe."

"Atje ka një burim rrjedhës uji."

"Dhe divane të ngritura."

"Ka kupa të vëna (për t'u mbajtur në dorë)**."**

"Dhe jastëkë të renditur."

"Si dhe shumë qilima të shtruar."

Komentimi

Prej mirësive të Xhennetit

Nisur nga sa u tha më lart, për gjendjen dhe dënimin që do të përjetojnë në Botën e Përtejme kriminelët, jobesimtarët dhe punëligët, në ajetet në vazhdim do të flasim dhe do të shpjegojmë për gjendjen e besimtarëve, punëmirëve.

Gjithashtu, do të flasim për mirësitë e pakufishme të Xhennetit. Në këtë mënyrë do të mëshironte zemërimin me mirësinë, edhe paralajmërimin me parashtrimin. Ajeti 8 thotë: **"Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara."**.

Nisur nga përshkrimi, që ajetet e mësipërme, bënë për fytyrat e punëkëqijve dhe për poshtërimin dhe vuajtjet e tyre, në këtë rast, flitet për gjendjen e besimtarëve dhe punëmirëve.

Fjala *"naimetun"* vjen nga rrënja e fjalës *"en ni'metu"*, që në këtë rast, flet për fytyra që i ka mbuluar mirësia. Ato janë të freskëta, të gëzuara. Fytyrat e tyre shfaqin vetëm lumturi, shkëlqejnë nga gëzimi. E njëjta situatë përshkruhet edhe në ajetin 24 të sures "El Mutaffifîn": **"Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë."**.

Në këtë ajet, fytyrat përshkruhen të lumturuara nga përpjekjet dhe punët e tyre: **"Të kënaqura për punët e bëra."**.

Banorët e Xhennetit janë të kënaqur, sepse do të shpërblehen për punët e mira që kanë bërë, ndërsa banorët e Xhehennemit janë

e kundërta. Ata nuk u shpërblyen për punën dhe përpjekjet e tyre, sepse punët dhe përpjekjet e tyre ishin të padobishme. Banorët e Xhennetit e marrin shpërblimin e tyre për punët dhe përpjekjet e tyre në mënyrën më të mirë dhe janë plotësisht të kënaqur.

Ata jo vetëm që shpërblehen për punët e mira, por shpërblim e marrim të shumëfishtë, ndonjëherë shpërblehen me dhjetëfishin, ndonjëherë me shtatëqindfishin, e ndonjëherë edhe më shumë. Kështu i furnizojmë besimtarët, duke i shpërblyer, pa ua llogaritur shpërblimin.

Ajeti 10 i sures "Ez Zumer" thotë: **"...Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë."**.[1]

Më tej, Kur'ani i Shenjtë komenton se ku do të qëndrojnë punëmirët: **"Ata do të jenë në kopshtin e lartë."**.

Fjala *"alijetun"* mund të shprehë apo të ketë për qëllim "lartësinë e vendit", që do të thotë se ata janë dhe do të qëndrojnë në katet e larta të Xhennetit. Ose ka për qëllim lartësinë e pozitës. Sipas komentuesve, janë të mundshme të dyja këto mundësi, por komentimi i dytë duket më i përshtatshëm, edhe pse të dy kuptimet mund të përmblidhen në një.

Më pas All'llahu e përshkruan Xhennetin, vendin ku shpirti është i qetë dhe nuk flitet përçart. Atje askush nuk flet kot, nuk përdoren fjalët e kota: **"Në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe."**.

[1] Sure "Ez Zumer", ajeti 10.

Atje nuk do të ketë asnjë fjalë apo fjalim që të shfaqë hipokrizi, armiqësi, luftë, grindje, smirë, xhelozi, gënjeshtër, thashetheme, shpifje apo fjalë boshe e të pavlera. Sa vend i mrekullueshëm, i qetë është! Nëse mendoni saktë, në të shumtën e rasteve, shqetësimet dhe mërzia vjen për shkak të dëgjimit të këtyre fjalëve. Këto fjalë prishin qetësinë shpirtërore, bëjnë që një shoqëri e tërë të prishet, ndezin zjarrin e grindjes dhe flakët e saj shkojnë shumë larg, aq sa krijojnë fitne gjithkund.

Pasi All'llahu i Madhëruar flet për qetësinë shpirtërore që do të ketë shpirti në Xhennet, për shkak të mos ekzistimit të këtyre fjalëve boshe, shpjegon një pjesë materiale të mirësive në Xhennet: **"Atje ka një burim rrjedhës uji."**.

Fjala *"ajnun"* është e pashquar dhe zakonisht përdoret për të shpjeguar një person. Por në kontekst të ajeteve të tjera të Kur'anit, ka kuptimin material, që në të përmbledh edhe burimet e ndryshme.

Në ajetin 15 të sures "Edh Dharjiat" lexojmë se punëmirët janë të vendosur në mesin e kopshtit të Xhennetit, ku pranë tyre kanë burime që rrjedhin: **"Pa dyshim, ata që i frikësohen All'llahut do të jenë në kopshte dhe burime."**.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se në çdo kështjellë nga kështjellat e Xhennetit ndodhen burime që rrjedhin dhe, duke qenë se fjala *"ajnun"* është në numrin njëjës, tregon përkatësinë, burim që është në përputhje me shijet e banorëve të Xhennetit, burim që mund të kalojë ngado dhe nuk ka nevojë që të hapet kanal apo përrua.

Faktikisht, ekzistenca e shumë burimeve të ndryshme, si dhe bukuria dhe freskia ka vlerën e saj, atje secili do të ketë pijen e tij të veçantë. Banorët e Xhennetit freskohen në çdo kohë me pije të ndryshme, të ëmbla dhe të freskëta.

Pasi citohen burimet e ujit, flitet për shtretërit e Xhennetit, shtretër të lartë: **"Divane të ngritura."**.

Fjala *"surur"* vjen nga shumësi i fjalës *"serijrun"* dhe ka kuptimin: *shtretër që përdoren në takime, ku ulesh mbi ta*.[1]

Lartësia e këtyre shtretërve është që banorët e Xhennetit të kenë mundësi të shikojnë nga lart pamjen e në këtë mënyrë ata kënaqen duke soditur pamjen e ofruar.

Ibn Abasi thotë se këta shtretër të lartë janë të tillë që, kur dikush dëshiron të ulet mbi ta, ata përulen poshtë, në mënyrë që personi të ulet mbi ta dhe, pasi personi ulet në shtrat, shtrati rikthehet në gjendjen e mëparshme.

Gjithashtu, ekziston edhe një tjetër mundësi, që përshkrimi i këtyre shtretërve me fjalën *"merfueh"* – *"të ngritur"* është për shkak se ata janë të çmuar.

Disa komentues janë të mendimit se pjesët e këtyre shtretërve janë të ndërtuara me flori dhe të zbukuruara me rubin. Përmbledhja e të dy këtyre kuptimeve është e mundur.

Nisur nga sa u tha më lart, për burimet që rrjedhin dhe pijet e freskëta të Xhennetit, se me çfarë do të pinë banorët e Xhennetit

[1] "Mufredat" i Ragibit, kapitulli (Ser).

në këto burime, ajeti në vijim na qartëson se pranë këtyre burimeve janë vendosur kupa të bukura dhe të çuditshme. Banorët e Xhennetit, sa herë që dëshirojnë të pinë, kupat mbushen te burimet dhe vendosen pranë tyre. Ata pinë pije të freskëta, shuajnë etjen me to, si dhe kënaqen. Kjo kënaqësi nuk mund të përshkruhet, është e papërshkrueshme për banuesit e kësaj bote.

Fjala *"ekuabun"* është shumësi i fjalës *"kubun"* dhe ka kuptimin: *enë ose kupë me bisht*. Është e nevojshme që të kihet parasysh dhe t'i kushtohet vëmendje kësaj çështje, që në Kur'anin e Shenjtë janë cituar shumë herë emra të ndryshëm, për sa u përket emrave të enëve që do të mbajnë pijen e pastër të banorëve të Xhennetit.

Në këtë rast dhe në disa ajete të tjera është përmendur emri *"ekuab"* – *"kupa"*, ndërkohë që në disa ajete të tjera është cituar fjala *"ebarijk"*.

Fjala *"ebarijk"* është shumësi i fjalës *"ibrijk"*, dhe ka kuptimin e enës që ka dorezë, si dhe gyp për të rrjedhur pijet, ose *"kase"*, me kuptimin: filxhan i mbushur me pije, sikurse thonë ajetet: **"Do t'u sillen rreth** (për shërbim) **djelmosha përherë të rinj, me kupa, ibrikë dhe gota me pije të kulluar, që rrjedh."**.[1]

Përsëri, Kur'ani i Shenjtë flet për gjëra të tjera, që janë detaje të mirësive të Xhennetit, duke shtuar se atje gjinden jastëkë dhe mbështetëse të radhitura mbi shtretërit.

[1] Sure "El Uâki'a", ajetet 17–18.

Fjala *"nemariku"* është shumësi i fjalës *"nemrekatun"* dhe ka kuptimin: *mbështetës i vogël*.[1] Këto mbështetëse zakonisht përdoren kur qetësohen dhe pushojnë.[2]

Interpretimi me fjalën *"mesfufetun"* tregon sasinë dhe sistemin e veçantë që mbizotëron tek ata.

Ky interpretim tregon se ata kanë takime me njëri-tjetrin dhe janë të pastër nga çfarëdolloj kotësie. Ata flasin vetëm për mirësitë dhe begatitë e pafundme të All'llahut. Shpëtimi nga dhimbjet, vuajtjet e dynjasë dhe të Ahiretit janë ndër bisedat e tyre. Për ta, është mirësi gjithçka që u është dhënë. Sa kënaqësi e madhe është për ta, që nuk i krahasojnë apo i barazojnë ato mirësi me mirësitë e Xhennetit.

Në ajetin e fundit, flitet për qilimat e shtruar në Xhennet. Atje janë shtruar qilima të çmueshëm dhe shumë të bukur: **"Si dhe shumë qilima të shtruar."**.

Fjala *"zerabijetun"* është shumësi i fjalës *"zerbun ose zeribejjetun"*, që ka kuptimin: *qilima të bukur, të cilët janë të butë e të rehatshëm dhe të çmueshëm e të vlefshëm*.

Është e dukshme që paralelet e këtyre mjeteve janë qetësuese dhe kënaqësi. Këto janë shembujsh që nuk mund t'i zëvendësojmë.

[1] Sure "El Uâki'a", ajetet 17–18.
[2] Libri "Sehahul Leghe", kapitulli, (Nemrekeh).

Në këto ajete janë cituar shtatë mirësi të rëndësishme të Xhennetit dhe çdonjëra nga këto mirësi është më tërheqëse dhe më e bukur se tjetra.

Me pak fjalë, Xhenneti është vend i pakrahasueshëm, është vend që nuk ndodhet asnjë lloj shqetësimi, grindje apo luftë. Aty gjenden lloje të ndryshme frutash me ngjyra të larmishme, melodi që e qetësojnë zemrën, burimet rrjedhin vazhdimisht pije të pastër, shërbyes të denjë, bashkëshortë unikë, shtretër të rehatshëm, qilima të bukur dhe fin, miq të këndshëm, kupa dhe ibrik që janë tërheqës.

Përfundimisht, këto janë mirësi që nuk mund të përshkruhen me fjalët e kushtëzuara të kësaj bote dhe as që mund të përshkruhen në botën e ëndrrave. Të gjitha këto janë në pritje të besimtarëve, që me punët e pastra të tyre kanë fituar mirësitë hyjnore.

Më shumë se kënaqësitë materiale janë kënaqësitë shpirtërore dhe më shumë e më mirë se kaq, janë të gjithë fytyrat e dashura, si dhe butësia e Krijuesit, butësi që, nëse të vjen një herë në dorë, është më e mirë se sa gjithë kënaqësitë materiale.

Ajetet 17 - 26

﴿أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ١٧ وَإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ١٨ وَإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ١٩ وَإِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ٢٠ فَذَكِّرْ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ٢١ لَسْتَ عَلَيْهِمْ بِمُصَيْطِرٍ٢٢ إِلَّا مَنْ تَوَلَّى وَكَفَرَ٢٣ فَيُعَذِّبُهُ اللَّهُ الْعَذَابَ الْأَكْبَرَ٢٤ إِنَّ إِلَيْنَا إِيَابَهُمْ٢٥ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ٢٦﴾

“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!“

“Po qiellin, se si është ngritur?!”

“Po malet, se si janë vënë të patundur?!”

“Po Tokën, se si është shtrirë?!”

“Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhammed)**, se ti je vetëm këshillues.”**

“Dhe nuk je ngarkuar t’i detyrosh ata me forcë!”

“Sa për ata që shmangen dhe nuk besojnë.”

“All’llahu do t’i ndëshkojë me dënimin më të madh.”

“Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne.”

“Dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!”

Komentimi

Deveja prej shenjave të krijimit të All'llahut

Më lart u fol për Xhennetin dhe mirësitë e tij, ndërsa në këto ajete do të flitet për çelësin kryesor të hyrjes në Xhennet, që është njohja e All'llahut (Marifetull'llah). Duke cituar katër shembuj: fuqinë e jashtme të All'llahut, krijimin e gjithçkaje prej Tij, ftesën e njeriut për të studiuar përreth tyre dhe rrugën e hyrjes në Xhennet. Ndërkaq e gjithë kjo është shenjë për fuqinë e pafundme të All'llahut, që është çelësi i zgjidhjes së çështjes së Ringjalljes.

Ajeti 17 thotë: **"Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!"**.

Komentuesit e Kur'anit kanë shumë për të folur për këtë ajet, për sa i përket krijimit të devesë. Është e qartë, se mbi të gjitha e gjithçka, në stadin e parë, për arabët e Mekës, deveja ishte gjithçka për jetën e tyre, sepse ajo përmblidhte gjithçka për ta, sepse me të organizonin punën. Ata ishin të zënë me devetë ditë e natë. Për më tepër, kjo kafshë ka cilësi të çuditshme, të cilat e veçojnë atë nga kafshët e tjera. Ajo është shenjë prej shenjave të All'llahut.

1- Disa kafshëve ne u përdorim vetëm mishin, disa të tjerave u përdorim qumështin. Të tjera hynë në punë vetëm për t'u kalëruar. Disa të tjera përdoren për të ngritur pesha. Por deveja është kafshë që i përmbledh në vetvete të gjitha këto cilësi që u thanë më lart. Mishi i saj është i përdorshëm, qumështi gjithashtu, përdoret edhe për të kalëruar, edhe për të ngritur pesha.

2- Deveja është kafsha më e fuqishme dhe më e fortë nga të gjitha kafshët e zbutura. Ajo ngre pesha të mëdha. Është i çuditshëm fakti që, kur ngarkohet deveja, ajo është e ulur dhe

ngrihet me një lëvizje e qëndron në këmbët e saj. Ndërkohë që kafshët e tjera nuk i kanë këto fuqi.

3- Deveja mundet të qëndrojë pa ujë një javë deri në dhjetë ditë. Gjithashtu, e duron shumë urinë.

4- Deveja mund të ecë gjatë gjithë ditës dhe të ecë mbi toka e rrugë të vështira. Këtë gjë nuk e bëjnë kafshët e tjera. Për këtë shkak, arabët devenë e quajnë anijen e shkretëtirës.

5- Deveja, për nga mënyra e të ushqyerit, harxhon shumë pak dhe ha ushqim pa pretendime, ha gjemba, ferra etj.

6- Deveja, në kushte të rënda dhe jo të përshtatshme, kur ngrihet tufani i rërës në shkretëtirë, i mbron sytë, veshët dhe hundën me mjete të veçanta që All'llahu i ka dhuruar, kështu që ajo mund të ecë në atë tufan.

7- Deveja, edhe pse ka forcë të madhe, është ndër kafshët më të qeta, saqë edhe një fëmijë i vogël mund ta marrë në dorë dhe të drejtojë frenat e saj aty ku ai dëshiron, pa pasur asnjë problem.

Shkurtimisht, cilësitë e kësaj kafshe janë të papara. Nëse njeriu do të shikojë me më kujdes dhe vëmendje, se si është krijuar ajo, atëherë do të mund të kuptonte se kush është Krijuesi i Madh që ka krijuar një krijesë të tillë.

Kur'ani, me një pyetje të zhdrejtë, pyet njerëzit, se ju, duke qenë të humbur dhe të zhytur në lëndinën e pavëmendjes, nuk shikoni. A nuk mendoni për sekretin e krijimit të këtyre

krijesave, që të mund të gjeni Rrugën e Drejtë e të largoheni nga e padrejta?

Është e dukshme, edhe pa u thënë se qëllimi i fjalës "*nedhere*" në fjalinë: "*efela jendhurun*", nuk ka kuptimin e të parit normal apo të vështrimit, por ka të bëjë me të parët e kombinuar me mendim dhe reflektim, njëkohësisht.

Më pas flet për qiejt: **"Po qiellin, se si është ngritur?!"**.

Qielli, me gjithë madhështinë, me të papriturat, me yjet dhe planetet, me bukurinë e rrallë të tij, e nxit njeriun të mendojë, të thellohet përballë Krijuesit, që botën e ka krijuar me rend e llogari. Kjo botë e vogël duket si zero përballë pafundësisë.

Si mundet që këto mirësi madhështorë, të jenë të radhitura me aq delikatesë në orbitën e tyre? Si mund të qëndrojnë në vendin e tyre pa asnjë shtyllë? Si mund, që edhe pasi kanë kaluar miliona vite mbi diellin, aksi kryesor i lëvizjes së planetit nuk ndryshon?

Edhe pse krijimi i qiellit gjithmonë është dukur si dukuri e çuditshme, edhe sot e kësaj dite, në dritën e zbulimeve shkencore, të papriturat dhe mrekullitë e tij janë të shumta. Madhështia e tij bëhet më tërheqëse.

A duhet të mendojmë e të thellohemi për Krijuesin dhe Zotin e kësaj bote të madhe? A duhet t'i afrohemi ne sa më tepër qëllimit të madh të Tij?!

Më tej flet për tokën dhe thotë se vështroni malet se si qëndrojnë në vendin e tyre: **"Po malet, se si janë vënë të patundur?!"**.

Malet i kanë rrënjët e lidhura me njëra-tjetrën. Ato janë të vendosura në tokë si unaza, rrathë-rrathë të blinduar. Tërmetet që shkaktohen si pasojë e llavës së brendshme; batica e shkaktuar si rezultat i tërheqjes së hënës dhe të diellit arrin në pikën minimale.

Malet janë ato që mbrojnë tokën, janë mbrojtësit e sigurt ndaj tufaneve. Nëse nuk do të ishin malet, toka do të shndërrohej në një shkretëtirë të pabanueshme.

Përfundimisht, malet e ruajnë ujin brenda vetes dhe e përcjellin atë gradualisht te tokat që kanë etje. Malet, në prehrin e tyre, mbartin gjelbërim, lulëzim dhe freski. Ndaj në ajetet e tjera malet janë konsideruar si shtyllat e tokës.

Parimisht, malet shfaqin dinjitet, madhështi dhe forcë, ato gjithkund janë burim i mirësisë dhe i bereqetit. Ndaj dhe për këtë shkak, njeriu bëhet më i thelluar në mendime. Edhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* para se t'i shpallejprofetësia qëndronte për adhurim në malin Nur (Xhebelul Nur) dhe në shpellën Hira.

Fjala *"nusibet"* vjen nga rrënja e fjalës *"en nasbu"* dhe ka kuptimin: *vend i përcaktuar*. Ky interpretim mundet të tregojë cilësinë e krijimit të maleve në fillimin e krijimit të tyre. Mundet të jetë ajo gjë për të cilën në ditët e sotme shkenca i ka vendosur një perde dhe justifikohet duke thënë se malet janë shkaktuar si pasojë e shkaqeve të ndryshme, ndaj edhe beson e pretendon lloje të ndryshme faktesh për krijimin e tyre:

Malet janë krijuar për shkak të rrudhave të kokës.

Malet janë krijuar për shkak të vullkaneve.

Malet janë si rezultat i prurjeve të shiut.

Malet që janë vendosur në zemër të deteve, janë pjesë e sedimentit të detit, si dhe pjesë e mbetur e kafshëve.

Po, secili mal, gjenezën dhe vlerën e bereqetit e ka të denjë për vëmendje dhe për t'i kushtuar rëndësi. Ndërsa për njerëzit e zgjuar, ata janë shenjë prej fuqisë së All'llahut.

Më tej ajeti i pyet se pse nuk e vështroni tokën, sa e sheshtë është ajo. **"Po Tokën, se si është shtrirë?!"**

Malet lahen vazhdimisht nga shirat. Në këtë mënyrë ato krijojnë grimcat e tokës. Më pas në gropat e shtrira dhe në tokën e sheshtë, mund të mbillet dhe mund të ndërtohet çfarëdolloj ndërtese në shërbim të njeriut.

Nëse i gjithë planeti i tokës do të ishte me male dhe lëndina, jetesa do të ishte e vështirë, rraskapitëse. Po kush e bëri gati, të banueshme dhe të përshtatshme për ne tokën? Të gjitha këto janë çështje, Kur'ani i Shenjtë na fton që të mendojmë e të thellohemi.

Shtrohet pyetja: Çfarë lidhje apo marrëdhënie ekziston midis këtyre katër çështjeve: devesë, qiellit, maleve dhe tokës?

Fakhru Rrazij, në komentimin e tij, thotë: Duke qenë se Kur'ani ka zbritur në gjuhën arabe, ka dhënë elemente nga mënyra e jetesës arabe. Arabët zakonisht udhëtonin, sepse tokat e tyre nuk punoheshin që të mbilleshin. Rrugëtimi i tyre ishte i gjatë dhe rraskapitës, nëpër shkretëtira, larg nga shoqëria. Kjo gjë bënte që ata të mendojnë, pra, mendja e tyre vihej në punë, por ata nuk kishin njeri që të shpreheshin. Sytë e tyre shkonin te deveja, së cilës

i kishin kalëruar. Pamja ishte e çuditshme, kështu që ata viheshin në mendime, kur shikonin lart, nuk shikonin gjë përveç qiellit. Ndërsa kur vështrimi i tyre ishte në të majtë dhe të djathtë, nuk shikonin gjë tjetër përveç maleve dhe tokës. A thua që All'llahu dëshiron t'u japë atyre urdhër, që të mendojnë e të thellohen? Te menduarit në vetmi, sigurisht, rrotullohet drejt boshtit të këtyre katër çështjeve.[1]

Por, nëse mendimin do ta shtronim jashtë boshtit dhe kufizimit të jetës së arabëve dhe ta shtrinim më tutje, mund të themi se katër çështjet që u trajtuan në ajetin e mësipërm, janë themelet e jetës së njeriut, pra, ato formojnë themelet e jetesës së njeriut: qielli, është ligji i dritës, shiut dhe ajrit.

Toka është qendra e zhvillimit të llojeve të ndryshme të ushqimeve.

Malet janë qendra e sekretit të qetësisë dhe e magazinimit, si dhe e ruajtjes së ujit dhe e lëndëve nëntokësore.

Deveja është një shembull i qartë i kafshëve të zbutura, të cilat janë vendosur në shërbim të njerëzve.

Pra, në këtë mënyrë, edhe çështja e bujqësisë, e blegtorisë dhe e industrisë është prekur nga katër çështjet. Të menduarit dhe të thelluarit në këto katër çështje dhe në këto mirësi të begata, dashje pa dashje, e shtyn njeriun që të falënderojë Krijuesin që e shtyn njeriun që ta njohë Atë.

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 31, f. 157.

Në vijim të këtij diskutimi, fjalën dhe theksin e diskutimit e kalon te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Tashmë, meqë çështja është e tillë, kujtoi ata, ti je vetëm përkujtues: **"Prandaj këshilloji** (njerëzit o Muhammed)**, se ti je vetëm këshillues."**.

Ti asnjëherë nuk mund të jesh dominues ndaj tyre, që t'i detyrosh ata për besim: **"Dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!"**.

Po, krijimi i qiejve dhe i tokës, i maleve dhe i kafshëve është tregues dhe orientim se kjo botë nuk është pa llogari. Krijimi i njeriut, gjithashtu, nuk është pa qëllim. Kur gjendja është e tillë, atëherë këshilloi ata që të njihen me qëllimin e vërtetë të krijimit të tyre, tregoju dhe mësoju atyre rrugën e afrimitetit me All'llahun. Në rrugën e evolucionit, bëju udhëheqësi dhe udhëzuesi i tyre.

Sigurisht që rruga e përsosmërisë arrihet dhe përftohet kur njeriu e dëshiron atë dhe e bën me dëshirën e tij. Gjithmonë duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me vullnetin e lirë, në të kundërt, përsosmëria dhe zhvillimi i detyruar është një bisedë pa vlerë. Ti nuk mund t'i detyrosh ata, edhe nëse e bën, kjo gjë nuk ka asnjë vlerë.

Disa imagjinuan se ky urdhër kishte zbritur para Shpalljes së urdhrit të Xhihadit dhe me zbritjen e urdhrit të Xhihadit është shfuqizuar.

Sa gabim i madh! Çështja e këshillimit dhe e propagandimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka nisur që nga dita e parë dhe ka vazhduar derinë sekondat e fundit të jetës së tij. Pas tij, këshillat dhe propagandën e

kanë pasuar mëkëmbësit e tij të pastër dhe dijetarët e fesë, të cilën do ta vazhdojnë e do ta pasojnë vazhdimisht.

Kjo çështje nuk është prej çështjeve që mund të shfuqizohet. Gjithashtu, edhe mos ekzistimi i vullnetit të lirë ndaj besimit, është një parim i qëndrueshëm. Qëllimi i Xhihadit përgjithësisht është betejë me rebelët dhe me largimin e pengesave që u vihen njerëzve që kërkojnë të drejtën e tyre, pra, njerëzve që duan të vërtetën.

Kjo çështje është e ngjashme e ajetin 80 të sures "En Nisa": **"...Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre."**. Kushdo që kthen shpinën, le ta kthejë. Ty nuk të kemi vendosur përgjegjës të tyre.

Gjithashtu, në ajetin 107 të sures "El En'âm" dhe në ajetin 48 të sures "Esh Shuara" citohet dhe përsëritet e njëjta gjë.

Fjala *"musajtir"* vjen nga rrënja e fjalës *"es satru"*, që ka kuptimin rreshtat e librit. *"Musajtir"* është ai që numëron rreshtat e faqes së librit dhe radhitësi që sistemon librin. Më pas kjo fjalë është përdorur për personat që janë dominues në një gjë apo sistemojnë rreshtat e tyre, po ashtu është përdorur edhe me kuptimin kur e detyron dikë që të kryejë një punë pa vullnetin tij.

Në ajetin tjetër, duke përjashtuar dhe duke veçuar thotë se ata që kthejnë shpinën dhe bëhen qafirë, All'llahu ata do t'i ndëshkojë me ndëshkim të madh: **"Sa për ata që shmangen dhe nuk besojnë, All'llahu do t'i ndëshkojë me dënimin më të madh."**.

Për sa si përket çështjes së përjashtimit, se ne cilën prej dy fjalive është bërë ky përjashtim, ekzistojnë komentime të ndryshme.

Së pari, thuhet se përjashtimi është dhënë për qëllimin e fjalisë: *"fedhekkir"*, që do të thotë se nuk është e nevojshme, apo përjashtohet të këshillosh njerëz, të cilët nuk e duan të drejtën, apo që nuk pranojnë të këshillohen.

Në të vërtetë, këtu ekziston një ngjashmëri me ajetin 83 të sures "Ez Zuhruf": **"Lëri ata të flasin marrëzi dhe le të argëtohen, derisa të takojnë Ditën që u është premtuar."**.

Lërini ata në gjendjen e tyre të mëparshme, që të mbeten në mëshirë të fatit me kotësitë e tyre, le të luajnë deri në ditën e premtuar për takim!

Së dyti, mendohet se përjashtimi mund të jetë nga fjalia e hequr dhe mund të ketë këtë kuptim: Këshillo, sepse këshillimi është i dobishëm për të gjithë, përveç atyre që janë armiq me të drejtën.

I ngjashëm me këtë kuptim, është ajeti 9 i sures "El Ala": "prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme!" duke u bazuar ajeti të ketë kuptimin e fjalisë kushtore. **Së treti**, ky përjashtim vjen nga përemri *"alejhim"*, që është në ajetin e mësipërm, që do të thotë: Ti nuk mund të ushtrosh forcë ndaj tyre, përveç atyre apo atij që kthen shpinën dhe largohet nga kokëfortësia e tij, kështu që je i detyruar të përballesh me ata.[1]

[1] Në tefsirin "Ed Durr'rrul Menthur" përmendet një hadith nga i cili përftohet se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

Gjithë sa u tha, është e mundur, nëse përjashtimi i ashtuquajtur, të jetë i lidhur, por ekziston edhe një tjetër mundësi, që ky përjashtim të jetë i shkëputur, që përafërsisht ka kuptimin "por" dhe kuptimi i fjalisë të jetë i tillë: Por personat që kthejnë shpinën dhe bëhen jobesimtarë, All'llahu është dominues mbi ta, ose All'llahu do t'i ndëshkojë ata me dënim të madh.

Midis këtyre komentimeve, vetëm dy prej tyre janë më të përshtatshëm, sepse, së pari, përjashtimi i bërë të jetë i lidhur dhe të kthehet te fjalia: **"Dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!"**

Duke iu referuar ndërmjetësimit me forcë, përballë dhunuesve, ose mund të jetë i shkëputur me kuptimin, i përjashtuar nga dënimi Hyjnor në lidhje me jobesimtarët kokëfortë.

Për sa i përket qëllimit të përdorimit të fjalës: *"adhabelekbere"* – *"ndëshkim i madh"*, bën ndarjen midis dënimit në këtë botë dhe ndëshkimit në Botën Tjetër. Dënimi i atjeshëm nuk është aspak i vogël, përkundrazi është i madh dhe me rëndësi. Sikurse lexojmë në ajtin 26 të sures "Ez Zumer": **"All'llahu i poshtëroi ata që në këtë jetë, por dënimi i Jetës Tjetër do të jetë më i madh! Veç sikur ta dinin!"**.

Në fund të kësaj sureje, me një ton kërcënues thotë: **"Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne."**.

Më tej shton: **"Dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!"**.

---

tij!) ishte i urdhëruar të përballej me idhujtarët dhe në çështje të tjera ai ishte i urdhëruar për këshillim.

Në të vërtetë, ky është një lloj ngushëllimi dhe rehatie për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përballë këmbënguljes së jobesimtarëve. All'llahu e ngushëllon Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të mos shqetësohet, por të vazhdojë punën e tij.

Gjithashtu, All'llahu kërcënon jobesimtarët kokëfortë, duke u thënë se me kë kanë të bëjnë, se me kë e kanë llogarinë.

Në këtë mënyrë, surja "El Gâshije" fillon dhe mbaron me çështjen e Kiametit. Ndërkohë që flitet edhe për çështjen e Teuhidit dhe të profetësisë, çështje që përbejnë bazën dhe themelin e Ringjalljes. Ajetet e fillimit të kësaj sureje tregojnë një pjesë të ndëshkimeve të rënda të kriminelëve.

Më pas flet për një pjesë të rëndësishme, sikurse është shpërblimi i besimtarëve.

Nga ana tjetër, është liria dhe vullneti i përzgjedhjes së rrugës së besimit nga ana e njerëzve. Po në të njëjtën kohë, i paralajmëron të gjithë, duke u thënë se kthimi është tek All'llahu dhe se llogaridhënia është me Të.

Përveç këtyre, qartëson faktin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është dërguar për të përçuar Mesazhin e All'llahut dhe se nuk është përgjegjës për veprat, gabimet, mëkatet e njerëzve. E tillë është rruga e gjithë përçuesve të mesazhit të Rrugës së Drejtë.

O All'llah! Në atë ditë, kur kthimi i të gjithë krijesave do të jetë te Ty dhe llogaria e të gjithëve do të jetë mbi Ty, na përfshi në mëshirën dhe mirësinë Tënde!

O All'llah! Na ruaj nga dënimi i madh, na mbaj larg atij dënimi dhe ndëshkimi!

O All'llah, mirësitë e Xhennetit, që një pjesë prej tyre u thanë në këtë sure, na i bëj kësmet, edhe pse nuk i meritojmë, na i dhuro me mirësinë dhe mëshirën Tënde!

Amin Ja Rabil Alemin.

Fundi i sures "El Gâshije"

Sure "El - Fexhr"

Zbritur në Mekë

Ajete 30

Përmbajtja e sures "El - Fexhr"

Kjo sure, sikurse edhe sure të tjera, që kanë zbritur në Mekë, është e përbërë prej ajeteve të shkurtra, tronditëse, plot jehonë dhe të kombinuara me këshilla të shumta.

Në pjesën e parë, kjo sure të përball me betime të ndryshme, që, në llojin e tyre, janë të pakrahasueshme. Këto betime janë parathënie për kërcënimin e kriminelëve dhe për dënimin e tyre.

Në pjesën tjetër të kësaj sureje, flitet për disa nga popujt kriminelë dhe zullumqarë, sikurse ishte populli i Adit, i Themudit dhe i Faraonit.

Gjithashtu, flet për dënimin dhe hakmarrjen e All'llahut ndaj tyre, mësim ky për popujt e tjerë.

Në pjesën e tretë të sures, flitet shkurtimisht për provat dhe sprovat e njeriut, si dhe kritikohet për punët e veprat.

Në pjesën e fundit të sures, flitet për çështjen e Ringjalljes dhe fatin e kriminelëve dhe të jobesimtarëve, si dhe për shpërblimin e madh të besimtarëve që janë të sigurtë e të kënaqur me Krijuesin e tyre.

Mirësitë e leximit të sures "El - Fexhr"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, kemi hadithin nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Ai që e lexon këtë sure në dhjetë netët e para të Dhul Hixhxhes, All'llahu do t'ia falë atij mëkatet. Ata që e lexojnë këtë sure në kohë të tjera, do të kenë dritë dhe shkëlqim në Ditën e Kiametit*".[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Suren 'El – Fexhr' është mirë ta lexoni në çdo namaz të detyruar, sepse ajo është surja e Husejn ibn Aliut (Paqja e Zotit qoftë mbi të!). Çdokush që e lexon këtë sure, në Kiamet do të jetë me Husejnin dhe do shkojë në të njëjtin Xhennet*".[2]

Prezantimi i kësaj sureje si surja e Ali Ibn Husejnit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ndoshta është për shkak se ai ka dhënë prova të qarta, për sa i përket (Nefsi Mutmeinne), ajet që citohet në fund të kësaj sureje.

Është quajtur si surja e Husejn Ibn Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, sepse dhjetë netët kanë lidhje me fillimin e muajit Muharrem, që në të vërtetë, ka një lidhje të veçantë me Husejn Ibn Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Sidoqoftë i gjithë ky shpërblim, është për ata që e lexojnë atë për të përmirësuar veten e tyre.

Ajetet 1 – 5

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 481.
[2] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 481.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالْفَجْرِ۝١ وَلَيَالٍ عَشْرٍ۝٢ وَالشَّفْعِ وَالْوَتْرِ۝٣ وَاللَّيْلِ إِذَا يَسْرِ۝٤ هَلْ فِي ذَلِكَ قَسَمٌ لِذِي حِجْرٍ۝٥﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëlotit!

"Betohem për muzgun e agimit."

"Dhe për dhjetë netët (e para të muajit Dhul Hixhxhe)**!"**

"Betohem për çiftin dhe tekun."

"Dhe për natën kur largohet!"

"A nuk janë këto betime të mëdha për njerëzit e mençur?!"

Komentimi

Betohem për muzgun e agimit!

Në fillim të kësaj sureje janë cituar pesë betime që e zgjojnë njeriun.

Në 2 ajetet e para thuhet: **"Betohem për muzgun e agimit dhe për dhjetë netët** (e para të muajit Dhul Hixhxhe)**!"**.

Fjala *"el fexhru"*, në origjinal, ka kuptimin e një therje të thellë, nga ku del drita e mëngjesit përmes errësirës së natës. Ndaj edhe është interpretuar me *"fexhr"*. Dimë se agimi, pra, *"fexhr"* është i ndarë në dy lloje: "i rremi" dhe "i vërteti".

"Agimi i rremë" është ai agim që shfaqet në qiell. Atë e krahasojnë me bishtin e dhelprës, sepse një pjesë e hollë e tij shfaqet në horizont, ndërsa baza e konit është ne mes të qiellit.

"Agimi i vërtetë" shfaqet në horizont që në fillim dhe përhapet nëpër qiell, dhe baza e konit të tij qëndron në mes të qiellit.

"Agimi i vërtetë" paralajmëron fundin e natës dhe fillimin e ditës. Në këtë kohë agjëruesit duhet të ndalojnë se ngrëni e së piri, si dhe çdo vepër tjetër që prish agjërimin (Imsak). Në këtë kohë hyn edhe koha e namazit.

Disa të tjerë janë të mendimit se fjala *"fexhr"*, në ajetin që cituam, ka kuptim absolut, që do të thotë (agim), që, sigurisht, është një ndër shenjat e mëdha të All'llahut. Jo vetëm në jetën e njeriut është pikëlidhës, por edhe për të gjitha krijesat e tokës. Aty nis pushteti i dritës dhe përfundon terri, nis lëvizja e gjithçkaje të gjallë

dhe përfundon gjumi e heshtja. Ndaj dhe All'llahu betohet për hir të kësaj jete.

Të tjerë komentues janë të mendimit se fjala *"fexhr" – "agim"* ka kuptimin e nisjes së muajit Muharrem.

Gjithashtu, komentues të tjerë, fjalën *"fexhr"* e kanë konsideruar si agimin e ditës së Kurban Bajramit, që është një ceremoni e rëndësishme, pas kryerjes së Haxhit, si dhe është e lidhur me dhjetë netë.

Të tjerë janë të mendimit se ka të bëjë me ardhjen e Muajit të Ramazanit, ose me ardhjen e agimit të ditës së Xhuma. Por, gjithsesi, ajeti ka një kuptim të gjerë, ku i përfshin të gjitha këto, edhe pse disa, prej vërtetësive dhe komentimeve, janë më të qarta dhe me më shumë rëndësi nga disa të tjera.

Komentues të tjerë, janë të mendimit se ajeti ka kuptim më të rëndësishëm se kaq, duke thënë se bëhet fjalë për agimin dhe dritën e zemrës, e cila shndrit në errësirë.

Ndaj dhe shkëlqimi i fesë islame dhe drita e pastër e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahu qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në terrin e epokës së injorancës, është një ndër agimet më të vërteta.

Gjithashtu, edhe ardhja e Imam Mehdiut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në një periudhë, të errët ku drita do të mbulohet nga terri,

dhuna e kërcënimi, do të konsiderohet si një agim i vërtetë (është cituar në shumë transmetime).[1]

Gjithashtu, edhe kryengritja e Ashures së Imam Husejnit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në atë fushë të gjakosur të Kerbelasë, si dhe thyerja e perdeve të historisë së territ dhe të dhunës që Beni Umajadët kryen, tregon fytyrën e vërtetë të djallit.

Të gjitha kryengritjet e vërteta, të cilat janë kundër kufrit dhe injorancës, si dhe kundër territ e dhunës përgjatë historisë së kohërave të kaluara dhe të ditëve të sotme, konsiderohen agim.

Edhe pendimi konsiderohet agim. Por, gjithsesi, kjo është një këshillë që jepet përgjatë kuptimit të ajetit, ndërkohë që për nga pamja e jashtme, ajeti ka kuptimin e lindjes së agimit.

Fjala *"lejalil ashri"* ka kuptimin e dhjetë netëve, e njohur si dhjetë netët e Dhul Hixhrit, pra, ato net konsiderohen si dëshmia më e madhe dhe më tronditëse e çdo popullate.

Ky kuptim është transmetuar nga Xhabir Bin Abdullah Ensari dhe ai e ka marrë nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[2]

Të tjerë atë e konsiderojnë si dhjetë netët e fundit të Muajit Ramazan, ku në të përfshihet edhe Nata e Kadrit.

Të tjerë janë të mendimit se ka të bëjë me dhjetë netët e para të muajit Muharrem.

---

[1] Këtë kuptim e gjejmë në hadithet e Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, si dhe në tefsirin "Burhan", vëll. 4, Hadithi 1, f. 457.
[2] Tefsiri "Ebul Fetuh Rrazij", vëll. 12, f. 74.

Përmbledhja e këtyre komentimeve mund të jetë plotësisht e mundur.

Në disa hadithe dhe transmetime, ku flitet për atë çka Kur'ani i Shenjtë mbart përbrenda, thuhet se fjala *"agim"* i atribuohet ekzistencës së Imam Mehdiut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*; fjala *"lejalil ashri"* – *"dhjetë netët"*, përputhet me dhjetë Imamët para tij, ndërsa fjala *"shef'un"*, e cila vjen në ajetin më poshtë, është komentuar se i atribuohet Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe Hazreti Fatime Zahrasë *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Sido që të jetë, betimi në këto dhjetë net tregon rëndësinë e jashtëzakonshme të këtyre dhjetë netëve, sepse All'llahu e përdor betimin vetëm për çështje të rëndësishme.[1] Përmbledhja e këtyre komentimeve është e mundur.

All'llahu i Madhëruar e vazhdon betimin duke shtuar: **"Betohem për çiftin dhe tekun."**.

Për sa u përket fjalëve: *"shef'i"* – *"çift"* dhe *"uitr"* – *"tek"*, komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme.

Disa komentues janë të mendimit se bëhet fjalë për njëzet thënie.[2]

[1] Fjala *"lejalil ashri"*, në këtë rast, ka ardhur në trajtën e pashquar. Por duke pasur parasysh që trajta e pashquar, në këtë rast, shpjegon madhështinë e diçkaje, ndaj merr formën dhe kuptimin e një premtimi, duke treguar apo duke folur për ato netë të veçanta, që i cituam më lart.

[2] Tefsiri "Fakhri Rrazij", vëll. 31, f. 164.

Të tjerë komentues kanë shkuar edhe më thellë, duke thënë se bëhet fjalë për tridhjetë e gjashtë thënie.[1]

Po japim më poshtë thëniet më të rëndësishme që janë cituar për sa i përket *çiftit* dhe *tekut*:

1- Thuhet se ajeti ka për qëllim, citimin e numrave çift dhe tek. Në përputhje me këtë komentim, vërejmë se All'llahu është betuar me të gjithë numrat, që nisin nga çifti dhe teku, ose janë të përbërë prej çiftit dhe tekut. Të gjitha llogaritë dhe sistemet rrotullohen rreth këtyre numrave, duke përshkruar të gjithë botën e ekzistencës. Ndoshta ka thënë: Betohem në rendin dhe llogarinë. Në botën e ekzistencës, kjo është çështja më e rëndësishme, pra, rendi e disiplina, llogaria dhe numrat janë ato që përbëjnë edhe bazat kryesore të jetës së njeriut.

2- Qëllimi i përdorimit të fjalës *"shef'i"* është të tregojë krijesat, sepse të gjitha krijesat janë të përbëra prej çiftit.

Fjala *"uitr"* - *"tek"* ka për qëllim të tregojë All'llahun, sepse Ai nuk ka të ngjashëm, as shok nuk ka. (Ky komentim është cituar edhe në disa prej transmetimeve të Masumëve[2].)[3]

[1] "Tabatabai", në tefsirin "El Mijzan" është marrë prej disa komentuesve. (vëll. 20, f. 406); në tefsirin "Ruhul Meanij", ky tekst është marrë nga libri "El Tahrijr ue et Tehjir", vëll. 30.

[2] Të pastër.

[3] Abu Said El Khuderij e ka transmetuar atë nga Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 485.

3- Sipas disa komentuesve, qëllimi i përdorimit të fjalëve *"çift"* dhe *"tek"* është të tregojë të gjitha krijesat e botës, sepse disa prej tyre, në një aspekt, janë çift dhe të tjerë janë tek.

4- Disa komentues të tjerë janë të mendimit se bëhet fjalë për namazet, sepse disa prej namazeve, për nga ana e numrave, janë çift e disa prej tyre janë tek. (Këtë mendim e hasim, gjithashtu, në transmetime të Masumëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*[1], ose bëhet fjalë për namazin e "*shef'i* dhe *uetr*", që i falim në fundin e natës si nafile.

5- Komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"shef'i"* ka të bëjë me ditën e Tervijes, që përputhet me ditën e tetë të muajit Dhul Hixhxhe, ku pelegrinët e Haxhit bëhen gati të shkojnë në Arafat.

Përdorimi i fjalës *"uitr"* ka për qëllim të tregojë Ditën e Arafatit, ditë ku vizitorët e shtëpisë së All'llahut janë në Arafat.

Të tjerë komentues janë të mendimit se fjala *"shef'i"* tregon ditën e Kurban Bajramit (dita e dhjetë e Dhul Hixhxhes).

Ndërsa fjala *"uitr"* tregon Ditën e Arafatit. (Ky komentim është hasur edhe në transmetimet e Masumëve).[2]

Është e rëndësishme se, nëse *"elifi"* dhe *"lami"* në këto dy fjalë përfshin të gjithë njerëzit dhe e përmbledh këtë kuptim edhe në numrin shumës, atëherë secili prej këtyre komentimeve dhe të

[1] Abu Said El Khuderij e ka transmetuar atë nga Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 485.
[2] Po aty.

tjerë përveç këtyre, janë shpjegues të një shembulli prej shembujve të *"shef'i"* dhe *"uitr"*.

Por, nëse *"elifi"* dhe *"lami"* tek *"shef'i"* dhe *"uitr"* është për premtim, tregon për çiftin dhe tekun, ndërsa, në këtë rast, në proporcion me betimet që u thanë më lart, dy kuptime janë më të përshtatshme nga gjithë sa u tha.

E para, ka për qëllim ditën e Kurban Bajramit dhe të Arafatit, ditë këto që përputhen dhe janë në një linjë me dhjetë ditët e fillimit të muajit Dhul Hixhxhe, ku pjesa më e rëndësishme është riti i Haxhit që kryhet në atë muaj.

Ose ka të bëjë me namazin, sepse ai është në proporcion me betimin që bëhet për agimin. Në agim është koha më e përshtatshme, kur njeriu i shpreh nevojat dhe sekretet e tij Krijuesit të tij.

Ajo çka është e veçantë në këto dy komentime është se komentimi i tyre është transmetuar edhe nga Masumët *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*.

Betimi i fundit bëhet për natën kur ajo largohet: **"Dhe për natën, kur largohet!"**.[1]

Sa interpretim i veçantë dhe sa fjalë tërheqëse janë përdorur për natën! Të ecësh natën. Fjala *"jeser"* vjen nga rrënja e fjalës *"suri"* dhe sipas Ragibit, te libri "Mufredat", ka kuptimin: *të ecësh natën*.

[1] Fjala *"jesr"* ka qenë *"jesri"*, folje që e ka burimin nga fjala *"es serij"* dhe *"ja"* është hequr në përshtatje me ajetet e tjera.

A thua se nata është një qenie e gjallë dhe e ndjeshme, dhe duket sikur nis të ecë dhe shkon drejt mëngjesit dhe drejt ndriçimit.

Na është përmendur betimi për natën e errët, ku pas saj vjen drita. Terri nuk është i lëvizshëm e as i qëndrueshëm, errësira është e tmerrshme, kur vjen në mënyrë të qëndrueshme, por, nëse tek terri shfaqet lëvizje drejt dritës, ajo atëherë kthehet në vlerë.

Të tjerë komentues, gjithashtu, kanë thanë se terri, errësira e natës mbi faqen e tokës është në gjendje të lëvizshme dhe parimisht, ajo çka është e rëndësishme, me vlerë dhe jetëdhënëse, është po kjo natë që është vazhdimisht në lëvizje, që do të thotë, se ajo vazhdimisht, në mënyrë të alternuar, e ndërron vendin e saj me ditën.

Nëse nata do të qëndronte, ose do të ngulej në një pjesë të tokës, ajo pjesë do të vdiste dhe po ashtu, edhe pjesa tjetër që do të kishte vazhdimisht diell.

Për sa i përket faktit se për cilën natë bëhet fjalë, në këtë rast, dhe a është fjala për një natë apo për të gjithë netët, në mesin e komentuesve ka shumë diskutime.

Nëse *"elifi"* dhe *"lami"*, në ajet, do të kishin kuptim të përgjithshëm, atëherë ky kuptim do t'i përfshinte të gjitha netët, sikurse e thotë edhe vetë ajeti, që është prej shenjave të All'llahut. Ky ndryshim është prej dukurive të rëndësishme të krijimit.

Por nëse *"elifi"* dhe *"lami"* tregon premtim, atëherë ai flet për një natë të caktuar dhe jo të përgjithshme. Duke u bazuar te betimet e kaluara, qëllimi në këtë rast, është për natën e Kurban Bajramit, natë kur haxhinjtë, pra, pelegrinët largohen nga Arafati për në

Muzdelife (Mesh'erul Haram) dhe, pasi kalojnë një natë në atë tokë të shenjtë, pasi lind dielli, nisen për në Mina. Ky komentim është cituar gjithashtu në transmetimet e Masumëve.[1]

Ata që e kanë parë nga afër këtë skenë, pra, Arafatin dhe Mesher-in e dinë se si në çdo cep dhe në çdo hap pranë tyre janë me qindra e mijëra persona që lëvizin. Duket sikur nata, me të gjithë qenien e saj, lëviz në atë vend. Është e vërtetë që haxhinjtë, pra, pelegrinët janë në lëvizje, por kjo lëvizje e përgjithshme në grup është aq shumë e përhapur, saqë duket sikur e gjithë toka dhe koha është në gjendje të lëvizshme.

E gjithë kjo vërehet vetëm kur personi është i pranishëm në atë tokë, natën e Kurban Bajramit, aty njeriu e ndien dhe e shikon me sytë e tij kuptimin e ajetit : **"Dhe për natën, kur largohet!".** Sido që të jetë dhe çfarëdolloj kuptimi të ketë pasur fjala *"natë"* në ajet (të veçantë apo të përgjithshëm) ajo është prej shenjave të mëdha Hyjnore, si dhe është ndër çështjet më të rëndësishme të botës ekzistenciale. Nata bën rregullimin dhe përshtatjen e nxehtësisë së kohës, të gjithave krijesave u fal qetësi, ofron vend për të biseduar dhe për t'i folur Krijuesit në mënyrën më të qetë.

Ndërsa për sa i përket natës së Kurban Bajramit, që ndryshe e quajnë edhe *"lejletul xhem'i"*, është ndër netët më të çuditshme të vitit, e cila është e ndjeshme në atë fushë të shenjtë, Mesh'arul Haram. Megjithatë, bashkimi dhe lidhja e këtyre pesë betimeve (betohem në Agim, dhjetë netët, çiftin dhe tekun, si dhe natën gjatë lëvizjes) është e qartë kur të gjitha këto betime i lidhim me kohën e Dhul Hixhxhes, si dhe me ceremoninë e kryerjes së Haxhit.

[1] "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 571.

Në të kundërt, është folur për një sërë ngjarjesh të rëndësishme të zhvillimit botëror dhe të legjislacionit, shenja këto që flasin dhe tregojnë për dukuri të jashtëzakonshme të kësaj bote të krijuar nga All'llahu.

Pasi citon këto betime me plot kuptim, shton: **"A nuk janë këto betime të mëdha për njerëzit e mençur?!"**.

Fjala *"el hixhr"*, në origjinal ka kuptimin *" ndalim"*, e në këtë rast, ka kuptimin *"intelekt, (el akl)"*. Sepse "intelekti" e ndalon njeriun që të bëjë punë të padrejta.

Edhe *"prehrit"* i thuhet *"hixhr"*, për shkak se ruan dhe ndalon të tjerët.

"Akl" – *"intelekti"* e ruan dhe e ndalon njeriun të kryejë punë të padrejta, ndaj edhe intelektit i kanë thënë *"hixhr"*.

Sikurse kuptimi i fjalës *"akl"*, ka kuptimin ndalim, edhe litarit që lidh gjunjët e devesë për të mos lëvizur, i thuhet "el akkalu".

Ekzistojnë dy mundësi për shkakun e këtyre betimeve: Së pari, fjalia: "Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!", është përgjigjja e këtyre betimeve. Së dyti, përgjigjja e betimeve është e fshehtë dhe ajetet që flasin për dënimin e kriminelëve, janë dëshmuese të kësaj gjëje, ndaj edhe kuptimin e kanë të tillë: "Betohem për atë që është thënë, që ne jobesimtarët, kriminelët e arrogantët do t'i dënojmë." Kështu, në këtë mënyrë, qartësohet betimi dhe për kë bëhet betimi.

Ajetet 6 – 14

﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ۝٦ إِرَمَ ذَاتِ الْعِمَادِ۝٧ الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا فِي الْبِلَادِ۝٨ وَثَمُودَ الَّذِينَ جَابُوا الصَّخْرَ بِالْوَادِ۝٩ وَفِرْعَوْنَ ذِي الْأَوْتَادِ۝١٠ الَّذِينَ طَغَوْا فِي الْبِلَادِ۝١١ فَأَكْثَرُوا فِيهَا الْفَسَادَ۝١٢ فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ عَذَابٍ۝١٣ إِنَّ رَبَّكَ لَبِالْمِرْصَادِ۝١٤﴾

"Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad,"

"Banorë të Iremit me pallate shumështyllëshe,"

"Të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!"

"Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)**?"**

"Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)**?"**

"Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre,"

"Duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin."

"Prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit."

"Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!"

Komentimi

Dhënia kohë të padrejtëve dhe hakmarrja!

Në vazhdim të ajeteve që u cituan më lart, që, në vetvete, përmbanin betime me plot kuptim, për sa i përket faktit të dënimit dhe të ndëshkimit të kriminelëve dhe të jobesimtarëve, do të hasim ajete që përmendin disa popuj të fortë, që kishin fuqi të mëdha. Këta popuj ishin mendjemëdhenj dhe arrogantë dhe në këtë mënyrë zgjodhën rrugën e mburrjes dhe të kriminalitetit.

Këto ajete flasin për këtë lloj populli dhe për fatin e dhimbshëm të tyre. Qartësohet shumë mirë gjendja e tyre, që jobesimtarët e Mekës dhe popuj të tjerë që mund të jenë më të dobët se ata, t'i bëjnë llogaritë e të zgjohen nga përgjumja dhe neglizhenca.

Së pari thotë: **"Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad?"**.

Qëllimi i përdorimit të fjalës *"ru'ijet"*, në këtë rast, është për dijen dhe njohuritë. Por për shkak se ky tregim dhe kjo ngjarje e këtyre popujve ishte bërë aq shumë e njohur, dukej sikur njerëzit që e dëgjonin, e kishin parë me sytë e tyre, pra, e kishin përjetuar atë, ndaj edhe është interpretuar me fjalën *"rui'jet"*.

Në të vërtetë, edhe pse adresuesi në këtë ajet është vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është paralajmërim për të gjithë.

Adi është populli i Profetit të madh, të All'llahut, Profetit Hud *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Disa historianë besojnë se populli i Adit ishte i ndarë në dy fise, një fis jetonte shumë larg dhe Kur'ani i Shenjtë ata i ka cituar me emrin (Adu El Eula[1]).[2] Ata, ka mundësi, të kenë jetuar para historisë, së njerzimit.

Ndërsa fisi i dytë ka jetuar përgjatë periudhës së historisë së njerëzimit. Mendohet se ata kanë jetuar shtatëqind vjet para lindjes së Profetit Mesih, Isait *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe janë të njohur me emrin Ad. Mendohet se kanë jetuar në tokën e Ehkafit, ose në Jemen. Ata ishin trupmëdhenj dhe të fuqishëm dhe për këtë shkak konsideroheshin si luftëtarë Elitë.

Gjithashtu, për nga ana e qytetërimit, ata ishin shumë të emancipuar, kishin qytete të ngritura, toka të mbjella, kështjella të mëdha, si dhe kopshte plot lulëzim e freski.

Disa komentues janë të mendimit se Ad është emri i gjyshit të këtij fisi, sepse zakonisht fiset thirreshin me emrin e gjyshit.

Më tej, All'llahu shton: **"Banorë të Iremit me pallate shumështyllëshe."**.

Për sa i përket emrit *"Irem"*, nëse është emër fisi, personi, i një vendi apo qyteti, midis komentuesve ka shumë diskutim.

Zamakhshari, në librin e tij "Kesh'shaf" transmeton prej disa dijetarëve se Adi është i biri i Eus dhe ai është djali i Iremit. Iremi është djali i Samit e Sami është djali i Nuhut. Për shkak se fisi

[1] Populli i Adit (pra Adët e parë)
[2] Sure "En Nexhm", ajeti 50.

thirrej me emrin e gjyshit, edhe fisin e Adit i thërrisnin me emrin "Irem".

Të tjerë janë të mendimit se Iremi është i Ad Eula, ndërsa Adi është fisi i dytë.

Komentues të tjerë janë të mendimit se *"Irem"* është emri i tokës dhe i qytetit të tyre.[1] Por, e përshtatshme me ajetin tjetër, është që *"Irem"* është emri i qytetit të tyre.

Fjala *"imadun"* ka kuptimin *"shtyllë"*. Shumësi i tij është *"umud"* – *"shtyllat"*.

Nëse do të bazohemi në komentimin e parë, ku flitej për trupat e fuqishëm dhe për shtatin e tyre, duke i krahasuar me shtyllat, është e dukshme se flitet për popullin e Adit.

Nëse bazohemi te komentimi i dytë, ku flitet për ndërtesa të mëdha dhe për kështjella të papara, si dhe për shtylla gjigante që janë përdorur për ndërtimin e këtyre kështjellave, na çon në atë drejtim, që të themi se flitet përsëri për fuqinë dhe forcën e popullit të Adit.[2]

Komentimi i dytë është më i përshtatshëm se i pari, ku flitet për shtylla të mëdha të kështjellave.

---

[1] Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 747, në vazhdim të ajetit për të cilën folëm. Të njëjtin kuptim e ka cituar edhe Kurtubiu në tefsirin e tij, si dhe në tefsire të tjera.
[2] Duke u bazuar në komentimin e parë, *"dhat"* është në gjininë femërore dhe jo mashkullore, për shkak të fisit. Kjo gjë ndodh, sepse gjinia femërore është verbale.

Prandaj në ajetin tjetër shton: **"Të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!"**.

Ky interpretim tregon se qëllimi i përdorimit të fjalës *"Irem"* është të tregojë për qytetin dhe nuk bëhet fjalë për fise.

Shumë komentuesit të Kur'anit e kanë pranuar këtë komentim, për shkak të këtij argumenti. Gjithashtu, edhe ne e përzgjodhëm si preferencën tonë.

Disa komentues kanë folur gjatë për një tregim të bukur, për sa i përket qytetit të Iremit dhe për shkretëtirat e Gadishullit Arabik, duke përshkruar me shumë delikatesë ndërtesat e mëdha dhe të bukura, shkretëtira e Adenit dhe ndërtesat e jashtëzakonshme dhe të pa para më parë. Por këto tregime janë më të afërta me përrallat dhe ëndrrat se sa me një të vërtetë.

Sido që të jetë, nuk është për t'u habitur apo për të qenë të pasigurt, sepse populli i Adit dhe qyteti i tyre ishte ndër më të fuqishmit dhe shumë i zhvilluar. Sikurse e thotë vetë Kur'ani, nuk gjendet qytet tjetër si ai qytet i bukur.

Janë treguar shumë tregime të ndryshme për "Xhenneti Shedad". Në gojëdhëna është folur shumë se ai ishte djali i Adit. Është folur aq shumë për ta, saqë kopshtet e Iremit u përdornin nga njerëzit si fjalë të urta e si gjëegjëza. Por këto tregime, më tepër ngjajnë me mitologjitë, edhe pse në to kanë edhe rrënjë të së vërtetës, por së bashku me rrënjët kanë edhe degë e gjethe të shtuara.

Pasi u fol për popullin e Adit dhe qytetin e Iremit, do të shkojmë në një tjetër çështje, ku flitet për armiqtë e popujve të

mëparshëm. All'llahu thotë në Kur'an se nuk patë se si u soll All'llahu me popullin e Themudit? Po ai popull, që priste damarët e tij në fushë dhe mbi gjak, ndërtonte shtëpi dhe kështjella.

"Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)**?"**.

Populli i Themudit është ndër popujt më të vjetër. Profeti i tyre ishte Profeti Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ata jetonin në tokën me emrin Vadiel Keri, e cila gjendej midis Medines dhe Shamit. Ishin të qytetëruar dhe të zhvilluar. Kishin një jetë të pasur, ishin pronarë të ndërtesave të mëdha. Disa komentues janë të mendimit se Themudi ishte emri i babait të një fisi.[1]

Fjala *"xhabu"*, në origjinal është marrë nga fjala *"xhubeh"*, që ka kuptimin ultësirë, fushor. Më pas ka marrë kuptimin: prerje të çdo pjesë të tokës.

Edhe dhënien e përgjigjes së një fjalie e kanë quajtur *"xheuab"*, sepse duket sikur e ndërpret ajrin dhe nga gjuha e folësit arrin në veshin e dëgjuesit, ose sepse e ndërpret pyetjen dhe i jep fund asaj.

Sido që të jetë, qëllimi në këtë rast është për prerjen e pjesëve të maleve dhe krijimin e shtëpive të sigurta. Sikurse lexojmë në ajetin 82 të sures "Hixhr", ku flitet po për popullin e Themudit: **"...Ata ndërtojnë shtëpi të sigurta në zemër të maleve..."**.

---

[1] *Themud*, nëse shikojmë rrënjën e fjalisë dhe, nëse i qasemi fjalorit, shikojmë se rrënja e saj *"themed"* do të thotë: *pak ujë*. *Themud* i thuhet një personi, prej të cilit kërkohen shumë mallra, saqë mallrat e tij përgjysmohen. Të tjerë këtë fjalë e konsiderojnë të ardhur. ("Mufredati" i Ragibit).

I ngjashëm me këtë kuptim, është edhe ajeti 149 i sures "Esh Shura", sepse edhe në këtë ajet janë përmendur shtëpitë e tyre, duke thënë: "Ju i gdhendni shtëpitë në male me mjeshtri të rrallë,". Të tjerë janë të mendimit se populli i Themudit ishte populli i parë që priste gurët e maleve, për të ndërtuar shtëpi të forta në zemër të maleve. Fjala *"uad"* ka qenë *"uadi"*, që ka kuptimin: *shtrat i lumit, ose vend ku kalon lumi*. Ndonjëherë përdoret me kuptimin *luginë*, sepse lumenjtë kalojnë nëpër lugina që janë pranë maleve. Në këtë rast, kuptimi më i përshtatshëm është ai i dyti, pra, lugina, sepse, nëse bazohemi tek ajetet e tjera të Kur'anit, që flasin për këtë popull dhe sikurse u tha më lart, flitet për popullin e Themudit. Populli i Themudit i ndërtonte shtëpitë e tyre afër maleve, ata bënin gati gurë dhe me ta ndërtonin shtëpi të sigurta.[1]

Në një hadith thuhet se Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte nisur për në luftën e Tubukut. Përgjatë rrugëtimit kaloi në jug të Arabisë dhe, kur arriti në luginën e Themudit, tha: *"Nxitoni, sepse ju jeni në tokën e mallkuar."*.[2] Pa dyshim që populli i Themudit, në epokën e tij, kishte qytetërim të zhvilluar, por përsëri, në këtë rast, hasim fakte dhe shifra që janë të tepruara e që ngjajnë më tepër me trillime. Për shembull disa komentues shkruajnë se populli i Themudit ka ndërtuar me gur njëmijë e shtatëqind qytete. Më tej, All'llahu flet për popullin e tretë, që është populli i Faraonit: **"Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve** (ku torturonte njerëzit)**?"**.

Ky ajet flet për mënyrën se si u soll All'llahu me popullin e Faraonit, popull i fuqishëm dhe dhunues.

---

[1] Fjala *"ba"*, në ajetin *"xhabul sekhre bil uadi"* duket se ka kuptim *fuqie*.
[2] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 425.

Fjala *"eutad"* është shumësi i fjalës *"ueted"* dhe ka kuptimin e diçkale me të cilën forcohet një diçka tjetër.

Për sa i përket faktit se përse Faraonin e kanë quajtur *"dhil eutad"* janë dhënë komentime të shumta.

Komentimi i parë thotë se Faraoni kishte ushtri të madhe dhe shumë prej tyre jetonin në çadra. Çadrat ndërtoheshin me shtiza të forta. Të tjerë komentues janë të mendimit se Faraoni, kur ndëshkonte dhe dhunonte ndokënd, e vendoste personin mbi katër shtiza. Duart dhe këmbët i gozhdonte në to, ose e lidhte atë dhe e linte në atë gjendje derisa të vdiste.

Ky komentim është transmetuar në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[1]

Nga historia është përcjellë se Faraoni e dënoi dhe e dhunoi në këtë mënyrë bashkëshorten e tij, Asijen, derisa ajo vdiq, sepse ajo besoi në Profetësinë e Musait *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Të tjerë komentues janë të mendimit se fjala *"eutad"*, parimisht, është ironi për pushtetin dhe themelimin e pushtetit.

Sigurisht që këto tri komentime nuk kanë ndonjë kundërshtim me njëri-tjetrin dhe është e mundur që të jenë të përmbledhura në ajet.

Në një përmbledhje të veprave dhe punëve që kanë kryer këta tri popuj, thuhet: "**Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre, duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin."**.

[1] "Ilelul Shera'i", në përputhje me "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 6, f. 571.

Korrupsioni, në vetvete, përmbledh: shthurjen, dhunën, ndjeshmërinë dhe mospërmbajtjen, e cila është një nga ndikimet e tiranisë së tyre. Çdo popull tiran përfundimisht zhytet në korrupsion.

Më tej, në një fjali të shkurtër, por me shumë kuptim, për sa i përket dënimit të dhimbshëm të këtij populli tiran, thotë: **"Prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit."**.

Fjala *"es seutu"* ka kuptimin e dënimit me kamxhik, që në origjinal ka kuptimin: përzierje të një gjëje me një gjë tjetër. Por më pas kjo fjalë ka marrë kuptimin dënim me kamxhik.

Të tjerë këmbëngulin se ka kuptimin dënim, i përzier me mishin dhe me gjakun e njeriut, gjë e cila e mërzit atë shumë.

Në fjalët e Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për sprovën, lexojmë: "*Betohem në Krijuesin që e dërgoi në të drejtën, Profetin, do të testohi në mënyrë rigoroze, do të shoshiteni sikurse shoshiten përbërsit në momentin kur bashkohen bashkë."*.[1]

Fjala *"sabbe"* është interpretuar me kuptimin e rrjedhjes së ujit, por, në këtë rast, flet për forcën dhe presionin e përsëritjes së këtij dënimi. Gjithashtu, mund të flasë për pastërtinë e sipërfaqes së tokës nga tiranët.

Sido që të jetë, kuptimi më i përshtatshëm është ai i fjalës *"sut"*, që do të thotë: ndëshkim me kamxhik. Ky interpretim është

[1] "Nehxhul Belaga"

i përdorur edhe përgjatë bisedave të përditshme, ku thuhet se filan person u dënua me rrahje kamxhiku.

Ky interpretim i shkurtër flet për dënimet e mëdha dhe të shumta që i kanë përjetuar këta popuj. Ndërkohë që populli i Adit, sikurse e thotë edhe vetë Kur'ani i Shenjtë, shkatërrohet dhe zhduket nëpërmjet erës dhe të ftohtit: **"Fisi Ad u shkatërrua nga një furtunë shungulluese të rreptë."**.[1]

Adi u zhduk nga faqja e dheut nëpërmjet erës së fortë të ftohtë dhe përvëluese.

Ndërsa, për popullin e Themudit, thotë se u zhduk si pasojë e dënimit: **"Fisi Themud u shkatërrua nga një ulërimë e tmerrshme."**.[2]

Për dënimin e popullit të Faraonit, All'llahu thotë në Kur'an se populli i Faraonit u mbyt në dallgët e Nilit: **"E, kur Na zemëruan, Ne u hakmorëm ndaj tyre dhe i fundosëm të gjithë."**.[3]

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, All'llahu i Madhëruar i vë në dijeni të gjithë personat që ecin mbi gjurmët e popujve tiranë dhe thotë: **"Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!"**.

Fjala "*mirsad*" vjen nga rrënja e fjalës "*resed*", që ka kuptimin përgatitje për t'u kujdesur nga diçka. Ekuivalenti i saj në persisht, është: *pritje*. Kjo fjalë, zakonisht, përdoret në vende ku personat

[1] Sure "El Hâkka", ajeti 6.
[2] Sure "El Hâkka", ajeti 5.
[3] Sure "Ez Zuhruf", ajeti 55.

janë të detyruar të kalojnë tranzit dhe dikush është në pritje të tyre për t'i goditur ata.

Si përfundim, tregon se askush të mos mendojë se dikush mund t'u ikë kthetrave të dënimit të Zotit. Të gjithë njerëzit janë në dorë të Tij. Kurdoherë që Ai dëshiron, i dënon ata.

Është e natyrshme dhe e dukshme se All'llahu nuk ka vend dhe nuk ulet në vendet e tranzitit të njerëzve. Ky interpretim u tregon tiranëve dhe dhunuesve fuqinë, pasi gjithçka është e përfshirë në pushtetin dhe fuqinë e All'llahut.

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet se kuptimi i ajetit është: *"All'llahu ka fuqi dhe pushtet, që t'u japë dënimin që meritojnë jobesimtarëve."*.[1]

Ndërsa në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Mirsad është një urë që kalon mbi Xhehennem. Kush ka shkelur të drejtat e një personi tjetër, nuk mund ta kalojë atë urë."*.[2]

Kjo gjë tregon një të vërtetë të qartë, sepse pritja e All'llahut është e lidhur me Kiametin dhe nuk është me urën e njohur të Siratit. All'llahu, edhe në këtë botë, është në pritje të dhunuesve. Pasqyrë e tyre është dënimi që pësuan popujt e mëparshëm.

Fjala *"rab'buke"* tregon se tradita Hyjnore është e zbatueshme për të gjithë popujt e dhunshëm dhe për të gjithë tiranët. Gjithashtu, është tregues i mbrojtjes dhe i kujdesit të All'llahut ndaj Profetit të Tij dhe ndaj besimtarëve. Armiqtë e përbetuar dhe kryeneçë nuk mund t'i fshihen kurrë All'llahut.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 487; "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 64.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 487; Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 64.

Gjithashtu, kjo fjalë tregon edhe një tjetër paralajmërim për ata që dhunojnë Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarët, se fuqia e tyre përfundon dhe zhduket me një tufan apo shkëndijë nga qielli.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Shpirti i besuar (Xhibraili) më ka thënë se, kur All'llahu i Madhëruar t'i vendosë të gjithë njerëzit përballë Tij, në Ditën e Kiametit, do të afrojë Xhehennemin dhe Urën e Siratit, e cila është më e hollë se sa një fije floku dhe më e mprehtë se sa shpata dhe do t'i vendos mbi urë. Në urë do të jenë edhe tri ura të tjera. Në urën e parë janë të vendosura: amaneti, punët e mira, mëshira dhe dashuria.*

Në urën e dytë është vendosur namazi. Në urën e tretë është vendosur drejtësia e botës. Më pas njerëzit urdhërohen të kalojnë mbi to. Ata që nuk e kanë mbajtur amanetin dhe nuk kanë kryer punë të mira, do të qëndrojnë tek ura e parë. Por nëse e kalojnë urën e parë dhe nuk e kanë falur namazin, do të qëndrojnë tek ura e dytë, por, nëse e kalojnë dhe qëndrojnë tek ura e tretë, pra, tek drejtësia Hyjnore, atëherë kanë shpëtuar. Këtë kuptim kishte ajeti: **'Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!'**".

Në fjalimet e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nëse All'llahu do t'i japë kohë dhunuesit, nuk do të thotë se dënimi i tij do të hiqet. Ai është në pritje të tyre, qafën e tyre e ka në dorë dhe, kur të dëshirojë, mund ta shtrëngojë atë, saqë mos t'u kalojë poshtë as pështyma e tyre."*.[1]

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbja 97.

Ajetet 15 – 20

﴿فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي
أَكْرَمَنِ١٥ وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ١٦ كَلَّا
بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ١٧ وَلَا تَحَاضُّونَ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ١٨
وَتَأْكُلُونَ التُّرَاثَ أَكْلًا لَمًّا١٩ وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا٢٠﴾

"Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: 'Zoti im më ka nderuar.'"

"Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: 'Zoti im më ka poshtëruar.'"

"Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët,"

"Dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfrit."

"Trashëgiminë (e të dobtëve) **e zhvatni me lakmi të pangopur,"**

"Dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme."

Komentimi

Qëndrimi i njeriut ndaj dhënies së mirësisë dhe ikjes së saj!

Në ajetet e kaluara u fol për tiranët dhe u kërcënuan me dënimin e All'llahut. Në ajetet që do të flasim, do të trajtojmë çështjen e sprovës, e cila është kriter i mirësive dhe i dënimit. Kjo gjë konsiderohet si çështja më e rëndësishme në jetën e njeriut.

Në fillim thuhet se, kur Zoti e sprovon njeriun, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: **"Zoti im më ka nderuar."**.

Njeriu nuk e di se sprova e tij është ndonjëherë me mirësi, ndonjëherë me fatkeqësi: **"Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: 'Zoti im më ka poshtëruar.'"**.

Të pasurit e mirësisë nuk duhet të bëhet shkak i mendjemadhësisë dhe as fatkeqësitë nuk duhet të bëhen shkak i humbjes së shpresës. Por njeriu që ka pak kapacitet, në të dy gjendjet e tij, e harron qëllimin e sprovës. Kur njeriut i jepet një mirësi, ai ikën aq larg, sa mendon se tani është afër Zotit. Njeriu e merr këtë mirësi si argument për t'u afruar tek All'llahu.

Është për t'u rikujtuar fakti se në fillim ajeti thotë se All'llahu atë e ka nderuar, por në vazhdim të ajetit, kur njeriu e shikon veten e tij si të nderuar dhe të respektuar nga All'llahu, turpërohet. Kjo gjë vjen për shkak se respekti dhe nderi i parë është në kuptimin e përgjithshëm, ndërsa respekti i dytë ka kuptimin e afrimitetit me Krijuesin.

Por, në kohën që do të sprovohet në Ditën e Kiametit dhe gjendja do të ngushtohet, ai do të zhgënjehet dhe do të thotë: "All'llahu mua më ka turpëruar!". Zhgënjimi përfshin të gjithë qenien e njeriut, që nga koka deri te këmbët, bëhet i pakënaqur prej Krijuesit të tij, duke mos pasur dijeni, që të gjitha këto janë mjet sprove për të. Sprova është çelësi i zhvillimit të njeriut dhe në ndjekje të këtyre sprovave, ata do të shpërblehen, në të kundërt, ata do të marrin dënimin.

Këto dy ajete paralajmërojnë se as fati i të pasurit mirësi nuk të afron tek All'llahu e as mospasja e mirësisë nuk është argument dhe arsye për t'u larguar nga e vërteta dhe Krijuesi. Të gjitha këto janë mënyra dhe lloje sprovash që All'llahu i ka ndarë te të gjitha grupet, sipas urtësisë. All'llahu sprovon sipas urtësisë së Tij, por kur njeriu është i paarsyeshëm, bëhet mendjemadh dhe ndonjëherë zhgënjehet.

Në ajetin 51 të sures "Fussilet" thuhet se, kur njeriut i japim mirësi, ai kthen shpinën dhe me mendjemadhësi largohet nga e vërteta, por, kur këtij njeriu i ndodh ndonjë pakënaqësi apo fatkeqësi, ai vazhdimisht lutet dhe është i padurueshëm: **"Kur njeriut i dhurojmë dhuntitë Tona, ai shmanget dhe na kthen kurrizin, mirëpo, kur atë e godet e keqja, ai lutet gjerë e gjatë."**.

Në ajetin 9 të sures "Hud", All'llahu thotë se, kur njeriu shijon shijen e rehatisë dhe më pas i merret ajo rehati, ai bëhet i pashpresë dhe jo falënderues: **"Kur Ne i japim njeriut të shijojë mëshirën Tonë e pastaj ia heqim atë, ai atëherë bëhet shpresëhumbur dhe mohues."**.

Këto dy ajete, përveçse trajtojnë çështjen e sprovës Hyjnore, në mënyra të ndryshme, na bëjnë të mendojmë për këtë përfundim: Asnjëherë nuk duhet të reagojmë për mirësitë, ose për mungesë të tyre, pasi mospasja e mirësive të mos bëhet shkak i humbjes së personalitetit te Krijuesi, i largimit nga zona e shenjtë, sepse kriteri i përhershëm është gjithmonë dhe kudo është besimi dhe devotshmëria.

Shumë Profetë janë sprovuar në këtë botë dhe kanë qëndruar përballë shumë jobesimtarëve dhe tiranëve, të cilët kanë pasur llojë të ndryshme mirësish. Kjo gjë konsiderohet si natyrshmëri e jetës së njeriut në këtë botë. Ndërkohë që ky ajet, në brendësinë e tij, flet për filozofinë e belave dhe ngjarjeve të dhimbshme që i kanosen njeriut.

Më poshtë komentohen veprat e njeriut, vepra që bëhen shkak për largimin e njeriut nga All'llahu dhe të dënimit të tij. Nuk është ashtu sikurse ju mendoni, që mallrat dhe pasuritë tuaja janë argument dhe arsye që ju të keni pozitë pranë All'llahut, por ato janë pengesë për afrimitetin tuaj tek All'llahu. Ju nuk i respektoni jetimët: **"Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfrit."**.

Sikurse edhe e shikoni, në ajet flitet për ushqimin e jetimëve dhe për respektimin e tyre, sepse për jetimin nuk është i mjaftueshëm vetëm ushqimi. Çështja e tyre është edhe më e gjerë, pra, ka një gamë gjërash që duhet të respektohen. Ata kanë nevojë për dashuri, përkëdhelje dhe ngrohtësi.

Jetimi nuk duhet të ndihet i humbur apo i poshtëruar, meqenëse nuk e ka babanë. Ndaj edhe në shumë transmetime dhe në moralin islam kjo çështje, pra, çështja e të respektuarit dhe të nderuarit të jetimit, ka një rëndësi të veçantë.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ai që përkëdhel një jetim, ose i ledhaton flokët jetimit, do të shpërblehet me dritë nga All'llahu i Madhëruar dhe i Mëshirshëm, në sasinë e atyre flokëve që i ka zënë dora, kur e ka përkëdhelur jetimin."*.[1]

Në ajetin 9 të sures "Ed Duhâ" thuhet: **"Prandaj, mos e shtyp jetimin."**.

Ky ajet i vihet përballë një shoqërie që është larg besimit dhe moralit, sikurse është edhe shoqëria në periudhën e injorancës së djeshme dhe të sotme. Kjo situatë, në shoqërinë njerëzore, ka ekzistuar dhe ekziston, jo vetëm nëpërmjet hileve dhe marrjes së mallit të jetimit, por edhe për pozicionin që atij i lënë në shoqëri, duke ia bërë më të hidhur mos pasjen e prindit.

Bëhet e qartë se respekti i jetimit nuk përfshin vetëm ruajtjen e pasurisë së tij, sikurse e komentojnë disa komentues të tefsirit, por çështja është edhe më e gjerë se kaq, pra, përfshin gjithçka i duhet njeriut.

Fjala *"tehad'dune"* vjen nga rrënja *"el had"* dhe ka kuptimin *"nxitje"*, që do të thotë se për jetimin nuk është i nevojshëm vetëm

[1] "Biharul Enuar", vëll. 15, f. 120, botim i vjetër "Vasailush Shiia", vëll. 21, f. 375, botim i "Ehli Bejti".

ushqimi, por njerëzit duhet të nxitin njëri-tjetrin që kjo traditë, pra, respektimi i jetimit të përhapet në të gjithë shoqërinë.[1]

Është për t'u habitur se po të njëjtën gjë e shikojmë edhe në ajetet 33-34 të sures "El Hâkka". Këtë çështje e ka renditur në rendin e njerëzve që besojnë, pra, janë besimtarë: **"Ai që nuk ka besuar në All'llahun e Madhërishëm dhe nuk është kujdesur për të ushqyer të varfrit e shkretë."**.

Ata nuk besojnë tek All'llahu i Madhëruar dhe të tjerët nuk i nxitin që të ushqejnë jetimët.[2]

Më pas flitet për punën e tretë të keqe të tyre. Ata i qorton, duke u treguar mënyrën e keqe të mbledhjes së pasurisë. Ju e keni mbledhur trashëgiminë nëpërmjet rrugës së hallallit dhe të haramit dhe e hani atë.[3-4]

"Trashëgiminë (e të dobtëve) **e zhvatni me lakmi të pangopur".**

Pa dyshim që ngrënia e pasurisë dhe e mallit të jetimit, që është lejuar nëpërmjet trashëgimisë, nuk është dhe nuk konsiderohet punë e ndaluar. Ndaj qortimi i kësaj pune, në ajetin e mësipërm, ndoshta është tregues i një prej çështjeve të mëposhtme: së pari, qëllimi është për përmbledhjen midis të drejtës së jetimit dhe të tjerëve.

---

[1] *"Tehad'dun"*, në original *"tetehad'dun"*. Fjalës së parë i është hequr një *"t"*, për ta shkurtuar.

[2] Fjala *"ta'am"*, në këtë ajet dhe në ajetin që diskutuam, është paskajore, *"it'am"*.

[3] Fjala *"lemma"* ka kuptimin e grumbullimit.

[4] Fjala *"turath"* ka kuptimin *"uirath"* - *"trashëgimi"*. Shkronja *"uau"* te fjala *"turath"* është shndërruar në *"ta"*.

Fjala *"lemma"*, ka kuptim të përmbledhur dhe disa komentues, sikurse edhe Zamakhshari, në librin e tij "Kesh'shaf", kuptimin e tij e ka përmbledhur midis hallallit dhe haramit. Në traditën arabe të periudhës së injorancës, gratë dhe fëmijët i përjashtonin nga trashëgimia, të drejtën e tyre ata e merrnin për vete. Ata ishin të bindur se trashëgimia i përket një personi që është luftëtar, sepse shumë prej mallrave, atyre u kanë rënë në dorë për shkak të forcës dhe për këtë arsye, mendonin dhe pretendonin se ata që mund të bëhen pjesë e trashëgimisë, duhet të jenë të fortë.

Një tjetër shpjegim i bëhet edhe për shkak të koprracisë, dorës së shtrënguar të atij personi që i bie trashëgimia, ai nuk u fal nga ajo të afërmve, të varfërve, si dhe nevojtarëve të shoqërisë. Në këtë rast thuhet se, për sa kohë që ju jeni dorështrënguar te një trashëgimi, e cila të ka ardhur në dorë pa u munduar, si mund të jeni dorëlëshuar, kur ju e fitoni atë me djersën tuaj, para apo çfarëdo qoftë ajo. Kjo sjellje dhe ky moral është shumë i keq.

Së treti, ngrënia dhe shfrytëzimi i trashëgimisë së jetimit dhe të drejtës së më të vegjëlve është parë kudo, persona pa besim dhe të pa fe, apo persona të parregullt e shfrytëzojnë pa kriter mallin e jetimit, që ia kanë lënë të tjerët. Kjo ndodh, sepse jetimët dhe të vegjlit nuk kanë fuqi dhe mundësi të mbrojnë të drejtën e tyre, ndaj edhe shfrytëzohen nga të tjerët, veprim ky shumë i keq dhe turpërues.

Përmbledhja e të tri komentimeve është e mundur.

Më tej flitet për veprimin e katërt të tyre. Ju e pëlqeni shumë pasurinë: **"Dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme."**.[1]

Ju jeni njerëz që pëlqeni këtë botë dhe e adhuroni atë, pëlqeni pasurinë, jeni të dashuruar pas saj dhe gjithçkaje në këtë botë. Sigurisht ai që ka këtë pëlqim të jashtëzakonshëm për pasurinë, nuk mund të bëjë ndasinë e të lejuarës dhe të palejuarës, hallallit dhe haramit. Dhe, sigurisht, një person i tillë, nuk e shlyen kurrë hakun Hyjnor, ose edhe kur e bën atë, e lë të përgjysmuar.

Gjithashtu, një njeri i tillë, që dashurinë e tij të parë ka pasurinë dhe zemrën ia ka mbuluar ajo, nuk ka vend për Krijuesin e tij.

Kështu, në këtë mënyrë, pas citimit të sprovës së njeriut nëpërmjet pasurisë, mirësisë dhe mundimeve, All'llahu u rikujton atyre katër sprova të rëndësishme.

Sprova ndaj jetimit.

Sprova për ushqimin e nevojtarëve.

Sprova për grumbullimin e pasurisë nëpërmjet të lejuarës dhe të ndaluarës.

Së fundi, grumbullimi i pasurisë pa kushte dhe kritere.

[1] Fjala *"el xhemmu"*, ka kuptimin: *shumë, pakufi,* sipas fjalorit "Misbahu Lugati" dhe "Mekajis". Fjala *"xhummetun"* ka kuptimin: *flokë të mbledhura pas koke*.

Është për t'u habitur, se të gjitha këto sprova, kanë tipar dhe aspekt financiar. Në të vërtetë, nëse dikush e kalon këtë test, pra, testin e financës, sprovat e tjera për të do të jenë shumë të thjeshta.

Kjo pasuri e kësaj bote, sipas një thënie të rëndësishme, ka tunduar edhe besimin më të fortë, sepse luhatjet në besim janë te kjo pjesë, e cila bëri që edhe djemtë e Profetit Adem *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* të tundohen në këtë pjesë.

Ka persona që e ruajnë një pjesë të pasurisë, por, kur peshorja e tyre mbushet dhe e tejkalon cakun, hyn në lojë vesvesi i shejtanit dhe i shtyn ata të gënjejnë. Por në të vërtetë, besimtarët e vërtetë janë persona që e ruajnë amanetin, respektojnë të drejtën e detyruar dhe atë të pëlqyer. I nderojnë dhe i respektojnë të tjerët, pa pasur interes. Të tillë njerëz janë me besim dhe të devotshëm.

Me pak fjalë, personat që e kalojnë testin e sprovës së financës, janë të besueshëm në çdo kohë dhe në çfarëdolloj kushtesh. Këta persona janë me dinjitet, të besueshëm, punëmirë dhe me personalitet. Të tillë persona konsiderohen si miqtë më të mirë të jetës. Të tillë njerëz, përgjithësisht, edhe në fusha të tjera, janë të pastër. Edhe ajeti i mësipërm i mëshonte më shumë këtij fakti, pra, sprovës së pasurisë dhe financës.

Ajetet 21 - 26

﴿كَلَّا إِذَا دُكَّتِ الْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا ﴿٢١﴾ وَجَاءَ رَبُّكَ وَالْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا ﴿٢٢﴾ وَجِيءَ يَوْمَئِذٍ بِجَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ وَأَنَّى لَهُ الذِّكْرَى ﴿٢٣﴾ يَقُولُ يَا لَيْتَنِي قَدَّمْتُ لِحَيَاتِي ﴿٢٤﴾ فَيَوْمَئِذٍ لَا يُعَذِّبُ عَذَابَهُ أَحَدٌ ﴿٢٥﴾ وَلَا يُوثِقُ وَثَاقَهُ أَحَدٌ ﴿٢٦﴾﴾

“Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime,”

“Kur të vijë Zoti yt (për të ndarë gjykimin) **me engjëjt të rreshtuar radhë pas radhe.”**

“Dhe, kur të sillet Xhehennemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç’i duhet se u kujtua!”

“Ai do të thotë: ‘Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!’”

“Atë Ditë, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai.’”

“E askush nuk do të lidhë në pranga siç lidh Ai!”

Komentimi

Ditën që nuk bën dobi përmendja!

Në ndjekje të kritikave që u bënë më lart, për sa u përket kriminelëve, adhuruesve të kësaj bote, si dhe dhunuesve të së drejtës së të tjerëve, do të hasim në një tjetër aspekt, që është dhënia e mundësisë dhe paralajmërimi për Ditën e Kiametit. Paralajmërimi është që ata të përgatiten për dhënien e llogarisë.

Nuk është ashtu sikurse ata mendojnë, që nuk do të ketë dhënie llogarie. Edhe nëse All'llahu u ka falur atyre pasuri, është për t'i respektuar dhe jo për t'i sprovuar ata.

"Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime."

Fjala *"ed dekku"*, në origjinal, ka kuptimin: *tokë e zbutur dhe e shtrirë*.

"Ed Dekkan" i thonë një toke që është e shtrirë dhe e sheshtë. Ndërsa *"deken"* i thonë një platforme që është e shtrirë dhe përdoret për t'u ulur. Përsëritja e fjalës *"ed deketu"* në ajetin e mësipërm është për të theksuar.

Nëse i përllogarisim së bashku, ky interpretim na flet për tërmetin dhe ngjarjen tronditëse të përfundimit të kësaj bote dhe fillimin e Ringjalljes. Tronditja e tërmetit do të jetë aq e madhe, saqë të gjitha malet do të thërrmohen dhe toka do të sheshohet, sikurse është cituar edhe në ajetet 105-107 të sures "Ta Ha": **"Kur të të pyesin ty** (o Muhammed) **për malet, thuaj: 'Ato do t'i bëjë hi e**

pluhur Zoti im, ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje.'".

Pas përfundimit të stadit të parë të Ringjalljes, që është përmbytja e kësaj bote, nis stadi i dytë, që është rikthimi i të gjithë njerëzve në jetë. Në këtë moment, të gjithë njerëzit vihen përballë drejtësisë Hyjnore dhe nis urdhri i Zotit, ku engjëjt vihen në rresht: **"Kur të vijë Zoti yt** (për të ndarë gjykimin) **me engjëjt të rreshtuar radhë pas radhe."**.

Engjëjt vihen në radhë për të zbatuar urdhrat e All'llahut. Kjo është një pamje nga ajo ditë e frikshme dhe nuk ka mundësi për t'u larguar nga dënimi.

Sifjalia: *"xhae Rab'buke"* - **"të vijë Zoti yt"**, nënkupton ardhjen e urdhrit të All'llahut dhe dhënien e llogarisë të të gjithë krijesave.

Mendohet se është shfaqja e shenjave të mëdha të All'llahut, ose qëllimi është për shfaqjen e All'llahut, si dija e Tij në atë ditë, ku asnjë nuk do të guxojë të mohojë. Kjo gjë do të duket sikur po shikohet me sy Qenia e Pashoq e All'llahut.

Sido që të jetë, është e sigurt se nuk ka të bëjë me ardhjen e All'llahut si trup, sepse Ai është i pastër për të pasur trup apo ngjashmëri me trupin.[1]

[1] Fakhru Rrazij, në tefsirin e tij thotë se ky ajet ka diçka që nuk përmendet, mund të jetë fjala *"emr"*, ose *"kahr"*, ose *"xhelail ajat"*, ose *"dhuhur dhe marifet"*. Edhe të tjerë komentues, këto katër fjalë dhe në veçanti fjalën e parë, e kanë cituar si vlerësim ajeti.

Po këtë kuptim e shikojmë qartë në hadithin e Imam Ali ibn Musa Err Rida *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[1]

Dëshmi e këtij komentimi është ajeti 33 i sures "En Nahl: **"A mos presin ata gjë tjetër, veç ardhjes së engjëjve apo të urdhrit të Zotit tënd?!"**.

Fjala *"Saffen Saffa"* ka të bëjë me radhitjen në rreshta të ndryshëm të engjëjve në ditën e fundit. Ka mundësi që engjëjt e secilit qiell do të rreshtohen në një rresht të veçantë dhe kështu ata rrethojnë të gjithë njerëzit në Ditën e Gjykimit. Më tej shton: **"Dhe, kur të sillet Xhehennemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç'i duhet se u kujtua!"**. Në atë ditë do të bëjnë gati Xhehennemin dhe në atë ditë njeriu do të kritikohet, por sa vlerë do të ketë kjo, sepse ky qortim nuk do të ketë vlerë.

Nga ky interpretim mund të thuhet se Xhehennemi është i lëvizshëm dhe afrohet te kriminelët. Sikurse thuhet për Xhennetin, në ajetin 90 të sures "Esh Shuarâ". **"Atë ditë Xhenneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm."**.

Edhe pse disa komentues dëshirojnë ta interpretojnë këtë kuptim si figurativ për shfaqjen e Xhennetit dhe të Xhehennemit, përballë këndvështrimit të punëmirëve dhe punëkëqijve, nuk ekziston një argument që të jetë i kundërt apo në kundërshtim me paraqitjen. Do të ishte më mirë që atë ta braktisin me paraqitjen e tij, sepse e vërteta e botës së Kiametit për ne është saktësisht e qartë, po ashtu kushtet që mbizotërojnë atje, me këtu, kanë një ndryshim

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 416.

shumë të madh. Kështu nuk do të kishte kuptim që në atë ditë Xhenneti dhe Xhehennemi të ndërronin vend.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "Kur zbriti ajeti Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet -por ç'i duhet se u kujtua!, ngjyra e fytyrës së tij ndryshoi. Kjo gjendje, për shokët u duk e dhimbshme. Disa prej tyre vajtën pranë Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe i folën për çështjen. Imam Ali *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* shkoi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke e puthur te dy supet, i tha: 'O i Dërguar i All'llahut! Nëna dhe babai im, t'u bëfshin kurban, çfarë ka ngjarë?'

- *Xhebraili më ka lexuar këtë ajet mua,* - tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

- Si do ta sjellin Xhehennemin? – e pyeta të Dërguarin e All'llahut.

- Shtatëdhjetë mijë engjëj me shtatëdhjetë mijë frena do e tërheqin dhe do e sjellin! Kjo gjë do të inspektohet, sepse nëse do e braktisin të gjithë, do i zërë zjarri e më pas unë do të qëndroj përballë Xhehennemit dhe ai do të thotë: 'O Muhammed! Unë s'kam punë me ty! All'llahu ma ka ndaluar mishin tënd.'. Në atë ditë askush nuk mendon për të tjerët, përveç Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që thotë: *'Rab'bi, Ummeti! Ummeti!'* – *'O Zot i im,*

umetin tim, umetin tim![1] - u përgjigj Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*".

Kur një kriminel e shikon këtë gjendje, ai lëviz, zgjohet. Qenien e tij e përshkon trishtimi dhe tkurrja. Ai vështron të kaluarën e tij, bëhet shumë pishman për të, por tashmë asgjë nuk ka më asnjë vlerë.

Njeriu shpreson të kthehet dhe të shlyejë të shkuarën e tij, por dyert e kthimit janë të mbyllura. Ata kërkojnë të pendohen, por koha e pendimit ka kaluar. Ata dëshirojnë të kryejnë punë të pëlqyera, por dosja e tyre është e mbyllur. Kur e shikojnë këtë gjendje, atyre u del nga zemra zëri dhe thonë: **"Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!"**.

Është për t'u habitur se nuk thotë: "Ah sikur të bëj punë të mirë për Ahiretin", por për **"jetën time"**, a thua se fjala *"hajat"* – *"jetë"* nuk është e denjë për Jetën e Përtejme. Po ashtu, jeta kalimtare, e mbushur më lloje të ndryshme pasionesh, në këtë botë, nuk përllogaritet si jetë.

Në ajetin 64 të sures "El Ankebut" lexojmë: **"Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e Botës Tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!"**.

Ata që e konsideruan si plaçkë mallin e jetimit dhe nuk lanë kafshatë për të uriturit, morën mallin nga njëri tek tjetri dhe

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 483. Të ngjashme me këtë kuptim, ose më mirë të përafërt e shikojmë në tefsirin "Durr'rrul Menthur", e përputhur me transmetimin e tefsirit "El Mijzan", vëll. 20, f. 415.

dashuria e tyre e vetme ishte pasuria, këta janë ata që në atë ditë, do të thonë: "Ah, sikur të kishim bërë diçka për Jetën e Përtejme!"

Por kjo dëshirë nuk do të realizohet kurrë.

Më pas, me dy fjali të shkurtra shpjegohet presioni i dënimit në atë ditë: **"Atë Ditë, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai."**. Në atë ditë All'llahu i dënon ata në atë mënyrë të tillë, saqë askush tjetër nuk do të këtë të ngjashëm me dënimin e Tij.

Këta kriminelë, që kur kishin pushtet e fuqi, kryenin krime të këqija dhe mëkatet më të mëdha, në atë ditë do të dënohen aq shumë, saqë nuk do të kenë pasardhës. Ashtu edhe punëmirët do të shpërblehen dhe askush nuk do ta paramendojë mënyrën e shpërblimit, sepse All'llahu është edhe i Gjithëmëshirshëm, edhe Mëshirëbërës, dhe po ashtu është edhe Dënues i madh: **"Askush nuk do të lidhë në pranga siç lidh Ai!"**.

Në atë ditë, askush nuk do të lidhë sikurse lidh në pranga All'llahu.

Askush nuk dënon si All'llahu. E përse të mos jetë kështu? Këta kriminelë janë sjellë keq, kanë lënduar, kanë dhunuar e kanë dënuar njerëz të pafajshëm të All'llahut. Ata sa kanë pasur mundësi dhe fuqi, kanë lidhur e kanë dënuar njerëz me tortura nga më të ndryshmet.

Ajetet 27 - 30

﴿يَا أَيَّتُهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ٢٧ ارْجِعِي إِلَى رَبِّكِ رَاضِيَةً مَرْضِيَّةً٢٨ فَادْخُلِي فِي عِبَادِي٢٩ وَادْخُلِي جَنَّتِي٣٠﴾

"O ti shpirt i qetësuar!"

"Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!"

"Bashkohu me robërit e Mi."

"Dhe hyr në Xhennetin Tim!"

Komentimi

Nderimi madhështor

Pasi u fol për dënimin e tmerrshëm që ka mbërthyer ajkën e kriminelëve dhe adhuruesve të kësaj bote, në Ditën e Kiametit, në vazhdim do të flasim për besimtarët që qëndrojnë përballë tufanit të madh e të rrezikshëm. Këta besimtarët janë të qetë, kanë një botë

me dashuri. All'llahu u drejtohet: **"O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!"**.

Eja pranë Krijuesit, ndërkohë që edhe ti je i kënaqur prej Zotit, edhe Ai është i kënaqur nga ti. **"Bashkohu me robtë e Mi dhe hyr në Xhennetin Tim!"**

Bashkoju me robtë e Mi dhe futu në Xhennetin Tim!

Sa interpretim i bukur, frymëzues dhe udhëzues shpirtëror! Në të buron mirësia, qetësia dhe siguria!

Është ftesë e drejtpërdrejtë e All'llahut, që u bëhet shpirtrave që janë plot me besim e të qetësuar. Thirrja u bëhet, sepse kthimi është tek All'llahu, tek Pronari, Kujdestari dhe Rregulluesi. Ftesa është e mbushur me kënaqësi për të dy palët, kënaqësi e dhënë nga i Dashuruari për të dashurin dhe kënaqësi e të dashuruarit dhe e adhuruesit të vërtetë për të Dashurin.

Në ndjekje të saj vjen kurora e krenarisë së adhurimit dhe krenaria për veshjen e krijesave, si dhe rrugëtimi i të pranishmëve, si dhe dhënia vend pranë Krijuesit.

Më pas, ftohen punëmirët për t'u futur në Xhennet: **"Hyr në Xhennetin Tim!"**.

Kjo tregon se mikpritësi i këtyre miqve është vetëm dhe vetëm Qenia e Shenjtë e Pastër dhe e pashoqe e All'llahut! Sa ftesë e jashtëzakonshme! Sa Mikpritës i jashtëzakonshëm! Sa Mik i jashtëzakonshëm!

Fjala *"en nefsu"* këtu tregon për shpirtin e njeriut. Ndërsa fjala *"mutmein'ne"* kumton qetësinë që vjen në dritën e besimit, sikurse thotë Kur'ani: **"Dijeni se zemrat qetësohen me përmendjen e All'llahut."**.[1]

Ky shpirt ka siguri te premtimi i All'llahut. Gjithashtu, ka siguri në rrugën dhe mënyrën e përzgjedhjes së besimit. Ai është i sigurt, si për fatin, si për fatkeqësitë e kësaj bote. Ai u bën ballë stuhive, ngjarjeve dhe fatkeqësive. Më shumë se kaq, ai është i qetë në gjithë atë tmerr dhe tronditje që do bëhet në Ditën e Kiametit.

Disa komentues janë të mendimit se sifjala: **"kthimi tek Zotit"**, ka për qëllim kthimin te mirësitë, sevapet dhe te mëshira e Tij. Por, është më mirë të thuhet kthim drejt Tij, që do të thotë të zësh vend pranë Krijuesit, kthimi është shpirtëror dhe jo me vendndodhje dhe me trup.

Lind pyetja se kjo ftesë, për t'u kthyer te Zoti, është vetëm për në Kiamet, apo në kohën e dhënies së shpirtit dhe të përfundimit të jetës në këtë botë?

Mënyra dhe stili i përdorur në ajete na thotë se ka të bëjë për Ditën e Kiametit, edhe pse interpretimi i vetë ajetit është absolut dhe i gjerë.

Interpretimi me fjalën *"radijetun"* është për shkak se të gjitha premtimet e shpërblimet të bëra nga All'llahu, kanë ngjashmëri shumë të madhe, saqë as nuk mund të paramendohet. Bujaria dhe mëshira e All'llahut përfshin gjithë gjendjen e tij, saqë bëhet si një pjesë e ngjitur e kënaqësisë dhe e pëlqimit.

[1] Sure "Rrad", ajeti 28.

Interpretimi i fjalës *"mardij'jetun"* është bërë për shkak se ai ka pranuar shokun e vërtetë dhe është i kënaqur me këtë. Një rob me këto cilësi dhe me arritjen në pozitën e kënaqësisë dhe të bindjes së gjithanshme, ka mundur të kuptojë të vërtetën e të qenit rob i All'llahut. Ky rob është prej robëve të veçantë të All'llahut dhe padyshim se për këtë rob nuk ka vend tjetër përveç se Xhenneti.

Në disa komentime thuhet se ky ajet ka zbritur për Hamzan Sejjidu Shuheda[1]. Por duke parë se kjo sure ka zbritur në Mekë, do të thotë se është bërë një lloj krahasimi dhe nuk ka të bëjë me vendzbritjen, sikurse u tha edhe në fillim për Imam Husejnin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*

Është për t'u habitur, sepse në një transmetim të "El Kafij", nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, thuhet se njëri prej shokëve e pyeti: "A është e mundur që besimtari të jetë i kënaqur në momentin që do t'i marrin shpirtin?!"

Ai u përgjigj: *"Jo, për Zotin, në kohën që engjëlli i marrjes së shpirtit vjen për të marrë shpirtin, ai shfaq pakënaqësi. Engjëlli i vdekjes thotë: 'O i dashur i All'llahut, mos u shqetëso! Të betohem në Zot, unë për ty do të jem më bujar se sa është babai për fëmijën e tij, andaj mbylli sytë mirë dhe shiko.'*

Ai i mbyll dhe shikon të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, shikon Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, Fatimen, Hasanin, Husejnin, si dhe imamët që vijnë pas tij *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*.

[1] Zotëria i martirëve

Më pas engjëlli i thotë: *'Shiko, i Dërguari i All'llahut (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), Aliu, Fatimja, Hasani, Husejni dhe imamët pas tij (Paqja e Zotit qoftë mbi ta!) janë shokët e tu.'*.

Ai i hap sytë dhe shikon. Papritur dikush e thërret drejt Zotit: O ti shpirt i qetësuar! – *'O ti që pate siguri te Muhammedi dhe familja e tij! Kthehu drejt Zotit tënd, ndërkohë që ti je i kënaqur me kujdestarinë dhe udhëheqësinë e tyre dhe ai është i kënaqur me punët e tua! Hyr në Xhennet midis robëve të Mi, Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) dhe familjes e tij. Në këtë çast nuk ka gjë më të dashur se kaq për njeriun, që shpirti i tij të ndahet nga trupi sa më parë dhe të bashkohet me thirrësin.'"*[1]

O All'llah! Na bëj krenar ndaj kësaj qetësie dhe na bëj të privilegjuar ndaj kësaj fjalie të madhe!

O All'llah! Të arrish këtë pozitë, nuk është e mundur veçse me kënaqësinë dhe mirësinë Tënde!

O All'llah! Pa dyshim dhe sigurisht që asgjë nuk pakësohet nga bujaria Jote, që ne të na bësh pronarë të sigurt të shpirtit!

O All'llah! E dimë që kjo qetësi nuk kryhet dhe nuk është e mundur përveçse nën hijen Tënde, na bëj prej të suksesshmëve!

Amin! Ja Rabil Alemin!

Fundi i sures "El Fexhr".

1 "El Kafij", vëll. 3, K. "Inel Muminune La Jekrehe Ala Kabdhi Ruhihi", Hadithi 2.

Sure "El Beled"

Zbritur në Mekë

Ajete 20

Përmbajtja e sures "El Beled"

Kjo sure, edhe pse është e shkurtër, mbart të vërteta të mëdha.

1- Në pjesën e parë të saj, pasi citon betimet me plot kuptim, trajton çështjen e rëndësishme të jetës së njeriut në këtë botë, e cila është e mbushur me probleme dhe mundime.

Nga një anë, ajo të përgatit për të shkuar në luftën e problemeve, nga ana tjetër, ajo të mëson se qetësia absolute në këtë botë nuk ekziston, qetësia dhe rehatia absolute ekziston vetëm në Jetën e Përtejme.

2- Në pjesën e dytë trajton një pjesë nga mirësitë më të rëndësishme hyjnore për njerëzit. Më pas flet edhe për mungesën e falënderimit nga ana e këtij njeriu.

3- Në pjesën e tretë të kësaj sureje, njerëzit ndahen në dy grupe: të djathtë dhe të majtë. Jep një pjesë të cilësive dhe veprave të punëve të mira (besimtarët e pastër). Më pas flet për fatin e tyre. Interpretimet e ajeteve të kësaj sureje janë shumë të sakta dhe të prera. Fjalitë janë të shkurtra, por të goditura në shenjë. Forma e ajeteve dhe përmbajtja e saj, tregojnë se kjo sure është mekase.

Mirësitë e leximit të sures "El Beled"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"Ai që e lexon suren 'El Beled', All'llahu e ruan dhe e mbron atë nga hidhërimi i Tij në Ditën e Kiametit."*.[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ai që lexon suren 'El Beled' në namazet e detyruara, në këtë botë do të jetë ndër të pastrit dhe punëmirët më të njohur, ndërsa në Ahiret do të jetë i njohur si person që ka pozitë pranë All'llahut të Madhëruar. Do të jetë ndër miqtë e Profetëve, dëshmorëve dhe të punëmirëve."*.[2]

Përmbajtjen e këtij hadithi e kemi ndjer përgjatë gjithë rrugëtimit tonë në këtë komentim. Sa më tepër të punojë njeriu me Kur'anin, aq më shumë dritë dhe shkëlqim do të ketë në fytyrë, në shpirt dhe në zemër. Ai që nuk e pranon këtë gjë, le ta provojë këtë përvojë.

Duke u bazuar në thellësinë dhe gjerësinë e dijes që përmban Kur'ani i Shenjtë, për ne bëhet i qartë fakti se ne, myslimanët, nuk kemi asnjë mangësi në çështjet, si: njohja me çështjet e besimit, ekonomia dhe shoqëria, ligji e politika. Kur'ani është aq i pasur, në të gjitha çështjet, saqë i përmbush të gjitha nevojat dhe kërkesat tona. Faktikisht në Kur'an është cituar parimi i këtyre çështjeve, si dhe komentimi i tyre nëpërmjet të pastërve (Masumin).

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 490.

[2] Tefsiri "Theuabul A'mal", sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 578.

Ndaj ne nuk kemi nevojë të shtrijmë dorën drejt filozofisë lindore e perëndimore, si dhe te ligjet e tyre. Prijësi i besimtarëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Dijeni! Askush nuk mbetet i varfër, nëse ka Kur'anin dhe askush nuk është i pasur dhe jo nevojtar, nëse nuk e ka atë."*.[1]

I gjithë problemi ynë në këtë çështje është informacioni i paktë dhe njohuritë e pamjaftueshme për këtë burim të madh.

Kur'ani ka mbetur në mesin tonë si një perlë dhe si një thesar i panjohur, të cilit nuk i gjendet vendi. Ne lusim të tjerët, ndërkohë që gjithçka na duhet, e kemi në buzë të detit (Kur'anin).

Një tjetër problem i yni është se ne, duke paragjykuar dhe duke marrë linjën e Perëndimit e të Lindjes, kërkojmë që ajetet e Kur'anit t'i krahasojmë, kjo gjë është e padrejtë për Kur'anin, sepse kjo gjë ne na lë pa njohuri, na ndalon të marrim dijen e vërtetë. Në këtë mënyrë, justifikojmë veten për gabimet që kryejmë.

Shumë myslimanë, Kur'anin e shikojnë si një libër të Shenjtë, që leximi i tij bëhet shkak për marrjen e mirësive, ndërsa të mësuarit përmendësh, bëhet shkak dhe argument për mirësitë.

Ata harrojnë se Kur'ani është një program që duhet vepruar, i gjithë respekti dhe madhështia që Kur'ani mbart, është si rezultat i edukimit që na jep. Nëse shkronjat, fjalët e fjalitë e Kur'anit janë të respektuara, që me patjetër janë të tilla, janë për shkak të qëllimit të rëndësishëm dhe të lartë që Kur'ani përmban. Por me habinë më

[1] "Nehxhul Belaga", Ligjërata 176.

të madhe, një grup e ka harruar qëllimin e vërtetë dhe ka mbetur vetëm tek teksti i tij.

Në shumë vende islame janë ngritur shumë shkolla që u mësojnë përmendësh nxënësve tekstin e Kur'anit. Gjithashtu, shumë dijetarë e recitojnë shumë bukur Kur'anin dhe me shumë kujdes, që të mos u rrëshqasë pa lexuar si duhet asnjë shkronjë. Kur një recitues i Kur'anit e lexon një ajet apo sure Kur'ani, e cila është e shkurtër, me një frymë, të gjithë të pranishmit, thonë "All'llah – All'llah" dhe e përgëzojnë atë, sepse atë lloj recitimi e konsiderojnë si art. Por për sa i përket përmbajtjes së tij, askush nuk thotë, "All'llah – All'llah". Në shumë vende islame nuk zbatohet ligji i tij.

Ne, në këtë tefsir, këtë fjali e kemi përsëritur 114 herë (me sasinë e sureve të Kur'anit). E kemi përsëritur në fillim të sureve, që ajo çka është cituar për mirësitë e leximit të Kur'anit në transmetime dhe në hadithe, është për shkak se ata ta lexojnë atë duke reflektuar dhe duke e vënë në veprim.

Kjo përsëritje e vazhdueshme, që ndoshta, sipas mendimit të disave, është e parregullt, është për shkak se këto mendime të thyhen e njerëzit të kuptojnë se mirësitë e të lexuarit të Kur'anit nuk janë vetëm për leximin, por për leximin që është së bashku me veprën e që Kur'ani të jetë libër që vihet në punë.

Shpresojmë që me përpjekje dhe me mundimin e shumë dijetarëve të Islamit, ne ta realizojmë këtë dëshirë, që të gjithë myslimanët t'i shikojnë ajetet e këtij Libri qiellor si një program për jetën e tyre dhe si një rregull i përgjithshëm për shoqërinë, jetën dhe edukimin e njeriut.

Ajetet 1 - 7

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿لَا أُقْسِمُ بِهَذَا الْبَلَدِ۝١ وَأَنْتَ حِلٌّ بِهَذَا الْبَلَدِ۝٢ وَوَالِدٍ وَمَا وَلَدَ۝٣ لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي كَبَدٍ۝٤ أَيَحْسَبُ أَنْ لَنْ يَقْدِرَ عَلَيْهِ أَحَدٌ۝٥ يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَالًا لُبَدًا۝٦ أَيَحْسَبُ أَنْ لَمْ يَرَهُ أَحَدٌ۝٧﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"Betohem për këtë vend."

"Në të cilin ti je i lirë (o Muhammed)**."**

"Dhe për atë që lind e për atë që është i lindur."

"Se, në të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi!"

"A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi atë?"

"Ai thotë: 'Kam shpenzuar pasuri të pamasë!'"

"Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush?"

Komentimi

Betohem për këtë qytet të shenjtë!

Është në traditën e Kur'anit, që shumë prej çështjeve të rëndësishme, që shpjegojnë dhe transmetojnë një të vërtetë shumë të rëndësishme, të nisin me betim. Betimet, në vetvete, janë shkak i vënies në lëvizje të njeriut, bëjnë që mendja dhe arsyeja e njeriut të jetë në lëvizje. Betimet kanë një lidhje të veçantë me çështje për të cilën flitet.

Ndaj edhe në këtë rast flitet për një të vërtetë të jetës së njeriut, e cila është e mbushur me vuajtje dhe përpjekje. Surja nis me një betim: **"Betohem për këtë vend, në të cilin ti je i lirë** (o Muhammed)**."**.

Edhe pse në këto ajete nuk është përmendur emri i qytetit të Mekës, është e kuptueshme se bëhet fjalë për këtë qytet. Nëse bazohemi në faktin se kjo sure është mekase dhe, nga ana tjetër, në faktin se ky qytet ka një rëndësi të jashtëzakonshme, bëhet e qartë se qëllimi është për Mekën. Shumica e komentuesve janë të mendimit se bëhet fjalë për Mekën.

Po, në të vërtetë, nderi dhe madhështia që kjo tokë përfaqëson, Meka, bën që All'llahu të betohet në të, sepse ajo tokë dhe ai qytet është qendra e parë e Teuhidit dhe e adhurimit të All'llahut. Në këtë vend është ndërtuar për herë të parë vendi i adhurimit. Profetë të mëdhenj i kanë ardhur rrotull këtij vendi të shenjtë.

Ajeti: **"Në të cilin ti je i lirë** (o Muhammed)**."**, flet për një çështje të re dhe thotë se ky qytet ka aq shumë bereqet dhe mirësi, sa e meriton të betohesh për të. Po, e vërteta është e tillë që rëndësia e tokave është e barasvlershme me vlerat e njerëzve që banojnë në ato toka. Kjo është për të sqaruar jobesimtarët e Mekës, që të mos mendojnë se Kur'ani betohet për këtë tokë, për shkak se në të ndodhen statujat e idhujtarëve. Jo, nuk është kështu, këtë madhështi dhe këtë vlerë, ky qytet e ka për shkak të historisë në të kaluarën dhe për shkak se në këtë qytet është krijesa më e pastër mbi tokë e All'llahut, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Një tjetër komentim që i bëhet këtij ajeti është: Unë po betohem për këtë qytet të shenjtë, ndërkohë që ata jo vetëm respektin ndaj teje e kanë dhunuar, por edhe mallin e marrjen e shpirtit tënd e kanë lejuar.

Kjo do të thotë se qortimi është i rëndë ndaj jobesimtarëve Kurejsh, që e konsideronin veten e tyre si shërbyes dhe mbrojtës të Mekës. Ata kishin shumë respekt për këtë tokë, saqë edhe, nëse shikonin vrasësin e babait të tyre në këtë vend, nuk e sulmonin. Ai ishte i sigurt në këtë vend të shenjtë.

Çdokush që merrte lëkurën e pemëve të Mekës dhe e vendoste në trupin e tij, ai ishte i sigurt në këtë qytet. Askush nuk e sulmonte. Sa e çuditshme, gjithë këto tradita e sunete që kishin këta njerëz, si mund të hedhin poshtë traditën e tyre ndaj Profetit Muhammedit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)*?!

Përse ata u sollën kështu me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe me shokët e tij? Si e harruan traditën dhe e lejuan derdhjen e gjakut të tij?!

Ky komentim është cituar, gjithashtu edhe në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[1]

Më pas betohet për babain dhe të birin: **"Për atë që lind e për atë që është i lindur."**.

Sa i përket çështjes se kush është ky "baba" dhe ky "fëmijë" janë cituar komentime të ndryshme.

Së pari, thuhet se fjala *"ualidun"* është për Profetin Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe fjala *"ueledun"* është për Profetin Ismail *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Duke u bazuar te ajeti i mësipërm, që betohej dhe kishte për qëllim qytetin e Mekës, themi se Profeti Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe i biri ishin themeluesit e këtij vendi, pra, qytetit të Mekës. Ky komentim duket shumë i përshtatshëm, për faktin se arabët e kohës së injorancës kishin një respekt të veçantë për Profetin Ibrahim dhe të birin *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*. Ata krenoheshin me ta dhe shumë prej tyre, pemën e brezave të tyre, e lidhnin me ata të dy.

Së dyti, thuhet se bëhet fjalë për Profetin Adem *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe të birin.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 493.

Së treti, mendohet se bëhet fjalë për Profetin Adem dhe Profetët *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* që lindën në dinastinë e tij.

Së katërti, mendohet se qëllimi i betimeve është për cilindo baba dhe cilindo fëmijë, sepse çështja e lindjes dhe e mbijetesës së brezave të njeriut për gjatë jetës, është ndër gjërat e jashtëzakonshme të krijimit, ndaj dhe All'llahu betohet veçanërisht për këtë gjë.

Përmbledhja e këtyre katër komentimeve nuk duket e pamundur, edhe pse komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Më tej flet për një gjë, që tregon qëllimin e fundit të betimit: **"Se, në të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi!"**.

Pa dyshim që Ne njeriun e krijuam në mundim.

Fjala *"el kebed"* sipas Et Tabarsij në veprën "Mexhmaul Bejan", ka kuptimin *"shidet"* – *"intensitet"*.

Por, sipas Ragibit, në librin "Mufredat", fjala *"kebed"* ka kuptimin: *dhimbje*. Ankuesi i dhimbjes është njeriu. Më pas është përdorur për çfarëdolloj mundimi dhe dhimbje. Rrënja e kësaj fjale, sido që të jetë, e ka kuptimin e tanishëm: *mundim* dhe *shqetësim*.

Po, njeriu, që në fillim të jetës, ose më mirë që kur ngjizet në mitrën e nënës, kalon plot peripeci dhe probleme, si dhimbje e mundim, derisa të lindë. Pasi të lindë, nis periudha e foshnjërisë dhe më pas e fëmijërisë, e rinisë dhe pjesa më me probleme është ajo e pleqërisë. Aty njeriu has lloje të shumta problemesh e

mundimesh. Kjo, pra, është natyra e të jetuarit në këtë botë, të presësh të kundërtën e saj, është e gabuar.

Edhe sipas poetit arab është e gabuar:

"Natyrshmëria e kësaj bote

është një zënkë

dhe ti dëshiron të jesh i pastër

nga çfarëdolloj zënke dhe papastërtie?

Kushdo që kërkon të kundërtën e natyrshmërisë së saj,

në këtë botë,

është i ngjashëm me atë

që edhe pse ndodhet

në mesin e dallgëve,

kërkon zjarr."[1]

Nëse vështrojmë jetën e Profetëve dhe të eulijave të All'llahut, shikojmë se jeta e këtyre luleve me plot gjelbërim ka pasur lloje të ndryshme mundimesh, dhimbjesh etj. Kur kjo gjendje, në këtë botë, është e tillë për ata, gjendja e të tjerëve është e qartë.

Nëse shikojmë nga afër persona apo shoqëri që, për nga pamja e jashtme, nuk kanë dhimbje e mundime, ose për shkak të

[1] "Meskenel Feuvad", f. 14.

studimeve janë në të njëjtin nivel me ne, vëmë re thellësinë e mundimit e të dhimbjes së tyre. Pra, ne njihemi me jetën e pasur të këtyre personave. Por kjo gjë është për një periudhë të shkurtër e të kufizuar, sepse ligji i gjithë kësaj bote nuk mund të ndryshojë.

Ajeti tjetër thotë: **"A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi atë?"**.

Kjo tregon se jeta e njeriut, me gjithë atë dhimbje dhe mundim, është argument se ai nuk ka fuqi e as pushtet. Por, ai njeri i ka hipur sipër mendjemadhësisë dhe bën çdo punë që nuk duhet bërë dhe bën mëkate pafund, dhunon dhe bëhet pjesë e dhunës. A thua se vetë ai është i sigurt dhe i mbrojtur?

I duket vetja i përjashtuar nga dënimi i All'llahut. Kur ky njeri qëndron mbi karrigen e pushtetit, e hedh poshtë të gjithë dispozitën dhe rregullat Hyjnore dhe e konsideron veten të përjashtuar nga dënimi. Ky njeri mendon kështu, duke kujtuar se është i liruar nga grepat e dënimit të Zotit. Sa gabim i madh, nëse mendon kështu!

Është dhënë mendimi se të tillë janë të pasurit, sepse ata mendojnë se askush nuk mund ta marrë pasurinë e tyre.

Po ashtu, është thënë se bëhet fjalë për ata persona që besonin se askush nuk u kërkon llogari për veprat e tyre.

Por në të vërtetë, ajeti ka kuptim të gjerë dhe mund t'i përfshijë edhe këto komentime.

Disa të tjerë janë të mendimit se ajeti flet për një burrë nga fisi Xhemeh, që quhej Abul Esed ibn Keldetu. Ai ishte shumë i

fuqishëm. Kur ai ulej në një pjesë lëkure dhe dhjetë persona të tjerë mundoheshin ta lëviznin atë nga lëkura, ose ta rrëzonin, nuk ia arrinin. Lëkura bëhej copa-copa dhe ai nuk lëvizte nga vendi.[1]

Por kjo gjë është e pamundur, sepse ajeti nuk u drejtohet këtyre njerëzve mendjemëdhenj. Kjo gjë është pengesë e përgjithësimit të kuptimit të ajetit.

Në vazhdim të këtij teksti, thotë: **"Kam shpenzuar pasuri të pamasë!"**.

Ky tekst u flet atyre personave që, kur u propozohej për të shpenzuar paratë e tyre për punë të mira e për bamirësi, ata me mendjemadhësi thoshin se kemi shpenzuar shumë në këtë rrugë, ndërkohë që ata nuk kishin shpenzuar asgjë e as nuk kishin falur asgjë në Rrugë të All'llahut. Edhe nëse ata kanë falur nga pasuria e tyre, ajo ka qenë sepse kanë dashur të duken në sy të të tjerëve.

Disa komentues janë të mendimit se ajeti flet për ata persona që paratë e tyre i kanë shpenzuar për t'iu kundërvënë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe për të krijuar armiqësi dhe komplote kundër fesë islame. Kështu ata krenoheshin me pasurinë, me punët e veprat që kryenin.

Në një hadith transmetohet se përgjatë ditëve të zhvillimit të luftës së Hendekut, kur Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* e prezantoi dhe e njohu Amru ibn Abdud me fenë islame, ai u

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 493.

përgjigj: "Ç'do të bëhet me gjithë pasurinë time, të cilën e kam shpenzuar kundër teje?!".[1]

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se ajeti ka për qëllim disa prej udhëheqësve Kurejsh, sikurse ishte El Harth ibn Amir, i cili kishte mëkatuar dhe për të gjetur rrugëdalje kishte shkuar te Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e urdhëroi që të japë sadaka një sasi parash.

Ai tha se, që kur jam futur në fenë islame, paratë e mia po shkojnë vetëm për bamirësi dhe për ndihmë.[2]

Përmbledhja e tre komentimeve bëhet pa pengesë, edhe pse komentimi i parë është më i përshtatshëm me ajetin që vjen prapa.

Folja *"ehleketu"* flet për pasurinë e tij, e cila po mbaron, ndërkohë që për atë pasuri nuk merr përqindje.

Fjala *"lubed"* ka kuptimin e një gjëje të grumbulluar e të shumtë. Në këtë rast, ka kuptimin e pasurisë së shumtë.

Më tej shton **"Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush?"**.

Ai është i pavetëdijshëm për këtë të vërtetë, që All'llahu nuk shikon vetëm veprat që i kryen për sy e faqe, por i shikon të gjitha veprat, kur ai është vetëm dhe me të tjerë. All'llahu është në dijeni të të gjitha veprave dhe ndjesive që ai ka në thellësi të zemrës. All'llahu është në dijeni të nijeteve të tij. Si mundet që Zoti, që me

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 10, f. 580.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 493.

dijen e Tij përfshin çdo gjë, të mos dijë e të mos ketë dijeni për zemrat e njerëzve?!

Këta të pavëmendshëm janë të paditur. Ata mendojnë se, meqë janë vetë injorantë, nuk janë nën vëzhgimin e përhershëm të All'llahut.

All'llahu e di se nga vijnë këto para e mallra, si dhe për çfarë dhe në ç'rrugë shpërdorohen.

Në një hadith të Ibn Abasit transmetohet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Në Ditën e Kiametit, asnjë krijesë nuk hedh asnjë hap pa u pyetur për katër gjëra: së pari, si e ka kaluar rininë e tij, në ç'rrugë? Si e ka grumbulluar pasurinë? Në ç'rrugë e ka shpenzuar? Çfarë veprash ka kryer? Dhe së fundi, do të pyetet për dashurinë që ka pasur për Ehli Bejtin!"*.[1]

Me pak fjalë: Si mundet ky njeri të bëhet mendjemadh dhe të pretendojë se është i fuqishëm, ndërkohë që jeta e tij është e mbushur me dhimbje e mundime? Nëse ka pasuri, ajo është për natën dhe, nëse ka shpirt, ai është për ethe.

Përveç kësaj, si mund të pretendojë njeriu e të thotë se ka shpenzuar shumë për hir të All'llahut, ndërkohë që All'llahu është në dijeni të nijeteve të tij? All'llahu është në dijeni të cilësisë dhe si janë fituar ato para, si dhe si janë shpenzuar ato para, me mendjemadhësi.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 494; kuptim të ngjashëm hasim edhe në tefsirin "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 435.

Ajetet 8 – 10

﴿أَلَمْ نَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ٨ وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ٩ وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ١٠﴾

"A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy?"

"Edhe gjuhë, edhe dy buzë?"

"Dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?"

Komentimi

Mirësia e syrit e gjuhës dhe e udhëzimit

Ajetet e kaluara flisnin për mendjemadhësinë dhe pavëmendjen e njeriut rebel, këto ajete tregojnë për një pjesë shumë të rëndësishme të mirësive materiale dhe shpirtërore të njeriut, që, në këtë mënyrë, mendjemadhësia dhe pavëmendja e tij të thyhet.

Nga ana tjetër, e fton njeriun të mendojë për Krijuesin e këtyre mirësive, duke i nxitur ndjesinë e falënderimit e njëkohësisht e drejton atë drejt njohjes së Krijuesit.

Së pari, thotë: **"A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë, dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?"**

Në këto tri fjali të shkurtra janë trajtuar tri prej mirësive shumë të rëndësishme që All'llahu i ka falur njeriut. Të gjitha këto janë nga madhështitë dhe mirësitë e All'llahut. Mirësia e syve, e gjuhës dhe e buzëve është e pakrahasueshme dhe e paarritshme për njeriun.

Nga ana tjetër, vendoset mirësia e udhëzimit për të mirën dhe të keqen.

Kini parasysh se fjala *"en nexhedu"*, në origjinal, ka kuptimin e një vendi të lartë. E kundërta e saj është fjala *"et tehametu"*që ka kuptimin e tokës së ulët. Në të vërtetë, të dyja këto kanë për qëllim shpjegimin e të mirës dhe të keqes.[1]

Për sa u përket mirësive të mësipërme, është e mjaftueshme të thuhet vetëm kaq, që: sytë, janë mjeti më i rëndësishëm i njeriu në mënyrë që të krijojë marrëdhënie me botën e jashtme. Mrekullitë e syrit janë në lartësinë më të madhe, saqë njeriu përballet me një mrekulli të Krijuesit të tij. Shtatë shtresat e syrit, të quajtura si më poshtë; lekura, konjuktiva,sklera, kornea,irisi, kristalini (korpus vitrium ose trupi qelqor) dhe retina. Çdo shtresë ka përbërje të habitshëm, të hollësishme dhe magjepsëse,ku është ruajtur në

[1] Ky komentim është marrë nga një hadith i Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Disa të tjerë janë të mendimit se bëhet fjalë për gjoksin e nënës. Ky mendim duket i pasaktë. Pra, fjala *"en nexhedu"*, ka kuptimin e të mirës për shkak të madhështisë. Ndërsa e keqja vjen për shkak të përparësisë që ka.

mënyrën më të saktë ligji fizik dhe kimik, i reflektimit dhe pasqyrimit të dritës.

Sytë janë ndërtuar në mënyrë të tillë, saqë çdo aparat fotografik para tyre është i pavlerë. Në të vërtetë, nëse në të gjithë botën, përveç njeriut dhe përballë gjithë qenies së njeriut, nuk do kishte tjetër përveç syrit, atëhere, studimi i këtij organi do të mjaftonte për të njohur dijen dhe plotfuqinë e All'llahut.

Përsa i përket "gjuhës", ky organ është mjeti më i rëndësishëm në lidhjet e njeriut me llojin e tij. Përcjellja e dijes, e informacionit nga një popull te një tjetër popull, nga një brez te një tjetër brez, gjithashtu, bëhet nëpërmjet gjuhës. Nëse nuk do të ishte ky instrument lidhës, njeriu asnjëherë nuk do të mund të promovonte dijen, kulturën dhe çështjen shpirtërore.

Buzët, së pari, kanë një rol ndikues në të folur, sepse shumë prej ndarjeve të shkronjave bëhet nëpërmjet buzëve. Buzët ndihmojnë shumë për të përtypur ushqimin, ruajnë lagështinë e gojës, ndihmojnë për të pirë etj. Nëse nuk do të ekzistonte ngrënia dhe pirja, njeriu do ta kishte të pamundur dhe shumë të vështirë për të jetuar. Gjithashtu, njeriu nuk do të mund të shqiptonte shumë prej shkronjave, pështyma e gojës do t'i kullonte dhe do të dukej shumë keq.

Perceptimi i të vërtetës në prizmin e parë, bëhet me sy dhe me gojë.

Në ndjekje të asaj që u citua më lart, do të flasim për ekzistencën e arsyes dhe udhëzimin racional natyror.

Interpretimi i ajetit ka për qëllim "udhëzimin legjislativ", i cili kryhet nëpërmjet Profetëve dhe eulijave.

Zoti i ka dhënë njeriut të parët, i ka shpjeguar Rrugën e Drejtë dhe të gabuarën, që në këtë mënyrë, të mund të kuptojë të drejtën.

Me gjithë këto llamba që lëshojnë dritë e që janë vendosur për të ndriçuar Rrugën e Drejtë, si mund të themi për ata që shkojnë në të kundërtën e dritës?! Për ata mund të themi vetëm: Lëri që të bien dhe të shikojnë ndëshkimin e tyre!

Fjalia: **"Ne e kemi njoftuar atë për Rrugën e Drejtë dhe të padrejtë"**, përveçse flet për faktin se çështja e vullnetit dhe e lirisë është në dorën dhe vullnetin e vetë njeriut, tregon edhe anën tjetër të medaljes, se fjala "*nexhed*" ka kuptimin e një vendi të lartë, ku tregon se, nëse duam të ndjekim Rrugën e Drejtë, nuk do të thotë se nuk do të përballemi me probleme, mundime e vuajtje.

Sikurse u citua edhe më lart, edhe toka e lartë ka probleme, po ashtu edhe ata që ndjekin rrugën e padrejtë kanë probleme. Sa mirë do ishte që njeriu, me përpjekje dhe mund, të përzgjedhë Rrugën e Drejtë.

Por në të njëjtën kohë, përzgjedhja e rrugës është nga vetë njeriu. Ai nëpërmjet syve e gjuhës, mund të përzgjedhë Rrugën e Drejtë, hallall, ose atë të padrejtë, haram. Në këtë mënyrë, mund të përzgjedhë cilën rrugë do të mbajë.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"All'llahu i Madhëruar i thotë djalit të Profetit Adem (Paqja e Zotit qoftë mbi të!): 'O bir i Ademit! Nëse gjuha ty të shtyn të bësh haram, Unë ty të kam dhuruar*

dy buzë që ta parandalosh atë, mbaj buzët mbyllur. Nëse janë sytë ata që të shtyjnë ty drejt haramit, Unë të kam dhuruar ty qepallat, që t'i mbyllës ato!'".[1]

Kështu, pra, All'llahu i ka vendosur njeriut mjetet e kontrollit të këtyre mirësive të mëdha, që është një tjetër mirësi e All'llahut për robtë e Tij.

Është e habitshme se ajetet e mësipërme flasin për gjuhën, që në të vërtetë lë të kuptohet se flet për buzët, ndërsa për sa u përket syve, nuk është lënë të kuptohet se flitet për qepallat. Kjo gjë ka ndodhur për dy arsye.

Arsyeja e parë është sepse roli i buzëve është për të folur, për të ngrënë, dhe mënyra të tjera, ndërkohë që qepallat janë vetëm për sytë.

Arsyeja tjetër është se kontrolli i gjuhës për fatin e njeriut është më i rëndësishëm se sa kontrolli i syve.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 581.

Hulumtime

1- Mrekullia e syrit

Sytë zakonisht i krahasojmë me një aparat fotografik, që me lente shumë delikate fotografojnë skena të ndryshme. Fotografitë fotografohen nga vetë syri e më pas, nëpërmjet nervit të të parit, transferohen te truri.

Ky aparat është jashtëzakonisht delikat dhe i saktë. Përgjatë gjithë ditës e natës ai mund të fotografojë me mijëra foto dhe skena të ndryshme. Ky aparat nuk mund të krahasohet me asnjë aparat tjetër që mund të jetë edhe më i përparuari apo me çdo aparat tjetër fotografik dhe filmues, sepse:

a- Rregullimi i valvulave të dritës të (diafragmës) në këtë pajisje, që është bebja e syrit, ndryshon pamje vetvetiu përballë dritës. Kur drita është më e fortë, bebja e syrit zvogëlohet dhe, kur drita është e dobët, bebja e syrit zmadhohet. Ndërkohë që aparati fotografik duhet të ndryshojë nëpërmjet dorës sonë apo sipas gradimit që ne i bëjmë.

b- Objektivi i syrit, në kundërshtim me të gjithë objektivët e aparaturave fotografike që janë përdorur nga fotografët, duhet të ndërrohen për të fotografuar sipas distancës. Për shembull ndonjëherë objektivi është 1/5 milimetër dhe ndonjëherë 8 milimetër, kjo lëvizje milimetrike bëhet për shkak se objektivi duhet të rregullohet në atë mënyrë që të mund të fotografojë edhe nga afër, edhe nga larg.

Te syri, kjo lëvizje dhe ky sistemim kryhet nëpërmjet muskujve që janë të vendosur anash objektivit. Kjo gjë bëhet në mënyrë të tillë, saqë një objektiv i syrit kryen në vetvete punën e qindra objektivëve.

c- Ky aparat fotografik lëviz në katër drejtime të ndryshme dhe nëpërmjet muskujve të syrit, mund të lëvizë nga cilado anë që dëshiron të fotografojë.

ç- Një tjetër shënim i rëndësishëm, në këtë rast, është se në aparatet fotografike duhet të ndërrohen filmat dhe, kur një shirit filmi mbushet, duhet të hiqet e të zëvendësohet, ose në aparaturat dixhitale ka një limit fotosh. Por tek sytë e njeriut kjo gjë nuk ndodh. Ata fotografojnë përgjatë gjithë jetës së tyre, pa ndryshuar asgjë. Kjo gjë ndodh, sepse në pjesën e retinës së syrit, ku fotot reflektohen në të, janë dy qeliza, konike dhe cilindrike, që kanë një material shumë të ndjeshëm përballë dritës. Këto qeliza, me pak dritë, vihen në punë e më pas krijohen disa dallgë që transferohen te truri e më tej shikohet ndikimi i tij. Në këtë mënyrë, retina e filmimit vihet në punë përsëri.

d- Aparatet filmike janë të ndërtuara nga substanca shumë të forta, ndërkohë që aparati fotografik i syrit të njeriut është ndërtuar nga substanca shumë delikate dhe të buta. Ato, me një gjë më të vogël, shkatërrohen, ndaj për këtë shkak janë të ruajtura midis kockash shumë të forta. Por syri, në të njëjtën kohë, që është delikat dhe i butë, është i përbërë nga një qëndrueshmëri e lartë e hekurit dhe e çelikut.

dh- Çështja e sistemimit të dritës për fotografët dhe filmuesit është shumë e rëndësishme, sepse që fotot të dalin të qarta, fotografët qëndrojnë me orë të tëra për të sistemuar dritën. Ndërkohë që syri, në çdo kohë e gjendje, ka dritë të fortë, si afër, si larg, ashtu edhe në errësirë. Syri fotografon edhe në errësirë, mjafton që të ketë pak dritë. Kjo pra është prej mrekullive të syrit.

e- Ndodh që ne vendosemi nga drita në errësirë dhe nga errësira në dritë, ose ndodh që një një çast të fiken dritat. Në atë çast, ne nuk shikojmë asgjë, por me kalimin e disa çasteve, sytë tanë vetvetiu mësohen me atë dritë të dobët. Kështu, pak nga pak, sytë tanë mësohen me errësirën dhe shikojnë edhe më tepër sendet që ndodhen përreth. Ne gjithmonë e përdorim këtë shprehje: "*U mësuan sytë me errësirën*". Kjo shprehje del lirshëm nga goja e njeriut. Rezultati i këtij mekanizmi që është vendosur tek syri, është shumë kompleks. E njëjta gjë ndodh kur dalim nga errësira në dritë. Në fillim sytë tanë nuk e durojnë dritën, por, pas disa sekondash, sytë tanë ambientohen. Këto çështje nuk ndodhin kurrë tek aparati filmik.

ë- Aparaturat filmike mund të filmojnë nga hapësira të kufizuara, ndërkohë që sytë e njeriut nuk e kanë këtë kufizim. Me fjalë të tjera, ne mund të shikojmë 180 gradë rreth e përqark, ndërkohë që asnjë aparat fotografik nuk është i tillë.

f- Ndër çështjet e çuditshme dhe të habitshme janë dy sytë e njeriut, që secili prej tyre ka një aparat të pavarur. Ata janë sistemuar dhe programuar në mënyrë të tillë, që secili prej tyre bie në një pikë. Nëse ky program do të prishet pak, atëherë njeriu me dy sytë e tij do të shikonte dy trupa.

g- Një tjetër pikë është se të gjitha skenat që syri i fotografon, kalojnë në retinën e syrit, me kokë poshtë, ndërkohë që ne nuk shikojmë asgjë me kokë poshtë. Kjo gjë ndodh për shkak se syri duhet të mësohet dhe të ruajë lidhjen e gjërave me njëra-tjetrën.

gj- Syri duhet të qëndrojë vazhdimisht i lagësht, sepse, nëse ndodh që syri të qëndrojë i thatë për disa orë, ai dëmtohet shumë. Kjo lagështi krijohet vazhdimisht nga gjëndrat e lotëve. Ato futen brenda syrit nga një anë dhe dalin nga syri nëpërmjet venave shumë të holla që janë vendosur në cep të syrit. Më pas lotët kalojnë te hunda dhe atë e mbajnë, po ashtu, të lagësht. Atëherë do të na rrjedhin lotët vazhdimisht

Nëse gjëndrat e lotit do të thahen, atëherë kjo gjë do të ishte e rrezikshme, sepse qepallat nuk do të mund të lëviznin dhe, nëse do të aktivizoheshin më shumë se sa duhet, atëherë do të na rrjedhin lotët vazhdimisht. Nëse rruga e hollë e daljes së lotit do të mbyllej, ne duhet vazhdimisht të mbanim një pecetë, që të thajmë lotët që na dalin. Kjo gjë do të ishte shumë e mërzitshme për njeriun.

i- Përzierja e lotëve, është një përzierje e ngatërruar, sepse është e përbërë më shumë se prej dhjetë elementesh. Këto elemente janë më të mirat dhe më të përshtatshmet burime për ruajtjen e syrit.

Me pak fjalë, mrekullia e syrit është aq e madhe, saqë duhen ditë të tëra të ulesh e të flasësh, si dhe të shkruash, e si rezultat, me të gjitha këto, burimi kryesor i tyre, për të cilin ne mendojmë, është afërsisht një pjesë dhjami, asgjë më shumë.

Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, në një nga fjalimet e tij, thotë: *"E habitshme që ky njeri shikon me një copë dhjami, flet me një copë mishi, dëgjon me një kockë dhe merr frymë nga një pjesë e çarë! Këto punë të mëdha të jetës kryhen me këto mjete të vogla."*.[1]

2- Çudirat e gjuhës

Edhe "gjuha", në radhën e saj, konsiderohet si një ndër pjesët dhe gjymtyrët më të habitshme të trupit të njeriut. Ajo mbart mbi supet e saj detyra shumë të rëndësishme. Përveç faktit që ndihmon shumë në tretjen e ushqimit, gjithashtu, ka një rol të rëndësishëm dhe në përtypjen e tij. Gjuha ndihmon që kafshatat e ushqimit t'i vendosë poshtë dhëmbëve, në mënyrë që ata t'i përtypin. Këtë funksion ajo e kryen aq mirë dhe me një njohuri të paparë, saqë veten e saj e ruan që të mos kafshohet nga dhëmbët. Edhe pse ajo vazhdimisht është e ngjitur me dhëmbët, kujdeset që të mos dëmtohet.

Ndonjëherë na ka ndodhur të gjithëve që nga pakujdesia kemi kafshuar gjuhën. Nga dhimbja kemi ulëritur sa s'ka më. Nga kjo kuptojmë se, nëse gjuha nuk do ta kishte këtë zhdërvjelltësi, çfarë do të kishte ngjarë me ne?!

Gjuha, gjithashtu, pasi ne ushqehemi, pastron të gjithë gojën në mënyrë të përpiktë. Ndër të gjitha këto punë të rëndësishme që gjuha i kryen, është edhe çështja e të folurit.

[1] "Nehxhul Belaga", Kalemat Kisar, Hikmeti 8.

Është e habitshme që All'llahu i ka vënë njeriut në dispozicion për të folur një mjet që është shumë i rehatshëm dhe i thjeshtë. Nuk sjell lodhje, nuk sjell mërziti dhe nuk ka shpenzime.

Por më e habitshme se kaq për gjuhën, është kapaciteti i të folurit të njeriut. Njeri mund të formojë fjali të shumta dhe të jashtëzakonshme, për të interpretuar apo për të shpjeguar vende të ndryshme.

Një tjetër kapacitet i gjuhës është edhe lidhja e fjalive të ndryshme që ekzistojnë në saje të studimit të mijërave gjuhëve që ekzistojnë në këtë botë. Në të vërtetë, madhështia e saj është e qartë.

3- Udhëzimi i dy rrugëve

Fjala *"en nexhedu"*, sikurse e kemi thënë, ka kuptimin "lartësi", ose "tokë e lartë". Në këtë rast, ka për qëllim Rrugën e Drejtë dhe atë të padrejtë. Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"O njerëz! Ekzistojnë dy lloje tokash, një tokë që është e mirë dhe një tokë që është sherr. Për ju nuk është kurrë më e dashur toka që është konsideruar si sherr."*.[1]

S'ka dyshim se "detyrat" dhe përgjegjësitë janë të pamundura, nëse nuk kemi njohuri. All'llahu, në përputhje me ajetin e mësipërm, këtë njohuri e ka lënë në dorë të njeriut.

Kjo njohuri merret nëpërmjet tri mënyrave:

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 494; Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7155.

- Nëpërmjet shqisave të mendjes dhe argumentit.
- Nëpërmjet dijes së lindur dhe natyrës, pa pasur nevojë për argument.
- Nëpërmjet Shpalljes dhe mësimeve të Profetëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* dhe eulijave.

Ajo çka i nevojitet njeriut për të përzgjedhur rrugën e përsosmërisë, është përzgjedhja e njërës prej këtyre tri mënyrave që All'llahu ka përcaktuar dhe ia ka mësuar atij.

Në një hadith është thënë se përzgjedhja apo ndjekja e njërës prej këtyre mënyrave apo rrugëve, sipas natyrës së njeriut, nuk është më e lehtë se sa tjetra. Në të vërtetë, njeriu përzgjedh më me kënaqësi dhe më me lehtësi rrugën e sherrit.

Nëse nuk do ishin edukimet e gabuara dhe mjediset e korrupsionit, dashuria dhe dëshira e njeriut për të mirën do të ishte edhe më shumë. Ndoshta edhe interpretimi me fjalën *"en nexhedu"* – *"tokë e sheshtë"*, *"e mirë"*, është për këtë arsye, sepse këto toka të buta dhe të mira kanë ajër dhe natyrë më të mirë.

Disa komentues janë të mendimit se ky interpretim flet për shfaqjen dhe qartësinë që ka Rruga e Drejtë dhe e padrejtë. Kjo gjë është e qartë edhe te toka e sheshtë dhe e butë.

Ajetet 11 – 20

﴿فَلَا اقْتَحَمَ الْعَقَبَةَ١١ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ١٢ فَكُّ رَقَبَةٍ١٣ أَوْ إِطْعَامٌ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ١٤ يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ١٥ أَوْ مِسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ١٦ ثُمَّ كَانَ مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ١٧ أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ١٨ وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا هُمْ أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ١٩ عَلَيْهِمْ نَارٌ مُؤْصَدَةٌ٢٠﴾

"Atëherë, le të ndjekë rrugën e vështirë!"

"E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është rruga e vështirë?"

"Ajo është të lirosh një skllav,"

"ose të ushqesh në një ditë zie,"

"jetimin e afërm,"

"ose të varfrin e mjerë."

"Veç kësaj, (njeriu duhet) **të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe e këshillojnë për mëshirë."**

"Këta janë njerëzit e krahut të djathtë."

"Ndërsa ata që i mohojnë Shpalljet Tona, ata janë njerëzit e krahut të majtë."

"Mbi ata do të jetë zjarri i mbyllur."

Komentimi

E vështira!

Në vazhdim të citimit të mirësive të mëdha që u përmendën në ajetet e mësipërme, do të diskutojmë e do të trajtojmë një tjetër temë për ata që nuk falënderojnë e që janë vendosur në krye të qortimit dhe të fajësimit. Ata, duke pasur kaq shumë mjete për të qenë fatlumë, nuk arrijnë të përzgjedhin rrugën e shpëtimit. All'llahu thotë: **"Atëherë, le të ndjekë rrugën e vështirë!"**.[1]

[1] Në pamje të parë, *"lami"* në këtë fjali është mohues dhe lajmërues, ndaj dhe shkaku që disa komentues atë e kanë marrë me kuptimin mallkim është i papranuar. I vetmi problem që shikohet këtu është se *"lami"*, kur vjen mbi foljen *e kohës së shkuar,* ndonjëherë përsëritet, sikurse është përsëritur edhe në ajetin 31 të sures "Kiamet": **– "as është falur e as ka dhënë sadaka"**, ndërkohë që në ajetin që po diskutojmë, nuk është përsëritur.
I ndjeri Tabrisi, në tefsirin e tij "Mexhmaul Bejan", shkruan se ky term ndonjëherë përdoret edhe pa u përsëritur.
Ndërsa Fakhru Rrazij dhe Kurtubij, në tefsiret e tyre, kanë cituar disa nga letrarët e mëdhenj arabë, që thonë se, nëse *"lami"* ka kuptimin *"lem"*, përsëritja nuk është e nevojshme.

Kuptimin e fjalës *"el akabetu"* e shpjegojnë dhe e komentojnë ajetet e mëposhtme.

Më pas thotë: **"E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është rruga e vështirë? Ajo është të lirosh një skllav, ose të ushqesh në një ditë zie jetimin e afërm, ose të varfrin e mjerë."**.

Në këtë mënyrë shpjegohet pakënaqësia e njerëzve që asnjëherë nuk janë të gatshëm që ta lënë atë. Kjo është një përmbledhje e punëve të mira, që, në përgjithësi, është e lidhur rreth boshtit të shërimit të njeriut, si ndihma ndaj nevojtarit, të pamundurit. Gjithashtu flitet për besimin e drejtë dhe të sinqertë, që u citua në ajetet e mësipërme.

Në të vërtetë, nuk është aspak punë e lehtë që njeriu të kalojë këtë sprovë, sikurse është dëshira e tij për të pasur para e pasuri.

Feja islame dhe besimi nuk arrihen duke pretenduar, por përballë çdo personi mysliman dhe besimtar vështirësitë janë kalimtare, që njeriu duhet t'i kalojë ato me ndihmën dhe fuqinë e Zotit, si dhe me shpirtin dhe sinqeritetin.

Disa komentues, fjalën *"el akabetu"* e kanë komentuar si egon e shpirtit, që xhihadi me të, sipas Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është konsideruar si Xhihadi i madh.

Në të vërtetë, nëse bazohemi në kuptimin e ajeteve që *"akabeh"* është komentuar, qëllimi i ajeteve të mëposhtme është të tregojë që vështirësia kryesore është ajo e egos, ndërsa të liruarit dhe ndihma ndaj të varfërve dhe nevojtarëve ka për qëllim luftën me egon.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"el akabetu"* tregon vështirësinë në Ditën e Kiametit, sikurse është transmetuar në hadithin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Përballë jush ndodhet një vështirësi që nuk kalohet kollaj dhe unë dëshiroj që këtë barrë tua lehtësoj nga kjo vështirësi."*.[1]

Ky hadith i transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është transmetuar për ajetin që po flasim, por komentuesit e kanë marrë me këtë kuptim, për shkak të komentimeve që janë dhënë fill pas ajetit. Ndaj dhe për këtë shkak, komentimi nuk është i përshtatshëm, vetëm, nëse qëllimi të jetë për vështirësitë në Ditën e Kiametit dhe kalimin e tyre nga kjo botë.

Në këtë rast, interpretimi i fjalës *"ikteheme"*, e cila vjen nga rrënja e fjalës *"el iktihamu"*, që në origjinal ka kuptimin e futjes në punë të vështirë dhe të frikshme,[2] ose futja apo kalimi nga një ashpërsi apo vështirësi,[3] tregon se kjo vështirësi nuk kalohet aq lehtë.

Gjithashtu, thekson faktin e asaj që cituam në fillim të sures, se njeriu do të vuajë dhe do të ketë vështirësi, pra, edhe jeta e tij është e kombinuar me vuajtje.

Gjithashtu, edhe bindja ndaj Zotit është e kombinuar me probleme.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 495.
[2] "Mufredat Ragib".
[3] Tefsiri "Kesh'shaf"

Në një fjalim të Amirul Mu'minin, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Xhenneti është i rrethuar me fatkeqësi, ndërsa Xhehenemi është i rrethuar me epshet."*.[1]

Në ajetin tjetër, në vazhdim të komentimit të vështirësive, thotë: **"Veç kësaj,** (njeriu duhet) **të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe e këshillojnë për mëshirë."**.

Ata që i kalojnë këto vështirësi, janë besimtarët që kanë moral të lartë, ftojnë të tjerët në besim dhe në durim, janë dashamirës, kryejnë vepra të mira, sikurse është lirimi i robërve, ushqyerja e jetimëve dhe e nevojtarëve, etj.

Me fjalë të tjera, ata që i kalojnë këto vështirësi dhe dalin ballëlartë nga ato, janë ata që janë besimtarë, me moral të lartë.

Interpretimi me fjalën *"thum'me"* nuk është gjithmonë me kuptimin e shtyrjes së kohës. Nevoja e kësaj bisede apo fjale është ushqyerja dhe falja dhe më pas besimi. Por në të tilla raste, sikurse e kanë cituar edhe një numër komentuesish, është për të shpjeguar edhe më mirë pozitën, sepse sigurisht që grada e besimit dhe këshilla për durim dhe qetësim është më lart se sa ndihma për nevojtarët. Sigurisht që veprat e mira e kanë burimin nga besimi dhe rrënja e të gjithë atyre mirësive duhet kërkuar te besimi dhe karakteri i lartë.

Disa komentues, gjithashtu, janë të mendimit se fjala *"thum'me"*, në këtë rast, ka kuptimin e kohë vonesës, sepse punët e mira dhe veprat e mira bëhen shkak i burimit të besimit, ose me

[1] "Nehxhul Belaga", Ligjërata 176.

fjalë të tjera, bëhen shkak që njeriu të ndërrojë drejtim. Kjo gjë është shumë frytdhënëse, kur është e lidhur me parimet e moralit, sepse humori i njeriut, së pari, është i lidhur me pamjen e tij të parë, pra, të tanishme dhe më pas me gjendjen e rastit. Pasi kalon këto gjendje, përshtatet, pasi përshtatet, del në pah si mbret.

Fjala "*tauasua*" ka kuptimin e porositjes së njëri–tjetrit. Një tjetër pikë e rëndësishme e saj janë çështjet e durimit dhe të qëndrueshmërisë drejt Rrugës së bindjes ndaj Krijuesit, luftës me egon, përforcimin e dashurisë dhe mëshirës. Të gjithë këta persona i porosit për respektimin dhe ruajtjen e këtyre parimeve, që nëpërmjet kësaj rruge të forcohet lidhja dhe barazia midis njëri-tjetrit.

Disa janë të mendimit se fjala "*sabr*", në këtë rast, flet për durimin dhe për bindjen ndaj All'llahut, si dhe për mëshirën e All'llahut. Ndërsa fjala "*merhamet*" flet për dashurinë në lidhje me krijesat dhe Krijuesin, sikurse edhe e dimë që baza kryesore e fesë ka të bëjë me Krijuesin dhe krijesat.

Ndaj sigurisht që durimi dhe qëndrueshmëria e kanë rrënjën e tyre kryesore te bindja, robëria dhe te braktisja e mëkatit.

Në fund të këtyre cilësive, paraqet pozitën e atyre që kanë këto cilësi, duke thënë se ata janë prej të djathtëve: **"Këta janë njerëzit e krahut të djathtë."**.

Njerëzit e krahut të djathtë u jepet libri i veprave të tyre në dorën e djathtë, sepse kanë kryer vepra të mira që janë pranuar tek All'llahu i Madhëruar.

Është dhënë mendimi se fjala *"mejmene"* vjen nga rrënja e fjalës *"jemen"*, me kuptimin: *bereqet*, që do të thotë se ata janë pronarë të bereqeteve. Qenia e tyre ka bereqet për vetë ata dhe për shoqërinë.

Më pas del te grupi tjetër, që nuk arriti t'i kalojë këto vështirësi: **"Ndërsa ata që i mohojnë Shpalljet Tona, ata janë njerëzit e krahut të majtë."**.

Kjo gjë tregon se duart e tyre janë bosh, nuk kanë kryer mirësi e as vepra të mira, ndaj dhe libri u vjen atyre në të majtë.

Fjala *"mesh'emeh"* vjen nga rrënja *"sheum"*, që ka kuptimin: *ogurzi, i pashpresë*. Fati i tyre bëhet shkak i fatkeqësive të vetë atyre, si dhe i shoqërisë. Ata fatzinj do të njihen në Kiamet, sepse libri i veprave të tyre do të vijë nga krahu i majtë. Disa e kanë komentuar kështu, pra, nga krahu i majtë, sepse fjala *"sheum"*, në fjalor, anon edhe në të majtë.[1]

Në ajetin e fundit të kësaj sureje flitet shkurtimisht dhe me plot kuptim për dënimin e grupit të fundit: **"Mbi ata do të jetë zjarri i mbyllur."**.

Fjala *"musede"* vjen nga rrënja e fjalës *"isad"* dhe ka kuptimin: *mbyllje e derës dhe forcim i saj*. Është e qartë, edhe pa u thënë, se njeriu, kur gjendet në një dhomë të mbyllur, ku ajrin e ka të nxehtë, dëshiron ta hapë derën, për t'u ajrosur. Tani mendoni në atë zjarr përvëlues, ku të gjitha dyert janë të mbyllura, si do të jetë gjendja?!

[1] Tefsiri "Abul Fetuh Razi", vëll. 12, f. 97 dhe " El Munxhid", Rrënja " Sheum".

Hulumtime

1- Fjala *"fek rakhabe"* ka kuptimin: *lirim i skllevërve*

Në një hadith është transmetuar se një arab shkoi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe tha: "O i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi ty dhe mbi familjen tënde!)* më mëso një vepër të mirë, me të cilën të hyj në Xhennet.".

- Edhe pse fole shkurt, mesazhin e përcolle. Liro skllav dhe këpute litarin e skllavërisë, - i tha i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi ty dhe mbi familjen tënde!)*.

- A nuk është e njëjta gjë si të lirosh një skllav dhe si të presësh litarin e skllavërisë?- pyet arabi.

- Jo, qëllimi për të parin është që ti, drejtpërdrejt, liron një skllav, ndërsa te rasti i dytë, të ndihmosh duke paguar një çmim për të, derisa ta lirosh.

Mbaj lidhjet me të afërmit e tu, edhe pse ata janë larguar nga ti dhe bëju mirësi atyre. Nëse nuk është e mundur kjo gjë, atëherë ushqe të uriturit dhe jepu të pinë të eturit, zbato urdhrat e udhëheqësit besimtar dhe largoju nga jobesimtari. Nëse nuk e bën edhe këtë gjë, pra, nuk ke mundësi, të paktën mbaje të mbyllur gojën tënde dhe fol vetëm për mirë.[1]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 583.

Nëse kjo lloj pune nuk arrihet, jepu për të pirë të eturve dhe të uriturve, për të ngrënë, zbato urdhrin dhe moho të padrejtën. Nëse nuk ke fuqi për këtë punë, atëherë gjuha të largohet përveç se nga e mira,[1] - iu përgjigj i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi ty dhe mbi familjen tënde!)*.

2- Disa komentues, fjalën "*feku rakabetu*", e kanë komentuar me kuptimin e fjalës "*liri*", pra, të qenit i lirë nga mëkatet nëpërmjet rrugës së pendimit, ose të qenit i lirë nga dënimi Hyjnor nëpërmjet rrugës së durimit. Por nëse u referohemi ajeteve që kanë zbritur pas tyre e që flasin për jetimët dhe nevojtarët, atëherë mendohet se ka të bëjë për lirimin e skllaveve.

3– Fjala "*el mesgebetu*" vjen nga rrënja e fjalës "*segeb*", që ka kuptimin "*uri*". Ndaj dhe "*jeumu dhij mesgebeh*" ka kuptimin: *ditët e urisë*. Edhe pse njerëzit e uritur kanë ekzistuar për gjatë gjithë shoqërisë njerëzore, në këtë rast, ky interpretim është një lloj theksimi për ushqimin e të uriturve në periudhën e mospasjes dhe të thatësirës. Për këtë shkak, ushqyerja e të uriturve dhe nevojtarëve është konsideruar si ndër mirësitë më të mira dhe veprat më të larta të njeriut.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Ai që ushqen një person në periudhën e zisë, All'llahu do ta shpërblejë atë, duke e futur në një prej dyerve të Xhennetit, derë në të cilën nuk është futur asnjë person tjetër përveç atyre që kanë kryer të njëjtën vepër.*".[2]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 582.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 495.

4- Fjala *"el makrabetu"* ka kuptimin: *të afërm*. Theksin e vendos te jetimët dhe te të afërmit, sepse ata duhen parë me sy tjetër. Përndryshe, të gjithë jetimët duhet të përkëdhelen. Por kjo gjë tregon se duhet të kujdesemi dhe të kemi më tepër përgjegjësi për jetimët që janë familjarët tanë.

Më tepër se kaq, jetimët e asaj periudhe shfrytëzoheshin për pasurinë e tyre nga të afërmit dhe vështirësia ishte shumë më e madhe.

Ebul Fettuh Rrazij është i mendimit se fjala *"el makrabetu"* nuk vjen nga rrënja *"karabetun"*, por vjen nga rrënja *"kurbun"* dhe flet për jetimët që, nga presioni i urisë, dukej sikur shpatullat e tyre janë ngjitur me njëra-tjetrën.[1] Ky komentim nuk duket i drejtë.

5– Fjala *"el metrebetu"* është paskajore nga shkronja *"mim"*, sepse në origjinal vjen nga fjala *"turab"*, që ka kuptimin: *dhé*. Dikush thotë se për shkak të urisë së madhe dhe zisë që kishte rënë, ishin bërë qëndrues në *dhé*. Edhe ky theksim është bërë për shkak të përparësisë që u është dhënë banorëve që qëndronin e banonin aty, se për ndryshe dhënia dhe ushqimi i nevojtarëve dhe i banorëve është ndër punët dhe veprat e mira.

Në një transmetim thuhet se Imam Ali ibn Musa Err Riida *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, kur hante, urdhëronte që të sillnin një tepsi të madhe dhe ta vendosnin në qoshe të sofrës. Si vinte ushqimi në sofër, ai përzgjidhte ushqimin më të mirë dhe e vendoste te tepsia që kishte vendosur në qoshe të sofrës. Më pas urdhëronte që atë ushqim ta ndanin për nevojtarët. Pasi ndahej

[1] Tefsiri "Ebul Fettuh Rrazij", vëll. 12, f. 96.

ushqimi, ai recitonte këtë ajet: **"Atëherë, le të ndjekë rrugën e vështirë!"**

Më tej shtonte: *"All'llahu e di se jo të gjithë njerëzit janë të aftë dhe kanë mundësi për të liruar një skllav, ndaj dhe ka përzgjedhur një tjetër mënyrë për të na dërguar drejt Xhennetit."*.[1]

O All'llah! Të lutemi të na mbrosh nga ky dënim, me mëshirën Tënde.

O All'llah! Për t'i kaluar këto vështirësi dhe mundime, nuk ka mënyrë tjetër vetëm se me suksesin Tënd. Të lutemi mos na lër pa sukses!

O All'llah! Të lutemi të na vendosësh në reshtin e atyre që libri u vjen nga krahu i djathtë.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Beled".

[1] "Kafi", sipas transmetimit të veprës "El Mijzan", vëll. 20, f. 424.

Sure "Esh Shems"

Zbritur në Mekë

Ajete 15

Përmbajtja e sures "Esh Shems"

Kjo sure është ndër suret që pastrojnë shpirtin dhe zemrën nga papastërtitë. Pra, boshti i saj vërtitet te këto dy kuptime, edhe pse në fillim të sures trajtohen njëmbëdhjetë çështje të rëndësishme, që nga krijimi i universit.

Në vazhdim flet për shpagimin e grupit të pastër nga nefsi. Përmendet betimi dhe betimet më të shumta të Kur'anit janë përmbledhur në mënyrë të përgjithshme.

Në përfundim të sures citohen shembuj nga popujt e padisiplinuar dhe kokëfortë, sikurse është populli i Themudit. Ky popull, për shkak se e la mënjanë pastrimin e shpirtit, përfundoi në fatkeqësi të përjetshme. All'llahu i dënoi ata me dënim të madh.

Më tej surja përfundon duke folur shkurtimisht për fatin e tyre.

Kjo sure e shkurtër trajton një ndër çështjet më të rëndësishme të fatit të njeriut. Ajo sqaron dhe shpalos për njerëzit sistemin e vlerave të fesë islame.

Mirësitë e leximit të sures "Esh Shems"

Për të treguar për mirësitë e kësaj sureje, është e mjaftueshme citimi i hadithit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Çdokush që e lexon suren 'Esh Shems', merr mirësitë sikur të ketë dhenë sadaka në Rrugën e All'llahut për të gjithë krijesat dhe gjërat ku mbi to bie dielli dhe hëna."*.[1]

Sigurisht që këto mirësi të mëdha janë për ata që e kanë kapur thelbin e këtyre ajeteve, edhe pse janë ajete të shkurtra. Për këta njerëz, detyrë parësore është pastrimi i shpirtit.

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 496.

Ajetet 1 – 10

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالشَّمْسِ وَضُحَاهَا ۝١ وَالْقَمَرِ إِذَا تَلَاهَا ۝٢ وَالنَّهَارِ إِذَا جَلَّاهَا ۝٣ وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَاهَا ۝٤ وَالسَّمَاءِ وَمَا بَنَاهَا ۝٥ وَالْأَرْضِ وَمَا طَحَاهَا ۝٦ وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ۝٧ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ۝٨ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ۝٩ وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ۝١٠﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëlotit!

"Për Diellin dhe shkëlqimin e tij."

"Dhe për Hënën që e përcjell atë!"

"Për ditën që ia zbulon shkëlqimin atij (diellit)**."**

"Dhe për natën kur e mbulon atë!"

"Për qiellin dhe për Atë që e ka ndërtuar!"

"Për Tokën dhe për Atë që e ka shtruar!"

"Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur."

"Duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën!"

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë.”

“Ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija)**, do të dështojë.”**

Komentimi

Betimet që janë radhitur në këtë sure, nëse i përllogarisim, janë njëmbëdhjetë, kurse në një sure tjetër janë shtatë. Në këtë sure janë mbledhur më shumë betime se sa në suret e tjera që ka Kur’ani. Është qartësuar shumë mirë se në këtë sure po trajtohet një çështje shumë e rëndësishme, madhështia e qiellit, e tokës, e diellit, e hënës dhe e fatit të njeriut.

Fillimisht, do të komentojmë këto betime dhe më pas do t’i shtjellojmë edhe më gjerë këto çështje të rëndësishme.

Në fillim All’llahu betohet për Diellin dhe përhapjen e dritës së tij: **“Për Diellin dhe shkëlqimin e tij.**”.

Sikurse e thamë edhe më parë, betimet e Kur’anit, në përgjithësi, kanë dy qëllime:

Së pari, kanë për qëllim të tregojnë rëndësinë e çështjes.

Së dyti, kanë për qëllim të tregojnë rëndësinë e vetë çështjes për të cilën u nis betimi, sepse betimet gjithmonë na kujtojnë çështje

të rëndësishme. Për këtë arsye, këto betime bëjnë që mendja dhe arsyeja e njeriut të vihet në punë, që këto çështje të rëndësishme të universit t'i mendojë e t'i shqyrtojë, që të mund të kërkojë një rrugë drejt Krijuesit nëpërmjet tyre.

Dielli është planeti që ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe te të gjitha krijesat e gjalla në tokë. Dielli, përveçse është burim i dritës dhe i nxehtësisë, gjë të cilat janë shumë të rëndësishme për jetën e njeriut, ka edhe burime të tjera jetese, sikurse ndihma që jep për fryrjen e erës, rënien e shiut, zhvillimin e bimëve, lëvizjen e lumenjve dhe burimeve të ujit.

Gjithashtu, është burim i energjisë, si: nafta, qymyri, etj. Nëse secilin prej këtyre burimeve që ne cituam, do ta shikojmë me vëmendje, do të arrijmë në përfundim se janë të lidhura me burimin e dritës së diellit dhe, nëse ky burim do të shuhej, e gjithë jeta do të binte në errësirë e gjithçka do të zhdukej.

Fjala *"duha"* ka kuptimin e përhapjes së dritës, kur dielli ngjitet në kulmin e tij dhe drita e tij përfshin gjithçka. Më pas atë pjesë të ditës e quajmë *"Duha"*.

"Duha" është quajtur për rëndësinë që mbart, sepse në kohën e sundimit të dritës, dielli shndrit mbi tokë.

Më pas citohet betimi i tretë, që është betim në Hënën, kur ajo është prapa diellit: **"Dhe për Hënën që e përcjell atë!"**.

Shumë komentues të Kur'anit këtë interpretim e kanë konsideruar si hënën e plotë (kur Hëna plotëson 14 ditët), sepse hëna, në katërmbëdhjetë ditshin e saj, del njëkohësisht me perëndimin e diellit, duke u shfaqur në horizont. Për shkak se në

atë periudhë hëna është plot dritë dhe plot shkëlqim, është betuar për të.

Gjithashtu, është edhe një tjetër mundësi, që interpretimi i mësipërm flet për natyrshmërinë e vazhdueshme të hënës ndaj diellit, si dhe përthithjen e dritës prej tij.

Të tjerë komentues janë të mendimit se komentimi i ajetit nuk ka rëndësi ndaj dhe është më mirë që të mos e citojmë.

Në betimin e katërt betohet për ditën, kur faqja e tokës shkëlqen prej saj: **"Për ditën që ia zbulon shkëlqimin atij** (diellit)**."**.

Fjala *"xhel'laha"* vjen nga rrënja e fjalës *"et texhlijetu"*, që ka kuptimin: *"shfaqje"* dhe *"shprehje"*.

Ka shumë diskutime në mesin e komentuesve se te kush kthehet përemri te fjala *"xhel'laha"*. Shumë komentues janë të mendimit se përemri kthehet te fjala *"tokë"*, ose te fjala *"dunja"*. Sikurse kemi thënë edhe më lart, është e drejtë që në ajetet e kaluara nuk është folur për Tokën, por kjo gjë bëhet e qartë nga pozicioni simetrik.

Të tjerë komentues besojnë se përemri i fjalës *"xhel'laha"* kthehet te fjala *"diell"*, që do të thotë, betohet në ditën kur dielli shfaqet. Në të vërtetë, dielli shfaq ditën. Por në mënyrë virtuale, mund të themi se dita është ajo që shfaq diellin. Nga të gjitha komentimet, komentimi i parë është më i përshtatshmi.

Sidoqoftë, betimi për këto planete të rëndësishme qiellore, është për shkak të ndikimit të jashtëzakonshëm të tyre jo vetëm në

jetën e njeriut, por edhe në të gjitha krijesat e gjalla, sepse dita është sekreti i lëvizjes dhe i jetës. Të gjitha përpjekjet dhe mundimet e jetës zakonisht shfaqen përgjatë ditës.

Në betimin e pestë betohet për natën që mbulon tokën: **"Për natën kur e mbulon atë."**.[1] Nata, me gjithë bereqetet e saj, dhe me gjithë ndikimet dhe vlerat e saj, që nga një anë ndryshon nxehtësinë e diellit përgjatë ditës dhe, nga ana tjetër, është burim qetësie dhe pushimi për të gjitha krijesat. Nëse nuk do të ekzistonte errësira e natës dhe, nëse dielli do të ndriçonte vazhdimisht, nuk do të ekzistonte qetësia, sepse nxehtësia përvëluese e diellit do të zhdukte çdo gjë. Po ashtu edhe, nëse sistemi i natës dhe i ditës do të ishte në kundërshtim me natyrshmërinë dhe ligjin e tyre, do të hasnin probleme.

Sikurse e dimë, një natë hënore në planetin e Hënës është e barasvlershme me dy javë ditënetët e planetit të Tokës. Ditët janë ekuivalente me dy javë. Në mesin e ditës, nxehtësia e diellit arrin në treqind gradë celsius. Në këto kushte nxehtësie nuk mund të mbijetojë asnjë krijesë. Ndërsa nata do të qëndronte e ftohtë nën zero gradë. Kjo ftohtësi nuk do të lejonte që krijesat të mbijetonin. Gjithçka do të ngrinte dhe do bëhej akull e kështu do të zhdukeshin.

[1] Midis komentuesve ka diskutime se ku kthehet përemri te fjala: *"jeghshaha"*. Një pjesë e tyre janë të mendimit se kthehet te fjala *"tokë"*, sepse nata është si mbulesë për tokën. Mendimi tjetër është se përemri kthehet te fjala *"diell"*, sepse nata është si mbulesë që mbulon diellin. Por në këtë rast, ka kuptim virtual, sepse nata nuk e mbulon diellin, sepse ajo shfaqet, pasi të perëndojë dielli. Faktikisht, nëse në ajetin e mësipërm përemri kthehet te fjala *"tokë"*, në këtë rast, gjithashtu, duhet të jetë kështu, sepse, edhe nëse përemri kthehet te fjala *"diell"*, në këtë rast, gjithashtu, ka të njëjtin kuptim.

Në ajetet e mëparshme foljet ishin në kohën e shkuar dhe në këtë ajet ato janë në kohën e tashme. Ky ndryshim interpretimi mund të tregojë se ngjarje, sikur shfaqja e ditës dhe natës, nuk janë të veçanta vetëm për tokën. E kaluara dhe e ardhmja janë të përfshira në të. Ndaj dhe disa komentues e kanë komentuar si folje e kohës së shkuar dhe të tjerë e kanë komentuar si folje të kohës së ardhme, sepse ka për qëllim sqarimin e këtyre ngjarjeve në kohë.

Në betimin e gjashtë dhe të shtatë behet për qiejt dhe Krijuesin e qiejve: **"Për qiellin dhe për Atë që e ka ndërtuar!"**.

Krijimi i qiejve, me gjithë madhështinë e tyre, është një mrekulli mahnitëse. Po ashtu, ndërtimi dhe zanafilla e të gjithë planeteve dhe e trupave qiellorë, si dhe sistemi i tyre, është një tjetër mrekulli mahnitëse. Më i rëndësishëm ndër të gjitha këto mrekulli mahnitëse, është Krijuesi i tyre.

Lidhëza *"ma"* tek ajeti: *"ues semai ue ma benaha"*, në fjalorin arab, zakonisht, përdoret për "jo – racionalët" dhe referimi i saj për All'llahun e Madhëruar nuk i përshtatet, ndaj disa komentues u detyruan që lidhëzën *"ma"*, në këtë rast, ta marrin si "paskajore" dhe jo "lidhës". Në këtë rast, kuptimi i ajetit bëhet: "Betohem për qiellin dhe ndërtimin e qiellit.".

Por duke pasur parasysh se ajetet që do të komentohen më vonë, nuk lënë rrugë tjetër vetëm se fjala *"ma"* të jetë lidhës dhe tregon Qenien e Pastër të All'llahut. Ai është Krijuesi i të gjithë qiejve. Përdorimi i lidhëzës *"ma"* në fjalorin arab për "Racionalët" nuk është i padëgjuar, sepse në ajetin 3 të Sures "En Nisâ" lexojmë: **"Martohuni me ato gra që ju pëlqejnë."**.

Një grup komentuesish janë të bindur se interpretimi me lidhzën "*ma*" – "*diçka*", në këtë rast është për shkak se burimi i botës është lënë i paqartë, me qëllimin që më pas, nëpërmjet saktësisë dhe studimit, të njihen me dijen dhe urtësinë e Tij. "*Ma*" – "*diçka*" shndërrohet në "*dikush*". Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Në betimin e tetë dhe të nëntë betohet për tokën dhe Krijuesin e tokës: **"Për Tokën dhe për Atë që e ka shtruar!"**.

Betimi bëhet për tokën, që është djepi i jetës së njeriut dhe i të gjithë krijesave të gjalla. Toka është mahnitëse, së bashku me malet, detet, luginat, pyjet, burimet, lumenjtë, mineralet, si dhe burimet të tjera të çmueshme, që, secili më vete, është një shenjë prej shenjave të Tij.

Më shumë se kaq dhe më mirë se sa u tha është Krijuesi i kësaj toke. Fjala "*telaha*" vjen nga rrënja e fjalës "*tehv*" dhe ka kuptimin: *zgjerim, shtrirje*. Gjithashtu, ka kuptimin: *largoj, përzë etj*. Në këtë rast ka kuptimin: *përhap*, sepse, së pari, toka, në fillesën e saj, ishte e mbuluar me ujë, më pas gradualisht ujërat e saj u zhvendosën nëpër gropat e tokës.

Së dyti, toka, në fillimet e saj, pati uljet dhe ngritjet me shpatet e pjerrëta, që nuk ishin të banueshme, shira të rrëmbyshëm, që binin vazhdimisht, e lanë lartësinë e tokës e kështu gradualisht toka u bë e shtrirë dhe e banueshme për jetesën e njeriut.

Disa komentues janë të bindur dhe besojnë se në këtë interpretim flitet shkurtimisht dhe në mënyrë të përgjithshme për lëvizjen e tokës, sepse një nga kuptimet e fjalës "*tehv*" është: "*lëviz*",

që mund të tregojë lëvizjen e transferimit të tokës përreth diellit, ose lëvizjen e saj përreth vetes, ose të dyja bashkë.

Më pas kalon te betimi i dhjetë dhe i njëmbëdhjetë, që janë edhe betimet e fundit në këtë seri: **"Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur."**.

Betohem për nefsin e njeriut dhe të Atij që e ka përsosur. Po ky njeri, është ekstrakt i gjithësisë, element i mbretërisë së botës dhe është lulja dhe gjelbërimi i botës së krijimit.

Ky krijim i hollësishëm, që është plot e përplot me mahnitje e mrekulli, ka aq shumë rëndësi, saqë All'llahu betohet për të dhe për Veten në të njëjtin vend!

Nëse do të kishte për qëllim *"shpirtin"*, atëherë fjala *"seu'uaha"* ka kuptimin e sistemimit dhe të rregullimit të forcës së shpirtit të njeriut, duke e marrë që nga forcat e perceptimit, të kujtesës, të transferimit, imagjinatës, nismat, dashurinë, vullnetin dhe vendosmërinë dhe të tjera si këto, të cilat trajtohen në shkencën e psikologjisë.

Nëse fjala *"seu'uaha"* ka për qëllim shpirtin dhe trupin, atëherë në të përfshihen të gjitha mrekullitë që na mahnitin, duke nisur që nga krijimi i sistemit të trupit dhe gjymtyrëve të tij, që janë pjesë e shkencës së anatomisë dhe të fiziologjisë.

Faktikisht, fjala *"en nefsu"*, i përmbledh të dyja kuptimet në Kur'anin e Shenjtë.

Për shpirtin lexojmë në ajetin 42 të sures "Ez Zumer: **"All'llahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes..."**.

Ndërsa për trupin flitet në ajetin 33 të sures "El Kasas", kur Musai thotë. **"O Zoti im, unë kam vrarë një njeri të tyre, prandaj kam frikë se do të më vrasin."**.

Por në këtë rast, është më e përshtatshme që të merren të dyja kuptimet, pra, në këtë rast përfshihen të dyja, sepse mrekullitë e All'llahut janë edhe në shpirt, edhe në trupin e njeriut, kështu që nuk mund ta veçojmë vetëm te një gjë.

Është për t'u habitur se fjala "*nefsun*", në këtë rast, ka ardhur në formën e papërcaktuar, në mënyrë që të tregojë madhështinë dhe rëndësinë e shpirtit të njeriut. Madhështi që nuk mund të imagjinohet, por që është e përzier me dykuptimësi, në mënyrë që ta paraqesë atë si qenie të panjohur. Disa shkencëtarëve të mëdhenj të ditëve të sotme, njeriun e kanë emërtuar si krijesë e panjohur.

Ajeti më poshtë flet për njërën nga çështjet më të rëndësishme, në lidhje me krijimin e njeriut, duke ia vënë në dukje njeriut të mirën e të keqen: **"duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën!"**

Po, pasi përfundoi krijimi i tij dhe "qenia" e tij u realizua, All'llahu i mësoi njeriut "të nevojshmet dhe të panevojshmet". Në këtë mënyrë, për nga ana e krijimit u bë ekzistencial. Një grumbull prej balte dhe me shpirt Hyjnor, mëson të keqen dhe devotshmërinë dhe në përfundim është ekzistencial e mund të përsoset aq shumë, saqë të jetë më i mirë se sa engjëjt. Por, kur ai përzgjedh rrugën e gabuar, mund të bjerë më poshtë se sa kafshët. E gjithë kjo varet nga përzgjedhja që njeriu bën vetë, pra, cilën rrugë përzgjedh.

Fjala *"elhemeha"* vjen nga rrënja e fjalës *"el ilham"*. Në origjinal ka kuptimin: *përtyp, pi diçka*. Më pas është përdorur me kuptimin e induksionit për një çështje, nga ana e Krijuesit, në shpirtin dhe zemrën e njeriut. Duket sikur njeriu atë çështje e gëlltit me gjithë ekzistencën e tij. Në disa raste ka ardhur me kuptimin: *shpallje*. Disa komentues janë të mendimit se ndryshimi midis *"ilhamit"* dhe *"vahjit"* është: Kur personit i bëhet *"ilham"*, nuk e kupton nga ku dhe si i ka ardhur ky *"ilhami"*. Ndërkohë që me *"vahj"*, *shpalljen* çdo gjë është e qartë, dihet nga ku dhe në ç'mënyrë ka ardhur tek ai.

Fjala *"fuxhur"* vjen nga rrënja e fjalës *"fexhr"*, sikurse edhe e cituam edhe më lart, ka kuptimin: *shqyeje e gjerë*. Për shkak se kjo shqyerje bëhet në agim, është quajtur *"fexhr"*.

Gjithashtu, për shkak se kryerja e mëkatit thyen, ose shqyen perden e ndershmërisë, është emërtuar *"fuxhur"*.

Sigurisht që qëllimi i fjalës *"fuxhur"*, në rastin tonë, pra, në ajetin që diskutuam, është për shkaqet dhe për mënyrat e thyerjes.

Fjala *"tekua"*, që vjen nga rrënja e fjalës *"uekaje"* ka kuptimin: *ruajtjes*.

Pra, njeriu të ruhet dhe të qëndrojë larg të këqijave, mëkateve, si dhe të qëndrojë larg çdo gjëje që e çon atë tek e liga.

Është e nevojshme të rikujtojmë se kuptimi i ajetit **"Duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën/"**, nuk nënkupton faktin që në brendinë e njeriut, All'llahu të ketë vendosur faktorët e të mirës dhe të keqes, sikurse e kanë përfytyruar disa komentues. Ata, në bazë të këtij përfytyrimi, arritën në përfundim se e mira dhe e

keqja gjendet në brendinë e njeriut. Por ajeti nënkupton se All'llahu ia mësoi njeriut këto dy të vërteta. I sqaroi atij Rrugën e Drejtë dhe të padrejtë. I njëjti kuptim gjendet edhe në ajetin 10 të sures "El Beled": "**Ne i mësuam njeriut të mirën dhe të keqen."**.

Thënë ndryshe: All'llahu i ka dhënë mundësinë njeriut të bëjë dallimin me anë të arsyes dhe logjikës. Njeriu, nëpërmjet arsyes dhe natyrshmërisë së tij, arrin të bëjë dallimin e të keqes dhe të mirës.

Disa komentues janë të mendimit se ky ajet tregon të mirën dhe të keqen e arsyes që All'llahu ia ka dhuruar njeriut.

Vërejmë se All'llahu ka vendosur në dispozicionin të njeriut mirësi të shumta, por midis gjithë këtyre mirësive, është theksuar më tepër fakti i frymëzimit të së mirës dhe të së keqes, sepse kjo çështje shkruan fatin e jetës së njeriut.

Në përfundim, pas gjithë këtyre betimeve të rëndësishme dhe të njëpasnjëshme, nxjerr përfundimin: **"Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë."**.

Fjala *"zek'kaha"* vjen nga rrënja e fjalës *"tezkije"*. Ragibi, në librin e tij "Mufredat" thotë se ka kuptimin: *zhvillim*.

Edhe fjala *"zekat"*, në origjinal ka kuptimin: *zhvillim*. Ndaj dhe në një thënie të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Pasuria pakësohet duke e falur, dija zhvillohet duke falur."*.[1]

[1] "Nehxhul Belaga", Kelimatul Kisar", Kelimetu 147.

Më pas kjo fjalë ka marrë kuptimin: *dëlirësi dhe pastërti*. Arsyeja mund të jetë se pastërtia është shkak i zhvillimit. Në ajetin që ne folëm, të dy kuptimet janë të mundura.

Po, shpengimi është nga ana e atij personi që e ka edukuar shpirtin e tij, e ka trajnuar dhe e ka zhvilluar që të qëndrojë larg ndyrësisë dhe mëkateve. Në të vërtetë, çështja kryesore e jetës së njeriut, gjithashtu, është kjo pastërti. Nëse do të ekzistojë kjo pastërti, do të ishte fatlum e, nëse jo, do të ishte fatkeq.

Më tej All'llahu flet për grupin kundërshtar dhe thotë: **"Ndërsa kushdo që e shtyp atë** (me punë të këqija)**, do të dështojë."**.

Fjala *"khabe"* vjen nga rrënja e fjalës *"el khajbetu"* dhe ka kuptimin: *mos arritje e qëllimit, i privuar, si dhe humbës*.[1]

Fjala *"des'saha"* vjen nga rrënja e fjalës *"desse"*, që në origjinal ka kuptimin e futjes së një gjëje të kombinuar me neveri. Kur'ani i Shenjtë flet për arabët e kohës së injorancës, kur ata i varrosnin vajzat e tyre për së gjalli: **"...apo ta varrosë në dhé..."**.[2]

"Desis" quheshin punët e fshehta.

Për kuptimin e këtij ajeti, janë thënë mendime të ndryshme.

Ndonjëherë është thënë se ky interpretim është tallje për të pabesin, sepse njerëzit e devotshëm dhe të denjë e shfaqnin veten e tyre. Ndërkohë që personat mëkatarë e fshehin veten e tyre, sikurse dhe është transmetuar: pasanikët arabë i ndërtonin shtëpitë

[1] "Mufredat" i Ragibit dhe "Kamusul Lugat."
[2] Sure "En Nahl", ajeti 59.

e tyre në vende të shtrira dhe mbrëmjeve ndiznin zjarr, që nevojtarët të shkonin pranë tyre edhe ditën edhe natën, që të mund të merrnin ndihmë. Njerëzit koprracë dhe të këqij i ndërtojnë shtëpitë e tyre në vende të këqija, që askush të mos shkojë pranë tyre.

Disa komentues janë të mendimit se mëkatarët e fshehin veten e tyre në mesin e të mirëve. Ose ata e fshihnin shpirtin e tyre dhe identitetin njerzor në mëkat.

Në çdo rast, është aluzion për ndotje në mëkat dhe qëndron saktë përballë përsosjes.

Kështu, fituesit dhe humbësit janë të njohur në jetën e kësaj bote. Kriteret e vlerësimit të këtyre dy grupeve nuk janë tjetër vetëm se pastërti dhe zhvillim i shpirtit, devotshmëri dhe bindje ndaj All'llahut. Ndotja nuk përllogaritet si mëkat. Nga këtu bëhet e qartë se: Imam Bakiri dhe Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* në komentim të ajetit, kanë transmetuar: "*Doli fitimtar ai që u bind, i pashpresë dhe i zhgënjyer, mbeti ai që mëkatoi.*".[1]

Në një tjetër hadith thuhet: I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur lexonte ajetin: **"Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë."**[2] ndalonte dhe bënte këtë lutje: *'O All'llah! Më dhuro mua devotshmëri, Ti je kurora dhe Zoti i saj, bëj që të jem i përsosur se Ti je më i miri i përsosmërisë!"*.[3]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 498.
[2] Sure " Shems" ajeti, 9.
[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 498.

Kjo gjë tregon se për të arritur këtë gradë dhe këtë shkallë të përsosmërie, duhet të kalosh një rrugë të gjatë, me plot kthesa. Kalimi i kësaj vështirësie nuk është aq e lehtë sa duket, sepse edhe për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kjo gjë është mundësuar vetëm me ndihmën e All'llahut. Pra, hapat i hedhim ne dhe vërtetimi është nga ana e All'llahut.

Në një tjetër hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për sa i përket komentimit të këtyre dy ajeteve, lexojmë: "*Shpëtoi, shpirti që është pastruar e përsosur, u privua, shpirti që All'llahu ia ndaloi (privoi) çdo të mirë.*".[1]

Hulumtime

1- Marrëdhënia e betimeve të Kur'anit me rezultatin e tij

Një pyetje e rëndësishme që trajtohet është: Çfarë lidhje ekziston midis këtyre njëmbëdhjetë betimeve të rëndësishme, me të vërtetën e bërjes së betimeve?

Mendohet se shpjegimi i kësaj të vërtete është nga All'llahu i Madhëruar, ku thotë që Unë gjithçka kam krijuar, që nga

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëlll. 6, f. 357.

instrumentet financiare deri ato shpirtërore, për lumturinë tuaj o njerëz.

Nga një anë, me dritën e diellit dhe të hënës bëj që skena e jetës suaj të jetë e qartë dhe me plot mirësi. Gjithashtu, sistemi i ditës dhe i natës, lëvizja dhe qëndresa juaj është sistemuar. Toka është bërë gati që ju të jetoni.

Nga ana tjetër, shpirtin tuaj e kemi krijuar me të gjitha kapacitetet e nevojshme. Ju është dhënë ndërgjegjja, ju është qartësuar e mira dhe e keqja. Juve nuk ju mungon asgjë për të nisur rrugën tuaj fatlume. Megjithatë, si nuk e pastroni dhe e përsosni shpirtin tuaj?! Si bini pre dhe i bindeni shejtanit?

2- Roli i diellit në këtë botë

Për diellin që është edhe qendra e sistemit diellor, si dhe udhëheqës i planeteve, ekzistojnë dy diskutime. Njëri ka të bëjë me madhështinë e tij, të cilën e kemi përmendur edhe më lart, kurse tjetri ka të bëjë me mirësitë dhe ndikimet e diellit, që shkurtimisht mund t'i përmbledhim kështu:

1- Jeta e njeriut dhe e gjithë qenieve njerëzore, si dhe e të gjithë krijesave të gjalla, ka nevojë për dritë dhe nxehtësi. Kjo domosdoshmëri për jetën e njeriut dhe të krijesave të tjera të gjalla sigurohet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet këtij planeti të zjarrtë.

2- Të gjithë përbërësit ushqimorë sigurohen nëpërmjet dritës së diellit, po ashtu edhe krijesa që jetojnë në thellësinë më të

madhe të deteve, marrin dritë dhe kanë nevojë për të. Ato shfrytëzojnë bimë që janë në thellësi të oqeaneve, për të pasur dritë. Edhe kur krijesat e gjalla të deteve duan të ushqehen, ato ushqehen nëpërmjet njëra–tjetrës. Një grup prej tyre ushqehet me bimë, bimë këto që nuk rriten pa dritën e diellit.

3- Të gjitha ngjyrat, bukuritë dhe efektet që i shikojmë në botën e natyrës, kanë lidhje me mënyrën e rrezatimit të diellit. Kjo gjë është vërtetuar në shkenca të ndryshme, por në veçanti është vërtetuar në shkencën e Fizikës.

4- Shirat që na falin jetë, bien nga retë. Avujt e reve krijohen nga rrezatimi i diellit që bie mbi oqeane, dete e lumenj, ndaj të gjitha burimet e ujit, që ushqehen nga shiu, janë për shkak të mirësive dhe bereqetit të diellit.

5- Erërat kanë si detyrë rregullimin e ajrit, zhvendosjen e reve, si dhe transferimin e nxehtësisë dhe të ftohtit nga një vend i ngrohtë te një vend i ftohtë dhe e kundërta. Ato, për shkak të rrezatimit të diellit dhe të ndryshimit të gradës së nxehtësisë, bëjnë që kjo nxehtësi të shpërndahet anekënd.

6- Përbërësit dhe burimet e energjisë së krijuar, si ajo e ujërave, e digave të mëdha që ndërtohen në vende malore, e burimeve të naftës, të qymyrit etj, të gjitha këto janë të lidhura në një mënyrë a tjetër me diellin. Nëse ai nuk do të ekzistonte, edhe këto burime nuk do të ekzistonin. Të gjitha lëvizjet në sipërfaqen e tokës janë të konvertuara me qëndresën.

7- Mbijetesa e sistemit diellor është për shkak të ekuilibrit të tërheqjes dhe shtytjes që ndodh midis planetit të diellit dhe planeteve që rrotullohen përreth tij. Kështu, dielli luan një rol të

madh dhe shumë të vlefshëm për ruajtjen e planeteve dhe të qarqeve.

Nga kjo përmbledhje mësojmë se përse All'llahu, së pari, është betuar për diellin. Pra, çfarë argumenti kishte?

Gjithashtu, edhe hëna dhe shkëlqimi i saj përgjatë ditës dhe natës dhe planeti i tokës, secili ka një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe të gjithçkaje. Për këtë arsye është betuar për to dhe më thellë se kaq, shpirti dhe trupi i njeriut është më i çuditshmi dhe me më shumë sekrete.

Për rëndësinë e pastrimit të shpirtit, do të diskutojmë në fund të sures.

Ajetet 11 - 15

﴿كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَاهَا١١ إِذِ انْبَعَثَ أَشْقَاهَا١٢ فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ نَاقَةَ اللَّهِ وَسُقْيَاهَا١٣ فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا فَدَمْدَمَ عَلَيْهِمْ رَبُّهُمْ بِذَنْبِهِمْ فَسَوَّاهَا١٤ وَلَا يَخَافُ عُقْبَاهَا١٥﴾

"Fisi i Themudit, nga shfrenimi i vet – përgënjeshtroi."

"Kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë)**."**

"I dërguari i All'llahut (Salihu)**, u tha atyre: 'Kjo është deveja e All'llahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!'"**

"Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit."

"Pa pasur frikë prej pasojave të kësaj."

Komentimi

Fundi i hidhur i tiranëve

Në vazhdim të ajeteve të mësipërme, që na paralajmëronin për fundin e atyre që shpirtin e kishin ndotur, në këto ajete merret si shembull populli i Themudit dhe fati i këtij populli. Citimet janë të shkurtra, të prera dhe shumë kuptimplota. All'llahu në Kur'an thotë se populli i Themudit, për shkak të arrogancës, e mohoi Profetin e tyre dhe ajetet Hyjnore: **"Fisi i Themudit, nga shfrenimi i vet – përgënjeshtroi."**.

Fjala *"et tagua"* dhe *"et tug'jan"* kanë të njëjtin kuptim, pra, tregojnë abuzimin dhe sulmin në gradën më të lartë. Populli i Themudit është ndër popujt më të vjetër. Ata kishin Profet Salihun, i cili jetonte në një zonë malore midis Hixhazit dhe Shamit. Kishin toka pjellore, ndërtesa dhe kështjella luksoze, shtëpi të forta etj. Por ata jo vetëm që nuk falënderonin për këto mirësi, por ishin edhe kryeneçë e mohues të Profetit të tyre, Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. U tallën me ajetet hyjnore. All'llahu i zhduku me një vetëtimë qiellore.

Më pas All'llahu jep një shembull të rëndësishëm për këtë populli tiran: **"Kur u ngrit më i keqi i tij** (për të therur devenë)**."**.

Fjala *"el eshka"* ka kuptimin: *mizor, i keq, i lig ose zemërgur*. Me këtë term i drejtohet atij personi që theri devenë e Themudit. Ajo deve ishte shfaqur në mesin e tyre si mrekulli. Therja e saj tregonte dhe paralajmëronte luftë me Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ajo deve ishte një mrekulli në mesin e atij populli.

Sipas mendimit të disa komentuesve, emri i personit që theri devenë e Profetit Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ishte Kuddar ibn Salif. Në disa transmetime thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thotë Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"Kush ishte më i ligu i të parëve?"*

- *Ai që theri devenë e popullit të Themudit*, - përgjigjet Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

- *The të vërtetën. Po njeriu më i ligu i të fundmëve?* - e pyeti Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

- *Nuk e di, o i Dërguari i All'llahut*, - i përgjigjet Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

– *Ai që do të godasë ty në kokë,* i përgjigjet Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Më pas, Profeti Muhammed bën me shenjë në pjesën lart të ballit të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[1]

Ajeti tjetër shpjegon dhe komenton edhe më shumë për tiranët e popullit të Themudit, duke thënë se i Dërguari i All'llahut u tha atyre se kjo është deveja e All'llahut, lëreni atë të pijë ujë, mos e bezdisni: **"I dërguari i All'llahut** (Salihu)**, u tha atyre: 'Kjo është deveja e All'llahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!'"**.

Fjala *"resulull'llah"*, në këtë rast, tregon Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, Profet i popullit të Themudit.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 499. Po ky kuptim është cituar edhe në tefsirin "Kurtubij", vëll. 6, f. 7168.

Fjala *"nakatu All'llah"* tregon se kjo deve nuk ishte një deve e zakonshme, por kishte ardhur si mrekulli dhe argument, për të vërtetuar vërtetësinë e Profetit Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe për ata që nuk besojnë e që janë kokëfortë.

Një ndër cilësitë e cituara për devenë e Profetit Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ishte se ajo doli nga thellësia e një shkëmbi.

Në ajetet e tjera të Kur'anit vërehet shumë mirë që Profeti Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* e kishte lajmëruar popullin e Themudit, që uji i pijshëm do të ndahej midis tyre dhe midis devesë. Pra, një ditë do të pinte deveja dhe një ditë ata do të mbushnin ujë e kështu asnjëri nuk do ta shqetësonte tjetrin: **"Dhe lajmëroji ata se uji do të ndahet ndërmjet tyre e devesë dhe çdo vakt do të shihet me rend!"**.[1]

Veçanërisht atyre u tha se, nëse ju i kundërviheni kësaj deveje, dënimi i All'llahut do t'ju zërë vazhdimisht. **"Mos i bëni kurrfarë të keqeje asaj, se do t'ju godasë dënimi i një Dite të madhe!".[2]**

Më pas shton, ky popull kokëfortë, arrogant e i padëgjuar nuk i kushtoi vëmendje fjalëve të Profetit Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ata e mohuan atë. E therën devenë: **"Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit."**.

[1] Sure "El Kamer", ajeti 28.
[2] Sure "Shuara", ajeti 156.

Fjala *"akaruha"* vjen nga rrënja e fjalës *"akere"* e cila ka kuptimin: *parim dhe baza e një gjëje*, ndërsa fjala *"akeru nakati"* ka kuptimin e therjes së saj.

Disa komentues janë të mendimit se fjala *"akere"* ka kuptimin e shkurtimit të këmbëve dhe të shtrirjes në tokë. Përfundimi i saj është vrasja e kësaj kafshe.

Devenë e vrau vetëm një person, sikurse edhe e interpreton Kur'ani me fjalën *"ushki"*. Por sikurse e shikojmë në ajetet e mësipërme, këtë veprim e ka kryer në bashkëpunim me këtë popull tiran. Ndaj dhe i referohet gjithë popullatës së Themudit, duke thënë se të gjithë kanë gisht në këtë punë, me mënyra të ndryshme.

Fjala *"akeruha"* ka ardhur në numrin shumës dhe tregon se krimi nuk është vetëm i një personi, por i të gjithëve, sepse komplote të tilla zakonisht bëhen në grup dhe më pas përcaktohet një person apo disa për t'i dhënë fund komplotit të hartuar në bashkëpunim.

Së dyti, për shkak se të gjithë kanë pasur të njëjtin mendim, për ta vrarë dhe për ta zhdukur devenë. Ata që janë kënaqur dhe e kanë dashur këtë gjë, konsiderohen bashkëpunëtorë në veprim.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thotë se, edhe pse devenë e popullit të Themudit e theri një njeri, All'llahu i dënoi të gjithë, sepse të gjithë ishin dakord që të kryhej ky veprim i lig. Ata e therën devenë, por më pas, të gjithë u bënë pishmanë. Por momenti i pendimit ishte i vonuar, nuk pati më vlerë për ta.[1]

[1] "Nehxhul Belaga", Ligjërata 201.

Ata, pasi kryen këtë veprim të lig dhe pasi e mohuan Profetin e tyre, nisën kundërshtimet midis tyre. All'llahu ata i dënoi aq rëndë, saqë atyre nuk u mbeti asnjë vlerë. Sikurse edhe shikohet në ajetin në vijim: **"Zoti për shkak të mëkatit që kryen i dënoi të gjithë së bashku dhe tokën e tyre e bëri të sheshtë."**.[1]

"Saiketu" është momenti i tmerrshëm, kur në pak sekonda ndodh ngjarja e tmerrshme e rënies së tërmetit dhe toka bëhet shkrumb e hi. Çdo gjë sheshohet, nuk shikohet asgjë mbi tokë, shtëpitë e tyre shndërrohen në argjinaturë të tyre. Ndonjëherë ka kuptimin: *shkatërrim i njeriut.*

Fjala *"demdem"* vjen nga rrënja *"demdeme"*. Ndonjëherë merr kuptimin: *shkatërrim*. Ndonjëherë *dënim i plotë*. Ndonjëherë tjetër ka kuptimin: *rrah dhe e zbus*. Gjithashtu, ka kuptimin: *zemërim, rrethoj*.[2]

Të gjitha këto kuptime janë të vërteta, për sa i përket diskutimit që bëmë, sepse dënimi i tmerrshëm ka ardhur për shkak të zemërimit të All'llahut.

Fjala *"seuaha"* vjen nga rrënja e fjalës *"tesuije"*. Mund të jetë përdorur edhe për sheshimin e tokës dhe shtëpive për shkak të vetëtimës dhe të tërmetit të tmerrshëm; ose mund të jetë përdorur me kuptimin e mbylljes së kësaj pune, që të gjithë të dënohen në mënyrë të barabartë.

Përmbledhja midis këtyre kuptimeve është e mundur.

[1] "Sure Esh Shems", ajeti 14.
[2] "Mufredat" i "Ragibit"; "Lisanul Arabi", tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 499, dhe tefsire e libra të tjerë.

Përemri te fjala "*seuaha*" kthehet te fisi i Themudit, ose te qyteti dhe te tokat e tyre, që All'llahu i ka shkrumbuar të gjitha.

Disa komentues janë të mendimit se përemri kthehet te fjala "*demdeme*", duke nënkuptuar se ky dënim, nga ana e All'llahut, do të jetë i njëjtë dhe do t'i përfshijë të gjithë.

Ndërmjet këtyre komentimeve, komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Nga ky ajet kuptohet më së miri se dënimi i tyre vjen për shkak të rezultatit të punëve të tyre dhe në përputhje me veprat e tyre. Nga këtu kuptohet se gjithçka është e bazuar në drejtësi dhe në urtësi.

Ne lexojmë për shumë popuj që janë penduar për veprat e tyre dhe përzgjedhin rrugën e pendimit. Në këtë rast, është për t'u habitur. Në disa transmetime thuhet se, kur populli i Profetit Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i pa shenjat e dënimit, kërkoi Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për ta hequr qafe.[1]

Sjellja e tyre tregon thellësinë e mëkatit të tyre dhe kokëfortësinë karshi Krijuesit dhe Profetit të tyre. All'llahu e shpëtoi atë dhe ata i shkatërroi.

Si përfundim, në ajetin e fundit, për t'i paralajmëruar edhe një herë ata që ecin e ndjekin këtë rrugë të gabuar, thuhet: **"Pa pasur frikë prej pasojave të kësaj."**.[2]

Janë të shumtë sundimtarët që kanë pushtet për të dënuar, por ata gjithmonë janë të frikësuar për atë çka bëjnë. Ata qëndrojnë

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 446.
[2] Pra, pa u penduar aspak për këtë.

në pritje, se si do të jetë sjellja, qëndrimi apo reagimi i tyre. Për këtë shkak, ata nuk e përdorin dot mundësinë e të udhëhequrit, sepse pushteti i tyre është i lidhur dhe në proporcion me pamundësinë dhe dobësinë e tyre. Edhe dija e tyre është e lidhur me injorancën e tyre.

All'llahu i Madhëruar, që sundon gjithçka dhe e ka gjithçka nën vëzhgimin, nuk frikësohet nga asgjë. Nuk i trembet asaj që do vijë apo çfarë pasojash do të ketë ky apo ai veprim. All'llahu vepron sipas vullnetit të Tij, ndërsa tiranët duhet ta mendojnë mirë ç'do të bëjnë, sepse për shkak të veprave të tyre përfshihen në hidhërimin e All'llahut. Ata duhet të rrinë larg zemërimit të All'llahut.

Fjala *"ukba"* ka kuptimin: *përfundim i punës*. Përemri i fjalës *"ukbaha"* kthehet te fjala *"demdeme"* dhe *"helaket"* – *"shkatërrim"*.

Hulumtim

1- Përmbledhje për përfundimin dhe fatin e popullit të Themudit

Populli i Themudit, sikurse edhe e cituam edhe më lart, jetonte në tokën e quajtur Uadi El Karij, pranë tokës dhe qytetit të Medines dhe Shamit. Ata adhuronin idhujt dhe ishin zhytur thellë në mëkat.

Profeti Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u përpoq ta udhëzonte këtë popull, por ata nuk hoqën dorë nga idhujt dhe as nuk ndryshuan mendim, për sa i përket tiranisë së tyre.

Kur ata kërkuan që t'u vinte një mrekulli, All'llahu u dërgoi një deve femër, e cila del nga mali në mënyrë të jashtëzakonshme. All'llahu, për t'i sprovuar ata për këtë mrekulli që kërkuan, jep urdhër që një ditë të gjithë ujin do ta përdorë deveja dhe një ditë do ta përdorin banorët. Në transmetime është parë se ditën kur banorët nuk do të pinin ujë, mund të shfrytëzonin qumështin e devesë. Por këta nuk i qëndruan urdhrit, por nisën e thurën planin se si ta vrisnin e ta zhduknin jo vetëm devenë, por edhe Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Shkaku ishte se ata e shikonin Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* si njeriun që i kishte ndaluar nga dëshirat e tyre.

Plani i vrasjes së devesë, sikurse u tha edhe më lart, u krye nga një person i pashpirt dhe zemërgur, me emrin Kedar Bin Salef. Ai e goditi devenë dhe ajo ngordhi.

Veprimi i tyre ishte paralajmërim për të luftuar me Zotin. Ata dëshironin dhe mendonin se me zhdukjen e devesë, do të mund të shuanin dritën e udhëzimit. Profeti Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u dha tri ditë afat, që të gëzojnë. Në këto tri ditë të shfrytëzojnë çdo gjë që kanë për kënaqësinë e tyre e pas këtyre tri ditëve do të vijë dënimi i All'llahut të Madhëruar: **"Por ata e therën dhe ai tha: 'Jetoni në shtëpitë tuaja edhe tri ditë! Ky është premtimi i vërtetë.'"**.[1]

Këto ishin tri ditë afat, që ata të mund të ndërronin mendim, si dhe ishte afati i fundit që ata të pendoheshin. Por ata jo vetëm që nuk ndërruan mendim, por e shtuan edhe më tepër mizorinë dhe tiraninë e tyre. Kështu që morën dënimin e tyre nga qielli.[2]

Toka e tyre u fundos dhe u përmbys, shtëpitë dhe gjithçka kishin, gjithashtu, u zhduk: **"Kurse ata që bënë të këqija, i kaploi një zë i tmerrshëm dhe në shtëpitë e tyre u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm."**.[3]

Ai vend dhe ato shtëpi u zhdukën, a thua se aty nuk kishte banuar e nuk kishte jetuar askush. All'llahu i Madhëruar, Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe shokët e tij besimtarë, i shpëtoi nga ai tmerr: **"E, kur erdhi urdhri Ynë, Ne - me mëshirën Tonë, e shpëtuam Salihun bashkë me besimtarët e tij nga poshtërimi i asaj dite. Me të vërtetë, Zoti yt është i Forti dhe i Plotfuqishmi."**.[4]

---

[1] Sure "Hûd", ajeti 65.
[2] Dënimi i tyre erdhi nga qielli, me vetëtima, sikurse e thamë edhe më lart. Ajo bubullimë dhe vetëtimë bëri që toka të dridhej. Vetëtima bëri që të përhapej zjarr në tokë.
[3] Sure "Hûd", ajeti 67.
[4] Sure "Hûd", ajeti 66.

Komentimin e plotë të ngjarjes së popullit të Themudit e shikoni në vëllimin 9 të këtij tefsiri, pra të "Komentimit të Përsosur", në faqen 156 e më pas, në vazhdim të ajeteve 62-68.

2- I ligu i parë, "Eshkil Evelin" dhe i ligu i fundit, "Eshkil Akherin"

Një grup dijetarësh të mëdhenj, si nga synitët, si nga shi'iat, duke përfshirë: "Tha'lebin", "Uahidin", "Ibn Merdevijen", "Khatib Bagdadin", "Taberin", "Muselin", "Ahmed Hanbelin" dhe të tjerë, në dokumentet e tyre nga "Amar Jasiri", "Xhabir ibn Semere" dhe "Osman ibn Sehibi", kanë transmetuar se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"O Ali! Më i ligu i të parëve është ai që vrau devenë e Profetit Salih (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) dhe më i ligu i fundit është ai që do vrasë ty."*.

Në një tjetër transmetim thuhet se *më i ligu i të parëve është ai që gjakosi devenë e Profetit Salih (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) dhe i fundit është ai që do të gjakosë mjekrën tënde.*[1]

Në të vërtetë ngjashmëria midis Keddar bin Salefit - vrasësit të devesë dhe vrasësit të Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, Abdurrahman ibn Mulxhem Muradij, është se të dy këta nuk kishin armiqësi personale, por donin të shuanin dritën e të vërtetës. Ata morën një mrekulli dhe shenja prej

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 587.

shenjave të All'llahut, të cilat ishin për udhëzimin e njerëzve. Ashtu sikurse popullit të Profetit Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i erdhi dënimi, edhe myslimanëve u erdhi mbi krye një pushtet, që u bë dëshmitar i dënimeve më të dhimbshme.

Hakim Hesekani, në librin "Sheuahidul Tenzijl", ka sjellë shumë transmetime për këtë çështje, të cilat kanë ngjashmëri të madhe si nga ana e përmbajtjes, ashtu edhe nga ana e kuptimit me transmetimin e lartpërmendur.[1]

3- Pastërtia shpirtërore është një detyrë e madhe Hyjnore

Betimet e All'llahut për një çështje apo fushë janë bërë për shkak të rëndësisë së çështjes. Ne e dimë që betimi më i gjatë dhe më i fortë është bërë në këtë sure, sepse betimi për Qenien e All'llahut është bërë tri herë.

Përfundimisht, është vënë theksi në çështjet e pastrimit të shpirtit.

Ndërsa humbja, fatkeqësitë dhe përjashtimet janë për shkak të braktisjes së pastërtisë shpirtërore.

Një ndër gjërat më të rëndësishme të jetës së njeriut është kjo çështje. Kur'ani e sqaron këtë çështje me interpretimin që bëri më lart. Aty thuhet se pastërtia shpirtërore dhe shpëtimi i njeriut nuk është as tek iluzioni, as te pasuria, as te pushteti e as nuk është e lidhur me punët e një personi tjetër, sikurse e imagjinojnë dhe e pandehin të krishterët, duke thënë se pastërtia shpirtërore dhe falja e mëkateve është premtuar nga Profeti Isa *(Paqja e Zotit qoftë mbi*

[1] "Sheuahidul Tenzijl", vëll. 2, f. 335 – 353.

të!). Pastërtia shpirtërore dhe veprat e mira, si dhe devotshmëria vijnë së bashku me veprat dhe besimin e drejtë.

Fatkeqësia e njeriut nuk është aspak te vendimi dhe caktimi (Kada dhe Kader) as te fatet, e detyruar apo e shkaktuar nga aktiviteti i njërës apo tjetrës. Por gjithçka është e lidhur me përlyerjen dhe ndotjen në mëkat dhe largimin nga Rruga e devotshmërisë.

Në librat e historisë thuhet se bashkëshortja e Aziz të Egjiptit , (titull që i përkiste ministrit të financave asokohe në Egjipt). Zulejhaja, kur Jusufi (Profet) u bë padroni i thesarit dhe udhëheqës në tokën e Egjiptit, e takoi atë dhe tha: *"Lakmia dhe epshi ka bërë që mbretërit t'i bëjë skllevër, ndërsa durimi dhe devotshmëria skllevërit i ka bërë mbretër"*.

Jusufi e vërtetoi fjalën e tij dhe kjo fjalë hyjnore e kthjelloi atë: *"Ai që është i durueshëm dhe i devotshëm, All'llahu nuk ia humbet mundin e tij."*.[1]

I njëjti kuptim është transmetuar me fjalë të tjera, që bashkëshortja e Aziz Egjiptit ishte ulur të pushonte. Kur aty po kalonte Jusufi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, ajo tha: *"Faleminderit All'llahut, që mbretërit, për shkak të mëkateve, i ka bërë skllevër dhe skllevërit, për shkak të bindjes i ka bërë mbretër."*.[2]

Po. Skllavëria e shpirtit bëhet shkak i skllavërisë së njeriut dhe devotshmëria e pastërtia shpirtërore bëhet shkak i pushtetit mbi univers.

[1] "Mehaxhetul Bejdha", vëll. 5, f. 116.
[2] "Mehaxhetul Bejdha" , vëll. 5, f. 116.

Janë të shumtë personat që, për shkak të skllavërisë, kanë arritur pozitë të lartë dhe janë bërë udhëheqës dhe me leje të All'llahut ata kanë ndikuar në këtë botë.

O All'llah! Na mbështet në luftën me egon tonë!

O All'llah! Ti na ke frymëzuar të mirën dhe të keqen, na ndihmo e na bëj të suksesshëm, që të ecim drejt së mirës e t'i largohemi së keqes!

O All'llah! Komplotet e shejtanit janë të fshehura në egon e njeriut, të lutemi na bëj që t'i njohim këto komplote!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "Esh Shems".

Sure "El Lejl"

Zbritur në Mekë

Ajete 21

Përmbajta e sures "El Lejl"

Kjo sure është mekase dhe përmban cilësitë e sureve mekase, pra, ajetet e saj janë të ndara, të shkurtra, me përmbajtje të nxehtë. Përgjithësisht flasin për Kiametin, për shpërblimin dhe dënimin në atë Ditë.

Pas citimit të tri betimeve, njerëzit i ndan në dy grupe: lëmoshdhënësit e devotshëm dhe koprracët, të cilët bëhen mohues të shpërblimit në Ditën e Kiametit. Pasi citohet fundi i punëve të grupit të parë, që është fati i mirë, lehtësia dhe rehatia, më pas vjen fundi i punëve të grupit të dytë, që janë vështirësitë, fatkeqësitë dhe ngushtimi.

Në pjesën tjetër të kësaj sureje, pasi flitet për kuptimin e udhëzimit të krijesave nga ana e All'llahut, i këshillon dhe i paralajmëron më pas, të gjithë, për zjarrin e Xhehennemit.

Në pjesën e fundit të sures, flet për ata që do të vuajnë e do të digjen në zjarr, si dhe për grupin që do të shpëtojë nga zjarri. Të dy palët njihen me citimin e cilësive të tyre.

Mirësitë e leximit të sures "El Lejl"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Çdokush që e reciton këtë sure, All'llahu i fal atij aq shumë, saqë ai të jetë*

i kënaqur. E shpëton atë nga vështirësitë dhe rrugën e jetës së tij e bën të lehtë për të".[1]

Ajetet 1 – 11

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَى١ وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّى٢ وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنْثَى٣ إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّى٤ فَأَمَّا مَنْ أَعْطَى وَاتَّقَى٥ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَى٦ فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْيُسْرَى٧ وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى٨ وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى٩ فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْعُسْرَى١٠ وَمَا يُغْنِي عَنْهُ مَالُهُ إِذَا تَرَدَّى١١﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"Për natën që mbulon (me terr)**."**

"Për ditën që agon."

"Dhe për Atë që ka krijuar mashkullin dhe femrën!"

"Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme."

"Sa për atë që jep (për hir të All'llahut)**, ka frikë** (nga Ai)**."**

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 499.

"Dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit)**."**

"Ne do t'ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit."

"Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm."

"Dhe e quan gënjeshtër më të bukurën (besimin)**."**

"Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit."

"E, kur të hidhet (në zjarr)**, pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi."**

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së kësaj sureje, të gjithë komentuesit kanë cituar transmetimin e Ibn Abazit. Do të paraqesim shkurtimisht shkakun e zbritjes së sures, sipas "Tabarsi", në libri "Mexhmaul Bejan".

Një burrë jetonte në mesin e myslimanëve dhe kishte një pemë hurme, që i kishte shtrirë degët e saj mbi shtëpinë dhe kopshtin e një burri të varfër. Kur pronari i hurmës ngjitej lart te pema, për të këputur hurma, disa prej tyre binin në shtëpinë e burrit të varfër dhe fëmijët i merrnin ato. Pronari i hurmës zbriste nga hurma dhe ua merrte fëmijëve hurmat nga duart. Ai ishte aq koprrac, saqë, nëse fëmijët kishin futur në gojë ndonjë hurmë, ai i fuste duart te goja e tyre dhe ua nxirrte me zor nga goja.

Burri i varfër shkoi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe u ankua.

- *Shko, se do ta rregulloj unë këtë çështje*, - i tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* takoi pronarin e hurmës dhe i tha: "*A ma jep mua atë pemën, që degët e saj bien mbi shtëpinë e filanit? Unë, në këmbim të saj, të jap një tjetër pemë hurme në Xhennet.*"

- Unë kam plot pemë hurme, por asnjëra nuk i ka hurmat si kjo pemë, ndaj nuk jam gati të bëj asnjë këmbim, - i tha burri.

Një prej shokëve të Profetit *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dëgjoi këtë fjalë dhe tha: "O i Dërguari i All'llahut! Nëse unë shkoj dhe e blej atë pemë nga ai person, për t'ia falur burrit të varfër, a më jep ti mua atë çka i premtove atij më parë?".

- *Po*, - iu përgjigj Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Burri u nis dhe shkoi te pronari i pemës së hurmës, bisedoi me të. Pronari i pemës së hurmës i tha: "A e di ti se Muhammedi më premtoi një tjetër pemë hurme në Xhennet, në të këmbim të kësaj dhe unë nuk e pranova. Unë e pëlqej shumë këtë pemë hurme, edhe pse kam plot pemë hurmash. Asnjëra prej tyre nuk është si kjo pemë.".

Burri që donte të blinte pemën e hurmës, tha: "A do ta shesësh apo jo?".

Nuk e shes, vetëm nëse më bëhet ndonjë ofertë me çmim të lartë parash, ofertë të cilën nuk mendoj se e bën njeri, i tha pronari i hurmës.

- Cila është shuma? – e pyeti blerësi.

- Dyzet pemë të tjera hurmash, - tha pronari.

- Sa çmim i lartë, për një pemë që është e shtrembëruar, dyzet pemë hurma! – u habit blerësi.

Ai u mendua pak në heshtje dhe tha: "Shumë mirë, do të të jap dyzet hurma në këmbim të saj.".

- Nëse thua të vërtetën, sa njerëz të thërras për dëshmitar?- pyeti pronari.

Ai pa që rrugës po kalonin disa njerëz, u afrua pranë tyre e u kërkoi të ishin dëshmitarë të kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja u krye dhe burri që e bleu pemën e hurmës, në këmbim të dyzet hurmave të tjera, u largua nga aty dhe shkoi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "O i Dërguari i All'llahut! Pema e hurmës është bërë tashmë pronë e imja dhe unë ta dhuroj ty!".

Profeti i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)* u nis drejt familjes së burrit të varfër dhe i tha të zotit të shtëpisë: "*Kjo pemë hurme tashmë të përket ty dhe fëmijëve të tu.*".

Në këtë moment zbret surja "El Lejl", për njerëzit koprracë dhe shpirtligj.

Në disa transmetime thuhet se emri i blerësit të pemës së hurmës ishte "Abu Ed Dehdah".[1]

Komentimi

Devotshmëria dhe ndihma e All'llahut

Përsëri në fillim të kësaj sureje hasim tri betime mahnitëse për krijesat dhe Krijuesin e kësaj bote.

All'llahu në Kur'an thotë: **"Për natën që mbulon** (me terr)**."**.

Interpretimi me fjalën *"jegsha"* mund të jetë për shkak se errësira dhe terri i natës bie mbi tokë si perde apo mbulesë dhe mbulon e strehon nën vete tokën. Ose ky interpretim është bërë, për shkak se fytyra e ditës apo e diellit, me rrezet e tij, mbulohet me rënien e natës. Sigurisht që kjo tregon rëndësinë e natës dhe ndikimin e saj në jetën e njerëzve. Ajo mundëson ndryshimin e nxehtësisë nga dielli, bën që të gjitha krijesat të qetësohen, si dhe ata që qëndrojnë për të adhuruar All'llahun natën, janë me shpirt e zemër të zgjuar, duke arsyetuar e duke falënderuar për gjithçka All'llahun.

Më pas vjen radha e betimit të dytë: **"Për ditën që agon."**.[2]

---

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10 f. 501.

[2] Vlen të përmendet se *"jegsha"* ka ardhur në formën e kohës së tashme,ndërsa fjala *"texhel'la"* ka ardhur në formën e foljes së kohës së shkuar.
Disa komentues janë të mendimit se ky ndryshim ka ardhur, sepse, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ftonte njerëzit për t'i udhëzuar në fenë islame, vendin e kishte pushtuar injoranca e

Agimi bën që perdja e territ dhe e errësirës së natës të thyhet, të largohet dhe mbi të gjithë gjerësinë e qiellit të sundojë drita. Çdo gjë do të zhytet në dritë. Në atë dritë që është sekreti i lëvizjes dhe burim i zhvillimit të jetës së gjithë krijesave. Në Kur'anin e Shenjtë është folur shumë dhe i është kushtuar shumë vëmendje çështjes së dritës dhe të errësirës, si dhe ndikimit të tyre në jetën e njeriut. Këto dy mirësi të mëdha, të përhershme, janë shenja prej shenjave të rëndësishme të All'llahut.

Ajeti tjetër thotë: **"Dhe për Atë që ka krijuar mashkullin dhe femrën!"**. Ekzistenca e këtyre dy gjinive në botën njerëzore, të kafshëve dhe të bimëve, si dhe ndryshimet që nisin që nga momentin kur ngjizet embrioni e deri në lindjen e tij.

Po ashtu, të dy gjinitë kanë cilësi që lidhen me aktivitetin dhe programin e secilit prej tyre, si dhe në brendi të gjinisë së tyre ka sekrete të shumta që janë shenja dhe argumente nga kjo botë e madhe. Nëpërmjet këtyre njohurive mund të njihemi me madhështinë e Krijuesit të tyre.

Përdorimi i shprehjes *"ma"* për Krijuesin është metaforë për madhështinë e Vetës së Shenjtë të All'llahut dhe se Ai përfshin gjithçka.

Komentues të tjerë janë të mendimit se shprehja *"ma"*, në këtë rast, është paskajore dhe kuptimi i fjalisë bëhet: "Betohem për Krijimin e mashkullit dhe femrës".

---

paditurisë. Por në këtë rast, të betohesh për një dhunë të tillë, nuk duket dhe aq e çuditshme. Më mirë do të ishte të thuhej, kjo folje e kohës se shkuar e cila ka ardhur pas, *"idha"* e cila tregon kusht, jep dhe kuptimin e foljes së kohës së tashme.

Por ky mendim duket mendim i dobët.

Më pas arrin te qëllimi përfundimtar i këtyre betimeve dhe thotë se përpjekjet dhe mundimet tuaja përgjatë jetës suaj janë të ndryshme dhe të shumëllojshme: **"Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme."**.

Përgjatë jetës, përpjekjet dhe mundimet e njeriut, si dhe rezultatet e tyre janë plotësisht të ndryshme, gjë që tregon se ju, gjithsesi, nuk do të gjeni qetësi përgjatë jetës suaj. Por ju, gjithsesi, nuk do të dorëzoheni, por do t'i harxhoni të gjitha mundësitë dhe përpjekjet tuaja. Shikoni, përpjekjet dhe mundimet tuaja në cilën rrugë dhe në cilin drejtim, krah apo çfarë përfundimi do të marrin?

Mos e thëntë që të gjitha kursimet tuaja t'i shisni për një çmim të ulët apo t'i çoni dëm kot!

Fjala *"shetaa"* është shumësi i fjalës *"shutejt"* që vje nga lënda *"shette"* dhe ka kuptimin: e ndarjes së grumbullimit. Në këtë rast flet për ndryshimin dhe përpjekjen e njerëzve për nga ana e cilësisë, qëllimit dhe konkluzionit.

Më pas njerëzit i ndan në dy grupe, duke u numëruar cilësitë: **"Sa për atë që jep** (për hir të All'llahut)**, ka frikë** (nga Ai) **dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës** (besimit)**, Ne do t'ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit."**.

Kuptimi i fjalës *"utije"* është: dhurimi në Rrugë të All'llahut dhe ndihma për nevojtarët.

Ndërsa theksimi për devotshmëri, pas dhurimit në Rrugën e All'llahut dhe ndihmës së nevojtarëve, tregon domosdoshmërinë

e nijetit të pastër dhe të qëllimit të sinqertë, kur fal e dhuron. Gjithashtu, mallrat për t'u falur e për t'u dhuruar, duhet të jenë siguruar nëpërmjet rrugës ligjore dhe të jenë të pastra nga çfarëdolloj papastërtie dhe dhunimi. Shumica e këtyre cilësive janë të përmbledhura në virtytet e devotshmërisë.

Komentues të tjerë kanë thënë se fjala *"a'taa"* flet për adhurimin financiar, ndërsa fjala *"itteka"* flet për adhurimet e tjera dhe për kryerjen e detyrimeve, si dhe braktisjen dhe largimin nga të ligat.

Nga këto komentime, komentimi i parë është më i përshtatshëm, edhe nga ana e jashtme e ajetit, edhe nga qëllimi i zbritjes së ajetit, të cilin e cituam më lart.

Fjala *"el husna"*, këtu tregon për shpërblimin e madh të All'llahut dhe pohimi i këtij shhpërblimi është tregues i besimit në All'llahun. Në shkakun e zbritjes së ajetit që përmendëm, pamë që Abul Dehdah, i cili shpenzoi pasurinë e tij si pasojë e besimit që kishte se All'llahu do t'ia kompensojë atë në Jetën Tjetër. Fjala *"el husna"* është përmendur me këtë kuptim edhe në ajetin 95 të sures "En Nisa: **"Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në Rrugën e All'llahut me pasurinë dhe jetën e tyre. All'llahu i ngre një shkallë më lart ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta. Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi, por i ka dalluar ata që luftojnë mbi ata që nuk luftojnë me shpërblim të madh."**.

Në këtë ajet, fjala *"husna"* ka kuptimin: *shpërblim të mirë*.

Komentues të tjerë kanë thënë se fjala *"husna"* ka për qëllim të tregojë *"sheriatin e mirë"*, që do të thotë të besosh në fenë islame, që është feja më e mirë.

Të tjerë komentues, këtë fjalë e komentuan me kuptimin e fjalës "La ilahe ilall'llah" apo me kuptimin e shehadetit.

Por duke u bazuar në stilin e ajeteve dhe qëllimin e zbritjes së tyre, për komentimin e fjalës *"husna"* – *"shpërblim i mirë"* është parë më i saktë komentimi i parë, sepse korrespondon me shumë prej ajeteve kur'anore.

Fjalia **"Ne do t'ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit."** mund të ketë për qëllim të tregojë suksesin Hyjnor, si dhe lehtësimin e urdhrit për të tillë persona. Apo të ketë për qëllim hapjen e rrugës së Xhennetit, si dhe pritjen dhe mirëseardhjen e engjëjve me respekt dhe me selam, ose mund të jenë të përfshira të gjitha këto.

Pa dyshim ata që falin në Rrugë të All'llahut, si dhe janë në Rrugë të Drejtë e të devotshëm, si dhe zgjidhin problemet e besimtarëve, do të jenë të shpërblyer në këtë botë e në Botën Tjetër do të gëzojnë qetësi shpirtërore.

Nëse i shikojmë të gjitha këto, mund të thuhet se për njeriun është pak e vështirë që në fillim të falë, por, nëse ky veprim përsëritet vazhdimisht, për njeriun kjo gjë bëhet aq e lehtë, saqë ndien kënaqësi, kur e kryen këtë veprim.

Ka plot njerëz dashamirës që kënaqen kur kanë në sofrat e tyre miq. Kur atyre nuk u vete njeri për mik, ata janë të dëshpëruar. Edhe kjo sjellje për ta është një lloj lehtësimi për problemet e tyre.

Nuk duhet të jemi të pavëmendshëm ndaj këtij veprimi. Në parim, të besosh në Ringjallje dhe në shpërblimet e mëdha hyjnore, ndihmon që t'u bëjmë ballë dhe të durojmë problemet që na lindin përgjatë jetës. Jo vetëm falja, pasuria e mban shpirtin e njeriut të sinqertë, por të gjitha mirësitë që bëhen bashkë në sheshin e luftës, bëjnë që njeriu të ndihet i kënaqur për këtë mirësi që kryen.

Fjala *"jusra"* vjen nga rrënja e fjalës *"jeser"* dhe ka kuptimin: *shaloj kalin, furnizoj dhe përgatis atë për t'i kalëruar*.[1]

Në ajetin e mëposhtëm do të shikojmë të kundërtën e asaj që thamë: **"Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm, dhe e quan gënjeshtër më të bukurën** (besimin)**, Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit, e kur të hidhet** (në zjarr)**, pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi."**.

Ata që janë koprracë, rrugën e besimit e konsiderojnë të panevojshme.

Fjala *"bukhl"* – *"koprraci"*, në këtë rast, është vendosur përballë fjalës *"eata"* – *"dhurim"*. Në grupin e parë, bujarët janë fatlumë.

Fjala *"uestegna"* – *"i/e panevojshme"*, mund të jetë një justifikim për koprracët dhe mund të jetë mjet për të grumbulluar pasurinë. Mund të tregojë se ai e konsideron veten si njeri që nuk ka nevojë për shpërblimet hyjnore. Këta njerëz janë e kundërta e atyre që gjithmonë sytë e tyre i kanë të drejtuar nga mirësia e All'llahut të Madhëruar. Ose ata e shikojnë dhe e mendojnë se nuk u nevojitet ajo çka Zoti u dhuron dhe gjithmonë përlyhen në mëkat.

[1] Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 762.

Ndërmjet këtyre tri komentimeve, komentimi i parë është më i përshtatshëm, edhe pse përmbledhja midis tri komentimeve është e mundur.

Qëllimi për mohimin e të mirave, pra, *"husna"* është mohim i shpërblimeve në Ditën e Kiametit, ose e mohimit të fesë, që është fe e qartë dhe e pastër e Profetëve. Interpretimi i ajeteve**"Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt shpëtimit"**, dhe ajetit " **Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit"** të cilat në fakt janë dy interpretime në dukje kondratiktore, në mënyrë të tillë që, Zoti, grupin e parë, bujarët, i përfshin në suksesin dhe varësinë e Tij, duke u lehtësuar vazhdimisht rrugën e faljes, me qëllim që të jenë të çliruar nga problemet e jetës.

Për grupin e dytë, suksesin e tyre e mohon dhe përzgjedhjen e rrugës për ta e bën të vështirë, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër. Ata gjithmonë do të përballen me vështirësi, sepse, parimisht, për këta koprracë, pa besim, kryerja e veprave të mira dhe veçanërisht dhurimi dhe falja në Rrugën e All'llahut, për ta, është shumë e vështirë, ndërkohë që për grupin e parë kjo gjë sjell lumturi dhe shpirtin e gëzon.

Në ajetin 11, këtyre koprracëve zemërgur u jep paralajmërimin: **"Kur të hidhet** (në zjarr)**, pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi.".**

Ata as nuk mund ta marrin me vete pasurinë që kanë siguruar. Por, edhe nëse e marrin me vete, ajo nuk mund të bëhet pengesë për ndalimin e zjarrit të Xhehennemit.

Fjala *"ma"*, në fillim të këtij ajeti, mund të jetë mohuese, sikurse e thamë edhe më lart, ose mund të jetë pyetje mohuese, që

do të thotë se pasuria e tyre nuk u shërben dhe nuk ka vlerë për në Botën Tjetër apo për në varr.

Fjala *"teredda"* vjen nga fjala *"er reda"* me kuptimin: *shkatërrim, rënie nga lartësia, që është burim i shkatërrimit*. Komentues të tjerë, origjinën e saj e dinë me kuptimin *"rënie"*, për shkak se rënia nga një vend i lartë bëhet shkak i shkatërrimit.

Në këtë rast, ka po këtë kuptim, pra, *shkatërrim*. Edhe në ajetin për të cilin po diskutojmë, kjo fjalë ka kuptimin: rënie në varr ose në zjarr. Fjala *"shkatërrim"* vjen me kuptimin: *"dënim"*.

Kur'ani, në këto ajete, flet për dy grupe, grupin e besimtarëve të devotshëm dhe bujarë dhe për grupin e dytë, që është grupi i pa fe, pa besim dhe koprrac. Shembullin e të dy grupeve e shikoni te shkaku i zbritje së sures, që është pasqyruar në mënyrë të saktë.

Grupi i parë, duke përfituar nga suksesi Hyjnor, e kalon me shumë lehtësi rrugën e tij drejt Xhennetit dhe mirësive. Ndërkohë që grupi i dytë, përgjatë jetës së tij, është i përballur me shumë probleme. Ata mbledhin pasurinë e tyre dhe më pas largohen. Ata nuk kanë tjetër gjë vetëm se vuajnë dhe marrin dënimin e All'llahut. Ata, me gjithë pasurinë e tyre, nuk marrin dhe nuk përfitojnë asgjë. As nuk mund të blejnë gjë me atë pasuri.

Ajetet 12 - 21

﴿إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَى١٢ وَإِنَّ لَنَا لَلْآخِرَةَ وَالْأُولَى١٣ فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّى١٤ لَا يَصْلَاهَا إِلَّا الْأَشْقَى١٥ الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّى١٦ وَسَيُجَنَّبُهَا الْأَتْقَى١٧ الَّذِي يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّى١٨ وَمَا لِأَحَدٍ عِنْدَهُ مِنْ نِعْمَةٍ تُجْزَى١٩ إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِ الْأَعْلَى٢٠ وَلَسَوْفَ يَرْضَى٢١﴾

“Neve na përket që t’ua tregojmë Rrugën e Drejtë.”

“Dhe, me të vërtetë, e Jona është ajo botë dhe kjo botë!”

”Prandaj Unë ju kam tërhequr vërejtjen me një zjarr që flakëron.”

“Ku do të hidhet vetëm më i keqi.”

“Që ka mohuar dhe është larguar nga besimi.”

“E do të mbahet larg tij (zjarrit) **më i devotshmi** (që ruhet nga gjynahet)**.”**

“Që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten.”

“Dhe duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë.”

"Por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) **e Zotit të tij, më të Lartit."**

"Dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!"

Komentimi

Shpenzimi dhe shpëtimi nga Zjarri

Në ajetet e kaluara, njerëzit ndaheshin në dy grupe, besimtarë dhe jobesimtarë, pra, grupi dorëdhënës dhe grupi koprrac. Gjithashtu, u fol për fatin e secilit grupe. Në ajetet që sapo cituam, së pari, flet për çështjen e udhëzimit, duke thënë se puna jonë është të udhëzojmë dhe jo të detyrojmë. Detyra juaj është që të vendosni dhe të jeni mbajtës të fjalës.

Përzgjedhja e kësaj rruge është në të mirën tuaj, sepse Ne nuk kemi asnjë nevojë.

Por, padyshim që udhëzimi është detyrë e Jona: **"Neve na përket që t'ua tregojmë Rrugën e Drejtë."**.

Pra, sigurisht që Rrugën e Drejtë do t'ua tregojmë Ne, si të jetë e natyrshme dhe racionale dhe si të jetë nëpërmjet Librit dhe traditës. Ne, çfarë ka qenë e nevojshme për t'u thënë, e kemi thënë dhe hakun e saj e kemi shlyer. Pa dyshim dhe sigurisht që Bota e

Përtejme dhe kjo botë është nga Ne: **"Dhe, me të vërtetë, e Jona është ajo botë dhe kjo botë!"**.[1]

Ne nuk kemi nevojë për bindjen dhe për besimin tuaj, për Ne bindja dhe besimi juaj nuk sjell asnjë dobi. Gjithashtu, as mëkati dhe mosbindja juaj nuk sjell dëm për Ne. Të gjitha këto janë për ju dhe në shërbimin tuaj.

Në përputhje me këtë komentim, *"udhëzimi"*, në këtë rast, ka kuptimin: *paraqet rrugën*. Gjithashtu, është dhënë mendimi, që qëllimi për këto dy ajete është nxitja e besimtarëve dorëdhënë, si dhe theksimi për të qenë bujar. Ne, të tillë njerëz, do t'i përfshijmë edhe më tepër në Rrugën e udhëzimit. Do t'ua lehtësojmë rrugën, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën e Përtejme. Ne e kemi në dorë, si dynjanë, ashtu edhe Botën e Përtejme, ndaj për Ne është e lehtë që ta bëjmë realitet atë çka themi.

Është e vërtetë që kjo botë, për nga ana e kohës, është më parësore se sa Bota e Përtejme, por për nga rëndësia dhe për realizimin e qëllimit përfundimtar, qëllimi kryesor është Ahireti, Bota e Përtejme, ndaj edhe për këtë arsye, është konsideruar si më parësore.

Për shkak se një prej degëve të udhëzimit është paralajmërimi dhe këshillimi, në ajetin në vazhdim thuhet: **"Prandaj Unë ju kam tërhequr vërejtjen me një zjarr që flakëron."**.

[1] *"Lami"* te fjala *"lel akhiretu"*, si dhe tek *"el huda"* duket se është me funksion theksimi. Në këtë rast ka ardhur tek emri *"inne"*, edhe pse shpeshherë vjen te fjalia dëftore. Në disa libra gjuhësie, kur fjala *"inne"* është parësore, *"lami"* vjen mbi emrin.

Tashmë, meqë është kështu, Unë ju frikësoj ju me zjarr.

Fjala *"teledh'dha"* vjen nga rrënja e fjalës *"ledha"* dhe ka kuptimin: *"flakë e pastër"*. Ne e dimë se flaka, kur është e pastër, pra, e pa përzier me tym, e ka të lartë gradën e nxehtësisë. Ndonjëherë fjala *"ledha"* është thënë për vetë Xhehennemin.

Më pas, grupi që hyn në këtë zjarr përvëlues dhe flakërues, digjet. All'llahu në Kur'an thotë se në këtë zjarr nuk futet kush, përveç grupit më fatkeq: **"Ku do të hidhet vetëm më i keqi."**.

Fjala *"eshka"* kumton se ata që mohuan ajetet dhe shenjat e All'llahut, duke i kthyer shpinën, do të dënohen: **"Që ka mohuar dhe është larguar nga besimi."**.

Prandaj edhe kriteri i lumturisë dhe i fatkeqësisë është besimi dhe mosbesimi. Këta janë të përfshirë me pasojat e veprave që kanë bërë, i merrnin të paqena të gjitha shenjat e udhëzimit dhe mundësitë për besim dhe devotshmëri.

Në fjalinë: **"që ka mohuar dhe është larguar nga besimi"** fjala *"tekdhijb"* ka mundësi të jetë për *"kufr"*, jo besimin. Fjala *"teuel'la"* flet për braktisjen e punëve të mira, sepse mosbesimi është mohim.

Gjithashtu, është e mundur që të dyja këto të flasin për braktisje të besimit. Në këtë mënyrë, në fillim mohon Profetin e All'llahut dhe më pas kthen shpinën përgjithmonë dhe largohet nga Ai.

Shumë komentues, përsa i përket këtij komentimi, janë të mendimit se në të ka problem dhe komentojnë se ajetet e

mësipërme tregojnë se zjarri është veçanërisht për jobesimtarët. Kjo gjë bie në kundërshtim me atë që kumtojnë disa ajete të tjera të Kur'anit dhe në një grumbull transmetimesh dhe hadithesh, se edhe besimtarët që kanë mëkatuar, kanë vend në zjarr.

Disa që janë të lëkundur dhe besojnë se, me ekzistencën e besimit, nuk bëjnë asnjë mëkat, këtë ajet e kanë marrë si argument për veten e tyre.

Duhet të kihen parasysh këto dy pika:

Së pari, qëllimi për hyrjen në Xhehennem, në këtë rast, është për ata që pandehin se janë të pavdekshëm, pra, kjo ide e pavdekshmërisë është cilësi e qafirëve. Simetria e kësaj fjale është nga ajetet që tregojnë, se edhe ata që nuk janë qafirë, futen në Xhehennem.

Së dyti, ajetet e mësipërme dhe ato në vazhdim, që thonë se ata që do të rrinë larg zjarrit të Xhehennemit, janë të devotshmit. Përgjithësisht dëshiron të shpjegojë grupin e parë, ata që janë të pa fe dhe koprracë dhe grupin e besimtarëve, që janë dorëdhënës dhe të devotshëm.

Nga këto dy grupe, vetëm grupi i parë do të hyjë në Xhehennem dhe grupi i dytë do të hyj në Xhennet. Kështu, në këtë mënyrë, nuk flitet fare për grupin e besimtarëve që mëkatojnë.

Me fjalë të tjera *"el hasru"* - *"kufizimi"* në këtë rast është i shtuar, a thua se Xhenneti është krijuar për grupin e dytë e Xhehennemi është krijuar vetëm për grupin e parë. Me këtë shpjegim qartësohet dhe merr përgjigje edhe një tjetër vështirësi që

është e lidhur me antagonizmin e ajeteve që po diskutojmë dhe ajeteve që do vijnë në vazhdim.

Më pas flitet për grupin që është larg zjarrit flakërues dhe përvëlues: **"E do të mbahet larg tij** (zjarrit) **më i devotshmi** (që ruhet nga gjynahet)**."**.

Shumë shpejt njerëzit e devotshëm do të qëndrojnë larg këtij zjarri përvëlues: ata që falën në Rrugën e All'llahut nga pasuria e tyre dhe patën për qëllim kënaqësinë dhe afrimin te All'llahu, patën për qëllim pastrimin e egos së tyre, si dhe të mallrave të tyre: **"Që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten."**.

Fjala *"jetezek'ka"* tregon afrimitetin dhe qëllimin e sinqertë. Sido që të jetë kjo fjali, pra, çfarëdolloj nijeti të ketë në këtë ajet, si arritjen shpirtërore, si arritjen e pasurisë së pastër, sepse et tezijetu ka ardhur me kuptimin e et tat'hijr, pastrim. Në ajetin 103 të sures "Et Teube" lexojmë: **"Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. All'llahu dëgjon dhe di gjithçka."**.

Më tej, për ta theksuar çështjen e sinqeritetit të tyre, për atë çka japin e falin në Rrugën e All'llahut, thotë: **"Dhe duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë, por vetëm për të kërkuar Fytyrën** (kënaqësinë) **e Zotit të tij, më të Lartit."**.

Me fjalë të tjera, shumë dhurime që bëhen në mesin e njerëzve, janë përgjigje për faljen që ka bërë personi përballë. Në të vërtetë, njohja e të vërtetës dhe përgjigjja me të mirë, është vepër e mirë, por llogaria e atyre që u largohen punëve të këqija dhe atyre që falin në Rrugën e All'llahut është e ndarë.

Ajetet e mëposhtme thonë se falja që bëjnë besimtarët punëmirë është ndryshe nga falja që bëjnë të tjerët. Dhurimi dhe falja në Rrugën e All'llahut, nëse është e sinqertë dhe jo për t'u dukur apo për t'u kthyer përgjigje atyre që të kanë respektuar më parë, ka një vlerë të jashtëzakonshme. Dhurimi duhet të jetë vetëm dhe vetëm për të kënaqur Krijuesin, pra, Zotin tonë.

Fjala *"uexh'hu"*, në këtë rast, ka kuptimin *"edh dhatu"* - *"qenie"* dhe ka për qëllim kënaqësinë e Qenies së Pastër të Krijuesit.

Fjala *"rab'bil a'la"* tregon virtytin e dhuruesit, ku tregon se kjo dhuratë dhe kjo mirësi është kryer me njohuri të plotë, si ndaj Krijuesit, ashtu edhe ndaj pozitës së lartë që ka Krijuesi.

Ky privilegj bën që çfarëdolloj nijeti i padobishëm apo jo i drejtë, të mohohet, sikurse është të dhuruarit për të pasur emër, apo për të tërhequr vëmendjen e njerëzve, apo për të krijuar një pozitë në shoqëri, e të tjera si këto. Kjo tregon se kuptimi i të dhuruarit për ata është i përqendruar vetëm e vetëm te kënaqësia dhe pëlqimi i Krijuesit e jo te kënaqësitë e tjera. Ato nuk janë të përfshira në sinqeritet.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje citohet shpërblimi i madh dhe i pa krahasueshëm i këtij grupi. Ai përshkruhet në një fjali të shkurtër: **"Dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!"**.

Një person i tillë, me këtë personalitet, do të shpërblehet së shpejti.

Po, ashtu sikurse ai punon për të kënaqur All'llahun, po ashtu edhe All'llahu e kënaq atë.

Kënaqësia dhe pëlqimi është absolut dhe pa kushte.

Kënaqësia dhe pëlqimi është i përhapur dhe pa kufi.

Kënaqësia është plot kuptimin, kur në të janë të përmbledhura të gjitha mirësitë.

Kënaqësia është e tillë, saqë edhe në ditët e sotme, ajo është e paimagjinueshme. E çfarë mirësie kërkojmë ne më tepër se kaq?

Po, Krijuesi është i lartë, po ashtu edhe shpërblimi dhe dënimi i Tij është i lartë. Ne nuk mund të imagjinojmë më mirë se kënaqësinë e Tij absolute për krijesat.

Disa komentues janë të mendimit se përemri te fjala "*jerda*" kthehet te Zoti, që do të thotë se shumë shpejt All'llahu do të kënaqet nga ky grup. Kjo është një dashuri e madhe dhe e pakrahasueshme, që All'llahu i Madhëruar e jep për një rob të tillë. Kjo kënaqësi është absolute, pa kushte. Sigurisht që pas kënaqësisë së Krijuesit, vjen kënaqësia dhe pëlqimi i robit të Zotit, rob me besim dhe i devotshëm. Që të dyja këto kënaqësi janë të domosdoshme për njëra-tjetrën, sikurse edhe lexojmë në ajetin 8 të sures "El Bejjine": **"...All'llahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë..."**. Përmendim ajetin 28 të sures "El Fexhr": **"Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!"**. Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Hulumtime

1- Disa fjalë për shkakun e zbritjes së sures "El Lejl"

Fakhru Rrazij thotë: "Komentuesit e Ehli Synetit, në përgjithësi, janë të mendimit dhe besojnë se fjala *"Etka"* tek ajeti: "*Sejexhenne'buhal Etka"*, ka për qëllim Ebu Bekrin. Ndërsa Ehli Bejti këtë mendim e mohon dhe thotë se ajeti ka për qëllim Ali Ibn Ebu Talibin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe se ajeti ka zbritur për Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.[1]

Më pas, në një analizë të veçantë thotë kështu: "Umeti islam, si Ehli Syneti dhe Ehli Bejti, është në një mendim se personi më i mirë ndër njerëz, pas të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ishte ose Ebu Bekri, ose Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, dhe këtë ajet nuk mund ta krahasojmë me Aliun, sepse Kur'ani, për këtë person, thotë i devotshëm: **"Dhe duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë"**[2]. Më tej shton se askush nuk ka pranë tij të drejtë apo mirësi që të marrë shpërblim, ndaj kjo cilësi nuk përputhet me Imam Aliun, sepse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte të drejtë mbi të, sepse e kishte strehuar, ushqyer, edukuar etj. Ndërsa sa i përket Ebu Bekrit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte asnjë të drejtë materiale ndaj tij. Për shkak se ishte Ebu Bekri që i kishte dhuruar Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ai kishte të drejtën

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 31, f. 204.
[2] Sure "El Leil" ajeti,19.

e shpërblimit! Përfundimi del i tillë, meqë shembulli i fjalës *etka"*[1] është Ebu Bekri dhe fjala *"etka"* ka kuptimin "më i drejti i njerëzve", atëhere epërsia e tij vërtetohet.[2]

Edhe pse nuk më pëlqen të diskutoj shumë për çështjet dhe temat e këtij tefsiri, por këmbëngulja e disa komentuesve, që nëpërmjet ajeteve të Kur'anit, kërkojnë të vërtetojnë interpretimet e tyre, që nuk janë aspak të përshtatshme me pozitën e ndritur të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, bëhet shkak që t'u rikujtoj disa pika.

Së pari, Fakhru Rrazij thotë se Ehli Syneti është i mendimit se ky ajet ka zbritur për Ebu Bekrin. Ky mendim është në kundërshtim me mendimin e disa komentuesve të Ehli Synetit, sikurse është komentuesi i njohur Kurtubi. Ai, në një hadith të Ibn Abasit, thotë se e gjithë kjo sure ka zbritur për Ebu El Deh Dahin (tregimin e saj e sollëm në fillim të sures),[3] veçanërisht për ajetin 17 të sures "Lejl": **"E do të mbahet larg tij** (zjarrit) **më i devotshmi** (që ruhet nga gjynahet)**."**.

Përsëri thotë se ka për qëllim Ebu El Deh Dahin, edhe pse shumica e komentuesve thonë kështu, por vetë nuk e ka pranuar këtë.

Së dyti, kur thotë se edhe shi'itët janë të të njëjtit mendim, se ky ajet ka zbritur për Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, nuk është e vërtetë, sepse shumica e komentuesve shi'itë tregojnë ngjarjen e Ebu Ed Dehdah dhe e kanë pranuar këtë. Po, në disa

[1] Sure "El Lejl", ajeti 5.
[2] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 31, f. 204.
[3] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7180.

hadithe të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është transmetuar se fjala *"Etka"* ka për qëllim ndjekësit dhe shi'itët e tij, ndërsa qëllimi i ajetit 18: **"Që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten.",** i dedikohet Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Është e qartë se këto nuk kanë shkak zbritje, por nga përputhja është e qartë.

Së treti, fjala *"etka"*, në ajetin e mësipërm, nuk ka kuptimin: *"më i devotshmi ndër njerëzit"*, por vjen me kuptimin: *"të jesh i devotshëm"*. Përveç kësaj, ky ajet ka zbritur, kur Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte gjallë. A mund të dalë Ebu Bekri, para Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?

Edhe nëse thuhet; se llogaria e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është e veçantë, themi; po përse në ajetin: **"Dhe duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë."**, nuk është veçuar llogaria e tij, dhe për të përjashtuar Aliun *(Paqja qoftë mbi të)* nga ajeti, të thëmi: Meqënëse Aliu *(Paqja qoftë mbi të)* ishte i përfshirë nga mirësitë materjale të Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk mundet të jetë i përfshirë në ajet?

Së katërti, kush është ai person që nuk është i dashur për dikë e të mos i kenë bërë një dhuratë, apo të mos e kenë vizituar atë? A ishte e vërtetë që Ebu Bekri, gjatë gjithë jetës së tij, nuk ka shkuar te askush dhe nuk i ka bërë dhuratë askujt? A ka ndodhur me të vërtetë kështu që Ebu Bekri gjatë gjithë jetës së tij të mos ketë vajtur të vizitojë njeri, dhe që nuk ka pranuar asnjë dhuratë, apo asnjë mirësi tjetër materiale? A është e besueshme kjo? Përfundimi është i tillë; qëllimi i ajetit **"Dhe duke mos pritur shpërblim prej**

dikujt tjetër për këtë."[1], nuk ka për qëllim që asnjë nuk ka të dretë mirësie mbi ta, përkundrazi dhënia e lëmoshës nuk është për hirë të së drejtës së mirësisë.

Pra, nëse ata i falin dikujt, është vetëm për hir të Zotit dhe jo për qëllim që të marrin shpërblim për atë që bënë.

Së pesti, ajetet e kësaj sureje tregojnë se kjo sure ka zbritur për dy ndodhi, njëra është për *"etka"* - *"më i devotshmi ndër njerëzit"*, dhe tjetra për *"eshka"* - *"Më i keqi"*. Kur të merret vesh shkaku i zbritjes, pra, që është për Ebu Ed Dehdahin, atëherë çështja është e zgjidhur. Por nëse do të themi se shkaku i zbritjes është për Ebu Bekrin, atëherë mbetet për t'u zgjidhur se kujt i adresohet fjala *"eshka"*.

Shi'itët nuk këmbëngulin se ky ajet është vetëm për Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, sepse ka shumë ajete që përshkruajnë dinjitetin e tij. Nëse do ta përputhim me Imam Aliun, çështja e *"eshka"*, është e zgjidhur, sepse janë transmetuar hadithe të shumta për ajetin 12 të sures "Esh Shems", të cilat i ka mbledhur Hakim Hesekanij, në veprën "Sheuahid Tenzijl".

Me fjalë përmbledhëse, analiza e Fakhru Razij për këtë ajet, është shumë e dobët dhe me shumë gabime. Ndaj edhe shumë komentues të njohur të Ehli Synetit, sikurse është Alusij në veprën "Ruhul Meanij", nuk e ka pranuar këtë arsyetim të tij.[2]

[1] Sure "El Lejl" ajeti,19.
[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 30, f. 153.

Mirësia e dhënies për hir të Zotit

Dhënia për hir të Zotit dhe ndihma materiale për njerëzit në nevojë, duke pasur nijet të pastër, është prej çështjeve që në Kur'anin e Shenjtë është folur vazhdimisht dhe citohet si ndër shenjat e besimit.

Gjithashtu, edhe transmetimet e shumta e theksojnë këtë fakt, ku tregojnë se në kulturën e fesë islame, të japësh për hir të Zotit, është një ndër veprat më të mira, por gjithmonë, që të ketë nijet të pastër dhe sinqeritet.

Këtë diskutim do ta plotësojmë me disa hadithe.

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë se puna më e dashur pranë Zotit, është: qetësimi i zemrës së besimtarit nevojtar, duke e ngopur atë ose duke i larë borxhet.[1]

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet se ndër shenjat e besimit, është: mirësia, furnizimi me ushqim, bërja kurban.[2]

Në një tjetër hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"Nuk shoh gjë më të përshtatshme, kur shkoj të vizitoj një besimtar, se sa ushqyerja e tij. Kush ushqen një besimtar, për hir të Zotit, ai nuk mbetet pa u ushqyer nga ushqimi i Xhennetit."*.[3]

Në një hadith tjetër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet se, kur dikush e

[1] "Biharul Enuar", vëll. 74, Hadithi 35, f. 365.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 74, Hadithi 39, f. 365.
[3] "Biharul Enuar", vëll. 74, Hadithi 79, f. 378.

pyeti Profetin për veprën më të pëlqyer se gjithë të tjerat, ai u përgjigj: *"Të ushqesh nevojtarët dhe të jesh gojëmbël me ta."*.[1]

Hadithi tjetër i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për këtë çështje, thotë: *"Ai që mban në shtëpi si mik për një ditë e një natë një familje myslimane, Zoti i fal të gjitha mëkatet."*.[2]

O All'llah! Na jep mundësinë që të jemi kontribues në këtë rrugë të madhe!

O All'llah! Na i shto të gjitha veprat tona të mira, për hir të nijetit të sinqertë!

O All'llah! Kërkojmë prej Teje mirësi dhe mëshirë të pafundme, që edhe Ti të jesh i kënaqur prej nesh, edhe ne të jemi të kënaqur e të gëzuar!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Lejl".

[1] "Biharul Enuar", vëll. 74, Hadithi 113, f. 388.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 74, Hadithi 2, f. 389.

Sure "Ed Duhâ"

Zbritur në Mekë

Ajete 11

Përmbajtja e sures "Ed Duhâ"

Kjo sure është sure mekase. Sipas transmetimeve, kur zbriti kjo sure, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i shqetësuar, sepse pati ndërprerje dhe vonesë në zbritjen e ajeteve, kështu që gojët e armiqëve u hapën. Surja zbriti dhe qëndroi në zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* sikurse qëndron shiu i mëshirës. Ajo i dha forcë Profetit dhe gojët e liga u mbyllën.

Kjo sure nis me dy betime. Në fillim i jep Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lajmin, se All'llahu kurrë nuk e braktis.

Më pas, All'llahu i Madhëruar i premton Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se do t'i dhurojë plot gjëra që të kënaqet.

Në pjesën e fundit flet për jetën e kaluar të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke kujtuar se si ai ka qenë gjithmonë i përfshirë nga mirësitë. Gjithashtu, në periudhat më të vështira, Ne e kemi mbështetur.

Në ajetet e fundit të sures urdhërohet që të falënderojë për të gjitha këto mirësi, të ndihmojë nevojtarët e jetimët dhe të tregojë mirësitë që All'llahu i ka dhuruar.

Mirësitë e leximit të sures "Ed Dhuhâ"

Për sa u përket mirësive të kësaj sureje, është i mjaftueshëm vetëm ky hadith i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Ai që e lexon këtë sure, do të jetë prej atyre që All'llahu është i kënaqur me ta dhe Muhammedi (Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) do të jetë shefi për të, dhe për çdo jetim, që do të interesohet apo kujdeset si dhe për çdo nevojtarë, shpërbilim i tij do të jetë dhjetë herë më shumë se sa masa."*.[1]

Të gjitha këto mirësi janë për ata që e lexojnë dhe i vënë në veprim ato që thuhen në sure.

Duhet të kihet kujdes se, sipas disa transmetimeve, kjo sure dhe surja në vijim, "El Neshr" janë një, ndaj edhe për këtë arsye, në çdo rekat të namazit, pas sures "Hamd" duhet të recitojmë një sure të plotë. Këto dy sure duhet të recitohen së bashku. E ngjashme me këtë është edhe surja "Fil", edhe surja "El Kurejsh".

Nëse i studiojmë me vëmendje përmbajtjet e këtyre dy sureve, shikojmë që lidhja e tekstit është shumë e fortë, saqë në të duhet të ketë një vazhdim, edhe pse midis tyre ekziston *"Bismilahir Rrahmamir Rrahim"* – *"Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!"*

Për sa i përket faktit që këto sure janë të njëjta nga çdo aspekt apo përgjatë faljes së namazit duhet të recitohen si një sure, ka diskutim midis komentuesve. Këtë shtjellim apo komentim duhet

1 "Mexhmaul Bejan" vëll, 10, f. 503.

ta shikojmë në librat e Fik'hut, në çështjen e leximit të sureve në namaz. Shumica e dijetarëve janë të mendimit se nuk duhet të mjaftohemi me njërën prej këtyre dy sureve.

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالضُّحَى۝١ وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَى۝٢ مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَى۝٣ وَلَلْآخِرَةُ خَيْرٌ لَكَ مِنَ الْأُولَى۝٤ وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَى۝٥﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"Betohem në shkëlqimin e paradites."

"Dhe në natën kur terret e qetësohet."

"Se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhammed)**!"**

"Natyrisht, Jeta e Ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë."

"E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur."

Shkaku i zbritjes

Për sa i përket shkakut të zbritjes së kësaj sureje janë transmetuar hadithe të shumta. Transmetimi më i qartë është: "Ibn Abasi thotë: 'Kishin kaluar pesëmbëdhjetë ditë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) nuk po i zbriste zbulesa'. Politeistët thanë: Zoti e ka braktisur Muhammedin dhe e ka bërë armik. Nëse ju thoni të vërtetën, se detyra juaj është nga ana e Zotit, atëherë përse shpallja nuk vjen në mënyrë të rregullt?

Pasi politeistët thanë këto fjalë, zbresin ajetet e mëposhtme, për t'u dhënë përgjigje atyre".

Sipas një hadithi, kur kjo sure zbriti, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Xhebrailit: *"U vonove, po të prisja me shumë entuziazëm." Unë kam qenë më shumë i përmalluar dhe më i etur për ty, por unë jam rob e urdhrat i marr nga Krijuesi dhe asgjë nuk më shpallet pa Urdhër të Krijuesit!* – tha Xhibraili.

Në një tjetër hadith, thuhet: "Një grup prej jehudive shkuan pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e pyetën për ngjarjen e Dhul Karneijn, As'hab Kehfin dhe për krijimin e shpirtit. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Nesër do t'ju përgjigjem."*. Nuk tha: "Inshalla" – "Në dashtë All'llahu". Ky ishte shkaku që zbulesa Hyjnore për një kohë u ndërpre. Nga kjo gjë mori shkas edhe armiku dhe nisi të flasë poshtë e përpjetë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u dëshpërua. Kjo sure zbriti për t'i dhënë kurajë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky shkak i zbritjes së sures duket i largët. Nuk është i pranuar, sepse kontakti i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me jehuditët dhe këto lloje pyetjesh kanë ndodhur në Medine dhe jo në Mekë.

Në disa transmetime thuhet se një grup myslimanësh thanë: "O i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përse nuk po të zbret Shpallja?" Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *"E si të më shpallet Zbulesa, kur ju nuk i lani gishtat e këmbës (ndërmjet gishtërinjve) dhe nuk i prisni thonjtë tuaj?!"*[1]

Për sa i përket kohës së ndërprerjes së Shpalljes, ka transmetime të ndryshme. Disa transmetues thonë se koha e ndërprerjes ka qenë njëmbëdhjetë ditë, pesëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzet e pesë, e të tjerë janë të mendimit se ka zgjatur dyzet ditë.

Në një transmetim tjetër thuhet se koha e ndërprerjes së shpalljes ka qenë dy apo tre ditë e net.

Komentimi

Do të të japë që ti të jesh i kënaqur

Në fillim të ajetit të kësaj sureje përballemi me dy betime, betimi në *"nur"* – *"dritë"* dhe betimi për *"dhulmet"* – *"terr"*: **"Betohem në shkëlqimin e paradites dhe në natën kur terret e qetësohet."**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 504 (me pak ndryshime).

Fjala *"duha"* ka kuptimin: *paradite*. Është koha, kur dielli ngjitet në kulmin e tij dhe drita e rrezet e tij përfshijnë gjithë vendin. Në të vërtetë, ajo është koha më e mirë e ditës.

Sipas interpretimit të disa komentuesve, paraditja konsiderohet si periudha e rinisë, sepse në atë periudhë të pranverës koha nuk është ngrohur akoma, por është thyer i ftohti i dimrit. Në këtë kohë shpirti dhe zemra e njeriut është e gatshme të ushtrojë çfarëdolloj aktiviteti.

Fjala *"sexha"* vjen nga rrënja e fjalës *"es sexhui"* ose *"es sexhu"*dhe ka kuptimin: *qëndroj* në *qetësi, mbuloj* dhe *bëhet errësirë*. Edhe kur xhenazen e mbështjellin në qefin, i thonë *"musexhxha"*.

Në këtë rast, ka kuptimin e parë, *qëndroj* dhe *qetësi*. Për këtë shkak, netëve kur nuk fryn erë, u thuhet *"lejletun saxhijetun"* - *"natë e qetë"*.

Gjithashtu, edhe *"bahrun saxhun"* - *"deti i qetë"*, e ka marrë këtë emër, sepse nuk ka dallgë dhe nuk ka tufan.

Sido që të jetë, është e rëndësishme se përgjatë natës qetësia është udhëheqëse. Natyrisht që nervat dhe shpirti i njeriu përgjatë natës bien në qetësi. Ato pushojnë e qetësohen për të qenë të gatshme për ditën e nesërme. Ndaj edhe e meriton që të betohesh për natën, sepse, po ta shikojmë nga këndvështrimi i mirësive, ajo qetësi dhe rehati është shumë e rëndësishme.

Midis këtyre dy betimeve dhe përmbajtjes së ajetit ka ngjashmëri dhe lidhje të afërt. Dita është sikurse zbulesa hyjnore, në zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi*

të dhe mbi familjen e tij!), ndërsa nata është sikur ndërprerja e Shpalljes, e cila është e nevojshme në disa periudha.

Në ndjekje të këtyre dy betimeve të mëdha, flet për përfundimin dhe rezultatin e këtyre betimeve: **"Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren** (o Muhammed)**!"**.[1]

Zoti yt nuk të ka braktisur kurrë. Asnjëherë nuk është zemëruar me ty o Muhammed.

Fjala *"uede'a"* vjen nga rrënja e fjalës *"et teudi'u"* dhe ka kuptimin: *braktisje* dhe *lamtumirë*.

Fjala *"kala"* vjen nga rrënja e fjalës *"kela"* dhe ka kuptimin: *urrejtje së madhe*. Gjithashtu, kjo fjalë vjen edhe nga rrënja e fjalës *"el kaleu"* dhe ka kuptimin: *hedh tutje*.

Ragibi është i mendimit se të dyja këto kthehen në një kuptim, sepse ai që është i urryer dhe armik i njeriut, duket sikur atë njeri ti e hedh tutje dhe zemra nuk e pranon më afër.

Ky interpretim është për të ngushëlluar dhe për t'i dhënë zemër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të dijë se, nëse ndonjëherë ka vonese në Shpalljen e ajeteve, ajo është në të mirë të tij e jo për ta ndëshkuar, sepse All'llahu kurrë nuk e ndëshkon të dashurin e Tij. Ndaj ajo

[1] Kjo sure i është shpallur Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pas një periudhe të gjatë ndërprerjeje të Shpalljes Hyjnore, gjatë së cilës Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i është dashur të durojë shpotitë e jobesimtarëve dhe talljet e armiqve të tij më të këqij. Gruaja e xhaxhait të tij, Ebu Lehebit, e tallte, duke i thënë: "Zotëria yt të ka braktisur".

ndërprerje dhe shkëputje nuk ka qenë kurrë si rezultat i asaj që thanë armiqtë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjithmonë ka qenë dhe do të jetë vazhdimisht i mbrojtur dhe i mbështetur nga All'llahu i Madhëruar dhe i Plotfuqishëm.

Më pas All'llahu i Madhëruar shton: **"Natyrisht, Jeta e Ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë."**.

Pa dyshim që bota e Ahiretit për ty është më e mirë se sa kjo dynja.

Ti në këtë botë je i mbushur me mirësitë dhe begatitë e All'llahut dhe në Botën e Përtejme më shumë dhe më mirë. Nuk do të jesh as për kohë të shkurtër dhe as për kohë të gjatë armik dhe i urryer nga Zoti.

Me pak fjalë, ti në këtë botë dhe në Botën e Përtejme je i dashur për All'llahun.

Disa komentues janë të mendimit se fjalët *"akhiret"* dhe *"eula"* flasin për fillimin dhe fundin e jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Gjithashtu, ata thanë se këto fjalë kanë për qëllim të tregojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të jetë i fituar, si në fillim të jetës, ashtu edhe në fundin e saj: me përhapjen e fesë islame, me fitoret e vazhdueshme të myslimanëve ndaj armiqve të tyre, me përhapjen e farës së unitetit, ndikimet e idhujtarëve pakësohen.

Përmbledhja e këtyre dy komentimeve është pa kuptim.

Ajeti i fundit që po diskutojmë, tregon se Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i është premtuar premtimi më i mirë: **"E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur."** Shumë shpejt, Zoti yt, ty do të të japë shumë, që ti të jesh i kënaqur.

Ky është respekti dhe nderi më i lartë që All'llahu i bën robit të Tij, Muhammedit *(Paqja e bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ne të falim ty në masën që ti të jesh i kënaqur. Në këtë botë do të jesh i fituar ndaj armiqve, feja jote do të përhapet në të gjithë botën. Edhe në Ahiret do të jesh i përfshirë dhe i mbushur me plot dhurata.

Pa dyshim që Profeti i Nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si vula e të gjithë Profetëve dhe si udhëheqës i botës njerëzore, nuk e ka kënaqësinë vetëm në shpëtimin e tij, por ai është i kënaqur dhe i lumtur kur do t'i pranohet shefaeti për ymetin e tij. Për këtë arsye, në shumë transmetime thuhet se ky ajet jo vetëm është ajeti më shpresëdhënës ndër ajetet e Kur'anit të Shenjtë, por edhe është argument për praninë e shefaetit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* transmeton nga babai i tij, Zejnul Abidijni *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, nga xhaxhai i tij, Muhammed ibn Hanefijeh, nga babai i tij, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se i Dërguari i All'llahut ka thënë: "*Në Ditën e Kiametit unë do të qëndroj në qendër të shefaetit. Do*

të jem shefi i shumë mëkatarëve, saqë All'llahu do të thotë: 'O Muhammed, a je i kënaqur?!'

Unë do t'i them: *'U kënaqa, u kënaqa!'*

Në atë moment, Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u drejtua drejt një grupi nga njerëzit e Kufes dhe tha: 'Ju besoni se ajeti më shpresëdhënës në Kur'an është: *'O ju që keni mëkatuar shumë, mos qëndroni të pashpresë nga mëshira e All'llahut!'*

Ata thanë: 'Po, ne kështu themi!'

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* tha: *'Ne të Ehli Bejtit themi se ajeti më shpresëdhënës në Kur'anin e Shenjtë është ajeti 5 i sures Duha : "Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar"*.[1]

Është e qartë, edhe pa u thënë se shefaeti i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka kushte. Jo çdo mëkatar do të mund të ketë këtë lloj pritje.[2]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"I Dërguari i All'llahut hyri në shtëpinë e Hazreti Fatimes (Paqja e Zotit qoftë mbi të!). Pa që vajza e tij kishte veshur rroba të thurura nga leshi i devesë. Ishte ulur. Me njërën dorë po bluante grurin dhe me dorën tjetër po ushqente djalin e saj.*

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përlot dhe i tha: *'Bija ime! Duroje hidhërimin*

[1] Abul Fetuh Razi, vëll. 12, f. 110.

[2] Komentimin e këtij diskutimi mund ta shikoni në vëllimin e parë, në vazhdim të ajetit 48 të sures "El Bekare".

e kësaj bote, sepse në Botën Tjetër do të ëmbëlsohesh, sepse All'llahu nëpërmjet Shpalljes së ajetit, më thotë **"E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur."**.[1]

Hulumtim

Filozofia e ndërprerjes së ardhjes së Shpalljes

Duke parë ajetet e mësipërme, qartësohet shumë mirë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* çdo gjë që e ka, e ka nga ana e All'llahut. Edhe për Shpalljen e ajeteve, ai nuk ka asnjë autoritet. Çdo herë që All'llahu dëshiron, e ndërpret Shpalljen dhe, kur dëshiron, e sjell përsëri. Ndoshta kjo ndërprerje ka qenë për t'u dhënë përgjigje atyre që mendojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* bën kërkesa sipas dëshirës dhe sipas kënaqësisë së tij. Ka pasur edhe nga ata që i propozonin Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të ndryshojë urdhrat apo ajetet. Ai thoshte se nuk kam asnjë autoritet në këto çështje. Kjo gjë është cituar edhe në ajetin 15 të sures "Junus".

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 505. Vërtet kjo sure ka zbritur në Mekë dhe ndodhia e Hazreti Fatimes *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka të bëjë me qytetin e Medines, por Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* këtë ajet e argumenton për veten dhe qëllimin e tij dhe jo që ajeti ka zbritur në atë kohë në Medine.

Ajetet 6 – 11

﴿أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَآوَىٰ ٦ وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَىٰ ٧ وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَىٰ ٨ فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ ٩ وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ ١٠ وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ ١١﴾

"A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?"

"A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) **e të udhëzoi?"**

"A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?"

"Prandaj, mos e shtyp jetimin."

"Lypësin mos e shty me ashpërsi."

"Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!"

Komentimi

Në falenderim për të gjitha mirësitë e All'llahut

Sikurse e thamë qëllimi i kësaj sureje është mbështetja dhe ngushëllimi i Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, dhe shprehja e mirësisë dhe dashurisë së Krijuesit në lidhje me Profetin *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut*

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ndaj në vazhdim të ajeteve, do të flitet për këtë temë.

Së pari, do të flasim për tri prej dhuratave të veçanta Hyjnore që All'llahu i ka bërë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Më pas do të flasim për tri prej urdhrave të rëndësishme që kanë të bëjnë me të. **"A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?"**

Kur të vdiq babai, ti ishe në barkun e nënës. Të edukuam në prehrin dhe në krahët e Abdul Mutalibit.

Kur nëna të vdiq, nuk ishe më shumë se 6 vjeç. Ishe i vetëm, edhe pa nënë, por ne shtuam dashurinë dhe mirësinë e Abdul Mutalibit ndaj teje.

Nuk ishe më shumë se tetë vjeç, kur gjyshi yt u largua nga kjo botë dhe të mori në kujdestari Ebu Talibi, që të kujdesej për ty në mënyrën më të mirë të mundshme.

Po, ti ishe jetim dhe Ne të mbrojtëm ty.

Disa komentues kanë dhënë një tjetër kuptim këtë ajet, kuptim i cili nuk është në përputhje me paraqitjen e jashtme të ajetit, përfshirë këtu edhe ky mendim se: jetim do të thotë apo përfshin këtu edhe atë i cili nuk ka asnjë të barabartë në nder dhe vyrtyt. Sikurse thonë ata, pra, kuptimi i fjalisë është si më poshtë: Zoti ju gjeti në " Luginën e jetimit" si një perlë unike të nderit dhe hirit të pashëmbullt, kështu që Ai ju zgjodhi dhe ju dha statusin e një Profeti. Ndaj dhe kuptimi i fjalisë bëhet i tillë: "All'llahu të ka dhënë ty nder dhe cilësi të pakrahasueshme, ndaj dhe të ka përzgjedhur dhe të ka dhuruar postin e Profetësisë". Kuptimi tjetër

është: Ti vetë një ditë ishe jetim, por dole fitimtar dhe u bërë mbrojtësi i jetimëve dhe udhëheqësi i njerëzisë. Pa dyshim që kuptimi i parë është më i përshtatshëm dhe me pamjen e jashtme të ajetit është më afër.

Më tej flet për dashurinë e dytë e thotë: **"A nuk të gjeti të paditur** (për Islamin) **e të udhëzoi?"**.

Po, ti kurrë nuk pate dijeni për Profetësinë e as për Shpalljen. Këtë dritë e hodhëm Ne mbi zemrën tënde, që nëpërmjet saj të udhëzosh njerëzit.

All'llahu, në një ajet tjetër, thotë: **"Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty Shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë. Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi. Por atë** (Kur'anin)**, Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robtë Tanë. Ti, me të vërtetë, udhëzon në Rrugën e Drejtë."**.[1]

Ti nuk ke dituar as për librin e as për besimin, sipas përmbajtjes së Kur'anit dhe fesë islame, pa t'u shpallur, por ne vendosëm në zemrën tënde dritë, që nëpërmjet saj të udhëzojmë çdo krijesë Tonën.

Është e qartë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, para se të arrinte këtë pozitë, pra, para se të merrte pozitën e të Dërguarit dhe të Profetit, i kishte këto cilësi Hyjnore. All'llahu kishte kapur dorën e tij, e kishte udhëzuar dhe e kishte ulur në këtë pozitë, sikurse edhe e shikojmë në ajetin 3 të sures "Jusûf": **"Ne të tregojmë ty** (Muhammed) **historinë më**

[1] Sure "Esh Shûra", ajeti 52.

të bukur përmes Shpalljes së këtij Kur'ani, ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni më parë.".

Nëpërmjet Shpalljes së këtij Kur'ani Ne të tregojmë ty, tregime e ngjarje nga më të mirat, sepse më parë ishit të paditur për këto histori.

Pa dyshim që, nëse udhëzimi i Allahut dhe ndihma e fshehtë që i jepej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk do të ishte, ai kurrë nuk do të mund të arrinte qëllimin.

Ndaj dhe qëllimi i fjalës "dhelalet" devijim, në këtë rast, nuk mohon besimin, njëshmërinë, pastërtinë dhe devotshmërinë. Por, nëse shikojmë simetrinë e ajeteve më lart, dallojmë qartë se flitet për mohimin e njohjes së të fshehtës së profetësisë dhe ligjeve islame. Gjithashtu, flet për mosnjohjen e kësaj të vërtete, sikurse edhe e thonë shumë komentues. Por pas Shpalljes së Profetësisë, me ndihmën e All'llahut, të gjitha këto çështje iu bënë të ditura.

Në ajetin 282 të sures "El Bekare", kur flitet për filozofinë e numrit të dëshmitarëve, për sa i përket çështjes së shkrimit të testamentit të borxhit, thotë: **"...nëse njëra grua harron, t'ia kujtojë tjetra..."**.[1]

[1] Islami synon të parandalojë gjithçka që mund të shkaktojë trazira në gjirin e bashkësisë së myslimanëve. Çështjet që kanë të bëjnë me paranë, janë nga shkaqet kryesore të kontradiktave midis njerëzve, prandaj All'llahu i Madhërishëm na urdhëron t'i rregullojmë ato nëpërmjet dokumenteve të shkruara dhe dëshmitarëve.

Kjo gjë bëhet për shkak se, nëse njëri prej dy dëshmitarëve del nga Rruga e Drejtë e harron, tjetri i sjell në mend atij atë çka është harruar.

Në këtë ajet, fjala *"dalalet"* është cituar me kuptimin: *harresë*, sepse është e bazuar sipas simetrisë së fjalës *"fetudhek'kir"* – *"rikujtoj"*.

Po ashtu, janë cituar komentime të shumta për ajetin, si për shembull, disa thonë se ajeti ka për qëllim të tregojë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i panjohur, por All'llahu i Madhëruar e deshi aq shumë, saqë i dhuroi plot e përplot mirësi. Atë e bëri të njohur në të gjithë vendin.

Edhe pse përgjatë fëmijërisë t'i humbe disa herë, Ne të mbështetëm dhe të vendosem në mbrojtjen e Abdul Mutalibit.

Një herë tjetër të shpëtuam, kur ti po ktheheshe me nënën tënde nga qyteti. Të mbante dhe të ushqente me qumësht Halime Sa'dije. Pas mbarimit të periudhës së ushqyerjes me gjoks, po të kthente drejt Mekës, që të të dorëzonte tek Abdul Mutalibi. Aty humbe përgjatë rrugës.

Hera e tretë që të shpëtuam, ishte kur humbe me xhaxhanë tënd, Abu Talibin, përgjatë rrugës së Shamit. Në çdo herë që ke humbur, Zoti të ka udhëzuar dhe të ka mbështetur, duke të vendosur në duart dhe krahët e gjyshit dhe të xhaxhait.

Duhet të dihet se fjala *"dal'lun"*, sipas fjalorit, ka dy kuptime: *i humbur dhe i hutuar*. Për shembull thuhet: " "Dija, është thesari i humbur i njeriut besimtar".[1]

Për këtë shkak, fjala *"daletun"* ka marrë edhe kuptimin *i fshehur dhe në mungesë*, prandaj edhe në ajetin 10 të sures "Es Sexhde" lexojmë që mohuesit e Ringjalljes thoshin: **"'Vallë, pasi të humbasim nën tokë, përsëri do të ngjallemi?'..."**.

Nëse fjala *"daletun"*, në ajetin për të cilin po diskutojmë, ka kuptimin *"humbas"*, nuk ka problem, por, nëse ka kuptimin *"i humbur"*, ka për qëllim të tregojë se para Shpalljes së Profetësisë, nuk ka pasur mundësi informacioni për të Dërguarin e All'llahut.

Me fjalë të tjera: Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk pati asgjë vetë, çdo gjë që e kishte, e kishte nga ana e All'llahut, ndaj dhe fjala *"dalen"*, te të dy mënyrat, nuk ka dhe nuk shkakton asnjë problem.

Më pas shpjegon dhuratën e tretë: **"A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?"**. All'llahu ty të gjeti të varfër, më pas të bëri të pasur dhe pa nevoja.

All'llahu bëri që Hadixhes, asaj gruaje me besë dhe të pastër, ti tërheqë vëmendjen ndaj teje. Aq shumë i tërhoqi vëmendjen ndaj teje, saqë pasurinë e saj e vendosi në dispozicionin tënd dhe në shërbim të qëllimit tënd të madh.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 148.

Gjithashtu, pas shfaqjes së fesë islame, të bëri për pjesë shumë pasuri nga ato të luftës, me qëllim që të mos kesh nevojë për asgjë, për të arritur qëllimin e madh.

Në një hadith të Imam Ali ibn Musa Rrida *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në komentim të këtij ajeti, lexojmë: "Pyetja: **'A nuk ishe jetim?',** do të thotë se ti ishe vetëm, që nuk ngjan me të tjerë në mesin e krijesave. Më pas, njerëzit i la nën mbrojtjen tënde.

Pyetja: **'A nuk të gjeti të paditur** (për Islamin) **e të udhëzoi?'**, kumton se ti ishe në mesin e njerëzve të humbur, në mesin e popullit që nuk e dinte pozitën e mirësisë tënde, por më pas ata i drejtoi kah ty, duke u bërë mbrojtësi i popujve në këtë botë. Nëpërmjet teje, ata i bëri që të mos jenë nevojtarë".[1]

Kur bisedohet për mirësitë dhe dashurinë, në lidhje me të dashurin e zemrës, në vetvete, është mirësi dhe dashuri, si dhe konsiderohet argument për dashamirësinë e veçantë që ka për të. Për këtë arsye, duke dëgjuar këto fjalë nga ana e të dashurit, shpirti i tij rinohet dhe zemra e tij bie në thellësinë e qetësisë.

Më pas, në ajetet në vazhdim, flitet për tri urdhra, që konsiderohen si rezultat i ajeteve të lartpërmendura. Këto tri urdhra shumë të rëndësishme i jepen Profetit Muhammed *(Paqja bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Edhe pse adresuesi në këto ajete është vetë i Dërguari i All'llahut *(Paqja bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sigurisht që i përfshin të gjithë. Në fillim thotë: **"Prandaj, mos e shtyp jetimin."**.

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 506.

Meqë është kështu, ti mos e përbuz jetimin.

Fjala *"tak'har"* vjen nga rrënja e fjalës *"kahare"* dhe, sipas Ragibit në librin "Mufredat", ka kuptimin: *shtyp* dhe *përbuz*. Edhe pse fjala *"tak'har"*, në mënyrë të veçantë, përdoret për të dy kuptimet, pra, edhe *shtyp,* edhe *përbuz,* në këtë rast, kuptimi më i përshtatshëm është *"përbuzje"*.

Kjo gjë tregon se, edhe pse çështja e të ushqyerit të jetimëve është e rëndësishme, por më e rëndësishme se kaq, është çështja e dhënies zemër të jetimëve, përkëdhelja e tyre, largimi i mërzitjes etj.

Në një hadith të njohur, lexojmë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Kushdo që përkëdhel kokën e një jetimi, në Ditën e Kiametit do të shpërblehet me masën e sasisë së flokëve që i ka prekur dora që ka përkëdhelur fëmijën jetim. Në Ditën e Kiametit do të ketë nur për atë person."*.[1]

Në këtë rast, duket sikur All'llahu i Madhëruar po i thotë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se ti ishe dhe u rrite jetim, e di se ç'do të thotë të jesh jetim, ke provuar vuajtjet e jetimit, ndaj tashmë ti ruaji dhe kujdesu për jetimët. Shpirtin e etur të tyre mbushe me dashuri.

Më pas flet për urdhrin e dytë: **"Lypësin mos e shty me ashpërsi."**. Mos e largo lypësin nga vetja.

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 506.

Fjala *"la tenhar"* vjen nga rrënja e fjalës *"nehere"* dhe ka kuptimin: *largoj, përzë me ashpërsi.*

Vështirë që rrënja *"nehrun"* e fjalës *"la tenher"*, të ketë kuptimin: *lum që rrjedh*; edhe pse lumi e largon ujin me ashpërsi dhe forcë.

Ka mendime të shumta midis komentuesve, jo vetëm për qëllimin e përdorimit të fjalës *"saailun", pyetësit, kërkuesit,* por edhe se kujt i referohet kjo fjalë. Po japim disa prej tyre:

Së pari, është komentuar dhe është menduar se u referohet personave që pyesin për çështje fetare, besimi, shkence. Anologjia është se ky urdhër është një recitim i asaj që përmendëm më lart në ajet. Si për shembull: **"A nuk të gjeti të paditur** (për Islamin) **e të udhëzoi?"**, ndaj dhe për të falënderuar për këtë udhëzim Hyjnor, ti, gjithashtu, përpiqu të udhëzosh nevojtarët dhe asnjë nevojtar mos e largo nga vetja.

Një tjetër mendim i komentuesve është se fjala ka për qëllim ata persona që vijnë pranë teje dhe janë të varfër. Nëse ata të kërkojnë ndonjë gjë, mos i largo nga vetja pa i ndihmuar me aq sa mundesh dhe me aq sa ke mundësi, mos i lër të pashpresë e mos i dëbo.

Një tjetër mendim i komentuesve është se ajeti flet edhe për varfërinë shkencore, edhe për varfërinë materiale. Kërkuesve që pyesin, jepu përgjigje pozitive. Ky kuptim nuk ka përshtatje me udhëzimin Hyjnor, në lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Gjithashtu, nuk ka kuptim me kujdestarinë e tij, kur ishte jetim.

Është e çuditshme se disa komentues, për të vërtetuar këtë çështje, thonë se qëllimi i fjalës *"saailun"*, në këtë rast, është vetëm pyetësi për çështjet shkencore. Të tjerë thanë se fjala *"saailun"*, në Kur'anin e Shenjtë, asnjëherë nuk ka ardhur me kuptimin: *nevojtar apo kërkues financiar*.[1]

Ndërkohë që ky kuptim është përsëritur vazhdimisht në Kur'anin e Shenjtë, sikurse e shikojmë edhe në ajeti 19 të sures "Edh Dhârijât": **"Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët."**.

Në mallrat e tyre ekziston një e drejtë edhe për lypësin edhe për nevojtarin.

Po këtë kuptim e hasim edhe në ajetin 25 të sures "El Me'ârixh": **"...për lypësin dhe për nevojtarin."**.

Gjithashtu, edhe në ajetin 177 të sures "El Bekare": **"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është** (cilësi) **e atij që beson All'llahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe Profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë All'llahun."**.

[1] Tefsiri "Abde", xhuzi i fundit, f. 113.

Në urdhrin e tretë dhe të fundit, All'llahu thotë: **"Shpalli dhuntitë e Zotit tënd!"**. Tregoi të tjerëve mirësitë e Zotit Tënd.

Ndonjëherë, mirësitë tregohen me gojë, duke përdorur lëvdata e duke falënderuar për mirësitë që All'llahu na ka dhënë, pa treguar mendjemadhësi dhe pa u treguar si më i miri ndër të tjerët. Ndonjëherë, shprehja e mirësisë dhe e falënderimit, bëhet duke vepruar dhe pikërisht duke falur dhe duke dhuruar në Rrugën e All'llahut. Dhurimi dhe falja tregojnë se All'llahu i ka dhënë me bollëk këtij njeriu.

Kjo është tradita e njerëzve që falin dhe janë bujarë. Ata, kur All'llahu u dhuron një mirësi, me bujarinë e tyre e falin dhe e dhurojnë te nevojtarët.

Ata janë falënderues, veprat dhe dija e tyre është e pranuar ndaj kësaj të vërtete. Ndërkohë që koprracët gjithmonë ankohen. Edhe sikur t'u falësh botën atyre, ata përsëri nuk janë të kënaqur. Fytyrat e tyre janë të varfra, bisedat e tyre janë të mbushura me ankesa dhe dija e tyre, gjithashtu, është e varfër.

Është transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se, kur All'llahu i fal mirësi robit të Tij, dëshiron të shikojë ndikimin e mirësisë tek ai.[1]

Ndaj dhe ajeti bëhet i tillë: "Falëndero Zotin tënd, që të bëri jo nevojtar, edhe pse ti ishe i varfër. Ndaj edhe ti tregoi ndikimet e mirësisë që All'llahu të ka dhuruar, tregoi ato me sjellje dhe me vepra.

[1] "Nehxhul Fesaha", Hadithi 683.

Disa komentues thanë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"mirësi"*, në këtë rast, është të tregojë vetëm mirësitë shpirtërore të njeriut, duke filluar që nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kishte për detyrë që t'ua propagandonte njerëzve Kur'anin e Shenjtë. Ky, pra, ishte edhe qëllimi i ajetit.

Ekziston edhe një tjetër mundësi, e cila përfshin të gjitha mirësitë, si ato materiale, ashtu edhe ato shpirtërore.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "Kuptimi i ajetit: *'Atë që All'llahu të ka falur ty, prej mirësive dhe prej riskut, si të ka udhëzuar e shumë e shumë prej mirësive të Tij, të gjitha këto tregoi, shfaqi te të tjerët.'"*.[1]

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Çdokujt që i dhurohet mirësi dhe prej mirësisë nuk vërehet asnjë ndikim, konsiderohet armik i All'llahut dhe kundërshtar i mirësive të All'llahut."*.[2]

Këtë diskutim e përfundojmë me një hadith të Amirul Mu'minin n, Ali Ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"All'llahu është i bukur dhe e dëshiron të bukurën. Gjithashtu, dëshiron të shikojë te njerëzit e Tij ndikimin e mirësisë"*.[3]

---

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 507.

[2] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7192. Kuptim të përafërt e hasim edhe në librin "Kafij", vëll. 6; po ashtu ka ardhur edhe në "Kitab Ez zejju ue et Texhmijl", Hadithi 2.

[3] "Furul Kafij", vëll. 6, f. 438.

Hulumtime

1- Udhëheqësia që starton nga vështirësitë dhe dhimbjet

Ajetet e mësipërme, përveçse shprehin dhe komentojnë mirësitë që All'llahu i ka dhuruar Profetit të Tij, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjithashtu, parashtrojnë edhe një hulymtim tjetër, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në fillimet e fëmijërisë së tij, ishte një fëmijë jetim, që ishte rritur në kushte të vështira ekonomike.

Pavarësisht se ai ishe rritur me dhimbje, u ngrit e vazhdoi përpara. Po, duhet të jetë kështu, sepse një udhëheqës Hyjnor dhe njerëzor duhet të jetë i tillë, të prekë vetë çdo vuajtje dhe shqetësim, si dhe të ndiejë me gjithë qenien e tij të gjitha vuajtjet dhe dhimbjet, në mënyrë që të perceptojë vuajtjet e popullit dhe të gjykojë drejtësisht.

Udhëheqësi duhet të jetë vazhdimisht në dijeni të mundimeve dhe vuajtjeve të popullit e të njerëzve.

Ai u rrit jetim, që të dijë vuajtjet e jetimit. Ka qëndruar me ditë të tëra i uritur, që të perceptojë, me gjithë qenien e tij, dhimbjen e të uriturit.

Ndaj dhe Profetit *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i dilnin nga sytë pika loti, kur i merrte ata. I mbante në prehër, i përkëdhelte e i ledhatonte me shumë dashamirësi.

Ai e kishte kuptuar më së miri varfërinë e kulturës së shoqërisë, sepse, kur dikush shkonte pranë tij për të përfituar nga dija e tij, ai i respektonte dhe e priste krahëhapur. Jo vetëm Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka hequr këto vuajtje, por të gjithë Profetët *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* kanë vuajtur dhe janë bërë njësh me dhimbjen dhe vuajtjet e popujve të tyre. Të tillë nuk duhet të jenë vetëm Profetët, por të gjithë udhëheqësit duhet të jenë të tillë.

Si munden ta kuptojnë dhimbjen e të varfërve dhe mundimet e tyre ata që janë rritur me mirëqenie dhe nuk dinë se ç'është dhimbja e varfëria? Si munden ata të kuptojnë se ç'do të thotë të jesh jetim, kur atyre nuk u ka munguar kurrë dashuria prindërore?

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"All'llahu nuk ka dërguar asnjë Profet që nuk ka qenë më parë bari i mirë e të jetë përkujdesur për delet e tij, me qëllim që nëpërmjet kësaj rruge, të mësojë se si të ruajë e të kujdeset për njerëzit."*.[1]

Në një hadith tjetër transmetohet se Musa Bin Imrani *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* e pyet Zotin e tij se me çfarë argumenti dhe arsye arriti në këtë pozitë. All'llahu i thotë: *"A të kujtohet dita, kur ishe fëmijë dhe t'u largua nga tufa një qengj e ti ike për ta kërkuar? Pasi e gjete, i the qengjit: 'Përse e lodhe veten?'*

Si i the këto fjalë, e ngrite dhe e vure mbi supe dhe e solle pranë tufës. Kjo ishte arsyeja që Unë të zgjodha ty si mbikëqyrësin dhe kujdestarin e

[1] "Biharul Enuar", vëll. 11, Hadithi 7, f. 64.

njerëzimit. Durimi yt ndaj një kafshe argumenton se ti ke një shpirt të madh, ndaj dhe të përzgjodha për këtë pozicion.".

2- Përkujdesja ndaj jetimëve

Ekzistenca e fëmijëve të vegjël jetimë, që kanë humbur prindërit e tyre në vegjëli, në çdo shoqëri është një ngjarje që nuk kapërdihet. Këta fëmijë duhet të mbështeten në mënyra të ndryshme, si nga ana ekonomike, si nga ana e afrimitetit dhe e dashurisë, ashtu edhe nga ana e drejtësisë. Nëse këto boshllëqe nuk mbushen te këta fëmijë, ata do të jenë të pashëndetshëm. Në shumë raste do të jenë zemërgur dhe jeta e tyre do të jetë në rrezik.

Ata, përveç dashamirësisë dhe përkëdheljes, duhet të jenë në qendër të vëmendjes së shoqërisë, që të mbështeten si fëmijët e tjerë. Ata nuk duhet të krijojnë në vetvete pasiguri, por duhet të jenë të sigurt.

Jetimët, në shumicën e rasteve, kanë pasuri të tyren, të cilën e trashëgojnë nga prindërit e tyre. Kjo pasuri duhet të ruhet me shumë kujdes për ta, derisa të arrijnë moshën e pjekurisë. Gjithashtu, ata, në shumicën e rasteve, kanë mungesë financiare. Kjo situatë duhet të menaxhohet me shumë kujdes. Të tjerët duhet të kujdesen për jetimët, sikur të ishin prindërit e tyre, si nëna e si babai, në mënyrë që jetimi të mos e ndjejë vuajtjen në shpirtin e tij, por të mundohen t'ia largojnë dhimbjen.

Ndaj edhe në ajetet e mësipërme të Kur'anit të Shenjtë dhe në shumë transmetime islame, kjo çështje është cituar dhe i është

dhënë një rëndësi e veçantë, e cila përfshin edhe etikën e moralit, edhe etikën e shoqërisë, edhe të humanizmit.

Ky hadith i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i njohur: "*Kur jetimi nis të qajë, Arshi i All'llahut nis të dridhet.*"

- *O engjëj! Kush e bëri për të qarë këtë jetim, që babanë e ka në varr?* - i pyet All'llahu engjëjt.

- O Zot! Ti je më i ditur për këtë, - përgjigjen engjëjt.

- *O engjëjt e Mi! Kush e qetëson dhe e gëzon këtë fëmijë, në Ditën e Kiametit Unë do ta gëzoj atë njeri dhe për këtë ju marr ju si dëshmitarë,* - thotë Zoti.[1]

Në një hadith tjetër nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Sa herë që jetimi qan, lotët e tij bien në duar e All'llahut Mëshirëplotë.*".[2]

Një hadith tjetër i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për këtë çështje: "*Unë dhe kujdestarët e jetimëve, sikurse këta të dy do të jemi në Xhennet, me kusht që të ndjekim devotshmërinë Hyjnore. Më pas tregoi gishtin tregues dhe gishtin e mesit*".[3]

Rëndësia e kësaj çështje është shumë e madhe. Në testamentin e njohur të Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Kujdesi dhe rëndësia ndaj jetimit*

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 506.
[2] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 31, f. 219.
[3] "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 23, f. 597.

është sikurse rëndësia dhe kujdesi për namazin dhe Kur'anin. Ai thotë: Zot o Zot për jetimët, mos i lini ata njëherë të ngopur e njëherë të pangopur, mos lejoni që ata të poshtërohen nga prania juaj.".[1]

Një prej miqve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, tregon: "Isha ulur pranë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pranë erdhi një djalë i vogël dhe i tha: 'Jam fëmijë jetim, kam edhe një motër jetime dhe nëna është e ve. Na ushqe edhe ne nga ajo që All'llahu të ka ushqyer, që All'llahu të të shpërblejë me çka pranë vetes së Tij e ti të jesh i kënaqur!'

- Sa bukur e the, o djalë! – tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. - *Shko e merr lart atë çka kemi dhe sille këtu!* - iu drejtua Bilalit.

Bilali iku dhe solli njëzet e një hurma.

- *Shtatë kokrra hurme janë për ty, shtatë për motrën dhe shtatë për nënën tënde,* - i tha djalit Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Muadh ibn Xhebel u ngrit, i përkëdheli kokën jetimit dhe tha: All'llahu ta shleftë periudhën e jetimit dhe të bëftë prej të pastërve, si zëvendës të babit. (babai i fëmijës ishte prej muhaxhirëve).

- *Ç'të shtyu ta bësh këtë gjë?* - e pyeti Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Muadh ibn Xhebelin.

[1] "Nehxhul Belaga", Pjesa "Letrat", Letra 47.

- Dashuria dhe mëshira, - u përgjigj ai. - Kushdo që është kujdestar i jetimit dhe kushdo që merr përsipër të rrisë një jetim, duke i shlyer të drejtën e tij dhe kush e përkëdhel jetimin, All'llahu do të shkruajë sevape dhe mirësi për të, si dhe për çdo fije floku të jetimit, do t'i falë atij pozitë.[1]

Megjithatë, në shoqërinë e ditëve të sotme myslimanët nuk duhet të mjaftohen me punën personale për të ndihmuar jetimët, por duhet të mbledhin forcat e tyre që jetimët të jenë të mbështetur dhe të jenë të mbuluar, si nga ana ekonomike, si nga ana kulturore, ashtu edhe nga arsimore, në mënyrë që të rrisin njerëz të denjë për shoqërinë dhe vendin e tyre. Kjo gjë e rëndësishme ka nevojë për bashkëpunim të përgjithshëm.

3- Të folurit për mirësitë

Rregulli që është cituar në ajetet e mësipërme, për sa i përket kësaj fushe, duhet të kryhet për të falënderuar dhe për të marrë kënaqësinë e All'llahut dhe jo për t'u krenuar dhe për të treguar se unë jam më i miri. Ky veprim, bën që njeriu të ketë pozitë të lartë pranë All'llahut, si dhe në shoqëri ka ndikim të madh dhe pozitiv. Gjithashtu, është shumë pozitive për vetë gjendjen emocionale të njeriut.

Përkujtimi i mirësive të All'llahut bëhet shkak që njeriu t'i ndjejë më pak mangësitë dhe të mos ankohet shumë për sëmundjet, sepse të kërkosh shëndet, kur shikon të tjerët të sëmurë, është falënderim. Njerëz të tillë, në vështirësitë dhe në tufanet që hasin,

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 506.

nuk janë të pashpresë dhe nuk ndihen të mërzitur, shpirti dhe zemra e tyre është e sigurt dhe ata kanë shumë fuqi për t'i përballuar këto probleme.

O All'llahu im! Mirësitë janë më shumë se sa ne i themi, mos i merr ato nga ne, por shtoi me bujarinë Tënde!

O All'llahu im! Ne, në këtë botë, jemi të mbuluar në mirësitë e Tua, shpresojmë që edhe në Botën e Përtejme të jemi të tillë!

O All'llahu im! Na bëj të suksesshëm, që gjithmonë të jemi mbështetës dhe ndihmues të jetimëve dhe të nevojtarëve, si dhe të mbrojmë të drejtën e tyre!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "Ed Duhâ".

Sure "El Inshirâh"

Zbritur në Mekë

Ajete 8

Përmbajtja e sures "El Inshirâh"

Kjo sure është e njohur, sepse ka zbritur pas sures "Ed Duhâ". Përmbajtja e saj miraton, gjithashtu, këtë çështje, sepse në këtë sure citohet një pjesë e mirësive të All'llahut të Madhëruar, dhënë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në të vërtetë, tri nga mirësitë e mëdha janë cituar në suren "Ed Duhâ" dhe tri prej tyre janë cituar në suren "El Inshirâh".

Kur folëm për mirësitë e mësipërme (në suren "Duha"), pamë se disa prej tyre ishin materiale dhe disa ishin shpirtërore, ndërkohë që tri mirësitë e kësaj sureje janë shpirtërore. Kjo sure është e ndarë në tri çështje:

Së pari, paraqet tri mirësitë.

Së dyti, flet për Shpalljen që i është bërë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, largimin e problemeve, si dhe për ftesën që do të bëjë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në të ardhmen.

Së treti, vëmendja që i kushtohet All'llahut Një, nxitjes për afrim në adhurim dhe bekim.

Për këtë arsye, në transmetimet e Ehli Bejtit *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*, sikurse e kemi përmendur edhe më parë, këto dy sure konsiderohen si një sure e vetme, ndaj edhe kur ato recitohen në namaz, i recitojmë të dyja, që të përllogaritet një sure.

Disa nga Ehli Syneti, janë të mendimit se ky mendim qëndron, edhe pse Fakhru Rrazij e ka marrë mendimin nga Tavusi dhe Omer ibn Abdul Azizi e ka transmetuar këtë gjë. Ata thoshin se këto dy sure janë një dhe në rekatet e namazit recitohen të dyja. *Bismilahi* i dytë nuk lexohet.[1]

Është për t'u habitur që Fakhri Razi, pasi e ka cituar fjalën e atyre që mendojnë se kjo sure është një sure e vetme, më pas thotë se kjo fjalë nuk është e drejtë, sepse përmbajtja e saj është e ndryshme nga tjetra. Kur ka zbritur kjo sure, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i zemëruar nga jobesimtarët dhe ishte në ankth. Ndërkohë që kur zbret surja "El Inshirâh", Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i gëzuar dhe i lumtur. Atëherë, si mund të mblidhen këto të dyja bashkë?[2]

Ky argument duket i çuditshëm, sepse të dy suret flasin për jetën e kaluar të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe këto ngjarje thuhen kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte kaluar shumë nga problemet dhe zemra e tij ishte e mbushur në shpresë dhe gëzim. Që të dy suret flasin për dhuratat dhe mirësitë e All'llahut.

Gjithashtu, ato rikujtojnë atë çka është thënë edhe më parë. Këtë e bëjnë për ta ngushëlluar dhe për t'i dhënë sa më shumë

[1] Por sipas fetvasë së dijetarëve tanë, "*Bismilahi*" duhet të jetë, pra, duhet të recitohet. I ndjeri Tabarsij, e ka shkruar në "Mexhmaul Bejan" se, edhe pse dijetarët tanë të jurisprudencës e kanë hequr "*Bismilahin*", nuk duket mendim i drejtë.

[2] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 32, f. 2.

shpresë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Gjithsesi, bashkimi i këtyre dy sureve me njëra-tjetrën nuk është ndonjë gjë për të pasur dyshim dhe frikë, sepse të ngjashme me këto sure, shikojmë edhe në suren "Fijl" dhe në suren "Kurejsh".

Surja "El Inshirâh" ka zbritur në Mekë.

Por, duke u bazuar në ajetin: **"Ne e ngritëm lart emrin Tënd"**, komentuesit janë të mendimit se ka zbritur në Medine, kur melodia e fesë islame kishte marrë gjithë vendin.

Ky argument nuk është bindës, sepse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pavarësisht problemeve që kishte në Mekë, e kishte ngritur zërin e melodisë së fesë islame dhe në të gjitha vendet flitej për Profetësinë e tij dhe ftesa e tij ekzistonte. Nëpërmjet grupeve të grumbulluara çdo vit për të kryer Haxhin, kjo ftesë dhe kjo melodi kishte kapërcyer edhe në vendet e tjera, si Hixhazi dhe në veçanti, në Medine.

Mirësitë e leximit të sures"El Inshirâh"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Ai që e lexon këtë sure, do të marrë mirësitë e atij njeriu që e ka parë Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) të hidhëruar dhe hidhërimi i Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i është ngulur në zemër.*"[1]

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 507.

Ajetet 1 - 8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ١ وَوَضَعْنَا عَنْكَ وِزْرَكَ٢ الَّذِى أَنْقَضَ ظَهْرَكَ٣ وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ٤ فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا٥ إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا٦ فَإِذَا فَرَغْتَ فَانْصَبْ٧ وَإِلَى رَبِّكَ فَارْغَبْ٨﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhammed) **kraharorin** (për të pranuar besimin)**"**

"Dhe ta hoqëm barrën,"

"E cila ta rëndonte tepër kurrizin,"

"Dhe ta ngritëm lart emrin?!"

"Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!"

"Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!"

"Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme)**, përpiqu fort** (në adhurim)**."**

"Dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!"

Komentimi

Mirësitë e Allahut

Tingulli i ajeteve është i përzier me mirësinë, dashurinë e jashtëzakonshme të All'llahut, me ngushëllimin dhe dhënien forcë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në ajetin e parë të sures hasim dashurinë më të rëndësishme të All'llahut: **"Vallë, a nuk ta hapëm ty** (Muhammed) **kraharorin** (për të pranuar besimin)**?"**.

Fjala "*esh sherh*" vjen nga rrënja e fjalës "*sherh*" dhe, sipas Ragibit, në librin "Mufredat", ka kuptimin: *zhvilloj*. Më pas shton se kumtimi i fjalës "*sadr*" është përhapja e saj nëpërmjet dritës Hyjnore, si dhe qetësisë shpirtërore që Zoti na ka dhënë. Më pas thotë; të komentosh dhe shpjegosh problemet e të folurit dhe fjalës, në kuptimin e zhvillimit të sajë dhe shpjegimi i kuptimeve të fshehta. Gjithsesi, nuk ka dyshim se qëllimi i përdorimit të fjalës "*sherhu sadr*", në këtë rast, ka kuptim e pseodonimit e cila është një këshillë për shpirtin dhe mendjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo këshillë mund të ketë kuptim të gjerë, që përfshin në të edhe gjerësinë, edhe thellësinë e dijes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nëpërmjet rrugës së Shpalljes, duke folur për gjerësinë dhe thellësinë e durimit dhe të qëndresës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) përballë kokëfortësisë së kundërshtarëve dhe të armiqve.

Kur Profetit Musa *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* iu dha misioni për të ftuar Faraonin në fe, pa se ai ishte arrogant dhe menjëherë i kërkoi ndihmë All'llahut: **"O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time."**.[1]

Në një tjetër vend i bëhet thirrje Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut** (Junusi */Paqja e Zotit qoftë mbi të!*)**, kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar** (në barkun e balenës)**!"**. [2]

Tani që punët shkuan kështu, prit urdhrin e All'llahut, qëndro dhe bëj durim e mos u bëj si Junusi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* që pasi humbi durimin, u zhyt në probleme.

Fjala "*shehru sadr*", që ka kuptimin: *zgjeromë kraharorin*, është vendosur përballë fjalës "*deikul sadr*", ngushtim i kraharorit, sikurse e lexojmë edhe në ajetin 97 të sures "Hixhr": **"Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre."**.

Në parim, asnjë prej udhëheqësve të mëdhenj nuk mund t'u dalë ballë problemeve, nëse nuk e ka kraharorin e zgjeruar. Dhe për ata që kanë mision të madh, sikurse është Profetësia dhe Dërgesa si e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, zgjerimi i kraharorit duhet të jetë i madh. Nuk duhet që tufanet t'i prishin qetësinë shpirtërore, nuk duhet që

[1] Sure "Tâ Hâ", ajetet 25-26.
[2] Sure "El Kalem", ajeti 48.

problemet ta ulin atë në gjunjë, gjithashtu, nuk duhet që punët e liga të armiqve ta zhgënjejnë dhe ta lënë të pashpresë. Pyetjet e vështira nuk duhet ta lënë atë në vështirësi apo të ngushtuar. Kjo, pra, është dhurata më e madhe hyjnore që i është bërë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* transmetohet: "*Unë dëshirova nga Zotit tim diçka, të cilën do të kisha dëshirë të mos e kisha dëshiruar. Iu luta Zotit tim: 'O Zoti im! Disa Profetëve para meje, u ke vënë në dispozicion erën, disa prej tyre ringjallnin të vdekurit'*.

- **Po ti, a nuk ishe jetim dhe ne në mbrojtëm? –** më tha All'llahu i Madhëruar.

- *Po*, - iu përgjigja.

- A nuk ishe i humbur dhe ne të udhëzuam?

- *Po, po, O Zoti im!*

- A nuk e hapëm gjoksin tënd dhe e pastruam nga gjithçka?

- *Po, o Zoti im!*"[1]

Kjo gjë tregon se mirësia e zgjerimit të gjoksit, që u tha më lart, është prej mrekullive të All'llahut, që u janë dhënë Profetëve. Dhe, nëse dikush do të studionte me saktësi gjendjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe peshën e zgjerimit të kraharorit përgjatë ndodhive të

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 508.

jetës së tij, do të shikojë, se ka pasur një jetë të vështirë dhe me plot peripeci. Të gjitha këto ngjarje nuk mund të ndodhin në një gjendje të natyrshme. Ky është një përcaktim hyjnor.

Për këtë rast, disa komentues janë të mendimit se togfjalëshi *"shehr sadr"* – *"zgjerimi i kraharorit"*, tregon ngjarjen që i ka ndodhur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgjatë rinisë së tij. Kur engjëjt e All'llahut të Madhëruar i hapën kraharorin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i nxorën zemrën, e kanë pastruar atë dhe e kanë mbushur atë me dije dhe me mirësi.[1]

Duket se qëllimi nuk është për zemrën që ne kemi në trup, por e gjitha kjo është përafërsi ose tregues i ndihmës Hyjnore, nga ana shpirtërore, sepse i ka përforcuar vullnetin e Profetësisë, duke e pastruar atë nga çdo lloj mangësie morale apo vesvesi.

Por ne nuk kemi asnjë argument të themi se ajeti për të cilin po flasim, tregon në veçanti këtë ngjarje, por ka një kuptim më të gjerë dhe mund të themi se ka përqasje me këtë tregim.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për shkak të zgjerimit të kraharorit që i është bërë, ka arritur të zgjidhë të gjitha problemet, në mënyrën më të përsosur dhe të kryejë detyrën e tij si Profet.

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", sipas transmetimit të tefsirit "El Mizan", vëll. 20, f. 452. Gjithashtu, tefsiri "Fakhri Razi", vëll. 32, f. 2. Të ngjashëm me këtë hadith dhe me këtë kuptim, e hasim edhe në hadithet e "Sahihet": El Bukharij, Termidhij dhe Nisaij. Gjithashtu, edhe në tregimin e ndodhisë së Miraxhit është cituar ky fakt.

Më tej citon një tjetër dashuri prej dashurive të mëdha të All'llahut ndaj Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Dhe ta hoqëm barren."**. A nuk të larguam ty një barrë shumë të rëndë? Të hoqëm nga supet atë barrë dhe ngarkesë që të rëndonte shumë në kurrizin tënd. "E cila ta rëndonte tepër kurrizin."

Fjala "*uizrek*", në fjalor, ka kuptimin: *rëndesë*. Edhe fjala "*uezir*" është e lidhur me këtë kuptim, sepse veziri (ministri) mbante mbi supe barrën e rëndë të udhëheqësit. Gjithashtu, edhe mëkatet i quajnë "*uezr*", sepse është barrë e rëndë në supet e njeriut.

Fjala "*enkade*" vjen nga rrënja e fjalës "*nekada*" dhe ka kuptimin: *zgjidhje e nyjës së litarit, ndarje e një pjese që është ngjitur në një ndërtesë*.

"*Entekada*" i thuhet zhurmës që shkaktohet si pasojë e shembjes së pjesëve të një ndërtese. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret kur thyhet një premtim dhe thuhet: Filan person theu premtimin.

Kështu, ajeti i mësipërm thotë: All'llahu e largoi nga ti, atë barrë të rëndë. Po cila ishte kjo ngarkesë e rëndë, që All'llahu e largoi nga supet e Profetit të Tij? Përmbledhja e ajeteve tregon më së miri se bëhet fjalë për problemet e dërgesës dhe të Profetësisë, për ftesën drejt Njëshmërisë dhe largimit e zhdukjes së korrupsionit nga vendi. Jo vetëm Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por të gjithë Profetët në fillimin e ftesës së tyre janë përballur me të tilla probleme. Ata kanë dalë fitimtarë nga të tilla probleme, vetëm me ndihmën e All'llahut. Por gjendja dhe kushtet që e rrethonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!), në shumë raste, kanë qenë më të vështira dhe më të rënda.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"uezer"* ka kuptimin: *barrë e rëndë e shpalljes në fillim të zbritjes*.

Disa të tjerë janë të mendimit se ka të bëjë me poshtërimin, paudhësinë dhe kokëfortësinë e jobesimtarëve.

Gjithashtu, të tjerë komentues janë të mendimit se ka të bëjë me ngacmimet dhe mërzitjen e jashtëzakonshme që jobesimtarët kryenin.

Të tjerë komentues, janë të mendimit dhe kanë komentuar se ka të bëjë me trishtimin dhe dhimbjen që i shkaktoi Profetit *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Ebu Talibi dhe bashkëshortja e tij, Hadixheja.

Të tjerë e komentuan me çështjen e pastërtisë dhe të dëlirësisë së Profetit Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe me pastërtinë nga mëkatet.

Por, duket se komentimi i parë është më i përshtatshëm nga të gjitha komentimet. Por këto komentime përllogariten si degë dhe gjethe për të.

Kur flet për dashurinë e tretë, thotë: **"Dhe ta ngritëm lart emrin?!"**.[1]

[1] Është e sigurt se asnjë njeri në botë nuk ka bërë më shumë emër se sa Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Mëse një miliardë myslimanë përmendin emrin e tij përditë, duke u lutur për të në namazet e tyre. Nga mijëra e mijëra minare, myezinët thërrasin emrin e tij pesë

Ne e ngritëm lart emrin tënd.[1]

Emri i Profetit Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), së bashku me fenë islame dhe me emrin e Kur'anit, kanë marrë dhenë, më mirë se kaq, emri i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përmendet së bashku me Emrin e All'llahut çdo ditë, pesë vakte, kur thirret ezani. Në ezan dëshmohet për Profetësinë e tij, në krah të dëshmisë për Zotin Një. Kjo gjë tregon arsyen e pranimit të kësaj feje të pastër.

Ku ka krenari më të mirë se kaq e ku ka post më të mirë dhe më të lartë nga ky?! As që përfytyrohet një post i tillë!

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për komentim të këtij ajeti, lexojmë: *"Xhibrili më tha mua: All'llahu i Lartësuar thotë: 'Kur të përmendet Emri Im, do të përmendet edhe emri yt, së bashku me Emrin Tim. Kjo gjë është e mjaftushme për madhështinë e postit tend.'"*.

Interpretimi me fjalën *"leke"* – *"për ty"* është përforcim për ngritjen e emrit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse, pavarësisht kurtheve dhe sabotimeve që i bënin armiqtë, ai u ngrit lart e më lart.

herë në ditë. Arritjet e misionit të tij shpirtëror, moral, juridik e politik janë tërësisht të gjalla dhe aktive, edhe katërmbëdhjetë shekuj pas ndarjes së tij nga kjo botë dhe do të zgjasin, në dashtë All'llahu, deri në Ditën e fundit të jetës tokësore dhe, në vazhdim, në Jetën e Amshuar.

[1] Interpretimi me fjalën *"refe'a"*, pas fjalës *"uedhe'eh"*, edhe pse janë të kundërta me njëra–tjetrën, në këtë rast, tregon një mirësi të veçantë.

Në këtë rast lind pyetja: Kjo sure ka zbritur në Mekë, ndërkohë që përhapja e fesë islame, zgjidhja e problemeve të Profetësisë, largimi i barrës së rëndë nga supet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ngritja e emrit të tij kanë ndodhur në Medine. Si shpjegohet kjo gjë?

Disa komentues janë përgjigjur se bëhet fjalë për ftesën që i është bërë vetë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe që i ka hequr nga zemra barrën e trishtimit dhe të hidhërimit nga zemra. Por e vërteta dhe e drejta është se një pjesë e këtyre çështjeve kanë ndodhur në Mekë, veçanërisht në fund të periudhës trembëdhjetë vjeçare, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i angazhuar në Mekë, duke i ftuar njerëzit në fenë islame. Besimi i disave kishte ndikuar në zemrën e shumë personave dhe problemet po ashtu, në krahasim me më parë, vinin duke u pakësuar. Emri dhe zëri i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po dëgjohej anekënd dhe në këtë mënyrë ishte bërë gati rruga për një fitore të madhe.

Është për t'u habitur që poeti i madh Hasan ibn Thabit, duke u bazuar në këtë ajet, thur një poezi për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Përmbledhja e poezisë është:

All'llahu e ka bashkëngjitur emrin e Profetit me Emrin e Tij

në kohën që muezini thërret pesë herë ezanin duke thënë se "Dëshmoj".

E atij i ka ndarë emrin nga emri i Tij që ta lartësojë atë

Sunduesi I Arshit është meritues i lavdërimit dhe ky është i lavdëruari (Muhamedi)

Në ajetin në vazhdim, All'llahu i Madhëruar i jep lajmin më të mirë Profetit të Tij, duke i shtuar shpresën dhe duke i gëzuar zemrën: **"Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!"**.

All'llahu i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Tij të mos u shqetësohet dhe të mos trishtohet, sepse vetëm në këtë mënyrë vështirësitë dhe problemet largohen. Sabotimet e armiqve nuk do të vazhdojnë përgjithmonë. Po ashtu, edhe privimet materiale dhe problemet ekonomike, si dhe varfëria e myslimanëve nuk do të jetë gjithmonë kështu.

Ai që do të jetë i duruar ndaj problemeve dhe vështirësive që do hasë gjatë jetës, në fund do të dalë i fituar, sepse një ditë do të shijojë shijen e durimit ndaj vështirësive dhe problemeve, si dhe guximin për t'u përballur me vështirësitë. Ditën që zëri i armikut do të shuhet dhe ditën që sabotimet e tij do të jenë pa ngjyrë, zhvillimi dhe përsosmëria do të dalë në pah. Në këtë ditë do të jetë më e lehtë që të arrihet Rruga e Drejtë.

Edhe pse disa komentues, këtë ajet e kanë cilësuar si shenjë të varfërisë së përgjithshme të myslimanëve në fillim të Islamit, duket qartë se kuptimi i ajeteve përfshin të gjitha problemet. Këto dy ajete janë cilësuar në mënyrë të tillë, që të mos i përshtaten vetëm personalitetit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe kohës së tij, por ato janë cituar si një formulë e përgjithshme, në mënyrë të tillë që të analizohet kjo çështje përgjatë diskutimeve të mëparshme. Kështu,

të gjithë besimtarët e sinqertë dhe të pastër, të cilët përpiqen për mirë, do të kenë shpërblimin e tyre, lehtësimi pas vështirësisë.

Po, kështu ndodh, pas vështirësisë vjen lehtësimi. Këto të dy gjithmonë kanë qëndruar bashkë dhe ashtu do të qëndrojnë gjithnjë.

Kjo është shpresa dhe premtimi që na jep Zoti. Me këtë shpresë, zemrat marrin dritë dhe forcë për fitore. Në këtë mënyrë largohet nga zemra dhe shpirti i njeriut pluhuri i dëshpërimit.

Në një hadith të Profetit Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Dije se pas vështirësisë vjen lehtësimi, me durimin vjen fitorja dhe me trishtimin vjen gëzimi dhe lumturia.*".[1]

Në një hadith të Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Një grua u ankua pranë tij për bashkëshortin e saj, se nuk i jep asgjë. Imam Aliu pa që bashkëshorti i saj ishte në vështirësi dhe nuk kishte mundësi t'i falte apo t'i blinte bashkëshortes së tij dhe për ta shpëtuar atë nga burgu, iu përgjigj gruas që po denonconte bashkëshortin me këtë fjalë: 'Pas vështirësisë vjen lehtësimi.'. Kështu e ftoi gruan që të kishte durim me bashkëshortin e saj.*".[2]

Më pas, në ajetet e fundit të kësaj sureje, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Prandaj, kur të çlirohesh** (nga punët e ndryshme)**, përpiqu fort** (në adhurim)**."**. Pasi të largohesh nga një punë e rëndësishme, nis një tjetër punë të rëndësishme.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 11, 13, f. 604.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 11, 13, f. 604.

Asnjëherë mos qëndro pa bërë gjë, përpiqu gjithmonë dhe, kur mbaron një punë, nis një tjetër edhe më të rëndësishme.

Përgjatë gjithë punëve që kryen, mbështetu tek All'llahu i Madhëruar.

Kërkoje dhe lype kënaqësinë e All'llahut gjithmonë dhe vrapo për tek Ai. **"Dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!"**

Në përputhje me atë që u tha më lart, ajeti ka kuptim të gjerë, duke përfshirë përfundimin dhe lirimin nga një punë dhe duke kërkuar një tjetër më të rëndësishme. Këtu këshillohemi që të përpiqemi për t'u afruar me Krijuesin tonë.

Disa komentues, këtij ajeti i kanë bërë një komentim të ngushtë, duke e kufizuar se kur të mbaroni namazin e detyruar, nis e bëj dua dhe kërko nga All'llahu, sepse çfarëdo të kërkosh, do ta marrësh.

Të tjerë e kanë komentuar kështu: Kur mbaron namazin e detyruar, nis e bëj namazet e pëlqyera.

Ose, në kohën që mbaron punët e kësaj dynjaje, nis e fillo punët për Botën e Përtejme, pra, nis e bëj namazet.

Ose, pasi të mbarosh detyrimet, kushtoi vëmendje edhe punëve të pëlqyera që All'llahu të ka urdhëruar.

Ose, në kohën që largohesh nga lufta me armikun, nis e kryej adhurimin.

Ose, në kohën që mbaron luftën me armikun, nis luftën me egon tënde.

Ose, në kohën që mbarove punë me shlyerjen e detyrimit të të Dërguarit të All'llahut, nis e kërko ndërmjetësimin (shefaetin)!

Në transmetime të ndryshme që, dijetari i njohur i Ehli Synetit Hakim Heskani, ka sjell në librin e tij "Sheuahidul Et Tenzijl", nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ku thotë në komentim të ajetit se kuptimi i tij është: "Kur të lirohesh, caktoje Aliun si prijës".[1]

Kurtubij, në tefsirin e tij ka transmetuar se kuptimi i ajetit është: Kur të lirohesh, cakto imamin pas teje që të të zëvendësojë ty. (Edhe pse e ka cituar vetë këtë kuptim, nuk e ka pranuar).[2]

Duke u bazuar në faktin që në ajetin e shenjtë nuk është përcaktuar çështja e lirimit dhe duke parë që fjala *"fenseb"* vjen nga rrënja *"neseb"*, që ka kuptimin: *temperaturë* dhe *vështirësi*, atëherë ajeti shpjegon diçka kryesore dhe të përgjithshme. Qëllimi i ajetit është që Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ta marrë si shembull, duke thënë se pas përfundimit të një pune, mos u qetëso, por nis një punë tjetër edhe më të rëndësishme, që përpjekja jote të jetë e vazhdueshme përgjatë jetës.

Duke marrë parasysh edhe këtë kuptim, shihet se të gjitha kuptimet janë të qarta dhe të drejta, por secila duhet të merret më vete.

Sa program ndikues dhe të gjallë ka vendosur për ne Krijuesi, për të mos rënë në dembelizëm, sepse sekreti i fitores

[1] "Sheuahidul Et Tenzijl", vëll. 2, Hadithet 1116–11119, f. 349.
[2] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7199.

është përsosmëria. Në parim, papunësia dhe largimi i përhershëm nga një punë, bëhet shkak i lodhjes dhe i mospasjes së energjisë së duhur, të cilat janë shkaqe të korrupsionit dhe të mëkatit.

Sido që të jetë, kjo sure tregon se All'llahu i Madhëruar ka një vëmendje të veçantë jo vetëm ndaj Profetit të Tij, por për të gjithë njerëzit, atyre që duan Rrugën e Drejtë.

Hulumtim

Sikurse u citua edhe më lart, në transmetime të ndryshme, për sa i përket qëllimit të ajetit thuhet se: Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim) (Si shembull i shpjegimit është vendosja e Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në pushtet, pas përfundimit të Profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Alusij, në librin "Ruhul Meanij", pasi transmeton këtë mendim, thotë se disa imami janë të mendimit se fjala *"fensab"* është lexuar me zanoren kesre (i) shkronja*"sad"* dhe, nëse hamendësohet se është kështu si thonë ata, kjo gjë nuk është argument, se ka për qëllim vendosjen e Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ndaj më poshtë transmeton nga Zamakhsherij, në librin "Kesh'shaf" se, nëse për shi'itët do të ishte i mundur një transmetim i tillë, atëherë armiqtë e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë*

mbi të!) mund ta marrin fjalën *"neseb"* me kuptimin: urrejtje për Ali ibn Ebu Talibin.[1]

Fjala *"insabe"*, me zanoren *"e"* te shkronja *"sad"*, merr kuptimin: *grindje* dhe *luftë.* Ndërkohë që *"insib"* me zanoren *"i" te shkronja "sad"*, ka kuptimin: *urdhëroj për të vendosur, ngre lart* dhe *qëndroj lart*.

Këta komentues menduan se shi'itët e ndryshojnë zanoren, kur e lexojnë ajetin, për ta marrë atë si argument për vilajetin (udhëheqjen) e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ndërkohë që nuk është ashtu. Kurrë nuk është i nevojshëm një transmetim i tillë, por një lexim i tillë është i njohur dhe i mjaftueshëm për komentimin e lartpërmendur. Sepse thuhet që, pasi lirohesh nga një punë e rëndësishme, sikurse është Profetësia, nis një tjetër punë të rëndësishme, sikurse është caktimi i zëvendësit (vilajeti). Kjo gjë është marrë si shembull që është plotësisht i pranueshëm.

Ne e dimë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në bazë të hadithit të njohur të Gadirit Khum-it, si dhe shumë hadithe të tjera që janë transmetuar në librat e dijetarëve myslimanë, përpjekjet dhe mundimet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kanë qenë të vazhdueshme, për sa i përket kësaj fushe.

Por sa gjë e keqe është kjo, që një dijetar, sikurse është Zamakhsharij, i cili e pranon Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* si udhëheqësin e katërt të myslimanëve dhe si zëvendës të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 30, f. 172; Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 772.

tij!), i jep leje vetes së tij që të thotë se *"nasibët"* kanë të drejtë që këtë ajet ta komentojnë me kuptimin urrejtje për Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Sa interpretim vulgar dhe i keq, nga një komentues i tillë!!

Dijetari i njohur mu'tezilit, Ibn Ebi Hadijdi, në komentimin e "Nehxhul Belagas" transmeton nga Zubejr ibn Bekar, që sipas tij, nuk ishte as shi'it e as nuk kishte armiqësi me Muavijen, por ishte larguar nga Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe ishte bashkuar me kundërshtarët e Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Transmetohet nga djali i Mugijreh ibn Shu'betu, se babai fliste shumë për arsyen dhe logjikën e Muavijes. Ai e admironte mënyrën e të menduarit të tij, por një natë prej netësh, babai u kthye shumë i mërzitur dhe i trishtuar nga Muavija. Kuptova se kishte ngjarë diçka shumë e rëndësishme, që ishte i trishtuar. E pyeta dhe po fliste keq për Muavijen. I thashë se cili ishte shkaku i mërzitjes nga ai? M'u përgjigj: sonte ishta vetëm për vetëm me të, i thash ti i arrite qëllimet dhe postet që ke dëshiruar, tani përpiqu për drejtësi dhe për të zgjeruar sa më shumë mirësitë, sepse edhe mosha po të shkon drejt plakjes, në lidhje me Beni Hashimët sillu mirë, sepse ata nuk konsiderohen më kërcënim për ty dhe kjo gjë është një arsye e mirë që ti të mbahesh mend për mirë.

Ai u përgjigj: "Mjerë! Çfarë emri do të më mbetet mua? Khalifi i parë dhe i dytë punuan, po ç'emër mbeti prej tyre? Por ti, o i shkretë, Ibn Ebi Kebsheh, shiko Muhammedin. Emri i tij këndohet çdo ditë, pesë herë, duke thënë "Esh'hedu enne Muhammeden Resulull'llah", pra, ç'punë dhe ç'vepër do të më mbetet pas mua?

Jo, për Zotin! Kjo gjendje duhet rrëzuar dhe emri i Profetit të zhduket!". [1]

Por, All'llahu ka dashur që këtë emër ta ngrejë lart në të gjithë botën dhe në të gjitha historitë, ta pëlqejnë apo të mos e pëlqejnë të tjerët.

O All'llah! Pastroje zemrën tonë nga egoja dhe dashuria për egon dhe bëj që dashuria Jote e pafund të na përfshijë ne!

O All'llah! Ti na ke premtuar Vetë se pas çdo vështirësie, vjen lehtësimi, bëj që myslimanët e ditëve të sotme të lehtësohen nga këto probleme që vijnë nga armiqtë e Islamit!

O All'llah! Mirësitë dhe dhuratat e Tua shtoi për ne dhe na bëj prej falënderuesve!

Amin! Ja Rabil Alemin!

Përfundimi i sures "El Inshirâh"

[1] "Nehxhul Belaga", vëll. 5, f. 129 (Pjesë nga Ibn Ebi Hadijd).

Sure "Et Tîn"

Zbritur në Mekë

Ajete 8

Përmbajtja e sures "Et Tîn"

Kjo sure flet për krijimin e bukur të njeriut, stadet e përsosmërisë së tij. Të gjitha këto çështje nisin me betimet kuptimplote në fillim të sures. Më tej, pasi citohen me radhë të gjitha shkaqet e fitores dhe të shpëtimit të njeriut, nis ritheksimi, për sa i përket çështjes së Ringjalljes dhe pushtetit Absolut të All'llahut. Me citimin e çështjes së fundit, pra, të pushtetit Absolut të All'llahut, përfundon edhe surja.

Mirësitë e leximit të sures "Et Tîn"

Në një hadith të Profetit *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Kushdo që e lexon këtë sure, do të përfitojë dy mirësi nga All'llahu, kur jeton në këtë botë, të cilat janë: shëndeti dhe besimi. Kur të largohet nga kjo botë, do të marrë sevapet e një dite agjërimi të të gjithë atyre që e kanë lexuar këtë sure."*.[1]

Kjo sure ka zbritur në Mekë. Ajeti: **"Dhe për këtë Qytet të sigurt** (Mekën)**."**, është argumenti me i qartë se i referohet Mekës.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 510.

Ajetet 1 – 8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالتِّينِ وَالزَّيْتُونِ١ وَطُورِ سِينِينَ٢ وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ٣ لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ٤ ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ٥ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ٦ فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالدِّينِ٧ أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمِ الْحَاكِمِينَ٨﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Për fikun dhe ullirin."

"Për malin e Sinait."

"Dhe për këtë Qytet të sigurt."

"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer."

"Pastaj e çuam atë (kur nuk beson) **në gjendjen më të ulët."**

"Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera."

"Atëherë, çfarë të shtyn ty (o njeri)**, që ta mohosh Ditën e Kiametit?"**

"A nuk është All'llahu Gjykatësi më i drejtë?!"

Komentimi

Në fillim të kësaj sureje hasim, gjithashtu, katër betime me plot kuptim. Parathënia e tyre është për të shpjeguar një çështje shumë të rëndësishme. Ajeti thotë: **"Për fikun dhe ullirin, për malin e Sinait, dhe për këtë Qytet të sigurt** (Mekën)**."**.

Në fjalor, fjala *"et tijn"* ka kuptimin *"fik"* dhe fjala *"ez zejtuun"* ka kuptimin *"ulli"*, ulliri prej të cilit marrim vajin e shëndetshëm.

Por, për sa i përket çështjes se betimi është vetëm për këto dy fruta të njohura apo përfshin edhe diçka tjetër, komentuesit kanë mendime të ndryshme.

Disa komentues, këtë betim e konsiderojnë vetëm për dy frutat e njohura, pra, fikun dhe ullirin. Ulliri është fryt me vlera të jashtëzakonshme dhe është kurues.

Të tjerë janë të mendimit se këto dy fjalë kanë për qëllim dy male që janë në Damask dhe në Shtëpinë e Shenjtë. Këto dy vende janë shumë të rëndësishme, sepse nga këto dy vende kanë dalë Profetë të mëdhenj të All'llahut, ndaj dhe këto dy betime janë të lidhura me betimet e tjera që vijnë më poshtë dhe që flasin për tokën e shenjtë.

Të tjerë janë të mendimit se vendosja e emrave të këtyre dy maleve, me emrin *"et tijn"* dhe *"ez zejtuun"*, është për shkak se në njërin prej tyre ka pemë të ullirit dhe në tjetrin ka pemë të fikut.

Një pjesë tjetër, gjithashtu, është e mendimit se këto dy emra flasin për kohën e Profetit Adem *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, sepse rrobat që ata u mbuluan në Xhennet, ishin prej gjetheve të fikut. Ndërsa ulliri ka të bëjë me kohën e Profetit Nuh *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, sepse në përfundim të tufanit, Nuhu nxori një pëllumb që të shikojë, nëse është ulur niveli i ujit. Pëllumbi u kthye me një degë ulliri dhe aty Nuhu kuptoi se kishte mbaruar tufani. Ndaj edhe gjethja e ullirit konsiderohet si shenjë e paqes dhe e sigurisë.

Të tjerë, fjalën "*et tijn*" e konsiderojnë si shenjë të xhamisë së Nuhut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, e cila është ndërtuar te mali i Xhudit, ndërsa fjalën "*zejtuun*" – "*ullirin*", e konsiderojnë si shenjë të Bejtul Mukades.

Edhe pse në dukje ajeti flet për dy fruta, *ullirin* dhe *fikun*, duke parë edhe betimet e mëtejshme, është i përshtatshëm kuptimi për dy malet, ose edhe për dy qendrat e shenjta, që janë të rrespektuara.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "All'llahu, midis qyteteve, ka përzgjedhur katër prej tyre. Për to ka thënë: *Et tijn* është qyteti i Medines, *Ez zejtuun* është qyteti i Bejtul Mukades së shenjtë, *Tuuri sijnijn* është qyteti i Kufes, ndërsa *Hadhal Beledil Emijn* është Meka.[1]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 4, f. 606. Është e vërtetë se në atë periudhë, qyteti i Kufes nuk ka qenë i madh, por, duke pasur parasysh se aty kalonte lumi i Eufratit, vendi duhet të ketë qenë i zhvilluar. Gjithashtu, sipas historisë, kuptohet se edhe para Islamit, aty ekzistonte një qytet. ("Dairetul Mearif Mesahebe", vëll. 2, Made Kufe.)

"Tuuri sijnij", në pamje të jashtme është Turi Sina, mali i Sinait, që, sipas komentuesve, flet për malin e njohur Tur, i cili është i vendosur në shkretëtirën e Sinait. Atje ka plot pemë ulliri.

"Sina" njihet si mali me plot mirësi, ose me shumë pemë, ose shumë i bukur. Është mali kur Profeti Musa *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* bisedonte me All'llahun dhe i lutej Atij.

Të tjerë komentues e konsiderojnë si një mal pranë Kufes dhe Nexhefit.

Të tjerë kanë përcaktuar se *"Sijnijn"* dhe *"Sina"* është një mal dhe ka kuptimin me plot mirësi.

Ajeti: **"dhe për këtë Qytet të sigurt."**, flet për Mekën, që edhe në periudhën e injorancës, është mbajtur dhe si vend i sigurt, dhe si vend i Shenjtë i All'llahut. Jo vetëm në atë periudhë, por edhe më parë, në atë vend nuk lejohej të dhunohej njeri, nuk lejohej që as ata që vinin apo kalonin në atë vend, të luftonin. Të gjithë ishin të sigurt.

Kjo tokë është shumë e rëndësishme për Islamin. Aty edhe kafshët, shpendët, çdo gjë që është në duart e njeriut në atë vend, ka një rëndësi të madhe dhe duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë.[1]

Një tjetër pikë që duhet parë, është fjala *"et tijn"* – *"fiku"* që në Kur'anin e Shenjtë është cituar vetëm një herë, ndërkohë që fjala *"ez zejtuun"* – *"ulli"* është cituar gjashtë herë në mënyrë të shpejtë dhe një herë është cituar duke iu referuar ullirit: **"si dhe pemën që**

[1] Fjala *"emijn"*, në këtë rast, mund të ketë kuptimin tokë e sigurt për njerëzit.

rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë, atyre që e hanë".[1]

Kurdoherë që këto dy betime (*tijn - fiku* dhe *zejtuun - ulliri*) të merren me kuptimin e parë të tyre, pra, fik dhe ulli, përsëri është një betim kuptimplotë, sepse fiku ka shumë vlera ushqimore dhe është i ngrënshëm për të gjitha moshat. Po ashtu njohësit e vlerave të ushqimit thonë se fiku mund të përdoret si sheqer natyral për fëmijët, sportistët dhe ata që janë të dobët mund ta përdorin fikun si ushqim me plot vlera ushqyese.

Thonë se Platoni, filozofi i madh grek, e pëlqente aq shumë fikun, saqë disa e quajtën miku i filozofit. Edhe Sokrati e konsideronte fikun si largues të sëmundjeve.

Xhalinusi kishte organizuar një dietë të veçantë me fiq për trimat. Trimave të Romës e të Greqisë u jepej fiq.

Njohësit e ushqimeve thonë se fiku është i mbushur me vitamina të ndryshme, si dhe me sheqer. Përdoret si ilaç për shumë sëmundje. Nëse fikun e përziejmë në mënyrë të barabartë me mjaltin, është shumë i dobishëm për të kuruar sëmundjet e stomakut. Ngrënia e fikut të thatë, bën mirë për forcimin e kujtesës.

Në mënyrë të përmbledhur, ngrënia e fikut është shumë e dobishme për ruajtjen e normalitetit të trupit dhe gjakut, si dhe është ushqim për të gjitha moshat.

Në një hadith të Imam Ali ibn Musa Err Rrida *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: "*Fiku largon aromën e keqe të gojës, forcon mishrat*

[1] Sure "El Mu'minûn", ajeti 20.

e dhëmbëve dhe kockat, rrit flokët, largon dhimbjen. Duke e pasur atë, nuk është nevoja për ilaçe. Fiku është fryti më i ngjashëm me frutat e Xhennetit.".[1]

Njohësit dhe hulumtuesit e ushqimeve kanë studiuar ullirin dhe vajin e ullirit. Ata i kushtojnë një rëndësi të jashtëzakonshme kësaj bime dhe janë të mendimit se ata që duan të qëndrojnë gjithmonë të shëndetshëm, duhet të përdorin vajin e ullirit.

Vaji i ullirit është shumë i dobishëm për zorrën e trashë, veshkat, tëmthin e shumë e shumë pjesë të tjera të trupit të njeriut. Për këtë arsye, pema e ullirit konsiderohet si pemë e bekuar në Kur'an.

Në vajin e ullirit gjenden lloje të ndryshme vitaminash. Ai përmban fosfor, kalcium, hekur, magnez etj. Përzierjet midis vajit të ullirit dhe hudhrës, janë shumë të dobishme për lloje të ndryshme dhimbjesh të reumatizmës, për gurët në tëmth etj. Me ngrënien e kësaj përzierje, gurët në tëmth zhduken.[2]

Në një tjetër transmetim të Prijësit të besimtarëve Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Në shtëpinë e atyre që përdoret uthulla dhe vaji i ullirit për ushqim, kurrë nuk do të mbetet duarbosh (pa ushqim). Ky është ushqim i Profetëve.*".[3]

---

[1] Tefsiri "Kafij", vëll. 6, f. 358; Al'lame Mexhlisij, në "Biharul Enuar", vëll. 66, f. 184; Ka shumë transmetime, për sa i përket fushës së ullirit.

[2] "Universiteti i parë dhe Profeti i Fundit", vëll. 9, f. 130 e më tej.

[3] "Biharul Enuar", vëll. 66, Hadithi 6, f. 180. Hadith të ngjashëm me të gjejmë edhe në tefsirin "El Kafij", vëll. 6, Hadithi 7, f. 328 dhe "Uesailu Shiia", vëll. 25, Hadithi 31262, f. 86 (botim i Ehli Bejtit) dhe "Biharul Enuar", vëll. 11, Hadithi 19, f. 67.

Në një hadith të Imam Ali ibn Musa Err Rrida *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"Vaji i ullirit është ushqim i mirë. Gojën e mban me aromë të mirë, mukozën e largon, fytyrën e njeriut e bën të pastër, forcon nervin, kuron sëmundje dhe dhimbjet i largon. Gjithashtu, zbut nervat e njeriut."*.[1]

Këtë diskutim do ta përfundojmë me një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Ushqehuni me vaj ulliri, lyeni trupin me të, sepse është prej pemës së bekuar."*. [2]

Pasi citohen këto betime kuptimplota, nis përgjigjja e këtyre katër betimeve, duke thënë se njeriun, Ne e kemi krijuar në mënyrën më të mirë e më të përsosur: **"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer."**.

Fjala *"tekuijm"* ka kuptimin: jo vetëm të nxjerrësh diçka në trajtë të përshtatshme, por edhe cilësia të jetë e mirë. Gjithashtu, kjo fjalë ka një kuptim të gjerë, për faktin se All'llahu e ka krijuar njeriun në trajtën më të përkryer, si nga ana fizike, ashtu edhe nga ajo mendore e shpirtërore, sepse te njeriu, All'llahu ka vendosur talent dhe e ka përgatitur për t'u ngjitur lart. Edhe pse njeriu është në kundërvajtje, All'llahu ka vendosur tek ai një botë të madhe, i ka dhënë shumë dinjitet, që është i denjë për t'u ngritur në këtë pozitë: **"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit..."**.[3]

[1] "Biharul Enuar", vëll. 66, Hadithi 25, f. 183.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 66, Hadithi 19, f. 182.
[3] Sure "El Isrâ", ajeti 70.

Po ky njeriu i cili pasi është krijuar thotë: **"...Qoftë lartësuar All'llahu, Krijuesi më i përsosur!"**.[1]

Por, po ky njeri, me të gjitha mundësitë që i janë dhënë, nëse do të dalë nga rruga e drejtë, do të bjerë aq poshtë, saqë do të shkojë drejt *Esfele Safilijn* (në gjendjen më të ulët). Ndaj në ajetin tjetër All'llahu thotë se Ne e ulëm në shkallën më të ulët: **"Pastaj e çuam atë** (kur nuk beson) **në gjendjen më të ulët."**

Më tej thotë se pranë maleve të mëdha ekzistojnë dyer shumë të thella dhe, në krahasim me ato, zhvillimi dhe rënia e i njeriut duket e tmerrshme. Po përse të mos jetë i tillë, ndërkohë që është një qenie me talente. Nëse këto talente i shfrytëzon në rrugën e përmirësimit, do të ngjitet në lartësitë më të mëdha dhe do të jetë krenari, por, nëse të gjitha këto mirësi dhe talente do t'i përdorë në rrugën e gabuar, atëherë do të jetë korruptuesi më i madh dhe natyrisht që do të jetë te *Esfele Safilijn* më të ultit.

Në ajetin tjetër thotë se ata që besuan dhe bënë punë të mira, do të kenë shpërblim që nuk do të ndërpritet. **"Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera."**

Fjala *"memnun"* vjen nga rrënja *"men"*. Në këtë rast ka kuptimin: *ndarje ose mangësi*, prandaj fjala *"gajru memnun"* flet për një shpërblim të vazhdueshëm dhe pa asnjë mangësi.

[1] Sure "El Mu'minûn" ajeti 14.

Disa komentues janë të mendimit se fjala *"pa mangësi"* ose *"pa të meta"* ka për qëllim të tregojë të qenit bosh, pa gjë. Kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Disa komentues të tjerë, thonë se fjalia: "*thumme redednahu esfele safilijn"*, ka kuptimin dobësi, pamundësi, jo inteligjent, mungesë shkathtësie në periudhën e pleqërisë. Por në këtë rast, nuk ka asnjë përshtatje me ajetin, se nuk është një rast i veçantë, prandaj, duke parë ajetet e mëparshme dhe ato që vijnë më poshtë, themi komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Më pas, këtë njeri jo falënderues dhe të pavëmendshëm e vendos në pozitën e dëgjuesit, duke treguar arsyet dhe shenjat e Ringjalljes. Duke e pyetur se pse e mohon Ditën e Gjykimit, pasi i dëgjon të gjitha këto argumente: **"Atëherë, çfarë të shtyn ty** (o njeri)**, që ta mohosh Ditën e Kiametit?"**.

Jeta e disa ditëve nuk mund të jetë qëllimi përfundimtar, jo vetëm i krijimit tënd, por edhe i krijimit të botës. Të gjitha këto janë parapërgatitje për një botë më të madhe dhe më të plotë dhe, sipas interpretimit të Kur'anit, "Nesh'etul Uula", është vetë lajmërim për "Nesh'etul Ukhra", (Ringjallja) që pse njeriu nuk e pranon kritikën, pse nuk mëson.[1] **"Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare), atëherë përse nuk mendoni?!"**[2]

Në botën e bimëve, ç'do vit dhe vazhdimisht, filizat dhe fidanët tregojnë dhe shfaqin para nesh jetën e dytë, edhe krijimi i

[1] Në vëllimin 23, nga faqja 239 e më pas janë cituar 7 argumente për çështjen e Ringjalljes, duke përdorur ajetet e sures "Uakia", në komentim.
[2] Sure "Uakia", ajeti 62.

embrionit, të gjitha këto tregojnë Ringjalljen dhe jetën e dytë. Me të gjitha këto, si mundet ky njeri të mohojë Ditën e dhënies llogari?

Nga ç'u tha, është e qartë se referenti i këtij ajeti është njeriu. Është dhënë edhe një mundësi tjetër, që dëgjuesi është vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili, duke pasur të gjitha argumentet e Ringjalljes, nuk mund ta mohojë njeri. Një mundësi komentimi e tillë, duket e pamundur.

Është e qartë se qëllimi për fenë, në këtë rast, nuk është feja dhe Sheriati, ligji, por është dhënia e llogarisë në Ditën e madhe të Gjykimit.

Ajeti tjetër është dëshmues i këtij kuptimi: **"A nuk është All'llahu Gjykatësi më i drejtë?!"**.

Dhe nëse e marrim fenë në kuptimin e përgjithshëm të Sheriatit (ligjit) dhe fesë, kuptimi i këtij ajeti do të jetë si më poshtë: "A nuk janë urdhrat dhe dekretet e Zoti më të drejta nga të gjithë?".

Kuptimi tjetër është i tillë: Krijimi i Zotit, për sa i përket njeriut, në çdo drejtim, është i bashkuar me drejtësinë dhe dijen.

Nëse do të shpreheshim kështu, shprehja dhe kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Në një hadith thuhet se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)* lexonte suren "Et tijn" dhe, kur arrinte tek ajeti: **"A nuk është Allahu Gjykatësi më i mirë"** (e lejse All'llahu bi Ahkemul Hakimijn), thoshte: **"Sigurisht.**

Dhe unë jam dëshmitarë për këtë." (Bela, ue ena ala dhalike mine esh shahidin).[1]

*O All'llah! Ne dëshmojmë se ti je **Gjykatësi më i drejtë!"***

O All'llah! Na ke krijuar në mënyrën më të mirë, na bëj që edhe veprat dhe morali ynë të jenë në formën më të mirë!

O All'llah! Ecja në Rrugën e Drejtë dhe kryerja e veprave të mira nuk bëhet vetëm se me mirësinë dhe kënaqësinë Tënde. Na bëj edhe ne përfitues të kësaj mëshire!

Amin! Ja Rabil Alemin!

Fundi i sures "Et Tijn".

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 512. Po me këtë kuptim është cituar edhe në tefsiret: "Ruhul Bejan"; "Kurtubij" dhe "Fi Dhilalil Kur'an", në vazhdim të ajetit që diskutuam.

Sure "El 'Alak"

Zbritur në Mekë

Ajete 19

Përmbajtja e sures "El 'Alak"

Midis dijetarëve është e njohur se kjo sure është surja e parë që ka zbritur për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Gjithashtu, përmbajtja e saj e qartëson këtë gjë.

Ka shumë kundërshtime, nëse surja "Hamd" ose surja "Muddeththir" janë ndër suret e para që kanë zbritur për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Kjo sure, pra, surja "El 'Alak", në fillim të saj, e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të lexojë.

Më pas flet për madhështinë e krijimit të njeriut nga një pjesë gjaku pa vlerë.

Në stadin tjetër, flet për përsosmërinë e njeriut në rendin e mirësisë dhe të bujarisë së All'llahut, si dhe me njohjen e njeriut me dijen e All'llahut.

Më tej flet për njerëzit që nuk janë falënderues, për ata që edhe pse shikojnë gjithë mirësinë dhe bujarinë e All'llahut, përsëri janë të devijuar.

Më pas flet për dënimin e dhimbshëm të atyre që janë pengesë e udhëzimit të njerëzve dhe të veprave të mira të tyre.

Në fund, surja përfundon, duke urdhëruar për sexhde ndaj All'llahut dhe afrimitet ndaj All'llahut.

Mirësitë e leximit të sures "El 'Alak"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Kushdo që gjatë ditës, ose gjatë natës reciton suren "El 'Alak" dhe vdes në po atë ditë apo natë, llogaritet sikur ka vdekur martir dhe atij i japin vend në radhët e martirëve. Në Kiamet ai është njësoj me ata që kanë luftuar në Rrugë të All'llahut, së bashku me Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).*". [1]

Kjo sure, për shkak të interpretimeve të ndryshme, të fillimit të saj, është e njohur me emrin sure "Alak", ose sure "Ikra", ose sure "Kalem".[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 512.
[2] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 478.

Ajetet 1 - 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِى خَلَقَ، خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ، اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ، الَّذِى عَلَّمَ بِالْقَلَمِ، عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Lexo me Emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)**,"**

"E krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!"

"Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh,"

"I Cili, me anë të penës ia mësoi,"

"Ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte."

Shkaku i zbritjes

Sikurse edhe e cituam në përmbajtjen e sures, sipas besimit të shumicës së komentuesve, kjo sure është e para sure që ka zbritur për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Sipas mendimit të përbashkët të komentuesve, pesë ajetet e para kanë zbritur të parat. Kuptimi i tyre e tregon këtë gjë.

Në transmetime ka ardhur se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte shkuar në shpellën Hira dhe Xhibraili u afrua pranë tij dhe i tha: *"O Muhammed! Lexo!"*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, u përgjigj se nuk di të lexoj. Xhibraili e mori në krahët e tij, e shtrëngoi dhe përsëri i tha: *"Lexo!"*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përsëriti të njëjtën gjë. Xhibraili përsëri tha të njëjtën gjë dhe përsëri mori të njëjtën përgjigje.

Herën e tretë tha: **"Lexo me Emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi** (gjithçka)**, e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte."**.

Pasi tha këto ajete, Xhibraili u largua nga sytë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi mori Shpalljen e parë, u lodh shumë dhe u nis për në shtëpi. Kur arriti në shtëpi, vajti pranë Hadixhesë dhe i tha: **"Më mbulo dhe shtro diçka që të pushoj pak"**.[1]

Tabrisi, në tefsirin e tij, "Mexhmaul Bejan", transmeton se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Hadixhesë: "*Kur jam vetëm, dëgjoj zëra (dhe jam i shqetësuar)!*".

All'llahu nuk do të të japë tjetër, përveçse mirësi, sepse ti, për Zotin, je prej atyre që e kryejnë amanetin, vizitojnë të afërmit. Ti thua të vërtetën, je besnik, - i thotë Hadixhja.

Pasi ndodhi kjo ngjarje, shkova pranë Uarakatu ibn Neufel . Ai ishte ndër dijetarët arabë dhe Hadixhja e kishte djalë xhaxhai.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ia kishte shpjeguar Uarakatu ibn Neufel atë që kishte parë dhe ai i kishte thënë se, kur ai zë vjen pranë teje, bëj kujdes dhe shiko çfarë dëgjon. Më pas hajde tek unë dhe më trego çfarë dëgjove.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur ishte vetëm, dëgjonte këtë zë që i thoshte: "O Muhammed! Thuaj: **'Bismilahi Rrahmani Rrahim Elhamdulilahi**

[1] "Ebul Fettuh Rrazij", vëll. 12, f. 96, (me pak ndryshim). Po këtë kuptim e kanë sjellë shumë komentues të Ehli Sunetit dhe komentues shi'it, në mënyra të ndryshme apo me ilustrime të ndryshme. Ku disa prej tyre nuk janë të pranueshme.

Rabil Alemin... Ueled Daalijn' dhe thuaj: *Lailahe ilall'llahu*.". Pasi i dëgjoi këto, vajti pranë Uarakatu dhe i shpjegoi ato çka dëgjoi.

Uarakatu i thotë: "Urime për ty! Edhe një herë, urime për ty! Unë dëshmoj se ti je ai që ka përzgjedhur Zoti për Profet, ashtu sikurse u përzgjodh Isai, i biri i Merjemes *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*. Ti do të kesh sheriat, ashtu sikurse kishte Musai *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ti je Profet, i përzgjedhur dhe shumë shpejt ti do të urdhërohesh për të luftuar. Nëse unë do ta arrij atë ditë, pa dyshim që edhe unë do të luftoj përkrah teje.".

Kur Uarakatu vdes, i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: "*Unë këtë burrë besimtar e kam parë në Xhennet (Xhennetin e Berzakhut), që në trup mbante rroba prej mëndafshi. Ky njeri dëshmoi për mua dhe besoi tek unë.*".[1]

Në librat e historisë, janë cituar dhe vihen re tekste të pakëndshme, për sa i përket këtij kapitulli të jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Sigurisht, ato citime që janë vënë re, janë hadithe të sajuara dhe konsiderohen si israilijat[2].

Për shembull: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas ngjarjes së parë të zbritjes së Shpalljes, u mërzit shumë dhe mendoi se mos këto fjalë janë prej shejtanit. Gjithashtu, vendosi të hidhej nga një shkëmb.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 514.
[2] Transmetime nga izraelitët.

Ka edhe shumë të tjera si këto, që nuk përputhen me pozitën e profetësisë dhe me arsyen e jashtëzakonshme të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Përgjatë gjithë jetës së tij, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është shquar për vetëkontroll, besim e shumë cilësi të tjera.[1]

Është e dukshme se të tilla transmetime janë të dobëta dhe të ndërtuara nga armiqtë e Islamit. Ata, në këtë mënyrë, duan që ta vënë në dyshim si fenë islame, ashtu edhe personalitetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Duke pasur vëmendje për çka u tha më lart, le të komentojmë ajetet.

[1] Sipas këndvështrimit të disa komentuesve, biseda midis Hadixhes dhe Uarakatu ibn Neufel, si dhe biseda e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Veraken nuk mund të jenë të vërteta, sepse, nëse bazohemi te vitet e fëmijërisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ajo që ka ngjarë në rininë e tij, që edhe Hadixhja e përzgjodhi dhe kërkoi të martohej me të për ato cilësi dhe për atë personalitet që kishte. Përkujdesja dhe vëmendja e veçantë e Abdul Mutalibit dhe e Ebu Talibit, si dhe hytbja "Kaseeh", që Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* mban, thotë se All'llahu ka vendosur një engjëll në shërbim të Profetit, që ta edukojë atë, të gjitha këto tregojnë se se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte dijeni për Profetësinë e tij dhe nuk kishte nevojë që Verakeja ta miratonte atë.

Komentimi

Lexo me emrin e Zotit tënd

Në ajetin e parë, All'llahu e vendos Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si dëgjues dhe i thotë: **"Lexo me Emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi** (gjithçka)**."**.[1]

Disa komentues janë të mendimit se në fjalinë e mësipërme, objektivi është hequr dhe se ajeti ka qenë:"Lexoje Kur'anin me Emrin e Zotit tënd!". Për këtë shkak, disa këtë ajet e kanë marrë si argument për të thënë se "Bismilah" është pjesë e ajeteve të Kur'anit.

Të tjerë janë të mendimit se shkronja *"ba"* është e shtuar dhe qëllimi i përdorimit të kësaj shkronje është për të lexuar Emrin e All'llahut.

Ky komentim është tepër i largët, sepse më e përshtatshme është të thuhet: "Kujto Emrin e All'llahut krijuesit tend.".

Duhet të dihet se, në këtë rast, përpara çdo gjëje, më tepër i është kushtuar vëmendje çështjes së "sunduesit të gjithçkaje" të All'llahut. Ne e dimë se fjala *"rabb"* ka kuptimin: "Zot, kujdestar", që do të thotë, një person që është zotërues i një gjëje, gjithashtu është edhe edukues, edhe kujdestar i saj.

[1] Ragibi në veprën "Mufredat" thotë se fjala *"kiraetun"* ka kuptimin: *të bashkosh dhe të ngjisësh shkronjat dhe fjalët me njëra-tjetrën*. Ndaj dhe fjalëve të veçanta nuk u themi *"keraet"*.

Më tej, për të vërtetuar se All'llahu është Zot, për trajtimin e çështjes së krijimit, janë mbështetur te çështja e krijimit të botës, sepse ajo është një ndër argumentet më të mirat për All'llahun dhe për krijimin e Tij.

Botën e drejton Ai që e ka krijuar.

Kjo është një përgjigje për jobesimtarët arabë, të cilët e kishin pranuar se krijimi është nga ana e All'llahut, por thoshin se Sundimi dhe komandimi bëhet nga ana e idhujve dhe jo nga All'llahu! Ndërkohë që Njëshmëria e All'llahut shikohet dhe vërtetohet në sistemin e universit. Kjo gjë është argumenti më i mirë për të vërtetuar Qenien e Pastër të All'llahut të Madhëruar.

Ndërmjet të tjerash, mund të shikohet krijesa më e mirë në këtë botë, që është njeriu. Krijimi i tij është rikujtuar në ajetet e Kur'anit: **"E krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!"**.

Po Ai Zot, që e ka krijuar njeriun nga një gjak i ngjizur.

Fjala *"alak"* ka kuptimin: *të ngjitesh pas diçkaje*. Ndaj dhe gjakut të ngjizur dhe gjakut në trup, i thuhet *"alak"*. Kur embrioni e kalon periudhën e parë në botën embrionale, del në formën e një cope gjaku të ngjitur, që në pamje të parë është një gjë me pak vlera. Fillimi i krijimit të njeriut, në këtë ajet, jepet si një qenie e pavlerë, që më pas, me fuqinë e All'llahut, kthehet në një qenie me shumë vlera.

Të tjerë komentues, janë të mendimit se qëllimi i përdorimit të fjalës *"alak"*, në këtë rast, është dheu i Ademit, sepse ai dhé kishte ngjashmëri me atë që thuhet në ajet, ishte dhé që ngjitej. All'llahu i

Madhëruar, që e krijoi njeriun nga një pjesë e çuditshme dheu, a nuk e meriton të adhurohet?

Po ashtu ndonjherë fjala *"alak"* është marrë me kuptimin: *të kesh dëshirë*, gjë e cila të bën me dije apo të tregon ndjesinë shoqërore të njeriut si dhe përgjumjen e tyre apo mos vëmendjen ndaj njëri-tjetrit, që në të vërtetë cilivizimi i shoqërisë është bazamenti kryesorë i zhvillimit dhe qytetërimit njerëzorë.

Të tjerë komentues, fjalën *"alak"* e kanë trajtuar si spermën e mashkullit. Kjo krijesë sa grimca, noton në ujëra dhe drejtohet kah veza, ku dhe ngjitet te mitra e femrës. Të dyja këto sjellin në jetë një embrion, që më pas bëhet një njeri i përsosur.

Është e vërtetë se në atë kohë, të tilla çështje nuk janë trajtuar dhe nuk kanë qenë të njohura për njeriun, por Kur'ani i Shenjtë, nëpërmjet dijes, ka bërë që të largohet perdja që mbulonte dijen e krijimit të njeriut.

Ndër këto katër komentime, komentimi i parë është më i qartë dhe më i plotë. Përmbledhja dhe bashkimi i katër komentimeve nuk sjell asnjë dëm.

Nga ajo që u tha, bëhet e qartë se njeriu, sipas një komentimi, ka ardhur me kuptimin e Profetit Adem *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe sipas tre komentimeve të tjera, ka kuptimin e të gjithë njerëzve.

All'llahu i Madhëruar, për të theksuar edhe një herë faktin se është bujar, thotë: **"Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh!"**.

Lexo, sepse Krijuesi yt është më bujar se çdo bujar tjetër dhe është më Zotëri se çdokush tjetër. (Ikra ue Rabbuke Ekremu.)

Disa komentues janë të mendimit dhe besojnë se fjala e dytë *"ikrah" – "lexo"*, është vendosur për të theksuar fjalën *"ikra"-n* e parë.

Komentues të tjerë janë të mendimit se është e ndryshme nga fjala *"ikra"* e dytë, sepse në fjalinë e parë, ka për qëllim leximin (Keraetin) e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ndërsa në fjalinë e dytë ka për qëllim leximin për njerëzit. Por më e arsyeshme dhe më afër logjikës është se ka ardhur si theksim, edhe pse për të dy këto fjali nuk kemi argument.

Gjithsesi, interpretimi i këtyre dy ajeteve është përgjigje për fjalët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndaj Xhibrailit, kur thotë se unë nuk di të lexoj, që do të thotë se ti ke mundësi të lexosh, me bereqetin dhe bujarinë e jashtëzakonshme të All'llahut të Madhëruar.

Më poshtë, All'llahu i Madhëruar flet për cilësitë e Tij, cilësi që e bëjnë All'llahun më Bujarin e bujarëve: **"I Cili, me anë të penës ia mësoi,"**.

All'llahu është Ai që, nëpërmjet lapsit dhe penës, të mëson. Njeriut i mësoi ato çka nuk dinte. **"Ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte."**.

Në të vërtetë, të gjitha këto fjalë janë përgjigje për atë çka Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha, se nuk dinte të lexonte, që do të thotë se Zoti, nëpërmjet penës, i mëson njeriut atë që nuk e di. Ai është i zoti t'i mësojë një krijese që nuk ka mësuar më parë shkrim e këndim, të lexojë.

Fjalia: "*El'ledhi al'leme bil kalem*", ka dy kuptime:

Së pari, All'llahu i mësoi njeriut shkrimin, i mësoi atij librin. Të dyja këto janë fuqi dhe mundësi e madhe që All'llahu i ka dhënë njeriut. Nëpërmjet kësaj fuqie, nis fillimi i historisë njerzore, burimi i pastër i shkencave teknologjike dhe i qytetërimeve.

Së dyti, dija dhe shkencat i janë transmetuar njeriut nëpërmjet kësaj rruge.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas një komentimi, ajeti ka për qëllim të theksojë të nxënin e librit.

Sipas një tjetër komentimi, ka për qëllim dijen që na vjen ne në dorë, si pasojë e librit. Në të dyja rastet, është një interpretim me shumë kuptim, që në ato momente të ndjeshme kanë zbritur ajetet e para të Shpalljes e që u janë bashkangjitur ajeteve të tjera.

Hulumtime

1- Rinisja dhe fillimi i Shpalljes u bë bashkë me një lëvizje shkencore

Këto ajete, ashtu sikurse e thamë, sipas besimit të shumë komentuesve, janë ajetet e para që iu shpallën të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Me zbritjen e parë të ajeteve rinis një kapitull i ri në historinë e

njerëzimit. Njeriu u bë përfitues i një mrekullie të madhe hyjnore. Në këtë kapitull përfunduan dhe u plotësuan të gjitha fetë e tjera. Më pas zbritën të gjitha ligjet dhe mësimet hyjnore. Ajeti kur'anor thotë: **"...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."**.[1]

Në këtë rast, do të shikoni një çështje shumë interesante. Profeti *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte *"umi"*[2] i pamësuar nga ndokush, nuk kishte studiuar pranë ndonjërit, Hixhazin e kishte mbytur injoranca.

Në ajetin e parë të Shpalljes flitet për çështjen e dijes dhe të shkrimit. Pas kësaj mirësie të madhe flitet për krijimin e njeriut.

Këto ajete të para, së pari, flasin për zhvillimin e trupit të njeriut, i cili është një qenie pa vlerë (aleke), nga ana tjetër, flitet për përsosmërinë e shpirtit, nëpërmjet të mësuarit dhe të nxënit, në veçanti nëpërmjet lapsit.

Kur zbritën këto ajete, jo vetëm në Hixhaz, i cili ishte një vend i zhytur në injorancë, por edhe në vende të tjera, askush nuk ia dinte vlerën lapsit. Në botën e qytetëruar të asokohe, lapsi nuk kishte vlerë. Por sot ne e dimë se të gjithë qytetërimet, dijet, hulumtimet, shkencat dhe zhvillimet, janë vetëm nëpërmjet lapsit. Njeriut i është dhënë mundësia të punojë me lapsin. Boja, me të cilën shkruan dijetarët, ecën më shpejt se sa "gjaku i dëshmorit", sepse gjaku i dëshmorit është themeli i mbrojtjes për bojën e penës

[1] Sure "El Maide", ajeti 3.
[2] Fjala "ummij" do të thotë person i cili nuk ka vajtur të mësojë në shkollë apo pranë dikujt"

së dijetarit. Në parim, e ardhmja e popujve është e lidhur me majën e penës së parë.

Reformat e komuniteteve nisin nga penat besimtare. Gjithashtu, edhe korrupsioni dhe shkatërrimi i një shoqërie nis po nga penat e helmuara dhe të korruptuara.

Kur'ani i Shenjtë nuk betohet më kot në penën dhe në atë që e shkruajmë me penë, që do të thotë se betimi është edhe për "mjetin", edhe për "produktin" e mjetit. *"Nun. uel kalemi ve ma Jesturun"* **"Nûn. Betohem për penën dhe për atë që shkruajnë"**[1]

Ne dimë se periudha e jetës së njeriut është e ndarë në dy periudha:

Periudha historike.

Periudha para historike.

Periudha historike është periudha kur pena e njeriut ishte bërë risi tashmë dhe njeriu mund të linte diçka si kujtim nga jeta e tij. Në këtë mënyrë, historia e njeriut është e barabartë me historinë e zanafillës së penës.

Për rolin e penës në jetën e njeriut, është bërë një komentim i gjerë në në fillim të sures "Kalem" të këtij komentimi.

Si përfundim, themeli i Islamit është vënë me penë dhe jo më kot, një popull i tillë që më parë ishte i prapambetur, do të lulëzonte me dijen e tij. Ata e shpërndanë gjithkund dijen, si të miku, ashtu edhe te armiku. Sipas historianëve të njohur

[1] Sure "Kalem" ajeti 1.

evropianë, ishte dija dhe drita e dijes islame ajo që e i dha Evropës vend në histori dhe e futi atë në epokën e qytetërimit.

Nga vetë ata, për këtë fushë janë shkruar libra të shumtë. Përmendim: "Historia e qytetërimit islam", ose "Trashëgimia islame".

Sa e pakëndshme që është, një popull i tillë, një fe e tillë të mbetet prapa në fushën e dijes, të jetë i varur nga të tjerët dhe t'u shtrijë dorën atyre.

2- Me emrin e Allahut në çdo situtë

Fillesa e ftesës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka nisur me Emrin e All'llahut: "Ikra Bismi Rabbik". E gjithë jeta e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë e mbushur me mirësi dhe bollëk dhe kjo si shkak i përmendjes së vazhdueshme që i bënte All'llahut. Përmendja e Emrit të All'llahut ishte në çdo frymëmarrje të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur ngrihej, kur ulej, kur flinte, kur ecte, kur kalëronte, kur zbriste, kur qëndronte, çdo gjë ishte në Emër të All'llahut.

Kur ai zgjohej nga gjumi, thoshte: *Falenderimi i takon Atij që na ringjalli pasi na vdiq dhe te Ai do të shkojmë. "Elhamdulilahi ledhi ehjana bade ma ematena ve ve ileihil nushur".*

Ibn Abasi thotë: "Një natë fjeta pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur u

zgjua, ngriti kryet nga qielli dhe recitoi dhjetë ajetet e fundit të sures "Ali Imran" e tha: **"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët",** më pas thoshte: *O Zot! Ty ytë takon falenderimi. Ti je drita e qiejve dhe e tokës dhe çfarë gjendet në to. O Zot! Ty të dorëzohem Ty të besova dhe te Ti u mbështeta dhe te Ti u ktheva! "All'llahume lekel hamdu ente nurul semavati vel erdhi ve men fihine. All'llahume leke eslemtu ve bike amentu ve aleike tevekeltu ve ileike enbetu...".*

Kur dilte nga shtëpia, thoshte: *Me emrin e Allahut. I jam mbështetur All'llahut. O Zot! Unë kërkoj mbrojtjen Tënde që unë të humbas dhe të çoj të tjerët në humbje! Unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga gabimet! Unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga padrejtësia dhe të bërit e saj, Unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga padituria ime dhe nga padituria ndaj meje! "Bismilah, tevekeltu ala All'llahi, All'llahume ini eudhu bike en udhile eu udhile eu unzile, eu edhlime, eu exh'hile aleje".*

Kur hynte në xhami, thoshte: *"Eudhu Bil'iahil adhijmi ue bi uexh'hihil kerijmi ue sultanihil kadijmi minel shejtani rraxhijmi"*

Kur vishte rroba të reja, thoshte: *"All'llahume lekel hamdu ente kesevtenihi eseluke hejren ma sunieh lehu ve eudhu bike min sherihi ve shere ma sunie lehu".*

Kur kthehej në shtëpi, thoshte: *"Elhamdulilahi ledhi kefani ve avani ve elhamdulilahi ledhi utemeni ve sekani".*

Kështu, në këtë mënyrë, e gjithë jeta e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte e mbushur me Emrin e All'llahut.[1]

[1] "Fi Dhilalul Kur'an", vëll. 8, f. 619, e më pas (me shumë shkurtime).

Ajetet 6 - 14

﴿كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لَيَطْغَى٦ أَنْ رَآهُ اسْتَغْنَى٧ إِنَّ إِلَى رَبِّكَ الرُّجْعَى٨ أَرَأَيْتَ الَّذِى يَنْهَى٩ عَبْدًا إِذَا صَلَّى١٠ أَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ عَلَى الْهُدَى١١ أَوْ أَمَرَ بِالتَّقْوَى١٢ أَرَأَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى١٣ أَلَمْ يَعْلَمْ بِأَنَّ اللَّهَ يَرَى١٤﴾

“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak,”

“Kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”

“Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!”

“A e ke parë ti (Muhammed) **atë që pengon”**

“Robin (Tonë) **kur falet?”**

“A nuk është ai (robi Ynë) **në Rrugë të Drejtë”**

“Dhe që urdhëron për devotshmëri?!”

“Mendo, nëse ai (penguesi) **mohon dhe kthen kurrizin,”**

“A nuk e di ai se All’llahu i sheh të gjitha?!”

Komentimi

Shkaku shkeljes së cakut

Ajetet e kaluara flisnin për mirësitë materiale dhe shpirtërore që All'llahu i ka bërë njeriut. Një mirësi e tillë kërkon falënderim dhe bindje ndaj All'llahut.

Në ajetet që do të diskutojmë, thuhet se jo gjithmonë mirësitë e All'llahut e bëjnë shpirtin e njeriut të ringjallet, të falënderojë për mirësitë që i janë dhënë. Ato, ndonjëherë, bëjnë që njeriu të jetë arrogant: **"Por vërtet që njeriu shkel çdo cak."**.

Këtë e bën, sepse e shikon veten të fortë dhe të pasur, i duket sikur nuk ka nevojë për gjë: **"Kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."**.

Është në natyrën e njeriut kjo gjë, në natyrën e atyre që nuk janë rritur dhe nuk janë edukuar në shkollën e Shpalljes dhe të arsyes, sepse ata e konsiderojnë vetveten të vetëmjaftueshëm dhe nisin të jenë kryelartë dhe arrogantë.

Ata, as All'llahun dëgjojnë, as janë rob të Tij, as ligjet e Tij nuk i njohin, as zërit të unit e të egos së brendshme të tyre nuk ia vënë veshin e as janë zbatues të së drejtës.

As njeriu e as ndonjë krijesë tjetër, kurrë nuk do të jetë i vetëmjaftueshëm, por krijesat gjithmonë do të jenë nevojtare ndaj të Krijuesit. Nëse mëshira dhe hiri i All'llahut ndalohet për një sekondë, ne, në po atë sekondë, do të zhdukemi nga faqja e dheut. Ndaj njeriu, ndonjëherë, humbet në gabimin e tij dhe mendon se është i vetëmjaftueshëm.

Interpretimi i butë i ajetit, gjithashtu, flet për këtë kuptim. E shikon veten të vetëmjaftueshem, sikur nuk ka nevojë për kënd.

Disa janë të mendimit se ky ajet i aludohet Ebu Xhehlit, që në fillim të ftesës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kundërshtoi atë. Por, në këtë rast, fjala *"insan"* ka kuptim të përgjithshëm, ndërsa persona si Ebu Xhehli janë shembuj prej tyre.

Sidoqoftë, duket se qëllimi i ajetit është: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të mos ketë shpresë që njerëzit do t'ia pranojnë shpejt ftesën, por duhet ta përgatisë veten e tij që arrogantët do të jenë mohues. Gjithashtu, duhet ta dijë se rruga është me ulje dhe se tatëpjeta është para tij.

Më tej, këta arrogantë kërcënohen: **"Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!"**. Sigurisht që kthimi i të gjithëve ju, është drejt All'llahut.

Në parim, të gjitha gjërat e kanë kthimin tek All'llahu. Të gjithë do të vdesin, e trashëgimia e qiellit dhe e tokës do të mbetet për Qenien e Pastër të Tij. Ata që bëhen koprracë me të mirat që u ka dhënë All'llahu, kurrsesi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta. Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar, do t'u ngarkohet atyre në qafë në Ditën e Kiametit. E All'llahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe All'llahu e di mirë ç'punoni ju.[1]

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 180.

Që në fillim, gjithçka ishte e All'llahut dhe se s'ka përse që njeriu ta konsiderojë veten e tij arrogant dhe të vetëmjaftueshëm.

Më tej flitet për punët e arrogantëve dhe të mendjemëdhenjve, parandalimi i tyre për të ecur në Rrugën e Drejtë, si dhe udhëtimi i tyre drejt rrugës së udhëzimit dhe të devotshmërisë. **"A e ke parë ti** (Muhammed) **atë që pengon?"**. Më thuaj mua, a ka njeri që mohon? **"Robin** (Tonë) **kur falet?"**[1] A nuk meriton një njeri i tillë dënim?!

Në hadithe transmetohet se Ebu Xhehli pyeti parinë që i rrinte prapa: "A mos vallë, Muhammedi e vendos fytyrën e tij në (sexhde) tokë, kur është me ju?"

- Po, iu përgjigjën ata.

- Betohem në atë që ne betohemi, nëse unë do ta shikoja atë në të tillë gjendje, do t'ia bëja qafën hi me këmbën time! – tha ai.

- Shiko, ai është duke falur namaz! - e orientuan atë.

Ebu Xhehli kur e pa, u nis drejt Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që t'i vinte këmbën mbi qafë. Kur u afrua pranë, u largua dhe me dorën e tij dukej sikur largonte diçka. Kur e pyetën atë, se ç'pati, ç'e gjeti që po bënte ashtu, tha: "Papritur midis meje dhe tij u shfaq një hendek prej zjarri. Një pamje e tmerrshme! Pashë fletë e krahë".

[1] Vargjet aludojnë për një nga prijësit e Mekës, Ebu Xhehlin, i cili ishte armiku kryesor i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!),* në fillimet e Islamit. Ai e kishte kërcënuar Profetin *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*, që të mos falej më në Qabe.

"Betohem për All'llahun, që shpirti im është në dorën e Tij, nëse do të më afrohej, engjëjt e All'llahut do t'ia bënin trupin copa–copa", - tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë rast zbritën ajetet e mësipërme.[1]

Sipas këtij transmetimi, ajetet e mësipërme nuk kanë zbritur në fillimin e misionit të profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*, por kanë zbritur, kur ftesa për në fenë islame bëhej hapur, ndaj dhe disa janë të mendimit se kësaj sureje në fillim i kanë zbritur vetëm pesë ajetet e para, në fillimin e misionit, ndërsa ajetet e tjera kanë zbritur më vonë.

Por gjithsesi, shkaku i zbritjes nuk është aspak pengesë për kuptimet e shumta të ajetit.

Në ajetet 11-12, për të theksuar më tepër, thuhet: **"A nuk është ai** (robi Ynë) **në Rrugë të Drejtë dhe që urdhëron për devotshmëri?!"**.

A është e drejtë ta mohojmë atë? A mund të këtë dënim tjetër për këtë person përveç zjarrit të Xhehennemit?!

Më lajmëro, nëse ky person arrogant, do të të pengojë në Rrugën e Drejtë dhe do të të pengojë në namaz e në devotshmëri. Nëse do të mohojë të vërtetën dhe të largohet prej saj, sa fat të dhimbshëm ka për të pasur! **"Mendo, nëse ai** (penguesi) **mohon dhe kthen kurrizin."**

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 515.

A nuk e dinë se All'llahu i shikon të gjitha veprat e tyre dhe i regjistron ato për në Ditën e Kiametit? **"A nuk e di ai se All'llahu i sheh të gjitha?!"**

Interpretimi në ajetet e mësipërme, thekson se ky njeri arrogant duhet të mendojë të paktën një gjë, që Profeti *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është në rrugën e udhëzimit, ftesa e tij është ftesë për devotshmëri.

Ajeti nuk flet për frikë në rrugën e udhëzimit dhe të ftesës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* drejt devotshmërisë, por flet për frikën që duhet të kenë ata që pengojnë Profetin Muhammed në rrugën e udhëzimit.

Disa komentues, zanoren e fjalës *"kane"* dhe *"emere"* e kanë komentuar po te ai person mohues, sikurse ishte Ebu Xhehli, prandaj, kuptimi i ajetit bëhet: Nëse ai e pranon udhëzimin dhe në vend të pengesës së namazit, pranon ftesën e devotshmërisë, sa e dobishme do të jetë kjo gjë për të! Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Hulumtim

I gjithë universi është në praninë e All'llahut

Prania e All'llahut ndihet në të gjithë universin, ndaj duhet të kihet parasysh kjo e vërtetë, që çdo punë apo vepër që njeriu e kryen, shënohet tek All'llahu.

Në parim, i gjithë universi është në praninë e All'llahut. Asgjë nuk është e fshehur për All'llahun, veprat, nijetit, si dhe gjithçka tjetër janë shumë të qarta për Krijuesin. All'llahu mund të ndikojë në programet e njeriut dhe ta ndalojë atë në kryerjen e veprave të liga, me kusht që njeriu ta besojë Atë, në zemrën e tij të ketë vend dhe besimi i tij të jetë i sigurt.

Në një hadith lexojmë: "*Adhuroje All'llahun në atë mënyrë sikur po e shikon. Edhe pse ti nuk e shikon, Ai të shikon ty.*".[1]

Transmetohet se një zemër ishte zgjuar, pasi kishte mëkatuar, ishte penduar. Gjithë kohës qante. E pyetën se përse qan kaq shumë. A nuk e di se All'llahu është Mëkatfalës, Mëshirues?

Ajo u përgjigj: "Po, është e vërtetë që All'llahu është Mëshirues dhe ka mundësi të më ketë falur, por unë, si ta largoj këtë turp dhe këtë mundim?! Ç'të bëj se turpi nuk më lë?".

[1] "Biharul Enuar", vëll. 25, Hadithi 16, f. 204.

Ajetet 15 – 19

﴿كَلَّا لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ١٥ نَاصِيَةٍ كَاذِبَةٍ خَاطِئَةٍ١٦ فَلْيَدْعُ نَادِيَهُ١٧ سَنَدْعُ الزَّبَانِيَةَ١٨ كَلَّا لَا تُطِعْهُ وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ ١٩﴾

"Jo, jo! Nëse ai nuk tërhiqet nga kjo, Ne do ta kapim për ballukesh (për ta hedhur në zjarrin e Xhehennemit)**,"**

"Për ballukesh të gënjeshtarit dhe fajtorit."

"Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet."

"Ne do t'i thërrasim Zebanijet (rojet e Xhehennemit)**!"**

"Kurrsesi mos iu nënshtro atij (o Muhammed)**, por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!"**

Komentimi

Suxhudi dhe të afruarit te All'llahu

Në vazhdim të diskutimit që u bë në ajetet e kaluara, për sa u përket arrogantëve dhe mendjemëdhenjve jobesimtarë, në lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe me falësit e namazit, ajetet në vazhdim janë kërcënuese dhe thonë se nuk është ashtu sikurse mendoni ju, (menduat se mund të vendosni këmbë mbi kokën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur bënte sexhde. Ju menduat se mund ta ndaloni atë nga program i tij hyjnor.

Jo. Nëse nuk hiqni dorë nga injoranca juaj dhe nuk e ulni hundën tuaj, do t'ju shkulen flokët e parme të kokës dhe ju do të shkoni drejt dënimit.

"Jo, jo! Nëse ai nuk tërhiqet nga kjo, Ne do ta kapim për ballukesh (për ta hedhur në zjarrin e Xhehennemit)**, për ballukesh të gënjeshtarit dhe fajtorit."**

Fjala"*le nesfe'an*" vjen nga rrënja "*es sef'u*" dhe, sipas disa komentuesve, ka kuptim të ndryshëm, si: *të marrësh e të tërheqësh dikë më forcë, ta qëllosh në fytyrë, t'i nxish fytyrën, të turpërosh dhe të përçmosh*.[1] Në këtë rast, komentimi i parë është më i përshtatshëm,

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 32, f. 23.

edhe pse ajeti për të cilin po diskutojmë, mund të ketë edhe kuptime të tjera.

Sidoqoftë, a mos vallë ka për qëllim, ndodhinë në Ditën e Kiametit, që në atë ditë do të tërhiqen flokët e Ebu Xhehlit dhe të shokëve të tij, të cilët do të futen në zjarrin e Xhehennemit, apo këto dënime do t'i shijojnë edhe në këtë botë, apo flitet për dënimin në të dy botët?

Nuk duket i pamundur dënimi i të dy botëve. Për këtë përfundim, bazohemi në hadithin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në transmetim lexojmë: "Kur zbriti surja 'Err Rrahman', Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u tha shokëve të tij: *'Kush nga ju do ta recitojë këtë sure për prijësit e kurejshëve?'*

Të pranishmit në fillim heshtën pak, sepse kishin frikë nga ata.

- O i Dërguari i All'llahut, do ta kryej unë këtë punë! – tha Abdullah ibn Mes'udi

Ibn Mes'udi kishte trup të dobët, por u ngrit dhe u nis pranë kryetarëve të kurejshëve. Kur pa se ata ishin mbledhur përreth Qabes, nisi të recitojë suren 'Err Rrahman'. Kur e dëgjoi Ebu Xhehli, u ngrit dhe e qëlloi në fytyrë aq shumë, saqë edhe veshin ia çau dhe nisi t'i rridhte gjak.

Ibn Mes'udi, duke vuajtur dhe me lot nën sy, shkoi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut*

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e pa në atë gjendje Ibn Mes'udin, u mërzit shumë, uli kokën dhe e përfshiu hidhërimi dhe mërzia. Papritur u shfaq Xhibraili i qeshur dhe i gëzuar.

- *O Xhibrail! Përse po qesh, ndërkohë që Ibn Mesudi është duke qarë?* – e pyeti Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

- *Shumë shpejt do ta marrësh vesh arsyen*, - iu përgjigj Xhibraili.

Kjo ngjarje kaloi dhe myslimanët shumë shpejt nisën Luftën e Bedrit, ku dolën fitimtarë. Ibn Mes'udi po ecte midis të vrarëve mushrikë. Sytë i hasën tek Ebu Xhehli, që ishte në grahmat e fundit. Ibn Mes'udi, u ul mbi kraharorin e tij. Kur Ebu Xhehli e pa, tha: 'O çoban i pavlerë!'

- Islami është ai që merr më të mirën dhe mbi Islamin nuk do të jetë kush! – i tha Ibn Mes'udi.

- Thuaji shokut tënd, Muhammedit, se jo vetëm gjatë gjithë jetës sime, por edhe në momentin e vdekjes nuk kam parë njeri më të urryer se ai! - i tha Ebu Xhehli atij.

Kur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mori vesh këtë gjë, tha: *'Faraoni i kohës sime, është më i keq se sa Faraoni i Musait (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), sepse Faraoni i tij, në momentin e fundit të jetës, besoi, ndërsa ky e shtoi edhe më tepër arrogancën e tij."*

- Ma pri kokën me shpatën tënde, sepse është më e mprehtë, - Ebu Xhehli iu drejtua Ibn Mes'udit.

Kur Ibn Mes'udi ia ndau kokën nga trupi, nuk mundi ta merrte në dorë që t'ia çonte të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por e tërhoqi zvarrë atë, duke e mbajtur prej ballukesh. Kështu u përmbush kuptimi i ajetit, për dënimin në këtë botë.".[1]

Fjala *"en nasijetun"* ka kuptimin: *flokët e parme, balluke*, të kapësh *balluket* thuhet në disa vende, kur duan të poshtërojnë dikë dhe ta detyrojnë të bëjë një punë, e kapin nga flokët e parme, balluket, sepse, kur dikush kapet për ballukesh, nuk ka mundësi të lëvizë dhe nuk ka mundësi tjetër përveçse të dorëzohet.

Por, gjithashtu fjala *"en nasijetu"* përdoret edhe për individë edhe për objekte sikurse edhe në gjuhën perse përdoret për "Fronti popullor" ose "Balli i ndërtesës".

Ndërsa interpretimi i ajetit *"Nasijetin kadhibetin khatietin" (Për ballukesh gënjeshtare, mëkatare)* flet për një person që është pronar i këtyre ballukeve, që ishte edhe gënjeshtar, edhe me gabime, sikurse ishte Ebu Xhehli.

Në një transmetim të Ibn Abasit, thuhet: "Një ditë, Ebu Xhehli erdhi pranë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti po falte namaz pranë mekamit të Ibrahimit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

- A nuk ta kam ndaluar këtë punë unë ty? - i thirri Ebu Xhehli.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i bërtiti dhe e largoi nga vetja.

[1] "Fi Dhilalul Kur'an", vëll. 8, f. 624.

- O Muhammed! Ti po me bërtet dhe po më largo mua. A nuk e di ti se të afërmit dhe fisi im në këtë tokë, është më i madhi?[1] - i tha Ebu Xhehli.

Këtu zbret ajeti: **"Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet.**[2] **Ne do t'i thërrasim Zebanijet** (rojet e Xhehennemit)**!"**. Lëre këtë injorant dhe mendjemadh të thërrasë të gjithë fisin dhe njerëzit e tij dhe të kërkojë ndihmë prej tyre.

Në këtë mënyrë, do të qartësohet se ky njeri pa informacion nuk mund të bëjë asgjë, ai do të jetë i varur nga rojet e dënimit, si dhe do të jetë i vendosur si kafshë në mesin e një tufani të tmerrshëm.

Fjala *"en nadijetu"* vjen nga rrënja *"nedaun"* dhe ka kuptimin e vendit ku *mblidhen populli*. Ndonjëherë, qendrës së argëtimit i thonë *"nadi"*, sepse atje njerëzit thërrasin njëri-tjetrin me zë të lartë.

Disa komentues janë të mendimit se fjala *"neda"* ka kuptimin e nderimit, sepse atje ata nderojnë dhe mirëpresin njëri-tjetrin.

Togfjalëshi *"darul neduetu"*, e njohur si vendi i *mbledhjeve dhe i konsultimit të kurejshitëve*, edhe në këtë rast, ka marrë të njëjtin kuptim.

Por në këtë rast, qëllimi i përdorimit të fjalës *"nadi"* është të tregojë popullatën e mbledhur në atë mbledhje.

---

[1]

[2] Pra, le të thërrasë në ndihmë prijësit e tjerë të Mekës, që ishin përkrahësit e tij.

Sipas një tjetër interpretimi, ka kuptimin: fis dhe farefis, miq e shokë, që Ebu Xhehli kishte rreth e rrotull vetes së tij, e mbështetej te ta.

Fjala *"ez zebanijetu"* është shumësi i fjalës *"zebenijetu"* që, në origjinë, ka kuptimin: *rojet*.

Vjen nga rrënja *"zeben"*, me kuptimin: *të varrosësh, të largosh*. Në këtë rast, ka kuptimin e dënimit, që engjëjt e dënimit janë rojet e Xhehennemit.

Në ajetin e fundit të sures, që është ajet sexhdeje, pra, pas leximit të tij të bëhet sexhde, All'llahu thotë: **"kel'la"***),* pra nuk është ashtu sikurse ai mendon, që këmbëngul, që ti të braktisësh sexhden, prandaj: **"Kurrsesi mos iu nënshtro atij** (o Muhammed)**, por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!"** Ebu Xhehli është më i vogël se sa mendojnë, që të bëhen pengesë e sexhdes, së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, apo të jenë pengesë e fesë tënde. Ti mbështetu te All'llahu, duke e adhuruar dhe duke bërë sexhde. Hidhi hapat në këtë rrugë dhe afrohu sa më shumë pranë Krijuesit tënd.

Gjithashtu, nga ky ajet, kuptohet më së miri se sexhdja është shkaku i afrimitetit të njeriut me Krijuesin. Ndaj dhe në një hadith të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Robërit janë më afër Zotit, kur janë në sexhde."*.[1]

Sipas transmetimeve të Ehli Bejtit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, janë katër sure në Kur'an, ku sexhdja është e detyruar: 1- ajeti 15 i

[1] "Biharul Enuar", vëll. 79, f. 161.

sures "Es Sexhde"; 2- ajeti 37 i sures "El Fussilet"; 3- ajeti 62 i sures "En Nexhm"; 4- ajeti 19 i sures "El Alak".

Sexhdet e tjera janë të pëlqyeshme.[1]

Hulumtim

Kalimi i cakut dhe ndjesia e vetëmjaftueshmërisë

Zakonisht, korrupsioni në këtë botë nis nga sëra e lartë, ose më mirë le të themi se burimi janë ata, ndaj ata gjithmonë janë kundërshtarët e parë të Profetëve. Edhe Kur'ani, në disa raste, ata i konsideron si *"el mel'u"*[2], *"el mutrefijn"*[3] , *"el mustekbirijn"*[4].

Në rastin e parë, flet për popullatën aristokrate, të ngritur, që, në pamje të jashtme, ta mbushin syrin, por brenda janë bosh.

[1] Të katër këto sure që cituam, nëse i lexojmë vetë apo i dëgjojmë nga të tjerët, është e detyrueshme të bëhet sexhde, sikurse biem në sexhde, kur falim namazin. Kryerja e sexhdes është e detyruar, ndërsa citimi i dhikrit është i pëlqyer. Zakonisht, në sexhden e detyruar thuhet ky dhikër: "La ilahe ilall'llahu hakkan hakkan, la ilahe ilall'llahu imanen ue tesdiken la ilahe ilall'llahu ubudijeten ue riken sexhedetu leke ja rabbi teabbuden ue riken la mustenkifen ue la mustekbiren, bel ena abdun daifun dhelilun khaifun mustexhijrun".

[2] Sure "El A'râf", ajeti 60; Sure "Sebe", ajeti 34; Sure "El Mu'minûn", ajeti 67.

[3] Sure "Sebe", ajeti 34,

[4] Sure "El Mu'minûn", ajeti 67.

Ndërsa në rastin e dytë, flitet për persona që gjithmonë kanë jetuar në rehati. Ata janë të dehur dhe mendjemëdhenj, nuk e kuptojnë hallin dhe dhimbjen e të tjerëve.

Pala e tretë janë ata njerëz që janë ulur mbi karriget e pushtetit dhe janë larg Zotit dhe krijesave.

Ndërkohë që ne e dimë se nga një fllad, kalendari i ditëve ndryshohet e bëhet rrëmujë. Nëse do të vinte ndonjë tufan apo tërmet, të gjitha mallrat dhe gjithçka që kanë ata, do të zhdukeshin në më pak se një orë, kështu ata do të shikonin vdekjen dhe se sa në rrezik janë.

Ç'është gjithë kjo pavëmendje që ka kapluar një grup njerëzish e që mendojnë se nuk kanë nevojë për gjë?! Ata duke qenë të ulur në karrigen e pushtetit, janë edhe mendjemëdhenj, edhe arrogantë. Popullin e kanë vendosur si skenë të tyren.

Kërkojmë strehim te ti o Zot, nga kjo padituri dhe nga kjo injorancë!

Për të larguar një gjendje të tillë, është e mjaftueshme që njeriu të vështrojë pak te vetja e tij e të shikojë se sa i dobët është, ndërsa pushteti dhe fuqia e All'llahut është e paimagjinueshme.

Nëse rikujtojmë pak historinë e të kaluarve, do të shikojmë se si kanë vepruar ata e se si u ka shkuar fati. Ka pasur prej tyre që janë treguar arrogantë, kanë menduar se janë të fortë, por u është ulur hunda dhe janë zbritur nga kolltuku i pushtetit dhe i arrogancës.

O All'llah! Na ruaj ne nga mendjemadhësia, që është shkaku i largimit nga Ti!

O All'llah! Mos na lër asnjë moment të vendosim vetë, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër!

O All'llah! Na jep forcë që planet e arrogantëve dhe mendjemëdhenjve të shkatërrohen dhe të shuhen!

Amin! Ja Rabbil Alemin.

Fundi i sures "El 'Alak".

Sure "El Kadr"

Zbritur në Mekë

Ajete 5

Përmbajtja e sures "El Kadr"

Përmbajtja e kësaj sureje, sikurse është qartësuar nga vetë emri i saj, flet dhe shpjegon zbritjen e Kur'anit të Shenjtë në Natën e Kadrit. Më pas shpjegon rëndësinë e Natës së Kadrit, mirësitë, bereqetet dhe ndikimet e saj.

Për sa i përket vendit të zbritjes së kësaj sureje, midis dijetarëve ka mendime të ndryshme. Disa janë të mendimit se kjo sure ka zbritur në Mekë, ndërsa të tjerë janë të mendimit se kjo sure ka zbritur në Medine.

Në transmetime është cituar se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shikon në ëndërr Beni Umeje, që ishin ulur në karrigen e fronit. Kjo gjë për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte shqetësuese, ndaj dhe All'llahu zbret ajetet e sures "El Kadr", për ta ngushëlluar Profetin Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Disa thanë se **"Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj."** ka zbritur për të treguar kohëzgjatjen e pushtetit të Beni Umajadëve, pushtet që zgjati njëmijë muaj.

Ne e dimë se xhamia dhe vendi që mbante fjalime Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte Medina dhe jo Meka.[1]

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 30, f. 188; Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 371.

Por ajo që është e njohur, sikurse edhe e thamë, surja është mekase dhe ky transmetim mund të tregojë një lloj krahasimi dhe jo shkakun e zbritjes.

Mirësitë e recitimit të sures "El Kadr"

Për të treguar mirësitë e leximit të kësaj sureje, është i mjaftueshëm të përmendim disa hadithe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Kushdo që e lexon këtë sure, ngjan me ata që agjërojnë në Muajin e Ramazanit dhe në Natën e Kadrit qëndrojnë zgjuar.*".[1]

Në një tjetër hadith, të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Ai që di suren 'Inna Enzelnahu' dhe e lexon atë me zë të lartë, qartë dhe në mënyrë të hapur, ngjan me atë person që ka ngritur shpatën në Rrugën e All'llahut dhe bën luftë të shenjtë. Ai që e lexon këtë sure fshehurazi, ka mirësi të shumta...*"

Është e qartë se këto mirësi nuk janë për ata që e lexojnë suren dhe nuk e kuptojnë të vërtetën e saj. Këto mirësi dhe bereqete janë për ata që e lexojnë dhe e kuptojnë suren. Gjithashtu, atë çka ata kuptojnë, e vënë në punë, Kur'anin e cilësojnë të madhërishëm dhe ajetet e tij i vënë në funksion përgjatë jetës së tyre.

[1] 1 dhe 2 – Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 516.

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ۝ لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ ۝ تَنَزَّلُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أَمْرٍ ۝ سَلَامٌ هِيَ حَتَّى مَطْلَعِ الْفَجْرِ﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"Ne e kemi zbritur (Kur'anin) **në Natën e Kadrit."**

"E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?"

"Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj."

"Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili)**, me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet."**

"Paqe është ajo deri në lindjen e agimit."

Komentimi

Nata e Kadrit, Nata e zbritjes së Kur'anit!

Nga vetë ajetet e Kur'anit kuptohet më së miri se Kur'ani i Shenjtë ka zbritur në Muajin e shenjtë të Ramazanit. **"Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur'ani..."**.[1]

Në ajetin e parë të sures "El Kadr" thuhet: **"Ne atë e zbritëm natën…"**. Edhe pse në ajet menjëherë citohet emri i Kur'anit, është e qartë, e kuptueshme që zanorja tek fjala **"Inna Enzelnahu"** kthehet dhe nënkupton Kur'anin.

Ajo çka është si paqartësi e jashtme, është për shkak të rëndësisë dhe shpjegimit të madhështisë së Kur'anit. Interpretimi i sures, me ajetin *"Ina enzelnahu"* **– "Ne e kemi zbritur"**, gjithashtu, flet për madhështinë e këtij Libri qiellor, libër që All'llahu, zbritjen e tij, e lidh me Vetveten.

Aty ku ka përdorur shumësin, All'llahu dëshiron të shprehë madhështinë e pafundme. Nata e Kadrit është nata kur përcaktohen ngjarjet e gjithë vitit, një tjetër arsye, se pse ky libër është i madhërishëm.

Nëse i krahasojmë këto ajete me ajetet e sures "El Bekare", marrim si përgjigje se nata e Kadrit është në Muajin e Ramazanit. Ndërsa për sa i përket faktit, se në cilën natë është përmendur në Kur'an, nuk mund të kuptojmë gjë. Transmetimet për këtë teme

[1] Sure "El Bekare", ajeti 185.

janë të shumta. Për këto transmetime dhe të tjera çështje, do të flasim në përfundim të tefsirit të kësaj sureje, në dashtë All'llahu.

Këtu lind pyetja: Si nga historia, si nga ana e lidhjes së tekstit të Kur'anit me ngjarjet e jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, bëhet e qartë se ky Libër qiellor, në mënyrë të vazhdueshme, përgjatë 23 viteve ka zbritur për të. Kjo gjë si mund të përputhet me ajetet e mësipërme, ku thuhet se Libri ka zbritur në Muajin e Ramazanit dhe në Natën e Kadrit?

Përgjigjja e kësaj pyetje, sikurse edhe thonë shumë studiues të shkencave kur'anore, është: Kur'ani ka dy zbritje. *Një zbritje të menjëhershme*. Quhet e menjëhershme, sepse ka zbritur në zemrën e pastër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* ose ka zbritur në (Bejtul Mamur), ose ka zbritur nga (Leuhul Mahfudh) në qiellin e dynjasë.

Ndërsa *zbritja e njëpasnjëshme* është përgjatë kohës së Profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e cila ka zgjatur njëzet e tre vjet.[1]

Të tjerë janë të mendimit se Shpallja e Kur'anit nisi në "Natën Kadrit" por jo i gjithë Kur'ani, por kjo gjë është në kundërshtim me pamjen e jashtme të ajetit që thotë: **"Ne e kemi zbritur** (Kur'anin) **në Natën e Kadrit."**.

Ajo që duhet të theksohet, për sa i përket çështjes së zbritjes së Kur'anit, në disa ajete, është interpretimi me fjalën *"inzalun"* dhe

[1] Komentimin e kësaj çështjeje e shikoni të plotë në vazhdim të ajetit 3 të sures "Ed Dukhân" në këtë komentim.

në disa interpretime të tjera, është fjala *"tenzijl"*. Duke iu referuar fjalorit, kuptohet se *"tenzijl"* zakonisht thuhet kur diçka zbret në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa fjala *"inzal"* ka kuptim më të gjerë, ku përfshihet edhe Shpallja e menjëhershme.[1]

Ky ndryshim interpretimi është se ajetet e mësipërme flasin për dy zbritjet e mësipërme.

Në ajetin tjetër, për të shpjeguar madhështinë e Natës së Kadrit, thotë: **"E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?"**.

Më pas thotë se Nata e Kadrit është nata më e mirë se sa njëmijë muaj: **"Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj."**.

Ky interpretim tregon se madhështia e kësaj nate është aq e madhe, saqë edhe vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me gjithë dijen e tij të gjerë, para se të zbriste ky ajet, nuk kishte dijeni për të. Ne e dimë se njëmijë muaj janë më shumë se tetëdhjetë vjet, në të vërtetë, çfarë nate është ajo që ka gjithë këtë madhështi. Madhështia e saj është aq e madhe, saqë bereqeti i saj është sa vlera e një jete.

Në disa komentime, tefsire është cituar se Profeti Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Një prej Beni Izraelitëve kishte veshur rrobat e luftës dhe nuk i kishte hequr ato për tetëdhjetë vjet. Ai vazhdimisht ishte gati për të luftuar në Rrugën e All'llahut. Shokët dhe miqtë u habitën, kur dëgjuan për këtë mirësi dhe shprehën dëshirën që këtë mirësi ta kishin edhe ata,*

[1] "Mufredat" i Ragibit, "Made Nuzul".

kështu që zbriti ajeti i mësipërm dhe shpjegoi se Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.”.[1]

Në një tjetër hadith, thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte folur për katër burra nga Beni Izrailët, të cilët kishin adhuruar All'llahun për tetëdhjetë vjet me radhë, pa bërë mëkate.

Shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shprehën dëshirën: “Oh, sa mirë do ishte që edhe ata të kishin këtë mundësi, për të adhuruar All'llahun!”.

Kështu që zbret ajeti i mësipërm për këtë fushë.[2]

Ka mendime të shumta, për sa i përket citimit të numrit (një mijë). Disa janë të mendimit se, në këtë rast, numri një mijë është cituar si një shumë. Të tjerë janë të mendimit se është cituar për “*tekthjir*” – “*shumim*”.

Ata që janë të mendimit se numri një mijë ka ardhur për të shprehur shumën, e argumentojnë se vlera e Natës së Kadrit është më e madhe se sa një mijë muaj, por transmetimet që cituam më lart, tregojnë se numri është përmendur.

Parimisht, numri gjithmonë përdoret për numërim, vetëm në rast se ka një shenjë të qartë, për ta marrë si shumë.

Më tej flet dhe këshillon për madhështinë e kësaj nate, duke thënë se engjëjt dhe shpirti, në atë natë, me lejen e All'llahut,

[1] Tefsiri “Durr'rrul Menthur”, vëll. 6, f. 371.
[2] Tefsiri “Durr'rrul Menthur”, vëll. 6, f. 371.

zbresin për të përcaktuar fatin e çdo gjëje: "Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.".

Fjala *"tenezzelu"* është folje në kohën e tashme dhe tregon vazhdimësi. Në origjinal, fjala ka qenë *"tetenezzelu"*. Jo vetëm kjo gjë, por edhe Kur'ani i Shenjtë, qartëson faktin se Nata e Kadrit nuk është vetëm për kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por deri në Ditën e Kiametit. Nata e Kadrit është natë që përsëritet vazhdimisht në të gjitha vitet.

Për sa i përket faktit se cili është qëllimi i përdorimit të fjalës "shpirti", disa dijetarë janë të mendimit se bëhet fjalë për Xhibrail Eminin. Është quajtur edhe "Ruhul Emin" – *"Shpirti i besuar"*.

Disa të tjerë, fjalën *"ruh"* e kanë komentuar *"el uahju"* – *"zbulesë"*, duke u mbështetur te shenja që na jep ajeti 52 i sures "Esh Shûra". *"Ue kedhalike euhejna ilejke ruhena minel emrina"* - "Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty Shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë.".

Kështu që kuptimi i ajetit është i tillë: Engjëjt, me urdhër të All'llahut, zbresin dhe sjellin Shpalljen Hyjnore në tokë, ku në atë natë përcaktohen fatet.

Në këtë rast, ekziston edhe një komentim i tretë, që është më i afërm se të gjitha komentimet e tjera: *"Ruh"* – *"shpirti"* është një krijesë e madhe, mbi të gjithë engjëjt, sikurse edhe e shohim në një prej haditheve të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Dikush pyeti Imam Sadikun: "A mos vallë, kur citohet fjala *"ruh"*, bëhet fjalë për Xhibrailin?'

– "Xhibraili është prej engjëjve dhe shpirti A'dham është prej engjëjve. A nuk thotë vetë All'llahu i Madhëruar: 'Zbresin engjëjt dhe Shpirti?'"[1] – iu përgjigj Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Këto të dyja, edhe pse kanë ngjashmëri, janë të ndryshme. Për fjalën *"ruh"* janë bërë komentime të tjera, të cilat nuk e pamë të nevojshme t'i citojmë këtu.

Ndërsa qëllimi i pjesës tjetër të ajetit: *"min kul'li emr"* **me të gjitha vendimet."**, ka të bëjë me engjëjt që zbresin për të sjellë çdo gjë që është shkruar për to, pra, për fatin e tyre. Ndaj dhe qëllimi i zbritjes së engjëjve është kryerja e këtyre punëve.

Ose që çdo punë të mirë dhe çdo fat të shkruar e sjellin me vete.

Studiues të tjerë janë të mendimit se qëllimi i përdorimit të fjalës është të tregojë se ata zbresin me urdhër të All'llahut. Shpjegimi i parë është më i përshtatshëm.

Interpretimi i fjalës *"rabbehum"*, ku dhe është mbështetur çështja e *"rebubijetit"* dhe e punëve që kryhen në këtë botë, ka ngjashmëri me punët e këtyre engjëjve. Ata zbresin për të sjellë atë çka është përcaktuar nga All'llahu për njerëzit dhe për gjithë botën. Puna e tyre është një pjesë e atributit të Zotit për të kontrolluar dhe furnizuar gjithësinë.

Më tej, në ajetin e fundit thuhet se Nata e Kadrit është nata e mbushur me paqe: **"Paqe është ajo deri në lindjen e agimit."**.

Në këtë natë ka zbritur Kur'ani. Adhurimi në këtë natë është i barabartë me një mijë muaj, mirësitë dhe bereqetet e All'llahut

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 481.

zbresin në këtë natë, mëshira e All'llahut përfshin të gjithë robtë. Engjëjt dhe shpirti zbresin në këtë natë.

Kështu që kjo natë, e gjitha, është e mbushur me mirësi, që nga fillimi i saj e deri në fund. Sipas disa transmetimeve, në këtë natë, shejtani është i lidhur në zinxhirë dhe, për këtë arsye, është një natë plotësisht e mbushur më paqe, mirësi e bereqet.

Ndaj dhe fjala *"selam"* – *"paqe"*, e cila ka kuptimin *shëndet*, në të vërtetë, është një lloj theksimi, e cila ka ardhur dhe është përdorur në vend të fjalës *"salem"* – *"shëndet"*.

Edhe ne, ndonjëherë themi se filani është vetë drejtësia. Komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"selam"*, në atë natë, është përdorur, sepse engjëjt i dërgojnë vazhdimisht selam njëri–tjetrit, ose besimtarëve, ose shkojnë pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe te mëkëmbësi i dëlirë e i përshëndesin me selam.

Përmbledhja e këtyre komentimeve është e mundur.

Megjithatë, ajo është një natë e mbushur me dritë dhe mëshirë. Mirësitë e kësaj natë përfshijnë gjithçka.

Kur është pyetur Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se, nëse e di cila është Nata e Kadrit, është përgjigjur: *"Si mos ta dimë? Atë natë, engjëjt na vijnë rrotull."*.[1]

Në historitë që flitet për Profetin Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, thuhet se disa engjëj erdhën pranë tij për të sjellë lajmin e lindjes së djalit, e përshëndetën atë me *selam*. "Të dërguarit Tanë, i

[1] Tefsiri "Burhan", vëll. 4, Hadithi 29, f. 488.

sollën Ibrahimit lajmin e mirë dhe i thanë: 'Paqe mbi ty!' Ai u përgjigj: 'Paqja qoftë mbi ju!"' Dhe me të shpejtë u solli atyre një viç të pjekur.".[1]

Profeti Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ndjeu një kënaqësi të paparë, saqë nuk e krahasonte atë selam më të gjithë botën. Tashmë duhet të mendojmë, kur engjëjt në Natën e Kadrit vijnë grupe-grupe dhe besimtarëve u thonë "selam", çfarë kënaqësie dhe mirësie kanë ata?!

Kur Profetin Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* e hodhën në zjarrin e Nemrudit, engjëjt erdhën pranë tij dhe e përshëndetën atë me "selam" dhe zjarri u bë fushë me lule për të. A mos edhe zjarri i Xhehennemit, në Natën e Kadrit, me bereqetin dhe mirësinë e selamit të engjëjve ndaj besimtarëve, do të jetë në paqe?

Po, kjo është shenjë prej shenjave të madhështisë së popullit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Atje, engjëjt zbrisnin për Profetin Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, këtu zbresin për popullin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[2]

[1] Sure "Hûd", ajeti 69.
[2] Tefsiri "Fakhri Razi", vëll. 32, f. 36.

Hulumtime

1- Çfarë ndodh në Natën e Kadrit?

Po përmendim disa fakte, se përse kjo natë është quajtur Nata e Kadrit.

Është quajtur "Nata e Kadrit", sepse në këtë natë, përcaktohet shumica e fateve të robëve, për gjatë gjithë vitit. Dëshminë e këtij shpjegimi dhe kuptimi e shikojmë në ajetet 3-4 të sures "Ed Dukhân": **"Ne e zbritëm Kur'anin në një natë të bekuar.**[1] **Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues. Në atë** (natë të zbritjes së Kur'anit) **vendoset çdo punë e urtë."**.

Ne këtë Libër të Shenjtë e kemi zbritur në një natë me plot mirësi, ku çdo punë është e sistemuar sipas drejtësisë së All'llahut. Ne gjithmonë jemi vëzhgues.

Për sa i përket shpjegimit të asaj çka është përcaktuar në Natën e Kadrit, janë transmetuar shumë hadithe, që thonë se në atë natë përcaktohen fatet e njerëzve për një vit, në atë natë përcaktohet risku, jetëgjatësia dhe shumë e shumë punë të tjera. Në atë natë shpjegohet Nata e bekuar.

Ajo çka përcaktohet në këtë natë, nuk ka asnjë kundërshtim me lirinë dhe vullnetin e njeriut, si dhe me çështjen e të qenit i lirë, sepse ajo çka përcaktohet nga All'llahu, nëpërmjet engjëjve, është e

[1] Në Natën e Kadrit.

bazuar mbi meritën e njerëzve, sipas besimit dhe devotshmërisë, si dhe pastërtisë së veprave të njerëzve.

Që do të thotë se për çdo njeri përcaktohet fati në bazë të meritës. Me fjalë të tjera, fusha është e përgatitur nga vetë njeriu, gjë që tregon se njeriu e ka lirinë e plotë për të zgjedhur. Kjo gjë nuk ka asnjë keqkuptim me lirinë që ka njeriu.

a- Komentues të tjerë janë të mendimit se Nata e Kadrit ka marrë këtë emër, sepse në të ka mirësi të madhe. E ngjashme me të është ajeti 74 i sures "Haxhxh": **"Ata nuk e njohën përcaktimin e All'llahut."**.

b- Të tjerë janë të mendimit se Kur'ani i është shpallur të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nëpërmjet engjëjve që mbartin përcaktimin.

c- Të tjerë janë të mendimit se është nata ku është përcaktuar të zbresë Kur'ani.

ç- Ai që e gdhin këtë natë, fiton pozitë të lartë.

d- Në atë natë zbresin aq shumë engjëj, saqë gjerësia e tokës ngushtohet, sepse fjala *"përcaktim"* është marrë edhe me kuptimin *"ngushtim"*: **Allahu nuk e ngarkon askënd mbi sa i ka dhënë**.[1]

Përmbledhja e të gjithë këtyre komentimeve, për sa i përket kuptimit të togfjalëshit *"Lejletul Kadr"* – *"Nata e Kadrit"*, është plotësisht e mundur. Komentimi i parë është më i përshtatshëm dhe më i njohur.

[1] Sure "Et Talâk", ajeti 7.

2- Cila natë prej netëve është Nata e Kadrit?

Nuk ka asnjë dyshim se Nata e Kadrit është në Muajin e Ramazanit, sepse të gjitha ajetet kur'anore e qartësojnë këtë fakt. Vetë Kur'ani thotë se zbritja e Kur'anit ka filluar në Muajin e Ramazanit: **"Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur'ani..."**.[1]

Por, për sa i përket faktit se në cilën natë prej netëve të Muajit të Ramazan është Nata e Kadrit, ka shumë diskutime midis dijetarëve. Disa janë të mendimit se është nata e shtatëmbëdhjetë, nata e nëntëmbëdhjetë, nata e njëzetenjëtë, nata e njëzetetretë, nata e njëzeteshtatë dhe nata e njëzetenëntë e Muajit të Ramazanit.

Por ajo çka është më e njohur në transmetime, është fakti se Nata e Kadrit është në dhjetëditëshin e fundit të Muajit të Ramazanit. Më tepër mendohet se është në natën e njëzet e një ose njëzet e tre. Ndaj, në transmetime lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjatë gjithë dhjetëditëshit të fundit të Muajit të Ramazanit, qëndronte zgjuar, duke adhuruar dhe duke i bërë ibadet All'llahut.

Në disa transmetime të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet se Nata e Kadrit është nata e njëzetenjëtë, ose e njëzetetretë. Kur transmetuesi ngul këmbë dhe pyet se në cilën prej këtyre netëve është Nata e Kadrit, nëse nuk mundem që të dy netët të qëndroj zgjuar për të bërë ibadet, Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë*

[1] Sure "El Bekare", ajeti 185.

mbi të!) nuk përcaktoi gjë dhe tha: "*Sa lehtë është (të qëndrosh zgjuar) për atë çka kërkon!*".[1]

Në transmetime të ndryshme që na janë sjellë nga Ehli Bejti *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, më tepër është vënë theksi te nata e njëzetetretë. Ndërkohë që në transmetimet e Ehli Synetit, më tepër i vihet theksi te nata e njëzeteshtatë.

Në një transmetim të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "Në natën e nëntëmbëdhjetë të Muajit të Ramazanit shkruhen fatet dhe në natën e njëzet e një përforcimi i tyre, ndërsa në natën e njëzetetretë firmosen ato.[2] Në këtë mënyrë transmetimet përmblidhen.

Por sidoqoftë , Nata e Kadrit ka mbërritur për shkak të disa mënyrave që do t'i citojmë më tej.

3- Përse Nata e Kadrit është e fshehtë?

Shumë studiues janë të mendimit se fshehtësia e Natës së Kadrit në mesin e netëve të vitit, ose në mesin e netëve të Muajit të shenjtë të Ramazanit është për shkak se njerëzit duhet t'i kushtojnë rëndësi kësaj nate. All'llahu i Madhëruar e ka mbajtur të fshehtë kënaqësinë e Tij midis llojeve të adhurimeve, në mënyrë që të gjithë njerëzit t'i kushtojnë rëndësi të gjithë llojeve të adhurimeve.

Po ashtu, zemërimin e Tij e mban të fshehtë, për shkak që të gjithë të ruhen dhe të largohen nga e keqja.

---

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 58, f. 625.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 62, f. 625.

Miqtë e Tij të dashur i mban të fshehtë, që t'i respektojnë të gjithë.

Pranimin e lutjeve e mban të fshehtë, që të gjithë të bëjnë lutje.

Emrin *"A'dham"* e mban të fshehur midis emrave të Tij, që ta adhurojnë të gjithë.

Edhe kohën e vdekjes e ka mbajtur të fshehtë, sepse dëshiron që të gjithë të jenë të gatshëm.

Kjo filozofi duket e arsyeshme.

4- A kanë pasur Natë Kadri popujt e mëparshëm?

Sipas ajeteve të kësaj sureje, është e dukshme se Nata e Kadrit, nuk është vetëm për periudhën e zbritjes së Kur'anit dhe epokës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por ajo është e përhershme, pra, është çdo vit, deri në përfundim të kësaj bote.

Folja *"tenez'zelul"* është në kohën e tashme dhe tregon vazhdimësi. Kjo gjë flet për një tjetër dëshmi të vazhdimësisë së Natës së Kadrit.

Edhe fjalia: **"Paqe është ajo deri në lindjen e agimit."** tregon vazhdimësinë e Natës së Kadrit. Sipas hadithit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, All'llahu, Natën e Kadrit e ka caktuar për popullin tim dhe

asnjë prej popujve të mëparshëm nuk e kanë pasur këtë privilegj.[1] Komentimi i ajeteve të mësipërme e vërteton këtë gjë.

5- Në ç'mënyrë Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj?

Mirësinë dhe të qenit natë e privilegjuar (Nata e Kadrit) është për shkak të vlerës së adhurimit dhe qëndrimit zgjuar në këtë natë.

Në librat e Ehli Bejtit dhe të Ehli Synetit lexojmë shumë transmetime për mirësinë e qëndrimit zgjuar dhe të adhurimit që bëhet në këtë natë. Këto vërtetojnë plotësisht kuptimin e Natës së Kadrit.

Përveç kësaj, zbritja e Kur'anit në këtë natë dhe zbritja e mirësive dhe e mëshirës së All'llahut, bëhet shkak që kjo natë të jetë më e mirë se sa një mijë muaj.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: Ali ibn Ebi Hamze Thumalit i kërkon Imam Sadikut se kur është Nata e Kadrit. Ai i thotë, që mirësinë e Natës së Kadrit ta kërkojë në natën e njëzetenjëtë dhe në natën e njëzetetretë. Në secilën prej këtyre dy netëve të falë njëqind rekate namaz. Nëse mundet, të qëndrojë zgjuar në të dy netët, si dhe marrë gusël.

- Nëse nuk mundem t'i fal të tëra këto namaze, duke qëndruar në këmbë, çfarë të bëj? – e pyet Ali ibn Ebi Hamze Thumali.

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 371.

- Fali ulur, përgjigjet Imam Sadiku

- Nëse nuk mundem ulur? - e pyet sërish Ali ibn Ebi Hamze Thumali.

- Fali shtrirë. Nuk ka asnjë problem, nëse fle në fillim të natës dhe pastaj nis adhurimin. Në Muajin e Ramazanit dyert janë të hapura, shejtani është i lidhur dhe veprat e besimtarëve janë të pranuara. Sa muaj i mirë është Muaji i Ramazan![1]

6- Përse Kur'ani ka zbritur në Natën e Kadrit?

Meqë në Natën e Kadrit shkruhen fatet e njerëzve për një vit me radhë, sipas veprave dhe punëve të mira, atëherë duhet të qëndrojmë zgjuar në atë natë. Duhet të jemi të vëmendshëm që vetveten ta mësojmë me vepra të mira, duhet t'i lutemi All'llahut që të na japë mundësi më të mira.

Po, kur e ardhmja jonë përcaktohet, nuk duhet të jemi në gjumë dhe të pavëmendshëm ndaj gjërave. Në këtë mënyrë do të kemi një fat të dhimbshëm.

Kur'ani, është një libër që ndërton fatet, rrjedhën e fateve, atëherë lumturia dhe udhëzimi i njerëzve është i qartësuar tek Zoti, ndaj dhe Kur'ani duhet të zbresë në një natë të tillë. Lidhja midis tyre (Natë së Kadrit dhe Kur'anit) është me plot kuptim.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn" , vëll. 5, Hadithi 58, f. 625.

7- A është Nata e Kadrit e njëjtë në të gjitha vendet?

Ne e dimë që fillimi i muajit hënor nuk është i njëjtë në të gjitha vendet, disa vende e nisin një ditë para muajin hënor e disa të tjerë një ditë më vonë. Ndaj dhe Nata e Kadrit nuk mund të jetë një natë e përcaktuar e një prej ditëve të muajit, sepse për shembull: nata e njëzetetretë në Mekë mund të jetë nata e njëzetedytë në Iran dhe në Irak. Ndaj për këtë arsye, secili vend duhet të ketë një Natë Kadri.

Por a është e njëjtë dhe e përshtatshme ajo që u tha me ajetet dhe transmetimet që cituam më lart?!

Përgjigjja: Kjo pyetje qartësohet, duke i kushtuar pak vëmendje kësaj çështje. Nata, është hija e pjesës tjetër të sipërfaqes së tokës, e cila bie në pjesën tjetër. Ne e dimë se hija e pjesës së tokës vjen në bazë të lëvizjes së tokës dhe një rrotullim i plotë i tokës kryhet pas njëzetekatër orësh. Ndaj ka mundësi që Nata e Kadrit të jetë një rrotullim i tërë rreth tokës, që do të thotë të jetë njëzetekatër orë të errësirës që ka mbuluar të gjitha pjesët e tokës, që fillimi i saj është diku dhe përfundimi diku tjetër.

O All'llah! Na jep dije dhe njohuri që të shijojmë mirësinë e Natës së Kadrit!

O All'llah! Sytë i kemi të drejtuara nga Ti! O All'llah i Madhëruar, na bëj prej shijuesve të asaj nate!

O All'llah! Mos na bëj prej atyre që nuk e shijojnë dhe nuk përfitojnë nga kjo natë! Ata nuk janë më lart, nëse nuk e kujtojnë!

Amin! Ja Rabbil Alemin!

Fundi i sures "El Kadr".

Sure "El Bejjine"

Zbritur në Medine

Ajete 8

Përmbajta e sures "El Bejjine"

Dihet se kjo sure ka zbritur në Medine, sepse edhe përmbajtja e saj tregon dhe dëshmon po këtë gjë, sepse në të flitet vazhdimisht për njerëzit e librit. Gjithashtu, dimë se myslimanët kanë pasur më shumë punë me njerëzit e librit në Medine.

Flitet për çështjen e namazit dhe të zekatit. Është e vërtetë që zekati është përhapur në Mekë, por zyrtarisht është zbatuar në Medine.

Sidoqoftë, kjo sure flet për profetësinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe tregon argumente e shenja të qarta për profetësinë, që ata më parë po e prisnin. Por kur erdhi dita e ardhjes së profetësisë, një grup, për shkak të interesave materiale dhe ekonomike, i bënë dredhi këtij fakti.

Bashkangjitur me këtë, kjo e vërtetë është e parë te të gjitha fetë e tjera, sepse parimi i ftesës së Profetëve është ftesa për besim, Njëshmëri, namaz dhe agjërim. Të gjitha këto janë parime të qëndrueshme dhe të përhershme në të gjitha fetë qiellore.

Në pjesën tjetër të kësaj sureje, flitet për çështje të ndryshme të besimtarëve të librit dhe të jobesimtarëve, çështje që qartësohen përballë Islamit.

Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, janë krijesat më të përzgjedhura dhe më të mira.

Ndërsa ata që përzgjodhën rrugën e kufrit, të shirkut e të mëkatit, konsiderohen si krijesat më të këqija.

Kjo sure, ka emra të ndryshëm, emra që janë përzgjedhur në përputhje më shkronjat e saj. Emrat më të njohur të sajë janë: Bejjinetu, Lem Jekun, si dhe Kijameh.

Mirësitë e leximit të sures "El Bejjine"

Në një transmetim të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për sa u përket mirësive të kësaj sureje, thuhet: "*Nëse njerëzit do ta dinin se sa mirësi dhe bekim ka recitimi i saj, do ta kishin braktisur familjen dhe mallrat e tyre dhe do t'i ishin kushtuar leximit të saj.*".

Një burrë nga fisi Khuzaetu tha: "O i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* çfarë mirësie ka leximi i saj?".

Profeti tha: "*Këtë sure nuk e reciton asnjë hipokrit dhe asnjë person që ka dyshim dhe frikë në zemrën e tij. Betohem në Zot, engjëjt e recitojnë atë që nga momenti që është krijuar toka dhe qiejt. Ata nuk përtojnë ta recitojnë. Çdokush që e reciton natën atë, All'llahu i vendos engjëjt roje, që ta mbrojë dhe ta ruajë fenë dhe këtë botë. Engjëjt kërkojnë falje e luten për ata që e lexojnë natën këtë sure. Nëse ata do ta lexojnë ditën, ata do të marrin mirësinë që përmbledh dita që ndriçon, si dhe nata.*".[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 521.

Ajetet 1 - 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ مُنْفَكِّينَ حَتَّى تَأْتِيَهُمُ الْبَيِّنَةُ، رَسُولٌ مِنَ اللَّهِ يَتْلُو صُحُفًا مُطَهَّرَةً، فِيهَا كُتُبٌ قَيِّمَةٌ، وَمَا تَفَرَّقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمُ الْبَيِّنَةُ، وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre)**, derisa t'u vinte Dëshmia e qartë:"**

"Një i Dërguar nga All'llahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra (Kur'anin)**,"**

"Të cilat përmbanin rregulla të drejta."

"Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë."

"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin All'llahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit)**, si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë."**

Komentimi

Kjo është feja e pastër

Në fillim të sures, flitet për gjendjen e ithtarëve të Librit (Jehudët dhe Nesari), si dhe për idhujtarët arabë para Islamit. Kur'ani thotë se ata besonin dhe pretendonin se nuk do të hiqnin dorë nga feja e tyre, derisa t'u vinte dëshmia: **"Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin** (nga mosbesimi i tyre)**, derisa t'u vinte Dëshmia e qartë."**.

Po cila është kjo dëshmi që ata prisnin t'u vinte?: **"Një i Dërguar nga All'llahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra** (Kur'anin)**."** Këto faqe të përmbanin rregulla të drejta dhe me vlerë: **"Të cilat përmbanin rregulla të drejta."**.

Po, është e vërtetë se ata, para se të vinte Profeti ynë, kishin këto pretendime, por, kur shfaqet Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe libri i tij qiellor, skena u ndryshua. Ata kundërshtuan fenë e All'llahut. Ithtarët e Librit nuk kundërshtuan, përveçse kur atyre u sollën argumente të qarta dhe Profet të drejtë e të vërtetë: **"Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë."**.

Në këtë mënyrë dhe sipas këtij rendi, ajetet e mësipërme shfaqin pretendimin dhe besimin e ithtarëve të Librit dhe të idhujtarëve, të cilët në fillim këmbëngulnin, se, nëse do t'u vinte argumenti i qartë dhe Profeti do të kishte argumente të qarta, do ta pranonin ftesën e tij.

Por, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vjen, ky premtim i gjeti ata të papërgatitur. Ata kundërshtuan, përveç një grupi që përzgjodhi rrugën e besimit.

Ajeti i mësipërm është i ngjashëm me ajetin 89 të sures "El Bekare": **"Dhe, kur një Libër që vërtetonte Shkrimet e tyre, u erdhi atyre nga All'llahu, ndonëse përpara luteshin për ndihmë kundër jobesimtarëve, pra, kur u erdhi ajo që e dinin se është e vërtetë, ata e mohuan atë![1] Prandaj mallkimi i All'llahut qoftë mbi mohuesit!"**

Ne e dimë se jo vetëm ithtarët e Librit i kishin të tilla pretendime, por edhe jobesimtarët arabë, që i konsideronin ithtarët e Librit si më të mençur dhe më të ditur, i ndiqnin ato. Por, kur erdhi dita dhe dëshira e tyre u realizua, ata ndërruan rrugë, shkuan nga rruga e kundërshtimit.

Një grup komentuesish, kanë një tjetër besim, për sa i përket komentimit të këtyre ajeteve. Komentuesit thonë se ata nuk hiqnin dorë nga feja e tyre, si dhe nuk ndaheshin nga ajo fe, derisa për ta të vinte një argument i qartë.

Por, kur argumenti dhe Profeti erdhi, ata besuan. Ajetet e mëposhtme tregojnë se nuk është ashtu, ata nuk besuan, përveç një

[1] Sipas Ibn Abasit, para ardhjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, hebrenjtë e Medines i kërkonin All'llahut t'u dërgonte një Profet, për t'i ndihmuar kundër fiseve arabe të Medines, Eus dhe Khazrexh. Por, kur All'llahu e zgjodhi Profetin nga radhët e arabëve, ata nuk e pranuan atë.

grupi prej tyre. Pra, nëse qëllimi është për një grup prej tyre, atëherë bëhet fjalë për imanin e atij grupi, edhe pse janë pakicë.

Ky komentim duket shumë i largët, ndoshta për këtë shkak edhe Fakhru Rrazij, në tefsirin e tij, kur arrin te ky ajet, e konsideron si ajetin më të ndërlidhur dhe më të vështirë të Kur'anit për ta komentuar, sepse del në kundërshtim me ajetet e mëpasshme. Ai, për të zgjidhur problemin, nuk citon asgjë, duke thënë se komentimi më i mirë është ai që u tha më lart.

Këtu ekziston edhe një komentim i tretë. Thuhet se idhujtarët dhe ithtarët e Librit nuk i braktis në gjendjen e tyre, pra, nuk i lë ashtu si janë, por atyre u Shpallet argumenti, u tregohet Rruga e Drejtë, ndaj dhe është dërguar Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për t'i udhëzuar ata.

Ky ajet citon "rregullin e mirësisë", që bëhet në "shkencën e Kelamit", që All'llahu për çdo popull do të sjellë argumentin e qartë për të përfunduar misionin.

Ndërkohë që, qëllimi i fjalës *"bejjine"*, në këtë rast, është i qartë, sepse ajeti ka për qëllim të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili ishte duke recituar Kur'anin.

Fjala *"suhuf"* është shumësi i fjalës *"sahijfetun"*, që ka kuptimin: *të shkruash mbi letër*. Ndaj, dhe në këtë rast, qëllimi është për përmbajtjen e letrave, sepse ne e dimë që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka lexuar kurrë gjë mbi letra.

Fjala *"mutahharatun"* ka kuptimin: *e pastër apo të qenit e pastër, prej çdo shirku, gënjeshtre, pavlefshmërie, si dhe e pastër me kuptimin e pastër edhe prej shejtanit dhe xhinve dhe njerëzve për të mos pasur mundësi të fusin hundët në të.*

All'llahu, në ajetin 42 të sures "Fussilet", thotë: **"Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtra nga asnjëra anë..."**.

Fjalia: **"Të cilat përmbanin rregulla të drejta."**, tregon faktin se në këtë faqe qiellore nuk ka asnjë çështje të shkruar keq apo të jetë gënjeshtër.

Prandaj fjala *"kutub"* ka kuptimin *"mektubat"* – *"të shkruara"*, ose ka kuptimin: ligje dhe rregulla që janë përcaktuar nga ana e All'llahut.

Fjala *"el kutub"* ka edhe kuptimin: *përcaktim ligji*, sikurse edhe thuhet: **"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat."**.[1]

Kështu në këtë mënyrë, edhe fjala *"kajjimetun"* ka kuptimin: *e drejtë, e fortë, e qëndrueshme, e vlefshme*. Të gjitha këto kuptime që u thanë, e përmbledhin atë, pra, kuptimin e saj.

Është edhe një koment tjetër. Librat e mëparshëm janë cenuar, pra, është vënë dorë mbi ta dhe kanë ndryshuar kuptimin, ndaj është thënë se ky Libër (Kur'ani) është i vlefshëm.

Duhet të kihet kujdes se në ajetin e parë, ithtarët e Librit janë parësorë ndaj mushrikëve. Në ajetin e katërt flitet vetëm për

[1] Sure "El Bekare", ajeti 183.

ithtarët e Librit dhe për jobesimtarët mushrikë nuk thuhet gjë, ndërkohë që ajeti i përfshin të dy grupet.

Ky lloj interpretimi ndoshta është për faktin se ithtarët e Librit, në këto programe, ishin më kryesorët, ndërsa mushrikët i ndiqnin ata, silleshin si ata. Ithtarët e Librit ishin më fetarë, sepse kishin dijetarë të ndryshëm, ndaj dhe për këtë shkak janë në pozitë dhe gradë më të lartë se jobesimtarët mushrikë. Ndaj dhe kundërshtimi i tyre ishte i shëmtuar dhe, në vetvete, përmbante kritikë.

Më tej ishin ithtarët e Librit dhe pas tyre mushrikët ata që u kritikuan dhe u qortuan, duke u kërkuar llogari, se përse e kundërshtuan këtë fe të re. Disa u bënë besimtarë e disa u bënë qafirë, ndërkohë që në këtë fe atyre nuk u është dhënë asnjë urdhër, përveçse të adhurojnë All'llahun, të ndajnë adhurimin dhe adhurimin karshi All'llahut ta kenë të pastër. Të rrinë larg çdo lloj shirku, le t'i afrohen Njëshmërisë së All'llahut, le të falin namazin dhe le të japin zekatin: **"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin All'llahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër** (të Ibrahimit)**, si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë."**.

Më pas shton se kjo fe është fe e drejtë dhe e qëndrueshme.

Disa komentues, fjalën **"ue ma umiru" (E megjithatë, ata qenë urdhëruar)** e kanë komentuar kështu: kjo fjalë tregon për Ithtarët e Librit. Në fenë e tyre ekzistonte çështja e Njëshmërisë, e namazit dhe e zekatit. Këto çështje ishin të qëndrueshme, por ata nuk qëndruan besnikë ndaj këtij urdhri.

Një tjetër çështje që trajtohet në fenë islame, është fakti se edhe në Islam nuk kanë ardhur rregulla të tjera përveç Teuhidit të pastër, namazit dhe zekatit, si dhe të ngjashme me këtë. Këto janë çështje të njohura. Ata nuk i pranojnë dhe në pranimin e tyre ata kanë kundërshtime.

Kuptimi i dytë është më i afërm, sepse, nëse ndjekim ajetin e mëparshëm, shohim se kundërshtimi i tyre është në pranimin e fesë së re. Ndaj është më e përshtatshme që fjala "*umiru*" tregon për fenë e re.

Nëse i kalojmë të gjitha këto, kuptimi i parë është i drejtë për ithtarët e Librit, ndërsa idhujtarët nuk i përfshin, ndërkohë që kuptimi i dytë i përfshin të gjithë.

Disa komentues besojnë se fjala *"ed dijnu"* në këtë rast, ka kuptimin: *ibadet, adhurim*. Fjalia: "**vetëm që të adhuronin Allahun"**, e cituar më parë, e vërteton po këtë kuptim.

Ekziston edhe një tjetër mundësi. Ajeti të aludojë për një pjesë të fesë dhe Sheriatit, që do të thotë se ata ishin dërguar dhe kishin vendosur të adhuronin Zotin, të zbatonin rregullat e fesë së tyre me gjithçka përmbajnë ato. Ky kuptim është më i përshtatshëm me fjalën "*din*".

Fjalia: *"ue dhalike dinjul kajjimetu"*, në këtë rast, fjalën *"ed dijn"* e trajton në një kuptim më të gjerë. Ky kuptim është më i vërtetuar.

Fjala *"hunefa"* është shumësi i fjalës *"hanijfun"*, e cila vjen nga rrënja e fjalës *"hanefe"* dhe sipas Ragibit, në fjalorin

"Mufredat", ka kuptimin: të përzgjedhësh Rrugën e Drejtë, pasi më parë kanë qenë në të gabuar.

Edhe arabët, personat që kryenin Haxhin apo bëheshin synet, i quanin "*hanif*". Kjo gjë ishte për shkak se ata ishin në fenë e Profetit Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, *uhnef* quhej ai person që ka këmbën të shtrembër. Në të gjithë librat e ndryshëm të fjalorëve shikohet se kjo fjalë, në origjinal, është përdorur me kuptimin: *i shthurur, në rrugë të gabuar*. Por në Kur'an dhe në hadithe, ka kuptimin: *i dalë nga shirku, që merr Rrugën e Drejtë kah Teuhidi, i udhëzuar*.

Përzgjedhja e këtij interpretimi, në origjinë, mund të ketë pasur kuptimin: i dalë nga rruga, sepse popujt idhujtarë e kanë përdorur këtë për ata idhujtarë që kanë lënë idhujt dhe janë drejtuar drejt Teuhidit. Prandaj dhe për popullatën islame, ky interpretim dalëngadalë ka zënë vendin e udhëzimit në Rrugë të Drejtë. Kuptimi më i drejtë është Teuhidi i pastër, Njëshmëria e All'llahut, si dhe largimi prej çdo lloj ekstremizmi. Por nuk duhet të harrojmë se këto janë kuptimet dytësore të kësaj fjale.

Fjalia: "*dhalike dinjul kajjimetu*", kumton se këto parime, pra, Teuhidi i pastër, namazi (vëmendje ndaj Krijuesit), zekati (vëmendje ndaj krijesave) janë ndër parimet e qëndrueshme dhe të përhershme të të gjitha feve. Por mund të themi se këto janë të ngulitura në vetë natyrën e njeriut, sepse, nga një anë, natyra e njeriut është e tillë, që të çon drejt çështjes së Teuhidit. Natyra e njeriut e fton atë që të falënderojë dhe fton që ta njohë Krijuesin.

Nga ana tjetër, shpirti i njeriut dëshiron të ndihmojë njerëzit në nevojë. Prandaj rrënjët e këtyre urdhrave janë të ngulitura në

zemrën dhe shpirtin e njeriut. Këto rregulla janë të vendosura jo vetëm në tekstet e mësimeve të të gjithë Profetëve të mëparshëm, por edhe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ajetet 6 – 8

﴿إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أُولَئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ۝٦ إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّةِ۝٧ جَزَاؤُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ۝٨﴾

"Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehennemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija."

"Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira."

"Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. All'llahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet."

Komentimi

Krijesa më e mirë dhe krijesa më e keqe

Në ajetet e mësipërme thuhet se qafirët, ithtarët e Librit dhe mushrikët ishin në pritje të një argumenti nga ana e All'llahut, por në momentin që argumenti u vjen, ata shpërndahen, kundërshtojnë dhe secili merr rrugën e tij.

Ajetet për të cilat folëm, janë të ndarë në dy grupe, *"qafirë"* – *"jobesimtarë"*, *"mu'minan"* – *"besimtarë"*. Përballë tyre qëndron ftesa hyjnore. Si përfundim, flitet për punën e secilit prej tyre.

Në ajetin 6 thuhet: **"Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehennemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija."**.

Ata që nuk besuan në këtë fe të re, si nga ithtarët e Librit, si nga idhujtarët, do të digjen në zjarrin e Xhehennemit. Aty do të jenë përjetësisht. Ato janë krijesat më të liga e më të këqija.

Fjala *"keferu"* tregon për kufrin e tyre, mosbesimin ndaj fesë islame, sepse kufri, mosbesimi dhe shirku për ta nuk ishte gjë e re. "Ata janë krijesat më të këqija." Sa interpretim tronditës, që tregon se midis të gjithë krijesave nuk gjendet kush që t'i jetë treguar e vërteta e më pas ta braktisë atë. Këto krijesa janë të ngjashme me përshkrimin që bëhet në ajetin 22 të sures "El Enfal": "Krijesat më të këqija para All'llahut janë ato që janë shurdhë dhe memecë (ndaj së vërtetës) e që nuk hanë arsye.".

Ose ajo çka ka ardhur në ajetin 179, të sures "El A'râf", ku, pasi flet për grupin që do shkojnë në zjarr, me po këto cilësi, thotë: **"Ne kemi paracaktuar për Xhehennemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit."**.

A mos vallë ajeti që ne po diskutojmë, ka më tepër diskutim se sa thamë, sepse ata i ka konsideruar si krijesat më të liga ndër gjithë krijesat dhe, në të vërtetë, kjo është një arsyeje për hyrjen e tyre në Xhehennem?

Pse të mos jenë ata krijesat më të liga ndaj gjithë krijesave? Atyre u ishin hapur të gjithë dyert e mirësive, por ata, nga mendjemadhësia, arroganca, kokëfortësia, kundërshtuan në mënyrë të hapur.

Ithtarët e Librit janë cituar të parët në ajet, për shkak të përparësisë që kishin ndaj idhujtarëve. Ata kishin libra qiellorë, dijetarë dhe studiues fetarë, si dhe shenjat e Profetit Islam, që i kishin në librat e tyre qiellor, ndaj edhe kundërshtimi i tyre ishte më i keqi dhe më i shëmtuari.

Ajeti tjetër, flet për grupin e dytë, të cilët janë e kundërta e tyre. Ky grup është ngritur shumë lart, ata janë personat që kanë besuar dhe kanë kryer vepra të mira, janë krijesat më të mira të All'llahut: **"Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira."**.

Më tej, shpërblimi i tyre citohet në disa fjali të shkurtra. Shpërblimi i tyre është pranë Krijuesit të tyre, në Xhennet, aty janë përjetësisht, aty rrjedhin lumenj, poshtë pemëve. Edhe Zoti është i

kënaqur me ta, edhe ata janë të kënaqur me All'llahun. Kjo pozitë dhe ky shpërblim është për ata që i frikësohen Krijuesit të tyre: **"Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. All'llahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet."**

Duhet të kihet parasysh, se fryti i pemës së besimtarëve, është kryerja e veprave të mira, përveç besimit. Nuk është e mjaftueshme të pretendosh se ke besim, por veprat e njeriut duhet të jenë dëshmi e besimit. Kurse idhujtaria, edhe nëse nuk është e përzier me vepra jo të mira, përsëri është shkak i rënies dhe i fatkeqësisë, sepse, zakonisht, idhujtaria është zanafilla e llojeve të mëkatit dhe e veprave të liga.

Fjalia: "**pikërisht ata janë krijesat më të mira."**, tregon më së miri se njerëzit besimtarë dhe punëmirë janë më të mirë se sa engjëjt. Ajeti është absolut dhe nuk veçon asnjë. Po ashtu edhe ajete të tjera të Kur'anit, sikurse janë ajetet e rënies në sexhde të engjëjve ndaj Ademit dhe ajeti 70 i sures "El Isra", thotë: **"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar."**.

Sigurisht që në këtë ajet, flitet për shpërblimin material dhe atë fizik. Kur flitet për kopshtet e Xhennetit, të cilat janë të mbushura me mirësi, shprehen shpërblimet materiale, vetjake, e shpirtërore. Këto janë shpërblime dhe vepra, që edhe All'llahu është i kënaqur prej tyre, edhe ata janë të kënaqur prej All'llahut: **"Ata janë të kënaqur nga All'llahu",** sepse çfarë deshën ata,

All'llahu ua jep. Gjithashtu, edhe All'llahu është i kënaqur prej tyre, sepse çfarë All'llahu kërkoi, ata e vepruan. Edhe nëse ka pasur ndonjë lëkundje, ata janë falur me mëshirën e Tij. A duhet kënaqësi më të madhe se sa kjo, se sa kënaqësia që Zoti ka për veprat që ai kryen?!

Sigurisht që "Xhenneti material" i njeriut është i përhershëm, sepse kopshtet janë të përhershme në atë botë, ndërsa "Xhenneti shpirtëror" është kur All'llahu është i kënaqur me veprat e robëve të Tij.

Fjalia: *Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet*. , tregon se të gjitha këto mirësi, e kanë burimin nga frika për All'llahun, sepse kjo frikë, është shkak për të lëvizur drejt çdo bindje dhe devotshmërie, si dhe veprave të mira.Disa komentues janë të mendimit se, nëse i citojmë këto ajete me ajetin 28 të sures "El Fatir", që thotë se vetëm të diturit tremben nga Zoti, atëherë ne marrim këtë përfundim, që Xhenneti është e drejtë e dijetarëve, e studiuesve dhe e atyre që kanë njohuri.

"Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë lloje të ndryshme. Në të vërtetë, nga robtë e Tij, All'llahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) All'llahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës."

Nëse shikojmë me vëmendje, fjala *"el khashijetu"* ka shkallë, edhe dija e njohuria ka shkallët e saj.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit, se fjala *"el khashijetu"* është pozitë më e lartë se sa pozita e frikës, por, gjithsesi, të dy fjalët kanë kuptimin e frikës, ndërkohë që fjala *"el khashijetu"* ka edhe kuptimin: frikë e përmbledhur me respekt.

Hulumtime

Aliu dhe pasuesit e tij janë krijesat më të mira

Në transmetime të shumta, që janë marrë si nga burimet e njohura të Ehli Synetit, ashtu edhe nga burimet e njohura të Ehli Bejtit, është transmetuar se ajeti: **"Ata janë krijesat më të mira të All'llahut"**, është komentuar për Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe ndjekësit e tij.

Hakem Haskanij Nishaburij, një nga dijetarët e njohur të Ehli Synetit, i shekullit të pestë Hixhri, në librin e tij të njohur "Sheuahidul Tanzijl", ka transmetuar këtë transmetim, me dokumentacion të ndryshëm, numri i tyre është më shumë se njëzet. Ne do të sjellim disa prej transmetimeve.

1- Ibn Abasi thotë: "Kur zbriti ajeti: **"Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira."**, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"Ky ajet ka për qëllim ty dhe shi'iat e tu. Në Ditën e Kiametit, ti do të jesh i kënaqur nga Zoti, edhe Zoti do të jetë i kënaqur nga ti; armiku, i inatosur, në Ditën e Gjykimit, do të hyjë me forcë në Xhehennem."* (Në disa libra të tjerë hadithesh është përdorur fjala *"mukmehin"* e cila ka kuptimin: *të vendosësh lart, ose të mbash kokën lart nëpërmjet zinxhirëve*).[1]

2- Në një hadith nga Ebu Berzetu transmetohet se, kur Profeti i Nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

[1] "Sheuahid Tenzijl", vëll. 2, Hadithi 1126, f. 357.

familjen e tij!) e lexoi këtë ajet, tha: *"Ato, janë shi'iat dhe ti, o Ali! Si dhe premtimi im dhe i yti është pranë burimit të Keutherit."*.[1]

3- Në një tjetër hadith të Xhabir ibn Abdull'llah Ensarit, thuhet: "Ne ishim pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ishim ulur pranë shtëpisë së All'llahut. Në atë kohë, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* erdhi drejt nesh. Kur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e hodhi vështrimin tek Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, tha: *'Vëllai im, po vjen drejt jush.'*.

Më pas, duke u kthyer nga Qabja, shtoi: *'Betohem për këtë Qabe, se ky burrë dhe shi'iat e tij do të jenë të shpëtuar në Kiamet.'*.

Më pas, u drejtua nga ne dhe shtoi: *'Për Zotin! Ai besoi para jush dhe kryengritja e tij me urdhër të Zotit, është më shumë se sa ju të gjithë. Besnikëria e tij ndaj All'llahut është më e madhe se sa ju të gjithë; gjykimi i tij me urdhër të All'llahut është më i madh; përkujdesja e tij në ndarjen e (bejtul mal) mallit është më e madhe se sa ju të gjithë; drejtësia e tij është më e madhe se sa ju të gjithë. Edhe pozita e tij tek All'llahu është më e lartë se sa ju të gjithë.'*.

Xhabiri tha: 'Në këtë rast, All'llahu zbriti ajetin.'.

Që nga ai çast e më tej, kur Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* vinte, shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thoshin: 'Erdhi krijesa më e mirë, pas të Dërguarit të All'llahut.'".[2]

[1] "Sheuahid Tenzijl", vëll. 2, Hadithi 1130, f. 359.
[2] "Sheuahid Tenzijl", vëll. 2, Hadithi 1139, f. 362.

Zbritja e këtij ajeti pranë shtëpisë së All'llahut nuk ka asnjë kundërshtim apo keqkuptim me të qenit sure medinase. Mund të jetë prej ajeteve që i ka zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në rrugëtimet që bënte nga Medina në Mekë.

Gjithashtu, transmetuesi i hadithit është Xhabir bin Abdullah Ensari, i cili i është bashkuar Profetit, në Medine. Konsiderimi i këtyre ajeteve si medinase nuk është gjë e pamundur.

Disa nga këto hadithe i ka sjellë Ibn Haxheri, në librin "Seuaik" dhe disa i ka sjellë Muhammed Sheblenxhij, në librin "Nurul Ebsar".[1]

Xhelaludin Sujutij, në librin "Durr'rrul Menthur", ka transmetuar dhe ka marrë një pjesë të shumtë të transmetimeve të fundit nga "Ibn Asakir" dhe "Xhabir ibn Abdullahi".[2]

4- Në veprën "Durr'rrul Menthur" është transmetuar nga Ibn Abasi: "Kur zbriti ajeti: "Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira.", Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *'Ajeti ka për qëllim ty dhe shi'iat e tu, që në Ditën e Kiametit, edhe All'llahu do të jetë i kënaqur me ty, edhe ti do të jesh i kënaqur me All'llahun.'"*.[3]

5- Ibn Merdvije transmeton nga Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë*

[1] "Es Seuaikul Muhrakatu", f. 96; "Nurul Ebsar", f. 70 dhe 101.
[2] "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 379.
[3] "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 379.

mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"A nuk e ke dëgjuar këtë fjalë të All'llahut: 'Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, janë krijesat më të mira'? Në këtë ajet flitet për ty dhe ndjekësit e tu. Ju jeni këto krijesa të mira. Ky është premtimi im dhe i yti, pranë burimit të Keutherit. Në kohën që unë do të vij për dhënien e llogarisë së ymetit, ti do të ftohesh. Balli yt do të jetë i bardhë dhe ti do të njihesh midis të gjithëve."*.[1]

Të tjerë dijetarë dhe studiues të Ehli Synetit kanë cituar po këtë kuptim në librat e tyre. Midis të tjerëve përmendim: *"El Khatijb El Khauarizmi"* në *"Menakib"*, *"Abu Naijm Esfahanij"* në *"Kefajetul Khisam"*, *"Al'lame Tabarij"* në tefsirin e njohur, *"Ibn Sabbag El Malikij"* në *"Fusulul Muhimeti"*, *"Al'lame Sheukanij"* në *"Fet'hul Gadijr"*, *"Sheik Sulejman Kunduzij"* në *"Jenabiul Muddeti"* dhe *"Alusij"* në tefsirin *"Ruhul Meanij"*.

Me pak fjalë, hadithi i mësipërm është një ndër hadithet e njohur dhe të pranuar nga një sërë dijetarësh islamë. Kjo është një mirësi e madhe dhe e pakundërshtueshme për Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe ndjekësit e tij.

Gjithashtu, nga ky transmetim kuptohet më së miri e vërteta se fjala *"shiatu"* është që nga koha e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo fjalë është përhapur midis myslimanëve nëpërmjet tij. Flet për ndjekësit e veçantë të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ata që thonë se fjala *"shi'iah"* është ndër fjalët e cituara shekuj më vonë, mendojnë gabim.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 35, Hadithi 17, f. 344; "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 379 (me pak ndryshim).

Nga ajetet e kësaj sureje kuptojmë më së miri se asnjë krijesë në këtë botë nuk e ka largësinë e ngjitjes lart dhe të zbritjes sikurse e ka njeriu. Nëse një njeri ka besim dhe kryen vepra të mira (duke pasur parasysh se fjala "a'milu salihat" përfshin të gjithë punët e mira dhe jo një pjesë të punëve të mira), ai njeri do të jetë krijesa më e mirë e All'llahut. Nëse ai njeri do të përzgjedhë rrugën e kufrit dhe do të jetë kryeneç e arrogant, atëherë ai njeri do të bjerë aq poshtë, saqë do të njihet tek All'llahu si krijesa më e ligë.

Kjo largësi e madhe e njeriut midis "lartësisë" dhe "zbritjes", edhe pse është një çështje e ndjeshme dhe e rrezikshme, tregon dhe vërteton madhështinë dhe pozitën e re të njeriut, si dhe aftësinë për të pasur e për të qenë i përsosur. Është e natyrshme se pranë një aftësie të tillë, të jashtëzakonshme, njeriu ka edhe mundësinë e zbritjes poshtë dhe zbritja e rënia e tij mund të jetë e jashtëzakonshme.

O All'llah! Kërkojmë ndihmën dhe mirësinë Tënde, që të arrijmë të jemi prej njerëzve të mirë!

O All'llah! Na bëj ne prej ndjekësve dhe shi'iave të atij burri të madh, i cili është më favoriti për këtë titull.

O All'llah! Na bëj të sinqertë, që të mos adhurojmë kënd përveç Teje dhe të mos duam (mos të vëmë të tjerë mbi Ty) askënd tjetër para Teje.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Bejjine".

Sure "Ez Zelzele"

Zbritur në Mekë

Ajete 8

Përmbajtja e sures "Ez Zelzele"

Midis dijetarëve ka mendime të ndryshme se ku ka zbritur kjo sure. Disa janë të mendimit se kjo sure është mekase, kurse disa të tjerë janë të mendimit se kjo sure është medinase.

Shumë dijetarë, këtë sure, e konsiderojnë dhe e njohin si medinase, ndërkohë që disa prej tyre besojnë se kjo sure ka zbritur në Mekë.

Ajetet e saj flasin për Ringjalljen dhe shenjat e ardhjes së Ringjalljes. Ajo është më tepër e ngjashme me ajetet mekase, por në hadith thuhet se, kur kjo sure zbriti, "Abu Said El Khuderij" e pyet Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për ajetin: **"kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë..."** Ne e dimë se Abu Seid Khedri i është bashkangjitur myslimanëve në Medine.[1] Origjina e kësaj sureje, nëse është mekase apo medinase, nuk ndikon në komentimin e saj.

Kjo sure është e ndarë në tri boshte kryesore:

Boshti i parë i sures flet për ngjarjen e Ringjalljes dhe shenjat e Kiametit.

Boshti i dytë flet më tej për dëshminë e tokës ndaj të gjithë veprave të kryera nga njeriu.

Në **boshtin e tretë** flitet për ndarjen e njerëzve në dy grupe, punëmirët dhe punëligët. Gjithashtu, flitet edhe për arritjen e çdo njërit grup, sipas veprave të kryera.

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 30, f. 208.

Mirësitë e leximit të sures "Ez Zelzele"

Mirësitë e leximit të sures janë cituar në transmetimet e ndryshme islame. Ndër to mund të citojmë një nga hadithet e Profetit Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Kushdo që e lexon këtë sure, ka mirësinë sikur të ketë lexuar suren 'El Bekare'. Shpërblimi i tij është sikur të ketë lexuar një të katërtën e Kur'anit."*.[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Mos u lodhni kurrë së lexuari suren 'I dha Zelzeletul Erdhu', sepse kushdo që e reciton atë në namazet nafile, kurrë nuk do të këtë problem me tërmetet dhe nuk do të vdesë prej tyre. Nuk do të ketë problem deri në çastin e vdekjes, për sa u përket ngjarjeve, si rënia e rrufesë etj…"*.[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 524.
[2] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu "Mirësitë e leximit të Kur'anit", Hadithi 24, f. 626; "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 647.

Ajetet 1 – 8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا ۝١ وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا ۝٢ وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا ۝٣ يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ۝٤ بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَى لَهَا ۝٥ يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ ۝٦ فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ۝٧ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ۝٨﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit),**"**

"Kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj"

"E njeriu të thotë: 'Ç'po i ndodh asaj?!'"

"Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj,"

"Sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë."

"Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre:"

"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë,"

"E kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."

Komentimi

Ditën kur njerëzit do të shohin punët e tyre

Ashtu sikurse u citua në fillim të shpjegimit të sures, surja nis me shpjegimin dhe citimin e disa ngjarjeve të tmerrshme të përfundimit të kësaj bote, si dhe me shpjegimin e fillimit të Ringjalljes.

Në fillim të sures "Ez Zelzele" shpjegohet momenti i tmerrshëm, sikurse është çasti i tërmetit: "**Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj** (të fundit)**."**.[1]

Gjithçka që është në brendësinë e Tokës, do të nxirret jashtë: **"Kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj."**.[2]

Fjala "*zelzeleha"* tregon se në atë ditë toka dhe planetet do të tronditen. Ajo tronditje do të jetë e ndryshme nga tërmetet e zakonshme që ne kemi parë. Ajo tronditje do të jetë për momentin e Ringjalljes.

Qëllimi i përdorimit të fjalës *"el ethkalu"*, pra, barrët e rënda, sipas komentuesve të tefsireve të ndryshme, është për të treguar njerëzit që do të ringjallen me tronditjen e madhe. Ata do të nxirren nga barku i tokës dhe varret, duke u hedhur. Këtë situatë të ngjashme e shikojmë edhe në ajetin 4 të sures "El Inshikâk". Disa

[1] Fjala *"idha"*, në këtë rast, tregon kusht, ndërsa për kushtin e fjalës *"xhezas"*, janë dhënë mendime të ndryshme. Disa janë të mendimit se *"xhezaja"* e saj është *"Jeumeidhin tuhad'dithu ekhbareha"*.

[2] Pra, kur të nxjerrë kufomat e të vdekurve që janë varrosur në të.

komentues janë të mendimit se toka, në atë moment, i nxjerr nga barku thesaret dhe adhuruesit e kësaj bote i lë pa njoftuar.[1]

Ekziston edhe një tjetër mundësi shpjegimi për barrën që mbart toka brenda saj. Thuhet se fjala *"barrë"*, nënkupton nxjerrjen jashtë të lëndëve të rënda dhe të shkrira brenda tokës. Lëndë që ndonjëherë dalin nga toka kur shpërthejnë vullkanet apo kur bien tërmete.

Gjithashtu, në fundin e kësaj bote ajo, çka është brenda tokës, do të dalë menjëherë pas tronditjes së madhe.

Komentimi i parë është më i përshtatshëm, për sa u tha më lart, por edhe bashkimi i komentimeve nuk është i pamundur.

Sidoqoftë, në atë ditë, kur njerëzit do të shikojnë këtë skenë të paparë ndonjëherë dhe të pahasur gjëkundi, do të tmerrohen shumë dhe do të pyesin se çfarë ndodhi që toka po tronditet kështu dhe atë çka mbartur brenda, e ka nxjerrë jashtë: **"E njeriu të thotë: 'Ç'po i ndodh asaj?!'"**.

Disa komentues, fjalën *"insan"* – *"njeri"*, në këtë rast, e kanë komentuar në mënyrë të veçantë për qafirët, të cilët kanë dyshim në çështjen e Ringjalljes.

Por pamja e jashtme e këtij ajeti tregon se fjala *"insan"* ka kuptim të gjerë, ku i përfshin të gjithë njerëzit, ndaj dhe habia dhe befasia nuk i përfshin vetëm qafirët, por të gjithë njerëzit.

---

[1] Fjala *"el ethkal"* është shumësi i fjalës *"thekel"* dhe ka kuptimin: *barrë* ose *ngarkesë*. Të tjerë komentues, fjalën *"thiklun"*, e kanë komentuar me kuptimin: *mjete të shtëpisë, ose mjete udhëtimi*. Kuptimi i parë është më i përshtatshëm për këtë fjalë.

Kjo habi, kjo çudi dhe kjo pyetje që bëjnë njerëzit, ka të bëjë me herën e parë apo të dytë?

Ajeti na thotë se është hera e parë, pra, hera e përfundimit të botës, sepse tronditja e madhe do të jetë në përfundim të botës.

Është dhënë edhe një tjetër mundësi shpjegimi, është e hera e Ringjalljes, ringjallja e të vdekurve dhe nxjerrja e tyre nga toka, sepse ajetet e mëpasshme do të flasin për herën e dytë.

Edhe pse ajetet e Kur'anit flasin për të dy herët, komentimi i parë është më i përshtatshëm, për sa i përket tronditjes së tmerrshme, ndaj dhe fjala *"el ethkal"* ka kuptimin: *tokë, minerale, thesare, si dhe lëndëve që mbart toka brenda saj*.

Më e rëndësishme ndër këto që u thanë, është fakti se toka, në atë ditë, gjithçka mbart brenda saj, do ta e nxjerrë jashtë vetes: **"Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj."**.[1]

Gjithçka do të jetë mbi skenën e tokës, të mirat e të këqijat, veprat e mira dhe veprat e këqija. Për njeriun, në atë ditë, një ndër dëshmuesit më të rëndësishëm të tij, do të jetë toka. Po, kjo tokë është një ndër dëshmuesit e veprave dhe punëve që ne kryejmë.

Në një ndër hadithet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: " *A e dini se kë kanë për qëllim këto fjalë (lajmet e tokës)?"*

- All'llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri, u përgjigjën. *"Qëllimi për lajmin që jep toka, është fakti se veprat e çdo burri dhe gruaje që janë kryer mbi tokë, do t'i nxjerrë, duke thënë se filani, në filan ditë, ka*

[1] Ashtu si të gjitha krijesat, edhe Toka do të dëshmojë për veprat e njerëzve.

kryer këtë punë. Kështu do të lajmërojë toka", tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Në një tjetër hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Kini kujdes dhe merrni abdes, sepse punët më të mira për ju janë falja e namazit. Kini kujdes tokën, sepse është nëna juaj. Asnjë njeri nuk kryen asnjë punë, qoftë e mirë apo e keqe, që toka të mos ketë haber."*.[2]

Abu Said El Khuderij thoshte: "Kurdoherë që gjendesh në shkretëtirë, kur të vijë koha e namazit, thirre me zë të lartë ezanin, sepse kam dëgjuar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: *"Nuk do mbetet asnjë xhin apo njeri, apo pjesë prej copave të gurëve, që të mos dëshmojnë për të në Ditën e Kiametit."*.[3]

A mos vallë, toka me urdhër të All'llahut, do të këtë gjuhë dhe do të flasë? Apo mos ka për qëllim shfaqjen e ndikimeve të veprave të njeriut mbi tokë? Ne e dimë se çdo vepër e njeriut, qoftë ajo e kryer me dashje apo pa dashje, do të lërë gjurmë. Ndikimin e saj do ta shikojmë në atë ditë. Kjo gjë për ne duket e pakonceptueshme. Për ta kuptuar më mirë, po e krahasojmë me shenjat e gishtërinjve që mbeten te doreza e shtëpisë apo në vende të tjera kudo që prekim. Në këtë mënyrë do të shohim edhe ndikimet e veprave tona, si dhe tokën që do të flasë për veprat tona. Po ashtu edhe kur dikujt i tregojmë një ëndërr të keqe, sytë thonë

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 649.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 526.
[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan" vëll. 10, f. 526.

se nuk kemi fjetur, sepse te sytë shikohen ndikimet e ëndrrës së keqe.

Gjithsesi, kjo çështje nuk është e çuditshme, sepse po sot, në ditët tona, me zhvillimin e shkencës dhe me dijen që njeriu ka, ka shpikur mjete që mund t'i incizojë njerëzit kudo që ata janë dhe në çdo sekondë i dëgjon ato. Po ashtu, mund ta filmojë njeriun dhe ta shikojë atë në çdo punë që ai kryen dhe veprat e punët që ai kryen, i merr si provë dhe dokument për çështje gjyqësore dhe personi nuk mund të mohojë asgjë.

Nëse për njerëzit e mëparshëm, disa prej dëshmive të tokës ishin të habitshme dhe të paimagjinueshme, për ditët e sotme kjo gjë nuk ka pse të jetë e pakonceptueshme, sepse një çip i vogël që vihet në një pjesë të trupit apo të rrobave, mund të tregojë shumë gjëra dhe të zbulojë shumë prej tyre.

I habitshëm është fakti se në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Falni namazet në vende të ndryshme të xhamisë, sepse çdo pjesë e tokës do të dëshmojë për ju në Ditën e Kiametit."*.[1]

Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, kur ndante pronën e përbashkët dhe, kur boshatisej vendi, falte dy rekate namaz dhe thoshte: *"Në Ditën e Kiametit dëshmo, se unë të kam mbushur (me mallra, para etj...) me të drejtë dhe të kam boshatisur me të drejtë (mallrat janë shpërndarë në mënyrë të drejtë te populli)."*.[2]

[1] "Biharul Enuar", vëll. 77, Hadithi 59, f. 384.
[2] "Leali Akhbar", vëll. 5, f. 79, (botimi i ri).

Në ajetin tjetër, All'llahu thotë: **"Sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë."**.[1]

Këto janë për shkak se All'llahu ty të ka zbritur Shpalljen në tokë.

Edhe toka, në zbatim të këtij urdhri, nuk neglizhon. Ky fakt duket në interpretimin e fjalës *"uhije"*, sepse, në këtë rast, një interpretim i tillë apo një bisedë e tillë është në kundërshtim me natyrën e tokës. Dhe, kjo gjë nuk ndodh vetëm se me ose nëpërmjet Shpalljes.

Disa komentues janë të mendimit se qëllimi i përdorimit të kësaj fjale, është të tregojë se tokës i zbret Shpallje, ose i shpallet Zbulesë, duke i thënë se çfarë ke brenda teje, nxirre jashtë. Komentimi i parë është më i saktë dhe më i përshtatshëm.

Më pas thuhet se në atë ditë njerëzit do të dalin grupe-grupe nga varret dhe do të paraqiten në Mahsher, që t'u paraqiten veprat e tyre: **"Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre."**.

Fjala *"eshtaten"* është shumësi i fjalës *"shette"* dhe ka kuptimin: *ndarje, të hedhësh sa andej e këtej*. Kjo mosmarrëveshje dhe hedhja sa andej e këtej mund të jetë për shkak se secili medh'heb do të paraqitet në Ditën e Llogarisë, i ndarë në gupe.

Ose mund të tregojë se grupet që janë të gëzuar dhe të lumtur, të jenë në një anë dhe grupet që kanë pamje të mërzitur, do të jetë në anën tjetër, kur të hyjnë në Ditën e Llogarisë.

---

[1] Shkronja *"ba"* te *"bi en'ne"* vjen kur tregon një shkak, ndërsa shkronja *"lam"* te fjala *"leha"* ka kuptimin: *ilej'je*. E njëjta gjë është edhe tek ajeti 68 i sures "En Nahl": "Ue uhaa Rabuke ila nahli".

Ose, secili popull të paraqitet për gjykim me Imamin e tij, sikurse thuhet në ajetin 71 të sures "El Isra": **"Ditën, kur Ne do t'i thërrasim të gjithë popujt me prijësin** (të dërguarin) **e vet, atyre, që do t'u jepet libri në anën e djathtë, do ta lexojnë librin e tyre dhe nuk do të pësojnë as padrejtësinë më të vogël."**. Ose besimtarët, me besimtarët dhe jobesimtarët me jobesimtarët do të paraqiten në atë ditë.

Përmbledhja e këtyre komentimeve është plotësisht e mundur, sepse kuptimi i ajetit është i gjerë. Fjala *"jesduru"* vjen nga rrënja *"es suduru"* dhe ka kuptimin: *dalja e deveve nga vatha e tyre*. Kur ato dalin nga vatha e tyre, dalin në masë dhe janë të trembura. E kundërta ndodh kur ato futen brenda vathës. Këtu, kuptimi është metaforik, për sa i përket faktit të daljes se popujve të ndryshëm nga varret, përgatitjes së tyre për në Ditën e Gjykimit dhe për dhënie llogarie.

Është dhënë edhe një tjetër variant komentimi. Mendohet se qëllimi është për daljen e tyre nga Dita e Gjykimit dhe lëvizjen drejt vendit të tyre, në Xhennet ose Xhehennem. Kuptimi i parë ka më tepër ngjashmëri dhe afërsi se sa komentimet e tjera.

Për fjalinë: **"që t'u tregohen veprat e tyre"**, ka disa variante komentimi. Po përmendim disa prej tyre: ata do të jenë të pranishëm, kur të shikojnë dënimin e veprave;

Do të shikojnë librin e veprave të tyre, ku çdo gjë, çdo vepër e mirë apo e keqe, është shkruar dhe është regjistruar në të;

Do të jetë një shikim i brendshëm, që ka kuptimin, njohje me veprat e tyre, pra, si janë veprat e tyre;

Ose ka kuptimin "Texhesumul A'mal", e vizualizimit të veprave.

Komentimi i fundit është më i drejtë, për sa i përket pamjes së jashtme të ajetit, sepse ky ajet konsiderohet si ajeti më i qartë sa i përket "Texhesum Amal" vizualizimit të veprave, sepse në atë ditë, veprat e njeriut marrin formën e punës apo të veprës që është kryer dhe paraqiten për të dhënë llogari. Ato mund të jenë të gëzuara ose të hidhëruara, mund të jenë me vuajtje dhe bela.

Më pas, flet për përfundimin e këtyre dy grupeve, punëmirëve dhe punëkëqijëve. All'llahu në Kur'an thotë: **"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."**.[1]

Përsëri për këto ajete janë bërë komentime të ndryshme, sepse lindin pyetjet. A mos vallë ne do shikojmë dënimi e veprave tona? A mos vallë ne e shikojmë librin e veprave tona? Apo ne shikojmë vetë veprën?

Këto ajete, nga pamja e jashtme, përsëri theksojnë faktin e shikimit të vetë veprave, qofshin ato vepra të mira apo vepra të këqija. Në Ditën e Kiametit do të shikohen të gjithë veprat, edhe sikur të jenë sa maja e gjilpërës. Ato do të shfaqen dhe ne do i shikojmë të gjitha veprat.

[1] Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë se dy ajetet përmbyllëse të kësaj sureje janë më frikësueset e të gjithë Kur'anit.

Fjala *"mithkal"* ka kuptimin: *peshë dhe peshore*. Këtu ka po atë kuptimin e parë.

Për fjalën *"edh dherretu"*, gjithashtu, janë dy kuptime dhe komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa kanë dhënë mendimin se ka kuptimin e një milingone të vogël, disa kanë thënë se ka kuptimin e pluhurit, kur ne vendosim duart në tokë na ngjiten në duar pluhura, ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se ka kuptimin e një thërrmije apo grimce të vogël dheu e cila gjendet në ajër dhe, kur dielli shfaqet, ato grimca të vogla dallohen dhe shfaqen qartë.

Ne e dimë se fjala *"edh dherretu"* përdoret për atomin. Edhe bombës atomike, i thonë *"el kunbuletu dherijetu"*. Atomi është aq i vogël, saqë nuk mund të shikohet jo vetëm me syrin e lirë të njeriut, por edhe me çfarëdolloj mikroskopi. Me mikroskop mund të shikohen vetëm ndikimet e tij. Përmasat dhe pesha e tij nuk mund të llogaritet. Pra, atomi është aq i vogël, saqë miliona atome mblidhen në majën e një gjilpërë të vogël.

Pra, kuptimi i fjalës *"edh dheretu"*, sido që të jetë, në këtë rast, ka kuptimin e peshës më të vogël.

Ky ajet është ndër ajetet që e rrëqeth trupin e njeriut dhe tregon se dhënia llogari tek All'llahu është jashtëzakonisht e saktë dhe e ndjeshme. Peshoret në atë ditë janë shumë të sakta dhe të ndjeshme, saqë peshojnë edhe më të voglën punë, vepër të mirë apo të ligë të njeriut.

Hulumtime

1- Saktësia dhe vështirësia në dhënien e llogarisë në Ditën e Kiametit

Jo vetëm ajetet e fundit të kësaj sureje, por edhe ajetet e ndryshme të Kur'anit përdoren shumë mirë, për sa i përket dhënies së llogarisë dhe marrjes në llogari për veprat e bëra, por dhënia e llogarisë për veprat e bëra në Ditën e Kiametit, trajtohet në nënyrë të jashtzakonshme në ajetin 16 të sures "Llukman" ku lexojmë: **"O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, All'llahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, All'llahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë."**.

Kokrra e sinapit është shumë e vogël, saqë, kur duan të krahasojnë ndonjë gjë të vogël, përdorin si fjalë të urtë kokrrat e sinapit. Ky interpretim tregon që në atë ditë do të jepet llogari për gjënë më të vogël.

Gjithashtu, këto ajete tregojnë se edhe mëkati më i vogël, i cili na duket i parëndësishëm, në atë ditë do të merret në llogari, si dhe vepra më e vogël e mirë do të llogaritet, çfarëdo që të jetë, nuk është e parëndësishme, apo sado e vogël të jetë e keqja dhe e mira, nuk do të lihet pa u llogaritur.

Disa komentues kanë thënë se këto ajete kanë zbritur kur disa shokë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin pak të pakujdesshëm, për sa i përket faljes së mallit që kishin. Ata thoshin se shpërblimi jepet për

gjëra që ne i duam, ndërsa gjërat e vogla nuk janë asgjë, që ne t'i duam.

Gjithashtu, edhe për mëkatet e vogla, ata ishin të pavëmendshëm. Ajetet e zbritura i njoftuan ata se edhe gjëja më e vogël dhe më e parëndësishme në syrin tonë, në Ditën e Kiametit do të llogaritet.

2- Përgjigje për një pyetje

Në këtë rast lind një pyetje: Sipas këtyre ajeteve, njeriu, të gjitha veprat e tij, qofshin ato të vogla apo të mëdha, të mira apo të këqija, do t'i shikojë në Ditën e Kiametit. Këto ajete si ti përputhim me ajetet të cilat flasin për *"Ehbat" – "shvleftësimin e punës", "Tekfir" – "shlyrjen", "Af'un" – "falje" dhe "Teubeh" – "pendimin"*. Sepse ajetet ku përmendet fjala **"Ihbat"** thonë se disa prej veprave tona, sikurse është kufri, i zhduk të gjitha veprat e mira të njeriut: **"Nëse i shoqëron All'llahut diçka tjetër** (në adhurim)**, me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit."**.[1]

Sipas ajeteve ku përmendet fjala *"et tekfijru" – "shlyrje, largim",* ndonjëherë veprat e mira i largojnë veprat e këqija. **"Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat."**.[2]

[1] Sure "Zumer", ajeti 65.
[2] Sure "Hud", ajeti 114.

Ndërsa ajetet që flasin për *"af'un"* – *"falje"* dhe *"teubetun"* – *"pendimin"* thonë: "Nën hijen e faljes hyjnore apo të pendimit, mëkatet fallen.". Si t'i krahasojmë këto kuptime, me të gjitha veprat e mira dhe të këqija?

Për të dhënë këtë përgjigje, duhet t'i kushtojmë pak vëmendje dhe përqendrimit të dy ajeteve të mësipërme, ku flasin për veprat që njeriu i shikon ato, qofshin të mira apo të liga. Të parit e veprave është si një ligj i përgjithshëm, sepse ne e dimë se çdo ligj mund të ketë (përjashtimet e tij) tipare që mund t'i shikojmë te ky ligj i përgjithshëm, (që janë ajetet e mësipërme). Ajetet që flasin për falje, pendim, qafirllëk etj., kanë dhe luajnë rol të veçantë për këtë ligj.

Një tjetër përgjigje, për sa i përket çështjes së *"ehbat"* – *"shvleftësimin e punës"*, *"tekfijr"* – *"shlyrjen"*, që në fakt është bilanci i thyerjes, ajo ngjan saktësish me "kërkesat" dhe "borxhet", këto shkaktojnë thyerje midis njëri-tjetrit. Kur personi e merr përgjigjen e këtij bilanci, shikon se të gjitha veprat dhe punët e tij, si të mira dhe si të liga, i ka parë. Po kjo gjë mund të thuhet edhe për rastin e faljes dhe të pendimit, sepse pendimi nuk arrihet, nëse nuk e meriton apo, nëse nuk i ke fuqitë, ndaj dhe pendimi është konsideruar si një prej veprave dhe punëve të mira të njeriut.

Disa komentues, për këtë gjë, kanë dhënë përgjigje tjetër, që nuk duket e saktë. Ata mendojnë se njerëzit apo personat që janë qafirë, përfundimin e veprave të tyre të mira do ta shikojnë në këtë botë, ashtu sikurse edhe personat besimtarë do t'i shikojnë në këtë botë përfundimin e veprave të këqija.

Në pamje të jashtme, përgjigjja është: Ajetet që flasin dhe kanë të bëjnë me Kiametin dhe jo këtë botë, nuk e kanë këtë universalitet, që çdo besimtar dhe jobesimtar do të shohë në këtë botë përfundimin e veprave të tij.

3- Ajeti gjithëpërfshirës

Abdullah ibn Mes'udi ka transmetuar se ajetet më të forta të Kur'anit të Shenjtë janë këto ajete: **"kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."** Këto ajete ai i interpretonte si ajete gjithëpërfshirëse. Në të vërtetë, besimi i thellë te përmbajtja e këtyre ajeteve është i mjaftueshëm, që njeriun ta udhëzojë drejt Rrugës së Drejtë dhe ta mbajë larg nga çfarëdolloj korrupsioni dhe fëlliqësire.

Lexojmë në një hadith: Një burrë u afrua pranë të Dërguarit të *All'llahut (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "Më mëso mua atë çka All'llahu të ka mësuar ty.".

Profeti i nderuar i tha njërit prej shokëve të tij, që t'i mësonte Kur'an. Ai i mësoi atij suren "Ez Zelzele". Burri i ngrit nga vendi dhe tha: "Kjo është e mjaftueshme për mua.".

Në një tjetër transmetim thuhet se ky burrë tha se kaq është mjaftueshëm për të. Profeti i nderuar tha: *"Lëreni në gjendjen e tij, sepse ai është bërë i ditur."*.

Arsyeja është e qartë, sepse, nëse një person e di që veprat tona peshohen dhe merren në llogari, edhe nëse janë më të vogla

se një kokërr sinapi, atëherë kjo është një gjë shumë e madhe dhe konsiderohet si ndikimi më i mirë, për sa i përket edukimit të njeriut.[1]

Në një transmetim tjetër të Abu Saijd El Khuderij thuhet: "Kur zbriti ajeti: **"kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë"**, e pyeta të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nëse do të shfaqen të gjitha veprat dhe punët që kam bërë.

- *Po*, - u përgjigj Profeti Muhammed.

- Punët e mëdha? - e pyeta.

- *Po*, - u përgjigj Profeti Muhammed.

- Edhe punët e vogla, të vogla fare? – e pyeta.

- *Po*, - u përgjigj Profeti Muhammed.

- Oh medet për mua! Nëna le të ulet dhe të nisë vajtimin për mua, të mbaj zi!

- *O Abu Saijd, lajme të mira paç, sepse punët e mira llogariten me dhjetëfishin deri në shtatëqind fish. All'llahu i shton mirësitë, për kë do. Ndërsa për mëkatet, jep dënimin vetëm për atë që bëjnë, ose ua fal ato*, - tha Profeti Muhammed. - *Dije dhe këtë! Askush nuk shpëton me veprat e tij, përveçse me mëshirën e All'llahut*.

- O i Dërguari i All'llahut, edhe ti?! – e pyeta.

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 495. Këtë kuptim ka edhe hadithi i transmetuar te tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f 650.

- *Edhe unë. Vetëm nëse All'llahu më përfshin në mëshirën e Tij*, - u përgjigj Profeti.[1]

O All'llah! Kur Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), që është me atë madhështi pranë Teje, e ka shpresën te Mëshira Jote, atëherë detyra jonë është e qartë.

O All'llah! Nëse veprat tona do të jenë kriter i shpëtimit tonë, medet për ne! Nëse Ti do të jesh mbështetësi ynë, lum ne!

O All'llah! Ditën që të gjithë veprat tona, do të paraqiten te ne në forma të ndryshme, ne sytë i kemi të drejtuar drejt mirësisë Tënde.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "Ez Zelzele".

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 381.

Sure "El 'Âdijât"

Zbritur në Mekë

Ajete 11

Përmbajtja e sures "El 'Âdijât"

Ka mendime të ndryshme midis komentuesve për vendin e zbritjes së sures "El 'Âdijât". Shumë komentues, këtë sure e konsiderojnë mekase. Disa të tjerë, e konsiderojnë medinase.

Ajetet janë të shkurtra, ekzistenca e betimeve dhe mbështetja te çështja e Ringjalljes, janë shenja që vërteton se surja është mekase.

Por nga ana tjetër, kuptimi i këtyre betimeve, çështja e xhihadit, të cilën do ta qartësojmë dhe do ta komentojnë më poshtë, si dhe transmetimet, thonë se kjo sure ka zbritur pas luftës Dhatul Es Selalil, që ka ndodhur në vitin e tetë të hixhretit. Në këtë luftë u kapën robër shumë jobesimtarë. Ata i kishin lidhur fort me litar, ndaj dhe emri i luftës u vendos "Dhatul Selasil".

Këto fakte dëshmojnë se kjo sure është medinase. Edhe nëse betimet e fillimit të kësaj sureje janë mbikëqyrëse të lëvizjes së Hexhaxhit drejt Minas dhe Mesherit, përsëri ka përputhje me Medinen.

Është e vërtetë se rituali i Haxhit, ishte i njohur edhe tek arabët xhahilë, sepse ata ndiqnin synetin e Profetit Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ata, këtë ritual, e kishin përzier aq shumë me legjenda, saqë duket e pamundur që Kur'ani të betohet në të.

Duke parë të gjitha këto raste, ne i japim më shumë rëndësi faktit se kjo sure është medinase.

Teksti i mësipërm, gjithashtu, sqaroi edhe përmbajtjen e sures, që në fillim betohet. Më pas flet për një pjesë të dobësive të

njeriut, sikurse është kufri, koprracia, si dhe adhurimi i kësaj bote. Më pas e përfundon suren duke folur shkurtimisht për çështjen e Ringjalljes dhe dijen gjithëpërfshirëse të All'llahut ndaj robëve të tij.

Mirësitë e leximit të sures "El 'Âdijât"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Çdokush që e lexon këtë sure, do të marrë dhjetëfishin e mirësisë, sa gjithë pelegrinët e Haxhit që kanë qëndruar natën e Kurban Bajramit në Muzdelife."*.[1]

Në një hadith tjetër të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Çdokush që e lexon suren 'El 'Âdijât', duke pasur vëmendjen tek ajo, në Ditën e Kiametit, All'llahu do ta ringjallë atë me Prijësin e besimtarëve, Ali Ibn Ebu Talibin (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), si dhe do të jetë në radhët e tij e të shokëve të tij në atë ditë."*.[2]

Në disa transmetime kuptohet se surja "El 'Âdijât" është sa gjysma e Kur'anit.[3]

Është e qartë se të gjitha këto mirësi arrihen, nëse e lexojmë vazhdimisht suren, duke e kuptuar dhe duke e zbatuar atë.

---

[1] "*Xhemeh*" është një ndër emrat e "*Mesherul Heram*", pra Muzdelifes sepse atje njerëzit grumbullohen për të mbledhur guralecet, atje namazin e akshamit dhe të darkës, e falin pa asnjë largësi nga njëri-tjetri.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 527.
[3] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 383.

Ajetet 1 - 11

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالْعَادِيَاتِ ضَبْحًا١ فَالْمُورِيَاتِ قَدْحًا٢ فَالْمُغِيرَاتِ صُبْحًا٣ فَأَثَرْنَ بِهِ نَقْعًا٤ فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا٥ إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ٦ وَإِنَّهُ عَلَى ذَلِكَ لَشَهِيدٌ٧ وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ٨ أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ٩ وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ١٠ إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَخَبِيرٌ١١﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjimëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Betohem për ata (kuaj) **që vrapojnë duke dihatur,"**

"Që nxjerrin xixa nga thundrat."

"Dhe trokojnë për sulm në mëngjes,"

"Duke çuar re pluhuri,"

"Ndërsa çajnë armikun në dysh,"

"Se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet,"

"Dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon."

"Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri."

"Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre,"

"Dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse,"

"Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!"

Shkaku i Zbritjes

Në hadithe të ndryshme thuhet se kjo sure ka zbritur pas luftës së Dhatul Selasel. Ngjarja ishte e tillë: Në vitin e tetë të hixhrit, e lajmëruan Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se janë mbledhur dymbëdhjetë mijë kalorës në tokën e *Jabisun* dhe kanë dhënë besën që të vrasin të Dërguarin e All'llahut dhe Imam Aliun, duke shpresuar se kështu do të zhdukin xhematin mysliman, që të mos ketë më asnjë mysliman.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi disa shokë të tij, që të bisedonin me ta, që të largoheshin, por bisedimet nuk patën sukses dhe shokët u kthyen.

Kështu që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi për luftë Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, me një grup të madh nga muhaxhirët dhe ensarët. Ata lëvizën me shpejtësi drejt vendit ku po qëndronin armiqtë. Kur

armiqtë mësuan se drejt tyre ishte nisur Ali Ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, u bënë gati të luftonin me të.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, së pari, i përshëndeti me paqe, por ata nuk e pranuan përshëndetjen. Ata donin vetëm të luftonin.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* pranoi, gjithashtu, kërkesën e tyre, që lufta të niste të nesërmen në mëngjes. Ai i përgatiti kalorësit dhe të nesërmen në mëngjes herët nisi luftën. U vranë shumë jobesimtarë. Fëmijët e gratë i zunë robër dhe mallin e tyre e morën.

Në këtë mënyrë zbriti surja "El 'Âdijât", ndërkohë që ushtria islame nuk ishte kthyer akoma në Medine. Atë ditë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në namazin e mëngjesit, recitoi këtë sure. Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbaroi namazin, shokët i thanë se këtë sure nuk e kishin dëgjuar më parë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, Aliu (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) doli fitimtar ndaj armiqve, dhe 'Xhibrili', mbrëmë më dha lajmin e mirë duke më sjellë këtë sure*".

Pas disa ditësh, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u kthye në Medine së bashku me shokët, robërit dhe me plaçkën e luftës.[1]

[1] "Biharul Enuar", vëll. 21, f. 68 e tutje; "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 528 dhe në disa libra të historisë.

Disa janë të mendimit se ky është një shembull i qartë i ajetit dhe jo shkaku i zbritjes.

Komentimi

Betimi në muxhahidinët vizionarë

Thamë se kjo sure ka nisur me betime, që e zgjojnë njeriun. Së pari, betohet për kuajt: **"Betohem për ata** (kuaj) **që vrapojnë duke dihatur."**.

Betimi është për devetë e haxhinjve që lëvizin nga toka e Arafatit në Mesh'arul Heram dhe që aty lëvizin për në Mina.

Fjala *"el adijatu"* është shumësi i fjalës *"adijetun"* dhe rrjedh nga rrënja e fjalës "*el aduvu"*. Kuptimi i sajë është: *të vendosësh dhe të ndash*, ndarja mund të jëtë me zemër gjë të cilës i thonë *"adavet"*, ose mund të jetë në lëvizje të jashtme dhe e quajnë, *"aduvu"* me kuptimin (vrapoj), po ashtu ndonjëherë kur bëhet ndonjë marrveshje transaksioni atë e quajnë *"el udauan"* që edhe në këtë rast ka për qëllim vrapimin me shpejtësi.

Fjala "*debhun"* ka kuptimin e zërit të frymëmarrjes së shpejtë, që në kohën e vrapimit e dëgjojmë, ose na vjen në vesh zëri i frymëmarrjes.

Ashtu sikurse u citua edhe më lart, ekzistojnë dy mendime. Mendimi i parë i komentuesve është se qëllimi i këtij ajeti është për kuajt që ecin me shpejtësi drejt sheshit të xhihadit. Për shkak se xhihadi është një urdhër i shenjtë, edhe kafshët që luftojnë në këtë rrugë, konsiderohen të shenjta, ndaj edhe ato vlerësohen, saqë betohen në to.

Një tjetër komentim i këtij ajeti thotë se betimi është për devetë, të cilat lëvizin me shpejtësi përgjatë kryerjes së një prej farzeve që ka caktuar All'llahu, për Haxhin. Për shkak se devetë kanë disa mirësisë të shenjta, edhe betimi është bërë për to.

Ibn Abasi transmeton se ishte i ulur në Qabe, pranë Hexherul Ismail. Një burrë u afrua dhe pyeti për ajetin **"Uel Adijati Dabha."**. Ai i tha se ka për qëllim kuajt që sulmojnë në rrugën e xhihadit dhe kthehen në vendin e tyre, si të ishte natë, si të ishte ditë. Gjithashtu, ka të bëjë më ushtarët, që ndezin zjarr dhe përgatisin ushqim për veten e tyre.

Ai burrë u largua nga Ibn Abasi dhe vajti pranë Ali Ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Imam Aliu ishte ulur pranë burimit të Ujit Zemzem. Burri e pyeti po për këtë ajet.

Imam Aliu i tha: *"Ke pyetur njeri tjetër për këtë ajet, para se të vish tek unë?"*

- Po, kam pyetur Ibn Abasin, - dhe përgjigja e tijë ishte kjo: "Qëllimi i këtij ajeti është të tregojë vlerën dhe rëndësinë e kuajve në luftë.". Imam Aliu tha: Shko dhe ma thirr Ibn Abasin të vijë pranë meje.

Kur arrita pranë tij, ai i tha Ibn Abasit: Si jep fetva, për një gjë që nuk e di në rregull? Lufta e parë islame ishte lufta e Bedrit

dhe ne, në atë luftë, patëm vetëm dy kuaj. Një e kishte Zybejri dhe tjetrin Mekdadi. Atëherë, si mundet që fjala *"adijat"* të ketë kuptimin "kuajt"?!

As nuk ka për qëllim devetë që shkojnë nga Arafati në Masher dhe nga Masheri në Mina. Ibn Abasi thotë: kur dëgjova këto fjalë, ktheva mendje nga mendimi im dhe pranova mendimin e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. [1]

Ekziston edhe një tjetër mundësi interpretimi për kuptimin e fjalës *"adijat"*. Për shkak të kuptimeve të shumta që ka, në të përfshihen edhe kuajt, edhe devetë e xhihadistëve.

Transmetimi i mësipërm tregon se kuptimi i fjalës *"adijat"* nuk duhet të kufizohet vetëm te kuajt, sepse ky kuptim nuk është i drejtë në të gjitha vendet. Ka kuptim të qartë edhe për devetë e haxhinjve.

Ky komentim është më i përshtatshëm.

Më tej shton: **"Që nxjerrin xixa nga thundrat."**.

Kuajt e xhihadistëve ecin aq shpejt drejt mejdanit, saqë thundrat e tyre nxjerrin xixa, kur përplasen në gur.

Ose devetë që ecin me shpejtësi, kur këmbët e tyre hasin gur, ose poshtë këmbëve kanë gur, ato hidhen. Për shkak të fërkimit të këmbëve me gurët, krijohen shkëndija dhe xixa.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan" , vëll. 10, f. 529. Këtë transmetim e ka sjellë edhe Kurtubij, në tefsirin e tij, vëll. 10, f. 7245.

Ose fiset dhe grupet që nisen për Haxh gjatë rrugës ndezin zjarr për të siguruar ushqim.

Ose mund të jetë ndonjë njeri që nis zjarrin e luftës.

Ose gjuhët, që me fjalët thumbuese ndezin zjarrin në zemër të armikut.

Ose mund të jetë dikush që, sipas disa komentuesve, përpiqet shumë për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Ata e arrijnë qëllimin e tyre, ashtu sikurse zjarri del nga guri.

Por të gjitha këto variante janë shumë larg kuptimit të ajetit, sepse ajeti, në pamje të jashtme, ka kuptimin e dy komentimeve të para.

Fjala *"el muurijatu"* është shumësi i fjalës *"murjetun"* dhe vjen nga rrënja *"el irau"*, me kuptimin: *ndez zjarr*.

Fjala *"el kad'hu"* ka kuptimin e nxjerrjes shkëndija dhe xixa zjarri, kur goditet guri.

Në betimin e tretë thotë: **"Dhe trokojnë për sulm në mëngjes."**.

Arabët kanë pasur si traditë, që të shkojnë ta sulmojnë armikun në mëngjes herët. Këtë gjë e thotë edhe Tabrasij në tefsirin e tij "Mexhmaul Bejan". Arabët nisen shumë herët, pa gdhirë, që ta sulmojnë në mëngjes herët armikun.

Sikurse lexuam për shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, luftëtarët myslimanë, me në krye udhëheqësin e tyre, Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, u nisën natën, pa gdhirë. Kur arritën

pranë vendit ku ndodhej armiku, ngritën çadrat dhe në të gdhirë sulmuan.

Nëse këto betime do t'i konsiderojmë se janë bërë për devetë e haxhinjve, atëherë ajeti ka për qëllim të tregojë futjen e karvanit të deveve në mëngjesin e Bajramit, nga Masheri në Mina.

Fjala *"el mugaijrat"* është shumësi i fjalës *"mugijretun"* dhe vjen nga rrënja e fjalës *"el igaratu"* dhe ka kuptimin: *sulm ndaj armikut*. Por për shkak se ndonjëherë sulmi konsiderohet si marrje e mallit të të tjerëve, ndonjëherë kjo fjalë në gjuhën perse, përdoret si sulm dhe si marrje e mallit të të tjerëve. Komentues të tjerë janë të mendimit se bëhet fjalë për sulmim me kuaj. Por përdorimi i fjalës tregon më së miri, se nëse, që në fillim do të ishte ky kusht, atëherë do të ishte fshirë dalëngadalë, me kalimin e kohës.

Ndërsa mendimi se qëllimi i fjalës *"mugairat"*, sulm ndaj armikut në këtë rast, është për fiset që sulmojnë dhe nisen me shpejtësi drejt sheshit të luftës, apo drejt Minas, është i largët, sepse ajeti: **"Uel Adijati Dabha",** sigurisht që është përshkrues për kuajt dhe devetë dhe jo për pronarët e tyre, është vazhdimësi e asaj që u tha më lart.

Më tej flitet për një cilësi tjetër të muxhahidëve dhe kafshët që ata përdorin për luftë: **"Duke çuar re pluhuri."**.

Devetë e haxhinjve, duke ecur nga Mesh'arul Harami drejt Minasë, ngrenë pluhur.

Fjala *"etherne"* vjen nga rrënja e fjalës *"el itharatu"* dhe ka kuptimin: *shpërndarje e dheut apo e pluhurit*. Gjithashtu, ka edhe

kuptimin: *tronditje*. Në disa raste është përdorur me kuptimin e përhapjes së valëve të zërit në natyrë.

Fjala *"en neke'u"* ka kuptimin: *pluhur, dhè*. Origjina e rrënjës së kësaj fjale i është referuar pluhurit. *"Neke'un"* i thuhet edhe ujit të ndenjur.

Më tej, kur flet për cilësinë e fundit të tyre, thotë: **"Ndërsa çajnë armikun në dysh."**.

Sulmi i tyre i gjen ata të papërgatitur dhe të pavëmendshëm, saqë me sulmin e parë, ata e çajnë armikun në dysh. Ky pra, është përfundimi dhe rezultati i shpejtësisë që ata kanë. Në këtë rast, shikohet trimëria dhe gatishmëria e tyre.

Një mundësi komentimi është: mund të jetë cituar hyrja e haxhinjve nga Masheri në zemrën e Minas. Komentues të tjerë janë të mendimit se ky ajet ka për qëllim të tregojë se armiku është i rrethuar. Ky komentim është i saktë, nëse fjala *"fe uesetne"* të lexohet me teshdid, pra, të lexohet *"sini"* dy herë, ndërkohë që leximi i njohur i kësaj fjale është pa teshdid, ndaj dhe kuptimi dhe komentimi i parë është më i saktë. Duke i përmbledhur të gjitha ajetet, arrijmë në këtë përfundim: betimi për kuajt është për ata që vrapojnë në sheshin e luftës, që, për shkak të shpejtësisë, prej thundrave dalin shkëndija e xixa zjarri. Ata janë luftëtarë që ngrihen dhe sulmojnë po natën. Ata thyejnë errësirën për t'u afruar pranë vendit të armikut, armikun e gjejnë të papërgatitur. Kur zbardh dita, ata sulmojnë. Sulmi i tyre është aq i fortë, saqë vendi mbushet me pluhur dhe tym. Si përfundim, ata sulmojnë dhe e çajnë armikun në dysh.

Betimi është për kuajt e fuqishëm.

Betimi është për kalëruesit trima.

Betimi është për frymëmarrjen që bëjnë kafshët e kalëruesve gjatë sulmit.

Betimi është për shkëndijat që lëshojnë nga këmbët kuajt.

Betimi është për sulmin e papritur.

Betimi është për pluhurin që ngrenë, kur sulmojnë.

Dhe, në fund, betimi është për ata që e gjejnë armikun në befasi dhe e sulmojnë duke e çarë atë në dysh. Edhe pse të gjitha këto që u thanë, nuk kanë ardhur në kuptimin e betimeve, ato nënkuptojnë të njëjtën gjë, sepse janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Këtu qartësohet fakti se xhihadi ka madhështi të madhe që edhe frymëmarrja e kuajve dhe e xhihadistëve është për t'u përgëzuar me betim. Gjithashtu, shkëndijat që ata krijojnë përgjatë ecjes, si dhe tymi dhe pluhuri që ata ngrenë, shpërndahet në të gjithë vendin. Edhe tymi është skenë e luftës, me shumë vlerë dhe madhështi.

Disa thanë se qëllimi i këtyre betimeve ka mundësi të jetë shpirtëror, për t'u transmetuar të tjerëve përsosmërinë.

Gjithashtu, edhe shkëndijat janë për të shfaqur punët e mira, të cilat pushtojnë mendjen dhe egon e njeriut. Në këtë mënyrë, ata shpërndajnë vëmendjen dhe dashurinë hyjnore.

Si përfundim, ata zënë vend në zemrat e pastra, që kanë arritur përsosmërinë.

Është fare e qartë se këto që u thanë, nuk mund t'i marrim si komentim të ajeteve më lart, por këto janë mendime që lindin në mendjen tonë.

Pas gjithë këtyre betimeve të mëdha, arrijmë në përgjigje të betimeve, se përse u betuan, pse u kujtuan për ta. Njeriu nuk e falënderon sa duhet All'llahun e Madhëruar për atë që i ka dhuruar, është koprrac: **"Se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet."**.

Ai njeri i paedukuar, që në zemrën e tij nuk ka vend për dijen hyjnore dhe të Profetëve, si dhe nuk i është dorëzuar së vërtetës, por i është dorëzuar egos dhe epshit, sigurisht që është njeri koprrac.

Fjala *"kenud"* përdoret për *tokën shterpë, që nuk mbin gjë*. Edhe njeriut që nuk falënderon dhe është mosmirënjohës, i thonë *"kenud"*.

Komentuesit, për fjalën *"kenud"*, kanë thënë kuptime të shumta.

Ebul Fettuh Err Razij, për këtë fjalë, ka transmetuar përafërsisht pesëqind kuptime. Në përgjithësi, kjo fjalë ka degët dhe gjethet e kuptimit kryesor, që i thamë më lart. Disa nga kuptimet e fjalës *"kenud"* janë:

1- "Kenud" është ai person që të metat i numëron një e nga një, ndërsa mirësitë i harron.
2- "Kenud" është ai person që mirësitë e All'llahut i dëshiron dhe ushqehet prej tyre, por të tjerët i ndalon të ushqehen me to. Ashtu sikur thuhet në hadithin e të Dërguarit të

All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*E dini cili është 'kenud'?*"

- All'llahu dhe i Dërguari i Tij janë në dijeni, - u përgjigjën të pranishmit.
- *Kenud është ai që ushqehet vetëm për vete dhe nuk u fal të tjerëve. Njerëzit që ka poshtë vetes i qëllon*, - tha i Dërguari i All'llahut.[1]

3- "Kenud" është ai që nuk ndihmon shokët, kur kanë probleme.
4- Është personi, që mirësitë e tij janë shumë të pakta.
5- Është personi, që, kur ka në dorë ndonjë mirësi, largohet nga të tjerët dhe, kur ka problem, vetëm ankohet.
6- Është personi, që mirësitë e All'llahut i shfrytëzon vetëm për të mëkatuar.
7- Është ai njeri që e mohon mirësinë e All'llahut.

Ashtu sikurse edhe thamë, të gjitha këto kuptime kanë ngjashmëri dhe janë të përafërta, sikurse degët e gjethet e pemës. Kuptimi më i përafërm është: *koprraci dhe jo falënderues*.

Interpretimi i fjalës "*insan*", në të tilla raste, ka kuptimin e njerëzve që janë egoistë, kokëfortë, tiranë etj. Disa komentues atë e kanë komentuar për njerëzit qafirë, jo besimtarë, sepse myslimanët nuk janë të tillë. Janë të shumtë personat që falënderojnë për gjithçka që kanë, ndërsa jobesimtari nuk falënderon asnjëherë.

Gjithashtu, ka njerëz, që për shkak të besimit të tyre ndaj All'llahut, kanë hequr dorë dhe janë larguar nga e liga dhe nga koprracia. Ka prej tyre që kanë arritur gradë të lartë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 530.

Më tej shton: **“Dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon.”**.

Njeriu e njeh veten e tij. Nëse njeriu i fsheh cilësitë e brendshme te të tjerët, nuk mund t’i fshehë para All’llahut, edhe nëse e pranon apo nuk e pranon këtë të vërtetë.

Disa komentues thanë se fjala *“in’nehu”* kthehet te Zoti, që do të thotë se Zoti është dëshmitar për koprracinë e njeriut.

Por, duke u bazuar tek ajetet e mësipërme dhe duke parë se zanoret e ngjashme në këto ajete kthehen te fjala “njeri”, atëherë ky komentim është shumë larg kuptimit të vërtetë të ajetit, edhe pse shumë komentues e kanë konsideruar si më të drejtin.

Një tjetër komentim i dhënë, thekson dëshminë e njerëzve ndaj mëkateve dhe mangësive të tyre në Ditën e Kiametit, sikurse edhe përftohet prej shumë ajeteve kur’anore.

Ky komentim nuk ka asnjë argument, sepse ajeti ka kuptime të shumta, që na tregon edhe një herë për mosbesimin e tyre dhe koprracinë që i përfshin ata në këtë dynja.

Është e drejtë që njeriu, ndonjëherë, është i pafuqishëm për të njohur vetveten, ndonjëherë e gënjen mendja, duke i zbukuruar punët që bën. Këto gjëra që bën njeriu, në pamje të parë, duken të bukura, sepse është shejtani që i zbukuron. Për jobesimtarët, kjo gjë është e qartë dhe nuk mund të mbulohet apo të gënjehet vetvetja.

Përsëri në ajetin tjetër shton: **“Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri.”**.

Kjo dëshirë e tepruar, për të pasur pasuri dhe mall, bëhet shkak i koprracisë, i indiferentizmit, i mosmirënjohjes, i mohimit të Zotit.

Faktikisht, fjala *"khajr"* ka kuptim të gjerë. Në të përfshin çdo lloj mirësie dhe bamirësie. Sigurisht që dëshira për punë të mira, sikurse është dija, të mësuarit, devotshmëria, Xhenneti dhe lumturia, nuk përfshihen në atë që u tha më lart. Ndaj dhe komentuesit, në këtë rast, e kanë komentuar me kuptimin *"el malu"* – *"pasuri"*, që të jetë e përafërt edhe me pozitën, edhe me ajetin e mësipërm, i cili dëshmon për të.

Gjithashtu, disa ajete të tjera të Kur'anit, sikurse është edhe ajeti 180 i sures "El Bekare", e trajtojnë këtë çështje: **"Ju është urdhëruar që, nëse ndonjërit prej jush i afrohet vdekja dhe ka pasuri për të lënë pas, atëherë të lërë testamentin në mënyrë të drejtë për prindërit dhe farefisin; ky është detyrim për besimtarët e devotshëm."**.

Sigurisht, që në këtë rast, fjala *"khajr"* përfshin edhe fjalën *"el malu"* – *"pasuri"*, sepse është gjë e mirë në sasinë e duhur.

Gjithashtu, mund të jetë mjet i llojeve të mirësive dhe bujarive. Por njeriu koprrac dhe mohues e ka ndaluar atë nga qëllimi kryesor dhe e shtyn në rrugën e koprracisë, të ligësisë e të indiferentizmit. Ky njeri nuk falënderon për mirësitë që i janë dhënë.

Më tej, All'llahu, me një fjali pyetëse mohuese, thotë: **"Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre?"**.[1]

[1] Pra, kur All'llahu i Lartmadhëruar të ringjallë të vdekurit.

Kur qartësohet dhe del në dritë ajo çka është brenda tyre, qoftë mosbesimi (kufri), sinqeriteti, mburrja, mendjemadhësia, thjeshtësia, nijetet e mira dhe të këqija, në atë ditë, All'llahu është në dijeni të veprave të tyre dhe, sipas veprave, do të marrin atë çka meritojnë: **"Dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse, Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!"**.

Fjala *"bu'thire"* vjen nga rrënja e fjalës *"el bu'thiretu"* dhe ka kuptimin: *të vendosësh poshtë diçka dhe të nxjerrësh në pah atë çka fsheh*.

Kur do të ringjallen të vdekurit, varret, do të kthehen nga një krah në krahun tjetër dhe çka ka brenda tyre, do të dalë në shesh, pra, do të qartësohet.

Ky lloj interpretimi i ajetit të mësipërm është përdorur për Ditën e Ringjalljes.

Togfjalëshi *"ma fil kubuur"* tregon gjendjen e të vdekurve që janë akoma nën dhé, pra, të varrosur, ose për shkak të paqartësisë që ata kanë, sepse nuk është e qartë se cilët persona janë poshtë varreve.

Fjala *"kubuur"* është përdorur për njerëzit që kanë varre, që u dihet varri, sepse një pjesë e njerëzve nuk kanë varre, për shembull, ata që mbyten në det dhe nuk gjenden, ose varret e disave, pas një periudhe kohe, zhduken, ose prishen.

Nuk ka ndonjë kundërshtim apo paqartësi që fjala *"varr"* mund të ketë kuptim të gjerë, si për shembull, vendi ku njerëzit kanë vendosur dherat e tyre, edhe pse, në pamje të jashtme, nuk është si varri i zakonshëm që është për njerëzit.

Fjala *"hussile"* vjen nga rrënja *"tahsijl"* dhe ka kuptimin: *nxjerr jashtë, të nxjerrësh bërthamën nga lëkura*. Gjithashtu, edhe kur kromi pastrohet dhe kur mineralet e tjera pastrohen e prej tyre nxirret floriri apo argjendi, merr të njëjtin kuptim.

Në një kuptim tjetër më të gjerë, kjo fjalë është përdorur për nxjerrjen apo zbulimin e diçkaje që është e lejuar. Në ajetin për të cilin po flasim, ka kuptimin e ndarjes, ose të shoshitjes së punëve të mira dhe të liga.

Punë që janë të fshehura brenda zemrave të njerëzve, qofshin këto prej të mirave, si: besimi, devotshmëria, cilësitë e mira, nijetet e mira apo të liga. Të gjitha këto, në atë ditë do të dalin sheshit, ku secili do të marrë shpërblimin apo ndëshkimin e tyre.

Në ajetin 9 të sures "Et Târik", thuhet: **"Në ditën ku do të shfaqen ato çka janë të fshehura."**.

Fjala *"jeumeidhin"* mbështetet te kuptimi i faktit se në atë ditë, All'llahu është në dijeni të veprave dhe të së fshehtës, që njeriu mendon se nuk e di kush të fshehtën, por Zoti i Madhëruar është gjithmonë në dijeni të veprave dhe qëllimeve tona. Ndaj dhe atë ditë e quajnë Dita e dhënies së llogarisë. Të gjithë do të japin llogari, sipas veprave dhe besimit.

Sipas mendimit të disa komentuesve, ky interpretim ngjan me një person që të kërcënon, duke i thënë "së shpejti do të arrij edhe te ti".

Në të vërtetë, ka për qëllim që së shpejti do të të dënoj dhe do ta shikosh përfundimin tënd.

All'llahu është gjithmonë në dijeni të veprave dhe të punëve tona. Dija e Tij është e gjithanshme. Në Ditën e Kiametit, do të qartësohet se kush do të marrë shpërblim dhe kush do të dënohet. Për njeriun është paralajmërim që të zgjohet dhe, nëse ka besim, në atë ditë, para tyre do të shfaqet një digë e madhe, ku në një anë qëndrojnë mëkatet e fshehta dhe të dukshme, kurse në anën tjetër, ndikimi edukativ, që në atë ditë nuk ka për të qëndruar i fshehtë për asnjë njeri.

Hulumtime

1- Lidhja dhe marrëdhënia që kanë këto betime me qëllimet e tyre

Ndër pyetjet që lindin për këtë sure, është lidhja dhe marrëdhënia midis betimeve dhe kuajve të xhihadistëve (luftëtarëve) në fjalinë: **"se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet",** duke u bazuar te ajetet e Kur'anit, ekziston një shoqërim dhe lidhje midis ajeteve dhe betimeve, si dhe betuesi ndaj asaj që është betuar. Elekuenca dhe lartësia e të shprehurit të Kur'anit e ka një gjë të tillë. Ajetet që diskutuam, mund të kenë edhe një lidhje të tillë, që Kur'ani thotë: "Do të gjenden njerëz që janë bamirës, që në Rrugën e All'llahut do të luftojnë, pa pasur

asnjë pretendim. Ata çdo gjë do ta japin në Rrugën e All'llahut. Në këto kushte, si mundet që disa prej tyre të jenë koprracë dhe nuk falënderojnë për mirësinë e All'llahut? Përse nuk janë bujarë në Rrugën e All'llahut?

Është e vërtetë që betimi është bërë për kuajt, por ne e dimë rëndësinë që ata kanë, ata janë mjet për luftëtarët. Në të vërtetë, betimi është për luftëtarët në Rrugën e All'llahut. (Gjithashtu, edhe nëse betimi është për devetë e haxhinjve dhe vizituesve të Shtëpisë së All'llahut, ka po të njëjtin kuptim.)

Të tjerë komentues janë të mendimit se lidhja që shkaktohet midis tyre, pra, midis kafshës dhe njeriut që do ta kalërojë atë, është e fortë, pasi të dy, ecin me shpejtësi drejt së vërtetës dhe Rrugës së Drejtë. Pra, ti o njeri! Pse nuk bindesh? Pse nuk i dorëzohesh All'llahut, t'i që je krijesa më e mirë dhe ke përparësi më të madhe se të gjitha krijesat e tjera?!

Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

2- Njeriu, nga natyra, është koprrac

Ka persona, që fjalinë: "se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet," e përdorin për të treguar se njeriu është koprrac dhe nuk falënderon për ato që i janë dhënë. Më tej lind pyetja: Si mund të jetë e përshtatshme dhe e perceptueshme një gjë e tillë, kur ne ftohemi të jemi falënderues dhe bujarë?

Në shumë ajete të Kur'anit, jepet e njëjta situatë me këtë pyetje, ku njeriun e përshkruan të dobët dhe me mangësi.

Në disa vende, njeriu përshkruhet si dhunues dhe injorant.[1]

Në një tjetër, përshkruhet me pak kapacitet.[2]

Në një tjetër vend, e përshkruan si të zhgënjyer dhe jo falënderues.[3]

Në vende të tjera, atë e përshkruan si tiran.[4]

Në të vërtetë, të gjitha këto që u thanë, janë në natyrën e njeriut. Edhe pse Kur'ani vërteton se bijtë e Ademit i ka nderuar dhe i ka respektuar ndaj të gjithë krijesave, duke e përzgjedhur dhe duke i falur atij moralin më të mirë: **"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar."**.

Përgjigjja e kësaj pyetje qartësohet me një shpjegim dhe ai është se njeriu ka dy dimensione. Për këtë shkak mund të arrijë shkallën më të lartë dhe mund të bjerë më poshtë se kafshët.

Nëse njeriu edukohet me edukues hyjnor dhe përdor arsyen e tij, atëherë do të jetë prej të mirëve dhe të përzgjedhurve.

Por nëse njeriu do t'u kthejë krahët këtyre dhe nuk do të ketë punë me besimin dhe me moralin e pastër, atëherë ai njeri do të jetë arrogant, koprrac, jo besimtar etj.

---

[1] Sure "El Ahzâb", ajeti 72.
[2] Sure "El Me'ârixh", ajeti 19.
[3] Sure "Hûd", ajeti 9.
[4] Sure "El 'Alak", ajeti 6.

Në këtë rast, midis ajeteve nuk do të ketë asnjë lloj përplasje, sepse secili prej ajeteve e shikon njeriun sipas dimensionit të tij.

Në brendësi të natyrës së njeriut janë mbjellë rrënjët e të gjithë të mirave, krenaritë e cilësitë, ashtu sikurse njeriu duhet të ketë përgatitje për të kundërtën e këtyre mirësive dhe cilësive. Ndaj asnjë krijesë në këtë botë nuk do të kishte kaq largësi me harkun ngjitës dhe Shpalljen.

3- Madhështia e xhihadit

Në Kur'anin e Shenjtë është folur shumë për çështjen e xhihadit dhe madhështinë e tij në Rrugën e All'llahut. Por ndoshta askund nuk është cituar me kaq madhështi kjo çështje, sa edhe frymëmarrja e kuajve të jetë përmendur. Gjithashtu, asgjëkund nuk është folur për shkëndijat dhe xixat që ata lëshojnë. Tymi dhe pluhuri që krijohet për shkak të ecjes së tyre nuk përmendet. Në këtë sure është cituar me shumë madhështi, saqë betimet janë për to.

Veçanërisht, shpejtësia e tyre që është një ndër shkaqet e fitores. Gjithashtu, flitet për befasinë, e cila është një tjetër shkak i fitores.

Të gjitha këto janë mësime të xhihadit.

Ajo që tërheq vëmendjen në shkakun e zbritjes së sures, se Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, urdhëroi të shalohen kuajt natën dhe të përgatiten plotësisht. Kur errësira u thye, fali namaz me shokët dhe me shpejtësi u nis drejt armikut për ta sulmuar. Kur

armiqtë u zgjuan, panë se janë të lidhur dhe janë në duar të luftëtarëve islamë.

Ky sulm i shpejtë dhe i papritur bëri që të ketë pak të vrarë dhe beteja të përfundojë brenda disa orëve. Është e habitshme se të gjitha këto janë cituar në mënyrë të përsosur në ajetet e kësaj sureje.

Është e pamundur, se si kali ka të tilla cilësi dhe si çështja e shkëndijave që lindin si pasojë e përplasjes së këmbëve të kuajve nëpër gur, dhe si dheu e pluhuri që ata ngrenë. Ajo çka është e rëndësishme dhe përbën temë diskutimi, është çështja e xhihadit dhe më pas mjetet e tij. Të gjitha mjetet e luftërave të ditëve të sotme përfshihen në të.

Gjithashtu, në ajetin 60 të sures "El Enfal" flitet për kuajt, të gjitha këto janë cituar në mënyrë të përgjithshme.

O All'llah, ne jep mundësinë e xhihadit dhe të bujarisë në Rrugën dhe kënaqësinë Tënde!

O All'llah! Bëj që egoja e mosbesimit të jetë larg nesh!

O All'llah! Ti je në dijeni të çdo sekreti që ne mbartim në zemrat tona, të lutemi të sillesh me butësi ndaj nesh!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El 'Âdijât"

Sure "El Kâri'atu"

Zbritur në Mekë

Ajete 11

Përmbajtja e sures "El Kâri'atu"

Kjo sure flet në mënyrë të përgjithshme për Ringjalljen. Fjalitë dhe fjalët e përdorura në ajetet e kësaj sureje, janë rrëqethëse dhe goditëse, bëjnë që njeriu të reagojë. Gjithashtu, njeriu këshillohet në mënyrë të qartë dhe të shpejtë.

Më pas, si përfundim, i ndan njerëzit në dy grupe: një grup që veprat e tyre janë të rënda në peshoren hyjnore, si dhe shpërblimet e tyre janë të gjithanshme, kanë kënaqësinë, mirësinë dhe mëshirën e All'llahut.

Veprat e grupit tjetër janë të lehta, peshojnë pak. Ata kanë si ndëshkim Xhehennemin, zjarrin e nxehtë dhe përvëlues.

Emri i kësaj sureje është "Kâri'atu" dhe është marrë nga ajeti i parë i sures.

Mirësitë e leximit të sures "El Kâri'atu"

Për mirësitë e leximit të sures "El Kâri'atu" është i mjaftueshëm vetëm hadithi i Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"Ai që lexon suren 'El Kâri'atu', All'llahu i Madhëruar e ruan atë nga fitneja e Dexhalit, si dhe nga besimi ndaj tij. E mban larg qelbit të Xhehennemit."*.[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 530.

Ajetet 1 - 11

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿الْقَارِعَةُ١ مَا الْقَارِعَةُ٢ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ٣ يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ٤ وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنْفُوشِ٥ فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ٦ فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ٧ وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ٨ فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ٩ وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَهْ١٠ نَارٌ حَامِيَةٌ١١﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Gjëmimi i tmerrshëm!"

"Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm?"

"Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?"

"Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara,"

"Kurse malet si leshi i shprishur."

"Sa i përket atij, veprat e (mira të) **të cilit do të rëndojnë në peshore,"**

"Ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhennet)**."**

"E sa i përket atij, veprat e (mira të) **të cilit nuk do të rëndojnë në peshore,"**

"Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehennemit)**."**

"Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehennemit)**?"**

"Ajo është një Zjarr i vrullshëm."

Komentimi

Ndodhia e Gjëmimit

Te këto ajete që përshkruhet Kiameti, së pari, thuhet: **"Gjëmimi i tmerrshëm! Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm? Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?"**.

Fjala *"el kariatu"* vjen nga rrënja e fjalës *"el kar'atu"* dhe ka kuptimin: *përplasje e një diçkaje me një diçka tjetër*. Përplasja është e tillë, saqë për shkak të saj, dëgjohet një zhurmë e madhe.

Edhe çekiçit i thonë *"el mikra'atu"*, sepse godet dhe përplaset. Gjithashtu, çfarëdolloj ngjarje të rëndësishme dhe të vështirë e quajnë *"el kari'atu"*.

Mundësia tjetër e pranisë së kësaj shkronje, është sepse i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "E çfarë di ti se ç'është ngjarja e vështirë dhe tronditëse?". Në këtë mënyrë qartësohet fakti se kjo ngjarje është aq shumë tronditëse, sa askush nuk mundet ta përshkruajë.

Shumë komentues kanë thënë se *"el karia'atu"* është një prej emrave të Kiametit, por nuk e kanë qartësuar, nëse ky interpretim flet për përgatitjen për Kiamet, sepse kjo botë do të goditet, dielli dhe hëna do të errësohen, detet do të shpërthejnë, atëherë nëse është kështu, përzgjedhja e emrit të kësaj sureje për këtë ngjarje, është arsye e qartë.

Mund të ketë si shkak edhe stadin e dytë, ringjalljen e të vdekurve dhe një program të ri në botën universale. Interpretimi me fjalën *"goditje"* është për shkak se në atë ditë zemrat goditen nga frika, tmerri dhe trishtimi.

Ajetet që kanë ardhur më pas, kanë pasur disi ngjashmëri me ngjarjen e shkatërrimit të botës. Disa ajete të tjera kanë ngjashmëri me ajetet e ringjalljes së të vdekurve. Por nëse i konceptojmë si një trup i vetëm, shikojmë se mendimi i parë është më i përshtatshëm, edhe pse në këto ajete të dy ngjarjet janë të përmendura njëra pas tjetrës (sikurse shumë ajete të tjera të Kur'anit që flasin për Kiametin).

Më tej, duke shpjeguar atë Ditë të Madhe dhe të çuditshme, thotë: **"Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara."**.

Fjala *"el ferash"* është shumësi i fjalës *"ferashetu"*. Shumë komentues atë e kanë komentuar dhe e kanë marrë me kuptimin *"flutur"*. Disa e kanë marrë me kuptimin *"karkalec"*. Edhe kuptimi i

jashtëm i këtij ajeti mund të komentohet nga ajeti shtatë i sures "El Kamer", që njerëzit i krahason me karkalecat e shpërndarë, sepse kuptimi i fjalës, sipas fjalorit, është *"flutur"*.

Sido që të jetë, krahasimi i bërë me *"fluturën"*, është sepse fluturat, zakonisht, hidhen si të çmendura në zjarr dhe digjen. Gjithashtu, edhe punëkëqijtë e hedhin veten e tyre në zjarrin e Xhehennemit.

Ky koment është i mundshëm, sepse krahasimi i bërë me "fluturën" flet për një moment të veçantë, sikurse është habia dhe të folurit përçart, që në atë ditë përfshin të gjithë njerëzit.

Edhe nëse fjala *"el ferash"* do të ishte me kuptimin "*karkalecat*", është një krahasim i lartpërmendur, sepse shumë shpendë, kur duan të nisen në ndonjë vend të caktuar, udhëtojnë në grup, përveç karkalecave. Ata nuk ndjekin në grup një rrugë të caktuar, por secili lëviz për hesap të tij.

Lind dhe një tjetër pyetje tjetër: Kjo endje dhe habi, tmerri dhe frika në atë ditë, është për shkak të ngjarjes së tmerrshme të asaj dite, pra, fundit të botës apo të fillimit të Kiametit?

Përgjigjja e kësaj pyetje bëhet e qartë me atë që u tha më lart.

Më tej All'llahu i Madhëruar flet për disa cilësi të tjera të asaj dite: **"Kurse malet si leshi i shprishur."**.

Fjala *"ihni"* ka kuptimin: *lesh i ngjyrosur*. Fjala *"el menfuush"* vjen nga rrënja e fjalës *"nefeshe"*, me kuptimin: *zhvillim i leshit*. Zakonisht leshi shpupuritet me mjete të veçanta.

Më lart thamë se sipas ajeteve të ndryshme të Kur'anit, malet janë të parët që lëvizin në atë ditë, më tej përplasen me njëri-tjetrin dhe bëhen shkrumb dhe hi, kështu si përfundim, malet e bëra shkrumb dhe hi ngrihen në qiell. Në ajetin që diskutuam, ato i krahasojnë me leshin e shpupuritur. Leshi i shpupuritur do të ecë me një erë të fortë dhe prej tij, vetëm ngjyra do të shihet. Kjo do të jetë faza e fundit e shkrirjes së maleve.

Ky interpretim mundet të flasë për ngjyrat e ndryshme të maleve, sepse malet mbi tokë kanë ngjyra të ndryshme.

Sidoqoftë, kjo fjali dëshmon se ajetet e mësipërme flasin për stadin e parë të Kiametit, pra, për stadin e shkatërrimit dhe të shembjes se botës.

Më pas flet për stadin e ringjalljes së të vdekurve, si dhe ndarjen e tyre në dy grupe. Atyre që veprat e tyre të mira u peshojnë më shumë, do të kenë një jetë të kënaqshme: **"Sa i përket atij, veprat e** (mira të) **të cilit do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë një jetë të kënaqur** (në Xhennet)**."**.

Grupi tjetër, që nuk i rëndojnë veprat e mira, do të ketë si vendbanim Xhehennemin: **"E sa i përket atij, veprat e** (mira të) **të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë si strehim Humnerën** (e Xhehennemit).[1] **Kush mund të ta shpjegojë ty se**

[1] **"Ai do të ketë si strehim Humnerën"**: fjalë për fjalë: "Ai do të ketë për nënë Humnerën". Në gjuhën arabe, fjalët "*umm"* dhe "*ebu" (nënë* dhe *baba)* përdoren edhe për të treguar origjinën e diçkaje dhe përkatësinë e tij absolute. Në këtë rast, fjala "*umm"* – *"nënë"* shpreh konceptin se njerëzit e mallkuar do të kenë për strehë *Hâuija*-n – *Humnerën e Xhehenemit*.

ç'është Humnera (e Xhehennemit)**? Ajo është një Zjarr i vrullshëm."**.

Fjala "*el meuazinu"* është shumësi i fjalës "*el mijzanu"* dhe ka kuptimin: *mjet peshe*. Kjo fjalë në fillim është përdorur për peshat materiale, por më pas kjo fjalë u përdor edhe për matjen dhe peshën e veprave shpirtërore.

Disa komentues besojnë se veprat e njeriut në atë ditë vijnë në formën e trupit, që të mund të peshohen. Me të vërtetë, ato peshohen me peshoren e veprave.

Gjithashtu, është dhënë edhe një tjetër mundësi komentimi, që peshohet edhe vetë libri i veprave. Nëse në të ka vepra të mira, ajo është e rëndë e, nëse jo, ajo është e lehtë, ose pa peshë fare.

Po mesa vërehet, nuk ka nevojë për këto justifikime, sepse fjala "*mijzan"* ka kuptimin *peshore* dhe nuk cilësohet vetëm për një lloj të veçantë peshoreje, por përfshin të gjitha llojet e peshoreve.

Në një hadith lexojmë: "*Prijësi i besimtarëv dhe Imamët e tjerë janë peshoret që peshojnë."*.[1]

Kur e pyetën Imam Sadikun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për kuptimin e peshores, ai u përgjigj: "*Peshorja është vetë drejtësia."*.[2]

Në këtë mënyrë, ekzistenca e ligjeve të drejtësisë hyjnore dhe e personave të drejtë, janë krahasime që njerëzit ua atribuojnë

[1] "Biharul Enuar", vëll. 7, f. 251.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 5.

veprave të tyre. Pra, pesha e tyre është në sasinë dhe masën që ata mund ta krahasojnë me të ngjashmen e saj.

Është e qartë se kuptimi i peshës së lehtë apo të rëndë nuk ka të bëjë me peshën e vetë peshores, por ka të bëjë me vetë peshën e gjërave që me to peshojmë.

Gjithashtu, interpretimi i fjalës *"meuazin"*, në këtë rast, është cilësuar në numrin shumës, është për shkak se evlijatë e vërtetë dhe ligjet hyjnore janë vetë një prej peshoreve.

Nga e kaluara, ndryshueshmëria e cilësive dhe veprat e njeriut kërkojnë që secila prej tyre të peshohet me peshore, po ashtu shembujt dhe peshoret e peshës të jenë të ndryshme.

Ragibi në veprën e tij "Mufredat" thotë se fjala *"mijzan"* në Kur'anin e Shenjtë, ndonjëherë përdoret në numrin njëjës dhe ndonjëherë në numrin shumës. Në rastin e parë flet për personin që merr në llogari, që është All'llahu Një, ndërsa në rastin e dytë ka për qëllim dëgjuesit.

Disa komentues kanë thënë se fjala *"meuazin"* është shumësi i fjalës *"muzun"* dhe ka kuptimin: *vepër që peshohet*, ndaj të qenit i rëndë apo i lehtë në peshë, ka kuptimin e të qenit i rëndë apo i lehtë i veprave dhe jo i sasisë së kilogramëve, peshës.[1]

[1] Këtë kuptim e ka cituar Zameksheri në komentimin "Kesh'shaf", ndërsa Fakhru Rrazij e ka komentuar në tefsirin "Kebijr". Abul Fettuh Rrazij e ka cituar në komentimin e tij si temë që fjala *"meuazin"* – *"peshoret"* ka një apo dy kuptime.

Sigurisht që përfundimi i të dyjave është një, por nga anë apo mënyra të ndryshme.[1]

Interpretimi i fjalës me *"isheten raadijeh"* – *"jetë e kënaqshme"* është shumë tërheqës, i cili e arrin kuptimin për jetën me plot mirësi dhe me plot qetësi të banorëve të Xhennetit, në Ditën e Kiametit. Ajo jetë është aq e kënaqshme dhe tërheqëse, saqë duket sikur vetë jeta është e kënaqur. Ndaj thuhet *"merdije"*, për të theksuar më shumë kohën e shkuar se sa të tashmen.[2]

E gjithë kjo mirësi e madhe është e veçantë për jetën e Ahiretit, Botës së Përtejme, sepse jeta e kësaj bote, sado e begatë e me mirësi të jetë apo sado e sigurt dhe e kënaqshme të jetë, përsëri në të gjenden shkaqe pakënaqësie.

Jeta në Ahiret përmbush të gjitha kënaqësitë, pëlqimet, qetësinë, sigurinë dhe popullata është e sigurt.

Fjala *"umm"*, në fjalinë: *"Fe ummehu hauijun"*, ka kuptimin: *nënë*. Ne e dimë se nëna është vendmbrojtja për fëmijën e saj, fëmija mbështetet te nëna, kur është në vështirësi, si dhe qëndron pranë saj. Edhe në këtë rast, flet për faktin që këta mëkatarë, që në peshoren e tyre nuk kanë tjetër veç mëkatit, kanë si vendmbrojtje zjarrin e Xhehennemit. Mjerë për ata që kanë Xhehennemin si vendprehje e mbrojtje!

[1] Në këtë fushë është folur dhe është komentuar në vazhdim të ajeteve 8-9 të sures "El A'râf", vëll. 6, f. 90; në vazhdim të ajetit 105 të sures "El Kehf", vëll. 12, f. 567; në vazhdim të ajetit 102 të sures "El Mu'miûn", vëll. 14, f. 328.

[2] Disa, fjalën *"radijetun,* e marrin me kuptimin *"qenie e kënaqur"*, ose në të kundërt, e marrin me kuptimin: *kënaqësia e pronarëve të tyre*. Komentimi i cituar më lart, është më i përshtatshëm.

Disa të tjerë thanë se kuptimi i fjalës *"umm"*, në këtë rast, ka për qëllim të tregojë *"megz"* – *"trurin"*, sepse arabët, trurit të kokës i thonë *"ummul r'es"*, prandaj kuptimi i ajetit bëhet: "Ata i hedhin (i fusin) në Xhehennem me kokë". Por ky mendim është i dobët, sepse ajeti në vazhdim: **"E çfarë di ti se ç'është ajo?",** nuk do të kishte kuptim të rregullt.

Fjala *"hauije"* vjen nga rrënja e fjalës *"huvije"*, me kuptimin: *rënë* apo *rrëzuar*. Ky është një prej emrave të Xhehennemit, sepse mëkatarët bien në të, rrëzohen, hidhen në të. Po ashtu është shenjë treguese, për sa i përket thellësisë së Xhehennemit.

Nëse fjalën *"umm"*, në këtë rast, e marrim me kuptimin *"tru"*, atëherë fjalën *"hauije"* do ta marrim me kuptimin *"rënie"*. Komentimi i parë është më i drejtë dhe më i përshtatshëm.

Fjala *"hamijetun"* vjen nga rrënja e fjalës *"hema"* dhe ka kuptimin: *forcë e nxehtësisë*. Fjala *"hamijetun"*, në këtë rast, tregon nxehtësinë e jashtëzakonshme të zjarrit të Xhehennemit. Sidoqoftë, kjo fjali pyet se çfarë di ti se ç'është "hauije"?

Hauije është zjarr djegës, përvëlues. Kjo thekson faktin se dënimi i Kiametit dhe i zjarrit të Xhehennemit është gjë e pakonceptueshme për të gjithë njerëzit.

Hulumtim

Mjetet e rënda të peshores së veprave

Pa dyshim që vlera e të gjitha punëve të mira dhe e mirësive nuk është e njëjtë. Ato ndryshojnë shumë nga njëra–tjetra. Në transmetime të ndryshme të fesë islame, është folur për veprat e mira. Për to flitet shumë dhe konsiderohen si mjetet e rënda të peshores së Ditës së Kiametit.

Gjithashtu, ndër të tjera, kemi hadithin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që thotë: "Komenti i fjalës: 'La Ilahe Ilall'llah', tregon Njëshmërinë e All'llahut dhe asnjë vepër nuk pranohet pa këtë fjalë. Kjo fjalë është devotshmëri që rëndon peshoren e veprave në Ditën e Kiametit.[1]

Në një hadith tjerër të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për sa i përket Njëshmërisë së All'llahut dhe profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Peshorja e peshave që merret si thënia e shehadetit, është e lehtë në vetvete, por, kur në të vihet shehadeti, dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Zotit Një, atëherë ajo rëndohet.*".[2]

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* apo të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Në peshoren e*

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 12, f. 659.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 8, f. 659.

veprave, nuk ka gjë më të rëndë se sa të dërgosh salavate për Muhammedin dhe familjen e tij.".

Në vazhdim të transmetimit, thotë: "*Ka persona që, në Ditën e Kiametit, janë të vendosur në peshoren e veprave të tyre, veprat e tyre janë të lehta. Ata më pas dërgojnë salavat për Muhammedin dhe familjen e tij. Më pas veprat e tyre rëndohen.*".[1]

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Kushdo që pamjen e jashtme e ka më të mirë se sa brenda vetes, në Kiamet veprat e tij do të jenë të lehta.*".[2]

Këtë diskutim do ta mbyllim me një përmbledhje të shkurtër të fjalëve të Selman Farsiut, që në të vërtetë, është përmbledhje e Shpalljes dhe e Sunetit: "Dikush, për të ofenduar Selman Farsin, i tha: 'Kush je ti? Dhe çfarë je? Nuk ke vlerë ti?'".

- Unë e ti, të dy, kemi qenë vetëm një spermë e pisët. Fundi im dhe yt nuk do të jetë tjetër vetëm se vdekja. Në kohën që do të vijë Kiameti dhe do të vihen në peshore veprat tona, ai që do të ketë më tepër vepra të mira (të rënda), do të jetë zotëri. Kush ka vepra të lehta (të këqija) në peshoren e tij, ai do të jetë i nënçmuar dhe i lig, - iu përgjigj Selmani.[3]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 7, f. 659.
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 13, f. 660.
[3] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 14, f. 660.

O All'llah! Rëndoje peshoren e veprave tona me dashurinë për Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)!

O All'llah! Të futesh në rrugën e vepërmirëvve, nuk arrihet vetëm se me mirësinë dhe dashurinë Tënde. Na ndihmo në këtë rrugë!

O All'llah! Zjarri i Xhehennemit është përvëlues. Ne nuk e kemi fuqinë për ta duruar. Na e shuaj zjarrin e Xhehennemit me ujin e mëshirës Tënde, o All'llah!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Kâri'atu".

Sure "Et Tekâthur"

Zbritur në Mekë

Ajete 8

Përmbajta e sures “Et Tekâthur”

Shumë komentues besojnë se kjo sure ka zbritur në Mekë. Prandaj edhe çështja që trajtohet në këtë sure, ka të bëjë më fisin e kurejshve, të cilët mburreshin dhe lavdëroheshin me njëri-tjetrin se kush është më i miri ndaj tjetrit.

Disa komentues të tjerë, midis tyre edhe i ndjeri Tabarsi në veprën “Mexhmaul Bejan”, besojnë se kjo sure ka zbritur në Medine. Për sa i përket çështjes së mburrjes që flet surja, i ndjeri mendon se ka të bëjë me jehudët, ose me dy fise prej ensarëve.

Por duke u bazuar në ngjashmërinë që kjo sure ka me suret e tjera mekase, është më e drejtë që kjo sure të konsiderohet si mekase.

Surja, së pari, flet për rivalitetin e personave, për ofendimet dhe fyerjet që i bëjnë njëri–tjetrit, për shkak të mendjemadhësisë.

Më pas flitet për çështjen e Ringjalljes, të Kiametit dhe të zjarrit të Xhehennemit.

Në përfundim, nëpërmjet pyetjeve rikujton dhe paralajmëron për mirësitë që All’llahu na ka dhënë.

Emri i kësaj sureje është marrë nga ajeti i parë i saj.

Mirësitë e leximit të sures "Et Tekâthur"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për mirësitë e leximit të kësaj sureje, ka thënë: "*Kushdo që e lexon këtë sure, All'llahu nuk do ta marrë në llogari për mirësitë që i ka dhënë në këtë botë, si dhe do ta shpërblejë më shpërblimin sikur të ketë lexuar një mijë ajete.*".[1]

Gjithashtu, kemi një hadith tjetër të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, që thotë: "*Leximi i kësaj sureje në namazet e detyruara dhe nafile ka mirësinë dhe sevapet e martirit.*".[2]

Natyrisht, leximi i sures duhet të jetë së bashku me veprën, pra, ai që e lexon, duhet ta praktikojë atë, për të marrë shpërblimin dhe mirësitë që u thanë më lart.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 532.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 532, (me shumë shkurtime).

Ajetet 1- 8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿أَلْهَاكُمُ التَّكَاثُرُ١ حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ٢ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ٣ ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ٤ كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ٥ لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ٦ ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ٧ ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ٨﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar,"

"Derisa të shkoni në varre."

"Gjithsesi, do ta merrni vesh!"

"Madje, së shpejti do ta merrni vesh!"

"Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!"

"Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!"

"Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë."

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)**!"**

Shkaku i zbritjes

Sikurse edhe e cituam, komentuesit janë të mendimit se shkaku i zbritjes së sures janë fiset që kishin rivalitet me njëri-tjetrin. Këtë gjë e bënin duke u mburrur me gjërat që kishin, si mallra materiale, që nga kafshët, fëmijët e farefisin. Kishte arritur puna deri aty, saqë shkonin edhe nëpër varreza, për të numëruar farefisin, për të treguar se kush ka më shumë farefis.

Disa komentues janë të mendimit se ka të bëjë më fisin e kurejshëve, në Mekë. Të tjerë janë të mendimit se ka të bëjë me dy fise, një nga fisi i ensarëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Medine, ndërsa disa të tjerë kanë mendimin se ka të bëjë me mburrjet e disa jehudive ndaj të tjerëve. Kjo sure duket se është më e drejtë të jetë mekase.

Sigurisht që shkaku i zbritjes nuk e kushtëzon asnjëherë kuptimin e ajetit.

Komentimi

Sprova e të pasurit shumë dhe e të krekosurit

Në këto ajete, në radhë të parë, flitet për mendjemadhësinë dhe konkurrencën midis njëri–tjetrit. All'llahu, me një citim shumë melodios, u kujton njerëzve që i ka pushtuar krenaria e

mendjemadhësia dhe kanë harruar se ka Zot e Kiamet: **"Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar."**.

Aq shumë janë hutuar në rivalitetin e tyre, saqë shkuan të numëronin edhe të vdekurit: **"Derisa të shkoni në varre."**.

Ka edhe një mendim tjetër për komentimin e ajetit: hutia, përhumbja dhe mendjemadhësia e tyre ishte aq e madhe, saqë konkurronin midis njëri-tjetrit edhe me të vdekurit.

Kuptimi i parë, me interpretimin e "**Derisa të shkoni në varre."**, dhe gjithashtu shkaku i zbritjes dhe hytbeja e Imam Aliut në "Nehxhul Belaga", të cilën do ta sjellim më poshtë, në dashtë All'llahu, është më i përshtatshëm.

Fjala *"el hakumu"* rrjedh nga rrënja e fjalës *"el lehvu"*, me kuptimin: *të jesh i zënë me punë të vogla dhe të mbetesh larg nga qëllimi dhe punët e rëndësishme*.

Ragibi në veprën "Mufredat" thotë: *"Lehvu"* është diçka që e huton njeriun dhe e mban larg qëllimit që ai ka.

Fjala *"tekathur"* vjen nga rrënja e fjalës *"kethret"*, me kuptimin: *mendjemadhësi, vetëkënaqësi, krenari ndaj njëri-tjetrit*.[1]

Fjala *"zurtum"* vjen nga rrënja e fjalës *"zejaretun"* dhe *"zeuere"*. Në origjinal ka kuptimin: *kraharor*. Më pas është përdorur me kuptimin: *takim* ose *përballim*.

[1] Fjala *"tekathur"*, në gjuhën perse, ka kuptimin: pasuri (mbledhje e pasurisë), ndërkohë që në rrënjë nuk ka këtë kuptim, por në disa transmetime që do t'i citojmë më pas, është përdorur me këtë kuptim.

Fjala *"zeuer"* ka kuptimin: *shtrembërim i pjesës së kraharorit*. Edhe gënjeshtra është prej llojit të devijimit nga e vërteta, ndaj edhe është përdourur fjala *"zuver"*.

Fjala *"mekabir"* është shumësi i fjalës *"mekbereh"* dhe ka kuptimin e vendit të varrit të të vdekurit dhe të vizitës së varreve, në këtë rast.

Gjithashtu, ka kuptimin: *vdekje* (sipas mendimit të disa komentuesve), ose ka kuptimin: *të shkosh pranë varrit, për të numëruar dhe për të shitur mend* (sipas mendimit të shumë komentuesve).

Sikurse edhe thamë, kuptimi i dytë është më i drejtë. Një nga dëshmitë e saj është fjala e prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, e cituar në "Nehxhul Belaga": *"Për ironi! Sa qëllim i largët! Sa vizitor të pavëmendshëm! Sa krenari fiktive dhe skandaloze!*

Po kujtojnë kockat e atyre që shumë vite më parë janë varrosur, e çfarë të kujtuarit!? Me këtë distancë të largët, po kujtojnë persona që për ta nuk kanë asnjë vlerë. A nuk ke vajtur deri më tani në ndonjë vend, që të shikosh se si krenohen me baballarët e tyre? Ose që numërojnë të vdekurit e tyre? Ata pretendojnë se trupat e tyre do të kthehen, trupa që janë në errësirë dhe të shqyer, lëvizjet e tyre janë vënë në gjumë. Këta trupa të kalbur, nëse do të ishin burim edukimi, do të ishte mirë që të krenohej për to!".[1]

Ajo çka sollëm më lart, është një pjesë e hytbes së Imam *Aliut (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Aq rrëqethëse është kjo hytbe, saqë Ibn Ebil Hadid Mu'tezeli thotë: "Betohem në atë që të gjithë popujt

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbeja e 221.

betohen në të, (betohem në Zot) se unë këtë hytbe e kam lexuar më shumë se një mijë herë. Sa herë që e lexoja këtë hytbe, zemrën time e përshkonte frika e madhe. Për mua, e gjithë hytbeja, ishte mësimdhënëse dhe edukative. Në shpirt dhe në gjithë pjesët e trupit tim, ato fjalë më bënin të dridhesha. Nuk ka ndodhur asnjëherë që ato fjalë të mos më kujtojnë vdekjen e të afërmve, shokëve dhe miqve, e të mos mendoj se unë jam sikur Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka këshilluar.

Është folur shumë për këtë gjë, unë kam dëgjuar, i kam vënë veshin fjalëve të tyre, por nuk më ka mbetur në mendje dhe nuk ka ndikuar tek unë ashtu sikurse fjala e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Ky ndikim i fjalëve të tij në zemrën time, ndoshta buron dhe është nga besimi që ka vetë Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, ose nga nijeti, ose nga sinqeriteti i tij".[1]

Ai, në një tjetër fjalim të tij, thotë: "Do të ishte mirë që të gjithë elokuentët arabë të mblidheshin e të lexohej për ta kjo hytbe. Për elokuencën e Prijësit të besimtarëve *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, citon edhe fjalën e Muavijës: "Për All'llahun, nuk e ka themeluar kush tjetër elokuencën për kurejshët përveç tij".

Kur'ani, në ajetin tjetër, i kërcënon ata me këtë fjali: **"Gjithsesi, do ta merrni vesh!"**.

Nuk është ashtu sikurse ju mendoni, apo që shisni mend. Ju shumë shpejt do të merrni rezultatin e mendjemadhësisë dhe të lavdërimit tuaj.

[1] "Sherhul Nehxhul Belaga ibn Ebil Hadid", vëll. 11, f. 150.

Më pas, për të theksuar edhe një herë këtë gjë, thotë se nuk është kështu si mendoni ju. Shumë shpejt do ta mësoni: **"Madje, së shpejti do ta merrni vesh!"**.

Disa komentues, këto dy ajete i kanë konsideruar si përsëritje të një çështjeje, pra, të dy ajetet flasin për dënimin që këta arrogantë mendjemëdhenj do kenë, të cilët mburren me atë që kanë. Disa komentues të tjerë, ajetin 3 e komentojnë si dënim të varrit, që njeriu do të përballet me të pas vdekjes, ndërsa ajetin 4 e komentojnë si dënimin e Ditës së Kiametit.

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: Një grup prej nesh ishin në dyshim për sa i përket dënimit të varrit, derisa zbriti surja "El hakumu tekathur"që sqaroi dyshimin që ne kishim. Deri aty ku citohet **"Gjithsesi, do ta merrni vesh!"**, pra, ka për qëllim dënimin e varrit, më tej vjen ajeti tjetër që thotë: **"Madje, së shpejti do ta merrni vesh!"** ajeti ka për qëllim dënimin e Ditës së Kiametit.[1]

Në tefsirin "Kebijr" të Fakhru Rrazit, lexojmë se kjo çështje i është cituar një prej shokëve të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, me emrin Zurben Hubejsh që thotë: "Ne kishim dyshim për sa i përket dënimit të varrit, derisa dëgjuam Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* të thotë: *'Ky ajet është argument për dënimin e varrit.'"*.[2]

Më pas thotë: "Nuk është ashtu sikurse mendjemëdhenjtë mendojnë. Nëse ju do të kishit besim apo bindje për Ahiretin, do ta kuptonit dhe nuk do t'i kryenit këto gjëra, nuk do krenoheshit e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 534.
[2] Tefsiri i Fakhru Raziut, vëll. 32, f. 78.

nuk do të mburreshit për gjëra fiktive”.**“Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!”**

Përsëri, për të theksuar dhe për të paralajmëruar më shumë, thotë se ju, patjetër, do ta shikoni Xhehennemin: **“Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!”**.

Më pas, si të futen në të, do të jenë plotësisht të bindur: **“Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë.”**.

Në atë ditë, të gjithë ju do të pyeteni për të gjithë mirësitë që keni pasur: **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë** (e kësaj bote)**!”**.

Në atë ditë do të qartësohet se si i keni shpenzuar, në ç’mënyrë i keni përdorur këto mirësi të dhuruara nga All’llahu: i jeni bindur Krijuesit apo mirësitë i keni çuar dëm dhe nuk e keni shlyer hakun e tyre.

Hulumtime

Burimi i krenarisë dhe arrogancës

Ajetet e mësipërme na bëjnë të kuptojmë se një ndër shkaqet kryesore të mendjemadhësisë është krenaria, pra, vetë injoranca dhe padituria, në lidhje me shpërblimin dhe mosbesimin për Ditën e Ringjalljes.

Këto, përveç injorancës së njeriut ndaj mangësive e dobësive dhe ndikimet që këto kanë si në fillesën e krijimit, ashtu edhe në përfundimin e tij, konsiderohen si shkaqe të tjera të mendjemadhësisë dhe të injorancës.

Për këtë arsye, Kur'ani i Shenjtë, për ta thyer këtë mendjemadhësi dhe injorancë, u tregon atyre të kaluarën e popujve të mëparshëm. Duke u bërë të qartë se në ç'mënyrë janë zhdukur popujt e mëparshëm, megjithëse ata kishim fuqi dhe mjete të përparuara.

All'llahu u tregon atyre se me një, tufan, një rrufe, një tërmet, një shi i rrëmbyeshëm etj, janë zhdukur vende e popuj të shumtë.

Duke ditur se çka ngjarë më parë, ju përsëri jeni mendjemëdhenj.

Zakonisht, mendjemadhësia dhe krenaria vjen nga humbjet dhe dobësitë e njeriut, kështu që për të fshehur humbjet dhe dobësitë e tyre, ata nisin e mburren me çka kanë.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Askush nuk mburret përveç atyre që ndiejnë kënaqësi në shpirtin e tyre.*".[1]

[1] "Usule Kafij", vëll. 2, f. 236; "babul el kibr", Hadithi 17.

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Tri gjëra janë prej shkaqeve të injorancës: mendjemadhësia dhe mburrja me gjenealogji, ofendimi i personalitetit të familjes, si dhe të kërkosh shi nga yjet."*.[1]

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë *"Dy gjëra i shkatërrojnë njerëzit, frika nga varfëria, që i shtyn njerëzit të grumbullojnë mallra, pa parë se në ç'mënyrë i sigurojnë ato, si dhe mburrja."*.[2]

Sigurisht që shkaqet më të rëndësishme të korrupsionit në shoqëri janë: lakmia, koprracia, adhurimi i kësaj bote (lakmia për këtë botë e jetë), konkurrenca. Kjo frikë e paarsyeshme dhe ky rivalitet është futur në fise e në popuj.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Nuk kam frikë për ju ndaj varfërisë, por kam frikë nga rivaliteti."*.[3]

Fjala *"tekathur"*, sikurse e kemi cituar edhe më lart, ka kuptimin: *rivalitet, mburrje, mendjemadhësi*. Ndonjëherë merr edhe kuptimin: *kërkim dhe grumbullim malli*, sikurse e shikojmë edhe në një hadith tjetër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Rivaliteti, është grumbullim malli, po jo në Rrugë të Drejtë. Nuk shlyhet haku, e drejta, por ato grumbullohen e mbyllen në kasaforta."*.[4]

---

[1] "Biharul Enuar", vëll. 73, Hadithi 10, f. 391.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 73, Hadithi 12, f. 290.
[3] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 387.
[4] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 7, f. 662.

Këtë diskutim do ta përfundojmë me një hadith kuptimplotë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Njeriu, thotë: 'E imja! E imja!', ndërkohë që ajo çka i përket, është vetëm ushqimi që ha, rrobat që vesh dhe lëmosha që lë për hir të All'llahut dhe në Rrugën e Zotit."*.[1]

Kjo është një çështje shumë e çuditshme, që ne nuk na lë të mendojmë për asnjë çast apo të kemi kujdes, për sa i përket çështjes së haramit dhe hallallit. Ato çka ne hamë, veshim falim për hir të All'llahut, janë gjëra shumë të pakta. Sa mirë do të ishte që këto gjëra ne t'i sigurojmë nëpërmjet rrugës së duhur dhe të shtojmë më shumë bereqetin tonë.

2- Bindja dhe nivelet e saj

Fjala *"bindje"* është e kundërta e fjalës *"dyshim"*, ashtu sikurse fjala *"dije"* është e kundërta e fjalës *"injorancë"*. Fjala *"bindje"* ka ardhur edhe me kuptimin: *qartësi* dhe *qëndrueshmëri*. Sipas transmetimeve dhe haditheve, në lidhje me këtë fjalë (bindje), kuptohet se stadeve të larta të besimit, u thuhet "bindje".

Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Besimi, është një shkallë më lart se Islami dhe devotshmëria është një shkallë më lart se sa besimi, ndërsa bindja është një shkallë më e lartë se sa devotshmëria."*.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 534.

Më pas tha: *"Në mesin e njerëzve nuk është ndarë gjë tjetër më pak se sa siguria."* (që do të thotë se bindjen e ka një pakicë e besimtarëve).

Më tej transmetuesi pyet, se ç'është bindja.

Imami thotë: *"E vërteta e bindjes, është t'i mbështetësh All'llahut, t'i bindesh dhe t'i dorëzohesh All'llahut dhe të jesh i kënaqur me atë çka All'llahu ka përcaktuar, gjithçka t'ia lësh në dorë All'llahut."*.[1] Epërsija e pozitës së bindjes mbi pozicionin e devotshmërisë, besimit dhe Islamit është diçka që përmendet dhe theksohet edhe në transmetime të tjera.[2]

Në një hadith tjetër Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nga shenjat e bindjes së vërtetë të myslimanëve, janë këto: nuk i gëzojnë njerëzit më zemërimin e All'llahut, nuk i poshtërojnë të tjerët me atë çka nuk u ka dhënë All'llahu. Për shkak të drejtësisë dhe dijes, në zemrat e tyre është vendosur bindja dhe kënaqësia e All'llahut ndaj dhe janë të qetë, ndërsa trishtimi dhe mërzitja është e vendosur te dyshimi dhe te pakënaqësia."*.

Të tilla interpretime dhe shumë e shumë të tjera si këto, tregojnë më së miri se, kur njeriu arrin në pozitën e bindjes, në zemrën dhe në shpirtin e tij mbizotëron qetësia dhe rehatia.

Në ajetet e mësipërme dhe në ajetin 95 të sures "Uakiah" janë përmendur 3 stadet e bindjes: **"Pa dyshim, kjo është e Vërteta e sigurt."**.[3]

---

[1] "Biharul Enuar", vëll. 70, Hadith 4, f. 138.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 70, f. 135–137.
[3] Sure "Uakiah" ajeti 95.

Tri stadet e bindjes janë:

1- *Bindja me dije*, e cila arrihet nëpërmjet argumenteve të ndryshme, si për shembull, të besosh në diçka, në mënyrë të tillë, që kur të shikosh tymin, të besosh se ekziston zjarri.

2- *Bindje e plotë*, kjo lloj sigurie arrihet kur njeriu e shikon vetë diçka me sytë e tij dhe jo nëpërmjet shenjave të mbetura, sikurse ishte tymi më lart. Nga kjo shenjë sigurohet dija e bindjes së zjarrit. Në këtë rast, vetë njeriu shikon zjarrin dhe beson me bindje të plotë.

3- *Bindja e vërtetë*, kjo gjë arrihet kur njeriu apo personi provon zjarrin, pra, hyn në zjarr dhe provon nxehtësinë e tij. Gjithashtu, bëhet një me cilësitë e zjarrit. Kjo është bindja më e lartë dhe më e arrirë.

Muhakik Tusij, në një prej fjalimeve të tij, për sa i përket bindjes, thotë: "Bindja është besimi absolut, i palëkundur. Është e pamundur zhdukja e saj. Ajo është e përbërë prej dy dijesh, dija e qartë dhe dija për të cilën nuk mundesh, ose është e pamundur e kundërta e saj. Është e përbërë prej disa stadesh: Bindja me dije, bindja e plotë dhe e bindje e vërtetë.".[1]

Stadi i parë, është stad i përgjithshëm, ndërsa stadi i dytë është stad për ata që largohen dhe ruhen nga e keqja, ndërsa stadi i tretë është për ata që janë të veçantë dhe të afruar te All'llahu.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "Kam dëgjuar që

[1] "Biharul Enuar", vëll. 70, f. 143.

disa prej shokëve të Profetit Isa *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ecnin mbi ujë. Ai tha: *"Nëse bindja e tij do të ishte edhe më e fortë, do të ecte në ajër!"*.

I ndjeri Eruditi Tabatabaij, pasi citon këtë hadith, shton: "Gjithçka rrotullohet rreth besimit dhe bindjes që keni ndaj All'llahut të Madhëruar, si dhe të largoheni nga gjithçka që ju pengon apo ndikon për keq te ju, për të arritur këtë qëllim, prandaj sa më tepër që të rritet fuqia e bindjes ndaj All'llahut, aq më të pavlefshme dhe më të panevojshme do t'u duken gjërat e kësaj bote.".[1]

Këtu është edhe sekreti i marrëdhënies së bindjes dhe i shfrytëzimit të jashtëzakonshëm në botën krijimit.

3- Të gjithë do ta shikojnë Xhehennemin!

Fjalia: **"Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!"** kumton dy ide:

Së pari, ka për qëllim, shikimin e Xhehennemin, ferrit në këtë botë, i cili është për vetë qafirët, ose për të gjithë xhindët dhe njerëzit, sepse, sipas disa ajeteve kur'anore, të gjithë do të kalojmë pranë Xhehennemit.

Ndërsa, për sa i përket faktit se qëllimi është për shikimin e Xhehennemit me zemër, në këtë botë, atëherë përgjigjja është me kusht, se, nëse do të kishit dijen e sigurt, do ta shikonit Xhehennemin në këtë botë me syrin e zemrës, sepse ne e dimë që

[1] Tefsiri "El Mizan", vëll. 6, f. 200 (në vazhdim të ajeti 105 të sures "El Maide").

Xhenneti dhe Xhehennemi është i krijuar dhe ka ekzistencë të jashtme. Por, sikurse e thamë edhe më parë, komentimi i parë me ajetet e mëpasshme, të cilat flasin për Ditën e Kiametit është më i përshtatshëm.

4- Për cilat mirësi do të pyetemi në Kiamet?

Në ajetin e fundit të kësaj sureje lexuam se të gjithë do të pyetemi për mirësitë e dhëna.

Disa komentues, këtë gjë e konsiderojnë si siguri, të tjerë, mirësitë i konsiderojnë të përfshira në ajet.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në një hadith, thotë: *"Mirësitë janë hurmat dhe uji i freskët."*.

Në një hadith tjetër, lexojmë se Ebu Hanife pyet Imam Sadikun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për komentimin e këtij ajeti. Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i përgjigjet: *"Sipas mendimit tënd, çfarë është mirësia?"*. Ai u përgjigj: "Ushqim dhe ujë i ftohtë.".

Imami i tha: *"Nëse All'llahu do të donte të të pyeste ty për çdo kafshatë që ke ngrënë dhe për çdo pikë ujë që ke pirë, atëherë do të duhej shumë kohë që t'i të qëndroje aty."*.

Ebu Hanife tha: "Atëherë, cila është mirësia?".

"Jemi ne, Ehli Bejti, që All'llahu, nëpërmjet nesh, ju jep krijesave të tij mirësi, edhe nëpërmjet nesh, ju jep rehati. Pasi ata grinden dhe kanë kundërshtime mes tyre, zemrat e tyre i qetëson nëpërmjet nesh, duke i bërë vëllezër me njëri–tjetrin; pasi ata armiqësohen mes veti, nëpërmjet nesh i

ka udhëzuar. Mirësi është vetë Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe All'llahu i Tij".[1]

Komentimi i këtyre transmetimeve të ndryshme është i tillë: Fjala "*naijm*" ka një kuptim shumë të gjerë, që përfshin të gjitha mirësitë shpirtërore dhe hyjnore, sikurse është: feja, besimi, Islami, Kur'ani, imamati, si dhe lloje të tjera të mirësive materiale, si të jenë ata personale, si të jenë shoqërore.

Por mirësitë që kanë rëndësi më të madhe, janë ato të imanit dhe vilajetit, besimi dhe imameti, për të cilat ne do të pyetemi më shumë. Nëse është shlyer haku dhe e drejta e tyre apo jo.

Ndërsa për sa u përket mirësive materiale, të cilat citohen në hadith, janë për faktin që të bëhet dallimi midis një mirësie me një tjetër, pra, cila është më e rëndësishme. Në të vërtetë, është një zgjim që u bëhet njerëzve, për sa u përket mirësive që duhet të duan më shumë. Për njeriun kjo është një detyrë shumë e rëndë.

Si është e mundur që të mos pyeten për këto mirësi, ndërkohë që njeriut i është dhënë në përdorim dhe shfrytëzim një pasuri e madhe? Duhet të dihet vlera e saktë për të gjithë ata, që të falënderohen e të nderohen si duhet.

O All'llah! mirësitë e tua janë të pafundme, sidomos mirësia e imanit dhe e vilajetit, na i mbro këto mirësi!

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 535.

O All'llah! Na bëj prej atyre që ta shlyejmë hakun e të gjithë mirësive që na ke dhënë!

O All'llah! Na i shto mirësitë e Tua dhe mos i merr kurrë prej nesh!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "Et Tekâthur".

Sure "El 'Asr"

Zbritur në Mekë

Ajete 3

Përmbajtja e sures "El 'Asr"

Është e njohur nga të gjithë komentuesit se kjo sure ka zbritur në Mekë, edhe pse disa komentues janë të mendimit se kjo sure është medinase. Por ajetet e shkurtra të sures dhe tingulli i saj, dëshmojnë se kjo sure është mekase.

Popullariteti i kësaj sureje është aq i madh, saqë, sipas mendimit të disa komentuesve, në këtë sure janë përmbledhur të gjithë shkencat, si dhe të gjithë qëllimet e Kur'anit. Me fjalë të tjera, kjo sure, edhe pse është e shkurtër, në të është përmbledhur një program i përgjithshëm dhe i plotë për lumturinë e njeriut.

Së pari, betohet për kohën. Ky betim është me shumë kuptim, komentimin e të cilës do ta shikoni së shpejti.

Më pas flet për punëkëqijtë dhe për humbjen e njeriut, që është i zhytur në gabime.

Më tej citon vetëm një grup që është ndarë nga këta njerëz. Ata kanë program dhe kanë këto katër cilësi: besim, vepra të mira, këshillojnë njëri-tjetrin në të drejtë dhe në durim. Në të vërtetë, këto katër pika kryesore janë programet që përfshijnë fenë islame.

Mirësitë e leximit të sures "El 'Asr"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, lexojmë një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "*Kushdo që e lexon suren 'El 'Asr' në namazet nafile (të pëlqyeshme), All'llahu do ta ngrejë ata në Ditën e Kiametit, ndërkohë që fytyrat e tyre janë të shndritshme, te qeshura. Sytë e tyre shkëlqejnë nga mirësitë e All'llahut, derisa të futen në Xhennet.*".[1]

Është e qartë se gjithë kjo mirësi dhe krenari është për ata që e lexojnë suren, duke i vënë në veprim këshillat e saj. Pra, të mos mjaftohemi vetëm me leximin e saj.

Ajetet 1 - 3

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 535.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَالْعَصْرِ ۝١ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ۝٢ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ۝٣﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Për kohën!"

"Me të vërtetë, njeriu është në humbje,"

"Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin."

Komentimi

Rruga e vetme e shpëtimit

Në fillim të kësaj sureje përballemi me një betim të ri: **"Për kohën!"**

Fjala *"el asru"* në origjinë, ka kuptimin: *shtrëngim*. Më pas ka marrë kuptimin e kohës, sepse në të janë të përmbledhura programet ditore të njeriut.

Më tej, kjo fjalë është përdorur me kuptimin absolut të kohës, të periudhës së historisë së njeriut, ose për një pjesë të kohës, sikurse është periudha e Islamit, apo e ngritjes së Profetit të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, apo periudha të tjera. Ndaj edhe në komentimin e këtij betimi, komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme.

1- Disa komentues, e konsiderojnë atë si shenjë të kohës (asr), duke marrë si ngjashmëri disa nga ajetet e tjera të Kur'anit, që flasin për fillimin e ditës, që është betuar për ditën *"Ued' duha"*[1] - ose *"Ue subhi idha esfere"*.[2] Këto betime janë përmendur për shkak të rëndësisë që këto ngjarje kanë për nga dita, sepse është koha e ndryshimit të sistemit të jetës së njeriut. Punët e ditës përfundojnë, shpendët dhe kafshët kthehen në strofullat e tyre, dielli perëndon dhe po ashtu, koha dalëngadalë errësohet. Ky lloj ndryshimi e bën njeriun të kuptojë fuqinë e paimagjinueshme të Krijuesit, fuqi që është sunduese në këtë sistem. Në të vërtetë, ky ndryshim është shenjë prej shenjave të Teuhidit dhe shenjë prej shenjave të All'llahut, i cili është favorit i betimeve.

2- Disa komentues të tjerë, e konsiderojnë atë si shenjë në të gjithë kohërat dhe historinë e njerëzimit. Kohë që është e mbushur me mësime dhe ngjarje të ndryshme tronditëse, që e zgjojnë njeriun. Ndaj dhe për këtë arsye, pra, të madhështisë që ka koha, është favorit i betimit hyjnor.

3- Të tjerë komentues e kanë komentuar këtë ajet si një pjesë të veçantë të kohës, sikurse është koha e kryengritjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Sure "Ed Duha", ajeti 10.
[2] Sure "El Muddeththir", ajeti 34.

tij!) apo si periudhën e ardhjes së Imam Mehdiut *(Zoti ia përshpejtoftë ardhjen)*, periudha që kanë pasur dhe do të kenë cilësi dhe madhështi të veçanta në historinë e njerëzimit, ndaj dhe betimin ia dedikojnë asaj periudhe kohore.[1]

4- Të tjerë, gjithashtu, iu kthyen rrënjës së fjalës, sipas fjalorit dhe betimin e morën për llojet e shtypjes e të shtrëngimit, si dhe për problemet që ndodhin përgjatë jetës së njeriut. Ato probleme e zgjojnë nga gjumi i pavëmendjes dhe e ftojnë të kujtojnë Zotin e Madh, në këtë mënyrë bëjnë që shpirti të forcohet.

5- Komentues të tjerë e konsiderojnë atë si betim ndaj njerëzve të përsosur, të cilët janë shenjë e kohës së botës së universit.

6- Po ashtu, të tjerë komentues janë të mendimit se ky ajet ka të bëjë me namazin e ikindisë, për shkak të cilësive që ka ky namaz, sepse edhe në Kur'an është cituar dhe i është vënë theksi namazit të ikindisë.

Edhe pse komentimet e mësipërme nuk kanë asnjë kundërshtim me njëra–tjetrën, mund të përmblidhen të gjitha në një kuptim të vetëm dhe betimi të jetë për të gjitha këto çështje që u cituan.

Ndër të gjitha komentimet, për sa i përket këtij ajeti, më i përshtatshëm është komentimi për kohën dhe historinë e njeriut, sepse shumë herë kemi thënë se betimet në Kur'an janë gjithmonë në përshtatje me një çështje, ndaj edhe betimi është bërë për një

[1] Transmetohet se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë në lidhje me ajetin: **"Uel Asr..."** se ky ajet ka për qëllim kohën e ardhjes së Imam Mehdiut *(Zoti ia përshpejtoftë ardhjen)*. Tefsiri "Nuruth Thekalejn" vëll,5 fq, 666, hadithi 5.

çështje. Është e sigurt se humbjet e njeriut përgjatë jetës së tij, është përfundimi i kalimit të kohës së tyre ose është periudha e kryengritjes së Profetit të fundit *(Paqja dhe bekimet e Allaut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për shkak se:

Ajo çka u tha më lart, përshkruan madhështinë e ajeteve të Kur'anit dhe gjerësinë e të kuptuarit të tyre, duke pasur parasysh se vetëm një fjalë e ajetit ka shumë kuptim dhe është favorit i një komentimi të thellë dhe të ndryshëm.

Ajeti më pas flet për rëndësinë e betimit, duke thënë se të gjithë njerëzit janë të humbur: "**Me të vërtetë, njeriu është në humbje.**".

Njeriu i humbet pasuritë e qenies së tij, do apo nuk do ai. Orët, ditët, muajt dhe vitet e jetës së tij kalojnë me shpejtësi. Fuqitë e tij shpirtërore dhe materiale ikin dhe fuqia i tij bie.

Njeriu ka një pasuri të madhe dhe, pa dashur, çdo ditë i merret një pjesë nga kjo pasuri. Kjo është natyrë e jetës së kësaj bote, natyra e të humburit vazhdimisht.

Njeriu ka një zemër që rreh vazhdimisht, por ka një fuqi të përcaktuar, për sa u përket numërimit të rrahjeve. Kur ky kapacitet të përfundojë, zemra do të ndalojë vetvetiu, edhe pa pasur ndonjë sëmundje apo problem tjetër.

Fjala *"khusr"* dhe *"khusran"*, sikurse e citon Ragibi te vepra "Mufredat", ka kuptimin: *pakësim i pasurisë*.

Ndonjëherë është lidhur me njeriun, duke thënë se filani ka humbur. Ndonjëherë fjala është lidhur me vetë veprimin, duke thënë se humbi ose doli me humbje në filan tregti. Kjo fjali

zakonisht përdoret për pasurinë e jashtme materiale, si: mallrat, apo si pozita në një vend pune etj.

Ndonjëherë kjo fjalë është përdorur edhe për pasuritë e brendshme të njeriut, sikurse është: shëndeti, mirësitë, mendja, besimi, sevapi etj. Këto, pra, janë konsideruar si humbje e madhe nga ana e All'llahut të Madhëruar, ose janë konsideruar si humbje të dukshme, sikurse thuhet: **"Të humburit e vërtetë janë ata që do të humbin veten dhe familjen e tyre në Ditën e Kiametit. Ja, kjo është humbja e qartë!"**.[1-2]

Fakhru Rrazij, në komentimin e këtij ajeti, transmeton thënien e dikujt: Një nga njerëzit e mëdhenj të kohëve të mëparshme, thoshte se kuptimin e kësaj sureje e ka mësuar nga një shitës akulli. Ai thërriste: "Mëshirojeni atë person që pasuria e tij i humbet! Mëshirojeni atë person që pasuria e tij i humbet!".

Thashë me vete se ky është kuptimi i i ajetit: **"Me të vërtetë, njeriu është në humbje",** koha dhe periudha i kalon, i ikën, jeta i mbaron, ndërkohë që nuk fiton asnjë sevap. Në këtë gjendje ai njeri është i humbur.[3]

Sidoqoftë, sipas mendimit të botëkuptimit islam, kjo botë është një treg, tregti. Për këtë çështje, lexojmë një hadith të Imam Hadit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: *"Kjo botë është një treg. Një pjesë përfiton prej saj."*.[4]

---

[1] "Mufredat Ragib", nga rrënja "khasire".
[2] Sure "Ez Zumer", ajeti, 15.
[3] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 32, f. 85.
[4] "Biharul Enuar", vëll. 72, Hadithi 1, f. 366; "Tuhuful Ukul", f. 361, (fjalët e Imam Hadiut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Programin e këtij grupi do ta sqarojmë në ajetin e mëpasshëm.

Po, ekziston një rrugë që të mbrohemi nga kjo humbje dhe detyrim, ajo është rruga e vetme që është cituar në ajetin e fundit të kësaj sureje: **"Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin."**.[1]

Janë të shpëtuar vetëm ata që besuan dhe kryen vepra të mira. Janë ata që e këshillojnë njëri-tjetrin të kryejnë vepra të mira dhe e këshillojnë njëri-tjetrin të bëjnë durim.

Me fjalë të tjera, ajo çka mund të bëhet pritë dhe pengesë e kësaj humbje të madhe dhe ta shndërrojë atë në një mirësi dhe përfitim të madh, është vetëm të sigurojmë një tjetër mirësi më të madhe dhe ta zëvendësojmë atë me mirësi, që shpërblimi dhe përfitimi të jetë qindra herë më i lartë se i pari.

Çdo herë që njeriu merr frymë, i afrohet një hap vdekjes, ashtu sikurse thotë edhe Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*: "*Çdo frymëmarrje e njeriut, bën që njeriu të jetë një hap më afër vdekjes.*".[2]

[1] Sa më shumë që koha kalon, aq më tepër njeriu i afrohet humbjes, nëse nuk plotëson katër kushte që kanë të bëjnë me përsosjen e tij personale dhe përsosjen e të tjerëve: besimi tek All'llahu dhe te gjithçka që Ai ka urdhëruar të besohet; kryerja e veprave të mira, qofshin këto vepra fizike apo shpirtërore; këshillimi i të tjerëve me këtë të vërtetë, që të përpiqen t'u përmbahen urdhrave të All'llahut dhe të durojnë sprovat e dhembshme dhe të vështira që mund të ketë paracaktuar Ai.

[2] "Nehxhul Belaga", Kalemat Kisar, Fjala, 74.

Prandaj, çdo rrahje që kryen zemra, e afron atë drejt fundit të jetës në këtë botë. Ndaj dhe duhet të bëjmë diçka që, përballë kësaj humbje të sigurt, të mbushim vendin bosh.

Një grup përpiqet të shtojë pasurinë dhe të ndërtojë kështjellë, ndërkohë që e ka humbur pasurinë e shpirtit. Një grup prej tyre këtë pasuri e humbet për të arritur pozitë. Edhe grupe të tjera e humbasin atë, duke u dëfryer dhe duke u ushqyer sa më mirë.

Sigurisht, asnjëri prej tyre nuk mund të jetë pronar i asaj pasurie të madhe, sepse ajo është vlerë që arrihet vetëm me kënaqësinë e All'llahut dhe me afrimitetin e Tij.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thotë: *"Për qenien tuaj nuk ka vlerë dhe çmim përveç Xhennetit. Mos e shisni atë më pak se vlera e Xhennetit."*.[1]

Apo sikurse lexojmë në lutjen e muajt Rexheb nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ku thotë: *"Ata që nuk vijnë te ti, po shkojnë te të tjerët, do të zhgënjehen, e ata që shkojnë diku tjetër përveç teje, janë punëligë!"*[2]

Jo pa qëllim, një prej emrave të Ditës së Kiametit është *"jeumul tegabin" "dita kur do të grumbullohen"*. Ky emër është cituar në ajetin 9 të sures "Et Tegâbun: **"Dita, kur Ai do t'ju mbledhë, dita, kur të gjithë do të grumbulloheni, do të jetë Dita e humbjes dhe fitimit. Atij që beson në All'llahun dhe bën vepra të mira, All'llahu do t'ia falë gjynahet dhe do ta shpjerë në kopshte, nëpër**

[1] "Nehxhul Belaga", Kalimatul Kisar, Fjala, 456.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 92, Hadithi 1, f. 389.

të cilët rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojë përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe.". Atë ditë do të qartësohet se cilët persona janë grumbulluar e që kanë kryer vepra të liga.

E bukura e kësaj çështje dhe mirësia që ndodhet në të, është se, në njërën anë, blerësi i pasurisë dhe i trashëgimisë së njeriut është vetë All'llahu. All'llahu në Kur'an thotë: **"Në të vërtetë, All'llahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhennetit. Ata luftojnë në Rrugën e All'llahut, vrasin dhe vriten.** (Ky është) **premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kur'an. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se All'llahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore."**.[1]

Nga ana tjetër, All'llahu ble edhe pasurinë më të vogël të tyre: **"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."**.[2]

All'llahu u jep atyre një vlerë të madhe, ndonjëherë u jep dhjetë herë më tepër se sa vlen puna e tyre dhe ndonjëherë shtatëqind herë më tepër se sa u vlen puna e tyre. Po ashtu, ndonjëherë më shumë se kaq: **"...secili kalli ka nga njëqind kokrra. All'llahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë..."**[3]

Në duatë që ne lexojmë, thuhet: *"O All'llah! Ti që pranon mirësinë më të vogël dhe që fal shumë mëkate..."*.[4]

---

[1] Sure "Et Teube", ajeti , 111.
[2] Sure "El Zelzele", ajeti 7.
[3] Sure "El Bekare", ajeti 261.
[4] "Biharul Enuar", vëll. 92, Hadithi 2, f. 100.

Nga ana tjetër, All'llahu, edhe pse të gjithë pasurinë e tij e ka vendosur në shërbim të njeriut, të gjithë këtë pasuri e ble përsëri nga njeriu me një çmim shumë të lartë. Sa i madhëruar dhe i nderuar është Emri i Tij!

Hulumtim

Programi i lumturisë me katër mënyra

Kur'ani i Shenjtë ka programuar një program shoqëror për të shpëtuar njerëzit, duke u bazuar në katër shtylla kryesore.

Shtylla e parë, është *"imani"* – *"besimi"*, i cili është themeli i gjithë ndërtesës së punëve dhe veprave të njeriut. Të gjitha këto vepra dhe punë, kërkojnë themele të forta, pra, besim, sepse të gjitha përpjekjet e njeriut, qofshin ato baza e të menduarit, apo të besuarit, varen nga besimi, sepse njeriu nuk është si kafshët, që lëvizjet i kryejnë sipas dëshirave që u kërkon instinkti.

Me fjalë të tjera, veprat dhe punët e njeriut janë pasqyrim i besimit të tij, për këtë shkak, të gjithë Profetët, para së gjithash, merren me rregullimin e bazave të besimit të ymetit, veçanërisht merren me shirkun, i cili është burimi i gjithë poshtërsirave dhe i fatkeqësive. Është për t'u habitur se besimi, në këtë rast, është cituar në mënyrë të përgjithshme, për shkak që të përfshijë të gjitha shenjtërimet, që nga besimi në All'llah dhe cilësitë e All'llahut të

Madhëruar, besimi në Kiamet, llogaria, dënimi, librat qiellorë, Profetët dhe të Dërguarit si dhe evlijatë hyjnorë.

Në shtyllën e dytë, flet për frytin e pemës, që është *"vepra e mirë e njeriut"* ose veprat e denja të tij. All'llahu citon një interpretim shumë të gjerë dhe me plot kuptim, duke i cituar punët e mira si veprat më të pëlqyeshme, jo vetëm adhurimin, jo vetëm bamirësinë dhe jo vetëm xhihadin, jo vetëm dijen dhe arritjet e saj, por çdo gjë që është plotësuese dhe përsosmëri për shpirtin e njeriut, për zhvillimin e moralit dhe afrimitetin tek All'llahu, apo zhvillimin e shoqërisë njerëzore, pra, çdo gjë, është konsideruar e pëlqyeshme tek All'llahu.

Të gjitha këto punë, qofshin punët më të voglat, sikurse është largimi i një guri nga rruga për të mos shqetësuar njerëzit e tjerë, konsiderohen punë të pëlqyeshme, sepse bëhet shkak i shpëtimit të milionave e milionave njerëzve nga rruga e padrejtë, si dhe bën që në të gjithë botën të përhapet drejtësia.

Nëse lexojmë një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, vëmë re se veprat e mira janë komentuar me kuptimin barazi me vëllezërit fetarë.

Mundet që ndonjëherë, veprat e mira të kryhen nga njerëz jobesimtarë. Sigurisht që ato vepra nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk kanë qëllimin dhe motivacionin që buron nga All'llahu, për këtë arsye nuk kanë integritetin e duhur.

Kur'ani, në këtë rast, veprat e mira i ka cituar në numrin shumës, gjithmonë kur shumësi vjen me *"elif"* dhe *"lam"*, ka

kuptim të përgjithshëm, si dhe tregon një të vërtetë që, rruga e kryerjes së veprave të mira është me besim. Nuk mund të kënaqemi me një ose disa vepra të mira. Nëse në zemrën e njeriut do të zërë vend besimi i thellë, do të shfaqen të tilla punë të mira.

Besimi nuk është një ide apo mendim, i shtuar apo i mangët me çfarëdolloj ndikimi, por besimi përfshin të gjithë qenien e njeriut. Besimi është sikur llamba që ndriçon dhomën brenda, jo vetëm që ndriçon ambientin e dhomës, por rrezet e saj përfshijnë të gjitha pjesët, si brenda, ashtu edhe jashtë. Kështu që gjithkush që e shikon atë, si jashtë, ashtu edhe brenda, ajo është e ndriçueshme.

Gjithashtu, kur në zemrën e besimtarit është drita e besimit, rrezet e dritës së tij reflektojnë tek i gjithë trupi i tij, si te: gjuha, syri, veshët, këmbët, duart etj. Për këtë arsye, në ajetet kur'anore, veprat e mira janë të shoqëruara me besimin. Ato vijnë si shoqëruese të njëra–tjetrës, si nevojë dhe domosdoshmëri.

Në ajetin 97 të sures "En Nahl" lexojmë: **"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë."**.

Çdokush prej njerëzve, qoftë mashkull apo femër, që kryen vepra të mira, ndërkohë që ka besim, Ne atë e ringjallim me një jetë të pastër.

Në ajetet 99-100 të sures "El Mu'minûn", lexojmë: **"Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre** (jobesimtarëve)**, ai thotë: 'O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!'. Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai** (kot) **e thotë!**

Prapa (vdekjes së) **tyre do të ketë një** (kohë) **ndarëse**[1]**, deri në Ditën kur do të ringjallen.”**.

Në ajetin 51 të sures “El Mu’minûn” thuhet: **“O të Dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju!”.**

All’llahu, të Dërguarve të Tij, u jep urdhër që të hanë nga të mirat e kësaj bote dhe të bëjnë vepra të mira, sepse besimi dhe veprat e mira, vazhdimësinë e tyre e kanë të lidhur me njëra-tjetrën, nuk ecin të ndara, por gjithnjë vijnë bashkë, besimi, veprat e mira.

Shtylla tjetër është çështja e “*Ftesës në të vërtetë*”, që do të thotë ftesë e përgjithshme për të gjithë drejt së vërtetës, në mënyrë që të gjithë të mund të dallojnë të vërtetën nga e pavërteta e të mos e harrojnë kurrë atë, në mënyrë që të mos devijojnë rrugën e jetës e të shkojnë nga e gabuara.

Fjala “*teuasua*” vjen nga rrënja e fjalës “*teuasi*” dhe sikurse e përshkruan Ragibi, në fjalorin e tij “Mufredat”, ka kuptimin: *disa këshillojnë disa të tjerë*.

Fjala “*hakku*”, ka kuptimin: *e vërtetë*, ose *përputhet me të vërtetën*.

Në librin “*Vaxh’hul Kur’an*”, kjo fjalë ka dymbëdhjetë kuptime, si: Zot, Kur’an, Njëshmëri, drejtësi, vërtetësi, qartësi, me qenë i detyrueshëm etj. Të gjitha këto që u përmenden, rikthen te rrënja që cituam më lart.

Sidoqoftë, fjalia: “*Teuasau bil hakki*”, ka kuptime të shumta, ku në të përfshin edhe “ zbatimi i të drejtës, largimin nga e padrejta,

[1] Jeta e varrit.

të mësuarit dhe udhëzimin e injorantëve, nxitjen, propagandën, besimin dhe veprat e mira, të gjitha këto janë të përfshira në këtë fjali".

Është e pamundur që njerëzit që i ftojnë të tjerët drejt së vërtetës dhe i këshillojnë për mirë, të mos jenë vetë mbrojtës të së vërtetës, pra, ata janë militantë të së vërtetës dhe të së drejtës.

Një tjetër gjë e rëndësishme, është durimi. Të jesh i duruar dhe të ftosh të tjerët në durim, është një çështje që përmendet gjithmonë, pasi njohja e çdonjërit, përgjatë rrugës së veprave dhe pengesat që ata hasin, nuk mund të realizohet, nëse nuk ka durim.

Pra, asnjëherë nuk mund të bëhet realizimi i të drejtës apo i veprave të mira, nëse nuk ekziston durimi. Realizimi i të vërtetës dhe zbatimi i të vërtetës në shoqëri nuk mund të bëhet vetëm me lëvizje dhe me një vendim të përgjithshëm, ndaj edhe qëndrueshmëria dhe rezistenca e përgjithshme nuk është e mundur përballë pengesave.

Durimi, në këtë rast, ka kuptim të gjerë, ku përfshin bindjen edhe durimin ndaj dëshirave për të mëkatuar. Gjithashtu, përfshin durimin përballë ndodhive dhe ngjarjeve të papritura që i ndodhin njeriut.

Ka kuptimin: të kesh durim kur humb gjërat me vlerë, pasurinë dhe të afërmit.[1]

[1] Të vërtetën e durimit dhe degëzimet e tij, e kemi trajtuar në vëllimin e parë, në vazhdim të ajetit 153 të sures "El Bekare".

Duke u bazuar në atë çka u tha më lart, për sa u përket katër parimeve, programi më i përmbledhur i jetës dhe më i drejti për lumturinë e njeriut është ai që trajtuam më lart.

Kemi transmetime se, kur shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* takoheshin me njëri–tjetrin, lexonin suren "El 'Asr" dhe përmbajtjen e kësaj sureje ia këshillonin njëri-tjetrit. Kështu, në këtë mënyrë, ata ndaheshin nga njëri-tjetri duke rikujtuar kuptimin e kësaj sureje.[1]

Nëse myslimanët e ditëve të sotme do të ndiqnin këto katër parime për jetën dhe shoqërinë që i rrethon, nuk do të kishin asnjëherë probleme. Problemet e tyre do t'i zgjidhnin shumë shpejt. Prapambetjet do të shlyheshin, nëse do të ndiqnim këto rregulla. Dobësitë e humbjet tona do të ktheheshin në fitore. Të gjitha këto do të bënin që grindjet do të pakësoheshin e do të ndaloheshin në botë.

O All'llah! Na fal ne durim, qëndrueshmëri dhe sukses, që të jemi të përulur!

O All'llah! Të gjithë ne jemi në humbje. Kjo humbje nuk shlyhet ndryshe vetëm se me mirësinë dhe dëshirën Tënde, o Zot!

[1] Tefsiri "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 392.

O All'llah! Ne duam t'i zbatojmë këto rregulla që janë në këtë sure, na e jep mundësinë dhe suksesin!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El 'Asr".

Sure "El Humeze"

Zbritur në Mekë

Ajete 9

Përmbajtja e sures

Kjo sure mekase flet për personat, që gjithë qenien e tyre ia kushtojnë mbledhjes së pasurisë, grumbullimit të mallrave.

Vlera e qenies dhe e ekzistencës së njeriut është e përmbledhur vetëm te vlera e pasurisë. Këta i shikojnë personat që e kanë humbur pasurinë si të shkretë dhe nisin e i tallin.

Këta tipa, aq shumë i kanë dhënë vetes së tyre hapësirë e fuqi, saqë të tjerët i shikojnë si lecka, i tallin e i ngacmojnë, duke qenë se vetë janë arrogantë, mendjemëdhenj dhe hilacakë. Ata kënaqen, kur tallen me të tjerët. Për ta, kjo mënyrë e të tallurit, është argëtim.

Në fund të sures flitet për fatin e dhimbshëm të tyre, se si do hidhen në Xhehennem. Zemra e tyre do të digjet e para e më pas shpirti i tyre, sepse ata kishin ligj mendjemadhësinë, arrogancën.

Kjo mendjemadhësi i dërgon ata në zjarr, i cili është afatgjatë dhe i vazhdueshëm.

Mirësitë e leximit të sures "El Humeze"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, lexojmë një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!): *"Kushdo që e lexon këtë sure, do të marrë dhjetë shpërblime për secilin ofendim që i kanë bërë Muhammedit dhe të shokëve të tij."*.[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kushdo që e lexon këtë sure në namazet e detyruara, varfëria do të largohet prej tij dhe do t'i afrohet e mira. Gjithashtu, vdekja e ligë do të largohet prej tij."*.[2]

Ajetet 1 – 9

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 536.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 536.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَيْلٌ لِكُلِّ هُمَزَةٍ لُمَزَةٍ ۝١ الَّذِى جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ ۝٢ يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ ۝٣ كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِى الْحُطَمَةِ ۝٤ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ ۝٥ نَارُ اللَّهِ الْمُوقَدَةُ ۝٦ الَّتِى تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْـِٔدَةِ ۝٧ إِنَّهَا عَلَيْهِمْ مُؤْصَدَةٌ ۝٨ فِى عَمَدٍ مُمَدَّدَةٍ ۝٩﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Mjerë për çdo përqeshës - shpifës,"

"Që grumbullon pasuri dhe e ruan,"

"Duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!"

"Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese."

"E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?"

"Ajo është zjarri i All'llahut i ndezur fort,"

"I cili depërton deri në zemrën e njeriut."

"Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë,"

"Në shtylla të gjata flakëruese."

Shkaku i zbritjes

Një grup komentuesish thanë se ajetet e kësaj sureje kanë zbritur për Uelijd ibn Mugijretu, i cili e ofendonte, e tallte dhe shpifte për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Të tjerë janë të mendimit se këto ajete janë zbritur për persona të tjerë, që ishin kryetarët e shirkut dhe armiq të Islamit, si: Akhnes ibn Sherijk, Umejjetu ibn Khalef, El As ibn Uail.

Shkaku i zbritjes është për këta persona që u cituan, por përsëri, përfshirja e gjithanshme e ajeteve nuk e thyen kuptimin e përgjithshëm të ajeteve, ku na bën të kuptojmë se përfshihen të gjithë personat që kanë këto cilësi.

Komentimi

Mjerë për përqeshësit dhe shpifësit

Kjo sure fillon me një kërcënim goditës: **"Mjerë për çdo përqeshës – shpifës."**. Mjerë për ata që përqeshin dhe tallin!

Ata që me gjuhën e tyre thumbojnë dhe me lëvizjen e duarve, të syve dhe të vetullave përqeshin e ofendojnë nga prapa të tjerët apo shpifin e tallin. Mjerë ata që kanë qëllim talljen dhe shpifjen e tyre.

Fjalët *"humeze"* dhe *"lumeze"* kanë kuptimin: *thyerje*. Personat që kanë për qëllim thyerjen e personalitetit të tjerëve, u thuhet "humeze".

Fjala *"lumeze"* vjen nga rrënja e fjalës *"lemz"*. Në origjinal ka kuptimin: *shpifje dhe tallje*.

Ka mendime të ndryshme për kuptimin e njëjtë që kanë këto fjalë. Disa komentues janë të mendimit se kanë një kuptim dhe përmendja e të dy fjalëve është për efekt theksimi.

Disa të tjerë janë të mendimit se fjala *"humeze"* ka kuptimin *shpifje,* ndërsa fjala *"lumeze",* ka kuptimin: *tallje, të tallësh*.

Disa të tjerë janë të mendimit se fjala *"humeze"* ka kuptimin e përqeshjes dhe të ofendimit me shenja, si lëvizja e duarve, e vetullave, e kokës etj. Ndërsa fjala *"lumeze"* ka kuptimin e personit që i kryen këto punë.

Komentues të tjerë, të parën e kanë marrë me kuptimin shpifje ballë për ballë, kurse të dytën, si shpifje mbrapa shpine.

Të tjerë komentues, fjalën *"humeze"* e kanë marrë si shpifje të hapur, ndërsa të dytën e kanë marrë si shpifje e tallje të fshehtë, duke përfshirë edhe sytë, edhe vetullat.

Gjithashtu, është thënë se të dyja këto janë përdorur për tituj të shëmtuar, dhe ofendues.

Në një fjalim të Ibn Abasit thuhet se janë ata persona që bëjnë thashetheme mes tyre, flasin kundër dhe fusin ndasi. Njerëzit i ftojnë në grindje dhe në të keqe.[1]

Ibn Abasi, këtë fjalim e transmeton nga një hadith i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"A dëshironi t'ju flas për njerëzit më ngatërrestarë?"*

- Po, o i Dërguari i All'llahut! - iu përgjigjën.

- *Ata që merren me thashetheme në mesin e miqve, krijojnë ndasi. Për njerëzit e pastër dhe të pamëkatë kërkojnë të gjejnë një cen,* – tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[2]

Nga e gjithë kjo kuptohet se fjala *"erbab"* - *"sundimtar"*, edhe pse është e njëjtë, në fjalor, ka të njëjtin kuptim. Po ashtu, kjo fjalë përmbledh në vetvete të gjitha kuptimet e liga, sikurse është kritika e pavend, thashethemet, injorimi, si dhe ofendimet që bëhen nëpërmjet shenjave.

Gjithsesi, të përdorësh fjalën *"ueilun"* - *"mjerë"*, me të vërtetë që është një kërcënim i fortë për këtë grup njerëzish. Parimisht,

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 32, f. 92.
[2] "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 369.

ajetet e Kur'anit kanë folur dhe kanë trajtuar shumë çështje në lidhje me të tillë njerëz.

Gjithashtu, Kur'ani i Shenjtë përdor terma që nuk janë përdorur për asnjë mëkat tjetër, për shembull, All'llahu i Madhëruar i kërcënon jobesimtarët, me zemra të mbyllura dhe të verbuara, për shkak të përqeshjes që u bënë besimtarëve: **"U lute për ta apo nuk u lute** (o Muhammed)**, All'llahu nuk do t'i falë, edhe sikur ti të kërkosh falje për ta shtatëdhjetë herë! Kjo sepse ata e mohuan All'llahun dhe të Dërguarin e Tij. All'llahu nuk i udhëzon në Rrugë të mbarë njerëzit e pabindur."**.[1]

I ngjashëm me këtë kuptim, është edhe ajeti 5 i sures "El Mûnâfikun": **"Kur u thuhet atyre: 'Ejani, se i Dërguari i All'llahut do të kërkojë falje për ju', ata tundin kokat e tyre dhe i sheh ata të kthehen me mendjemadhësi."**.

Feja islame e konsideron shumë të rëndësishme personalitetin dhe nderin e personave. Ndaj edhe përgojimin dhe ofendimin e njerëzve e konsideron si një mëkat shumë të madh. Në një hadith të Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) thuhet: *"Njerëzit më të ulët janë ata njerëz që shpifin për të tjerët."*.[2]

Më pas flet për burimin dhe shkakun se si lind kjo vepër e keqe (kritika, nxjerrja e yçklave, si dhe ngacmimi). All'llahu në

[1] Sure "Et Teube", ajeti 80.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 75, f. 142.
Për më tepër informacion dhe komentim më të zgjeruar, adresohuni tek ajetet 11-12 të sures "El Huxhrat".

Kur'an na shpjegon se kjo gjë zakonisht vjen nga mendjemadhësia dhe pasuria: **"Që grumbullon pasuri dhe e ruan."**.

Ata që grumbullojnë pasuri, pa e ndarë se si e fitojnë atë, në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme.

Ata janë aq të pasionuar dhe të dhënë pas pasurisë, saqë e numërojnë vazhdimit atë dhe gëzohen për të. Çdo para është një idhull për ta. Ata, gjithë personalitetin e tyre, e shikojnë tek paraja, ose më mirë e përmbledhin te paraja. Ndaj është e natyrshme që të tillë persona, të paudhëzuar, të ofendojnë dhe të përçmojnë besimtarët.

Fjala *"adede"* vjen nga rrënja e fjalës *"ade"* që ka kuptimin: *numërim*.

Komentues të tjerë janë të mendimit se kjo fjalë vjen nga rrënja e fjalës *"udeh"*, me kuptimin: të përgatitësh këto mallra dhe këto rezerva. Të tjerë atë e kanë komentuar si vetëpërmbajtje dhe maturi. Kuptimi i parë është më i qartë nga të gjithë.

Gjithsesi, ajeti trajton çështjen e pasurisë jo si mjet, por si qëllim. Në mbledhjen e pasurisë ata nuk kanë asnjë kusht, si hallall dhe si haram. Ata dhunojnë të drejtat e të tjerëve dhe kjo gjë nuk u bën përshtypje, por krenohen se si dhe në ç'mënyrë i grumbullojnë pasuritë e tyre.

Ata nuk e duan pasurinë për të plotësuar nevojat jetësore, por e duan atë për lakminë që kanë.

Në Kur'anin e Shenjtë kritikohet kjo lloj pasurie, sepse nuk është fituar në Rrugë të Drejtë, ndërsa, për sa i përket pasurisë që është fituar në saje të mundit dhe të djersës, jo vetëm që nuk

konsiderohet gjë e keqe, por Kur'ani i Shenjtë i nxit njerëzit që e fitojnë pasurinë sipas së drejtës.

Kur'ani i Shenjtë, ata që e fitojnë pasurinë në Rrugë të Drejtë, i ka cituar si mirësi të All'llahut: **"Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e All'llahut dhe përmendeni shumë All'llahun, në mënyrë që të shpëtoni."**.[1]

Gjithashtu, All'llahu i Madhëruar, në një ajet tjetër kur'anor, thotë: **"Ju është urdhëruar që, nëse ndonjërit prej jush i afrohet vdekja dhe ka pasuri për të lënë pas, atëherë të lërë testamentin në mënyrë të drejtë për prindërit dhe farefisin; ky është detyrim për besimtarët e devotshëm."**.[2]

Një pasuri e vënë në këtë mënyrë, nuk është aspak mjet mendjemadhësie dhe as justifikim e tallje. Ndërsa një pasuri që shikohet si mjet adhurimi dhe qëllim kryesor për jetën, nuk ofron asgjë tjetër vetëm se të jesh tiran, sikurse ishte Karuni. Pasuri të tilla të bëjnë të rrish larg Zotit dhe afër zjarrit të Xhehennemit.

Në përgjithësi, të fitosh një pasuri kaq të madhe, nuk është e mundur përveçse me pisllëk. Në një hadith të Imam Ali ibn Musa Rrida *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nuk mund të mblidhet pasuria diku përveçse në pesë mënyra: koprraci e madhe, dëshira të largëta dhe të gjata, lakmi e përhapur, ndërprerje e marrëdhënieve familjare, si dhe vënia përparësi e kësaj botë ndaj Ahiretit."*.[3]

[1] Sure "El Xhum'a", ajeti 10.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 180.
[3] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 7, f. 668.

Personat që janë bujarë dhe nuk janë të lidhur pas dëshirave afatgjata, janë të kujdesshëm ndaj hallallit dhe haramit. Ata ndihmojnë të afërmit e tyre, zakonisht nuk grumbullojnë mallra pranë vetes së tyre, edhe pse të ardhurat e tyre mund të jenë të shumta.

Në ajetin tjetër shton: **"Duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!"**.

Ky njeri është grumbullues dhe adhurues i pasurisë. Ai pandeh se pasuria do jetë shkak i jetëgjatësisë së tij.

Është për t'u habitur se në këtë rast, fjala *"ekhlede"* është folje e kohës së shkuar, duke na kumtuar se ai mendon se malli i tij është si një qenie e përhershme, që as vdekja nuk i afrohet, as sëmundje dhe as problemet nuk i vijnë, sepse, sipas tij, çelësi i zgjidhjes së problemeve është pasuria që ka.

Sa mendim i gabuar dhe sa imagjinatë boshe! Karuni kishte aq shumë mall e pasuri, saqë edhe çelësat e thesareve ishin në dorën e tij. Por ato nuk shërbyen për asgjë, nuk mundën ta vononin vdekjen e tij.

All'llahu i Madhëruar e zhduku pasurinë e tij me një tërmet: **"Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t'i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i All'llahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten."**.[1]

Një tjetër shembull i plotë për këtë gjë është Faraoni i Egjiptit. Në Kur'anin e Shenjtë përshkruhet kështu: **"Eh, sa e sa**

[1] Sure "El Kasas", ajeti 81.

kopshte dhe burime i lanë ata, sa ara të mbjella dhe ndërtesa fisnike dhe sa begati, në të cilat kënaqeshin! Kështu, Ne ua lamë trashëgim ato një populli tjetër.".[1]

Ndaj në Ditën e Kiametit, kur perdet të largohen, do të kuptojnë gabimin e madh, atëherë do të bërtasin: **"Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!"**.[2]

Njeriu, në parim, nuk e dëshiron vdekjen, i neveritet ajo dhe po ashtu asgjëja. Ai është i pasionuar pas jetës së përhershme. Kjo dëshirë e brendshme ne na ndihmon shumë në çështjet që diskutojmë përreth Ringjalljes, për të ditur se njeriu është krijuar për të qenë i përjetshëm. Edhe nëse nuk është brenda tij shqisa e të jetuarit përjetësisht, ai këtë gjë e dëshiron.

Por ky njeri, i cili është mendjemadh, egoist, adhurues i kësaj bote, ndonjëherë e shikon jetëgjatësinë dhe përjetësinë e tij te gjëra që janë burim i vdekjes dhe i zhdukjes së tij, për shembull: pasuria dhe pozita, që vazhdimisht janë armik i jetëgjatësisë së tij. Ai i konsideron si mjet për jetëgjatësinë. Këtu bëhet e qartë se të mendosh përjetësish nëpërmjet pasurisë, si dhe pasuria të bëhet shkak i të jetuarit, atëherë kjo nuk është tjetër gjë vetëm se t'i hapësh gropën vetes.

Kur'ani, në përgjigje të këtij grupi, thotë: **"Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese."**.

Nuk është ashtu sikurse ai mendon. Shumë shpejt do të hidhet në zjarr, duke qenë i turpëruar.

---

[1] Sure " Dukhan" ajeti 25 deti 27.
[2] Sure " El Hakka" ajeti 28 dhe 29.

Më pas, vetë Kur'ani i Shenjtë e komenton kështu fjalën *"hutameh"* – *"shkatërruese"*: **"E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i All'llahut i ndezur fort."**.

Ky zjarr e ka burimin e tij nga zemra. Më pas i shikohen shenjat që ai lë në zemër: **"I cili depërton deri në zemrën e njeriut."**.

Fjala *"le junbedhen'ne"* vjen nga rrënja e fjalës *"nebedhe"* dhe sipas Ragibit, në librin e tij "Mufredat", ka kuptimin: të largosh diçka për shkak të poshtërimit dhe të mos pasjes vlerë.

All'llahu, këta mendjemëdhenj dhe koprracë, në Ditën e Kiametit i hedh në zjarr si gjëra pa vlerë, që të shikojnë përfundimin e mendjemadhësisë së tyre.

Fjala *"el hutametu"* vjen nga rrënja e fjalës *"hattame"* dhe ka kuptimin: *të thyesh diçka*. Kjo gjë tregon se, kur ata hidhen në zjarrin e përvëluar, zjarri ndahet në mes, për shkak të forcës së hedhjes.

Disa komentues janë të mendimit se fjala *"hutame"* nuk është emri i gjithë Xhehennemit, por është një pjesë jashtëzakonisht e nxehtë e tij.[1]

Ndoshta dikur ishte shumë e vështirë të konceptohej se pjesët e trupit tkurren në zjarr, ndërsa në ditët e sotme, kjo gjë është shumë e kuptueshme.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, Hadithi 60-64, f. 17-19.

Gjithashtu, ndikimi i forcës së valëve shpërthyese është shumë i qartë për të gjithë ne, mënyra se si ato shpërthejnë, bëjnë që të marrin me vete jo vetëm njerëzit, por hekur dhe shtylla të mëdha. Pra, tashmë kjo gjë nuk është më një pamje që nuk mund të konceptohet.

Grupi emëror **"zjarri i All'llahut"**, nënkupton madhështinë dhe fuqinë e Tij. Fjala *"muvekede"* është shkak për ndriçimin që bën gjithmonë ai.

Është për t'u habitur se ky zjarr, në kundërshtim me të gjitha zjarret e tjera, që në fillim djegin lëkurën e më pas futet brenda në trup, në fillim djeg zemrën dhe të gjitha pjesët e brendshme. Më pas djeg trurin, kockat dhe së fundi, djeg gjithë trupin nga jashtë.

Po çfarë zjarri është ky, që në fillim shfaq qelb në zemrën e njeriut? Çfarë zjarri është ky, që në fillim djeg nga brenda e më pas djeg nga jashtë?

Gjithçka në Ditën e Kiametit është e çuditshme, ka shumë ndryshim me këtë botë, po ashtu edhe zjarri i tij.

Po përse të mos jetë i tillë? Në zemrat e tyre ka ekzistuar ligji i mosbesimit dhe i mendjemadhësisë, qendra e tyre ka qenë dashuria për dynjanë dhe pasuria.

Po përse të mos i përpijë hidhërimi i zjarrit, ndërkohë që ata kanë hidhëruar zemrat e besimtarëve? Drejtësia hyjnore e kërkon që ata të shikojnë shpërblimin e veprave të tyre.

Së fundi, ajetet e kësaj sureje thonë se ky zjarr përvëlues vjen tek ata në çdo anë, i rrethon ata: **"Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë."**.

Fjala *"mu'sedetun"* vjen nga rrënja e fjalës *"el ijsadu"* dhe ka kuptimin: *të mbyllësh derën dhe ta forcosh shumë atë*. Ndaj edhe dhomat që i mbajnë për të ruajtur mall dhe pasurinë, u thonë *"uesid"*.

Në të vërtetë, ashtu sikurse ata i ruanin pasuritë e tyre nëpër arka e sëndukë, ashtu edhe All'llahu i fut ata në Xhehennem, nëpër arka e sëndukë të mbyllur, duke vuajtur dënimin.

Në përfundim, All'llahu thotë se ata do të vendosen nëpër shtylla të gjata dhe do të tërhiqen: **"Në shtylla të gjata flakëruese."**.

Fjala *"el amedu"* është shumësi i fjalës *"amuud"* dhe ka kuptimin: *shtyllë apo çdo gjë që është e gjatë*.

Fjala *"mumed'dedetun"* ka kuptimin: *e gjatë*.

Një grup komentuesish, fjalën *"mumed'dedeh"* e kanë quajtur si gozhdë gjigante shumë e madhe, prej hekuri, që me to janë mbyllur dyert e Xhehennemit. Ata janë të mbyllur në mënyrë të tillë, saqë nuk mund të gjendet rruga për të dalë.

Ky ajet e vë theksin tek ajeti i mëparshëm dhe thotë se dyert e Xhehennemit i mbyllin dhe nga çdo lloj ane janë të rrethuara.

Të tjerë, gjithashtu, e kanë konsideruar si një lloj mjeti për të ndëshkuar, që në mesin tonë e kanë krahasuar me pjesë të drurit dhe të hekurit.

Disa të tjerë e kanë bërë komentimin e tretë me ndihmën e eksplorimeve të fundit, flakët përvëluese të Xhehennemit tërhiqen si shtylla të gjata, duke i përvëluar ata.

Komentuesit, gjithashtu, thonë se në kërkimet dhe zbulimet e fundit është vërtetuar se flakët "X", në kundërshtim me flakët e tjera që vijnë në formë koni, qëndrojnë në mënyrë cilindrike, sikurse është shtylla.

Është për t'u habitur që këto flakë depërtojnë në të gjithë qenien e njeriut dhe janë dominuese edhe në zemrat e tyre. Për këtë arsye, për të fotografuar pjesët e brendshme të trupit përdorin rrezet "X". Por flakët e Xhehennemit nuk janë të pangjashme me flakët e mësipërme.[1]

Nga të gjitha këto komentime, më i përshtatshëm është komentimi i parë. (Sipas disa komentimeve, fjalia **"në shtylla të gjata flakëruese "**është shpjegim i gjendjes së Xhehennemit, kurse në disa të tjera shpjegon gjendjen e banorëve të Xhehennemit.

Hulumtime

[1] Tefsiri "Tantauij" fundi i ajetit në fjalë.

Mendjemadhësia është burim i gabimeve të mëdha

Të mendosh se ti je më i miri, është një fatkeqësi e madhe, është burimi i të gjitha të këqijave. Të mos mendosh për ato çka na ka dhuruar Zoti, të mos falënderosh për mirësitë e All'llahut, t'i vësh shkelmin mirësisë së All'llahut, të zhytesh në shfrenim, në përqeshje të të tjerëve, në ofendim të besimtarëve etj, të gjitha këto janë cilësi të mendjemadhësisë, të personave me pak kapacitet. Këta persona, sapo rriten në pozitë, ndryshojnë aq shumë, saqë nuk ia dinë vlerën të tjerëve. Kjo gjë bëhet shkak i ndarjes nga shoqëria dhe shkak i ndarjes së shoqërisë nga ata.

Ata e konsiderojnë veten e tyre të ndarë nga të tjerët, në pozitë të lartë, e konsiderojnë veten e tyre të dashur dhe të afërm të Zotit. Ky, pra, është shkak që ata të mos pyesin për sedrën dhe për vlerat e njeriut dhe të shpirtit të tij.

Është për t'u habitur se disa hadithe, këta persona i kanë krahasuar me akrepat, që do të thotë se puna e tyre është thumbimi, me ndryshimin që akrepi nuk thumbon nga zilia, ndërsa njeriu po.

Në një hadith thuhet: "Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë se në natën e Miraxhit pa disa banorë të Xhehennemit që i ndanin mishin nga shpatullat e tyre dhe ua jepnin për ushqim. Ai e pyeti Xhibrailin se cilët ishin këta. Xhebraili i tha: 'Këta janë ata që vetëm denigrojnë të tjerët'."[1]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 5, f. 667.

Ashtu sikurse e cituam edhe më lart, për këtë çështje kemi diskutuar dhe e kemi trajtuar në ajetet e sures "El Huxhurat".

Të kesh dëshirë për të mbledhur pasurinë

Për sa i përket pasurisë dhe grumbullimit të saj, ka mendime të ndryshme. Disa i kushtojnë shumë rëndësi, saqë të gjitha problemet i konsiderojnë hallall.

Ndaj nuk është për t'u habitur se ky grup të merret vazhdimisht me grumbullimin e pasurisë dhe nuk i bën përshtypje se nga e fiton këtë pasuri, në rrugë hallall apo haram.

Përballë këtyre gjendet një grup tjetër që nuk u bën përshtypje aspak pasuria, ata nuk i tremben varfërisë, përkundrazi e duan atë.

Gjithashtu, janë të mendimit se pasuria është bezdisëse, nëse duan të afrohen tek All'llahu.

Përballë këtyre dy besimeve vendosim atë çka thotë Kur'ani i Shenjtë, si dhe transmetimet dhe hadithet: "Pasuria është e mirë, por më kusht që:

Së pari, ajo të jetë mjet dhe jo qëllim;

Së dyti, njeriu të mos bëhet skllav i saj, por të jetë zotërues i saj;

Së treti, ajo të grumbullohet në mënyrë të ligjshme dhe jo në mënyrë të paligjshme, si dhe të harxhohet për kënaqësi të All'llahut. Ta duash një pasuri të tillë, jo vetëm që nuk është

adhurim i kësaj bote, por është argument për të dashur Botën e Përtejme.

Në një hadith kexojmë: Kur një prej shokëve të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dëgjoi se Imami po mallkonte floririn dhe argjendin, e pa me habi dhe e pyeti se përse po e mallkon. Imami iu përgjigj: *"Nuk është ashtu sikurse ti e kuptove, unë pata për qëllim floririn që e zhduk fenë, ndërsa qëllimi për argjendin ishte kur ai bëhet burim i mosbesimit."*.[1]

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Dehja është katër llojesh: dehja me alkool, dehja me pasuri, dehja me gjumë dhe dehja me pushtet."*.[2]

Në një hadith tjetër të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Një burrë erdhi pranë dhe kërkoi që Imami ta këshillojë. Imami i tha: 'Nëse mirësitë janë të drejta dhe kemi besim në to, atëherë përse na duhet grumbullimi i pasurisë? Përse të mos e falim në Rrugën e All'llahut, kur shpërblimi do të na kthehet nga ana e All'llahut, atëherë koprracia për çfarë është?'"*.[3]

Janë të shumtë personat që vazhdojnë të grumbullojnë pasuri e më pas e japin hua. Llogaria është më ata, ndërsa përfitimi është për të tjerët.

Në një hadith tjetër të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "Dikush e pyeti Imam *Aliun (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* se kush është personi më fatkeq. Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* i tha: 'Kushdo që e sheh pasurinë e tij në peshoren e matjes së

[1] "Biharul Enuar, vëll. 73, Hadithi 17, f. 141.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 73, Hadithi 18, f. 142.
[3] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 8, f. 668.

veprave të të tjerëve, Zoti atë për shkak të kësisoj pasurie do e fus në xhehenem dhe trashegimtarin e tij për shkak të asaj pasuije e dërgo në xhenet.[1]

Në një hadith tjetër të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për komentimin e këtij ajeti, lexojmë: *"Në këtë mënyrë All'llahu bën që ata të kenë keqardhje për pasurinë e tyre.*

Ky ajet është për personat që japin hua dhe për shkak të koprracisë së tyre, nuk falin asgjë në rrugën e All'llahut. Më pas vdesin dhe atë pasuri e lënë për persona që e përdorin si bindje ndaj Zotit, ose e përdorin në kundërshtim ndaj Tij. Nëse do ta shpenzojë këtë pasuri në Rrugë të Drejtë dhe duke iu bindur rregullave të All'llahut, atë e shikon në peshoren e veprave të mira, në të kundërt ata do të bëhen shkak për përforcimin e kryerjes së mëkatit.".

Çështja e grumbullimit të pasurisë është shumë delikate. Ajo të bën të ndërtosh idhuj të rrezikshëm dhe ndonjëherë bëhet shkak i fatmirësisë.

Këtë fjalim do ta përmbledhim me një hadith me shumë kuptim të Ibn Abasit: "Kur u vendos për herë të parë monedha në këtë botë, Iblisi u hodhi një vështrim. Si i pa ato, i mori dy në dorë dhe i vendosi mbi sytë. Më pas i vendosi në gjoksin e tij. Nga kënaqësia lëshoi britma. Përsëri i vendosi në gjoks dhe tha: 'Ju jeni drita e syve të mi dhe fryti i zemrës sime! Nëse njerëzit ju duan ju, nuk është më e rëndësishme që të bëjnë idhuj.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 73, Hadithi 21, f. 142.

Për mua është e rëndësishme që t'ju duan ju, sepse ju jeni idhujt më të mirë.".[1]

O All'llah! Na ruaj nga dehja e pasurisë, nga pozita e nga epshet e kësaj bote!

O All'llah! Na çliro nga pushteti i shejtanit dhe nga robëria e pasurisë së kësaj bote!

O All'llah! Zjarri i Xhehennemit është i tmerrshëm, t'i rrish larg zjarrit nuk është e mundur, përveç se me mëshirën dhe urdhrin Tënd o Zot!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Humeze".

[1] "Biharul Enuar", vëll. 73, Hadithi 30, f. 137.

Sure "El Fîl"

Zbritur në Mekë

Ajete 5

Përmbajtja e sures "El Fîl"

Kjo sure, sikurse kuptohet edhe nga emri i saj, flet për ngjarjen historike që ka ndodhur në lindjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në këtë histori tregohet se si All'llahu e ruajti dhe e mbrojti shtëpinë e tij,

Qaben, nga sherri i ushtrisë së madhe të qafirëve, që kishin ardhur nga toka e Jemenit, të hipur në elefantë, për të prishur Qaben.

Kjo sure rikujton një ngjarje të çuditshme. Shumë mekas e kishin të ruajtur në kujtesën e tyre, sepse kishte pak kohë që kishte ngjarë.

Kjo histori u tregon dhe u rikujton jobesimtarëve mendjemëdhenj se nuk kanë asnjë fuqi ndaj fuqisë së All'llahut. All'llahu i Madhëruar e sulmon ushtrinë e tyre të elefantëve me zogj të vegjël, duke i goditur me gurë balte.

E kështu i godet mendjemëdhenjtë dhe arrogantët kokëfortë, duke ua treguar vendin e tyre.

Fuqia e tyre nuk ishte as më e madhe se sa fuqia e reve dhe ushtria e tyre nuk e arrinte kurrë atë kapacitet, prandaj, përse nuk bindeni dhe përse nuk e ulni hundën, kur ju vetë e keni parë atë ndodhi me sytë tuaj?!

Mirësitë e leximit të sures "El Fîl"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Kushdo që e lexon këtë sure (Fil), në namazet e detyruara (vaxhib), në Ditën e Kiametit do të dëshmojnë për të,*

gjithçka që është në tokë, se ky njeri është prej namazfalësve. Gjithashtu, do të thërrasin për të, se ai është prej njerëzve që thotë të vërtetën dhe do të futet në Xhennet, pa dhënë llogari. Xhenneti do të thotë se e dua këtë njeri dhe veprat e tij.".[1]

Është e qartë se mirësia e leximit të sures fitohet, nëse veprohet ashtu siç urdhëron në të All'llahu.

Ajetet 1- 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan" vëll, 10 fq, 539.

﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ١ أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ٢ وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ٣ تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِنْ سِجِّيلٍ٤ فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَأْكُولٍ٥﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshrshim, Mëshirëplotit!

"Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?"

"A nuk ua prishi atyre kurthin,"

"Duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,"

"të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?"

"Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë."

Shkaku i zbritjes

Në një hadith të Imam Ali ibn Husejnit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "Ebu Talibi e mbronte vazhdimisht me shpatë Profetin *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!). Një herë i thotë: 'Djali i vëllait tim, a je dërguar ti për të gjithë njerëzit apo vetëm për popullin tënd?'

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *Jam përzgjedhur për të gjithë njerëzimin, të bardhë e të zinj, arabë dhe jo arabë. Betohem për atë që shpirti im është në dorën e Tij, unë i ftoj të gjithë njerëzit, të bardhë e të zinj t'i bashkëngjiten kësaj feje. Ftoj në këtë fe, të gjithë ata që qëndrojnë mbi male dhe dete. Unë ftoj të gjithë ata që flasin gjuhën perse dhe romake drejt udhëzimit.*

Kur kjo fjalë arriti në veshin e kurejshëve, ata u trishtuan dhe thanë: "A nuk po e dëgjon se ç'thotë djali i vëllait tënd?

Nëse populli pers dhe romak i dëgjon këto fjalë, ne do të na nxjerrin nga kjo tokë dhe gurët e Qabes do t'i copëtojnë pjesë–pjesë".

Këtu All'llahu i Madhëruar zbriti ajetin 57 të sures "El Kasas": **"Ata thonë: 'Nëse ndjekim udhëzimin së bashku me ty, së shpejti do të jemi të dëbuar nga vendlindja'. Vallë, a nuk ua kemi mundësuar, që të jetojnë në një vend të shenjtë e të sigurt, ku sillen fruta të llojllojshme, si ushqim prej Nesh? Por shumica e tyre nuk e dine."**.

Për shkak të kësaj fjale që ata thanë, që Shtëpinë e Zotit do ta bëjnë copash, All'llahu zbriti suren "Fil", duke u kujtuar atyre se askush nuk mund të ketë forcë për ta bërë këtë gjë.[1] Tregimi i as'habëve të elefantëve.

Komentuesit dhe historianët këtë ngjarje e tregojnë në mënyra të ndryshme. Midis tyre ka diskutime, për sa i përket vitit

[1] Tesiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 8, f. 669.

të ndodhisë. Ngjarja është shumë e njohur. Ne këtë ngjarje do ta tregojmë sipas transmetimit të njohur, që është cituar nga "Sire" Ibn Hishami, në "Bulugul Erbu", "Biharul Enuar" dhe "Mexhmaul Bejan". Kemi bërë një përmbledhje:

Mbreti Dhu Nevas , të krishterët e Nexhranit, të cilët jetonin pranë asaj toke i kishte dhunuar dhe i kishte dënuar që të hiqnin dorë nga feja e krishterë. (Kur'ani këtë ngjarje e trajton në suren "Burûxh", duke i konsideruar këta njerëz si Ashabi Uhdud. Ne në komentim kemi sjellë po këtë sure të njohur.)

Pas kësaj ngjarje të dhunshme dhe të përgjakshme, një burrë, me emrin Dus, vendosi të shkojë tek udhëheqësi i Romës, i cili ishte i krishterë. Atij i tregoi gjithçka që kishte ngjarë.

Duke qenë se largësia nga Roma dhe Jemeni ishte e madhe, udhëheqësi i Romës i shkruan një letër Nexhashit, mbretit të Etiopisë që të merrte hak për të krishterët e Nexhranit. Letrën e dërgoi me po atë person që erdhi e kërkoi ndihmë.

Mbreti Nexhash nisi një ushtri të madhe drejt Jemenit, me në krye Arpatin dhe Abrehan, komandant të kësaj ushtrie.

Dhu Nevasi humbi dhe Erpati u bë udhëheqës i Jemenit. Pas një periudhe, Ebrehi u ngrit kundër tij dhe, pasi e vrau atë, i zuri vendin, i mori pushtetin.

Lajmi i kësaj ngjarje arriti te Nexhashi. Ai vendosi që ta shtypë Abrehan. Abreha, për të shpëtuar veten, rruajti kokën dhe flokët i leu me baltën e Jemenit dhe u nis drejt mbretit Nexhash, për t'i treguar se është dorëzuar dhe është besnik i tij. Nexhashi kur e pa kështu, e fali.

Abreha, për të treguar se është në shërbim të tij, ndërtoi një kishë shumë të bukur, e cila nuk ishte parë në asnjë vend në tokë deri në atë periudhë. Ata vendosën që njerëzit e Gadishullit Arabik t'i ftojnë drejt asaj kishe, në vend të Qabes. Ata, në këtë mënyrë, vendosen që Qaben, që është qendra e gjithë myslimanëve, ta dërgonin në Jemen dhe Jemeni të bëhet qendër e rëndësishme. Për këtë qëllim u nisën shumë propagandistë drejt Mekës dhe Hixhazit. Arabët, që ishin shumë të dashuruar me Mekën dhe Qaben, e ruanin dhe e nderonin atë, sepse e kishin trashëgimi të Profetit Ibrahim, ndjenë se ishin në rrezik.

Sipas disa transmetimeve, një grup, fshehurazi, i vuri zjarrin kishës.

Sipas një tjetër transmetimi, kishën e kanë ndyrë, kështu që e gjithë ajo ftesë dhe madhështi që u bë për Kishën, mbeti një vepër e pasigurt dhe punën e Abrahasë e bëri të pasigurt. Abrahaja u zemërua keq dhe vendosi ta shkatërrojë Qaben, për të marrë hak, si dhe arabët i njoftojë së vendi i cili ata duhet të adhurohet nuk është më Qabja. Kështu Abraha, me një ushtri të madhe, e cila kishte edhe elefantë, u nis drejt Mekës. Kur u afruan pranë Mekës, vendosën të nisin disa ushtarë për të marrë plaçkën që kishte Meka dhe devetë e saj.

Abdul Mutalibit i marrin dyqind deve. Abrahaja dërgoi një njeri në brendësi të Mekës, që të gjejë të parin e Mekës dhe t'i thotë se Abreha, mbreti i Jemenit, nuk ka ardhur për luftë, por ka ardhur vetëm të shkatërrojë Qaben. Nëse nuk sulmoni, ai nuk ka përse ta dredhë gjakun tuaj.

I urdhëruari i Abrahesë u fut në Mekë. Nisi të kërkojë kryetarin e Mekës. Të gjithë i treguan Abdul Mutalibin. Si iu afrua pranë, i tregoi shkakun e ardhjes.

Abdul Mutalibi tha: *"Ne nuk jemi në nivelin tuaj për të luftuar, ndërsa Qaben e ruan vetë Zoti."*.

Lajmësi i Abrahesë i tha Abdul Mutalibit që të shkonte të fliste me Abrahanë. Kur Abraha e pa Abdul Mutalibin, u emocionua shumë, sepse Abdul Mutalibi qe shumë tërheqës dhe i nderuar. Kur ai u afrua pranë, Abraha u ngrit në këmbë dhe u ul në tokë për respekt.

E uli pranë vetes Abdul Mutalibin dhe i tha përkthyesit që ta pyeste Abdul Mutalibin se çfarë kërkese ka.

Përkthyesi i tha se dëshira dhe kërkesa e tij është që t'i kthehen devetë e marra peng, sepse i janë marrë dyqind deve.

Abraheja u habit shumë nga kjo kërkesë dhe i tha përkthyesit t'i përkthente fjalët e tij.

- Kur të pashë ty në fillim, thashë me vete se ti je një njeri autoritar, me pushtet të madh, por tani që dëgjova këto fjalë, po më dukesh shumë i vogël dhe pa pushtet. Ti po kërkon dyqind deve dhe për Mekën nuk thua asgjë?

- Unë jam pronar i deveve. Edhe kjo shtëpi ka një pronar, që e mbron atë, - iu përgjigj Abdul Mutalibi. (Këto fjalë bënë që Abraheja të lëvizë).

Abdul Mutalibi u afrua pranë Mekës dhe u tha njerëzve që të fshihen, vetë dhe një grup njerëzish të tjerë u afruan pranë Qabes,

që të luteshin. Pasi u lutën, u larguan nga Qabja për t'u mbrojtur diku.

Ebu Talibi urdhëroi njërin prej djemve, që të qëndronte në malin Abu Kabis, për të parë se çfarë do të ndodhte. Djali i tij, shumë shpejt, u kthye pranë tij dhe tha: "Baba! Nga Deti i Kuq shikohet një re e zezë, që po vjen drejt tokës sonë!".

Ebu Talibi u gëzua dhe thirri: "O kurejsh! Kthehuni në shtëpitë tuaja, sepse shpresa hyjnore po vjen drejt nesh!".

Por, edhe ushtria e Abrahasë, së bashku me elefantët, që mbante emrin Mahmud, po i afroheshin Qabes, për ta rrënuar atë. Sado që Abraheja e nxiste elefantin e tij të ecte më shpejt, ai nuk lëvizte shpejt.

Abraheja u habit shumë nga sjellja e elefantit. Në këtë çast, nga deti u afruan shpendë. Ata ishin të ngjashëm me dallëndyshet. Secili prej tyre mbante tre gurë, një në sqep dhe dy të tjerët te kthetrat. Gurët ishin sa një qiqër dhe të gjithë gurët u zbrazën mbi ushtrinë e Abrahesë. Po të godiste guri, të shponte tej e tej dhe të linte te vdekur. Kur ushtria e Abrahasë e pa këtë gjë, nisi të ikte nga aty, për t'u shpëtuar gurëve, por nuk pati shpëtim. Vetë Abrahaja u plagos dhe u kthye ne vendin e tij, por nuk shpëtoi, sepse kishte marrë plagë të rënda.

Disa thanë se numri i elefantëve që Abrahaja kishte sjellë, ishte tetëmbëdhjetë. Disa vetëm dymbëdhjetë, të tjerë thanë se ishte vetëm elefanti Mahmud. Po në këtë vit, sipas mendimit më të njohur, lind edhe Profeti ynë Muhammedi *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*. Kjo ngjarje ishte aq shumë e

rëndësishme, saqë e quajtën *Amul Fijl*, viti i elefantit dhe e përcaktuan si fillimin e historisë arabe.[1]

Komentimi

Intriga e Abrahas

Në ajetin e parë të kësaj sureje thuhet: **"Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?".**

Ata erdhën që nga Jemeni me ushtri të fuqishme, për të shkatërruar shtëpinë e Zotit, por All'llahu, me një ushtri, që në pamje të jashtme dukej e vogël dhe e papërfillshme, i rrëzoi ata përtokë, bëri që ata elefantë të mëdhenj, të rrëzohen në tokë nga dallëndyshet e vogla. E gjitha kjo ishte për t'i treguar fuqinë hyjnore njeriut mendjemadh.

Fjalia: "*Elem Tera*" – "A nuk e pe?", është cituar sikur i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sikur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kishte parë atë ngjarje, edhe pse në atë kohë ai nuk kishte lindur akoma. Kjo ngjarje ndodhi kur lindi Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo ngjarje ishte bërë aq e njohur dhe e

[1] "Sire Ibn Hisham", vëll. 1, f. 38–62; "Bulugul Erb", vëll. 1 f. 250-263; "Biharul Enuar", vëll. 15, f. 130 dhe "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 542.

përsëritur nga të gjithë, saqë dukej sikur Profeti i nderuar dhe disa bashkëkohës të tij e kishin parë me sytë e tyre atë.

Togfjalëshi: *"as'habul fil"* – "njerëzi e elefantit" tregon elefantët që u përdorën në këtë luftë. Ata u sollën që nga Jemeni për të rrëzuar shtëpinë e Zotit. [1]

Më tej shton: "A nuk ua prishi atyre kurthin?".

Abrahaja kishte për qëllim të rrëzonte Qaben, me shpresën se një nga kishat e Jemenit të bëhej qendra e të gjitha fiseve arabe. Por ata jo vetëm që nuk e arritën qëllimin e tyre, por kjo ngjarje bëri që i gjithë Gadishulli Arabik të marrë vesh se çfarë kishte ngjarë me Ebrehenë dhe Shtëpinë e Zotit.

Gjithashtu, kjo ngjarje bëri që njerëzit të kenë më shumë besim dhe siguri.

Fjala *"tedlijl"* - *"i humbur dhe devijim"*, në këtë rast, është përdorur për të treguar se ata nuk e arritën kurrë qëllimin e tyre.

Më tej shpjegon më hollësisht këtë ngjarje, duke thënë se All'llahu dërgoi tek ata shpendë që vinin grupe-grupe mbi kokat e tyre: **"Duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh."**.

Fjala *"ebabijl"*, në kundërshtim me atë që është njohur, si emër i një shpendi, nuk ishte emri i shpendit, por ky emër ka një kuptim më të gjerë. Disa janë të mendimit se ka kuptimin e një

[1] Fjala *"fijl"* – *"elefanti"*, në këtë rast, është në numrin njëjës, por përfaqëson kuptimin e shumësit.

grupi të ndarë, sepse shpendët erdhën grupe-grupe nga çdo anë, drejt ushtrisë së elefantit.

Kjo fjalë ka kuptimin e shumësit, që disa e thonë në njëjës *"ebabiletu"*, që ka kuptimin: një grup nga shpendët, ose kuajt, ose devetë.

Disa të tjerë thonë se është shumës që nuk ka njëjës.

Sidoqoftë, në këtë rast, fjala *"taijr"* është në shumës dhe të dyja këto fjalë *"taijr"* dhe *"ebabil"* kanë kuptimin shpendë që vijnë grupe-grupe dhe nuk është emri i shpendëve.

Ndërsa, për sa i përket faktit se çfarë lloji ishin shpendët, ashtu sikurse e thamë edhe në komentimin e tregimit të kësaj ngjarjeje, mendimi më i njohur është se ato ishin dallëndyshe që erdhën nga Deti i Kuq dhe sulmuan njerëzit e elefantëve.

Në ajetin tjetër thuhet se këta shpendë qëlluan ushtrinë (e elefantit) me gurë prej balte: **"Të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur."**.

Ashtu sikur e thamë edhe më lart, në historinë e njerëzve të elefantit, shpendët mbanin tre gurë, një në sqep dhe dy të tjerët te këmbët e tyre.

Gurët që mbanin, ishin në madhësinë e një qiqre, ose më të vegjël. Por këta gurë, nëse të zinin, të bënin copë, ashtu sikurse

thuhet edhe në ajetin e mëposhtëm: **"Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë."**.

Fjala *"asefun"* ka kuptimin: gjethe që bien mbi bahçe dhe më pas thahen e bëhen grimca të shtypura, pra byku.

Disa komentues janë të mendimit se ato ishin lëvozhga të grurit, të cilat mbeten në kallirin e tij.

Në këtë rast, është më e përshtatshme të thuhet se ka kuptimin e parë, gjethe të grimcuara dhe të shtypura.

Fjala *"me'kul"* ka kuptimin: këto gjethe ishin thërrmuar dhe ishin brejtur nga dhëmbët e kafshëve. Kjo tregon se gurët që lëshonin shpendët, kishin një përbërës të fortë, që i shkërmoqte ashtu njerëzit. Ky interpretim, përveçse tregon arsyen e shkatërrimit të tyre, tregon edhe se sa pa vlerë dhe i dobët ishte grupi shkatërrues.

Hulumtime

1- Mrekullia e jashtëzakonshme! (Kjo shtëpi ka të Zotin e vet!)

Është për t'u habitur se si Kur'ani i Shenjtë, këtë tregim të gjatë e ka përmbledhur në disa fjalë të shkurtra.

Në të vërtetë, janë vendosur pikat mbi "i", që do të thotë se mendjemëdhenjtë e shikuan pafuqinë e tyre dhe fuqinë e Zotit.

Kjo ngjarje tregon se mrekullitë dhe punët e jashtëzakonshme, në kundërshtim me mendimin e disave, nuk është e thënë që detyrimisht mrekullia të bëhet vetëm me dorën e Profetit dhe të Imamit.

Por, kurdo që Zoti të dëshirojë dhe ta shikojë të nevojshme, kryen mrekulli. Qëllimi është që njerëzit të njohin të vërtetën.

Këto mrekulli të çuditshme kanë një ndryshim me mrekullitë e popujve të pabindur.

Populli të Nuhut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, Zoti i lëshoi tufan, tërmet. Populli të Lutit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, Zoti i lëshoi shi me gurë. Populli i Themudit pati një sërë ngjarjesh natyrore, të cilat ishin mrekulli, për nga kushtet që ndodhën.

Populli i Adit u përmbys dhe u zhduk nga era e fortë. Ndërsa ngjarja e ushtrisë se Ebrehesë nuk është prej ngjarjeve

natyrore, sepse ushtria e tij u mund nga gurët e vegjël, që shpendët mbanin në sqepin dhe te këmbët e tyre.

Ngritja e këtyre shpendëve të vegjël dhe ardhja e tyre drejt ushtrisë së Abrahasë dhe e gjithë ajo çka shpendët bënë, është një punë e jashtëzakonshme. Por ne e dimë se e gjitha kjo nuk krahasohet me fuqinë e All'llahut.

All'llahu, në brendësi të këtyre guralecëve, kishte vendosur fuqinë atomike dhe në momentin që ato hidheshin, krijonin një shpërthim të fuqishëm.

Të gjitha këto mrekulli janë të lehta për fuqinë e All'llahut.

Nuk është e nevojshme ta komentojmë ajetin, sikurse bëjnë disa komentues, që për t'i dhënë vëmendje kësaj çështje, të themi

që guralecët mbartnin mikrobe, të cilat shkaktonin sëmundje të rënda, që të çonin drejt vdekjes.[1]

Nëse është transmetuar në disa transmetime se në trupat e viktimave kishte flluska gjaku dhe qelbi, nuk është e thënë se ata kishin sëmundjen e lisë.

Po ashtu, nuk është e nevojshme të themi se guralecët ishin jashtëzakonisht të rëndë e, ku binin, hapnin vrimë.

Të gjitha këto justifikime janë bërë për ta treguar ngjarjen në mënyrë sa më natyrore. Ne nuk e shikojmë të nevojshme t'i themi këto.

I vetmi informacion që ne kemi për ata gurë, është se veçoria e çuditshme e tyre, ishte dekompozimi. Më tepër se kaq, për ta nuk ka informacion.

Sidoqoftë, përballë fuqisë së All'llahut, asnjë punë nuk është problem.

2- Mrekullitë më të vështira me më pak mjete

Është për t'u vënë në qendër të vëmendjes fuqia e All'llahut, e cila është përshkruar në mënyrën më të përsosur, përballë arrogantëve dhe dhunuesve. Ndoshta nuk ka pasur ndëshkim më

[1] Tefsiri "Muhamed Abduh", vëll i fundit, f. 158. Nëse në disa libra të historisë është shkruar se në atë periudhë kishte rënë sëmundja e lijës, kjo nuk do të thotë se është shkaktuar nga gurët

të vështirë se sa ai i ushtrisë së Ebrehesë, e cila u shkatërrua copa-copa.

Për shkatërrimin e asaj ushtrie u përdorën guralecë dhe shpendë të vegjël si dallëndyshet. E gjitha kjo është paralajmërim për arrogantët në të gjithë botën, për të parë se sa të fuqishëm janë përballë fuqisë së All'llahut.

All'llahu mund të kishte lëshuar mikrobe të kolerës dhe të mortajës, të cilat nuk shikohen me sy dhe për një kohë të shkurtër popujt e fuqishëm i shkatërronte.

Diga e madhe Me'reb në Jemen, sikurse është thënë në tefsirin e sures "Sebe'", u bë mjet i gjetjes së një qytetërimi të madh dhe të fuqishëm.

Por urdhri për zhdukjen e saj (digës), sikurse është transmetuar në disa hadithe, u la në dorë të disa minjve të shkretëtirës.

Minjtë arritën ta prishin digën e madhe, duke bërë vrima në të. Vrimat u bënë aq të mëdha, saqë diga u shkatërrua plotësisht.

Uji që mbante diga përmbyti gjithçka: shtëpitë, kështjellat dhe gjithë popullsinë e tyre e zhduku. Kjo është fuqia e Zotit.

3- Qëllimi i ngjarjes së elefantit

Në suren "Kurejsh" shpjegohet shumë mirë që njëri prej qëllimeve të sures "El Fil" është rikujtesa ndaj mirësive të mëdha të All'llahut, që u ka dhënë kurejshve.

Gjithashtu, tregon mirësinë e All'llahut se, nëse nuk do të ishte mirësia e All'llahut, nuk do të kishte mbetur asnjë gurë nga Meka e Qabja, po ashtu as nga kurejshët.

Ndoshta atyre do t'u zërë sytë mendjemadhësia dhe arroganca dhe nuk do ta pranojnë ftesën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Nga ana tjetër, kjo ngjarje ndodhi, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi në këtë botë.

Kjo ngjarje është kërcënim për të gjithë arrogantët në të gjithë botën, që ta dinë, se asnjëherë nuk mund të qëndrojnë përballë fuqisë së All'llahut.

Do të ishte më mirë për ta, që të dorëzohen përballë Krijuesit.

Nga ana tjetër, rëndësia e kësaj Shtëpie të madhe tregon se, kur armiku i Qabes nis punën për ta shkatërruar atë, apo për t'i ndërruar vendin, All'llahu u jep atyre një mësim të tillë që të mos e harrojnë asnjëherë ligjin e shenjtë.

Në këndvështrimin tjetër, All'llahu i Madhëruar e kishte pranuar lutjen e Profetit Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, që kjo tokë e shenjtë gjithmonë do të qëndrojë e sigurt.

Në këtë ngjarje është treguar se Qabeja do të jetë gjithmonë e sigurt. Ajo çka është për t'u cituar, në këtë rast, është kjo ngjarje, e cila për të gjithë arabët nisi një histori të re për ta.

4- Ndodhi e skatë historike

Sikurse thamë, Kur'ani i Shenjtë, me interpretimin e bukur që bën, i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke i thënë: **"A nuk e pe?"**.

Një interpretim i tillë tregon se, edhe pse Profeti nuk ishte në atë kohë, ngjarja është aq e freskët, saqë nuk është harruar dhe është e vërtetë.

Duke i lënë mënjanë këto, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i lexoi këto ajete për jobesimtarët e Mekës, asnjëri prej tyre nuk e mohoi këtë ngjarje. Nëse ndonjë nga fjalët do të ishte e dyshimtë, ata, së paku, do të bënin ndonjë kritikë. Nëse do të kritikonin, kritika e tyre do të

regjistrohej në histori, ashtu sikurse janë regjistruar kritikat e tjera të tyre.

Kur'ani i Shenjtë e ka nisur fjalinë: **"A nuk ke dëgjuar ti...?"**. E gjithë kjo mrekulli e shtëpisë së Shenjtë është regjistruar në histori.

O All'llah! Na jep mundësinë ta ruajmë Ligjin e madh Hyjnor.

O All'llah! Priti duart e atyre që hiqen se duan ta ruajnë Ligjin Hyjnor, por në të vërtetë ata duan ta fshijnë të vërtetën.

O All'llah! Na bëj prej vizituesve të sinqertë të Shtëpisë së Shenjtë.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Fijl".

Sure "El Kurejsh"

Zbritur në Mekë

Ajete 4

Përmbajtja e sures "El Kurejsh"

Kjo sure konsiderohet si plotësuese e sures "El Fil", sepse ajetet e saj janë të qarta dhe janë argumente për këtë çështje.

Ashtu sikurse në fillim të sures "Ed Duha" thamë se kjo sure dhe surja "El Inshirah" konsiderohen një sure, edhe surja "El Fijl" dhe surja "El Kurejsh" konsiderohen një, sepse, nëse e lexojmë me vëmendje përmbajtjen e saj, do të shikojmë se sa të lidhura janë ajetet me njëra-tjetrën, gjë të cilën e marrim si argument për të qenë një sure e vetme.

Për këtë shkak, nëse në namaz lexojmë njërën sure, duhet t'i lexojmë të dyja. Për shpjegim më të qartë për këtë rregull, mund të shikoni në librin e Fik'hut.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*ka thënë: *"Kushdo që e reciton këtë sure, merr dhjetë mirësi, në masën e të gjithë atyre që bëjnë tavafin e Qabes."*[1]

Sigurisht që mirësia është për ata që e adhurojnë All'llahun me sinqeritet, dhe e respektojnë Shtëpinë e All'llahut..

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 543.

Ajetet 1 - 4

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿لِإِيلَافِ قُرَيْشٍ١ إِيلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ٢ فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ٣ الَّذِى أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ٤﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"(Shkatërrimin e njerëzve të elefantit All'llahu e bëri) **për të mbrojtur fisin Kurejsh,"**

"Për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë."

"Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes)**,"**

"I Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike."

Komentimi

Zoti i kësaj Shtëpie duhet të adhurohet

Në suren "El Fijl" u fol për shkatërrimin e ushtrisë së elefantit të Abrahasë, i cili ishte nisur drejt Shtëpisë së All'llahut, për ta shkatërruar atë. Në fillim të kësaj sureje që, në të vërtetë është plotësuese për suren "El Fijl", thuhet se ushtria e elefantit u shkatërrua, u shtyp si gjethet e grimcuara. E gjithë kjo u bë për të siguruar kurejshët: "(Shkatërrimin e njerëzve të elefantit All'llahu e bëri) **për të mbrojtur fisin Kurejsh."**.

Fjala *"li ijlafi"* ka ardhur në paskajore dhe ka kuptimin: *për të falur dashuri*. Disa, fjalën "*li ilaf"*, e kanë komentuar me kuptimin: *"besëlidhje"*.

Ky komentim nuk ka asnjë lidhje me këtë fjalë, e cila është paskajore në veprim, *"bab efal"*.

Gjithashtu, nuk ka lidhje edhe me përmbajtjen e ajetit.

Sidoqoftë, në këtë rast, ka për qëllim dashurinë ndërmjet kurejshëve dhe tokës së shenjtë të Mekës dhe Qabes, sepse ata dhe të gjithë vendasit e Mekës, për shkak të sigurisë së kësaj toke, qëndronin atje.

Shumë njerëz nga Hixhazi, çdo vit, shkonin për të kryer ritualin e Haxhit. Ata kishin marrëdhënie ekonomike dhe kulturore midis tyre.

Gjithashtu, flitet se midis tyre kishin edhe veprimtari të tjera, që në sure nuk janë cituar.

Mirësitë e kësaj toke ata nuk i përdornin.

Të gjitha mirësitë që kjo tokë kishte, ishin për shkak të sigurisë që All'llahu i kishte dhënë. Nëse kjo Shtëpi e Shenjtë do ta humbiste sigurinë e saj, nuk do të gëzonte e nuk do të shikohej me dashuri.

Shumë komentues dhe njohës të fjalorit, fjalën *"kurejsh"* e kanë komentuar me kuptimin e një lloj kafshe të madhe, që mund të hajë shumë kollaj çdo kafshë tjetër.

Kur e pyetën Ibn Abasin se përse kurejshët janë quajtur kurejsh, ai tha: "Në origjinal, është emri i një kafshe të madhe, të fortë, që nuk ia hedh dot asnjë kafshë tjetër, qoftë e shëndoshë apo e dobët.".

Më pas për ta vërtetuar fjalën e tij, Ibn Abasi sjell si dëshmi një slogan të arabëve. Pra, përzgjedhja e emrit të këtij fisi ishte për shkak të fuqisë dhe keqpërdorimit të pushtetit dhe fuqisë që kishin.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"kurejsh"* është me kuptimin: *përvetësim,* sepse ky fis përvetësonte pjesën më të madhe të fitimit dhe të tregtisë.

Të tjerë janë të mendimit se ka kuptimin: "*inspektim*", sepse kurejshët inspektonin dhe kishin informacion për gjendjen e pelegrinëve dhe po ashtu shumë herë i ndihmonin ata. Për këtë shkak u përzgjodh kjo fjalë për ta.

Në fjalor, fjala "*kurejsh*" ka kuptimin: *komunitet*. Për shkak se ky fis ishte një komunitet i veçantë, u përzgjodh ky emër për ta.

Sidoqoftë, emri i kurejshëve në ditët e sotme nuk ka ndonjë kuptim interesant, edhe pse ata janë nga fisi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata konsiderohen si më kokëfortët dhe armiqtë e Islamit në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata, edhe kur Islami fitoi përsëri, nuk hoqën dorë nga komplotet e fshehta. Pasi Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u largua nga kjo botë, ata sollën në histori një ngjarje shumë të dhimbshme, që nuk do të harrohet në historinë e Islamit. Ne e dimë që Beni Umajadët dhe abasitët, me pushtetin e tyre arrogant, u ngritën nga kurejshët.

Në ajetitn tjetër, thuhet se qëllimi ishte që Zoti t'u siguronte kurejshëve udhëtim të lirë, dimër e verë: **"Për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë."**.

Mundet që qëllimi i faljes së dashurisë ka të bëjë me këtë Tokë të Shenjtë, që ata, përgjatë udhëtimit që bëjnë dimrit dhe verës, të mos heqin dorë nga dashuria për Shtëpinë e Shenjtë dhe, për shkak të sigurisë, të kthehen drejt saj, të mos qëndrojnë në Jemen apo Damask dhe Tokën e Shenjtë ta lënë bosh.

Ndoshta mund të ketë për qëllim edhe dashurinë midis kurejshëve dhe fiseve të tjera, që përgjatë këtyre dy udhëtimeve njiheshin, sepse, pas ngjarjes së Ebrehesë, njerëzit kishin respekt të madh për kurejshët.

Kurejshët kishin nevojë për këtë siguri përgjatë udhëtimeve të tyre, po ashtu edhe Mekën. All'llahu, me thyerjen që i bëri ushtrisë së Ebrehesë, ua siguroi të dyja këto.

Tokat në Mekë nuk kanë të mbjella, gjuetia, po ashtu, ishte e kufizuar. Të ardhurat e tyre më të shumta ishin nga tregtia. Në periudhën e dimrit ata udhëtonin drejt Jemenit dhe koha ishte e mirë, ndërsa në verë ata udhëtonin drejt Damaskut, ku koha ishte përsëri e përshtatshme, jo shumë e nxehtë. Këto vende kishin një ligj shumë të rëndësishëm tregtar, në atë kohë. Meka dhe Medina ishte ura e lidhjes midis tyre, për sa i përket tregtisë.

Sigurisht që kurejshët, me gjithë punët e tyre, nuk ishin të denjë për mirësitë që All'llahu u kishte dhënë. Por ishte përcaktuar nga Zoti që në këtë fis dhe në këtë Tokë të Shenjtë do të lindë Islami dhe Profeti. All'llahu u dha gjithë këto mirësi.

Në ajetin tjetër kuptojmë se kurejshët, me të gjitha këto mirësi hyjnore që vinin për shkak të Shtëpisë së Shenjtë, All'llahu i urdhëron që ta adhurojnë Atë: **"Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie** (Qabes)**"**, Zotin që i shpëtoi ata nga uria dhe i siguroi, pas frikës që ata kishin: **"I Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike."**.

Nga një anë, Zoti atyre u kishte siguruar një tregti të mirë dhe, nga ana tjetër, u kishte larguar pasigurinë. Të gjitha këto u erdhën atyre pas humbjes së ushtrisë së Ebrehesë, që në të vërtetë, gjithçka kthehet te lutja e Profetit Ibrahim *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, i cili ishte ndërtuesi i Qabes. Kurejshët nuk ia dinin vlerën asnjërës prej këtyre mirësive dhe Shtëpinë e Zotit e kishin kthyer në shtëpi idhujtarie dhe adhuronin idhujt.

O All'llah! Na jep mundësinë e adhurimit të sinqertë dhe të falënderimit për të gjitha mirësitë!

O All'llah! Këtë qendër të Islamit bëje dita-ditës më të gjallëruar dhe urën e lidhjes midis myslimanëve të botës!

O All'llah! Largoji armiqtë dhe ata që përfitojnë për keq nga ky vend i shenjtë!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Kurejsh".

Sure "El Mâ'ûn"

Zbritur në Mekë

ajete 7

Përmbajtja e sures "El Mâ'ûn"

Kjo sure, sipas besimit të shumë komentuesve, është prej sureve mekase. Mënyra e të shprehurit në rreshta të shkurtër, por kuptimplotë, flet për Kiametin dhe veprat e mohuesve të tij.

Surja përshkruan, në pesë faza, cilësitë e veprave të mohuesve në Ditën e Kiametit. Në fillim trajtohet çështja e mohimit të Ditës së Kiametit dhe të dhurimit në Rrugën e Zotit, që nuk ndihmonin jetimët dhe të pastrehët, dhe faljen e bënin për sy e faqe. Nevojtarëve u kthenin kurrizin.

Disa janë të mendimit se kjo sure ka zbritur për Ebu Sufjanin, që çdo ditë therte dy deve të mëdha, që të ushqehej vetë dhe shokët e tij me to. Një ditë vjen pranë tij një jetim dhe i kërkon diçka. Ai, i nevrikosur, e qëllon dhe e largon nga aty.

Komentues të tjerë janë të mendimit se surja ka zbritur për Uelijd ibn Mugiretu, ose El As ibn Uailin.

Mirësitë e leximit të sures "El Mâ'ûn"

Sa i përket mirësive të kësaj surje në një hadith të Imam Bakir (paqja qoftë mbi të!) lexojmë: *"Kushdo që e lexon këtë sure në namazet e detyruara dhe ato të pëlqyera, Zoti i Madhëruar do t'ia pranojë namazin dhe agjërimin e tij. Gjithashtu, nuk do t'i llogarisë gabimet që ka bërë gjatë jetës në këtë botë."*.[1]

[1] Tefsiri "Maxhmuel Bejan", vëll. 10, f. 546.

Ajetet 1 – 7

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿أَرَأَيْتَ الَّذِى يُكَذِّبُ بِالدِّينِ١ فَذَلِكَ الَّذِى يَدُعُّ الْيَتِيمَ٢ وَلَا يَحُضُّ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ٣ فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ٤ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ٥ الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ٦ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ٧﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?"

"Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët"

"Dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit."

"Mjerë për ata, të cilët kur falen,"

"Janë të pakujdesshëm për namazet,"

"Të cilët duan vetëm që të duken"

"Dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve."

Komentimi

Mohimi i Ringjalljes dhe ndikimet e tij të këqija

Së pari, kjo sure i është adresuar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Më pas vërteton mohuesit e Ditës së Kiametit me veprat që bëjnë: **"A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?"**.

Më pas, papritur që ndokush të përgjigjet, thotë: **"Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët."**.

Ata as nuk i ftojnë e as nuk i nxitin të tjerët të ndihmojnë të varfrit: **"Dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit."**.

Fjala *"ed dijn"*, në këtë rast, ka kuptimin e llogarisë, ose të Ditës së dhënies llogari, ndërsa për sa i përket mohimit të Ditës së Gjykimit, në veprat e njeriut ka reflektim të gjerë, të cilat janë cituar në këtë sure. Ato janë pesë: largimi me ashpërsi i jetimit, mos nxitja e të tjerëve për të ndihmuar nevojtarët, që do të thotë jo vetëm që nuk falin vetë, por edhe të tjerët nuk i ftojnë që të falin.

Komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"ed dijn"*, në këtë rast, është Kur'ani, ose e gjithë feja islame. Kuptimi i parë është më i përshtatshëm. Me këtë kuptim, është i ngjashëm edhe ajeti 9 i sures "El Infitâr" dhe ajeti 7 i sures "Et Tîn".

Ajetet e tjera të sureve tregojnë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"ed dijn"* është të tregojë Ditën e dhënies llogari.

Fjala *"jedu'u"* vjen nga rrënja e fjalës *"de'u"* dhe ka kuptimin: *asgjësim, ose largim i hidhur me përbuzje dhe ashpërsi*.

Fjala *"jeheddu"* ka kuptimin: mos*nxitës i të tjerëve*. Ragibi, në librin "Mufredat", thotë: Fjala *"el heththu"* do të thotë *"nxitje"*, ndërsa fjala *"heddun"* është e kundërta.

Fjalët *"jehuddu"* dhe *"jed'u"* janë folje të kohës së tashme dhe tregojnë se kjo punë është kryer vazhdimisht te jetimët dhe nevojtarët.

Shihet se çështja e jetimit është shumë e përfolur, flitet më shumë për anën shpirtërore të njeriut, se sa për ushqimin dhe ngopjen me ushqim, sepse vuajtja më e madhe e jetimit është vuajtja shpirtërore, e cila është ushqimi i shpirtit, ndërsa ushqyerja e trupit vjen më pas.

Përsëri në këto ajete flitet për çështjen e ushqimit të nevojtarit, e cila është një çështje shumë e rëndësishme. Në të thuhet, se nëse vetë nuk ke mundësi të ushqesh nevojtarët, atëherë nxit të tjerët ta kryejnë këtë vepër të mirë.

Fjala *"fedhalike"* tregon mosbesimin në Ditën Gjykimit, që këto vepra jo të mira do të bëhen shkak i dënimit. Me të vërtetë, ata që e besojnë me zemër Ditën e dhënies llogari, do t'ia shohin hajrin, gjatë gjithë jetës së tyre, ndërsa ata që nuk kanë iman, do t'ia shohin hajrin në dënimin që do t'u jepet.

Më pas thuhet: **"Mjerë për ata, të cilët kur falen,"**. Ata falës të namazit që e falin atë me pakujdesi: **"Janë të pakujdesshëm për namazet."**. Ka prej atyre që nuk i kushtojnë rëndësi namazit dhe

kohëve të tij. Gjithashtu, as rregullat dhe as traditën e tij nuk e respektojnë.

Fjala *"sahun"* vjen nga rrënja e fjalës *"sehv"*, dhe ka kuptimin: *gabim që kryhet pa dashje*. Por nëse gabimi është me paramendim, ose pa paramendim, në të dy rastet, quhet gabim, por në rastin e parë nuk ka asnjë justifikim, ndërsa në rastin e dytë, po. Në rastin tonë, gabimi është i paramenduar.

Vetë ajeti nuk thotë se namazin e tyre e falin me përtaci, sepse, në të vërtetë, për çdo kënd ndodh që të gabojë, por thotë se ata përtojnë për vetë namazin, për origjinën e tij dhe atë e lënë në harresë.

Është e qartë se kjo çështje, nëse ndodh një herë, ose disa herë mund të jetë nga dështimi, por, nëse dikush e harron vazhdimisht namazin dhe e lë në dorë të harresës, është e dukshme se nuk i kushton rëndësi dhe për të nuk është i rëndësishëm namazi. Ose nuk beson fare në të e, kur ndonjëherë fal namaz, e fal sa për sy e faqe të njerëzve.

Fjala *"sahun"*, në këtë rast, përveç asaj që thamë në komentimin më lart, ka edhe komentime të tjera, si për shembull, vonesë e namazit nga hyrja e kohës së tij.

Edhe pse qëllimi është për jobesimtarët, të cilët nuk besojnë as në mirësinë e namazit e as në dënimin e tij, nëse nuk e falim në kohë, mund të ketë për qëllim edhe personat që e falin namazin për t'u dukur, ndërkohë që ky kuptim vjen në ajetin e mëposhtëm.

Përmbledhja e këtyre komentimeve është e mundur, por komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Sidoqoftë, në ajetin e mëposhtëm do të shikojmë se çfarë gjendje do të kenë harruesit e namazit, si dhe ata që kryejnë veprën më të keqe që është shtirja: **"Të cilët duan vetëm që të duken."**.

Në fund thotë: **"Nuk u japin ndihmë nevojtarëve."**.

Me siguri që një nga burimet dhe shkaqet e dukjes, është mosbesimi në Ditën e Kiametit dhe pavëmendja ndaj shpërblimit hyjnor. Në të kundërt, si është e mundur që njeriu të lërë pas dore shpërblimin hyjnor?!

Fjala *"maun"* vjen nga rrënja e fjalës *"el me'nu"*, me kuptimin: *një gjë e pakët*. Shumë komentues janë të bindur se qëllimi është për gjërat e veçanta dhe të detajuara, që njerëzit dhe veçanërisht komshinjtë i marrin nga njëri–tjetri, kur kanë nevojë dhe në shtëpinë e tyre nuk gjendet për momentin, sikurse është, kripa, uji, shkrepëse e gjëra të tjera si këto.

Është e pamundur që ndokush të mos u japë të tilla gjëra të tjerëve. Në të kundërt, do të konsiderohej si njeri pa besim dhe pa dinjitet, që do të thotë se ata janë aq koprracë, saqë edhe një gjë të vogël, nuk e japin. Ndërkohë që po këto vegla të vogla, ndonjëherë largojnë probleme të mëdha e mos dhënia e tyre shkakton probleme të mëdha në jetën e njerëzve.

Të tjerë, gjithashtu, thanë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"maun"* është të tregojë zekatin, sepse dhënia e zekatit, në krahasim me pasurinë që kemi, nuk është asgjë e madhe, por një sasi shumë e vogël, duke filluar nga 2.5%, 5%, 10%.

Sigurisht që ndalimi i zekatit është një ndër punët më të këqija, sepse zekati zgjidh shumë nga problemet e shoqërisë.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për komentimin e fjalës *"maun"*, lexojmë: *"Maun, është hua që një njeri ia jep një njeriu tjetër, është mjet jetese që i huazohet dhe u lihet në dispozicion të tjerëve, gjithashtu, edhe ndihmesat dhe punët e mira që kryen njeriu."*.[1]

Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është pyetur: "Ne kemi fqinj që, kur u huazojmë gjë, ata i thyejnë apo i prishin. A është gjynah t'ua japim atyre?".

Imami tha: *"Në të tilla raste, nuk pa problem."*.[2]

Në tefsirin "Kurtubij" janë transmetuar dymbëdhjetë mendime për kuptimin e fjalës *"maun"*. Shumë prej tyre mund të përmblidhen së bashku. Por e rëndësishme është ajo që u tha më lart.

Citimi i këtyre dy veprave, pra (hipokrizia dhe ndalimi i ndihmës), flet për faktin se ata gënjeshtarët, atë çka është për Zotin e veprojnë me nijetin e krijesave, e ajo çka është për krijesat ata nuk e japin, në këtë rast asgjë nuk shkon për atë që duhet.

Këtë diskutim po e përfundojmë me një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Ata që nuk u japin mjetet më të vogla dhe të nevojshme fqinjëve, Zoti, në Ditën e Kiametit, do t'ua ndalojë të mirat e Tij dhe do ta lërë në*

[1] "El Kafij", në përputhje me transmetimin; Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vël. 5, f. 679.
[2] "El Kafij", në përputhje me transmetimin; Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 679.

gjendjen e tij. Çdokush që lihet në gjendjen e tij, është në situatën më të keqe.".[1]

Hulumtime

1- Përmbledhja e pjesëve të sures "El Mâ'ûn"

Në këtë sure të shkurtër janë përshkruar cilësitë e njeriut pa iman (besim), që sjell poshtërimin. Ata mohojnë Ditën e Gjykimit, injorojnë dhe poshtërojnë jetimët, braktisin nevojtarët, janë të pavëmendshëm në namaz, duan të duken, nuk bashkëpunojnë me njerëzit edhe në çështje, si huazimi i mjeteve të vogla që njeriut i nevojiten për momentin. Në këtë mënyrë, Zoti i Madhëruar, këta njerëz koprracë dhe egoistë i konsideron pa iman dhe pa përgjegjësi, si dhe i përshkruan me ata njerëz që s'e kanë mirë as me Zotin e as me njeriun. Të tillë njerëz nuk mendojnë as për shpërblimin hyjnor e as për dënimin hyjnor.

2- Mburrja është një problem i madh i shoqërisë

Vlera e çdo vepre është e lidhur me qëllimin që një njeri ka. Me fjalë të tjera, sipas këndvështrimit islam, baza e çdo vepre është nijeti dhe nijeti duhet të jetë i pastër e i sinqertë.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 20, f. 679.

Feja islame, më parë se çdo gjë tjetër, kontrollon dosjen e nijetit dhe prandaj në hadithin e njohur të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet se çdo vepër e punë ka të bëjë, ose vlerësohet me nijetin dhe përfitimi i çdo njeriu është në përputhje me nijetin.

Ai që bën xhihad (lufton) për hir të All'llahut, vlerësimi dhe shpërblimi është me Zotin e Madhëruar. E ai që lufton për këtë botë, edhe shpërblimin na kjo e botë e merr.[1]

Të gjitha këto janë për shkak se nijeti i jep pamje çdo gjëje. Ai që punon për hir të All'llahut, është i kapur fuqishëm dhe të gjitha mundimet e tij shpërblehen. Por ai që nijetin dhe qëllimin e tij e ka vetëm për t'u dukur, edhe shpërblimin të tillë e merr. Nëse një shoqëri mësohet me kryerjen e punëve duke pasur si qëllim dukjen, do të jetë larg Zotit dhe engjëjve, si dhe në të gjitha programet shoqërore do të vërë re se nuk do të përfitojë asgjë, atëherë do ta kuptojë sa i dhimbshëm është fati i njeriu të tillë dhe i një shoqërie të tillë.

Transmetimet për sa i përket çështjes së dukjes, janë të shumta, saqë disa hadithe, dukjen e konsiderojnë shirk.

Në një prej haditheve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: *"Do të vijë një kohë te njerëzit, që brendësia e tyre do të jetë e keqe dhe e ndyrë, ndërsa pamja e jashtme e tyre do të jetë shumë e bukur, sepse ata nuk kanë asnjë dëshirë për shpërblimin e All'llahut, feja e tyre është sa për sy e faqe, nuk*

[1] "Uesailul Shiah", vëll. 1, Hadithi 10, f. 35.

i frikësohen Zotit. Zoti do t'i dënojë ata shumë keq. Sa herë që ta thërrasin Zotin si të huaj, asnjëherë lutjet e tyre nuk do të plotësohen.".[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë se i ka thënë shokut të tij, Zerares: *"Ai që kryen vepra për njerëzit, edhe sevapi për to është, o Zerare! Çdo punë e bërë për sy e faqe, për t'u dukur, është shirk."*.[2]

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Personi që kryen punë sa për sy e faqe e për t'u dukur, në Ditën e Kiametit do të thirret me katër emra: qafir, i ndyrë, hilacak, punëlig. Medet për ty! Veprat e tua u zhdukën dhe shpërblimi vajti dëm. Sot asnjë gjë nuk të shpëton, merre dhe kërkoje shpërblimin tënd nga ai që ke punuar!"*.[3]

O All'llah! Të kesh nijet të pastër, është punë shumë e vështirë. O Zot, na pri vetëm në këtë rrugë!

O All'llah! Bëje të tillë besimin tonë, që të mos mendojmë për tjetër gjë, përveç mirësive dhe dënimit Tënd!

O All'llah! Çdo gabim që kemi bërë deri tani, përgjatë kësaj rruge, na i fal!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Mâ'ûn".

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, Hadithi 14.
[2] "Uesailul Shiah", vëll. 1, f. 49, në vazhdim të hadithit 11.
[3] "Usulul Kafi", vëll. 2, kreu *"err rrijau, dukja"*, Hadithi 14.

Sure "El Keuther"

Zbritur në Mekë

Ajete 3

Përmbajtja e sures "El Keuther"

Sipas mendimit më të njohur, kjo sure ka zbritur në Mekë. Disa janë të mendimit se kjo sure ka zbritur në Medine, sepse kjo sure ka zbritur dy herë. Transmetimet që kanë ardhur, për shkakun e zbritjes së sures, vërtetojnë se kjo sure është mekase.

Për shkakun e zbritjes së kësaj sureje, lexojmë: "Një ditë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po dilte nga xhamia dhe u përball me El As ibn Uail, që ishte nga të mëdhenjtë e mushrikëve. Ai bisedoi pak me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Të mëdhenjtë e kurejshëve po e shikonin këtë pamje nga larg. Kur As bin Vail u fut në xhami, kurejshët e pyetën: "Me kë po bisedoje?".

- Me këtë burrë fatprerë, pa trashëgimtarë, - u përgjigj ai.

Këtë gjë e tha, sepse Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i kishte vdekur djali i tij, Abdullahu. Arabët, një njeriu që nuk kishte djalë, i thoshin fatprerë, pa trashëgimtarë. Kurejshët e kishin përzgjedhur këtë emër për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi i kishte vdekur djali.

Kur kjo sure zbriti, i dha myzhde Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke i thënë se të kemi dhënë mirësi të pafundme dhe Keutherin. Ata janë vetë fatprerë, të shuar.[1]

1 "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 549.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte dy djem nga zonja Hadixhe *(All'llahu qoftë i kënaqur me të!)*, Kasemin dhe Tahirin, të cilin e quanin edhe Abdullah. Që të dy kishin vdekur në Mekë, kështu Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbeti pa djem.

Kjo ngjarje bëri që kurejshët të gëzonin dhe për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të përzgjidhnin emrin Ebter, i shuar.[1]

Ashtu sikurse është e njohur, arabët, sipas traditës së tyre, i kushtonin rëndësi shumë të madhe fëmijëve djem, për ta thurnin plane, duke i konsideruar në vend të babait. Pas ngjarjes që i ndodhi Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ata u gëzuan, sepse menduan se tashmë, pasi Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të largohet nga kjo botë, nuk kishte kush ta zëvendësonte dhe programi i tij do të lihej në harresë.

Kur'ani i Shenjtë, në këtë sure, u shpall dhe në mënyrë madhështore u kthen përgjigje armiqve, duke thënë se armiqtë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të jenë të shuar, ndërsa Kur'ani dhe feja islame nuk do të ndërpritet asnjëherë. Lajmi që iu dha myslimanëve në këtë sure, ishte humbje e armiqve të Islamit, nga ana tjetër, ata deshën

1 Profeti i nderuar pati edhe një tjetër djalë nga Marie Kubtijeh, me emrin Ibrahim, i cili lindi në vitin e tetë hixhri. Por edhe Ibrahimi, pa bërë dy vjet, largohet nga kjo botë. Vdekja e tij e lëndoi zemrën e pastër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

të mërzisnin zemrën e pastër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por All'llahu i nuk lejoi.

Mirësive të leximit të kësaj sureje

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Kushdo që e reciton dhe e lexon këtë sure, do t'i shuhet etja nga lumenjtë e Xhennetit, do të shpërblehet me masën e çdo kurbani që bëhet në ditën e Kurban Bajramit dhe kurbanet që bëjnë Ehli Kitabi dhe Mushrikët.*".[1]

Kjo sure, e ka marrë emrin "Keuther", për shkak të ajetit të parë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 548.

Ajetet 1 – 3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ ۝ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ ۝ إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ ۝﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira,"

"Andaj, falu (vetëm) **për Zotin tënd dhe ther kurban!"**

"Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë."

Komentimi

Të kemi dhënë një mirësi të madhe

E gjithë kjo sure, në të gjitha aspektet, sikurse edhe surja "Ed Duha" dhe "Esh Shehr", flasin për qëllime të mëdha dhe për t'i dhënë sa më shumë zemër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), që të mos shqetësohet për sa u përket fatkeqësive.

Së pari thuhet: **"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira."**. Ne të dhuruam ty Keutherin.

Fjala *"keuther"* rrjedh nga fjala *"kethret"* dhe ka kuptimin: *mirësi, bereqet i pafundmë*. Njerëzit që janë të mëkëmbur shumë, u thuhet "Keuther".

Ka transmetime të shumta për sa i përket qëllimit të përdorimit të fjalës *"keuther"*. Kur zbriti kjo sure, Profeti u ngjit në mimber dhe e recitoi atë. Shokët pyetën se çfarë i ka dhuruar All'llahu atij.

Ai tha: *"Është një lum në Xhennet, më i bardhë se qumështi. Dy anët e tij janë të stolisura me rubinë."*.[1]

Të tjerë janë të mendimit se ka të bëjë me "burimin e Keuther" që i përket Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe, kur besimtarët do të hyjnë në Xhennet, do të shuajnë etjen nga ky ujë.[2]

Të tjerë e kanë komentuar atë më profetësinë, të tjerë me Kur'anin e disa të tjerë e kanë komentuar me bollëkun e shokëve dhe të miqve. Të tjerë e kanë komentuar me bollëkun e fëmijëve dhe të pasardhësve, që do të jenë nga rrjedha e Fatimes *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, të cilët do të jenë të shumtë në numër.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 549.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 549.

Të tjerë, duke u bazuar në hadithin e Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, e kanë komentuar me shefaatin.

Edhe Fakhru Rrazij ka cituar pesëmbëdhjetë mundësi për kuptimin e fjalës *"keuther"*, por asnjëra prej tyre nuk ka përçuar kuptimin e qartë të kësaj fjale.

Sikurse edhe e thamë, fjala *"keuther"* ka kuptimin: mirësi dhe bereqet të pafund. Gjithashtu, ne e dimë se All'llahu i Madhëruar, i ka falur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mirësi dhe bereqet të pafundmë. Secili kuptim që u citua më lart për Keutherin, është shembull i qartë. Gjithashtu, kemi shembuj të tjerë, që mund të merren si përforcuese për ajetin që cituam.

Sidoqoftë, të gjitha mirësitë hyjnore, në të gjitha fushat, Profeti i nderuar i ka patur me vete. Edhe dijetarët e ymetit të tij, në çdo epokë dhe periudhë kohore, janë të përfshirë nga mirësia e Kur'anit dhe e fesë islame.

Nuk duhet të harrojmë se All'llahu, këtë fjalë e thotë për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, kur akoma nuk dukeshin ndikimet e mirësive të All'llahut.

E gjithë kjo mirësi ishte për të ardhmen e afërt dhe të largët, ishte mrekulli dhe tregues i vërtetësisë së ftesës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*.

Kjo mirësi e madhe dhe e pafund kërkon një falënderim të madh, edhe pse falënderimi i krijesave nuk mund ta shlyejë kurrë

hakun e mirësive që All'llahu na ka dhuruar, sepse të kesh mundësi të falënderosh, është një tjetër mirësi e dhuruar nga vetë All'llahu. Andaj All'llahu thotë se meqë është kështu, fal namaz vetëm për Zotin tënd dhe bëj kurban: **"Andaj, falu** (vetëm) **për Zotin tënd dhe ther kurban!"**.

Po, dhuruesi i mirësive është Vetë All'llahu. Duke u bazuar në fjalët e Kur'anit, namazi dhe adhurimi, si dhe therja e kurbanit, është një lloj ibadeti dhe ta kryesh për tjetër kënd nuk ka vlerë, sepse është veçanërisht për All'llahun e Madhëruar.

Me pak fjalë, adhurimi dhe kurbani janë vetëm për Krijuesin, janë mirësi posaçërisht për Qenien e Pastër të All'llahut.

Idhujtarët bënin kurban për idhujt, ndërkohë që mirësitë e tyre i dinin të Krijuesit. Sidoqoftë, fjala *"lirab'bike"* është argument i qartë për të pasur qëllim nijetin e pastër, vetëm e vetëm për All'llahun.

Shumë komentues besojnë se qëllimi për namazin është namazi i festës së Kurban Bajramit dhe të bësh kurban në atë ditë, por ajeti tregon një kuptim të përgjithshëm, edhe pse namazi dhe therja e kurbanit është një shembull i qartë i saj.

Fjala *"uen har"* është e veçantë, përdoret për therjen e deveve. Është cituar në këtë rast, ndoshta se therja e kurbanit të devesë për ta kishte rëndësi të madhe. Gjithashtu, edhe myslimanët e parë kishin dëshirë të bënin kurban devetë.

Për këtë rast janë përmendur edhe dy komentime të tjera:

1- Fjala *"uen har"* mendohet se ka kuptimin: të qëndrosh drejt Kibles, sepse rrënja e fjalës *"nehr"* ka kuptimin: *"bllok që zë kalimin"*.

Më pas, arabët atë e kanë përdorur me kuptimin: *"përballë çdo gjëje"*, ndaj edhe thonë: *"shtëpitë tona janë përballë njëra tjetrës"*.

2- Për sa i përket qëllimit të ngritjes së duarve në kohën e Tekbirit dhe afrimi i tyre përballë fytyrës, do të lexojmë një hadith: *"Kur zbriti kjo sure, Profeti i Nderuar e pyeti Xhibrailin: 'Çfarë është 'nahiri',[1] që mua më ka urdhëruar Zoti im?'"*.

Xhibraili tha: *"Nuk është 'nehir', por Zoti ty të urdhëron, që në kohën e namazit, kur të thuash Tekbirin (All'llahu Ekber), duhet të ngresh duart, gjithashtu, edhe kur të biesh në Ruku apo kur ngre kokën nga Rukuja, apo të biesh në sexhde, sepse edhe namazi i engjëjve në shtatë qiejt është i tillë. Për çdo gjë ka një bukuri dhe bukuria e namazit është të ngresh duart në çdo Tekbir (All'llahu Ekber)"*.[2]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, për komentimin e ajetit, lexojmë: *"Imami ngriti duart e tij, duke treguar se qëllimi i ngritjes së duarve është se ato duhet të ngrihen në mënyrë të tillë, që pëllëmba e dorës të jetë me drejtim nga Kibla."*.[3]

---

[1] "En nehijretu" ka kuptimin: dita e fundit e muajit, sepse në atë ditë, njeriu është në pritje të hënës së re. Disa e kanë komentuar si nata e fundit dhe dita e fundit e muajit, duke u bazuar në këtë kuptim. Transmeti bëhet i tillë: *"Mirëpritja që më ka urdhëruar mua Zoti për muajin e ri, ç'është?* Xhibraili tha: *'Nehire' nuk është."*.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 550.

[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 550.

Komentimi i parë është më i përshtatshëm se të gjithë të tjerët, sepse tregon mohimin e veprave të idhujtarëve, të cilët ibadetin dhe kurbanin e tyre e bënin për të tjerë e jo për Krijuesin.

Sidoqoftë, përmbledhja e komentimeve dhe e haditheve, në këtë rast, nuk ka asnjë kuptim, veçanërisht për sa i përket ngritjes së duarve në kohën e Tekbirit (All'llahu Ekber). Si tek shiat, edhe te sunitë kemi transmetime të shumta për këtë fakt, prandaj ajeti ka kuptim të gjerë që i përfshin edhe këto.

Ndërsa në ajetin e fundit, të kësaj sureje, duke u bazuar në lidhjen që të mëdhenjtë e idhujtarisë i bënë Profetit, All'llahu thotë në Kur'an: **"Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë."**.

Ti nuk je i shuar e as i prapambetur. Armiku yt është i shuar.

Fjala *"esh shaniju"* ka kuptimin: *mëri, armiqësi, të sillesh keq*.

Fjala *"ebter"* ka kuptimin: *kafshë me bisht të prerë*. Përzgjedhja e një fjale të tillë prej armiqve të Islamit, kishte për qëllim ofendimin e Profetit.

Përdorimi i fjalës *"shanieke"* tregon se ata nuk ruanin as respektin më të vogël për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që do të thotë, se urrejtja e tyre ishte e mbushur me armiqësi. Në të vërtetë, Kur'ani thotë se ky epitet është për vetë ju dhe nuk është për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Për shkakun e zbritjes së të kësaj sureje, u tha se kurejshët ishin në pritje të vdekjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ishin në pritje të

shkatërrimit të fesë islame, sepse thoshin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është fatkeq. All'llahu i Madhëruar tha se ai që është fatkeq dhe pa fat, është armiku i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Hulumtime

Fatimja *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* **dhe Keutheri**

Edhe më lart e thamë se fjala *"keuther"* ka një kuptim të gjerë dhe shoqëror, që është mirësi e pafundme. Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme për të.

Shumë dijetarë shi'it janë të mendimit se një nga përshkrimet e Keutherit është Fatimja, sepse shkaku i zbritjes thotë: "Ata thanë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i shuar, fatprerë, ndërsa Kur'ani jo vetëm që e mohon këtë gjë, por thotë se Ne të dhamë ty Keutherin.".

Nga ky interpretim kuptojmë se kjo mirësi dhe bereqet është Fatimja, sepse edhe pasardhësit e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vijnë nga kjo vajzë. Ajo qe e vetmja pjesë e trupit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajo i ruajti të

gjitha vlerat e fesë islame. Transmetohet se jo vetëm Imamët e pastër të Ehli Bejtit kanë prejardhjen nga Fatimja, po ka qindra e qindra breza nga raca e fëmijëve të Fatimes në gjithë botën. Ndërmjet tyre ka dijetarë të mëdhenj, të cilët përpiqen ta ruajnë fenë islame.

Në këtë pjesë është një diskutim i Fakhru Rrazit, që përveç komentimeve të ndryshme që ka bërë për fjalën *"keuther"*, ndër të tjera ka shtuar se kjo sure ka zbritur për të treguar se All'llahu i Madhëruar nuk e ka lënë pa pasardhës Profetin e Tij të nderuar, por i ka dhënë shumë trashëgimtarë, të cilët do të jenë brez pas brezi, sa të jetë kjo botë. Ndërkohë që nga Beni Umajadët, të cilët ishin armiq të fesë islame, nuk do të mbetet njeri. Nëse dëshiron të dish për ta, shiko e hidh një sy, a do të gjesh një dijetar prej tyre, që është sikurse Bakiri, Sadiku dhe Nefsi Zekijeh?[1]

Mrekullia e sures "El Keuther"

Kjo sure flet për tri parashikime të mëdha:

1- Dhurimi i mirësisë dhe i begatisë të pafundme për Profetin e Nderuar dhe ndjekësit e tij.

2- Sukseset dhe fitorja që pati Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kur u shpall kjo sure, që nuk parashikohej në Mekë.

[1] Nefsu Zekijeh është epitet që i është vendosur Muhammed ibn Abdullahit, djalit të Imam Hasan Muxhtebasë *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, që është vrarë nga dora e Mansur Devanakit, në vitin 145 hixhri.

3- Kjo sure lajmëron se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk do të mbetet pa trashëgimtarë, por do të ketë gjithmonë trashëgues, brez pas brezi. Njoftimi tjetër është se i lajmëron armiqtë që të mos mendojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i shuar, por vetë ata janë të shuar. Kjo gjë është e dukshme.

Përdorimi në numrin shumës i fjalës *"ne"*: **"Ne të kemi dhënë ty shumë të mira."**, tregon madhështinë dhe fuqinë e All'llahut, sepse, kur të mëdhenjtë flasin për veten, ata nuk përfshijnë vetëm vetën e tyre, por edhe personat që i kanë në shërbim.

Po në këtë ajet, fjala *"en"* tërheq vëmendjen për një gjë tjetër, duke treguar se fjala *"a'tejnake"* nuk është *"a'tinake"*. E gjitha kjo vërteton se All'llahu i Madhëruar i ka falur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Keutherin, që është një mirësi e madhe për të, që të mos i hidhërohet zemra nga fjalët e armiqve e të dijë se vendmbështetja e tij është All'llahu i Madhëruar, që është burim i të gjithë të mirave dhe Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka në dispozicion mirësi të shumta.

O All'llah! Mos na lër duarbosh edhe ne nga mirësitë që i ke dhuruar Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

O All'llah! Ti e di se ne e duam shumë Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)! Na bashko me ta në Ditën e Kiametit!

O All'llah! Madhështia e Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe e fesë islame dita-ditës bëhet edhe më e madhe, mbroje dhe lulëzoje edhe më tepër!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Keuther".

Sure “El Kâfirûn”

Zbritur në Mekë

Ajete 6

Përmbajtja e sures "El Kâfirûn"

Kjo sure ka zbritur në Mekë. Përmbajtja e saj është dëshmi e qartë për vendzbritjen e sures. Kur të flasim për shkakun e zbritjes së kësaj sureje, do të shikojmë disa arsyetime të tjera, që vërtetojnë se kjo sure është mekase, pavarësisht se disa thonë se është medinase.

Vetë melodia e sures tregon se, kur kjo sure ka zbritur, myslimanët kanë qenë pakicë, kurse qafirët shumicë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte në vështirësi të madhe për shkak të tyre, sepse ata, me kokëfortësinë e tyre, dëshironin ta tërhiqnin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* drejt shirkut, por Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vazhdimisht i kthente ata duarbosh. Ata nuk patën më shpresë, sepse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk u ngatërrua kurrë me ta.

E gjitha kjo është një detyrë që myslimanët të mësojnë se në asnjë rast të mos bien dakord me armikun, për sa i përket fesë dhe Islamit. Sa herë që ata të kërkojnë këtë gjë, t'i lënë pa shpresë. Jo më kot në këtë sure është cituar dy herë: **"Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni"**, për t'i zhgënjyer e për t'i lënë të pashpresë ata. Gjithashtu, është cituar dy herë: **"As ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj"**, për të treguar kokëfortësinë e tyre. Përfundimi del: **"Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"**.

Unë dhe feja ime (Teuhidi), ju dhe feja juaj e prishur (idhujtaria).

Mirësitë e leximit të sures "El Kâfirûn"

Janë transmetuar hadithe të shumta për mirësitë e leximit të kësaj sureje, të cilat tregojnë rëndësinë e jashtëzakonshme të saj. Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Ai që e lexon suren 'El Kâfirûn', është sikur ka lexuar një çerek të Kur'anit dhe shejtani largohet prej tij, pastrohet prej shirkut dhe do të jetë i sigurt në Ditën e Kiametit."*.[1]

Përshkrimi me një çerek të Kur'anit, ndoshta është për shkak se një e katërta e Kur'anit flet për luftën kundër shirkut dhe idhujve. Sikurse edhe e dimë, shirku është mjeti më i rëndësishëm që ka shejtani. Edhe shpëtimi në Ditën e Kiametit është te grupi që ka mohuar shirkun.

Në një hadith tjetër të Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë se një burrë u afrua pranë tij dhe tha: "O i Dërguari i All'llahut! Kam ardhur të më mësosh ndonjë gjë, që ta lexoj në kohën e gjumit.".

I Dërguari i All'llahut tha: *"Në kohën që shtrihesh për të fjetur, lexo suren 'El Kâfirûn', më pas fli. Kjo sure të largon nga shirku."*.[2]

Në një transmetim tjetër lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thotë Xhebir bin Mutemit: *"Kur udhëton, dëshiron të jesh prej më të mirëve të shokëve për nga ana e të veshurit?"*.

- Po, t'u bëfsh kurban, o i Dërguari i All'llahut! - i tha ai.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 551.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 551.

- *Lexo këto pesë sure: "El Kâfirûn", "Fat'h", "Asr", "El Felek" dhe "En Nâs". Leximin tënd nise me Bismilahir Rrahmanir Rrahim,* - i tha Profeti *Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).*[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Babai thoshte se surja 'El Kâfirûn' është një çerek prej Kur'anit*. Kur mbaronte së lexuari këtë sure, thoshte: "*Unë adhuroj vetëm All'llahun, unë adhuroj vetëm All'llahun!"*.[2]

[1] Po aty.
[2] Po aty.

Ajetet 1 - 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ۝ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ۝ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ۝ وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ۝ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ۝ لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ۝﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Thuaj: 'O ju mosbesimtarë!'"

"Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni."

"Dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj."

"Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni."

"Dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!"

"Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"

Shkaku i zbritjes

Në transmetime të ndryshme lexojmë se kjo sure ka zbritur për një grup njerëzish nga të mëdhenjtë e kurejshëve, sikurse Uelijd ibn Mugijretu, El As ibn Uaili, Harith ibn Kajsi, Umejetu ibn Khalefi etj.

Ata i thanë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "O Muhammed! Ti ndiq fenë tonë dhe ne ndjekim fenë tënde dhe ty do të të kemi ortak. Një vit ti adhuro zotat tanë dhe një vit, ne, do të adhurojmë Zotin tënd. Nëse feja jote do të jetë më e mirë, ne do të përzgjedhim fenë tënde, po, nëse feja jonë do të jetë më e mirë, do të përfitosh prej saj.".

- *I mbështetem All'llahut! Unë nuk i shoqëroj kënd!* - u tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

- Të paktën të adhurosh disa prej zotave tanë dhe ne do të adhurojmë Zotin tënd! – thanë ata.

- *Unë jam në pritje të urdhrit të All'llahut,* - thotë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në këtë kohë zbret surja "El Kâfirûn". Profeti i nderuar erdhi në xhami, ndërkohë që një grup prej kurejshëve kishte ardhur aty.

Profeti i nderuar e lexoi suren deri në fund dhe, kur ata e dëgjuan këtë mesazh, u zhgënjyen dhe filluan ta mërzisin Profetin

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokët e tij.[1]

Komentimi

Tri ajetet e para të kësaj sureje thonë: **"Thuaj: 'O ju mosbesimtarë!'. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj."**.

Në këtë mënyrë bëhet ndarja e plotë prej tyre. Unë kurrë nuk do të jem adhurues i idhujve. Edhe ju, me këtë kokëfortësi që keni dhe me ndjekjen tuaj të verbër të idhujve, kurrë nuk do të bëheni adhurues të Zotit Një.

Për t'i lënë të pashpresë idhujtarët, edhe një herë shton: **"Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"**.

Shumë komentues janë të mendimit se thirrja në këto ajete u drejtohet jobesimtarët, në këtë rast, është një grup i veçantë prej të mëdhenjve të Mekës, sepse fjalës *"kafirun"* i është ngjitur *"elifi"* dhe *"lami"*, andaj është në numrin njëjës.

[1] Shkakun e zbritjes së kësaj sureje e kanë sjellë edhe komentues të tjerë, me pak ndryshim, si Tabrasij, në "Mexhmaul Bejan", Kurtubij, Abu Fettuh Rrazij, si dhe Sujuti.

Mundet që arsyetimi i tyre për këtë çështje, duke shtuar edhe atë çka u tha për shkakun e zbritjes, të jetë kështu, sepse shumë prej tyre, si përfundim, besuan.

Fjalia e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!"**, u adresohet kurejshëve, që kurrë nuk besuan.

Ata, deri në fund të jetës së tyre qëndruan jobesimtarë. Pas çlirimit të Mekës, shumë jobesimtarë u bënë besimtarë dhe u futën në fe grup-grupe.

Hulumtime

1- Përse surja ka nisur me urdhrin: "Thuaj"?

A nuk do ishte më mirë që të fillonte **"O ju jobesimtarë"**, pa thënë **"Thuaj"**? Me fjalë të tjera, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* patjetër duhet të zbatojë urdhrin e All'llahut dhe atyre t'u lexonte fjalinë: **"O ju jobesimtarë"** dhe të mos e përsëriste përsëri fjalën **"Thuaj"**.

Përgjigjja e kësaj pyetje është e qartë, në përputhje me përmbajtjen e sures, sepse jobesimtarët arabë e ftuan Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) që të binte dakord me idhujt dhe ai duhet ta mohonte të këtë çështje.

Nëse do të përdorej fjala *"kul"* – *"thuaj"*, atëherë do të ishte Fjalë e All'llahut. Në këtë rast, ajeti nuk do të kishte kuptim: **"Unë nuk adhuroj atë çka ju adhuroni"**. Edhe ajetet e tjera me radhë, nuk do të kishin asnjë kuptim. E thënë ndryshe, fjala *"kul"* është në mesazhin e Xhibrailit, nga ana e Zotit,

Profeti e ka për detyrë ta ruajë me kujdes atë çka i shpall All'llahu në Kur'an dhe ta transmetojë për të tjerët, në të njëjtën mënyrë. Kjo gjë tregon që Xhibraili dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kanë ndryshuar edhe gjënë më të vogël. Gjithashtu, tregon se që të dy janë të besueshëm dhe urdhrin e All'llahut e dëgjojnë dhe e zbatojnë. Në ajetin 15 të sures "Jûnus" lexojmë: **"E, kur u lexohen Shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin, para Nesh thonë: 'Na sill ndonjë Kur'an tjetër ose ndërroje atë!'. Thuaj** (o Muhammed)**: 'Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është Shpallur. Unë druaj, nëse e kundërshtoj Zotin tim, dënimin e Ditës së Madhe.'"**.

2- A mos vallë idhujtarët ishin mohues të Zotit?

Ne dimë se idhujtarët nuk e kanë mohuar asnjëherë Zotin dhe, sipas ajetit, nëse ata i pyet se kush është krijuesi i qiejve dhe i tokës, ata thonë Zoti. Në ajetin 25 të sures "Lukmân", lexojmë: **"Nëse ti** (o Muhammed) **i pyet ata: 'Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?', me siguri që do të të thonë: 'All'llahu!'. Atëherë ti**

thuaju: 'Qoftë lavdëruar All'llahu!'. Por, shumica e tyre nuk dine.".

Atëherë, si ka mundësi që në këtë sure thotë: "As unë nuk adhuroj adhuruesin tuaj dhe as ju adhuruesin tim"?

Përgjigjja e kësaj pyetje është e qartë, sepse nuk bëhet fjalë për Krijuesin, por për adhurimin. Idhujtarët e pranojnë Krijuesin e kësaj bote, por, ata besojnë se duhet të adhurohen idhujt, që të jenë ndërmjetës ndërmjet tyre dhe Zotit, ose thonë se nuk kanë mundësi të adhurojnë Zotin, por duhet të adhurojnë idhujt që kanë ndërtuar. Edhe Kur'ani merr lapsin e kuq dhe u tërheq vizën atyre, duke thënë se adhurimi duhet të jetë vetëm për Zotin dhe jo për të dy.

Ndërsa, për sa i përket shkakut të mohimit të idhujve nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe mohimit të adhurimit të Zotit nga ana e jobesimtarëve, ka shumë për të thënë.

Disa janë të mendimit se theksimi dhe përsëritja e këtyre ajeteve është për t'i zhgënjyer jobesimtarët, të ndajë rrugën e tyre nga rruga e fesë islame dhe të vërtetojë se nuk ka mirëkuptim midis Teuhidit - Njëshmërisë së Zotit dhe shirkut - shoqërimit shok të All'llahut.

Me fjalë të tjera, ata po këmbëngulnin që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të shkonte pas tyre. Këtë gjë ata e përsëritën disa herë, edhe Kur'ani bëri të njëjtën gjë.

3- Përse kjo përsëritje e ajeteve?

Në një hadith thuhet se Abu Shakir Ed Disanij (një prej ateistëve të periudhës së Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* pyet një prej shokëve të Imam Sadikut, Ebu Xhafer El Ehvel (Muhammed ibn Ali Nu'mani), i njohur si Mu'min Et Tak, për arsyen e përsëritjes së këtyre ajeteve.

- A është e mundur që një i ditur (Hakim) ta përsërisë fjalën e tij kështu? – pyeti Abu Shaker Disani.

Abu Xhaferr El Ehvel nuk pati përgjigje dhe u drejtua drejt Medines. Pyeti Imam Sadikun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për këtë gjë.

- *Shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve dhe përsëritja e tyre ishte sepse kurejshët i propozuan Profetit të All'llahut që një vit të adhuronte zotat dhe idhujt e tyre dhe vitin tjetër, ata do të adhuronin Zotin e tij. Dhe përsëri ai të adhuronte zotat e tyre dhe vitin e katërt ata, përsëri do të adhuronin Zotin e tij. Kështu zbriten ajetet e mësipërme dhe të gjitha këto propozime i mohoi,* - i tha Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Kur Abu Xhaferr El Ehveli i ktheu këtë përgjigje Abu Shakirit, ai i tha se kjo përgjigje nuk është nga ana jote, janë fjalët e Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Disa të tjerë janë të mendimit se përsëritja është për shkak se një herë flet për të tashmen dhe një herë për të ardhmen, që do të thotë se as tani e as në të ardhmen nuk i adhuroj idhujt tuaj. Por për këtë nuk ekziston asnjë dëshmi e jashtme.

Tefsiri i tretë që bëhet, për sa i përket përsëritjes, është se në fillim tregohet kundërshtimi në adhurim, së dyti, vjen kundërshtimi tjetër, që unë kurrë nuk adhuroj idhujt tuaj dhe nuk flet për mënyrën e adhurimit, që të jetë si e juaja, sepse adhurimi im është i pastër nga çfarëdolloj shirku.

Duke shtuar se adhurimi juaj është një ndjekje zakoni nga të parët, ndërsa adhurimi im vjen si pasojë e kërkimit dhe e falënderimit. Por, ashtu sikurse e thamë edhe më lart në hadithin e Imam Sadikut, pamja e jashtme e ajetit tregon se kjo përsëritje, është për theksimin e çështjes në fjalë.

Ekziston edhe një tjetër tefsir i katërt, që nuk duket mendim i largët. Në të thuhet se ka një ndryshim të vogël midis ajetit të dytë dhe të katërt.

Në ajetin e dytë thuhet: "Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni.".

Në ajetin e katërt thuhet: "Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni.".

Ndryshimi është: Në ajetin e dytë thuhet *"ta'budune"* – *"adhuroni"*. Folja është në kohën e tashme. Në ajetin e katërt thuhet *"a'bedtum"* – *"adhuruat"*. Folja është në kohën e ardhme.

Edhe pse ky komentim sqaron vetëm ajetin dy dhe katër, por përsëritja e ajetit të tretë dhe pesë, qëndron me fuqinë e tij.

4- A është leje për adhurimin e idhujve kuptimi i ajetit "Lekum dijnukum..."?

Ndonjëherë është imagjinuar se ajeti i fundit i sures: **"Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"**, ka kuptimin e paqes së përgjithshme dhe atyre u është dhënë leje që të rrinë në fenë e tyre, sepse ata, mund ta pranojnë kur të duan fenë islame.

Por ky mendim është tepër i dobët dhe i pabazë, sepse ajetet e tregojnë më së miri se kjo është një lloj përqeshje dhe kërcënim, që do të thotë se feja juaj le të mbetet e juaja, sepse shumë shpejt do t'ia shikoni vlerën. Kjo pamje është e ngjashme me ajetin 55 të sures "El Kasas": **"Kur dëgjojnë ndonjë marrëzi, i shmangen asaj, duke thënë: 'Ne kemi veprat tona, ndërsa ju keni veprat tuaja! Paqja qoftë me ju! Ne nuk duam shoqëri me të paditurit.'"**.

Besimtarët, në çdo kohë që të dëgjojnë fjalë të pavlera, largohen nga aty. Ata thonë se veprat e tyre janë për ta, kurse veprat tuaja, janë për ju. Ata nuk kërkojnë injorancën.

Dëshmi e këtyre janë qindra ajete kur'anore, që shirkun e konsiderojnë si mëkatin më të rëndë. All'llahu nuk e fal atë që bën shirk.

5- All'llahu kurrë nuk ka bërë paqe më shirkun

Ajo që transmetohet në këtë sure, është tregues i një të vërtete, që është Teuhidi. Teuhidi nuk shkon me shirkun, janë dy drejtime të ndryshme. Gjatë rrugës, gjithashtu, janë plotësisht të

ndara, nuk kanë asnjë ngjashmëri me njëri-tjetrin. Teuhidi e lidh njeriun me All'llahun, ndërsa shirku e ndan nga All'llahu.

Teuhidi është sekreti i unitetit në të gjitha fushat, ndërsa shirku është ndarje dhe grindje, në të gjitha rastet.

Teuhidi e ngre njeriun lart nga bota materiale dhe bota natyrore, ndërkohë që shirku e hedh njeriun në pusin e natyrës dhe e bashkon atë me krijesat e kufizuara dhe të dobëta.

Po për këtë shkak, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si të gjithë Profetët, nuk e pranoi asnjë sekondë idhujtarinë, por e para gjë dhe më e rëndësishmja, ishte lufta me idhujtarinë.

Edhe sot, të gjithë duhet ta ndjekin këtë Rrugë të Drejtë dhe ta vazhdojmë atë në çdo vend. Kudo që shkojmë, të tregojmë që jemi kundër shirkut dhe nuk bëjmë kompromis me të.

Kjo është Rruga e Drejtë e fesë islame.

O All'llah! Na largo nga çfarëdolloj shirku dhe vepre shirku! Cytjet e jobesimtarëve të kohës sonë janë shumë të rrezikshme, na ruaj nga kurthet e tyre!

O All'llah! Na forco dhe na largo nga çdo e ligë, na trimëro ashtu sikurse Profetin, që të mos biem preh e asnjë propozimi prej shirkut.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Kâfirûn".

Sure "En Nasr"

Zbritur në Medine

Ajete 3

Përmbajta e sures "En Nasr"

Kjo sure ka zbritur në Medine, pas hixhretit (migrimit) të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo sure lajmëron për një fitore të madhe. Pas kësaj fitoreje, njerëzit do të futen në fenë islame grupe-grupe. Për këtë shkak e fton Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të falënderojë, të bëjë tesbih dhe të kërkojë falje *(istigfar)*.

Edhe pse në fenë islame janë arritur fitore të mëdha, kjo fitore dhe ky çlirim i Mekës, me cilësitë e përmendura, është një mrekulli, sepse ky çlirim mbartte me vete një triumf të madh. Vetë arabët kishin thënë se, nëse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do ta çlironte Mekën, atëherë ky çlirim do të ishte argument që ai ka të drejtë. Nëse nuk do të kishte të drejtë, Zoti nuk do t'i jepte leje që ta çlironte Mekën, ashtu sikurse nuk i dha leje ushtrisë së Abrahasë (As'habi Fili-it), që ta rrënonte e ta pushtonte Qaben dhe Mekën.

Një gjë të tillë nuk do ta lejonte edhe për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të çlironte Mekën, për këtë shkak se jobesimtarët e Mekës, pas kësaj ngjarje, e pranuan fenë islame dhe u futën në Islam grupe-grupe.

Disa janë të mendimit se kjo sure ka zbritur pas (Sulh Hudejbije) marrëveshjes së Hudejbes, në vitin e gjashtë, pas migrimit dhe dy vjet pas çlirimit të Mekës.

Disa të tjerë janë të mendimit se ka ndodhur pas çlirimit të Mekës, në vitin e dhjetë të migrimit, në lamtumirën e fundit. Ky

mendim është tepër i largët, sepse interpretimi i sures me këtë kuptim nuk ka asnjë përputhje, si dhe lajmëron për një ngjarje që do të ndodhë së afërmi dhe nuk flet për të kaluarën.

Një emër tjetër i kësaj sureje është *"et teudi'u"* (që do të thotë lamtumirë), për shkak se në të tregohet edhe largimi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga kjo botë.

Në një hadith transmetohet se, kur kjo sure iu shpall Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ai e lexoi për shokët e tij. Të gjithë u gëzuan dhe u lumturuan, por Abasi, xhaxhai i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur e dëgjoi, nisi të qajë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pyeti: *"O xhaxha, përse po qan?"*.

- Mendoj se në këtë sure është edhe një tjetër lajm, ai i largimit tënd, - tha ai.

- *Po, është e vërtetë ajo që ti po thua,* - iu përgjigj Profeti i All'llahut.[1]

Ka mendime të ndryshme midis komentuesve se në cilën pjesë të sures flitet për një gjë të tillë, për shkak se pamja e jashtme e ajeteve nuk tregon asgjë tjetër përveç se një lajmi të mirë për çlirimin e Mekës. Por mendohet se ndoshta është përdorur kuptimi i saj, se tashmë po përfundon profetësia e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe feja e tij është plotësuar dhe është përsosur. Është e qartë se në kushte të

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 554. I njëjti kuptim, po me fjalë të tjera, është cituar edhe në vende të tjera. (Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 532.)

tilla, largimi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga kjo botë ishte i pritshëm.

Mirësitë e leximit të sures "En Nasr"

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për mirësitë e leximit të kësaj sureje, thuhet: "*Ai që lexon suren 'Nasr', është sikur ka qenë së bashku më Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në çlirimin e Mekës.*".[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Ai që e lexon suren 'En Nasr' në namazet jo të detyruara apo të detyruara, do të jetë i fituar dhe fitimtar ndaj të gjithë armiqve të tij dhe në Kiamet do t'i jepet një letër, e cila do ta mbrojë, kur të dalin nga varret në Ditën e Kiametit, që të mos e djegë zjarri i Xhehennemit.*".[2]

Është e qartë se gjithë kjo krenari dhe mirësi është për atë që e lexon këtë sure dhe ecën në Rrugën e Profetit të All'llahut dhe çdo synet të tij e vë në zbatim, nuk mjaftohet vetëm me pëshpëritje të tyre.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 553.
[2] Po aty.

Ajetet 1 – 3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ۝١ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا۝٢ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا۝٣﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Kur të vijë ndihma e All'llahut dhe çlirimi (i Mekës)**."**

"Dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e All'llahut grupe-grupe."

"Atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve."

Komentimi

Në këto tri ajete të shkurtra, por me shumë kuptim dhe me shumë domethënie, flitet për punë që janë të vogla, në pamje, por që rëndojnë shumë. Nëse u kushtojmë vëmendje atyre, do të

shohim se do të na ndihmojnë në kuptimin dhe qëllimin përfundimtar të sures:

Në ajetin e parë, fjala *"en nasru"* i është shtuar All'llahut, *"nasrull'llah"*. Nuk është shtuar vetëm këtu, por në shumë ajete të Kur'anit ky kuptim është pasqyruar.

Ndër to është ajeti 214 i sures "El Bekare" që thotë: **"Vërtet mendoni të hyni në Xhennet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: 'Kur do të arrijë ndihma e All'llahut?!'. Ja, ndihma e All'llahut është afër!"**.

Në ajetin 126 të sures "Ali Imran" lexojmë: **"All'llahu e bëri këtë që t'ju sjellë lajmin e gëzuar dhe që t'jua qetësojë zemrat. Vërtet, fitorja është vetëm nga All'llahu, i Plotfuqishmi dhe i Urti."**.

Në ajetin 10 të sures "El Enfâl" gjithashtu lexojmë: **"All'llahu e bëri këtë fitore si lajm të mirë, që të qetësohen zemrat tuaja me të. Fitorja vjen vetëm nga All'llahu. Me të vërtetë, All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**.

Është e drejtë që për të fituar mbi armikun, duhet të forcohemi dhe të kemi forca, por një njeri besimtar, fitoren e pret vetëm nga ana e All'llahut. Për këtë shkak, në kohën e fitores nuk bëhet mendjemadh, por nis të falënderojë.

Së pari, në këtë sure flitet për ndihmën hyjnore dhe më pas për çlirimin dhe fitoren. Në fund për ndikimin dhe përhapjen e fesë islame, si dhe për hyrjen në fe grupe–grupe të njerëzve. Këto janë

tri arsye që, nëse nuk do ishte ndihma nga ana e All'llahut, nuk do të kishte çlirim dhe fitore. Nëse nuk do të kishte çlirim, fitore dhe, nëse nuk do të largoheshin pengesat, njerëzit nuk do të mund të hynin në fe grupe-grupe.

Në të vërtetë, pas këtyre tri mirësive vjen edhe një mirësi tjetër, që është falënderimi dhe adhurimi i All'llahut.

Fitorja dhe çlirimi hyjnor janë për të treguar jo vetëm hyrjen e njerëzve në fenë islame, por edhe udhëzimin e tyre.

Në këtë rast, çlirimi ka ardhur në mënyrë të përgjithshme dhe, sipas shenjave që dhamë më lart, padyshim që flitet për çlirimin e Mekës. Ky çlirim hapi një kapitull të ri në historinë islame, sepse qendra kryesore e shirkut u shpërbë, idhujt u larguan dhe shpresa e idhujtarëve u shua. Po ashtu, pengesat që u vendosen para myslimanëve u hoqën nga rruga. Për këtë shkak, çlirimi i Mekës duhet të jetë një stad prej stadeve të qëndrueshmërisë së fesë islame, përhapja e saj në Arabi dhe më pas në të gjithë botën. Kështu që pas çlirimit të Mekës nuk pati asnjë qëndresë prej jobesimtarëve (vetëm një rast që edhe ai u rrëzua shumë shpejt). Nga i gjithë vendi vinin pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* për të pranuar fenë islame.

Në vazhdim të ajetit, i urdhërohen Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* tri rregulla të rëndësishme (natyrisht të gjithë besimtarëve), njëra është

falënderimi për këtë fitore të madhe, së dyti, të bërit tesbih[1] dhe hamd[2] dhe së treti, pendimi.

Et tesbijh, me kuptimin të lartësosh Zotin nga çfarëdolloj gjëje.

El hamdu është për cilësitë dhe përsosmërinë, ndërsa *el istigfaru* për gabimet e robëve. Kjo fitore bëri që të zhduken të gjitha papastërtitë e idhujtarisë, të shfaqet përsosmëria dhe bukuria e All'llahut dhe të humburit të kthehen drejt së vërtetës.

Kjo fitore e madhe u bë shkak që askush të mos mendojë se All'llahu i lë vetëm shokët, por Ai e mban Fjalën e dhënë.

Gjithashtu, All'llahu tregon se njerëzit duhet të tregojnë mungesat që kanë përpara madhështisë së All'llahut.

Përveç këtyre, në kohën e fitores, njeriu mund të reagojë jo mirë dhe mund të bëhet preh e mendjemadhësisë apo ndoshta mund të ngrihen për t'u hakmarrë ndaj armikut, duke i mbyllur llogaritë vetë personalisht. Këto tri rregulla iu mësuan atij, që në momentin e veçantë, kur të jetë afër fitorja, të kujtojnë cilësitë Xhelal[3] dhe Xhemal[4] të All'llahut, që çdo gjë është prej Tij. Gjithashtu, i kërkohet të pendohet, që të shuajë mendjemadhësinë dhe të heqë dorë nga hakmarrja.

Është e ditur se Profeti i Islamit (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* sikurse edhe Profetët dhe të

[1] Lartësim.
[2] Falënderim dhe lavdërim.
[3] Madhështi.
[4] I bukur, madhështor.

Dërguarit e tjerë, ishin të pastër, atëherë përse janë urdhëruar që të pendohen, për çfarë është pendimi?

Në përgjigje të kësaj pyetje, duhet të themi:

Së pari, kjo është një detyrë për gjithë ymetin, sepse përgjatë kësaj përballjeje të gjatë, që ka zgjatur rreth njëzet vjet, myslimanët kaluan shumë ditë të vështira dhe të dhimbshme. Ngjarjet ishin aq shumë të ndërlikuara, saqë shpirti u kishte ardhur në majë të hundës. Disa kishin mendime te këqija, për sa u përket premtimeve Hyjnore, ashtu sikurse thotë edhe Kur'ani për luftën, në ajetin 10, të sures "El Ahzâb": **"Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek All'llahu u lëkund."**.

Tashmë që fitorja u afrua, e kuptojnë se ato mendime të këqija dhe lëkundjet e tyre ishin të gabuara, tashmë duhet të pendohen.

Së dyti, njeriu sado që të falënderojë dhe të mundohet ta shlyejë hakun, nuk do të arrijë kurrë ta bëjë atë, ndaj në fund të falënderimit duhet të pendohet për çka vepruar.

Së treti, zakonisht, pas fitores nisin cytjet e shejtanit, mendjemadhësia, hakmarrja dhe shumë e shumë cytje të tjera. Në të tilla raste, duhet të kujtojmë Zotin dhe vazhdimisht të kërkojmë falje e të pendohemi që asnjë nga ato që thamë, të mos gjendet te ne, ose, nëse janë, të largohen.

Së katërti, ashtu sikurse u tha edhe në fillim të sures, njoftimi i kësaj fitoreje, përafërsisht lajmëron përfundimin e misionit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi*

të e mbi familjen e tij!), si dhe përfundimin e jetës së tij dhe bashkimin me Krijuesin, e gjitha kjo kërkon tesbih, (lartësim) hamd (falënderim dhe lartësim) dhe istigfar (falje pendim).

Në transmetime të ndryshme thuhet se pas zbritjes së kësaj sureje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* përsëriste shumë herë këtë fjali: "*O All'llah! I lavdëruar qoftë Emri Yt! Të falënderoj, O All'llah! Më fal mua, sepse Ti je Falës dhe Pranues i pendimit!*".[1]

Fjalia "*in'nehu kane teuaba*" tregon shkakun e pendesës, që do të thotë: pendohu dhe kërko falje, sepse Zoti yt është Mëshirues, Falës dhe Pranues i pendimit.

Ndoshta mund të flasë edhe për një çështje tjetër, që mund të jetë kjo: Kur Zoti ta pranon ty pendesën, atëherë edhe ti prano pendimin e mendjemëdhenjve pas fitores e, kur prej tyre nuk shikon kundërshtim, ose dredhi, pra, nuk shfaqin asnjërën nga këto që thamë, atëherë mos i largo nga vetja. Sikurse do ta shohim. Profeti i Nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, në këtë ngjarje, të çlirimit të Mekës, tregoi në mënyrën më të përsosur fytyrën e mëshirës së fesë islame, përballë armiqve, smirëzinjve që kishin humbur në këtë luftë.

Nuk qe vetëm Profeti i Islamit që bëri teube (pendim) , tesbih (lartësim) dhe falënderim për All'llahun pas fitores, por e njëjta gjë ka ndodhur edhe me Profetët e tjerë që i tregon historia më së miri për këtë çështje.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 554.

Për shembull, Profeti Jusuf *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, kur mori pushtetin e Egjiptit dhe pranë tij erdhën babai, nëna dhe vëllezërit e tij, pas një kohe të gjatë pa u parë, ai tha: **"O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në Botën Tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët** (në Botën Tjetër)**!"**.

Edhe Profeti Sulejman *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, kur u ul në fronin e mbretëreshës Sebes, tha: **"Po ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: 'Unë do të ta sjell ty sa çel e mbyll sytë'. Kur** (Sulejmani) **e pa të vendosur para tij, tha: 'Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon,** (ta dijë se) **Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues."**.

Hulumtim

Çlirimi i Mekës, fitorja më e madhe e Islamit

Çlirimi i Mekës, sikurse e thamë edhe në lart, ishte një kapitull i ri në historinë e fesë islame, mbrojtja e armikut u thye pas gati njëzet vitesh.

Me çlirimin e Mekës u zhduk idhujtaria nga Gadishulli Arabik dhe feja islame u bë gati që të udhëzojë vendet e tjera.

Përfundimisht, kjo ngjarje ishte e tillë: Pas ardhjes së mesazhit të paqes së Hudebijes, jobesimtarët e Mekës e thyen besëlidhjen e paqes dhe nuk e pranuan firmosjen e paqes së Hudebijes.

Disa të tjerë u ankuan për Profetin Muhammed, kështu që ai vendosi t'i mbështesë ata që ishin bashkuar me të.

Nga ana tjetër, kishte ardhur momenti i duhur që të hiqej ligji i idhujtarisë. Ky ishte shkaku që të kryhej kjo gjë, ndaj edhe Profeti i Nderuar, me urdhër te All'llahut, u bë gati të niset drejt Mekës.

Çlirimi i Mekës u krye në tri stade. Së pari, u arrit përgatitja e forcave, përzgjedhja e kohës së përshtatshme, mbledhja e informacionit të mjaftueshëm për armikun, për sa u përket forcave të tyre, si dhe anën shpirtërore të tyre.

Stadi i tytë ishte kryerja me rregull dhe boshatisja nga gjërat e tepërta, që do të sillnin çlirimin e Mekës, ndërsa stadi i tretë, ishte ajo çka erdhi dhe si ndikoi ky çlirim.

Të gjitha këto stade u kryen me shumë saktësi dhe cilësi. Profeti i Nderuar e kishte përgatitur në mënyrë të saktë rrugën e Mekës dhe të Medines. Ata u gjenden në befasi dhe kjo gjë bëri që në atë tokë të mos derdhej asnjë pikë gjaku dhe Meka të çlirohet.

Njëri prej myslimanëve me besim të dobët, me emrin Hatib bin abi Beltet, kishte shkruar një letër për kurejshët, që t'i lajmëronte për qëllimet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. E nisi letrën drejt Mekës nëpërmjet një gruaje, me emrin Kefud, ose Sara, nga fisi Mezinetu.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u njoftua nëpërmjet mrekullisë për këtë gjë dhe dërgoi Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* me disa shokë të tjerë. Ata e gjetën gruan në një nga shtëpitë midis Mekës dhe Medines, i morën letrën dhe atë vetë e kthyen në Medine. Këtë ngjarje e kemi shpjeguar më gjerësisht ne suren "El Mumtehine", në vazhdim te ajetit të parë të kësaj sureje.

Sidoqoftë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* la në Medine zëvendësin e tij dhe ditën e dhjetë të muajit Ramazan, viti i tetë i migrimit, u nis drejt Mekës dhe pas dhjetë ditëve arriti në Mekë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në mesin e rrugës, takohet me xhaxhain e tij, Abasin, i cili po vinte nga Meka për të shkuar në Medine për të takuar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Profeti i tha: "*Nise për Medine plaçkën dhe eja me ne, sepse ti je migruesi i fundit.*".

Si përfundim, myslimanët arritën pranë Mekës dhe disa kilometra pa u futur në Mekë, vendosen një piknik dhe në darkë ndezën zjarre të shumta për të përgatitur ushqimin (ose për të treguar se janë shumë). Një grup prej mekasve e pa këtë gjë dhe u tremb.

Kurejshët nuk dinin asgjë për lëvizjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Atë natë, Ebu Sufjani dhe disa të tjerë nga të mëdhenjtë e shirkut, kishin dalë jashtë për të marrë informacion për Mekën. Në këtë moment,

Abasi, xhaxhai i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, mendoi se, nëse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të hynte në Mekë me hidhërim, asnjë prej kurejshëve nuk do të mbetej gjallë. Për këtë shkak kërkoi leje nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të njoftojë për çka po ndodh dhe mekasit të vijnë e të kërkojnë mbrojtje te ta.

Abasi u nis dhe, kur u afrua afër Mekës, dëgjoi rastësisht zërin e Ebu Sufjanit që po i thoshte dikujt tjetër, me emrin Bedil, se nuk kishte parë më parë një zjarr të tillë. Bedili i tha: "Mendoj se është zjarr i ndezur nga fisi Khuza'atu.".

- Nuk mendoj kështu, sepse zjarri është më i përhapur, - tha Ebu Sufjani.

Në këtë moment, Abasi thërret Ebu Sufjanin. Ai e njohu Abasin dhe i pyet: - Çfarë po ndodh?

- Ky është i Dërguari i All'llahut, që ka ardhur drejt teje me dhjetë mijë ushtarë myslimanë, - tha Abasi.

Ebu Sufjani s'po dinte ç'të bënte dhe tha: - Ç'më urdhëron të bëj?

- Eja me mua dhe kërko mbrojtje nga Dërguari i All'llahut, në të kundërt do të vritesh! - tha Abasi.

Kështu Abasi e mori me vete Ebu Sufjanin dhe, kur arriti afër vendit ku qëndronte Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, u shfaq Omer ibn Khattabi.

Kur pa Ebu Sufjanin, tha: - Falëminderit Zotit që unë jam më i fortë se ti dhe ti nuk ke asnjë siguri!

Ai vajti me nxitim te Profeti dhe i kërkoi leje ta vriste Ebu Sufjanin. Por Abasi u afrua dhe tha: O i Dërguari i All'llahut! Unë e mora në mbrojtjen time Ebu Sufjanin.

- *Edhe unë, gjithashtu, do ta lë të mbrojtur, derisa nesër ta sillni tek unë,* - tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Të nesërmen, kur Abasi e solli pranë, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i tha: *Mjerë për ty o Ebu Sufjan, a nuk ka ardhur koha të besosh te Zoti Një?*

- Po, o i Dërguari i All'llahut! Unë dëshmoj në Zotin Një. Nëse idhujt do të kishin bërë gjë apo do kishin fuqi për gjë, unë nuk do kisha rënë në një ditë të tillë, - tha Ebu Sufjani.

- *A nuk ka ardhur dita që të dish se unë jam i Dërguari i Zotit?* – i tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

- Dyshimi dhe pyetjet janë të shumta në zemrën time, - tha Ebu Sufjani.

Si përfundim, ai dhe dy shokë të tij u bënë myslimanë.

- *Dërgoje Ebu Sufjanin tek vendi ku do kalojnë luftëtarët e Zotit, që ai t'i shikojë,* - i tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Abasit.

- Ebu Sufjani është njeri me pozitë, mos e lini pa vlerësuar, - tha Abasi.

- *Çdokush që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt dhe çdokush që kërkon mbrojtje në Xhamin El Haram është i sigurt, çdokush që qëndron në shtëpinë e tij dhe dyert i ka të mbyllura, edhe ata janë të sigurt*, - tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Kur Ebu Sufjani pa gjithë atë ushtri të madhe, besoi.

Nuk i kishte mbetur rrugë tjetër, që të krahasohej dhe iu kthye Abasit, duke i thënë: Është shumë e madhe mbretëria e djalit të vëllait tënd!

- Mjerë për ty, nuk është mbretëri, është Profetësi! Shko të mekasit dhe lajmëroi që të përballen me ushtrinë islame, - tha Abasi.

Ebu Sufjani u nis the shkoi në Qabe. Aty thirri me zë të lartë: "O njerëz, Muhammedi ka ardhur me një ushtri të madhe, që asnjë forcë nuk mund ta thyejë! Kushdo që futet në shtëpitë e veta, është i sigurt. Kush qëndron në Qabe, është i sigurt dhe kushdo që vjen në shtëpinë time, është i sigurt!".

Më pas thirri me zë të lartë: "O kurejsh, pranoni Islamin, që të qëndroni gjallë!".

Bashkëshortja e tij, Hindi, e tërhoqi për rrobe dhe thirri me zë të lartë: - Vriteni këtë burrë plak dhe budalla!

- Lëshomë, nëse nuk pranon Islamin, edhe ti do vritesh! Për Zotin! Shko futu në shtëpi dhe rri brenda! – i tha Ebu Sufjani të shoqes.

Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi të ecë së bashku me rreshtat e ushtrisë islame, derisa arriti tek vendi Dhitui, nga ku dukej Meka. Kur sytë e tij hasën Mekën, iu kujtua dita kur e larguan nga Meka me detyrim. Sot po vjen drejt saj me një ushtri të madhe, ndaj dhe e vendosi ballin e tij të ndritur mbi deve dhe bëri sexhden e falënderimit.

Më pas Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u afrua në një vend, me emrin Huxhun, vend lart Mekës, ku ishte varrosur Hadixhja. Aty ndaloi dhe mori gusël. Me rrobat e punës hipi mbi deve, ndërkohë recitonte suren "El Fet'h" (Nasr). Hyri në Qabe dhe thirri: "*All'llahu Ekber!*".

Të njëjtën gjë bëri edhe ushtria islame. Zëri i tyre përfshiu gjithë fushat e malet. Më pas Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* zbriti nga deveja dhe u fut brenda Qabes, për të zhdukur idhujt. Pasi i theu të gjithë, njëri pas tjetrit, tha: "*E drejta erdhi dhe e padrejta u zhduk, e padrejta është për t'u zhdukur!*".

Disa idhuj të mëdhenj kishin mbetur mbi Qabe, pasi Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk i arrinte dora. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, që të vendoste këmbën mbi supin e tij dhe t'i rrëzonte ato. Kështu veproi dhe idhujt u thyen të gjithë.

Më pas mori çelësin e Shtëpisë së Qabes dhe fotot e pikturuara të Profetëve, të cilët ishin vendosur mbi mure, brenda Qabes, i zhduki.

Pas kësaj fitoreje Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vendosi dorën mbi unazën e Qabes dhe u kthye nga njerëzit, duke u thënë: *"Si thoni ju? Si mendoi ju? Çfarë urdhri të jap për ju?"*.

- Ne nuk presim nga ti asgjë tjetër përveç mirësisë dhe begatisë. Ti je vëllai i madh dhe fëmija i vëllait tonë të madh. Sot ti more pushtetin dhe ne na fal, thanë ata.

Në sytë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* rrodhën lotët. U dëgjua edhe zëri i mekasve që qanin me zë të lartë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj atyre: *"Unë për ju do të them atë çka tha vëllai im, Jusufi (Paqja e Zotit qoftë mbi të!): 'Sot nuk do të ketë asnjë faj dhe qortim për ju, Zoti ju fal ju, sepse Ai është Mëshirues.'"*.[1]

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i fali të gjithë dhe tha: *"Jeni të lirë, mund të shkoni kudo që dëshironi."*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte urdhëruar që ushtria e tij të mos shqetësojë asnjë, të mos vrasë asnjë. Sipas një transmetimi, janë veçuar vetëm 6 persona që kishin gjuhë shumë të keqe dhe të rrezikshme nga gjithë të tjerët.

Edhe kur dëgjoi se Sead ibn Ubadetu, mbajtësi i flamurit, tha: "Sot është dita e hakmarrjes!", Profeti Muhammed *(Paqja e*

[1] Sure "Jusuf", ajeti 92.

bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të)*: *"Vrapo dhe merre flamurin dhe thuaj: 'Sot është dita e faljes dhe e mëshirës!'"*.

Kështu Meka u çlirua pa gjakderdhje. Ata nuk e prisnin këtë falje dhe mëshirë nga ana e Islamit. Kjo gjë ndikoi shumë në zemrat e tyre, saqë njerëzit erdhën grupe-grupe dhe u bënë myslimanë. Kjo fitore e madhe u dëgjua nga i gjithë Gadishulli Arabik. Të gjithë po dëgjonin për fenë islame. Kështu, vendi i myslimanëve dhe i fesë islame u vërtetua nga çdo anë.[1]

Në disa libra të historisë thuhet se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* qëndroi pranë Shtëpisë së Qabes, tha: *"Nuk ka të adhuruar përveç Zotit, që është Një! E mbajti Fjalën dhe premtimin e Tij, robin e tij e ndihmoi, e mbështeti dhe vetë të gjitha dënimet i theu, o njerëz! Dijeni se çdo mall, çdo koncesion, çdo gjak, në lidhje më të kaluarën dhe kohën e injorancës, është poshtë këmbëve të mia."*.

Nuk duhet të flitet më për gjakrat që janë derdhur në kohën e injorancës, apo mallrat që ju janë marrë. Çdo gjë që është quajtur e mirë në kohën e injorancës, sot është zhdukur, kështu të gjitha dosjet e të kaluarës janë mbyllur.

Ky qe një plan shumë i rëndësishëm dhe i habitshëm, që bëri që njerëzit e Hixhazit të heqin dorë nga e kaluara e tyre dhe të nisin jetën e tyre me fenë islame, me paqe dhe falje.

[1] "Et Telkhijs" nga "Kamil, i Ibn Ethijr", vëll. 2, dhe tefsiri "Mexhmaul Bejan" në vazhdim të ajetit që diskutuam.

Kjo punë qe e jashtëzakonshme dhe ndihmoi shumë në zhvillimin e fesë islame dhe është shembull për sot dhe të nesërmen tonë.

O All'llah! Ti ke fuqi të sjellësh edhe një herë te myslimanët madhështinë e fesë së ndjekur nga tradita dhe syneti i Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

O All'llah! Na bëj prej ndjekësve dhe shokëve të drejtë të Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)!

O All'llah! Na jep mundësinë të shijojmë pushtetin e drejtësisë islame në këtë botë dhe ta pranojmë atë me shpirt dhe zemër!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "En Nasr".

Sure "El Mesed"

Zbritur në Mekë

Ajete 5

Përmbajtja e sures "El Mesed"

Kjo sure ka zbritur në Mekë, përafërsisht në fillim të ftesës së hapur që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u bëri kurejshëve. Është e vetmja sure që sulmon duke cituar emrin e një prej armiqve të fesë islame dhe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që në atë kohë ishte Ebu Lehebi. Përmbajtja e saj tregon se ai kishte një urrejtje të veçantë për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. As ai dhe as gruaja e tij nuk përmbaheshin nga asnjë punë dhe nga gjuha e ligë e tyre.

Kur'ani thotë me qartësi se që të dy ata janë banorë të Xhehennemit, për ta nuk ka rrugë shpëtimi. Ajo çka u tha, u vërtetua, sepse ata vdiqën pa besim. Kjo gjë tregon qartë parashikimin e All'llahut të Madhëruar.

Mirësia e leximit të kësaj sureje

Në hadithin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Ai që e lexon këtë sure, shpresoj që Zoti të mos e bashkojë në një shtëpi me Ebu Lehebin."*[1] (që do të thotë se ai që e lexon këtë sure, do të jetë Xhennetli, ndërsa Ebu Lehebi Xhehennemli).

Është e qartë se mirësia e kësaj sureje është për ata që ndryshojnë rrugë, nga e keqja hyjnë në të mirë dhe nuk janë në rrugën e Ebu Lehebit, pra, të mos jenë Ebu Leheb, as me gojë, as me vepra.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 558.

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ، مَا أَغْنَى عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ، سَيَصْلَى نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ، وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ، فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِنْ مَسَدٍ﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëploti!

"Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!"

"Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera."

"Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,"

"Po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,"

"Në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme."

Shkaku i zbritjes

Është transmetuar nga Ibn Abasi se, kur zbriti ajeti që e urdhëroi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të ftojë të afërmit dhe familjarët e tij të afërm në fenë islame, pra, ta bëjë hapur ftesën për fenë islame, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* qëndroi mbi malin Saffa dhe thirri me zë të lartë: "*Ja Sebahah*"! (kjo fjalë përdorej nga arabët, kur ata zinin pa mendje armikun, që të gjithë të viheshin në dijeni që është gjetur armiku pa vëmendje.)

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përzgjodhi këtë fjalë, sepse sulmet pa mendje kryheshin në mëngjes herët.

Kur mekasit e dëgjuan këtë zë, pyetën se kush po thërriste.

- Muhammedi është, - thanë.

Të gjithë u grumbulluan pranë tij. Ai i thirri të gjitha fiset arabe në emër dhe tha: "*Më thoni, nëse ju them dhe ju lajmëroj se kalorësit e armikut do t'ju sulmojnë nga ky mal, a më besoni?*".

- Ne nuk të kemi njohur ty asnjëherë për gënjeshtar, - iu përgjigjën ata.

- Unë ju paralajmëroj për një dënim shumë të madh. Ju ftoj të braktisni idhujt dhe të pranoni Teuhidin, Njëshmërinë, - tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Kur Ebu Lehebi e dëgjoi këtë fjalë, tha: "Vdekja qoftë për ty! Ti na mblodhe këtu për të na thënë këtë?!". Këtu zbret kjo sure.

Disa të tjerë shtuan se, kur bashkëshortja e Ebu Lehebit, Umi Xhemil, u njoftua se kishte zbritur një sure për bashkëshortin e saj dhe për të, shkoi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me një gur në dorë. Por, kur pa se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ndodhej aty, tha: "Dëgjova se Muhammedi ka sulmuar burrin tim dhe mua, do t'ia thyej dhëmbët me këtë gur! Unë jam vete poete.".

Më pas nisi të shkruajë poezi kundër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe fesë islame.[1]

Rreziku i Ebu Lehebit dhe i bashkëshortes së tij për fenë islame dhe thirrjen e tij nuk ishte vetëm kjo. Ata ishin më shumë të rrezikshëm.

Këtë gjë do ta trajtojmë më poshtë.

Komentimi

[1] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 7324 (me pak ndryshim). Po të njëjtin kuptim, me pak ndryshim, e gjejmë edhe te Tabrasij, në "Mexhmaul Bejan" dhe te Ibn Ethiri në vëll. 2, f. 60; "El Kamil" po ashtu, në "Durr'rrul Menthur", Abul Fettuh Rrazij, "Fi Dhilalil Kur'an" janë cituar në tefsirnin e kësaj sureje.

Ashtu sikurse e cituam edhe në shkakun e zbritjes së kësaj sureje, kjo sure është përgjigje për fjalët e këqija të Ebu Lehebit, xhaxhait të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe djalit të Abdul Mutalibit, të cilët ishin armiq të vështirë të fesë islame.

Kur dëgjuan për ftesën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe për paralajmërimin e tij në lidhje me dënimin Hyjnor, tha: "U shkatërrofsh, për këtë na ke thirrur?!".

Kur'ani i Shenjtë këtij burri me gjuhë të ligë i përgjigjet: **"Iu thafshin duart Ebu Lehebit**[1] **dhe u thaftë në gjithçka!"**.

Sipas Ragibit, në librin "Mufredat", fjalët *"et tebbu"* dhe *"et tebbab"* kanë kuptimin: *dëm i vazhdueshëm dhe i përhershëm*.

Tabrasij, në veprën "Mexhmaul Bejan", thotë se kanë kuptimin humbje që përfundon me shkatërrim.

Disa gjuhëtarë e kanë komentuar atë me kuptimin: *të ndash, të presësh*. Ndoshta, sepse humbja dhe shkatërrimi bëhet shkak i ndarjes dhe i prerjes. Nga përmbledhja e kuptimit përfitohet ajo që thamë për kuptimin e ajetit.

[1] Ebu Leheb (Babai i flakës) ishte nofka e Abdul 'Uzza-s, birit të Abdul Muttalibit, pra, xhaxhait të Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur u bë kryetar i fisit të Hashimive, pas vdekjes së Ebu Talibit, ai refuzoi ta vazhdonte mbrojtjen fisnore për Muhammedin *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e la atë të ekspozuar ndaj armiqësisë së idhujtarëve.

Edhe pse ky shkatërrim dhe humbje mund të ketë të bëjë ose me këtë botë, ose me shpirtëroren dhe Botën e Përtejme, ose të dyja këto.

Në këtë rast lind një pyetje: Si ka mundësi, Kur'ani i Shenjtë, në kundërshtim me mënyrën dhe traditën e tij, në këtë rast, ka përmendur emrin e një personi dhe e ka sulmuar atë me forcë të madhe?!

Duke qartësuar gjendjen e Ebu Lehebit, qartësohet edhe përgjigjja e kësaj pyetje.

Emri i tij, Abdul Uza (rob i idhullit Uza) dhe nofka e tij ishte Ebu Leheb, përzgjedhja e këtij emri, ndoshta ishte për shkak se kishte fytyrë të kuqe. Në fjalor, fjala *"leheb"* ka kuptimin: *flakë zjarri*.

Ai dhe bashkëshortja e tij, e cila ishte motra e Ebu Sufjanit, qenë ndër armiqtë me të vështirë dhe më të këqij të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në një transmetim nga Tarik Meharebi thuhet: "Unë isha në tregun e lirë që bëhej pranë Arafatit. Pak larg nga Meka, papritur dëgjova zërin e një djali të ri që thërriste: "O njerëz! Thoni: "La ilahe Ilall'llah", që të shpëtoni!". Pashë që një burrë po e qëllonte me gurë nga këmbët, saqë këmbët iu gjakosën dhe thërriste: "O njerëz! Ky është gënjeshtar! Mos e dëgjonin e mos e ndiqni atë!".

Unë pyeta se cili ishte ky djalë i ri. Më thanë se ishte Muhammedi, që mendon se është profet. Ai plak është xhaxhai i tij, Ebu Lehebi që e konsideron atë gënjeshtar.[1]

Në një tjetër transmetim thuhet se Rebije bin Ebad thotë: "Unë dhe babi im ishim bashkë, kur pamë të Dërguarin e All'llahut që shkonte te fiset arabe dhe i fonte ata të adhurojnë All'llahun Një dhe ta pranojnë atë si i Dërguari i All'llahut.

Kur ai largohej prej tyre, një burrë i vinte nga prapa dhe i thërriste: 'O fisi filan! Ky burrë do që ju të lini mënjanë idhullin Lat dhe Uzei dhe të prishni besën tuaj me xhindet. Ky po ju fton drejt bidatit dhe humbjes. Largohuni, mos ia dëgjoni fjalët, mos e ndiqni atë!'.

Unë pyeta se cili ishte ky njeri. Më thanë se ishte xhaxhai i tij, Ebu Lehebi".[2]

Në një transmetim tjetër thuhet se, kur grupe të ndryshme arabe vinin të kërkonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në fillim shkonin tek Ebu Lehebi, sepse ishte më i madhi i fisit. Ai thoshte se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte magjistar. Kështu njerëzit iknin dhe nuk e takonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Një herë tjetër erdhi një tjetër grup dhe thanë se nuk iknin nga Meka, pa takuar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 559.
[2] Tefsiri "Fi Dhilalul Kur'an", vëll. 8, f. 697.

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ebu Lehebi tha: "Ne vazhdimisht jemi në kurim të çmendurisë së tij! E marrtë vdekja sa më parë!".[1]

Nga këto transmetime kuptojmë më së miri se ai, në shumicën e rasteve, e ndiqte Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si hije dhe nuk kënaqej asnjëherë me punën dhe veprat e këqija që bënte kundër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në veçanti, përdorte gjuhë të ligë dhe të ndyrë, shprehjet e tij ishin shumë ofenduese. Ndoshta për këtë konsiderohej edhe si armiku më i madh i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ndoshta kjo është arsyeja që edhe ajetet për të cilat folëm më lart, flasin me shumë egërsi për të dhe për bashkëshorten e tij.

Ai ishte i vetmi person nga Beni Hashimitët që nuk kishte firmosur për të mbështetur dhe për të mbrojtur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai u vendos në rreshtin e armikut dhe merrte pjesë në besëlidhjet që bënin armiqtë kundër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Duke u bazuar te të gjitha këto të vërteta, shpjegohet shumë qartë se përse është e veçantë.

Më pas thuhet se pasuria dhe pushteti i tij nuk patën asnjë dobi për të, nuk i hiqet dënimi i Zotit: **"Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera."**.

[1] Tefsiri "El Furkan", vëll. 30, f. 503.

Nga ky ajet kuptohet se ai ishte burrë i pasur dhe mendjemadh, ishte mbështetur te pasuria dhe mallrat e tij për të qenë kundër fesë islame.

Në ajetin tjetër shtohet: **"Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara."**.

Nëse emri i tij ishte Ebu Leheb, edhe zjarri që do ta djegë, do të ketë emrin "Ebu Leheb", i cili do të ketë flakë të mëdha. Në këtë rast, fjala *"leheb"* ka ardhur në formën *"nekere"*, që tregon madhësinë e flakës së zjarrit.

Jo vetëm Ebu Lehebi, po asnjë jobesimtar dhe punëlig, nuk do t'i ruhet as pasuria e as pushteti. Ata nuk do mund t'i shpëtojnë dënimit Hyjnor, ashtu sikurse thuhet edhe në ajetet 88-89 të sures "Esh Shuara": **"Në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek All'llahu!".**

Sigurisht që qëllimi i ajetit të tretë të sures: **"Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara."**, ka për qëllim zjarrin e Xhehennemit.

Disa janë të mendimit se përfshin edhe zjarrin e kësaj botë. Në disa transmetime thuhet se pas luftës së Bedrit dhe humbjes që patën kurejshët, Ebu Lehebi, që nuk kishte marrë pjesë në këtë luftë, vajti pranë Ebu Sufjanit dhe e pyeti se si shkoi kjo luftë. Ebu Sufjani i tregoi se si kurejshët humbën. Më tej shtoi se betohej në Zot, se në këtë luftë kishte parë kalorës që qëndronin midis qiellit e tokës e që ndihmonin Muhammedin. Në këtë moment, Ebu Rafeh, një prej shërbëtoreve të Abasit, thotë: "Unë isha ulur aty dhe ngrita dorën e thashë se ata janë engjëjt e qiellit.

Ebu Lehebi, kur dëgjoi këtë gjë nga unë, u mërzit shumë dhe më qëlloi në fytyrë. Më pas më ngriti në këmbë dhe më shtyu në tokë. Më qëllonte e më qëllonte pa pushim. Në këtë moment erdhi bashkëshortja e Abasit, Umu Fadl, kapi një shkop dhe e qëlloi Ebu Lehebin në kokë dhe i tha: "Ç'të ka gjetur? Apo gjete një njeri të dobët dhe po e qëllon!".

Koka e Ebu Lehebit u ça dhe filloi t'i dilte gjak. Pas shtatë ditësh koka iu infektua dhe më pas u sëmur rëndë dhe vdiq.

Infeksioni i trupit të tij ishte shumë i rëndë, saqë nuk mund t'i bëhej derman. Atë e dërguan jashtë Mekës, sepse nuk i afrohej asnjë afër. E lanë me ujë nga larg dhe më pas i hodhën një gur të madh mbi trup. Kështu u fsheh poshtë dheut dhe gurëve.[1]

Në ajetin tjetër flet për gjendjen e bashkëshortes së tij, Ummu Xhemilit. Edhe ajo do të jetë prej xhehennemlinjve, ndërkohë që në kurrizin e saj do të ketë drunj zjarri që tërheq nga pas: **"Po ashtu edhe gruaja e tij,[2] që mbart drutë e zjarrit, në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme."**.

Nuk ka dyshime për bashkëshorten e Ebu Lehebit, e cila së bashku me bashkëshortin e saj, kanë qenë kundërshtarë të ashpër

[1] "Biharul Enuar", vëll. 19, f. 227.

[2] Ajo quhej Ummu Xhemijl bintu Harb dhe kishte një rol kryesor në armiqësinë që burri i saj ushqente ndaj nipi të tij, Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajo ishte motra e Ebu Sufjanit, që në atë kohë do të udhëhiqte luftën e idhujtarëve kundër myslimanëve. Me mllefin e saj, ajo hidhte përreth shtëpisë së Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ferra dhe gjemba, me shpresën që ai të lëndohej gjatë kthimit në shtëpi natën.

të Islamit, por përse në Kur'an thuhet se ajo do të mbartë mbi supe drurët e zjarrit?

Për këtë çështje janë dhënë komentime të ndryshme.

Disa janë të mendimit se ajo mbante mbi kurriz idhujt dhe ato ia hidhnin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që këmbët e tij të vriteshin.

Disa thanë se ky interpretim është aludim për thashethemet e tij dhe për të treguar për të, sikurse thuhet edhe në letërsinë perse për thashethemexhinjtë: "Midis dy njerëzve lufta është si zjarri, thashethemexhiu fatkeq shton zjarrin!".

Të tjerë mendojnë se tregon forcën e koprracisë së tij, sepse me gjithë atë pasuri që kishte Ebu Lehebi, nuk ndihmonte nevojtarët, për këtë arsye e kanë krahasuar me "tërheqësin e drurëve të zjarrit".

Të tjerë janë të mendimit se ai, në Ditën e Kiametit do të ketë mbi supe edhe mëkatet e një grupi të madh.

Ndër të gjithë këto komente, komenti i parë është më i përshtatshëm, edhe pse përmbledhja e gjithë komenteve është e mundur.

Fjala *"el xhijd"* ka kuptimin *"qafë"*. Shumësi i saj është *"exhjad"*.

Disa fjalorshkrues besojnë se fjalët: *"xhjid"*, *"enek"* dhe *"rekebe"* kanë kuptim të ngjashëm, me ndryshimin që *"xhijd"* quhet pjesa e sipërme e gjoksit, ndërsa *"unukun"* i thonë pjesës së prapme të

qafës, ose të gjithë qafës, ndërsa *"rekbetun"* i thuhet qafës. Ndonjëherë përdoret për lirimin e një njeriu.

Fjala *"mesedun"* ka kuptimin: *litar që është thurur nga fijet*. Disa komentues janë të mendimit se fjala *"mesed"* është litari që është varur në qafën e tij në Xhehennem dhe ka nxehtësinë e zjarrit dhe është i rëndë sikur hekuri.

Të tjerë, gjithashtu, janë të mendimit se gratë e shtresave të larta, për të treguar lartësinë e tyre, përdornin xhevahir të veçantë dhe me çmim shumë të shtrenjtë. Zoti, në Ditën e Kiametit, për ta nënvleftësuar këtë grua egoiste dhe aristokrate, i vendos në qafë një litar prej fijeve të hurmës.

Të tjerë kanë thënë se shkaku i këtij interpretimi është se Ummu Xhemil mbante në qafë një gjerdan shumë të shtrenjtë dhe ishte betuar se atë do ta përdorte në rrugën e armiqësisë së Profetit të Zotit. Ndaj edhe Zoti i Madhëruar, për ta dënuar, i vendos këtë lloj dënimi.

Hulumtime

1- Një tjetër shenjë prej mrekullisë së Kur'anit

Ne dimë se këto ajete kanë zbritur në Mekë dhe Kur'ani jep lajmin se Ebu Lehebi dhe bashkëshortja e tij do të jenë në zjarrin e Xhehennemit, që do të thotë se ata kurrë nuk do të besojnë dhe përfundimi i tyre ishte i tillë.

Shumë jobesimtarë të Mekës besuan, disa prej tyre në mënyrë sipërfaqësore, por prej personave që as me të vërtetë dhe as në mënyrë sipërfaqësore nuk besuan, këta dy persona ishin që nuk besuan kurrë dhe Kur'ani i Shenjtë njoftoi për ta dhe vendin ku do të përfundojnë.

Kur'ani i Shenjtë, të tilla lajme i ka sjellë edhe në ajetet e tjera, të cilat janë grumbulluar me titullin kapitulli "Mrekullitë e Kur'anit".

Ne, për secilin nga këto ajete, në këtë tefsir, kemi trajtuar çështjen e mrekullisë së tyre.

2- Përgjigje e një pyetje

Në këtë rast është një pyetje që duhet të trajtohet: Me këto parashikime të Kur'anit të Shenjtë nuk ka qenë e mundur që Ebu Lehebi dhe bashkëshortja e tij të besonin. Tashmë ky lajm, a konsiderohet si gënjeshtër?

Kjo pyetje është sikurse pyetja e njohur që bëhet për çështjen e Dijes së All'llahut në çështjen e Xhebrit - detyrimit, kur thuhet se ne e dimë që Zoti ka dije për çfarë kemi qenë, ç'do të jemi dhe ç'do të bëjmë. Duke u bazuar në këtë, nëse mëkatari nuk bën mëkat, atëherë dija e Zotit kthehet në injorancë. Përgjigjja e kësaj pyetje është dhënë shumë kohë më parë nga dijetarët dhe filozofët islamë: Zoti e di se çfarë pune kryen çdokush, duke përdorur autoritetin dhe lirinë e tij, sikurse edhe në ajetin për të cilin diskutuam, Zoti që në fillim e dinte se Ebu Lehebi dhe bashkëshortja e tij, me dëshirën dhe vullnetin e tyre, nuk do të besonin kurrë.

Me fjalë të tjera, elementet e lirisë, vullnetit dhe të autoritetit janë pjesë të qarta të Zotit. Ai e dinte se çfarë veprash do të kryenin robtë e Tij, me cilësitë e autoritetit, vullnetit dhe lirisë së tyre. Sigurisht që një dije e tillë dhe të lajmërosh për të ardhmen, është theksim për çështjen e autoritetit dhe jo argument për shtrëngim dhe detyrim.

Kjo sure, edhe një herë, thekson këtë të vërtetë, që të afërmit, nëse nuk janë në një besim, nuk kanë asnjë vlerë. Burrat e Zotit nuk infektohen nga të paudhët, sado të afërm të jenë ata.

Ebu Lehebi ishte xhaxhi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe konsiderohej nga më të afërmit, por, kur besimi nuk është i njëjtë, edhe veprat janë të ndara, sikurse edhe hija e tij e paudhë, e cila bëhet e largët dhe nuk konsiderohet më pjesë e familjes, por as edhe e një race dhe gjuhe.

Ka njerëz që nuk janë familjarë e as të një race apo kombi, por kanë të njëjtin besim dhe kryejnë të njëjtat vepra, të tillë njerëz, sikurse edhe thotë hadithi i njohur i Selmanit, "Selmani është nga familja jonë", me veprat e tij dukej sikur u bë pjesë e familjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Është e vërtetë që ajetet e kësaj sureje flasin vetëm për Ebu Lehebin dhe bashkëshorten e tij, po është e dukshme se ata, për

[1] Shpjegim më të detajuar për këtë fushë, shikoni komentimine ajetit 46 të sures "Hud", ku flitet për djalin e Profetit Nuh *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

shkak të cilësive të tyre, u dënuan kështu. Duke u bazuar në këtë, çdo person apo grup që i ka këto cilësi, do të marrë të njëjtin dënim.

O All'llah! Pastroje zemrën tonë nga çdo lloj kokëfortësi!

O All'llah! Ne jemi të frikësuar nga fundi i veprave tona, Na fal siguri dhe qetësi, bëje të mirë të ardhmen tonë!

O All'llah! Në atë ditë nuk do të bëjë dobi as pasuria, as familja e as shoqëria, është vetëm mirësia Jote, o Zot, që do të na shpëtojë.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Mesed".

Sure "El Ikhlâs"

Zbritur në Mekë

Ajete 4

Përmbajtja e sures "El Ikhlâs"

Kjo sure, sikurse është e kuptueshme edhe nga emri që mban, flet për Njëshmërinë e All'llahut. Në katër ajete të shkurtra është përshkruar në mënyrën më të përsosur Njëshmëria e All'llahut.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është transmetuar shkaku i zbritjes së kësaj sureje: *"Një jehudi i kërkoi të Dërguarit të All'llahut (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) që t'i përshkruajë Zotin. Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) qëndroi tri ditë në heshtje dhe nuk i ktheu përgjigje, deri sa zbriti kjo sure."*.

Në disa transmetime të tjera thuhet se këtë pyetje e bëri Abdullah Sureja, një prej të mëdhenjve të njohur të jehudive. Në një transmetim tjetër thuhet se këtë pyetje e bëri Abdullah ibn Selam, në Mekë. Më pas ai besoi dhe besimi i tij qe shumë i fortë.

Në një tjetër transmetim thuhet se këtë pyetje e bënë jobesimtarët e Mekës.[1]

Në të tjera transmetime thuhet se pyetësi ishte një grup prej katolikëve të Nexhranit.

Në mesin e këtyre transmetimeve nuk ka asnjë kundërshtim, sepse kjo pyetje mund të jetë bërë nga të gjitha grupet dhe kjo, në vetvete, është një argument, për sa i përket madhështisë së jashtëzakonshme të kësaj sureje, e cila jep përgjigjen për të gjithë ata dhe popuj të ndryshëm.

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 546.

Mirësitë e leximit të sures "El Ihlâs"

Janë transmetuar shumë hadithe për sa u përket mirësive të leximit të kësaj sureje. Në një prej hadithe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush prej jush është i pamundur që të lexojë një të tretën e Kur'anit në një natë?!"*.

- O i Dërguari i All'llahut! Po kush mund të bëjë një punë të tillë, në një natë?! – tha një prej të pranishmëve.

- *Lexoni suren "Kulhu'uall'llahu e had"*, - tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në një hadith tjetër të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë*: "Kur Profeti i nderuar i fali namazin e xhenazes Sa'd ibn Meadhit, ishin edhe shtatëdhjetë mijë engjëj. Ndër to ishte edhe Xhibrili. Unë pyeta Xhibrilin, 'çfarë vepre të mirë ka bërë që po ia fal namazin edhe ti'"*.

- Ai recitonte suren "Ikhlas" në çdo gjendje që ishte, i ulur, në këmbë, i hipur mbi kafshë apo kur ecte në këmbë, kur ikën e kur vjen, - u përgjigj Xhibraili.[1]

Në një hadith tjetër të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nëse një person fal namaz një natë e një ditë pa thënë suren "Ikhlas", atij i thuhet: 'O rob i Zotit, ti nuk je nga falësit e namazit.'"*.[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 561.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 561. Edhe në libra të tjerë të tefsirit dhe të hadithit.

Në një tjetër hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Kush beson në Zot dhe në Ditën e Kiametit, nuk e braktis asnjëherë suren 'Ihklas' pas namazit, sepse, kur e reciton atë, shikon hajër në këtë botë edhe në Tjetrën, ato i ka të mbledhura për veten e tij, babain, nënën dhe fëmijët e tij.*".[1]

Nga transmetimet dhe hadithet e tjera, nxjerrim mësim se leximi i kësaj sureje, para se të hymë në shtëpi, bën që të kemi mirësi dhe bereqet.

Mirësitë e kësaj sureje janë të shumta. Ne përmendëm vetëm një pjesë të shkurtër prej tyre.

Po përse e kanë konsideruar suren "Ihklas" si një të tretën e Kur'anit?

Disa janë të mendimit, sepse Kur'ani është i përbërë nga Ligji, Besimi dhe Historia dhe kjo sure, në mënyrë të ngjeshur, flet për një pjesë të Besimit.

Të tjerë janë të mendimit se Kur'ani është i përbërë prej tri pjesëve: Krijimi, Ringjallja dhe çka është midis këtyre të dyjave. Kjo sure komenton pjesën e parë.

Është e pranueshme që një e treta e Kur'anit flet për Njëshmërinë dhe Teuhidin. Kjo sure e ka përçuar mesazhin e saj.

Për madhështinë e kësaj sureje flet ky hadith: "Kur e pyetën Imam Aliun (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për suren Teuhid, ai u përgjigj: *'Zoti i Madhëruar e dinte që në kohën e fundit do të vijnë popuj që do të jenë të mendueshëm dhe në shumë çështje do të kenë shumë saktësi,*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 561.

ndaj edhe suren 'Ikhlas' dhe ajetet e fillimit të sures 'El Hadîd' i ka zbritur për çështjen e Njëshmërisë dhe njohjes së Zotit. Kushdo që kërkon më shumë se kaq, do të shkatërrohet.'".[1]

[1] "Usulul Kafij", vëll. 1, kreu "El Nisbetu", Hadithi 3.

Ajetet 1 – 4

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ، اللَّهُ الصَّمَدُ، لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ، وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Thuaj: 'Ai është All'llahu, Një dhe i Vetëm!'"

"All'llahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim."

"Ai as nuk lind, as nuk është i lindur."

"Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) **me Atë!"**

Komentimi

I Vetëm të Cilit i përgjërohet gjithçka

Ajeti i parë i kësaj sureje i përgjigjet pyetjes që bëhet vazhdimisht prej popujsh, personash të ndryshëm në lidhje me

cilësitë e All'llahut: **"Thuaj: 'Ai është All'llahu, Një dhe i Vetëm!'"**.

Fjalia ka filluar me përemrin **"Ai"**, që është në numrin njëjës dhe tregon një kuptim të pakonceptueshëm. Në të vërtetë, është një sekret për një të vërtetë, që Qenia e Shenjtë e Zotit është në pafundësi, jemi të kufizuar, edhe pse ndikimet e Tij e kanë mbushur botën plot e përplot dhe mund të jetë nga çdo gjë më i qartë.

Në ajetin 53 të sures "Fussilet", thuhet: **"Ne do t'u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai** (Kur'ani) **është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?!"**.

Pas kësaj të vërtete të panjohur, hapet një perde dhe thotë: **"Thuaj: 'Ai është All'llahu, Një dhe i Vetëm!'"**.

Fjala *"kul-thuaj"*, në këtë rast, ka kuptimin: shfaqe të vërtetën, tregoje atë.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet se pas citimit të kësaj fjale, tha: "Jobesimtarët dhe idhujtarët i thërrisnin në emër dhe i tregonin me shenjë ata, duke thënë: 'Këta janë zotat tanë, o Muhammed! Edhe ti na e përshkruaj Zotin tënd, që ta shohim e ta ndiejmë!'".

Zoti zbriti këto ajete, që të përshkruajë dhe të vërtetojë atë çka është larg syve dhe larg prekjes së shqisave.

Në një hadith tjetër të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Në natën e Luftës së Bedrit pashë në ëndërr Hidrin dhe i kërkova të më mësojë ndonjë gjë, që të dal fitimtar ndaj armikut*. Më tha, thuaj: **"Ja hu, Ja men la hu ila hu."**

Kur u zbardh, këtë gjë ia tregova të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

- *O Ali, të është mësuar "Ismi A'dhem"*, më tha Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Këtë fjali e kam recituar gjatë Luftës së Bedrit.".[1]

Kur Amar Jasiri dëgjoi se Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, në ditën e Luftës së Siffinit, po recitonte diçka, e pyeti se çfarë ishte kjo që po recitonte.

- *Ismi Adhem i Zotit dhe shtylla e Teuhidit,* - i tha Imami.

Emri *"All'llah"* është emër i veçantë për Zotin. Kuptimi i fjalës së Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, në këtë rast, është se në këtë fjalë, *"All'llah"*, janë përmbledhur të gjitha cilësitë e Tij si madhështia hyjnore po ashtu edhe bukurija hyjnore dhe për këtë shkak është emëruar si "Ismi Adhem" i Zotit.

Ky emër nuk i thuhet askujt përveç Zotit, ndërkohë që emrat e tjerë të Tij, zakonisht përshkruajnë një prej cilësive të Tij, sikurse është: "Alijm - i Ditur", "Khalik – Krijues", "Rrezzak - Dhurues i

[1] "Biharul Enuar", vëll. 3, Hadithi 12, f. 221. (me shkurtim)

riskut". Në përgjithësi, këta emra përdoren edhe përveç Zotit, sikurse është: Rrahijm, Kerijm, Kadijr etj.

Gjithsesi, rrënjët e saj kanë kuptim mbiemëror dhe në origjinal është i prejardhur nga fjala *"uelhun"*, që ka kuptimin *"tehajare"*sepse mendjet janë të habitura nga Qenia e Pastër e Zotit.

Në hadithin e Imam Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"Fjala 'All'llah', vjen me kuptimin 'i adhurueshëm' dhe krijesat mahniten dhe dashurohen pas Tij. All'llahu është Ai që nuk mund të perceptohet nga sytë, sepse është i mbuluar nga mendimet e intelekti modest i njerëzimit."*.[1]

Ndonjëherë kuptimi i saj është marrë nga rrënja e fjalës *"alihun"* dhe ka kuptimin: *adhurim*. Në origjinal ka qenë *"el ilah"*, me kuptimin: *i vetmi i adhuruar me të drejtë*.

Por, sikurse edhe e thamë; sido që të kenë qenë rrënjët dhe prejardhja, më pas ka marrë formën e emrit "Ismi A'dhem", ky emër i referohet thelbit gjithpërfshirës të të gjitha atributeve të përsosjes e cila është e pastër nga çdo e metë.

Ky emër i shenjtë në Kur'an është përmendur njëmijë herë. Asnjë emër nga emrat e shenjtë të Tij nuk është përmendur në Kur'an në këtë shifër. Është emër që e ndriçon zemrën, njeriut i fal forcë dhe qetësi, duke e mbuluar atë në dëlirësi.

Fjala *"ehad"* vjen nga rrënja e fjalës *"el uahid"*. Disa i kanë komentuar me të njëjtin kuptim të dyja fjalët, *një*. Gjithashtu, ata besojnë se të dyja flasin për Qenien që është e pamposhtur dhe i

1 "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 222.

Vetëm në univers. Fuqia e Tij nuk mund të krahasohet, është i Vetëm në mëshirë.

Përfundimisht, është i Paarritshëm dhe i Pakrahasueshëm, nga çdo anë.

Por të tjerë besojnë se midis fjalëve *"ehad"* dhe *"uahid"* ka ndryshim.

"Ehadun" i thuhet një qenie që nuk pranon shumës, as në pikëpamjen e jashtme e as në mendje, ndaj nuk mund të numërohet dhe kurrë nuk mund të futet te numrat, në kundërshtim me fjalën *"uahidun"*, që për të mund të përfitojmë edhe dy, edhe tre, si në pikëpamjen e jashtme, ashtu edhe të brendshme. Ndaj ndonjëherë themi, nga ai grup nuk erdhi asnjë (ehedi), do të thotë se askush nuk qe i pranishëm. Por, kur themi nuk erdhi njëri *(uahedun)*, mund të kenë ardhur dy ose disa persona.[1]

Por ky ndryshim nuk është shumë i përshtatshëm me përdorimin që i bën Kur'rani i Shenjtë dhe hadithi.

Të tjerë komentues janë të mendimit se fjala *"ehad"* flet për thjeshtësinë e Qenies së Zotit përballë komponentit përbërës të jashtëm, ose intelektit. Ndërkohë që fjala *"uahid"* flet për Njëshmërinë e Qenies së Zotit përballë shumicës së jashtme.

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Fjala "ehed" është një, ndërsa fjalët "ehed" dhe "uahid" kanë një kuptim që është Qenie e Vetme, e Cila nuk ka të ngjashëm me Të, ndërsa Teuhid është të rrëfesh Njëshmërinë e Zotit*.

1 Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 543.

Në vazhdim po të këtij hadithi, lexojmë se *fjala "uahid" nuk vjen nga numrat, por është themeli i numrave. Numri nis nga dyshi, dhe sipas këtij kuptimi, "All'llahu Ehad" ka kuptimin: adhurues.*

Njerëzit e kanë të pamundur ta perceptojnë Qenien e Zotit, edhe për sa i përket cilësisë së Tij e kanë të pamundur, Ai është tek, nuk ka ngjashmëri me krijesat".[1]

Në Kur'anin e Shenjtë, fjala *"Uahid dhe Ehed"* është përdorur vetëm për Qenien e Pastër të All'llahut.

Është për t'u habitur se në "Teuhidin e Sadukut" thuhet se një arab, ditën që nisi Lufta e Xhemelit, e devesë, u ngrit dhe tha: O Prijësi i besimtarëve! A thua se Zoti është "uahid" *një*? Ç'kuptim ka fjala "uahid"?

Kur njerëzit e dëgjuan pyetjen e tij, e sulmuan, duke i thënë: O burrë arab! Ç'pyetje është kjo? A nuk e shikon se Prijësi i besimtarëve, Aliu është shumë i zënë me çështjet e luftës? Çdo pyetje dhe fjalë ka vendin dhe kohën e saj!?

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!) tha:- Lëreni në gjendjen e tij, sepse ajo çka ai kërkon, është e njëjtë me atë çka kërkojmë ne nga ky grup armik. (Ai pyet për Teuhidin, ne kemi kundërshtarë që po i ftojmë në Teuhid).*

Më pas shtoi: - *O arab! Ajo që themi se Zoti është "Uahid" Zoti Një, mund të ketë katër kuptime, ku dy prej kuptimeve të përdorura nuk janë të rregullta, ndërsa dy të tjerat janë të rregullta.*

[1] "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 222.

Dy kuptime që nuk janë të rregullta: si uniteti numërik, kjo gjë nuk është e lejuar për Zotin, (Nëse themi Ai është Një, nuk është dy, kuptimi i kësaj fjale është se mund të imagjinohet për të një i dytë, por nuk ekziston. Ndërkohë që sigurisht për Qenien e Pastër dhe të Pafundme nuk mund të imagjinohet një i dytë), sepse ajo gjë që nuk ka të dytë, nuk fytet te numërimi. A nuk pe ti se si tha Zoti për ata që thanë se Zoti është i përbërë nga tri persona? Ata i quajti qafirë.

Një tjetër kuptim që nuk duhet përdorur, është *"uahid"* si lloj, për shembull, nëse themi se filan person është një nga njerëzit, kjo gjë nuk mund të përdoret për Zotin, sepse Zoti nuk ka lloj e as gjini. Kuptimi i kësaj fjale është një lloj krahasimi. Zoti është i pastër prej çdo lloj krahasimi.

Por nëse do të themi dy kuptimet e sakta, ato janë: e para, kur themi Zoti Një, do të thotë se në këtë botë nuk ka të ngjashëm me të. Po, Zoti ynë është i tillë.

Tjetra, nëse themi Zoti ynë është tek, në gjithçka, do të thotë se Qenia e Tij nuk mund të ndahet as në pikëpamje të jashtme e as në intelekt. Po, Zoti ynë është i Madh.

Me pak fjalë, kur themi që Zoti është *"Ehad dhe Uahid"* Një dhe tek, nuk ka kuptimin një si numër apo lloj dhe gjini, por ka kuptimin një si qenie. Me fjalë më të qarta, Njëshmëria e Tij ka kuptimin e mohimit të ekzistencës së shembullit apo ngjashmërisë së Tij.

Arsyeja e këtij fjalimi është e qartë. Ai është Qenie e Pafundme nga çdo pikëpamje, prandaj është e sigurt që nuk mund të përshkruhen dy qenie të pafundme, sepse, nëse do ta bënim, që

të dyja do të ishin të kufizuara dhe nuk do të kishin përsosmërinë e asnjërit.

Në ajetin tjetër do të shikojmë se si përshkruhet një tjetër cilësi e Qenies së Shenjtë: **"All'llahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim."**.

Për fjalën *"samedun"* janë cituar shumë kuptime nga komentuesit dhe fjalorshkruesit, si dhe janë cituar shumë hadithe.

Ragibi, në librin e tij "Mufredat" thotë se fjala *"samed"* do të thotë *"zotëria te i cili mbështetesh për diçka"*, pra, i drejtohesh atij.

Të tjerë janë të mendimit se fjala *"samed"* tregon diçka që nuk është bosh nga brenda, por e mbushur.

Në fjalorin "Mekajis el lugat" thuhet se fjala *"samed"* ka dy rrënjë: një me kuptimin: *qëllim* dhe tjetra me kuptimin: *qëndrueshmëri*.

Kur Zotit i thuhet *"Samed"*, është për shkak se robtë e Tij i drejtohen Atij me lutje dhe kërkesa.

Ndoshta për këtë shkak, librat e fjalorit e kanë trajtuar në mënyra të ndryshme kuptimin e fjalës "Samed" si:

I madh që është në kulmin e madhështisë.

Dhe ai të cilit njerëzit i drejtohen për nevojat e tyre.

Ai që nuk është asgjë më superior se ai.

Dhe ai që është i përhershëm dhe mbetet pas shkatërrimit të njerëzve.

Për këtë arsye Imam Hysejni *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për fjalën *"samed"* ka cituar pesë kuptime:

Së pari, *"samed"* i thuhet një personi që është zotëri.

Së dyti, *"samed"* është qenie që është vazhdimisht e përjetshme dhe e përhershme.

Së treti, *"samed"* është ekzistencë që nuk ka shoq.

Së katërti, *"samed"* është ai që nuk ha e nuk pi.

Së pesti, *"samed"* është ai që nuk fle.[1]

Në një tjetër tekst, thuhet se *"samed"* është ai që është i qëndrueshëm dhe jo nevojtar.

"Samed" është ai që nuk ka ndryshime, nuk dhunon.

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është transmetuar: *"'Samed' është ai që nuk ka ortak, nuk e ka problem ta ruajë atë që ka, nuk i fshihet asgjë."*.[2]

Disa janë të mendimit se *"samed"* është ai që, çdoherë që dëshiron diçka, i thotë, bëhu dhe bëhet.

Në një hadith tjetër thuhet se disa njerëz nga Basra i shkruan Imam Hysejnit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe e pyetën për kuptimin

[1] "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 2223.
[2] Po aty.

e fjalës "*samed*". Imami iu përgjigj: "*Fjala 'samed' është komentuar nga Kur'ani, në ajetet e mëposhtme:* 'Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!'".

Po, "*samed*" është Ai që nuk ka ardhur në këtë botë nga ndonjë gjë, nuk ekziston te ndonjë gjë, nuk është i vendosur te ndonjë gjë. Është Krijues i gjithçkaje. Gjithçka ka ardhur si pasojë e fuqisë së Tij, atë çka e ka krijuar që të vdesë, bëhet me vullnetin e Tij. Ajo çka është krijuar që të mbetet, do të qëndrojë. Ky, pra, është Zoti".[1]

Në një hadith tjetër lexojmë se Muhammed ibn Hanefijeh e pyeti Prijësin e besimtarëve, Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për kuptimin e fjalës "*samed*". Ai tha: "*Nuk është as emër e as trup, nuk ka si Ai e as të ngjashëm me Të, nuk ka pamje dhe nuk ka të ngjashëm, nuk ka masë, as kufizim, nuk ka vend, as qëndrim, nuk ka cilësi, nuk është as këtu e as aty, nuk është bosh e as i mbushur, nuk qëndron në këmbë e as ulur, nuk ka vend e as ngjyrë, nuk ka vendosur kufizim në zemrën e njeriut, nuk ka as aromë, të gjitha këto nuk ekzistojnë në Qenien e Pastër të Tij.*".[2]

Ky hadith tregon më së miri se fjala "*samed*" ka një kuptim shumë të gjerë, ku mohon çfarëdolloj cilësie të përbashkët me krijesat, për shkak se emrat e përcaktuar dhe të kufizuar, si: trupi, ngjyra, vendi, lëvizja, cilësia dhe të tjera si këto, janë ndër cilësitë dhe mundësitë e krijesave. Por ndonjëherë është cilësi e botës materiale dhe ne e dimë se Zoti është më lart dhe më i madhëruar prej këtyre.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 565.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 230, Hadithi 21.

Në studimet e fundit, të bëra nga të gjitha mjetet materiale, duke nisur që nga atomi dhe përbërësit e tij, si dhe elektronet që vërtiten rreth tij, është zbuluar se midis tyre ekziston një largësi e madhe (duke e krahasuar me atomin) në mënyrë të tillë që, nëse hiqet kjo largësi, mjetet do të duken kaq të vogla, sa për ne do të jetë shumë e mahnitshme dhe e habitshme.

Për shembull. Nëse largësia e atomit do të largonte pjesët e ekzistencës së një njeriu dhe atë ta shtypë plotësisht, ai mund të transformohet sa një grimcë, e cila është e vështirë të shikohet me sy, por megjithatë, e gjithë pesha e trupit të një njeriu e ka atë (për shembull kjo pjesë sa një grimcë peshon 60 kg).

Disa, duke u bazuar në kërkimet shkencore, janë të mendimit se një nga kuptimet e fjalës *"samed"* është ekzistenca që nuk është bosh. Këtë përfundim e kanë arritur duke u bazuar në Kur'an, sepse Kur'ani mohon çfarëdolloj trupi apo forme të Zotit, sepse të gjithë trupat janë të përbërë nga atomi dhe atomi është bosh. Kështu, ky ajet mund të konsiderohet si një prej mrekullive shkencore të Kur'anit.

Por nuk mund të harrojmë se fjala *"samed"*, në origjinë, ka kuptimin: *zotëria i madh, që të gjithë nevojtarët shkojnë pas tij dhe nga çdo aspekt është i mbushur dhe i plotësuar*. Të gjitha kuptimet dhe komentimet e tjera që u cituan për fjalën *"samed"*, kthehen te kjo rrënjë.

Ndërsa në ajetin tjetër kundërshtohet besimi i të krishterëve, jehudive dhe i jobesimtarëve arabë, të parët i bënë Zotit shirk, duke thënë se Zoti ka fëmijë, është baba etj... All'llahu në këtë ajet thotë: **"Ai as nuk lind, as nuk është i lindur."**.

Përballë gjendet fjala e atyre që besojnë në trinitet: Zoti baba, Zoti djalë, si dhe shpirti i shenjtë. Jehuditët thonë se Uzejri është djali i Zotit: **"Hebrenjtë thonë se Uzejri është i biri i All'llahut. Të krishterët thonë se Mesihu është i biri i All'llahut. Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e jobesimtarëve të mëparshëm. I vraftë All'llahu! Si po shmangen** (nga e vërteta)**?!"**[1]

Edhe jobesimtarët arabë besonin se engjëjt janë vajzat e Zotit!

Idhujtarët i shohin xhindet si ortakë të All'llahut, ndërkohë që Ai i ka krijuar ata. Me padituri, i kanë veshur Zotit djem e vajza. I lavdëruar dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia veshin ata, qoftë Zoti!

Prej disa transmetimeve kuptohet se fjala *"lindje"*, në ajetin: **"Ai as nuk lind, as nuk është i lindur."**, ka kuptim të gjerë, po ashtu çfarëdolloj dalje e gjërave materiale dhe e gjërave të buta, ose dalja e tyre prej Qenies së Shenjtë, si të jenë materiale, si të jenë të buta, ato i mohon.

Për ta qartësuar më tepër se çfarë janë gjërat materiale dhe ato të buta, do t'i hedhim një sy letrës që Imam Hyseni *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u shkroi njerëzve të Basrës, për komentimin e fjalës *"samed"*. Midis të tjerash thotë se *"Lem Jelid"* ka kuptimin: prej atij nuk del asgjë jashtë, qofshin këto gjëra materiale, sikurse është fëmija dhe gjëra të tjera që dalin prej krijesave (sikurse është qumështi që del nga gjoksi i nënës) dhe as gjëra të buta, sikurse është shpirti, apo të tjera, sikurse është: gjumi, imagjinata, trishtimi, gëzimi, e qeshura, të qarit, frika, uria, ngopja etj. Zoti është shumë e shumë herë më i mirë nga këto, që prej tij të dalë gjë.

[1] Sure Teube, ajeti 30.

Gjithashtu, është shumë më i mirë, saqë prej tij të lindë gjë, qofshin ato materiale apo jo materiale, sikurse dalja e një qenie të gjallë prej një qenie tjetër, apo sikurse del bima nga toka dhe uji nga burimi, fryti nga pema. Apo të dalin gjërat e buta prej burimit të tij, sikurse të shikosh prej syve, të dëgjosh me veshë, të marrësh frymë me hundë, të provosh shijet me gojë, të flasësh me gjuhë, të kesh njohuri dhe të përcaktosh nëpërmjet të perceptuarit të zemrës.[1]

Në përputhje me këtë hadith, fjala *"lindje"* ka kuptim shumë të gjerë, që përfshin çfarëdolloj dalje dhe çdo gjë që del nga një gjë tjetër. Në të vërtetë, ky është kuptimi i dytë i ajetit, sepse kuptimi i parë ishte i qartë, sikurse e thamë në fillim. Duke bashkuar edhe kuptimin e dytë dhe duke bërë një analizë mbi kuptimin e parë, e gjitha kjo është plotësisht e kuptueshme, sepse, nëse Zoti nuk ka fëmijë, është sepse nuk ka asnjë lidhje me ndikimet e jashtme. Ky kuptim është i drejtë edhe për ndikimet e tjera materiale.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, flitet për cilësitë e arritjes së përsosmërisë: **"Dhe askush nuk është i barabartë** (a i krahasueshëm) **me Atë!"**.

Fjala *"kufu"*, në origjinal, ka kuptimin: *barazi në pozitë dhe në fuqi*.

Më pas në këtë fjalë u përfshi çfarëdolloj ngjashmërie.

Në përputhje me këtë ajet, të gjitha ngjashmëritë e krijesave dhe cilësitë e tyre apo çfarëdolloj mangësie dhe kufizimi prej Qenies së Pastër të Tij është e mohueshme. Ky, pra, është ai Teuhidi

[1] "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 224.

i cilësive, përballë Teuhidit numëror dhe llojit që e cituam në fillim të komentimit të kësaj sureje.

Duke u mbështetur në këtë, ai as nuk ka ngjashmëri në qenie e as të ngjashëm në cilësi e as në vepra apo çfarëdolloj tjetër, nga të gjitha është i paarritshëm dhe i pakrahasueshëm.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në një prej fjalimeve në "Nehxhul Belaga", thotë: "*Ai nuk ka lindur kënd, që të jetë edhe Vetë i lindur. Nuk është i lindur prej askujt, që të jetë i kufizuar. Nuk ka të ngjashëm me Të, që të krahasohet me kënd. Nuk mund të imagjinohet asgjë apo të ketë ngjashmëri me gjë apo të jetë i barabartë me kënd.*".[1]

Ky koment është i mahnitshëm, që tregon në mënyrë të përsosur Teuhidin.

Hulumtime

1- Arsyetimet e Teuhidit

Teuhid do të thotë Njëshmëri e Qenies së Zotit, si dhe mos ekzistenca e asnjë homologu të ngjashëm për të, duke lënë pas arsyetimet e transmetuara apo ajetet e Kur'anit të Shenjtë. Vetëm me arsyetim të mendjes është e vërtetueshme Njëshmëria e Zotit. Në këtë rast do të sjellim një pjesë të argumenteve.

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 186.

a - Argumenti i ekzistencës

Zoti është Qenie Absolute, nuk ka asnjë kusht apo kufizim për Të, sigurisht që një Qenie e tillë është e pakufizuar, sepse, nëse do të ishte e kufizuar, do të përfshihej te mohimi, ndërkohë që i gjithë universi dhe ekzistenca vjen prej Tij dhe kështu s'ka si të mohohet, të mos jetë. Po ashtu, nuk ekziston gjë jashtë, që atë ta mohojë. Duke u bazuar në këtë, nuk është i kufizuar nga asgjë.

Nga ana tjetër, dy ekzistenca të pakufizuara në botë nuk mund të imagjinohen, sepse, nëse do të gjendeshin dy krijesa, patjetër që secila do të ishte e përbërë prej cilësive të ndryshme, që do të thotë përsosmëri dhe cilësi, të cilat nuk do t'i kishte tjetra, kështu që do të ishin të kufizuara. Vetë kjo është një argument i qartë sa i përket Njëshmërisë dhe të qenit i domosdoshëm në thelbin përkatës.

b - Argumenti i dytë

Kur hedhim sytë te kjo botë e gjerë, në fillim e shikojmë këtë botë si një botë të trazuar, jo të rregullt, toka, qielli, dielli dhe hëna, yjësia dhe llojet e ndryshme të bimëve dhe të kafshëve. Sa më shumë të shikojmë me vëmendje, do të vërejmë pjesë të vogla të kësaj bote, të cilat janë të lidhura me njëra–tjetrën, që formojnë një pjesë, të cilat, sipas një sërë ligjesh të përcaktuara, udhëzojnë të gjithë botën. Sa më shumë të zhvillohet bota dhe sa më shumë të ecë dija përpara, do të shikohet dhe do të qartësohet edhe më shumë uniteti i gjërave të kësaj bote, saqë ndonjëherë, kur bëhet ndonjë analizë mbi ndonjë lloj gjëje, sikurse është rënia e mollës nga pema, bëhet shkak që të zbulohet një ligj që do të udhëheqë në

të gjithë botën e ekzistencës. Apo sikurse është edhe çështja e Njutonit dhe Ligji i tërheqjes. Ky unitet i rregullit të botës dhe ligjet që udhëzojnë mbi të, janë të njëjta midis gjërave, duke treguar se krijuesi është një.

c - Argumenti shkencoro-filozofik

Një tjetër argument që thamë për vërtetimin e Njëshmërisë së Zotit, është ajeti 22 i sures "El Enbijâ": **"Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç All'llahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar All'llahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!"**.

Shpjegimin e këtij argumenti e kemi dhënë në vëllimin 13, në faqen 381.

ç - Thirrja e përgjithshme e të gjithë të Dërguarve në Zotin Një

Edhe ky është një arsyetim tjetër, për të vërtetuar Njëshmërinë, sepse, nëse do të ekzistonin në këtë botë dy qenie të detyrueshme *(dy zota)*, që të dy duhet të kishin burim hiri, për shkak se një qenie e pakufishme nuk mund të jetë dorështrënguar në përhapjen e dritës, sepse, nëse nuk do të kishte hir, do ta konsideroje si mangësi për të. Dhe të jesh, atëherë kërkon që të gjithë t'i përfshijë në hirin e tij.

Ky hir ka dy degë: Hiri gjenetik (në botën e udhëzimit). Duke u bazuar në këtë, nëse Zotat e ndryshëm do të ekzistonin,

atëherë të Dërguarit duhet të vinin nga të gjithë ata dhe hiri legjislativ të arrijë tek ata të gjithë.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* në testamentin që lë për djalin e tij të nderuar, Imam Hasan Muxhtebanë *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, thotë: *"Dije o biri im! Nëse Zoti do të kishte homolog, të Dërguarit e Tij do të vinin pranë teje dhe do t'i kishe parë ndikimet e pushtetit dhe të udhëheqjes së tyre. Gjithashtu, edhe me veprat dhe cilësitë e tyre do të ishe njohur. Por Ai është Një, i Vetëm, Tek, i Adhuruar, ashtu sikurse e përshkruan Veten e Tij."*.[1]

Të gjitha këto janë argumente për Njëshmërinë e Tij, argumente për mos ekzistencën e çfarëdolloj përbërje apo pjese në Qenien e Tij të Pastër. Të gjitha këto janë të qarta, sepse, nëse për Të do të ekzistonin pjesë të jashtme, sigurisht që do të ishte nevojtar për to, po ashtu do kishte nevojë për një Zot tjetër, të paarsyeshëm, atëherë do të ishte i kufizuar, ndërkohë që e dimë se Qenia e Tij është e pakufizuar dhe nuk është e përbërë nga asnjë lloj natyre. Një gjë që nuk është e përbërë prej natyre, nuk ka as lloj, as stinë.

Nëse "përbërësit e arsyes" (do të ishin të përbërë nga natyra dhe qenia apo nga lloji), do të ishin të tillë, kjo do të ishte e pamundur, sepse përbërja (nga natyra dhe qenia) do të ishte e kufizuar. Ndërkohë që ne e dimë se Qenia e Tij është e pakufizuar dhe nuk është i përbërë as nga natyra e as nga lloji. Një gjë që nuk ka natyrë, nuk ka as lloj.

[1] "Nehxhul Belaga", testamenit për Imam Hasanin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, Letra 31.

2- Njohjet e Njëshmërisë

Zakonisht, për njohjen e Njëshmërisë, janë cituar katër njohje:

a - Njëshmëria e Qenies (Ajo çka u shpjegua më lart).

b – Njëshmëria e cilësive, që do të thotë se cilësitë e Tij nuk janë të ndara nga Qenia e Tij dhe nuk ndahen prej njëra-tjetrës, për shembull, dija dhe fuqia jonë janë dy përshkrime që janë të bashkangjitura në qenien tonë. Qenia jonë është diçka dhe dija e fuqia jonë është një tjetër gjë. Ashtu sikurse Dija dhe Fuqia është e ndarë te ne, po ashtu edhe qendra e dijes te ne është shpirti ynë, ndërsa qendra e fuqisë sonë është trupi dhe pjesët e trupit tonë.

Por te Zoti, as cilësitë nuk janë të ngjitura te Qenia e Tij e as nuk janë të ndara nga njëra-tjetra, por është ekzistencë, që e gjithë dija, fuqia, pafundësia dhe përjetësia nuk janë të ndara.

Nëse do të ishte ndryshe, atëherë do të ishte i përbërë dhe, nëse do të ishte i përbërë, do të kishte nevojë për pjesë. Një gjë që është nevojtare, nuk mund të quhet vetekzistuese (Zot).

c - Njëshmëria e të vepruarit

Çdo ekzistencë, çdo lëvizje dhe çdo veprim në univers kthehet te Qenia e Pastër e Zotit. Ai është shkaku i shkaqeve dhe shkaku kryesor.

Gjithashtu, veprimet që ne kryejmë, në një kuptim, janë prej tij, Ai na fal ne forcë dhe na jep ne liri e vullnet. Duke u bazuar në këtë, në të njëjtën kohë që ne jemi vepruesi i veprës sonë, përballë saj jemi përgjegjës. Nga një anë vepruesi është Zoti, sepse të gjitha çka ne kemi, rikthehen tek Ai.

d – Njëshmëria në adhurim

Njëshmëri në adhurim do të thotë që duhet të adhurojmë vetëm Atë. Askush tjetër nuk është i denjë për t'u adhuruar, për shkak se i adhuruar duhet të jetë ai që i ka të gjitha përsosmëritë absolute dhe është përsosmëri absolute. Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe është falësi i të gjitha mirësive dhe krijuesi i të gjitha krijesave. Këto cilësi nuk mund të përmblidhen askund, përveç se në Qenien e Pastër të Tij.

Qëllimi kryesor i adhurimit është të gjesh në rrugën e afrimit te përsosmëria absolute dhe gjithësia e pafundme, si dhe të reflektosh ndaj cilësive të përsosmërisë. Ato janë në thellësinë e shpirtit. Përfundimi është largimi nga cytjet dhe kthimi drejt vetëedukimit të egos. Ky qëllim nuk mund të arrihet vetëm se me adhurim të All'llahut, që është përsosmëria absolute.

3 – Njohja e njëshmërisë së veprave

Njëshmëria e veprave zë një vend të rëndësishëm. Në këtë rast do të citojmë gjashtë prej pjesëve të saj:

a – Njëshmëria e Krijimit

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **"Thuaj Zoti është krijuesi i gjithçkaje"** (sure "Er Rrad", ajeti 16).

Arsyetimi është i qartë, kur themi se me argumentet dhe arsyetimet e kaluara, është vërtetuar se Vetë Ekzistuesi (Zoti) është Një, edhe të gjitha gjërat e tjera përveç Tij, janë të mundshme. Duke u bazuar në këtë, krijuesi i gjithçkaje do të jetë një.

b - Njëshmëria e zotërimit

Drejtuesi dhe udhëheqësi i universit është vetëm Zoti. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **"A po kërkon një tjetër Zot, ndërkohë që Ai është Zoti i gjithçkaje?!"** (sure "El Enam", ajeti 164).

Argument për këtë është uniteti i domosdoshëm dhe Njëshmërija e Krijuesit të universit.

c – Njëshmëria, vendosja e ligjit dhe ligji

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **"Çdokush që nuk merr vendim për atë çka Zoti ka zbritur, është jobesimtar."** (sure "El Maide", ajeti 44).

Kur ne vërtetuam se udhëheqësi dhe drejtuesi është vetë Zoti, bëhet e qartë se ligjvënësi nuk mund të jetë ndokush tjetër përveç Tij, pra, askush nuk e ka këtë kompetencë, sepse askush nuk është pronar me të, që edhe ai tjetri të vendosë ligje.

ç - Njëshmëri në pronësi

"Pronar i vërtetë" do të thotë pushtet mbi një gjë apo "Pronar i vërtetë", do të thotë ligji mbi një gjë, të gjitha këto janë prej Zotit. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **"Pushteti dhe pronësia e qiejve dhe tokës është posaçërisht për Zotin."**.[1]

Dhe: **"Falni prej mallrave që Zoti ju ka caktuar si udhëheqës ndaj tyre."** (sure "Hadid", ajeti 7).

Një tjetër arsye është vetënjëshmëria në krijim, kur gjithçka është e Krijuesit, sigurisht që edhe pronari i të gjithë gjërave është Qenia e Shenjtë e Tij. Duke u bazuar në këtë, çdo pronësi merr burim nga pronësia e Tij.

d - Njëshmëria e udhëheqjes

Myslimanët kanë nevojë për udhëheqje, sepse nuk është e mundur të jetohet në bashkësi dhe të mos ketë një udhëheqës, ndarja e përgjegjësive, koordinimi i programeve, zbatimi i detyrave, paraprita e dhunës etj. Të gjitha këto, nuk mund të kryhen pa pasur një udhëheqës.

Nga një anë, thuhet se liria e njeriut është e tillë, që asnjë person ndaj një personi tjetër nuk ka të drejtën e udhëheqjes, vetëm nëse pronari kryesor dhe pronari i vërtetë të japë leje. Nga këtu ne bazohemi se çfarëdolloj pushteti që nuk ka lidhje me pushtetin hyjnor, nuk e pranojmë.

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 189.

Gjithashtu, nga këtu ne mësojmë se duhet t'i bindemi pushteti të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe pas tij, Imamëve të pastër *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* e pas tyre, për juristët e shoqërisë vendosen kushte.

Sigurisht që mund të jetë edhe kjo e mundur, që një pjesë e njerëzve të japin leje, që dikush t'i udhëheqë, por, nëse nuk e pranojnë të gjithë, një pushtet i tillë është i pamundur.

Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë se uniteti i sundimit është i lidhur me botën e krijimit, ndërsa uniteti i ligjvënies dhe i pushtetit është i lidhur me botën e ligjvënies. Kur'ani i Shenjtë thotë: **"Ligji dhe pushteti është vetëm prej Zotit."** (sure "El Enam", ajeti 57).

dh - Njëshmëria e bindjes

I vetmi që duhet t'i bindemi është Zoti, ligji i bindjes ndaj çdokujt tjetër duhet të merret nga ky burim, që do të thotë bindja ndaj tij është bindje ndaj Zotit.

Arsyeja e saj është e qartë, kur udhëheqja është posaçërisht për të. Ne, bindjen ndaj Profetëve, Imamëve të pastër dhe zëvendësve të tyre e konsiderojmë si rreze prej bindjes së Zotit.

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet **"O besimtarë! Bindjuni All'llahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni All'llahut dhe të Dërguarit, nëse besoni All'llahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur."** (sure "En Nisâ", ajeti 59).

Dhe: **"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur All'llahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre."** (sure "En Nisâ", ajeti 80).

Sigurisht që pjesa e mësipërme kërkon, për secilën, komentim të shumtë, por për të mos u larguar nga mënyra e komentimit, nuk do të dalim jashtë teme, për këtë arsye e kemi shpjeguar në mënyrë të përmbledhur.

O All'llah! Na mbaj të qëndrueshëm dhe në drejtimin e Teuhidit në të gjithë veprat dhe punët tona.

O All'llah! Degët e shirkut, ashtu edhe sikurse degët e Teuhidit janë të shumta, shpëtimi nga shirku nuk mund të arrihet vetëm se me mëshirën dhe dëshirën Tënde. Na përfshi në mëshirën dhe mirësinë Tënde!

O All'llah! Na mbaj të gjallë me Teuhid dhe na merr nga kjo botë me Teuhid!

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Ihlâs".

Sure "El Felek"

Zbritur në Mekë

Ajete 4

Përmbajtja e sures "El Felek"

Një grup komentuesish janë të mendimit se kjo sure ka zbritur në Mekë. Një grup tjetër janë të mendimit se kjo sure ka zbritur në Medine.

Përmbajtja e kësaj sureje të mëson se si Zoti i Madhëruar e mëson të Dërguarin e Tij dhe myslimanët e tjerë se si të mbështeten tek Ai nga sherri i gjithë sherrxhinjve e të jenë të sigurt.

Në hadithe thuhet se shkaku i zbritjes së kësaj sureje është: Disa jehudi i bënë magji Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai u sëmur. Xhibraili u shfaq dhe i tregoi vendin ku ata kishin fshehur magjinë, brenda një pusi. E nxori jashtë atë dhe i lexoi këtë sure. Më pas gjendja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përmirësua.

Tabrasij dhe disa komentues të tjerë, një transmetim të tillë, prej dy personave, Ibn Abasit dhe Aishes, nuk e pranojnë, sepse, së pari, surja "Felek" është e njohur si mekase dhe ka edhe melodi mekase, ndërkohë që problemet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me jehuditët ishin në Medine, ndaj edhe ky hadith nuk pranohet.

Nga ana tjetër, nëse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të binte preh e magjive, që të sëmurej e të mos ngrihej nga shtrati kaq lehtë, atëherë ata mund ta ndalonin të kryente qëllimin e tij. Sigurisht Zoti që e përzgjodhi për një detyrë kaq të madhe, do ta ruante nga

ndikimi i magjisë, që të mos vinin dorë mbi pozitën e lartë të Profetësisë.

Nga ana tjetër, nëse magjia do të ngjiste kaq shpejt te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, njerëzit mund të keqkuptoheshin, duke thënë se magjia ndikon në shpirtin e tij.

Gjithashtu, punët e tij mund të jenë bërë nën ndikim të magjive të magjistarëve. Kjo gjë do të bënte që njerëzit të humbnin besimin te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Shpallja e tij. Ndaj edhe Kur'ani i Shenjtë u përgjigjet atyre që e akuzuan Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se është i magjepsur nga magjia dhe thotë: **"Të padrejtët thonë: "Ju ndiqni vetëm një njeri të magjepsur"!" "Shiko çfarë shembujsh të sjellin e ata (me këtë) kanë humbur e nuk mund të gjejnë rrugën e vërtetë."**[1]

Sidoqoftë, ne nuk mund ta pranojmë një transmetim të dyshuar, sepse vë në pikëpyetje pozitën e Profetësisë.

[1] Sure El Furkan, ajetet 8-9.

Mirësitë e leximit të sures "El Felek"

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Më kanë zbritur ajete që nuk kanë zbritur si ato. Këto janë surja 'El Felek' dhe 'En Nas'."*.[1]

Në një hadith të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë se ai që lexon suren "El Felek" dhe "En Nas" në namazet e vitrit, atij i thuhet: *"O rob i Zotit, ty do të gëzojmë me një myzhde, Zoti ta ka pranuar namazin e vitrit."*.[2]

Transmetohet nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se i ka thënë njërit prej shokëve të tij: *A dëshiron që të t'i mësoj dy suret, të cilat janë më të mirat e Kur'anit? Ai tha: Po o I dërguar I Allahut! Profeti I mësoi atij suren Felek dhe suren Nas.*Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *Lexoi në namazin e mëngjesit dhe më pas i tha: lexoi këto dy sure sa herë që ngrihej dhe sa herë që shtrihej për të fjetur.*[3]

Është e qartë se ndikimi i saj është për ata që shpirtin, besimin dhe veprën e tyre e kombinojnë me përmbajtjen e kësaj sureje.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 716 dhe tefsiri Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 567.
[2] Po aty.
[3] Po aty.

Ajetet 1 – 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ١ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ٢ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ٣ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ٤ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ٥﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit.'"

"Që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar."

"Dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri."

"Dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)**."**

"Dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."

Komentimi

Te Zoti i agimit mështetem

Në ajetin e parë dhe të dytë i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si një udhëheqës dhe shembull, duke e urdhëruar: "**Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit, që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar."**.

Fjala *"felek"* ka kuptimin: *të thyesh një gjë dhe të ndash disa prej të tjerëve*. Kur zbardh mëngjesi, nata thyhet. Kjo fjalë ka ardhur edhe me kuptimin e lindjes së agimit. Edhe në suren "El Fexhr" është përdorur me këtë kuptim.

Komentues të tjerë e kanë marrë atë me kuptimin: të gjithë llojet e lindjes dhe të gjithë krijesat e gjalla, si: njerëzit, kafshët dhe bimët, për shkak se lindja e këtyre krijesave bëhet ose duke shpërthyer bima, ose nëpërmjet vezës dhe të ngjashme me këto që cituam.

Por gjëja më e habitshme është stadi i krijimit të tyre. Në kohën e lindjes tek ato ndodh një ndryshim i madh, nga një botë në një tjetër botë.

Në ajetin 95 të sures "El En'âm" lexojmë: **"Me të vërtetë, All'llahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë. Ai e nxjerr të gjallën prej të vdekurës dhe të vdekurën prej të gjallës. Ky është All'llahu. Atëherë, përse i largoheni Atij?"**.

Disa komentues, kuptimin e fjalës *"felek"* e kanë marrë me kuptim më të gjerë dhe e kanë konsideruar një, për të gjitha llojet e krijimit, sepse me krijimin e çdo krijese mbulesa dhe perdja e njeriut thyhet dhe drita e ekzistencës qartësohet.

Secili kuptim (lindja e agimit, lindja e krijesave, krijimi i çdo krijese) janë ndodhi shumë të habitshme, të cilat janë një arsye e madhe, që Zoti është krijuesi dhe drejtuesi i tyre. Përshkrimi i Zotit për këto cilësi është shumë i thellë.

Në disa hadithe është cituar se fjala *"felek"* është *pus ose burg në Xhehennem*, që e tregon veten e tij në zemër të Xhehennemit. Ky hadith mundet të citojë një cilësi të tij dhe nuk ka për qëllim ta kufizojë kuptimin e fjalës *"felek"*.

Kuptimi i ajetit: **"Të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar"**, nuk është se krijimi Hyjnor në vetëvete ka sherr, sepse krijimi ka kuptimin e gjetjes e sjelljes në ekzistencë dhe sjellja në ekzistencë përfshin vetëm mirësisë. Kur'ani i Shenjtë, ajetin 7 të sures "Es Sexhde", thotë: **"Ka përsosur çdo gjë që ka krijuar..."**.

Sherri vjen kur krijesat të jenë larguar nga rruga e përcaktuar e Zotit. Për shembull, te kafshët ka vendosur dhëmbët, ose pickimin, që të mbrohen nga armiqtë, ashtu sikurse ne përdorim armë kundër armikut. Nëse kjo armë do të përdoret për ndonjë çështje të mirë, atëherë nuk konsiderohet sherr, por, nëse do ta përdorim pa vend dhe në dëm të mikut, atëherë do të konsiderohet sherr.

Shumë gjëra, në pamje të jashtme, konsiderohen sherr, por brenda tyre janë për mirë, sikurse janë ngjarjet që na

paralajmërojnë, na zgjojnë nga gjumi. Të gjitha këto sigurisht që nuk konsiderohen për keq, sherr.

Më tej shpjegon dhe komenton se duhet të mbështeten te Zoti, prej çdo lloj sherri: **"Dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri."**.

Fjala *"gasikun"* vjen nga rrënja e fjalës *"el gaseku"* dhe, sipas Ragibit, në librin "Mufredat", ka kuptimin: *errësirë e plotë e natës*. Kur'ani i Shenjtë, kur citon fundin e kohës së mbarimit të akshamit, thotë: **"ila gasaki lejli."**.

Në disa fjalorë, fjala *"gesek"* ka kuptimin: errësirë e natës, në mesnatë. Një prej kuptimeve të saj është edhe *sulm,* prandaj është përdorur edhe me këtë kuptim.

Sipas këtij kuptimi, fjala *"gasekun"*, në ajetin për të cilin po flasim, ose është "person sulmues", ose "çdo lloj krijese që sjell sherr", që përfiton nga errësira e natës për të sulmuar, prandaj jo vetëm kafshët e egra dalin natën nga strofka e tyre dhe sjellin ligësi, por edhe persona jo të pastër dhe sherrxhinj e përdorin natën për qëllime jo të mira.

Fjala *"uekab"* vjen nga rrënja e fjalës *"el uekbu"* dhe ka kuptimin *"groë"*, pra, vepra e tij është me kuptimin *të hysh në gropë*, për shkak se krijesat që sjellin sherr, përfitojnë prej errësirës dhe duke krijuar zgavra mund të arrijnë edhe më shpejt qëllimin e tyre. Ose mund të ketë kuptimin: *të kesh ndikim*.

Më pas shton: **"Dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje** (duke bërë magji)**."**.

Fjala *"en nef'fath'that"* vjen nga rrënja e fjalës *"en nefethe"*. Në origjinal ka kuptimin: *të nxjerrës apo të derdhësh pak ujë nga uji i gojës (ose pështyma) me fryrje*.

Nga ana tjetër, kjo punë kryhet duke nxituar. Fjala *"nefeth"* ka kuptimin *"nefekh"* – *"të frysh"*.

Por shumë komentues, fjalën *"nef'fath'that"* e kanë komentuar me kuptimin: *gratë magjistare*.

Fjala *"nef'fath'that"* është shumësi i fjalës *"nefeth"*. Njëjësi i saj është *"nefathe"*. Ata lexojnë diçka dhe u fryjnë nyjeve, kështu, në këtë mënyrë, ata bëjnë magji.

Një grup tjetër komentuesish thonë se bëhet fjalë për disa gra që kanë vesvese që vazhdimisht u thonë bashkëshortëve të tyre diçka, që i bën ata të jenë të dobët në kryerjen e punëve pozitive. Të tilla gra, për gjatë gjithë historisë, kanë sjellë shumë dëme, jo vetëm duke dobësuar pushtete, por edhe duke sjellë sherre e luftëra.

Fakhru Rrazij, në komentimin e tij, thotë se gratë, për shkak se ndikojnë shumë në zemrat e burrave, përfitojnë prej tyre.[1]

Ky kuptim, në kohën dhe epokën tonë, është tepër i qartë dhe qartësohet dita-ditës edhe më shumë. Një nga ndikimet më të rëndësishme të shoqërisë, janë spiunët që përdoren nga politikanët dhe ato janë gra. Ata, me fjalinë **"Që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar."**, hapin kutitë e sekretareve dhe njihen

[1] Tefsiri i Fakhru Rrazij, vëll. 32, f. 196.

me sekretet më të rëndësishme, duke e vendosur atë në shërbim të armikut.

Të tjerë, janë të mendimit se fjala "*nef'fath'that*" është dhënë me kuptimin: *njerëzit e ligj, ose grupe që janë me vesvese, të cilët, me propagandën e tyre të vazhdueshme, i dobësojnë lidhjet*.

Nuk është e pamundur që ajeti të ketë kuptim të përgjithshëm dhe shoqëror, që të gjitha këto i përmbledh.

Edhe thashethemexhinjtë dhe lajkaxhinjtë i kanë dobësuar ligjet e dashurisë, duke i shkatërruar ato.

Po sigurisht, nuk ka një mendim të prerë, për sa i përket shkakut të zbritjes, që thamë më lart dhe në ajet nuk ka ndonjë shenjë, që qëllimi të jetë i veçantë për magjistarët.

Edhe sikur ajeti të komentohet në këtë mënyrë, nuk ka arsye apo argument, për sa i përket vërtetësisë së shkakut të zbritjes, por është vetëm arsye se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të kërkojë mbrojtjen nga sherri i magjistarëve, ashtu sikurse edhe ne kërkojmë mbrojtje, që të mos sëmuremi, ndërkohë që jemi shëndetshëm. Një person i shëndetshëm kërkon mbrojtje prej Zotit, që mos të sëmuret me kancer, edhe pse ai nuk është sëmurur kurrë, por mbrojtjen e kërkon.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje thuhet: **"Dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."**.

Ky ajet tregon se smira është një nga cilësitë më të këqija. Kur'ani e ka rreshtuar atë në rreshtin e punëve të kafshëve të egra, të gjarpërinjve helmues dhe të shejtanit, që është vesves dhe cytës.

Hulumtime

1- Burimet më të rëndësishme të sherrit dhe të shthurjes

Në fillim të kësaj sureje Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhërohet të kërkojë mbrojtjen e Zotit prej të gjitha sherreve të të gjitha llojeve të krijesave.

Më tej, në shpjegim të saj, surja flet për tri lloje sherresh, sherri i sulmuesve të natës, të cilët përfitojnë prej errësirës dhe sulmojnë. Nga sherri i vesveselinjve, që me fjalët dhe me propagandën e tyre duan të marrin nga vetja vullnetin, besimin e të tjerëve. Sherri tjetër është smira, e cila vjen nga smirliu.

Nga e gjithë kjo kuptojmë se shumica e sherreve e ka burimin nga këto tri emra që cituam.

2- Përshtatshmëria e ajeteve

Në ajetin e parë të kësaj sureje, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i urdhërohet të mbështet te Zoti i agimit prej të gjitha sherreve të të gjitha krijesave. Përzgjedhja e "Rab'bil Felek", Zoti i agimit, ndoshta është për shkak se krijesat që bëjnë sherr, duan ta mbyllin rrugën e udhëzimit, ndërkohë që Zoti është thyesi i errësirës. Ai sjell agimin dhe dritën.

3- Ndikimi i magjisë

Në vëllimin e parë, në komentim të ajeteve 102-103 të sures "El Bekare", kemi folur gjerë e gjatë për vërtetësinë e magjisë në kohët e kaluara dhe në ditët e sotme, gjithashtu, kemi folur edhe për magjinë, sipas mendimit të fesë islame.

Po ashtu kemi folur edhe se si ndikon ajo në jetën e njeriut. Në këto diskutime e kemi pranuar në mënyrë të përgjithshme ndikimin e saj. Por jo në atë mënyrë që e mendojnë personat me besëtytni.

Për të marrë informacion më të zgjeruar, kthehuni në vëllimin e parë, te surja "El Bekare", në ajetet që cituam më lart.

Por është e rëndësishme të citohet se, nëse në ajetet për të cilat folëm, e urdhërojnë Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të mbështetet te All'llahu prej magjisë së magjistarëve apo të ngjashëm me të, kuptimi nuk është i tillë që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte preh e magjisë së tyre, por e drejtë është të thuhet se Profeti Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kërkonte mbështetjen e All'llahut për çdo gjë, që do të thotë se ai ishte i ruajtur nga këto sherre prej Zotit.

Nëse nuk do ishte mëshira e Zotit, edhe ai do të ndikohej nga magjia.

Sikurse e thamë edhe më lart, nuk është e thënë që qëllimi i fjalës *"nef'fath'thati fil uked"* të jenë magjistarët.

4- Sherri i smirliut

Smira është një ligësi prej shejtanit, prej shkaqeve të ndryshme, sikurse është besimi i dobët, koprracia dhe mendja e ngushtë e tij. Gjithashtu, ka edhe kuptimin: kërkesë dhe dëshirë për shtimin e mirësisë nga të tjerët. Smira është burim i shumë gjynaheve të mëdha.

Smira, ashtu sikurse është cilësuar edhe në hadithe, e ha besimin e njeriut, duke e zhdukur fare atë.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: "*Dobësimi i fesë është smira, mendjemadhësia dhe mburrja.*".

Kjo vjen sepse smirliu i ankohet udhëheqjes së Zotit, duke thënë se përse disave u ke falur mirësi dhe i ke përfshirë nën kujdesin Tënd.

Shembullin e kësaj çështje do ta shohim në ajetin 54 të sures "En Nisa": **"A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar All'llahu nga të mirat e Veta? Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si dhe një pushtet të madh."**.

Puna e smirës është aq shumë e keqe, saqë mund të arrijë të fshijë të gjithë mirësitë prej një personi dhe ta shndërrojë ujin në zjarr. Shembull i gjallë është historia e njohur e dy vëllezërve.

Për të parë se sa e ligë është smira, është e mjaftueshme t'i hedhim një sy vrasjes së parë që ndodhi midis dy vëllezërve. Kabili vret Habilin nga smira.

Smirliu gjithmonë ka qenë pengesë e rrugës së Profetëve, ndaj edhe Kur'ani i Shenjtë e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të kërkojë mbrojtjen e Zotit prej sherrit të tij.

Edhe pse kjo sure i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sigurish që është një shembull për të gjithë, sepse duhet të mbrohemi nga sherri i smirliut dhe të kërkojmë ndihmën dhe mbrojtjen e Zotit.

O All'llah! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga sherri i smirit, mbështetemi te Qenia Jote e Shenjtë.

O All'llah! Kërkojmë nga Ti të na ruash prej smirës që kemi për të tjerët.

O Zot im! Na ruaj prej sherrit të falltarit dhe atyre që na shtyjnë në vesve.

Amin! Ja Rab'bil Alemin!

Fundi i sures "El Felek".

Sure "En Nâs"

Zbritur në Mekë

Ajete 6

Përmbajtja e sures "En Nâs"

Njeriu është gjithmonë në shënjestër të shejtanit dhe shejtani, xhindet dhe njerëzit përpiqen të ndikojnë në zemrën dhe shpirtin e tij. Sa më shumë të rritet pozita e njeriut në botë, pozita e tij në shoqëri do të jetë edhe më e tepërt. Vesveset dhe cytjet e shejtanit do të jenë edhe më të shumta, që atë ta devijojë nga Rruga e Drejtë dhe botën ta prishë me shthurje e korrupsion.

Kjo sure e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si udhëheqës dhe drejtues i fesë islame, të kërkojë mbrojtje nga sherri i cytësit.

Përmbajtja e sures, nga një anë, është e ngjashme me suren "El Felek". Që të dyja kështillojnë që të mbështetmi tek All'llahu prej sherrit dhe fatkeqësive, me ndryshimin që në suren "El Felek" janë cituar lloje të shumta cytjesh dhe sherresh, ndërsa në këtë sure është folur me tepër mbi sherrin e cytjeve që nuk duken.

Midis komentuesve ka mendime të shumta për vendin e zbritjes së kësaj sureje. Një grup është i mendimit se kjo sure ka zbritur në Mekë. Një grup tjetër është i mendimit se ka zbrit në Medine. Por mënyra dhe melodia e ajeteve është më e afërt me suret mekase.

Duke ditur se kjo sure dhe surja "El Felek", sipas mendimeve të komentuesve është mekase, kjo sure, gjithashtu, mund të jetë mekase.

Mirësitë e leximit të sures "En Nâs"

Janë transmetuar hadithe të shumta për mirësitë e leximit të sures "En Nâs". Po përmendim një hadith: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte sëmurë rëndë. Xhibraili dhe Mikaili i ishin ulur pranë. Njëri i rrinte te koka (Xhibraili), kurse tjetri te këmbët (Mikaili). Xhibraili i këndoi suren "El Felek" dhe kërkoi mbrojtjen e Zotit nëpërmjet saj, ndërsa Mikaili i recitoi suren "En Nas".[1]

Në një transmetim të Imam Bakirit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Kushdo që lexon suren 'El Felek' dhe 'En Nâs' në namazin e vitrit, atij i thuhet: 'O Rob i Zotit! Ty të është pranuar namazi!'*".[2]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 7645; Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 569.
[2] Po aty.

Ajetet 1 - 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ١ مَلِكِ النَّاسِ٢ إِلَهِ النَّاسِ٣ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ٤ الَّذِى يُوَسْوِسُ فِى صُدُورِ النَّاسِ٥ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ٦﴾

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve.'"

"Sundimtari i njerëzve."

"I Adhuruari (i vetëm me të drejtë) **i njerëzve."**

"Nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)**."**

"E që hedh dyshime në gjokset e njerëzve."

" (Qoftë ai djall) **prej xhindeve apo njerëzve!"**

Komentimi

Zotit të njerëzve i kërkoj ndihmë

Në këtë sure, që është edhe surja e fundit e Kur'anit të Shenjtë, flitet për detyrën kryesore të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të ndjekësve të tij: **"Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari** (i vetëm me të drejtë) **i njerëzve.'"**.

Në këto ajete janë cituar tri cilësi prej cilësive të mëdha të All'llahut (Rebubijet, Malekijet, Vehijet) të gjitha këto kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me edukimin e njeriut dhe me shpëtimin e tij prej kthetrave të vesveseve. Sigurisht që qëllimi për mbështetjen dhe mbrojtjen nuk është vetëm ta themi me gojë këtë fjalë, por duhet me mendje, me besim dhe vepër, që ta vendosim veten tonë në mbrojtjen e Zotit.

Të mbështetemi te Zoti, duke u ruajtur prej rrugëve, programeve të shejtanit, punëve dhe propagandës së tij, qëndrimet në vende që shejtani i ka shumë qejf. Veten tonë ta vendosim në rrugën e Mëshiruesit dhe të bëjmë vepra që Ai është i kënaqur me to. Nëse nuk e bëjmë këtë gjë, veten tonë do ta vendosim para një tufani vesvesesh. Largimi nga ky tufan nuk arrihet vetëm me leximin e fjalëve të kësaj sureje, por duhet të kryhen edhe punët që thamë më lart.

Kur themi *"Rab'bi'n Nas"*, ne kemi dëshmuar për sundimin e Zotit dhe veten tonë e kemi vendosur nën edukimin e Tij.

Kur themi *"Maliki'n Nas"*, veten tonë e dimë pronë të Zotit dhe robi i bindet urdhrit të Tij.

Kur themi *"Ilahi'n Nas"*, do të thotë se ecim në Rrugën e Zotit dhe nuk adhurojmë tjetër përveç Tij. Pa dyshim, ai besimtar që ka këto tri cilësi dhe e përshtat vetveten me këto tre cilësi, do të jetë i mbrojtur prej sherrit të vesveselinjve.

Në të vërtetë, këto cilësi janë më të rëndësishmet, për sa i përket edukimit. Janë tri programe, tri mënyra shpëtimi prej sherrit të vesveselinjve dhe njerëzit i siguron prej tyre.

Për këtë shkak, në ajetet e tjera, shtohet: **"Nga sherri i djallit cytës që fshihet** (pasi cyt) **e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,** (qoftë ai djall) **prej xhindeve apo njerëzve!"**.

Fjala *"uesaas"*, sipas Ragibit, në librin e tij "Mufredat", ka kuptimin: zë i qetë i hijshëm, sikurse janë edhe stolitë e grave të hijshme. Por më pas është përdorur me kuptimin përshpëritje për punët dhe mendimet e këqija që rrinë në zemrën e njeriut. Ato ngjajnë me zërin e ulët, që të fishkëllen butë në vesh.

Fjala *"uesaas"* është paskajore. Ndonjëherë vjen edhe me formën e foljes, kryerjes së veprimit. Në ajet ka po këtë kuptim.

Fjala *"khan'nas"* vjen nga rrënja e fjalës *"el khenus"* dhe ka kuptimin: *të mblidhesh dhe të ecësh prapa,* për shkak se shejtanët, kur përmendet Emri i All'llahut, kthehen prapa dhe fshihen. Kjo fjalë ka ardhur edhe me kuptimin: *"ikhtefa"* – *"fshehje"*.

Duke u mbështetur në këtë kuptim, ajetet thonë: "Thuaj, unë kërkoj mbrojtje prej sherrit të cytësit, i cili fshihet prej Emrit të Zotit.".

Në parim, shejtanët, punën dhe programin e tyre, e kryejnë fshehurazi, ndonjëherë ata aq shumë i fryjnë njeriut në vesh, saqë njeriu u beson atyre dhe mendon se mendimi i tyre është i tij. Brena tij, shpirti i vlon. Kjo gjë bëhet shkak që ai të humbasë dhe të ndjekë rrugë të gabuar.

Ndonjëherë, shejtani fshihet dhe nis të mashtrojë me cytjet e tij, duke e larguar prej së vërtetës dhe duke e bërë të vërtetën gënjeshtër dhe mëkatin e fsheh në rrobën e adhurimit. Paudhësinë në rrobën e udhëzimit.

Shkurtimisht, edhe vetë janë të fshehur, edhe punët, edhe programet e tyre janë të fshehura. Kjo për ne është një paralajmërim, që të mos mendojmë se shejtani do të na dalë ne përpara me fytyrën e tij të vërtetë, apo t'i shohim programet e tij. Nuk do jetë kurrë kështu. Ata do të na cytin ne me vesvese dhe punët e tyre janë të mbushura me gënjeshtra, hile dhe dredhi, vetëm e vetëm për të fshehur të vërtetën.

Ata nuk e shfaqin "*fytyrën e tyre të vërtetë*", e përziejnë të vërtetën me të pavërtetën, nuk flasin qartë.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, lidhur me këtë çështje, thotë: "*E vërteta nuk e fsheh Rrugën e Zotit.*".

Ata janë betuar dhe për këtë gjë ankohen e ankohen, saqë një pjesë prej saj ta bëjnë të besueshëm për njerëzit.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për komentimin e ajeteve: **"Nga sherri i djallit cytës që fshihet** (pasi cyt) **e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve."**, thotë se përzgjedhja e fjalës

"uesaas" – *"hedh dyshime"* dhe *"es sudur"* në gjokset e njerëzve, është një tjetër theksim për këtë kuptim.[1]

Nga një anë, të gjitha këto na paralajmërojnë për vesveset e xhindëve dhe njerëzve. Ata nuk janë në mesin e një grupi apo një populli, por janë të shpërndarë ndër njerëz e xhind dhe janë të fshehur te të gjitha rrobat e te të gjithë grupet, ndaj duhet të ruhemi nga të gjithë dhe prej sherrit të tyre të kërkojmë mbrojtjen e Zotit.

Janë të shumtë ata që na shtyjnë në të keqe, miqtë jo të mirë, të devijuar, udhëheqës të devijuar dhe dhunues, punonjës tiranë, shkrimtarë dhe titullarë të shthurur, shkolla, që nga pamja e jashtme të gënjejnë, mjete komunikimi që të çojnë drejt vesveseve, të gjitha këto, në një fjalë, **"vesvas han nas"**, janë ngjitëse dhe njeriu duhet të mbështetet tek All'llahu dhe të kërkojë mbrojtje për të gjitha.

Hulumtime

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 50.

1- Përse kërkojmë mbrojtjen e Zotit?

Për njeriun, në çdo moment ekziston mundësia e devijimit. Në parim, kur Zoti e urdhëron të Dërguarin e Tij, të mbështetet dhe të kërkojë mbrojtje nga Zoti për sherrin e **"vesvasi han nas"**, do të thotë se mundësia e zënies ngushtë e njeriut dhe e futjes në kurthin e **"vesvas han nas"** cytësit që fshihet (pasi cyt) është e mundur.

Edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me mëshirën dhe mirësinë e All'llahut të Madhëruar, si dhe me ndihmën që i vjen prej Tij, në mënyrë të fshehtë, ishte i siguruar, ai i lexonte këto ajete dhe kërkonte mbrojtje prej sherrit të cytësit që fshihet (pasi cyt). Kështu që edhe detyra e të tjerëve është e qartë.

Ne nuk duhet të mbetemi pa shpresë, sepse përballë tyre qëndrojnë engjëjt e qiellit dhe besimtarët e Rrugës së Drejtë asnjëherë nuk janë vetëm. Engjëjt u shfaqen atyre dhe ata i ndihmojnë.

Atyre që thonë se Zoti ynë është All'llahu, e vazhdojnë të vendosur në Rrugën e Drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: **"Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Gëzojuni Xhennetit që ju është premtuar."**[1]

Sidoqoftë, kurrë nuk duhet të jemi mendjemëdhenj dhe ta konsiderojmë veten tonë si jo nevojtar ndaj këshillave dhe ndihmës Hyjnore. Gjithmonë duhet të mbështetemi te Zoti dhe të jemi të zgjuar e të vëmendshëm.

[1] Sure "Fusilet" ajeti 30,

2- Përse përsëritet fjal *"en nas"?*

Disa komentues kanë thënë se në secilin rast ka një kuptim. Por ajo çka vihet re është se fjala është përdorur për të theksuar këto tre cilësi të Krijuesit e që në të tre herët që është përmendur kjo fjalë ka një kuptim të vetëm.

3- Kuptimi i fjalës khannas në hadithe

Në një transmetim të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Zemra e çdo besimtari ka dy veshë, një vesh, ku fryn engjëlli dhe një vesh, ku fryn cytjet e shejtanit (khannas). Zoti e përkrah besimtarin nëpërmjet engjëllit. ky është edhe kuptimi i ajetit:* **"...dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet**."[1]

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: "Kur zbriti ajeti: **"Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre"**[2] Iblisi (shejtani) u ngjit lart në një mal në Mekë dhe me zë të lartë thirri të gjithë udhëheqësit e ushtrisë së tij. Ata e pyetën se përse na thirre?

[1] Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 10, f, 571.
[2] Sure " Ali Imran" ajeti 135.

- Ka zbritur ky ajet, që mua më bën të dridhem dhe për njerëzit është burim shpëtimi. Kush prej jush mund të përballet me të? – pyeti Iblisi (shejtani).

- Unë mundem, tha një prej shejtanëve të mëdhenj dhe shpjegoi një plan. Por Iblisi (shejtani) nuk e pëlqeu! Kërkoi plan tjetër. Të tjerë u ngritën e thanë planet e tyre, por përsëri nuk u bind. Këtu u ngrit **"uessas khannas"** dhe tha: "Unë e kryej këtë detyrë".

- Në ç'mënyrë? – e pyeti Iblisi.

- Unë do t'i mbaj ata me premtime, derisa ata të përfshihen në mëkat. Kur ata të mëkatojnë, do të kryej veprime që ata të mos pendohen, - u përgjigj ai.

- Ti mund ta kryesh këtë punë (plani yt është tepër i mirë), - tha Iblisi.

Këtë detyrë ia caktoi atij deri në Ditën e Kiametit".[1]

O All'llah! Na ruaj prej gjithë sherreve dhe cytësve të shejtanit (han nas)!

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 557.

O All'llah! Kurthi është i vështirë dhe armiku është i zgjuar. Kurthet e hartuara janë të fshehta dhe nuk ka shpëtim përveçse nëpërmjet mirësisë dhe dëshirës Tënde.

O All'llah! Nuk dimë se si të të falënderojmë për të gjitha mirësitë që na ke dhuruar! Kjo për ne është krenari e madhe dhe sukses, që na ke falur që në këtë orë dhe pas gati 15 vitesh të përfundoj këtë tefsir.

O All'llah! Ti e di që në këto momente gëzimi dhe të mbushura me falënderime, e gjithë qenia ime është e lumtur. Nuk mund ta përshkruaj me fjalë, por i ngre duart lart drejt Teje dhe them: "O Krijues! Në komentimin e këtyre ajeve, mund të kemi gabuar, Ti na i fal të gjitha ato! Shpresoj që edhe robtë e Tu të na i falin!".

Së fundi, dua të them: "O Zot i Mëshirueshëm dhe Bujar, këtë shërbim të paktë, pranoje nga të gjithë ne, me bujarinë Tënde, bëje dhe ruaje për ne nga punët e dobishme në Ditën e Kiametit dhe të Ringjalljes!

Lutja jonë e fundit: "Elhamdulil'lahi Rab'bil Alemin!"

Fundi i sures "En Nas"

Përmbajtja

Sure "En Nebe"....5
Përmbajtja e sures "En Nebe"....6
Mirësitë e leximit të sures "En Nebe"....7
Ajetet 1 – 5....8
Komentimi....9
Lajm i rëndësishëm!....9
Hulumtim....10
1- Çështja e "udhëheqësisë"- "vilajet" dhe e "lajmit të rëndësishëm" - "Nebeul Adhijm"....10
2- Sekreti i këmbënguljes për "Meadin" - "Ringjalljen"....17
Ajetet 6 – 16....19
Komentimi....20
Çdo gjë është me urdhërin Tënd o Zot....20
Hulumtim....35
Lidhja e këtyre ajeteve me çështjen e "Ringjalljes" - "Meadit"....35
Ajetet 17 – 20....37
Komentimi....37
Do të vijë Dita e premtuar....37
Ajetet 21 – 30....45
Komentimi....46
Xhehennemi pritë tmerruese....46
Ajetet 31 – 37....54
Komentimi....55
Premtimi i Allahut për të devotëshmit....55
Hulumtim....62
1- Shpërblimi i të devotëshmve dhe dënimi i mëkatarëve....62
2- Pijet e Xhennetit....63
Ajetet 38 – 40....65
Komentimi....66
Pendimi i madh....66
Hulumtim....76

Vështrim i shpejtë rreth çështjes së "el xhebru uel ikhtijar" - "detyrimi dhe zgjedhja".....76
Sure "En Naziat" 81
Përmbajtja e sures "En Naziat".....82
Mirësitë e leximit të sures "En Naziat".....83
Ajetet 1 – 5.....84
Komentimi.....84
Betimi në engjëjt.....84
Përgjigje për dy pyetje.....90
Ajetet 6 – 14.....92
Komentimi.....92
Britma tmerruese e vdekjes.....92
Ajetet 15 – 26.....98
Komentimi.....99
Shpifja e Faraonit.....99
Hulumtim.....107
Ajetet 27 – 33.....108
Komentimi.....109
Shenjat e hyjnore në sistemin e gjithësisë.....109
Ajetet 34 – 41.....114
Komentimi.....115
Pastrimi nga egoizmi.....115
Hulumtime.....119
1- Ç'është pozita e All'llahut?.....119
2- Marrëdhënia e tiranisë me adhurimin e kësaj bote.....121
Ajetet 42 – 46.....123
Komentimi.....123
Ditën kur do të ndodhë Kiametit, e di vetëm All'llahu i Madhëruar.....123
Sure "Abese" 128
Përmbajtja e sures "Abese".....129
Mirësitë e leximit të kësaj sureje.....129

Ajetet 1 – 10.....130
Shkaku i zbritjes.....131
Komentimi.....131
Qortimi Hyjnor!.....131
Ajetet 11 – 23.....140
Komentimi.....141
Ajetet 24 - 32 152
Komentimi.....153
Njeriu duhet të mendojë për ushqimin e tij.....153
Hulumtim.....164
Përbërësit e shëndetshëm ushqimorë.....164
Ajetet 33 – 42.....166
Komentimi.....167
Britma e ringjalljes.....167
Hulumtim.....172
Bazat e ndërtimit të vetvetes.....172
Surja "Et Tekuijr" 176
Përmbajtja e sures "Et Tekuijr".....177
Mirësitë e leximit të kësaj sureje.....178
Ajetet 1 – 9.....180
Komentimi.....181
Ditën kur çdo gjë do të paloset!.....181
Hulumtim.....187
1- Varrosja e vajzave të gjalla, është një ndër gjërat më të tmerrshme dhe më të dhimbshme që kryhej në epokën e injorancës (Xhahilijetit)...187
Ajetet 10 – 14.....190
Komentimi.....190
Ditën kur njeriu do të shohë ato që ka bërë!!.....190
Hulumtim.....194
Përpushmëria e ajeteve.....194
A shuhet sistemi i diellit dhe i planetëve?.....195
Ajetet 15 – 25.....197

Komentimi.....198
Kur'anin e solli në i Dërguar fisnik.....198
Hulumtim.....209
Ajetet 26 - 29.....211
Komentimi.....211
Ku po shkoni o të shkujdesur?!.....211
Sure "El Infitâr" 216
Përmbajtja e sures "El Infitâr".....217
Mirësitë e leximit të sures "El Infitâr".....218
Ajetet 1 – 5.....219
Komentimi.....220
Në kohën që sistemi i botës të çrregullohet.....220
Hulumtim.....225
Veprat që mbeten nga njeriu.....225
Ajetet 6 – 12.....228
Komentimi.....229
O njeri ç'të bën ty të jesh mendjemadh?!.....229
Hulumtim.....242
Kujdestarët e regjistrimit të veprave.....242
Ajetet 13 – 19.....244
Komentimi.....245
Atë Ditë, askush nuk mund të bëj asgjë për askënd!.....245
Sure "El Mutaffifîn".....251
Përmbajtja e sures "El Mutaffifîn".....252
Mirësitë e leximi të sures"El Mutaffifîn".....253
Ajetet 1 – 6.....254
Shkaku i zbritjes.....255
Komentimi.....257
Mjerë ata që peshojnë mangët!.....257
Hulumtimi.....262
Shitja e mangët është një nga shkaqet e korrupsionit.....262
Ajetet 7 – 10.....266

Komentimi....266
Çfarë është "Sixh'xhijni"?....266
Ajetet 11 – 17....272
Komentimi....273
Ndryshku i mëkateve....273
Dy Hulumtime....278
1- Përse mëkati është ndryshk i zemrës?....278
2- Perdet që mbulojnë fytyrën e shpirtit....281
Ajetet 18 – 28....283
Komentimi....284
Të lartit në pritje të të mirëve....284
Hulumtim....294
Ajetet 29 – 36....299
Komentimi....300
Deri dje talleshin me besimtarët, por...!!....300
Hulumtim....307
Tallja është arma e të dëshpëruarit....307
Sure "El Inshikâk" 309
Përmbajtja e sures "El Inshikâk"....310
Mirësitë e leximit të sures "El Inshikâk"....311
Ajetet 1 – 9....312
Komentimi....313
Përpjekja plot mundim drejt përsosmërisë absolute....313
Hulumtim....321
1- Merre dijen nga Aliu....321
2- Dynjaja vendi i vështirësive....322
Ajetet 10 – 15....323
Komentimi....324
Ata që e marrin nga prapa librin e veprave të tyre....324
Ajetet 16 – 25....329
Komentimi....330
Ligji i ndryshimit!....330

Hulumtim.....340
Sure "El Burûxh" 342
Përmbajtja e sures "El Burûxh".....342
Mirësitë e leximit të sures "El Burûxh".....345
Ajetet 1 – 9.....346
Komentimi.....347
Besimi i rrënjosur është më i mirë se gropat e zjarrit.....347
Dy Hulumtime.....358
Kush ishin "As'hab Ukhdud"?.....358
2- Qëndresa në rrugën e ruajtjes së besimit.....362
Ajetet 10 – 16.....364
Komentimi.....365
Dënimi i Alla'llahut për kriminelët.....365
Ajetet 17 – 22.....370
Komentimi.....371
A nuk ke dëgjuar se çfarë i ndodhi ushtrisë së Faraonit dhe Themudit?!.....371
Sure "Et Târik" 376
Përmbajtja e sures "Et Târik".....377
Mirësitë e leximit të sures "Et Târik".....378
Ajetet 1 – 10 379
Komentimi.....380
O njeri, shiko dhe mendo se nga se je krijuar!.....380
Ajetet 11 – 17.....393
Komentimi.....394
I shkatërroj planet e armiqve.....394
Sure "El A'lâ" 402
Përmbajtja e sures "El A'lâ".....403
Mirësitë e leximit të sures "El A'lâ".....404
Ajetet 1 – 5.....407
Komentimi.....408
Lavdëro emrin e All'llahut tënd!.....408

Hulumtim....414
Ajetet 6 – 13....417
Komentimi....418
Suksesi hyjnor....418
Ajetet 14 – 19....427
Komentimi....428
Programet që kanë ardhur në të gjitha librat qiellorë....428
Hulumtim....433
Sure "El Gâshije" 438
Përmbajtja e sures "El Gâshije"....439
Mirësitë e leximit të sures "El Gâshije"....440
Ajetet 1 - 7....441
Komentimi....442
Të lodhurit e humbur!....442
Ajetet 8 – 16....447
Komentimi....448
Prej mirësive të Xhennetit....448
Ajetet 17 - 26....455
Komentimi....456
Deveja prej shenjave të krijimit të All'llahut....456
Sure "El - Fexhr" 468
Përmbajtja e sures "El - Fexhr"....469
Mirësitë e leximit të sures "El - Fexhr"....470
Ajetet 1 – 5....471
Komentimi....472
Betohem për muzgun e agimit!....472
Ajetet 6 – 14....482
Komentimi....483
Dhënia kohë të padrejtëve dhe hakmarrja!....483
Ajetet 15 – 20....494
Komentimi....495
Qëndrimi i njeriut ndaj dhënies së mirësisë dhe ikjes së saj!....495

Ajetet 21 - 26.....503
Komentimi.....504
Ditën që nuk bën dobi përmendja!.....504
Ajetet 27 - 30.....510
Komentimi.....510
Nderimi madhështor.....510
Sure "El Beled" 515
Përmbajtja e sures "El Beled".....516
Mirësitë e leximit të sures "El Beled".....517
Ajetet 1 – 7.....520
Komentimi.....521
Betohem për këtë qytet të shenjtë!.....521
Ajetet 8 – 10.....530
Komentimi.....530
Mirësia e syrit e gjuhës dhe e udhëzimit.....530
Hulumtime.....535
1- Mrekullia e syrit.....535
2- Çudirat e gjuhës.....539
3- Udhëzimi i dy rrugëve.....540
Ajetet 11 – 20.....542
Komentimi.....543
E vështira!.....543
Hulumtime.....549
1- Fjala "fek rakhabe" ka kuptimin: lirim i skllevërve.....549
Sure "Esh Shems".....553
Përmbajtja e sures "Esh Shems".....554
Mirësitë e leximit të sures "Esh Shems".....555
Ajetet 1 – 10.....556
Komentimi.....557
Hulumtime.....569
1- Marrëdhënia e betimeve të Kur'anit me rezultatin e tij.....569
2- Roli i diellit në këtë botë.....570

Ajetet 11 - 15.....573
Komentimi.....574
Fundi i hidhur i tiranëve.....574
Hulumtim.....581
1- Përmbledhje për përfundimin dhe fatin e popullit të Themudit.....581
2- I ligu i parë, "Eshkil Evelin" dhe i ligu i fundit, "Eshkil Akherin".....583
3- Pastërtia shpirtërore është një detyrë e madhe Hyjnore.....584
Sure "El Lejl".....587
Përmbajta e sures "El Lejl".....588
Mirësitë e leximit të sures "El Lejl".....588
Ajetet 1 – 11.....589
Shkaku i zbritjes.....590
Komentimi.....593
Devotshmëria dhe ndihma e All'llahut.....593
Ajetet 12 - 21.....601
Komentimi.....602
Shpenzimi dhe shpëtimi nga Zjarri.....602
Hulumtime.....609
1- Disa fjalë për shkakun e zbritjes së sures "El Lejl".....609
Mirësia e dhënies për hir të Zotit.....613
Sure "Ed Duhâ".....615
Përmbajtja e sures "Ed Duhâ".....616
Mirësitë e leximit të sures "Ed Dhuhâ".....617
Ajetet 1 – 5.....619
Shkaku i zbritjes.....619
Komentimi.....621
Do të të japë që ti të jesh i kënaqur.....621
Hulumtim.....627
Filozofia e ndërprerjes së ardhjes së Shpalljes.....627
Ajetet 6 – 11.....628
Komentimi.....628
Në falenderim për të gjitha mirësitë e All'llahut.....628

Hulumtime.....640
1- Udhëheqësia që starton nga vështirësitë dhe dhimbjet.....640
2- Përkujdesja ndaj jetimëve.....642
3- Të folurit për mirësitë.....645
Sure "El Inshirâh".....647
Përmbajtja e sures "El Inshirâh".....648
Mirësitë e leximit të sures"El Inshirâh".....651
Ajetet 1 - 8.....652
Komentimi.....653
Mirësitë e Allahut.....653
Hulumtim.....665
Sure "Et Tîn".....669
Përmbajtja e sures "Et Tîn".....670
Mirësitë e leximit të sures "Et Tîn".....670
Ajetet 1 – 8.....671
Komentimi.....672
Sure "El 'Alak".....682
Përmbajtja e sures "El 'Alak".....683
Mirësitë e leximit të sures "El 'Alak".....684
Ajetet 1 - 5.....685
Shkaku i zbritjes.....686
Komentimi.....690
Lexo me emrin e Zotit tend.....690
Hulumtime.....694
1- Rinisja dhe fillimi i Shpalljes u bë bashkë me një lëvizje shkencore.....694
2- Me emrin e Allahut në çdo situtë.....697
Ajetet 6 - 14.....699
Komentimi.....700
Shkaku shkeljes së cakut.....700
Hulumtim.....705
I gjithë universi është në praninë e All'llahut.....705

Ajetet 15 – 19.....706
Komentimi.....707
Suxhudi dhe të afruarit te All'llahu.....707
Hulumtim.....713
Kalimi i cakut dhe ndjesia e vetëmjaftueshmërisë.....713
Sure "El Kadr".....716
Përmbajtja e sures "El Kadr".....717
Mirësitë e recitimit të sures "El Kadr".....718
Ajetet 1 – 5.....719
Komentimi.....720
Nata e Kadrit, Nata e zbritjes së Kur'anit!.....720
Hulumtime.....728
1- Çfarë ndodh në Natën e Kadrit?.....728
2- Cila natë prej netëve është Nata e Kadrit?.....730
3- Përse Nata e Kadrit është e fshehtë?.....731
4- A kanë pasur Natë Kadri popujt e mëparshëm?.....732
5- Në ç'mënyrë Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj?.....733
6- Përse Kur'ani ka zbritur në Natën e Kadrit?.....734
7- A është Nata e Kadrit e njëjtë në të gjitha vendet?.....735
Sure "El Bejjine".....737
Përmbajta e sures "El Bejjine".....738
Mirësitë e leximit të sures "El Bejjine".....739
Ajetet 1 - 5.....740
Komentimi.....741
Kjo është feja e pastër.....741
Ajetet 6 – 8.....749
Komentimi.....750
Krijesa më e mirë dhe krijesa më e keqe.....750
Hulumtime.....754
Aliu dhe pasuesit e tij janë krijesat më të mira.....754
Sure "Ez Zelzele".....759
Përmbajtja e sures "Ez Zelzele".....760

Mirësitë e leximit të sures "Ez Zelzele".....761
Ajetet 1 – 8.....762
Komentimi.....763
Ditën kur njerëzit do të shohin punët e tyre.....763
Hulumtime.....772
1- Saktësia dhe vështirësia në dhënien e llogarisë në Ditën e Kiameti.....772
2- Përgjigje për një pyetje.....773
3- Ajeti gjithëpërfshirës.....775
Sure "El 'Âdijât".....778
Përmbajtja e sures "El 'Âdijât".....779
Mirësitë e leximit të sures "El 'Âdijât".....780
Ajetet 1 - 11.....781
Shkaku i Zbritjes.....782
Komentimi.....784
Betimi në muxhahidinët vizionarë.....784
Hulumtime.....797
1- Lidhja dhe marrëdhënia që kanë këto betime me qëllimet e tyre….797
2- Njeriu, nga natyra, është koprrac.....798
3- Madhështia e xhihadit.....800
Sure "El Kâri'atu".....802
Përmbajtja e sures "El Kâri'atu".....803
Mirësitë e leximit të sures "El Kâri'atu".....803
Ajetet 1 - 11.....804
Komentimi.....805
Ndodhia e Gjëmimit.....805
Hulumtim.....813
Mjetet e rënda të peshores së veprave.....813
Sure "Et Tekâthur".....816
Përmbajta e sures "Et Tekâthur".....817
Mirësitë e leximit të sures "Et Tekâthur".....818
Ajetet 1- 8.....819
Shkaku i zbritjes.....820

Komentimi.....820
Sprova e të pasurit shumë dhe e të krekosurit.....820
Hulumtime.....826
Burimi i krenarisë dhe arrogances.....826
2- Bindja dhe nivelet e saj.....828
3- Të gjithë do ta shikojnë Xhehennemin!.....831
4- Për cilat mirësi do të pyetemi në Kiamet?.....832
Sure "El 'Asr".....835
Përmbajtja e sures "El 'Asr".....836
Mirësitë e leximit të sures "El 'Asr".....837
Ajetet 1 - 3.....838
Komentimi.....838
Rruga e vetme e shpëtimit.....838
Hulumtim.....846
Programi i lumturisë me katër mënyra.....846
Sure "El Humeze".....853
Përmbajtja e sures.....854
Mirësitë e leximit të sures "El Humeze".....855
Ajetet 1 – 9.....856
Shkaku i zbritjes.....857
Komentimi.....858
Mjerë për përqeshësit dhe shpifësit.....858
Hulumtime.....869
Mendjemadhësia është burim i gabimeve të mëdha.....869
Të kesh dëshirë për të mbledhur pasurinë.....870
Sure "El Fîl".....874
Përmbajtja e sures "El Fîl".....875
Mirësitë e leximit të sures "El Fîl".....876
Ajetet 1- 5.....877
Shkaku i zbritjes.....878
Komentimi.....883
Intriga e Abrahas.....883

Hulumtime.....887
1- Mrekullia e jashtëzakonshme! (Kjo shtëpi ka të Zotin e vet!).....887
2- Mrekullitë më të vështira me më pak mjete.....889
3- Qëllimi i ngjarjes së elefantit.....891
4- Ndodhi e skatë historike.....892
Sure "El Kurejsh".....894
Përmbajtja e sures "El Kurejsh".....895
Mirësitë e leximit të kësaj sureje.....895
Ajetet 1 - 4.....896
Komentimi.....897
Zoti i kësaj Shtëpie duhet të adhurohet.....897
Sure "El Mâ'ûn".....902
Përmbajtja e sures "El Mâ'ûn".....903
Mirësitë e leximit të sures "El Mâ'ûn".....903
Ajetet 1 – 7.....904
Komentimi.....905
Mohimi i Ringjalljes dhe ndikimet e tij të këqija.....905
Hulumtime.....910
1- Përmbledhja e pjesëve të sures "El Mâ'ûn".....910
2- Mburrja është një problem i madh i shoqërisë.....910
Sure "El Keuther".....913
Përmbajtja e sures "El Keuther".....914
Mirësive të leximit të kësaj sureje.....916
Ajetet 1 – 3.....917
Komentimi.....917
Të kemi dhënë një mirësi të madhe.....917
Hulumtime.....923
Fatimja *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe Keutheri.....923
Mrekullia e sures "El Keuther".....924
Sure "El Kâfirûn".....927
Përmbajtja e sures "El Kâfirûn".....928
Mirësitë e leximit të sures "El Kâfirûn".....929

Ajetet 1 - 6.....931
Shkaku i zbritjes.....932
Komentimi.....933
Hulumtime.....934
1- Përse surja ka nisur me urdhrin: "Thuaj"?.....934
2- A mos vallë idhujtarët ishin mohues të Zotit?.....935
3- Përse kjo përsëritje e ajeteve?.....937
4- A është leje për adhurimin e idhujve kuptimi i ajetit "Lekum dijnukum..."?.....939
5- All'llahu kurrë nuk ka bërë paqe më shirkun.....939
Sure "En Nasr".....941
Përmbajta e sures "En Nasr".....942
Mirësitë e leximit të sures "En Nasr".....944
Ajetet 1 – 3.....945
Komentimi.....945
Hulumtim.....951
Çlirimi i Mekës, fitorja më e madhe e Islamit.....951
Sure "El Mesed".....961
Përmbajtja e sures "El Mesed".....962
Mirësia e leximit të kësaj sureje.....963
Ajetet 1 – 5.....964
Shkaku i zbritjes.....965
Komentimi.....967
Hulumtime.....974
1- Një tjetër shenjë prej mrekullisë së Kur'anit.....974
2- Përgjigje e një pyetje.....975
Sure "El Ikhlâs".....978
Përmbajtja e sures "El Ikhlâs".....979
Mirësitë e leximit të sures "El Ihlâs".....980
Ajetet 1 – 4.....983
Komentimi.....983
I Vetëm të Cilit i përgjërohet gjithçka.....983

Hulumtime.....996
1- Arsyetimet e Teuhidit.....996
2- Njohjet e Njëshmërisë.....1000
3 – Njohja e njëshmërisë së veprave.....1001
Sure "El Felek".....1006
Përmbajtja e sures "El Felek".....1007
Mirësitë e leximit të sures "El Felek".....1009
Ajetet 1 – 5.....1010
Komentimi.....1011
Te Zoti i agimit mështetem.....1011
Hulumtime.....1016
1- Burimet më të rëndësishme të sherrit dhe të shthurjes.....1016
2- Përshtatshmëria e ajeteve.....1017
3- Ndikimi i magjisë.....1017
4- Sherri i smirliut.....1018
Sure "En Nâs".....1021
Përmbajtja e sures "En Nâs".....1022
Mirësitë e leximit të sures "En Nâs".....1023
Ajetet 1 - 6.....1024
Komentimi.....1025
Zotit të njerëzve i kërkoj ndihmë.....1025
Hulumtime.....1029
1- Përse kërkojmë mbrojtjen e Zotit?.....1029
2- Përse përsëritet fjal "en nas"?.....1030
3- Kuptimi i fjalës khannas në hadithe.....1030

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الثلاثون

تيرانا: 2021

نام كتاب: الامثل فى تفسير كتاب الله المنزل (جزء سى ام)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: رایموندا فزا

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْیَا

ویرایش: یریدا کولا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2021